




Titulli i origjinalit: Πεντηκοστάριον τό χαρμόσυνον

**Pentikostari, për periudhën më të ndritshme dhe më të
gëzueshme të Vitit Kishtar, jepet dhuratë për vëllezërit tanë
të dashur.**

© Manastiri i Hirshëm i Paraklitit, Oropos-Atikë, Greqi

*Duhet të kihen gjithmonë parasysh Udhëzimet në fillim të volumit të
parë të Mujorëve si, p.sh. se “Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër
mbajmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka”.*

*Germat e pjerrëta të këndimet biblike i kemi shtuar
që të na ndihmojnë për t'i kuptuar më mirë.*

O Perëndi, mëshiroji dhe shpëtoji ata që bashkëpunuan
me shpirt dhe u lodhën për himnimin Tënd. Amin.

Lejohet kopjimi i citimeve biblike, por të referohet burimi.

Ἐπιτρέπεται ἡ ἀντιγραφὴ τῶν βιβλικῶν παραπομπῶν μὲ μόνη τὴν ἀναφορὰ
τῆς πηγῆς.

Copyrighting of biblical quotes are permitted; it is necessary only to
reference the source.

Разрешается выписка библейских цитирований; необходимо сделать
ссылку на источник.



JAVA E NDRITSHME
KANUNI DHE VARGËZIMET E
NGJALLJES*

*Kopjuar nga "JAVA E MADHE E
SHENJTË", botim i KOASH-it, Tiranë 2014.*

*Kanuni, poezi e Joan Damaskinoit Ting. I
Ode I*

Irmosi: Anastáseos imera

»Ditë e Ngjalljes, le të ndriçohemi, o
»popuj, Pashka e Zotit,¹ Pashka. Se prej
»vdekjes te jeta² dhe prej dheut në qiell
»na shpuri Krishti Perëndia ynë, duke
»kënduar këngë fitoreje.³

Le të paqësojmë ndjenjat, dhe do të
shohim me dritën e paafruar të Ngjalljes
Krishtin që vetëtin, dhe do ta dëgjojmë
të thotë me zë të lartë Gëzohuni,⁴ duke
kënduar këngë fitoreje.³

Qiejtë le të dëfrejnë siç vlen, dhe le të
ngazëllohet dheu,⁵ dhe tërë bota e dukur
dhe e padukur le të kremtojë, se u ngjall
Krishti, gëzimi i amëshuar.

Zbritësore: Anastáseos imera
Ditë e Ngjalljes.

*[Vetëm gjatë Javës së Ndrishme thuhet
Litani të e Vogla:*

Krishti u ngjall së vdekurish, me vdekje
vdekjen shkeli, edhe të varrosurve, jetën
u fali. (3x)

Kur u ngrit Jisui prej varrit, siç paratha,⁶
na dha jetën e amshuar dhe përdëllimin
e madh.⁷

*Pastaj thuhet Litanja e Vogël "Përsëri
dhe përsëri..." dhe Thirrja "Se yti është
pushteti dhe jotja është mbretëria dhe
fuqia dhe lavdia e Atit..."]*

Ode III

Irmosi: Dhefte poma piomen

»Eni të pimë një të pirë të re, që s'del
»çuditërisht prej një shkëmbi të thatë,⁸ po
»burimin e paprishjes që kërcen prej varrit
»të Krishtit, me të cilin sigurohemi.⁹

Umbushën me dritë të gjitha tani, qielli e
dheu dhe të nëndheshmet; le të kremtojë
pra tërë krijesa Ngjalljen e Krishtit, me të
cilën sigurohet.

Dje varrosesha me Ty, o Krisht, ngrihem me Ty sot që u ngjalle; kryqëzohesha dje me Ty; Ti më lavdëro bashkë, o Shpëtimtar, në mbretërinë tënde.¹⁰

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni të pimë.

[Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall etj. Thirrja “Se ti je Perëndia ynë dhe ty ta drejtojmë lavdinë Atit...”.]

*Ipakoia**

Ting. IV

Kur erdhën gratë me Marinë para agimit dhe gjetën gurin të rrokullisur, dëgjonin prej engjëllit: Atë që rron tek drita e amshuar si e kërkoni si njeri me të vdekurit? Rendni dhe i lëçitni¹¹ botës se u ngrit Zoti, duke vrrarë vdekjen; se është i Biri i Perëndisë, që shpëton gjindjen e njerëzve.

Ode IV

Irmosi: Epi tis thias filakis

»Le të qëndrojmë me ne hyjfolësi Abakum
»mbi ruajtjen¹² e perëndishme, dhe le të
»rrëfejmë engjëllin dritësijellës që thërret
»sheshit: Sot vjen shpëtimi në botë, se u ngjall Krishti si i tërëfuqishëm.

Krishti u tregua si mashkull që çeli gjirin virgjëror;¹³ si njeri u quajt qengj i pacenuar,¹⁴ se nuk njohu njollë, Pashka jonë;¹⁵ dhe si Perëndi i vërtetë, quhet i përsosur.

Si qengj i¹⁶ përmotshëm, theret për të gjithë vullnetarisht¹⁷ kurora jonë e mirë¹⁸ e bekuar, Pashka paqësore; dhe përsëri prej varrit na ndriti i bukuri Diell i drejtësisë.¹⁹

Hyjprindi David²⁰ u hodh, duke kërcyer

përpara arkës së hyjësme;²¹ dhe ne, populli i Perëndisë i shenjtë, duke shikuar mbarimin e simboleve, le të dëfrejmë hyjërisht, se u ngjall Krishti si i tërëfuqishëm.

Zbritësore: Epi tis thias filakis

Le të qëndrojmë me ne.

[Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall etj. Thirrja “Se ti je Perëndi i mirë dhe njeridashës dhe ty ta drejtojmë lavdinë Atit...”.]

Ode V

Irmosi: Orthrisomen orthru vatheos

»Le të mëngojmë qëmenatë,²² dhe le t'i
»blatojmë Zotit himne në vend të miros²³
»dhe do të shikojmë Krishtin, Diellin e
»drejtësisë,¹⁹ që u lind jetën të gjithëve.

Kur panë mëshirën tënde të pamatur ata që përmbaheshin në radhët e Ferit, o Krisht, shpejtonin tek drita²⁴ me këmbë të ngazëlluar, duke trokitur Pashkë të amshuar.

Le t'i dalim përpara me llambadhe në dorë Krishtit që del prej varrit, si një dhëndëri, dhe le të kremtojmë me urdhrat kremtedashës Pashkën shpëtimtare të Perëndisë.¹

Zbritësore: Orthrisomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

[Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall etj. Thirrja “Se i shenjtëruar dhe i lavdëruar është emri yt i gjithënderuar e madhështor, i Atit, i Birit edhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin”.]

*Ode VI**Irmosi: Katilthes en tis katotatis*

»Zbrite në më të poshtmet e dheut dhe
 »dërrmove llozet²⁵ e përjetëshme, që
 ruanin të burgosurit, o Krisht, edhe pas
 »tri ditësh, si Jonai prej balenës,²⁶ kërceve
 »jashtë prej varrit.²⁷

Duke ruajtur vulat të pangara, o Krisht, u
 ngrite prej varrit, Ti që nuk cenove kyçet
 e Virgjëreshës me lindjen tënde, dhe na
 çele dyert e Parajsës.²⁸

O Shpëtimtari im, viktimë e patherëshme
 që më fal jetë, duke i blatur veten Atit
 vullnetarisht, ngjalle Adamin me gjithë
 gjindjen e tij, kur u ngjalle prej varrit.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

[Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall
 etj. Thirrja "Se ti je mbret i paqes dhe
 shpëtimtar i shpirtrave tanë dhe ty ta
 drejtojmë lavdinë Atit..."]

*[Thuhen gjatë Javës së Ndrishme:***Kontaqi, poezi e Romanos Melodistit**Ting. Tërth. IV*

Me gjithë që zbrite në varr, o i Pa-
 vdekshëm, po rrëzove fuqinë e Ferrit; dhe
 u ngjalle si fitimtar, o Krisht Perëndi, duke
 u thënë grave mirapurrëse "Gëzohuni!"⁴
 dhe apostujve të tu u dhurove paqen,²⁹ Ti
 që u fal ngjalljen të rënëve.

Shtëpia

Diellin para diellit, që perëndoi një herë
 në varr, duke mënguar qëmenatë, vajtën
 ta kërkonin si ditë vajzat mirapurrëse³⁰
 dhe i thërrisnin njëra-tjetrës: Ejani, o mike-
 sha, ta lyejmë me aroma trupin jetëpru-
 rës të varrosur, trupin e shtrirë në varr, që

ngjall Adamin fajtor. Ejani, shpejtoni si
 magët, t'i falemi e t'i blatojmë miro për
 dhurata, jo të mbështjellurit ndër shpër-
 ngënj³¹ por në pëlhurë, dhe le të qajmë
 e të thërresim: Ngjallu, o Zot, që u fal
 ngjalljen të rënëve.

Sinaksari i Mujorit dhe i Pashkës:

Të Dielën e Shenjtë të Pashkës së Madhe
 kremtojmë vetë Ngjalljen jetëprurëse
 të Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit
 tonë Jisu Krisht.

Vargje: Krishti zbri kundër Ferrit³² ve-
 tëm,/ u ngjit si mori shumë plaçka
 fitoreje.

E atij është lavdia dhe fuqia në jetë të
 jetëve. Amin.

Ne që pamë Ngjalljen e Krishtit le t'i
 falemi të shenjtit, Zotit Jisu, të vetmit të
 pamëkatshëm.³³ Kryqit tënd po i falemi,
 o Krisht, dhe Ngjalljen tënde të shenjtë
 himnojmë dhe lavdërojmë; se Ti je Pe-
 rëndia ynë, veç teje nuk njohim tjetër,³⁴
 emrin tënd përmendim. Ejani gjithë be-
 simtarët t'i falemi Ngjalljes së shenjtë të
 Krishtit; se ja tek erdhi me anën e Kry-
 qit gëzim në tërë botën; duke bekuar
 kurdoherë Zotin, himnojmë Ngjalljen e tij;
 se duke duruar kryqin për ne, me vdekje,
 vdekjen e zhduku. (3x)

Kur u ngrit Jisui prej varrit, siç paratha, na
 dha jetën e amëshuar dhe përdëllimin e
 madh.⁷ (3x)/

*Ode VII**Irmosi: O Pedhas ek kaminu*

»Ai që shpëtoi Djemtë prej furrës,³⁵
 »pasi u bë njeri, pëson si i vdekshëm
 »dhe me pësimin e tij, vesh njeriun me
 »mirëhijeshinë e paprishjes,³⁶ Perëndi
 »i Etërve tanë, i vetëm i bekuar dhe i

»përmilavdishëm.³⁷

Gratë hyjmendëse me miro të rendën pas;³⁸ dhe Atë që kërkonin me lot si të vdekshëm, e adhuruan me gaz si Perëndi të gjallë,⁴ o Krisht, dhe Pashkën mistike u ungjillëzuan nxënësve të tu.

Kremtojmë vrasjen e vdekjes, rrëzimin e Ferrit, nisjen e një jete tjetër t'amëshuar; dhe, duke kërcyer, himnojmë shkaktarin, Perëndinë e Etërve tanë, të vetmin të bekuar dhe të përmilavdishëm.³⁷

Me të vërtetë e shenjtë dhe e kremtuar prej të gjithëve kjo natë shpëtimtare dhe e ndritëshme, që paralajmëron ditën e shkëlqyer të Ngjalljes, në të cilën *Drita*³⁹ e *pakohshme* u shkëlqeu të gjithëve prej varrit trupërisht.

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu
Ai që shpëtoi Djemtë.

[*Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall etj. Thirrja* "Qoftë pushteti i mbretërisë sate i bekuar dhe i lavdëruar i Atit..."]

Ode VIII

Irmosi: Afti i kliti ke ajia

»**K**jo është ditë e zgjedhur dhe e shenjtë, »e para ditë e javës, mbretëresha dhe »zonja, e kremte e të kremteve,⁴⁰ dhe »panair i panairëve, me të cilën bekojmë »Krishtin përjetë.

Ejani, në ditën e shënuar të Ngjalljes, të kungojmë prej pemës së re të vreshtit,⁴¹ prej dëfrimit të hyjshëm, prej mbretërisë së⁴⁰ Krishtit, duke e himnuar përjetë.

Ngri sytë rreth teje, Sion, dhe shiko; ja se ku të vijnë bijtë e tu, të hyjndritshëm si yje, nga perëndimi dhe nga veriu, nga deti dhe nga lindja,⁴² duke bekuar më ty

Krishtin përjetë.

Atë i tërëfuqishëm dhe Fjalë dhe Shpirt, natyrë e bashkuar me tri hipostaza, i përmblqenshëm dhe i përmblhyshëm, më ty jemi pagëzuar⁴³ dhe ty të bekojmë për gjithë jetët.

Zbritësore: Afti i kliti ke ajia

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

Kjo është ditë e zgjedhur.

[*Gjatë Javës së Ndrishme: Krishti u ngjall etj. Thirrja* "Se i bekuar është emri yt dhe e lavdëruar mbretëria jote e Atit, Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin".]

Ode IX

Irmosi: Fotizu, fotizu

O shpirt, madhështojë atë që duke dashur, pësoi¹⁷ dhe u varros, dhe u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

»**N**driçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri,⁴⁴ »se lavdi e Zotit lindi përmbl ty,⁴⁵ loj valle »tani dhe ngazëllohu o Sion, dhe ti, o »Hyjlindëse e qashtër, dëfre me Ngjalljen »e Birit tënd.

O shpirt, madhështojë Krishtin jetëdhënës, që u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

Krishti është Pashka e re,¹⁵ therorja e gjallë, Qengji i Perëndisë, që ngre mëkatin e botës.⁴⁶

O zëri i hyjshëm, i dashur edhe fort i ëmbël, se me të vërtetë u zotove të jesh deri në mbarim të jetës, o Krisht;⁴⁷ dhe këtë spirancë shpëtimi⁴⁸ duke pasur, ne besnikët ngazëllohemi.

Sot krijes' e tërë gëzohet e ngazëllohet, se Krishti u ngjall dhe Ferri u plaçkit.

O Zëri i hyjshëm...

O shpirt, madhështoje fuqinë e Hyjnisë në tre persona dhe të pandarë.

O Pashka e madhe dhe hierore, o Krisht,¹⁵ o Urtësi dhe Fjalë dhe fuqi e Perëndisë!⁴⁹ Vlerësona të marrim pjesë sheshit te dita e pambrëmëshme e mbretërisë sate.

Gëzohu, Virgjëreshë, gëzohu; gëzohu, e bekuar; gëzohu, e lavdëruar, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

O Pashka e madhe dhe hierore...

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Virgjëreshë e qashtë dhe prapë të them gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

[Gjatë Javës së Ndritshme: Krishti u ngjall etj. Thirrja "Se ty të lavdërojnë tërë fuqitë e qiejve dhe ty ta drejtojnë lavdinë Atit..."]

Dërgimësore

Ting. II Sarki ipnosas

Si fjete si njeri me trup,* o Mbreti ynë Zoti Krisht,* u ngjalle të tretën ditë,* dhe ngrite gjyshin shën Adam,* dhe e dërmmove vdekjen krejt.* Pashkë¹⁵ burim i jetës, shpëtim i besnikëve.* (3x)

Në Lavdërimet [dhe në Pasvargjet] dhe këto të Pashkës:

Ting. Tërth. I

Varg: Le të ngjallet Perëndia, dhe le të shpërndahen armiqtë e tij dhe le të ikin prej faqes së tij, ata që e kanë mëri.

Pashka hierore na u shfaq neve sot; Pashka e re e shenjtë, Pashka mistike, Pashk' e gjithënderuar, Pashka Krishti¹⁵ shpërblyes, Pashka e panjollëshme, Pash-

ka e madhe, Pashka e besnikëve, Pashka që na çeli dyert e Parajsës,²⁸ Pashka që shenjtëron gjithë besimtarët.

Varg: Siç zhduket tymi le të zhduken; siç shkrin qiri nga faqja e zjarrit.

Ejani prej pamjes, gra⁵⁰ miralajmëruese, dhe Sionit thojini: Prit prej nesh ungjillëzime gazi të Ngjalljes së Krishtit; dëfre dhe gëzohu dhe ngazëllohu, o Jerusalem, duke parë Krishtin Mbret të kërcejë si dhëndër prej varrit.

Varg: Ashtu do të humbasin mëkatarët prej faqes së Perëndisë, dhe të drejtët do të dëfrejnë.

Gratë mirapurrëse qëmenatë qëndruan te varri i Jetëdhënësit, gjetën një engjëll që rrinte mbi gurin, dhe ai u foli kështu, duke thënë: Si kërkonti të gjallin me të vdekurit? Si vajtoni si me prishje të paprishurin? Shkoni dhe lëçituni nxënësve të tij.¹¹

Varg: Kjo është dita që bëri Zoti; le të ngazëllohemi dhe le të dëfrejmë në të.

Pashka e gëzuar, Pashka e Zotit Pashka, Pashk' e gjithënderuar na lindi, Pashka me gaz, le të përqafojmë njëri-tjetrin, o Pashkë, shpërblim i helmit, se Krishti sot shkëlqeu prej varrit si prej nusëroreje,⁵¹ dhe i mbushi gratë me gëzim, duke thënë: Lëçituni apostujve.⁴

Lavdi dhe Tani

(ose vetëm Tani kur e kërkon Tipikoja)

Ting. Tërth. I

Ditë e Ngjalljes, le të ndriçohemi prej panairit dhe le të përqafojmë njëri-tjetrin, le t'u themi, vëllezër, dhe atyre që na urrejnë, le t'i ndiejmë të gjitha në ditën e Ngjalljes dhe kështu le të thërresim: Krishti u ngjall së vdekurish, me vdekje vdekjen shkeli, edhe të varrosurve, jetën u fali.

Krishti u ngjall së vdekurish, me vdekje vdekjen shkeli, edhe të varrosurve, jetën u fali. (3x)



TË HËNËN E NDRITSHME NË MËNGJESORE

Prifti (duke temjanisur): Lavdi Trinisë së Shenjtë, të njëqenshme, jetëbërëse dhe të pandarë, gjithnjë, tani e përherë e në jetë të jetëve.

Psaltët: Amin.

Prifti: Krishti u ngjall së vdekurish... (3x)

Dhe gjashtë herë prej psaltëve pas çdo vargu që thotë prifti. Në fund, përsëri nga prifti. Paqësoret dhe Kanuni ngjallësor, të gjitha pikërisht si në ditën e Ngjalljes (Sinaksari i Mujorit dhe i Pashkës). Në Liturgji pikërisht si në ditën e Pashkës, por me Leximet e përshtatshme. Kjo Tipikó është për gjithë ditët e Javës së Ndrishme.

Lavdërimet: 4 Ngjallësore të Tingullit dhe 4 të Pashkës

Ngjallësoret Ting. II

Çdo frymë dhe çdo krijesë...

Le të thonë judenjtë...

Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni...

Engjëlli, o Zot, i solli Hirplotes...

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshimi dialogjisht. Antifonet e Pashkës. Kjo Tipikó është për gjithë ditët e Javës së Ndrishme.



TË HËNËN E NDRITSHME NË MBRËMËSORE

Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoret, pikërisht si në ditën e Pashkës, Thirrtoret Ngjallësore të Tingullit:

Ting. III

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht...

U ndriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde...

Lavdëroj fuqinë e Atit e të Birit...

Kryqit tënd të çmuar i falemi...

Himnojmë Shpëtimtarin që u mishërua...

Krishti zbriti dhe u ungjillëzoi...

Lavdi

Ne të pavyerit që qëndrojmë...

Tani Hyjlindësore Dogmatike

Si të mos admirojmë...

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i Madh:

Ting. i Rëndë

Perëndia yn' në qiell dhe në dhé të gjitha sa deshi i bëri.

Varg a): Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e shtëpisë së Jakovit nga një popull barbar.

Perëndia yn' në qiell...

Varg b): Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Perëndia yn' në qiell...

Varg c): Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Perëndia yn' në qiell...

Le të themi të gjithë... *etj.*

Pasvarg Ngjallësor Ting. III

O Krisht, që errësive diellin me pësimin tënd⁵² dhe ngazëllove gjithësinë me dritën e Ngjalljes sate, prit himnin tonë mbrëmësor, o Njeridashës.*

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Krishti u ngjall (3x) dhe Përlëshimi dialogjikisht. Kjo Tipikó është për gjithë ditët e Javës së Ndrishme.



TË MARTËN E NDRITSHME NË MËNGJESORE

Lavdërimet: 4 Ngjallësore të Tingullit

dhe 4 të Pashkës

Ngjallësoret Ting. III

Ejani, gjithë kombet, njihni fuqinë...

I rrëfyn gjithë çuditë e tua...

Të gjitha u mbushën me gëzim...

Në dritën tënde, o Zot...

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË MARTËN E NDRITSHME NË MBRËMËSORE

Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoret,

Thirrtoret Ngjallësore të Tingullit:

Ting. IV

Duke iu falur Kryqit tënd jetëdhënës...

Mallkimin e drurit të mosbindjes e zgjidhe...

I dërmive dyert e Hadhit, o Zot...

Ejani të përhimnojmë, o popuj...

Engjëj dhe njerëz, o Shpëtimtar...

Dërmive dyert prej bronzi...

Lavdi

O Zot, lindja jote prej Atit është pa kohë...

Tani Hyjlindësore Dogmatike

Profeti David, që prej teje u bë Hyjprind...

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i Madh:

Ting. Tërth. IV

Me zërin tim thirra drej Zotit, me zërin tim thirra drejt Perëndisë dhe më vuri re.

Varg a): Në ditën e shtrëngimit tim e kërkova Perëndinë.

Me zërin tim thirra...

Varg b): Shpirti im mohoi të ngushëllohet.

Me zërin tim thirra...

Varg c): O Perëndi, udha jote është në të shenjtin.

Me zërin tim thirra...

Pasvarg Ngjallësor Ting. IV

O Zot, duke u ngjitur në Kryq, shove mallkimin tonë stërgjyshëror⁵³ dhe, duke zbritur në Skëterrë,³² çlirove robërit ndër shekuj dhe i dhurove gjinisë së njerëzve paprishjen. Prandaj, duke himnuar, lavdërojmë Ngjalljen tënde jetëbërëse dhe shpëtimtare.*

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË MËRKURËN E NDRITSHME NË MËNGJESORE

*Lavdërimet: 4 Ngjallësore të Tingullit
dhe 4 të Pashkës
Ngjallësoret Ting. IV*

O Zot i tërëfuqishëm, që durove kryq...
Me Kryqin tënd, o Krisht, na çlirove...
Me Kryqin tënd, o Krisht Shpëtimtar...
Pa u ndarë nga gjiri prindëror...

*Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre
(fq. 7):*

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË MËRKURËN E NDRITSHME NË MBRËMËSORE

*Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoret,
Thirrtoret Ngjallësore të Tingullit:
Ting. Tërth. I*

Me Kryqin tënd të nderuar, o Krisht...
Ai që i fal Ngjalljen gjinisë së njerëzve...
Çudi e madhe! Krijuesi i të padukurave...
Adhurimin e mbrëmjes ta ofrojmë ty...
Krishtin, kryetarin e shpëtimit tonë...
Rojat udhëzoheshin prej të paudhëve...

Lavdi

O Zot, që plaçkite Hadhin...

Tani *Hyjindësore Dogmatike*

Në Detin e Kuq u përshkrua dikur ikona...

Hyrje. O dritë gazmore.

*Proqimeni i Madh:
Ting. i Rëndë*

Dëgjoje, o Perëndi, lutjen time dhe mos
e shpërfill kërkesën time.

Varg a): Më vë re dhe më dëgjo.

Dëgjoje, o Perëndi...

Varg b): Sepse u kthyen kundër meje me
paligjësi.

Dëgjoje, o Perëndi...

Varg c): Unë thirra drejt Perëndisë.

Dëgjoje, o Perëndi...

Pasvarg Ngjallësor Ting. Tërth. I

Ty, Krishtin Shpëtimtar, që u mishërove
dhe nuk u ndave prej qiejve, me zëra
dhe këngë po të madhërojmë, se durove
Kryq e vdekje për gjininë tonë si Zot nje-
ridashës dhe, pasi theve dyert e Hadhit,
u ngjalle pas tri ditësh, duke shpëtuar
shpirtrat tanë.*

*Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre
(fq. 7):*

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË ENJTEN E NDRITSHME NË MËNGJESORE

*Lavdërimet: 4 Ngjallësore të Tingullit
dhe 4 të Pashkës
Ngjallësoret Ting. Tërth. I*

O Zot, kur ishte varri i vulosur...

O Zot, duke dërrmuar kyçet e përjetshme...

O Zot, gratë rendën në varr...

O Zot, sikundër dole nga varri i vulosur...

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË PREMTEN E BURIMIT JETËDHËNËS*

Poezi e Nikifor Kalist Ksanthopulit

TË ENJTEN NË MBRËMËSORE

Krishti u ngjall (10x) dhe Paqësoret. 10
Thirrtores:

6 Ngjallësore dhe 3 të Burimit në 4
Ngjallësoret Ting. Tërth. II

Duke pasur fitoren...

Sot Krishti, pasi shkeli...

Nga ti, o Zot...

Me Kryqin tënd, o Krisht...

Duke bekuar kurdoherë Zotin...

Lavdi fuqisë sate, o Zot...

Të Burimit

I njëjti Olin apothémeni

Zoti qiellor ka bër' në nisje gjëra mahnit'se* dhe të huaja te ti,* e fort-paqortueshme, se si shi nga lart* zbri-ti,⁵⁴ hyjnuse, qart'* brenda mitrës sate,* të tregoi si burim ty që gufon gjithçka të mir',* rrjedh pa fund bollëk mirëbërjesh tok* shërime përmes ujërash* plot me hir përkundrejt atyre pra* që u nevojitet dhe

forcë shpirtërore, dhe shëndet* trupor, prandaj të nderojmë ty dhe lëvdojmë Birin tënd. (2x)

Ty të quaj saktësisht* manën e qiellit,⁵⁵ Zonjë,* dhe burimin krejt hyjnor* të Parajsës,⁵⁶ në katër anët rrjedh çdo hir* vazhdimisht me çudi* kolosale, kështu* e mbulojnë dheun; kur ky ujë pihet, plotëson* çdo kërkesë që bëjmë gjithë ne;* sa kemi emrin krishteror,* rendim besërisht me gëzim gjithnjë,* nxjerrim shenjtërimin që rrjedh me ëmbëlsi, prandaj krejt ne* po të nderojm', o e Virgjër dhe* e lëvdojmë Birin tënd.

Oe Virgjër, ti gufon* rrjedhje shërimesh përherë* te sa rendin besërisht* drejt burimit tënd, o Hyjnuse, ngaqë nxjerr* falas dhe me bollëk* pra për të sëmuret* çdo shërim; edhe të verbrit që vrapoj' te ti, i bën* të shikojnë qartë, ke ngritur drejt* dhe njerëz që çalonin keq,* ke shëruar dhe paralizën ti;* me tri hedhje uji e ngjalle krejt të vvarin, dhe shërim* për frymëmarrjet e dhimbshme mjaft* si dhe për hidropizit'.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Kush do t'i shprehë fuqitë e tua, o Burim? Përmbushesh me mrekulli të pasosura dhe bën akte të shumta dhe të përmbinatyrshe përmes shërimeve; sa madhështi u rrjedh të gjithëve! Sepse, jo vetëm që i zmbapse sëmundjet e rënda prej atyre që të erdhën me mallëngjim, por i pastron plotësisht edhe pasionet shpirtërore, o e Tërëpanjollshme; dhe me të gjitha këto jep edhe përdëllimin e madh.⁷

Tani *Hyjlindësore Dogmatike*

Ting. Tërth. II

Cili nuk do të të lumërojë, o Virgjërëshë

* Përkthimi i saktë është "JETËPRITËS", por, meqë është e ngulitur, e mbajmë "JETËDHËNËS".

e Tërëshenjtë? Cili nuk do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se Biri yt i Vetëmlindur,⁵⁷ që shkëlqeu prej Atit pa kohë, lindi prej teje së Qashtrës dhe u mishërua⁵⁸ pa shpjegim, duke qenë nga natyra Perëndi, dhe duke u bërë për ne njeri nga natyra, jo i ndarë në dy persona, por i njohur në dy natyra të papërziera. Atij lutju, o Zonjë e Tërëlumur, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i Madh:

Ting. i Rëndë

Do të të dua, o Zot, fuqia ime, Zoti është mbështetja ime, dhe streha ime, dhe shpëtimtari im.

Varg a): Perëndia im, ndihmëtar im dhe do të shpresoj mbi të.

Do të të dua, o Zot...

Varg b): Do t'i thërras Zotit duke e himnuar.

Do të të dua, o Zot...

Varg c): E dëgjoi zërin tim nga tempulli i tij i shenjtë.

Do të të dua, o Zot...

Pasvarg Ngjallësor Ting. Tërth. II

Ngjalljen tënde, o Krisht Shpëtimtar, engjëjt e himnojnë në qiej. Denjësona dhe ne përmbi dhé, që të të lavdërojmë me zemër të pastër.*

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Nëse do, thuaji para atyre (të Pashkës) këto Pasvargje të Hyjlindës:

Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, o jetëpritis burim,* si det i ke çudirat për tërë kozmosin* dhe je oqean mendor, e kalojnë rrjedhjet që ke* lumin Nil në hedhje hiri pasurisht;* je si Siloam⁵⁹ i dyt',* ujë paradoksal gufon* pors prej gurit,*⁸ e pranove krejt energjin'* e Jordanit ti,* manë⁵⁵ shpëtimi shfaqesh ti* dhe transformohesh me tepri vërtet, qartas, pa kursim* sipas nevojës së çdokujt⁶⁰ që të kërkon, çdo gjë e përmbush,* Vajz'-nënë e Krishtit,* dhe gjithmonë i jep botës të madhin përdëllim.⁷

Varg: E shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.

Renë mbiqiellore⁶¹ me himn* të mrekullueshëm, besnikë, ta përhimnojm'* prej qiellit pa rrjedhim derdhi pikën si shi mbi dhé,*⁵⁴ Krishtin Jetëdhënës; është uj' hyjnor* i gjallë që hidhet lart*⁶² dhe nxjerr pavdekësi pa fund,* që nuk sos kurrë* ndërsa pihet pors nektar,* është ambrozí* dhe dëbon etjen që i tret* shpirtrat që, kur e pinin mençurisht, kanë një rrjedhim* të hyjshëm pors prej barkut⁶³ mendor, që derdh pra hir me tepri* si shi mbi të gjithë;* kjo është një bekim, mëshirë, prej Zotit Perëndi.

Varg: Vrullet e lumit dëfrenjë qytetin e Perëndisë.

G'zohu, o jetëpritis burim* që hire me tepri gufon, krua që lëshon* shërime dhe flak çdo forcë të keqe dhe pa fuqi,* për të verbrit ti je rishikim dhe sy,* të kan' të lebrosurit* si pastrim të hyjnueshëm,* nxjerr çdo ilaç, hir* për sëmundjet pafundësisht* te çdokush që vjen,* rend, te tempulli yt me bes';* je si klinikë falas e përbashkët, madhore krejt,* vërtet e gatshme, o nënë e Fjalës Krisht, Zotit Perëndi;* i jep botës mbarë* me bollëk ai

mëshirë të madhe⁷ dhe shpëtim.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O kremtues, le të trumbetojmë me himne, le të kërcejmë dhe le të vallëzojmë duke dëfryer për ujërat e Burimit jetëprurës, që rrjedhin pa sosur. Le të rendin së bashku, mbretër dhe pushtetarë, se i shpëtoi mbretërit, kur i ngriti ata që dergjeshin në shtrat, me anë të prekjës. O barinj dhe të gjithë ne, le të vijmë bashkë dhe të nxjerrim ujin shpëtimtar nga reja plot me shi, pra: Të sëmurët, çlirim; ata që rrezikojnë, fuqinë; të eturit, lehtësimin; të verbrit, sytë; të shurdhët, dëgjimin; të këputurit, shërimin; ata që vdesin, jetëprurësin; të gjithë të duartrokasim për atë që u rrjedh besnikëve gjithkund ujëra shpëtimi dhe të thërrasim kështu: o Virgjëreshë e dëlirë, mos pusho së rrjedhuri nga Burimi i gjallë e i pashtershëm dhe ndërmjeto gjithmonë për shërbëtorët e tu.

Tani *I Pashkës*

Ditë e Ngjalljes... (*f.q. 7*)

Krishti u ngjall... (3x)



TË PREMTEN NË MËNGJESORE

Kanuni i Pashkës (tok me Irmoset) në 8 dhe i Hyjlindës në 6.

I Hyjlindës që ka Akrostihidhë: "I Nikifor Kalist Ksanthopulit".

Tingulli dhe Irmoset e njëjta

Më gufo hir ti, Burim Perëndilindëse, tash,* më jep fjal' ta himnoj mjaft burimin tënd, meqë nxjerr jet'* si dhe hir për ne besnikët, o Virgjëresh',* sepse e burove ti* Fjalën enipostate Zot.

Vajzë, te të gjithë tempulli yt ngjan si

klinik'* e mbinatyrshe, qartë i ngre nga vdekja e sigurt* besimtarët që drejt tij vrapojnë me zell;* buron për të gjithë ne* ëmbëlsi pa kursim, e thjesht'.

Veç ti rrjedh vërtet prej qiellit hir pa fund gjithnjë,* se bën ta shohë dritën sërish i verbri në mjerim* me një balt'⁶⁴ të re kur të mëpasshmin mbret,* Leonin, e thirre ti* përmbi mendje nga lart, Zonjë.

O Mari e thjeshtë, ti je bujarë për të gjith'* njerëzit, ti gëzohu se Bërësi i Gjithësis'*⁶⁵ zbreti qartë përmbi ty si pikë nga lart,*⁶⁴ burim të pavdekshëm ty* të tregoi, Hyjnuse, ty.

Zbritësore: Anastaseos imera

Ditë e ngjalljes.

Ode III

I Hyjlindës

Tempull fort të ndritshëm për Jisun',* Zotin e çdokujt,⁶⁶ unë të di, o Vajzë, si* burim me pavdekësi,* i cili rrjedh ujë, Krishtin pra,* nga pimë mëshirë ne.

Mbreteit shumë hir i jep përmes* ujit ti, o burim-Zonja jon', se e çliron* urinën që mbahej keq* dhe tmerrshëm, se kish gur si penges',* ndërsa uji e lëshon.

Zonjë Virgjëreshë, rrjedh nga ti* pa kursim një bollëk hiri, ndaj kërcejn' për ty* të çalët, numër i madh* pastrohet nga lebra, mbyten krejt* demonët, Hyjlindëse.

Te besnikët mbarë ndan shërim,* te të varfrit, arkondët, sovranët, mbretërit,* te qytetarët e thjesht',* të pasurit; si ilaç unik* u derdh ujë, o burim.

Zbritësore: Defte poma piomen

Eni të pimë.

*Kontaqi i Pashkës**Ndenjësores**Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Ta himnojmë Burimin e shenjtë tok* ne që po e kërkojmë hirin e tij;* gufon rrjedha, është gurr* i pasosur, i gjallë krejt,* përditë nxjerr shërime si rryma që shfaqen pra* të bollshme shumë, sa i kalojnë lumenjtë mbar*;* ndaj, detyrimisht, t'i vijmë afër me besë,* me mall që të marrim ne* nga ai forcë që nuk vdes,* me gëzim tok* shëndet vërtet;* zemrat e besnikëve ky* i mbush me plot freski mirë;* me buzë ne* t'i thërrasim: Je ngushëllim ti për çdo besnik. (2x)

*Ode IV**I Hyjlindëses*

O Virgjëreshë, shumicat e veprave të burimit tënd janë më të shumta se rëra dhe pikat e shiut; rrjedhin vazhdimisht dhe pasurisht mbi tërë dheun dhe shërojnë shpejt çdo të sëmurë.

Uji i burimit tënd, o Zonjë, derdhet mbi gjirin e gruas që e zuri kanceri dhe menjëherë me rrjedhjen pushoi sëmundja vdekjeprurëse dhe gaforrja** mësoi të ecte drejt.

O Perëndilindëse, është qartë e pa-kuptueshme ajo që u bë në ty përmbi natyrë, se uji i burimit tënd bëhet shërim, luftues i sëmundjeve vdekjeprurëse, gjë që nuk e njohu asnjëherë qartë natyra.

O burim, Zonjë Hyjlindëse, armiku më vret gjithnjë me sulmet epshore; mos më shpërfill, arri ti, ndihma e shpejtë, më çliro nga pusitë e tij, që të të himnoj ty të shumëhimnuarën.

** Kancer përkthehet gaforre.

Zbritësore: Epi tis thias filakis

Le të qëndrojmë me ne.

*Ode V**I Hyjlindëses*

O Vajzë e virgjër, kur flitet për gjërat kolosale të burimit tënd, habitet mendja e vdekatarëve, sepse janë mbi natyrë dhe i shenjtërojnë gjithë shpresëplotët.

Hirin tënd e shkroi shtëllunga,⁵⁴ mana,⁵⁵ Siloami,⁵⁹ guri që buronte,⁶⁰ portiku i Solomonit,⁶⁷ rrjedhat e Jordanit dhe pusi i Samaritanes.⁶⁸

O Vajzë e virgjër, pikat e burimit tënd e ngjallën dhe një të vdekur; akti është mbi logjikën dhe mendjen; të gjithë gjërat e tua, o e tërëdëlirë, e tejkalojnë arsyen njerëzore.

O Vajzë që e thave burimin e gjak-rrjedhëses, shëroji sëmundjet, dridhmat, nxehtësinë e flakës, prirjen në dobësi, vështirësinë në urinim dhe flashkësinë e zorrëve.

Zbritësore: Orthrisomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

*Ode VI**I Hyjlindëses*

Ty fjalët, si real burim i Fjalës Krisht,* e dëlirë, të himnojnë, meqenëse kulmin e urtësisë⁶⁹ e lind* ti përmbi çdo mend,* që i var në eter rrjedhjet dhe tokën mbi ujin.⁷⁰

Ufute poshtë shkallës që, me dërmim,* i tmerronte mjaft piktorët që ishin atje, o i Tërëshenjtë Burim,* dhe shpëtove një* popull, kur ra streha posht' prej tërmetit shfarosës.

Me rrjedhjen e burimit tënd, dukshëm,

fort* hap dhe zgjidh papjellorinë e mitrave shterpë më parë, se virgjërisht* linde Krishtin, Zot* mbi të gjitha,⁶⁶ që dhuron bujarisht lindje, Vajzë.

Nuk munden ta himnojnë dot, e dëlir',* lindjen tënde pra, as fjalë, as mendje, as gjuhë, por dobësohen në ty,* shfaqen pa fuqi,* hijeshi oratorike dhe nder filozofësh.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

Kontaqi

Ting. Tërth. V Ti ipermaho

Gufon ti rrjedha* hiri prej burimit tënd pa fund,* mbi mend, nuk shterin* kurrë, ndaj m'i jep prej tij falas,* se mbi fjal' e linde Fjalën, të lyp: Freskomë,* e Hyjhirshme, përmes hirit tënd me mbushulli,* si thesar i çdo të mire tërë dhembshuri,* që të të thërras:* G'zohu, o ujë shpëtimtar.

Shtëpia

O Perëndilindëse e pacen, e thjeshtë, që linde parrëfyeshëm Fjalën e parajetshme të Atit, ma zgjero gojën⁷¹ dhe më jep ndihmë në lavdërimin tënd, që të të mburr duke thirrur drejt Burimit tënd këto:

Gëzohu, o burim i gazit të pafund; gëzohu, o rrjedhje e bukurisë së pashprehshme.

Gëzohu, o katastrofë e sëmundjeve të shumëllojshme; gëzohu, o mbytje e pasioneve të llojllojshme.

Gëzohu, o rrymë tejet e pastër, që u jep shëndet besëmirëve; gëzohu, o ujë shumë i hirshëm për ata që kanë sëmundje të ndryshme.

Gëzohu, o çurg i urtësisë që zhduk injorancën; gëzohu, o përzjerje e zemrës që rrjedh ambrozi.

Gëzohu, o kanë e manës⁵⁵ që rrjedh jetë; gëzohu, o vaskë dhe nektar i hyj-rrjedhshëm.

Gëzohu, ti që tregon daljen e sëmundjes; gëzohu, ti që fik flakën e sëmundjes.

Gëzohu, o ujë shpëtimtar.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Të Premten e Javës së Ndrtitshme, kremtojmë përrurimin e kishës së Zonjës sonë të përmbishenjtë dhe Perëndilindëses, Burimit Jetëpritës; gjithashtu, kujtojmë mrekullitë e përmbinatyrshme që u kryen në të prej Hyjnënës.

Vargje: O Vajzë, cilido e sheh dukshëm burimin tënd/ si manë,⁵⁵ Siloam⁵⁹ dhe portik Solomoni.⁶⁷

Me ndërmjetimet e nënës sate, o Krisht Perëndi, mëshirona.

Ne që pamë Ngjalljen...(3x)

Kur u ngrit...(3x)

Ode VII

I Hyjlindëses

Ju të sëmurët, nxirrni shërime, se e Tërëdëlira rrjedh nga burimi hyjnor ëmbëlsinë autentike, buron përroin e shijimit⁷² të vërtetë; prandaj, të gjithë ne le t'i nxjerrim besërisht krojet e bollshme.

O Zonjë, mrekullitë e tua të huaja i çuditën tërë besnikët që i dëgjojnë, se uji yt i shfaq si folës të mirë memecët dhe të shurdhët, i shëron ata që vuajnë rëndë dhe u dhuron shërim.

Ata që vijnë te ti, i nxjerr prej kaminës së shtrëngimeve, duke i freskuar nga burimi i huaj, o e Thjeshtë; njeriu çlirohet nga kanceri dhe lebra; ti e shëron të lebrosurin dhe i heq infeksionet.

Ju të reja dhe virgjëresha dhe të gj-

thë njerëzit, ta mburrim Zonjën shkëlqyeshëm, me besim nga shpirti, se shëroi vrima prej gozhdësh, plagë të dhimbshme, tumore dhe një paralitik.

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu

Ai që shpëtoi djemtë.

Ode VIII

I Hyjlindëses

O Perëndilindëse, burimi yt rrjedh ujë të hyjshëm dhe të çmuar, se zmbrafs fuqishëm rryma hidropizie me thirrjen e hyjnueshme të Hirrit; prandaj të nderojmë në jetë, o Burim.

Të gjithë le ta nderojmë me zell ujin e çmuar që rrjedh jetë, sepse e ndalon frymëmarrjen e vështirë dhe e çliron nga pengesa. Sa gjëra të çuditshme që bën, o Hyjnënë e kulluar!

Cila gojë do ta mburrë lindjen tënde të habitshme? Dhe cila mendje do ta shikojë burimin e mrekullive dhe do ta duartrokasë me fjalë? S'ka fuqi natyra të çuditet me gjërat e tua.

O Zonjë dhe mbretëreshë, tërë pushteti i vdekjes u zhduk shpejt, se ti nxore Mbretin, jetën⁷³ e pavdekshme, ujin,⁶² manën,⁵⁵ Krishtin në jetë.

Zbritësore: Afti i kliti ke ajia imera

Kjo është ditë e zgjedhur.

Ode IX

I Hyjlindëses

Më lart se çdo ujë, o Vajzë e dëlirë, është* uji yt; nga Burimi,* nga ti, dukshëm u dhuron* shpirtrave forcë plot si dhe shëndet,* se derdhet përmbinatyrshëm dhe jep* çlirim sëmundjesh të rënda mjaft.

Burimin tënd gjith' ne e mbajm' si Siloam⁵⁹ të ri* që shëron çdo sëmundje,* Virgjëreshë, se merr sy* korbi sakat, por edhe çdo njeri;* pa fund, fitojm' mjaft fuqi përjetë,* prandaj të mburrim nga zemra ty.

Sa doni shëndet, shpejt vraponi te burimi ju,* meqë Vajza e virgjër* po banon në ujëra.* O kor i madh i besnikëve mbar',* hidhu, dëfre se kështu do marrësh* në kishë gjithë sa lype ti.

Burim, është ngritur më lart se qiejt uji yt,* i kaloi në tokë* rrjedhat e avushave;* ky është mjaltë prej gurit,⁷⁴ nektar,* mana⁵⁵ që ndahet te besimtarët* dhe ambrozia e shpirtrave.

E Virgjër, i jep mjaft gaz mbretit mbinatyrshëm ti,* se gufon hir përherë* nga Burimi, i dhuron,* kundër armiqve, fuqi dhe shëndet,* paqe, fitore madje gjithmonë* edhe kërkesat ia plotëson.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Virgjëreshë e qashtër dhe prapë të them gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

Dërgimësore e Pashkës

Ting. II Sarki ipnosas

Si fjetë si njeri me trup, o Mbreti ynë Zoti Krisht, u ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt. Pashkë burim i jetës, shpëtim i besnikëve.*

Dhe e Hyjlindëses E ngjashme

Burim i ujit ngjallësor* vërtet ti je se i shëron* sëmundjet fort të vështira*

të trupit edhe të shpirtit* përmes spërkatjes vetëm, thjesht;* Zonjë, rrjedh uj' shpëtimi* që është Jisui Krisht.

Lavdërimi: 4 Ngjallësore, 4 të Hyjlindësës dhe 4 të Pashkës

Ngjallësoret Ting. Tërth. II

Kryqi yt, o Zot, është jetë...

Varrimi yt, o Zot, i çeli Paraajsën...

Bashkë me Atin dhe me Shpirtin...

U ngjalle pas tri ditësh...

Të Hyjlindësës

Ting. II Ikos tu Efrathá

Çdo i sëmur' e ka* pra ujin e Burimit* si shpëtimtar; me besë* të vijmë që të nxjerrim* hir plot ne edhe shenjtërim.

Pusi i gjallë krejt,* Burimi i pavdekshëm,* u jep pa fund shërime* atyre që afrohen* me besë, përkushtim dhe mall.

Varg: E shenjtëroi tendën e tij i Shumëlarti.

Shpirtrat i përforcon* ky uj' i Virgjëreshës,* sa kemi ndotje vesesh,* të rendim drejtas Vajzës,* që t'i pastrojmë ne ato.

Varg: Vrullet e lumit e dëfrejnë qytetin e Perëndisë.

Shtamba e hyjshme mjaft*⁷⁵ e derdh te sa kërkojnë* tash manën me shumicë,* gjithmonë nga Burimi;* ta marrim për nevojën ton'.

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia....

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Në Liturgji, Antifonet e Pashkës. Pas Hyrjes, Krishti u ngjall, Ipakoia dhe Përlëshorja e Burimit. Kontaqi i Pashkës. Sa u pa-

gëzuar... *Apostulli dhe Ungjilli i ditës dhe i Hyjlindësës (kërkoji më 8 shtator). Te Dip-tikët, Madhështimi i Hyjlindësës:*

Tin timioteran ton Heruvim

Ujin e Burimit* që rrjedh jetën,* manën⁵⁵ dhe freskimin* që s'vdes, por që na e dhuron* ambrozin' e huaj,* nektarin mjaft të hyjshëm* dhe mjaltin pra prej gurit,*⁷⁴ me besë ta nderojm'.

Kungatorja e Pashkës.



TË PREMTEN E NDRITSHME NË MBRËMËSORE

“Krishti u ngjall” (10x) dhe Paqësoret, Thirrtoret Ngjallësore të Tingullit: Ting. Tërth. IV

Himn mbrëmësor dhe adhurim...

O Zot, o Zot, mos na hidh tej prej fytyrës sate...

Gëzohu, Sion e shenjtë, Nënë e Kishave...

Fjala, që lindi para jetëve prej Perëndisë Atë...

Lavdërojmë Ngjalljen tënde prej së vdekurish...

Lavdi ty, o Krisht Shpëtimtar, Biri i Perëndisë...

Lavdi

Ty të lavdërojmë, o Zot, që durove Kryq...

Tani Hyjlindësore Dogmatike

Mbreti i qiejve u shfaq mbi dhé...

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i Madh: Ting. Tërth. IV

U dhe trashëgim atyre që e kanë frikë emrin tënd, o Zot.

Varg: Nga skajet e tokës thirra drejt teje.

U dhe trashëgim...

Varg: Do të mbulohem në strehën e kraheve të tu.

U dhe trashëgim...

Varg: Kështu do të psal për emrin tënd në jetë.

U dhe trashëgim...

Pasvarg Ngjallësor Ting. Tërth. I

U ngjite mbi Kryq, o Jisu, që zbritë prej qiellit;⁷⁶ shkove te vdekja ti, o jeta e pavdekshme; Dritë e vërtetë,⁷³ për ata që ishin në errësirë;²⁴ Ngjallja e të gjithë të rënëve. Ndriçimi dhe Shpëtimtari ynë, lavdi më ty.*

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7)

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*



TË SHTUNËN E NDRITSHME NË MËNGJESORE

*Lavdërimet: 4 Ngjallësore të Tingullit
dhe 4 të Pashkës*

Ngjallësoret Ting. Tërth. IV

O Zot, megjithëse vajte në gjykatore...

O Zot, megjithëse të vunë judenjtë...

O Zot, armë kundër djallit...

Engjëlli yt, o Zot, që lëçiti Ngjalljen...

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7).

Varg: Le të ngjallet Perëndia...


Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

CITIME

1. Eks. 12.11 etj.
2. I Joan 3.14
3. Eks. 15.1
4. Math. 28.9-10
5. Ps. 95(96).11
6. Mark. 8.31; 9.9,31; 10.34; Lluk. 18.33
7. Num. 14.19 etj.
8. Eks. 17.6; Num. 20.11; Ligji i Dytë 8.15; Ps. 77(78).15-16,20
9. I Mbret. [Sam.] 2.1
10. II Tim. 2.11-12
11. Matth. 28.2-7; Mark 16.5-7
12. Abak. 2.1
13. Eks. 13.2; Num. 8.16; Lluk. 2.23
14. Lev. 3.6; 23.12; Num. 6.14
15. I Kor. 5.7
16. Eks. 12.5 etj.
17. Joan 10.15,17-18
18. Ps. 64(65).12
19. Mal. 4.2 (3.20)
20. Lluk. 1.32
21. II Mbret. [Sam.] 6.5,14-15
22. Ps. 62(63).2; Is. 26.9
23. Lluk. 23.56
24. Is. 9.2; Matth. 4.16
25. Ps. 106(107).16
26. Jona 2.1,11
27. Matth. 12.39-40; 16.4; Lluk. 11.29-30
28. Gjen. 3.24
29. Joan 20.19,21,26
30. Math. 28.1; Mark. 16.1-2; Lluk. 24.1
31. Math. 2.1-11
32. I Petr. 3.19; 4.6
33. Joan 8.46
34. Is. 26.13
35. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
36. I Kor. 15.53
37. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
38. Kënga 1.4
39. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
40. Eks. 12.16; Lev. 23.2-3,7-8,21,24,27,35-36; Num. 28.25
41. Math. 26.29; Mark. 14.25
42. Is. 49.18-22; 60.4
43. Matth. 28.19
44. Apok. 3.12; 21.2
45. Is. 60.1
46. Joan 1.29
47. Math. 28.20
48. Hebr. 6.19

- | | |
|--|--|
| 49. I Kor. 1.24,30 | 63. Joan 7.38 |
| 50. Is. 27.11 | 64. Joan 9.6 |
| 51. Ps. 18(19).6 | 65. Joan 1.3; Kol. 1.16 |
| 52. Matth. 27.45; Mark. 15.33; Lluk. 23.44 | 66. III Makk. 2.2 |
| 53. Gjen. 3.16-19 | 67. 6Joan 5.2-3 |
| 54. Gjyq. 6.37-38; Ps. 71(72).6 | 68. Joan 4.5-7 |
| 55. Eks. 16.35 etj. | 69. Rom. 11.33; I Kor. 1.24 |
| 56. Gjen. 2.10 | 70. Ps. 135(136).6 |
| 57. Joan 1.14,18; 3.16-18; I Joan 4.9 | 71. I Mbret. [Sam.] 2.1; Ps. 80(81).11 |
| 58. I Tim. 3.16 | 72. Ps. 35(36).9 |
| 59. Joan 9.7-11 | 73. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20 |
| 60. Fil. 4.19 | 74. Ligji i Dytë 32.13; Ps. 80(81).17 |
| 61. Eks. 13.21-22; 14.19-24; 16.10; 19.9; Is. 19.1 | 75. Eks. 16.33; Hebr. 9.4 |
| 62. Joan 4.14 | 76. Joan 3.13; 6.38 |





E DIELA E THOMAIT
Nuk psalet asnjë ngjallësore.
TË SHTUNËN
NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtores

Ting. I Ton uranion tagmaton

Krishti, pasi u ngjall nga varri pas tri ditësh, ndonëse varri ishte i vulosur,¹ pranon prekjen nga njeridashja sikundër dhe para saj Kryqin dhe vrasjen e padrejtë; dhe, si i tërëfuqishëm, iu vajti papritur Nxënësve edhe pse dyert ishin të mbyllura. (2x)

Mosbesimi i Thomait prek me të djathtën kureshtare me guxim për verifikim universal shpimin e duarve dhe të këmbëve; dhe vërteton ngritjen botëshpëtuese të Fjalës Perëndinjeri nga bodrumet e Hadhit.

Kur ishin mbledhur apostujt nga frika e pësimit tënd, o Fjalë, dhe dyert ishin të mbyllura, hyre papritur mes tyre duke iu dhuruar paqe, dhe i the Thomait t'i prekte

traumat e nderuara të brinjës sate.

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Pas ngritjes sate, o Zot, kur Nxënësit e tu ishin të mbledhur dhe dyert të mbyllura, qëndrove në mes dhe u dhe paqe. Dhe, meqë u bind dhe Thomai kur pa duart dhe brinjën tënde, të pohoi si Zot dhe Perëndi që i shpëton ata që shpresojnë te ti, o njeridashës.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

O vdekatarë, himnojeni me buzë të pastra bashkë me engjëjt të ngjallurin nga varri pas tri ditësh, që e ngriti botën bashkë me veten e tij.

Varg: Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion.

O Shpëtimtar, iu shfaqe apostujve të tu të shenjtë kur dyert ishin të mbyllura, duke na dhënë për herë të parë Shpirtin tënd Hyjnor me anë të tyre.

Varg: Se i përforcoi shulat e portave të tua, i bekoi bijtë e tu në ty.

O Tërëmbret, duke të parë tani jo me sy, por me mallëngjim zemre, të besojmë si Perëndi dhe të madhërojmë me himne.

Lavdi *dhe* Tani *I ngjashëm*

O Çlirimtar, i jep paqe popullit tënd² dhe zgjidhjen e fajeve me ndërmjetimet e së Tërëdëlirës dhe Hyjnënës së vetme.

Përlëshore



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pas bekimit të priftit, Krishti u ngjall (3x, si dhe në fillim të çdo shërbese deri në Mbylljen e Pashkës).

*10 Thirrtores Idhiomele,
poezi e Joan Monakut
Ting. I*

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, u fute befasisht, o i tërëfuqishmi Jisu, Perëndia ynë; dhe, pasi qëndrove midis tyre dhe u dhe paqe, i mbushe me Shpirtin e Shenjtë dhe i urdhërova të prisnin dhe të mos largoheshin fare nga Jerusalemi derisa të visheshin me fuqi nga lart; prandaj të thërrasim: O ndriçimi, ngjallja³ dhe paqja jonë,² lavdi më ty. (2x)

Tetë ditë pas ngritjes sate, o Zot, u shfaqe te Nxënësit e tu në vendin ku ishin mbledhur; dhe, pasi iu thirre “Paqe në ju”, i tregova Nxënësit që s’besonte, duart dhe brinjën e pacen; dhe ai u bind dhe të thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty”. (2x)

Thomai që quhej binjak, nuk ishte me ta kur hyre, o Krisht, edhe pse dyert ishin

të mbyllura, ndaj nuk i besonte ato që i kishin thënë, pra prej mosbesimit na siguronte në besim; o i mirë, nuk refuzove t’ia tregojë brinjën tënde pa cen dhe plagët e duarve dhe të këmbëve; dhe ai, sapo i preku dhe i pa, të pohoi si Perëndi jo të zhveshur nga veçoritë dhe jo si njeri sipërfaqësor; dhe thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty. (2x)

Ditën e tetë, ndërsa Nxënësit ishin duke dysuar, Shpëtimtari erdhi befas atje ku ishin të mbledhur. Dhe, pasi u dha paqe, i thirri Thomait: “Eja, apostull, prekmi pëllëmbët që m’i karfosën me gozhdë”. O mosbesimi i mirë i Thomait! Zemrat e besnikëve i çoi në njohuri; dhe ai thirri me frikë: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty. (2x)

Ting. II

Pas ngritjes sate, o Zot, kur Nxënësit e tu ishin të mbledhur dhe dyert të mbyllura, qëndrova në mes dhe u dhe paqe. Dhe, meqë u bind dhe Thomai kur pa duart dhe brinjën tënde, të pohoi si Zot dhe Perëndi që i shpëton ata që shpresojnë te ti, o njeridashës.

Kur dyert ishin mbyllur, Jisui u erdhi Nxënësve papritur dhe u dha guxim e paqe. Pastaj i tha Thomait: Pse nuk më beson që u ngjalla prej së vdekurish? Sille këtu dorën tënde të djathtë dhe vendose në brinjën time dhe shih; sepse, me mosbesimin tënd, i mësuan të gjithë pësimet dhe ngjalljen time, që të thërrasin tok me ty: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

O Krisht, shkove te Nxënësit kur dyert ishin të mbyllura; Thomai, me plan hyjnor, nuk ishte atëherë me ta, se thoshte:

“Nuk besoj fare nëse nuk e shikoj edhe unë Zotin, brinjën nga doli gjaku, uji⁴ dhe pagëzimi, plagën që shëroi traumën e madhe, njeriun; nuk besoj nëse nuk shikoj që nuk ishte frymë, por mish dhe kocka”. O Zot, ti që e shkele vdekjen dhe e informove Thomanë, lavdi më ty.

*Hyrje. O dritë gazmore.
Proqimeni i ditës (Zoti mbretëroi...).*

*Në Liti Idhiomele
Ting. IV*

O Zot, me lavdinë e Hyjnisë sate të panxënshme, ndërsa dyert ishin të mbyllura, shkove dhe qëndrove në mes të Nxënësve dhe iu zbulove brinjën; dhe, kur iu tregove traumat e duarve dhe plagët e këmbëve, e zhduke zyrtësinë e trishtimit⁵ dhe the qartë me zë të lartë: “Siç më shihni, o miq, kam marrë natyrën e mishit, nuk jam frymë”. Dhe e nxite Nxënësin që dyshonte, të të prekte frikshëm duke thënë: “Hulumtoji të gjitha dhe mos dysho!”. Dhe ai, sapo ndjeu në dorë esencën tënde të dyfishtë, thirri me tmerr i nxitur prej besimit: “Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty”.

Ting. Tërth. IV

Krishti thotë: “Prekma brinjën me dorë, o Thoma, shihi shenjat e gozhdëve, heto me besim dhe bëhu besimtar dhe jo mosbesues”. Dhe Thomai, sapo e preku me gisht Zotin, thirri fuqishëm: “Ti je Perëndia dhe Zoti im, o i dhembshur, lavdi më ty”.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, Shpëtimtari shkoi atje ku ishin së bashku. Dhe, pasi qëndroi mes tyre, i thotë Thomait: Eja, prekmë

dhe shihi shenjat e gozhdëve, tendose dorën, preke brinjën time dhe mos u bë mosbesues, por predikoje me besim ngjalljen time prej së vdekurish.

Pasvargje Idhiomele Ting. IV

O çudi paradoksale! Mosbesimi lindi një besim të sigurt, sepse, kur Thomai tha: “Nuk besoj nëse nuk shikoj” dhe kur e preku brinjën, e theologoi të mishëruarin si vetë Birin e Perëndisë, e njohu si të pësuar në trup, dhe e shpalli Zotin e ngjallur, dhe thirri me zë të shkëlqyer: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Varg: Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion.

O çudi paradoksale! Edhe pse e preku zjarrin, kashta shpëtoi se, kur e vuri dorën në brinjën e flaktë të Jisu Krishtit, Thomai nuk u dogj nga prekja, sepse mosbindjen e shpirtit e shndërroi nxehtësisht në besim; ndaj thirri nga thellësia e shpirtit: Ti je Zoti dhe Perëndia im që u ngrite nga të vdekurit, lavdi më ty.

Varg: Se i përforcoi shulat e portave të tua, i bekoi bijtë e tu në ty.

O çudi paradoksale! Joani ra në kraharorin e Fjalës,⁶ ndërsa Thomai u denjësua ta prekte brinjën. I pari nxori nga atje frikshëm thellësinë e thelogjisë, Ekonominë. Tjetri u vlerësua të na mësonte misteret, meqë na paraqet fuqishëm argumentet e ngritjes duke thirrur: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. I

O njeridashës, shumica e dhembshurive të tua është e madhe dhe e paimagjinueshme, meqë u tregove zemërgjerë kur judenjtë të godisnin me shuplakë,⁷

apostulli të prekte dhe mohuesit të hulumtonin me dashakeqësi. Si u mishërove? Si u kryqëzove, ti që je i pamëkatshëm?⁸ Por, urtësona që të të thërrasim si Thomai: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Përlëshore Ting. i Rëndë

Duke qenë varri i shiluar,¹ o jetë,⁹ linde prej varrit, o Krisht Perëndi; dhe, duke qenë dyert mbyllur, u qëndrove përpara Apostujve, o ngjallja³ e të gjithëve, dhe përsërite ndër ne frymë të drejtë me anën e tyre, pas përdëllimit tënd të madh.^{10*}

(3x)



NË MËNGJESORE

[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kanunin Triadik).]

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore Ting. Tërth. I Tu lithu sfracisthentos

Kur ishin fshehur Nxënësit mbarë plot me frikë * nga judenjtë dhe në Sion ishin mbledhur, o i Mirë,* u fute dhe ndenje në mes, Zot,* u dhe gaz kur qen' dyert mbyllur krejt;* u tregove brinjën tënde dhe traumat* e brinjës pa cen, i the pra* Nxënësit mosbesues, Zoti Krisht:* Eja dhe vëre dorën ti* edhe hulumto, un' jam ai që për ty vuajta. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore Ting. I Ton tafon su Sotir

U vajte Nxënësve,* jetë, Krisht,⁹ sado dyert* qen' mbyllur mirë dhe ua tregove ti duart* dhe këmbët, si dhe brinjën tënde kur verifikoje fort* ngritjen prej varrit,* veçse nuk ndodhej Thomai,* ndaj u thoshte ky:* S'besoj te fjalët që thoni,* po s'e pashë edhe vet'. (2x)

Pas Polieleit, Ndenjësore E ngjashme

“Thoma, meqë e pe* brinjën time dhe shpimet* nga gozhdët, s'e beson ngjalljen time?”, i thoshte* Jisui kur u ngrit nga varri dhe shfaqej te Nxënësit* parrëfyeshëm,* prandaj Binjaku u bind krejt* dhe i thirri fort* Ndërtuesit, Krijimtarit:* Je Zoti im Perëndi. (2x)

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV Proqimeni Ting. IV

Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion.

Varg: Se i përforcoi shulat e portave të tua, i bekoj bijtë e tu në ty.

Ungjilli. Ne që pamë ngjalljen... Psalmi 50.

Ting. II Lavdi

Me ndërmjetimet e apostujve...

Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...

Përdëllemë, o Perëndi...

I njëjti

Kur u ngrit Jisui prej varrit, siç paratha, na dha jetën e amshuar dhe përdëllimin e madh.

Kanuni, poezi e Joan Monakut.

Irmoset në 2 dhe Troparet në 12.

Ting. I

Ode I

Irmosi: Ásomen pantes lai

»E nxori prej skllavërisë vrer të faraonit* »Izraelin Zoti edhe në det, në fund,* e »çoi pa iu lagur hiç këmbët; ndaj t'i psalin »popujt mbar'* një ode triumfi, sepse u lëvdua fort.¹¹

Ësht' shpirtërorja pranverë sot, meqë, nga varri,* Krishti shndriti pas tri ditësh

si dielli* dhe dimrin mjaft të errët të fajit tonë e dëboi larg;* këtë ta himnojmë sepse u lëvdua fort.

Sot, mbretëresha e stinëve, si shërbëtore,* feks një dit' drit'prurëse, mbretëreshën pra* të ditëve edhe e gëzon dhe popullin e shquar fort* të Kishës; dhe Krishtit të ngjallur i psal pa fund.

Nuk rezistuan ndaj teje, o Krisht, shula dyersh* dhe as vula varri,¹ portat e vdekjes helm;* por, si u ngjalle, erdhe, o Zot, te miqtë e tu dhe u dhe,* u fale atyre, ti paqen që është' mbi mend.¹²

Zbritësore: Anastáseos imera

Ditë e Ngjalljes. (fq. 3)

Ode III

Irmosi: Steréosón me Hristé

»**M**ë siguro ti, o Krisht,* mbi gurin¹³ e »porosive që dhe,* me dritën e pamjes »sate¹⁴ shkëlqemë pra,* se, o njeridashës, »s'ka tjetër shenjtë veç teje.¹⁵

Me Kryqin tënd, Zoti Krisht,* ne, nga të vjetër, ti na ke bërë* të rinj, na nxore nga prishja ku kishim rënë* dhe urdhër na dhe për një jet' të re denjësisht.¹⁶

I papërshkruari Krisht,* në varr e mbylle trupin përshkrues* që pate, i tërëfort', por te Nxënësit* i ngjallur u duke kur dera që mbyllur pra.

I ruajte si dëshmi* për ngjalljen tënde të lavdëruar,* Krisht, plagët që i pësove vullnetarisht*¹⁷ për ne, dhe i shfaqe te Nxënësit e tu, Zot.

Zbritësore: Defte poma plómen

Eni të pimë.

Ipakoi Ting. Tërth. II

Siç arrite në mes të Nxënësve të tu, o Shpëtimtar, dhe u dhe paqe, eja dhe te ne dhe shpëtona.

Ode IV

Irmosi: Mega to mistírion

»**M**isteri i Ekonomisë sate është i madh, »o Krisht, sepse, duke e parashikuar që »nga fillimi me shikim hyjnor, Abakumi »thërriste: Dole për shpëtimin e popullit »tënd,¹⁸ o njeridashës.

Dikur, Krishti shijoi vrer¹⁹ dhe e shëroi shijimin e lashtë;²⁰ ndërsa tani, me shijimin e huallit të mjalit,²¹ ia përçoi stëratit ndriçimin dhe pjesëmarrjen e tij të ëmbël.

Gëzohesh kur hulumtohesh, o Krisht njeridashës, ndaj e paraqet brinjën dhe e nxit Thomanë që nuk besonte, ta shikojë, dhe kështu ia siguron botës ngjalljen tënde të triditshme.

Binjaku e mbush botën me urtësi dhe njohuri, të cilat i nxori nga thesari i pagrabitur i brinjës sate hyjnore që u shpua prej shtizës, o Mirëbërës.⁴

Gjuha jote e tërëlumur lumërohet, o Binjak, sepse ajo është e para që e shpall besërisht Jisu jetëdhënësin si Perëndi dhe Zot, pasi u mbush me Hir nëpërmjet prekjes.

Zbritësorja: Epi tis thias filakis

Le të qëndrojë me ne.

Ode V

Irmosi: Ek niktós orthrízontes

»**D**uke mënguar qëmenatë,²² të him- »nojmë ty, o Krisht, që je i bashkëpafi- »llim me Atin dhe Shpëtimtari i shpirtrave

»tanë; jepja paqen tënde botës, o njeri-
»dashës.²

Pasi shkoi te miqtë e tij të zyrtë, Shpëtimtari, me prezencën e tij, e flak tërë apatinë⁵ dhe i nxit të kërcejnë për ngjalljen e tij.

O atentat i frikshëm i Thomait, që vërtet lavdërohet se e preku guximshëm brinjën që shkëlqente shumë nga zjarri hyjnor!

Mosbesimin e Thomait na e tregove si lindëse të besimit, se, nëpërmjet urtësisë sate, i rregullon me providencë të gjitha për dobinë tonë, si njeridashës, o Krisht.

Zbritësorja: Orthrísomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

Ode VI

Irmosi: Ton profitin dhiésosas

»Njeridashës, shpëtove krejt* një profet
»nga një peshk i madh;* të lutem, ti
»nxirrme dhe mua* nga fundi²³ i fajeve.

Kur Thomai po zhytej, Zot,* në humnerën e pabesis*,* s'e le kur i shtrive pëllëmbët* të bënte kërkim ai.

«Shihni duke më prekur ju:* Un' kam eshtra dhe mish», u tha* kështu Shpëtimtari yn', Krishti,* «meqë s'u ndryshova hiç».

Preku brinjën Thomai shenjt* dhe besoi, kuptoi pra;* nuk ishte në hyrjen e parë* kur erdhe, o Shpëtimtar.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

Kontaqi Ting. Tërth. IV

Me të djalhtën kureshtare, Thomai e hetoi brinjën tënde jetëdhënëse, o Krisht Perëndi; se, kur u fute, megjithë-

se dyert ishin të mbyllura, të thërriste bashkë me Nxënësit e tjerë: Ti je Zoti dhe Perëndia im!

Shtëpia

Kush e ruajti të padjegur pëllëmbën e Nxënësit atëherë kur u afrua te brinja e zjarrtë e Zotit? Kush ia dha një guxim të tillë sa arriti të prekte kockë të përfllaktë? Patjetër që ia dha brinja që preku; nëse ajo nuk do t'i kishte dhënë fuqi së djalhtës prej balte, si do të ishte e mundur t'i prekte pësimet që i lëkundën të sipërmet dhe të poshtmet?²⁴ Thomait iu dha ky hir që ta prekte dhe t'i thërriste Krishtit: Ti je Zoti dhe Perëndia im!

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Dielën e dytë pas Pashkës, kremtojmë ripërtëritjen e Ngjalljes së Krishtit dhe prekjen e apostullit të shenjtë Thoma.

Vargje: Në qoftë se çelësi i mitrës ose i varrit,¹ o Shpëtimtar, nuk e pengon vullin tënd,/ si do ta pengojë çelësi i dyerve? Me ndërmjetimet e apostullit tënd Thoma, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: Ikoni latrevin

»Djemtë, duke kënduar himne nga »odet e Sionit²⁵ të atit të tyre David, e »shkatërruan dekretin e shëmtuar të ti- »ranit, teksa simfonia muzikore i ftonte »popujt ta adhuronin ikonën.²⁶ Dhe ata e »shndërronin flakën në vesë duke psalur »himn: O Perëndi i përmbilartësuar i etër- »ve dhe yni, je i bekuar.²⁷

Është si e para dhe kryetarja²⁸ e ditëve kjo dita dritëprurëse, në të cilën ngazëllohet populli i ri dhe i hyjshëm. Tmerrshëm,

ka simbolizmin e përjetësisë, meqë është e teta e së ardhmes. O Perëndi i përmbilartësuar i etërve dhe yni, je i bekuar.²⁷

Vetëm binjaku Thoma pati guxim dhe, me besim prej mosbesimit, na bëhet mirëbërës, ndërsa e shpërbën për hir të të gjitha anëve paditurinë e errët dhe e thur qartë kurorën për veten e tij duke thënë: Ti je Zot, Perëndia i përmbilartësuar i etërve dhe yni; je i bekuar.²⁷

Thomai nuk dyshoi kot për Ngritjen tënde dhe nuk e pohoi, por nxitonte ta argumentonte pa diskutim në mbarë kombet, o Krisht; ndaj, me anën e mosbesimit, na siguroi të gjithë dhe na mësoi të themi: Ti je Zot, Perëndia i përmbilartësuar i etërve dhe yni; je i bekuar.²⁷

Kur e vuri i frikësuar dorën në brinjën tënde jetëprurëse, Thomai i ndjeu me tmerr të dyja energjitë e të dyja natyrave të tua të bashkuara pa ngatërrim te ti, o Krisht Shpëtimtar, dhe thërriste fort me besë: Ti je Zot, Perëndia i përmbilartësuar i etërve dhe yni; je i bekuar.²⁷

Zbritësorja: O Pedhas ek kaminu

Ai që shpëtoi djemtë.

Ode VIII

Irmosi: Ton en floji pirós

»Zotin që i ruajti Djemtë në flakët e zja-
»rrit në kaminë të ndezur, dhe zbriti afër
»tyre me pamje engjëlli,²⁷ himnojeni dhe
»përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Sado e dëshironte pamjen tënde gaz-
more, Thomai s'kishte besim më përpara;
mirëpo, kur u denjësuua për të, o Krisht,
të quante Perëndi dhe Zot; të përmbilar-
tësojmë në gjithë jetët.

Zotin që e duroi mosbesimin e Thomait dhe e tregoi brinjën që u hulumtua nga pëllëmba e tij, himnojeni dhe përmbilartësojeni në gjithë jetët.

O Thoma, kureshtja jote na hapi një thesar të fshehur se, duke theologuar me gjuhë hyjprurëse, thoshe: Himnojeni dhe përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Zbritësore: Afti i kliti ke ajia

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

Kjo është ditë e zgjedhur.

Ode IX

Irmosi: Se tin fainin llambadha

»Ty, pra llambën plot me dritë,* lavd i
»denj' fort për zili,* nënë e Perëndisë,*
»e cila je më lart se krijesat mbarë,* me
»himne po të madhështojm'.

Ditën tënde të shkëlqyer* plot me dritë,
o Krisht Zot,* hirin e tërëdritshëm,* pra
në të cilën erdhe i hyjshëm bukur*²⁹ te
Nxënësit, e madhështojm'.

Ty që prej pëllëmbë balte* ishe prekur,
Krisht, në brinj',* dhe s'e dogje me zjarrin*
që ka esenca pa lëndë dhe hyjnore,* me
himne po të madhështojm'.

Sado nuk të pam' me sy ne,* të besuam
me dëshir',* me mall zemre, o Krisht
Zot,* ty që u ngjalle si Perëndi nga varri;*
me himne po të madhështojm'.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Vir-
gjëreshë e qashtër dhe prapë të them
gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh
prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

Dërgimësore: O uranón tis astris

Thoma, me dorën tënde* gjurmoji traummat që kam* në gjymtyrë unë që mjaft* për ty pësova, ki besim,* ki një mendim me apostujt,* dhe Perëndi të gjall' shpallmë. (2x)

Sot mban er' pranverore,* e reja botë¹⁶ po kërcen* dhe sot ngrihen lloze dyersh* dhe mosbesimi ndërkoh' që* Thomai, mi-ku, thërret fort:* Je Zoti im, Perëndia.

Lavdërime

Ting. I Panëfimi mártires

I ngritur nga varri yt plot tmerr,* o Zot, Jetëdhënës Krisht,* s'i zgjidhe vulat e varrit¹ dhe ashtu u fute ti* teksa ishin mbyllur* dyert, mes apostujve të tu të lavdëruar mjaft e u dhe hare, dhe Shpirtin tënd* krejt të drejtë, se ke përdëllim* të pamasë, Shpëtimtar me dhembshuri.(2x)

Binjaku Thoma nuk qe atje* kur u vajte Nxënësve* edhe iu shfaqe, s'besoi pra në ngjalljen tënde, Zot;* ndaj u tha atyre* që të kishin par': Po s'vura gishtin tim në brinjën e tij, në shenjat e gozhdimit pra,* nuk besoj dot se u ngjall ai* nga të vdekurit, nga varri dhe u shfaq.

I thirri Thomait Zoti Krisht:* "Në do, vëre dorën, m'prek* dhe shih që kam trup nga dheu, kocka, edhe mos dysho,* mos ji mosbesues,* veçse bëhu ti porsi të tjerët". Atëherë ky thirri: "Ti je Perëndia im,* Zoti im, o Shpëtimtari im;* lavdi ngjalljes sate jetëprurëse".

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

Tetë ditë pas ngjalljes sate, mbreti Jisu, Fjala e vetëmlindur e Atit, u shfaqe te Nxënësit e tu kur dyert ishin të mbyllura, edhe u dhe paqen tënde, edhe ia tregove shenjat Nxënësit që nuk besonte, edhe i

the: "Eja, prekmi duart, këmbët dhe brinjën e pacen". Ndaj ai u bind dhe të thërriste: "Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty!".

Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanuni i Thomait Ode III dhe VI. Hyrtore Ejani t'i falemi... që u ngjall prej së vdekurish... Ose] Antifonet e Pashkës [si dhe çdo ditë deri në Mbylljen e Pashkës]. Hyrtore Ejani t'i falemi... Shpëtona... që u ngjalle prej së vdekurish... Pas Hyrjes, Përlëshorja e Thomait Duke qenë varri i shiluar... dhe Kontaqi i tij Me të djathtën kureshtare... Trishenjti. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX Ty, pra llambën plot me dritë... Kungatore Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion. Aliluia. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall [si dhe çdo ditë deri në Mbylljen e Pashkës]. Emri i Zotit...



NË MBRËMËSORE

6 Thirrtoret: 3 të Thomait (Lavdërimet Ting. I Panëfimi mártires)

I ngritur nga varri yt plot tmerr,* o Zot, Jetëdhënës Krisht,* s'i zgjidhe vulat e varrit¹ dhe ashtu u fute ti* teksa ishin mbyllur* dyert, mes apostujve të tu të lavdëruar mjaft e u dhe hare, dhe Shpirtin tënd* krejt të drejtë, se ke përdëllim* të pamasë, Shpëtimtar me dhembshuri. (2x)

Binjaku Thoma nuk qe atje* kur u vajte Nxënësve* edhe iu shfaqe, s'besoi pra në ngjalljen tënde, Zot;* ndaj u tha atyre* që të kishin par': Po s'vura gishtin tim në brinjën e tij, në shenjat e gozhdimit pra,* nuk besoj dot se u ngjall ai* nga të

vdekurit, nga varri dhe u shfaq.

I thirri Thomait Zoti Krisht:* “Në do, vëre dorën, m’prek* dhe shih që kam trup nga dheu, kocka, edhe mos dysho,* mos ji mosbesues,* veçse bëhu ti porsi të tjerët”. Atëherë ky thirri: “Ti je Perëndia im,* Zoti im, o Shpëtimtari im;* lavdi ngjalljes sate jetëprurëse”.

Dhe 3 të Mujorit.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, u fute befasisht, o i tërëfuqishmi Jisu, Perëndia ynë; dhe, pasi qëndrova midis tyre dhe u dhe paqe, i mbushe me Shpirtin e Shenjtë dhe i urdhërova të prisnin dhe të mos largoheshin fare nga Jerusalemi derisa të visheshin me fuqi nga lart.³⁰ Prandaj të thërrasim: O ndriçimi,³¹ ngjallja³ dhe paqja jonë,² lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i Madh:

Ting. i Rëndë

Cili Perëndi, është aq i madh sa Perëndia ynë. Ti je Perëndi i vetëm që bën çudira.

Varg a): Ua bëre të njohur popujve fuqinë tënde.

Cili Perëndi, është aq i madh sa Perëndia ynë. Ti je Perëndi i vetëm që bën çudira.

Varg b): Dhe thashë: Tani fillova, ky ndryshim është i së djathtës së të Shumëlartit.

Cili Perëndi, është aq i madh sa Perëndia ynë. Ti je Perëndi i vetëm që bën çudira.

Varg c): I kujtova punët e Zotit.

Cili Perëndi, është aq i madh sa Perëndia ynë. Ti je Perëndi i vetëm që bën çudira.

Pasvargje

Ting. I

Ngjallësor

Lutjet tona të mbrëmjes priti, o Zot i shenjtë, dhe falna ndjesë mëkatesh, se ti je i vetmi që rrëfeve në botë Ngjalljen.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Katanikistik

Meqë deti i shkeljeve të mia është i madh, o Shpëtimtar, dhe jam mbytur tmerrshëm në paudhësitë e mia, ma jep dorën, shpëtomë si Petron, o Perëndi,³² dhe mëshiro më.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Me ndërmjetimin e të gjithë shenjtorëve dhe të Hyjlindëses, o Zot, na jep paqen tënde² dhe mëshirona, si i vetmi i dhembshur.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Tetë ditë pas ngritjes sate, o Zot, u shfaqte te Nxënësit e tu në vendin ku ishin mbledhur; dhe pasi u thirre “Paqe në ju”, i tregove Nxënësit që s’besonte, duart dhe brinjen e pacen; dhe ai u bind dhe të thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty”.

Përlëshorja e Thomait [një herë si gjatë gjithë javës, ndërsa në fillim të Mëngjesores (pas Perëndia është Zoti) tri herë. Në fund të saj, një herë].



TË HËNËN E JAVËS II NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të

Oktoikut

Ting. I

Ngjallësore Ton tafon su Sotir

Ushtarët, Shpëtimtar,* që të ruanin varrin,* nga engjëlli q'u duk,* si të vdekur u bënë,* kur ndriti dhe u lajmëroj* grave Ngjalljen me gaz të madh.*³³ Ty të japim lavd,* o shkatërrues i prishjes,* dhe mëgjunjazi* të biem ty, Perëndisë,* që u ngjalle së vdekurish.*

Kataniktike

Meqë u zura në paudhësi,³⁴ unë i shtururi nuk guxoj të vështroj në lartësinë e qiellit, por, duke u mbështetur në njeri-dashjen tënde, thërras: O Perëndi, le të të vijë keq për mua³⁵ dhe shpëtomë.

Martirike

O Zot, athloforët e lavdishëm të kanë veshur si krenari atletizmi dhe gradë kuro-rash, sepse me durim në tortura triumfuan mbi të paudhë, dhe me fuqi hyjnore e morën fitoren nga qielli; me përgjërimit e tyre çliromë nga armiku i padukshëm dhe shpëtomë, o Shpëtimtar.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

O Hirplote, Krijesa ngazëllohet duke parë në ty çudinë e çudive, sepse zure pa farë dhe linde parrëfyeshëm atë që nuk mund ta vështrojnë dot batalionet e engjëjve,³⁶

atij përgjëroju, o Perëndilindëse, që t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e

Thomait

Ting. I Ton tafon su Sotir

Binjaku shën Thoma,* sa ta preku me dorë* ty brinjën që nuk mundi ta shihte, s'u dogj hiç* prej prekjes; mbeti teksa prekte ky plagët me saktësi,* dhe të shpuarit* për ne me heshtë,⁴ i thoshte:* Perëndia im* je, Zoti, sado që hoqe* pësim shpëtimtar për ne. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi i Thomait. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e së kremtes.*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. I

Ngjallësor

Himnojmë, o Krisht, pësimin tënd shpëtimtar dhe lavdërojmë ngjalljen tënde.*

(2x)

Kataniktik

O shpirt, të pret një tjetër botë dhe gjyqtar, i cili ka për t'i publikuar të fshehtat³⁷ dhe të tmerrshmet e tua; ndaj mos qëndro te të këtushmet, por nxito t'i thërrasësh gjykatësit: O Perëndi, le të të vijë keq për mua³⁵ dhe shpëtomë.

Martirik

Ejani, gjithë popujt, t'i nderojmë me himne dhe ode shpirtërore³⁸ athloforët e Krishtit, ndriçuesit e botës,³⁹ predikuesit e besimit dhe burimin e përhershëm, nga gufojnë shërime për shpresëplotët. Me përgjërimit e tyre, o Krisht Perëndi, dhu-

roji paqen² botës sate dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹⁰

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Thomai që quhej binjak, nuk ishte me ta kur hyre, o Krisht, edhe pse dyert ishin të mbyllura, ndaj nuk i besonte ato që i kishin thënë, pra prej mosbesimit na siguronte në besim; o i mirë, nuk refuzove t'ia tregoje brinjën tënde pa cen dhe plagët e duarve dhe të këmbëve; dhe ai, sapo i preku dhe i pa, të pohoi si Perëndi jo të zhveshur nga veçoritë dhe jo si njeri sipërfaqësor; dhe thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Thomait
Ting. II Ikos tu Efrathá

Njerëz, me engjëjt tok,* me buzë krejt të pastra,* himnoni të triditshmin;* u ngjall nga varri edhe* e bashkëngriti botën ton'.

Varg: Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion.

Shfaqesh, o Shpëtimtar,* kur dyert janë mbyllur,* te Nxënësit e tu shenjt'* edhe, për her' të parë,* Shën Shpirtin na jep ti me ta.

Varg: Se i përforcoi shulat e portave të tua, i bekoi bijtë e tu në ty.

Të pamë, Tërëmbret,* me mall prej zemrës sonë* tanimë, jo me sy pra;* si të besuam si Zot,* me himne po të madhësh-tojm'.

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Ditën e tetë, ndërsa Nxënësit ishin duke dyshuar, Shpëtimtari erdhi befas atje ku ishin të mbledhur. Dhe, pasi u dha paqe, i thirri Thomait: "Eja, apostull, prekmi pëllëmbët që m'i karfosën me gozhdë". O mosbesimi i mirë i Thomait! Zemrat e

besnikëve i çoi në njohuri; dhe thirri me frikë: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Në Liturgji, çdo ditë të javës Antifonet dhe Hyrtoja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshorja e Thomait dhe e shenjtit të kishës. Kontaqi i Thomait. Trishenjtë. Të meriton... Kungatorja e ditës. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Emri i Zotit...



TË HËNËN E JAVËS II NË MBRËMËSORE

Thirrtoje

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Si u ngrite prej varrit, vjen,* Fjalë e plotfuqishme ti,* Krisht, te miqt' e tu,⁴⁰ sado janë mbyllur krejt* dyert; Thomai s'beson ndaj ia shfaq vrimat e gozhdëve,* brinjën që t'u shpua keq* nga një shtizë⁴ ty pra, edhe* siguron kështu,* vërteton fort se ti vet' je ai që i duroi shpëtimtaret pësime nga dhembshuria, Zot.

"Bashkëzbritjen e madhe dhe* zbrazen time⁴¹ prej dhembshurisë* së pamasë kur e sheh, të mos kesh dyshim,* por sigurohu, Binjak, se unë jam i pësuar* edhe pas tri ditësh pra* un', nga varri, u ngrita lart* edhe zbraza krejt* arka Hadhi edhe u dhashë jetë plot të vdekurve nga jeta, që nga fillimi", tha Zoti Krisht.

I hutuar, Thomai shenjt,* o i tërëfuqishmi Krisht,* sapo të pa, thirri fort: Ti je Zoti im,* je Perëndi, njeridashës; po be soj se pësove keq,* i shëron sëmundjet mbar'* shpirtërore; o Çlirimtar; ndaj pushtetit tënd* po i falem dhe shpall në botë ngritjen tënde të tërëpushtetshme,

të frikshme, o Shpëtimtari im.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Ditën e tetë, ndërsa Nxënësit ishin duke dyshuar, Shpëtimtari erdhi befás atje ku ishin të mbledhur. Dhe, pasi u dha paqe, i thirri Thomait: “Eja, apostull, prekmi pëllëmbët që m’i karfosën me gozhdë”. O mosbesimi i mirë i Thomait! Zemrat e besnikëve i çoi në njohuri; dhe ai thirri me frikë: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Oktoikut

Ting. I

Ngjallësor

Rrethoni Sionin, o popuj, dhe vëreni në mes dhe jepini lavdi në të, atij që u ngjall së vdekurish, se ai është Perëndia ynë,⁴² që na çliroi nga paudhësitë tona.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Meqë u dënova për shkak mendimesh dhe veprash djallëzore, o Shpëtimtar, më dhuro mendim kthimi, o Perëndi, mua që të thërras: Shpëtomë, o mirëbërës i dhembshur, dhe mëshiro më.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

O shenjtorë, pohimi juaj i mirë në stadium e frikësoi fuqinë e demonëve dhe i çliroi njerëzit nga mashtrimi; prandaj,

kur po jua pritnin kokat, thërrisnit: O Zot, le të bëhet i mirëpritur para teje flijimi⁴³ i shpirtrave tanë, sepse, meqë të dëshiruar thellë, e shpërfillëm jetën kalimtare, o njeridashës.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Pas ngritjes sate, o Zot, kur Nxënësit e tu ishin të mbledhur dhe dyert të mbyllura, qëndrove në mes dhe u dha paqe. Dhe, meqë u bind dhe Thomai kur pa duart dhe brinjën tënde, të pohoi si Zot dhe Perëndi që i shpëton ata që shpresojnë te ti, o njeridashës.



TË MARTËN E JAVËS II
NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të Oktoikut

Ting. I

Ngjallësore Tu lithu sfracisthentos

Drejt varrit qëmenatë miropurëset shkuan* edhe u tmerruan kur panë* një engjëll të shkëlqyer,* se varri lëshonte shkrepët,* çudia mendjen ua turbulloj;*³³ edhe rendën dhe dishepujve në qytet* me gaz ua çuan lajmin:⁴⁴* Skëterrën e plaçkiti Zoti Krisht* dhe i ngjalli të varrosurit,* edhe tutje e largoj me Kryq* frikën e gjyqeve.*

Kataniktike

Meqë i drejti me vështirësi shpëtohet, unë mëkatari ku do të shfaqem?⁴⁵ Nuk e mbajta peshën dhe vapën e ditës,⁴⁶ o Perëndi; më numëro së bashku me ata të orës njëmbëdhjetë⁴⁷ dhe shpëtomë.

Martirike Tu lithu sfracisthentos

Shenjtorë, si ushtarë të mirë,⁴⁸ me një

mendje* kishit besë, nga kërcënim tiranik hiç s'u tmerruat;* si ngritët të çmuarin fort Kryq,* pasuat Krishtin me gatishmëri,*⁴⁹ dhe fitoren lart e morët prej qiellit* kur udhën krejt e mbaruat;*⁵⁰ lavd përforcuesit që ju dha forc';* dhe lavd kurorëzuesit,* lavd atij që përmes jush bën shërime ndër gjithë ne.

Lavdi *dhe* Tani *Hyjlindësore*

O besnikë, duke pasur si mur të paçarë Perëndilindësen Mari, ejani t'i biem ndër këmbë asaj,⁵¹ sepse ka guxim para atij që lindi prej saj, që të ndërmjetojë dhe t'i shpëtojë nga mllëfi dhe vdekja shpirtrat tanë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e Thomait

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Le ta mburrim krejt ne Nxënësin, apostullin* e Krishtit gjatë kujtimit të tij me himne, psalmim,* se hyjnisht e mbajti mendjen ton' kur prekte pak* shenjat e gozhdëve, sepse* e kërkonte të vërtetën bes'; e mbështeti botën* dhe i lyp Shpëtimtarit, Zotit, t'i mëshirojë shpirtrat tanë me hir. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi i Thomait. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e së kremtes.*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. I

Ngjallësor

O Zot, që durove kryq dhe shfuqizove vdekjen, dhe u ngjalle së vdekurish, paqësonaje jetën,² si i vetmi i Tërëfuqishëm.* (2x)

Kataniktik

O Shpëtimtari im, mos më moho mua që jam pushtuar nga përtacia e mëkatit; ma ngri mendimin drejt pendimit dhe më trego punëtor të sprovuar të vreshtit tënd, si dhe më dhuro pagën e orës njëmbëdhjetë⁴⁷ dhe përdëllimin e madh.¹⁰

Martirik

Këta ushtarë⁴⁸ të mbretit të madh i kundërshtuan urdhrat e tiranëve, i shpërfillën me trimëri torturat dhe, pasi e shkelën tërë mashtrimin, u kurorëzuan denjësisht, dhe kërkojnë paqe nga Shpëtimtari dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.¹⁰

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Kur dyert ishin mbyllur, Jisui u erdhi Nxënësve befas dhe u dha guxim dhe paqe. Pastaj i tha Thomait: Pse nuk më beson, që u ngjalla prej së vdekurish? Sille këtu të djathtën tënde dhe vendose në brinjën time dhe shih; sepse, me mosbesimin tënd, i mësuan të gjithë edhe pësimet si dhe ngjalljen time, që të thërrasin tok me ty: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Thomait

Ting. II Ikos tu Efrathá

Me engjëjt ta himnojm'* pa fund, besnikë, Krishtin* e ngjallur pas tri ditësh* nga varri edhe botën* me veten lart e ngriti pra.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

O Zot i dhembshur Krisht,* sapo ta preku brinjën,* Thomai shpejt u kthye* në besë; nëpërmjet tij* të njohëm ty si Perëndi.

Varg: Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall punën e duarve të tij.

Jepi, o, Çlirimtar,* tër' popullit tënd paqe*² si bashkëngrite botën* nga Hadhi kur u ngjalle* nga varri, i fuqishëm krejt.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

O Krisht, shkove te Nxënësit kur dyert ishin të mbyllura; Thomai, me plan hyjnor, nuk ishte atëherë me ta, se thoshte: “Nuk besoj fare nëse nuk e shikoj edhe unë Zotin, brinjën nga doli gjaku, uji⁴ dhe pagëzimi, plagën që shëroi traumën e madhe, njeriun; nuk besoj nëse nuk shikoj që nuk ishte frymë, por mish dhe kocka”. O Zot, ti që e shkele vdekjen dhe e informove Thomanë, lavdi më ty.



TË MARTËN E JAVËS II NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Ting. I Panëfimi märtires

I triditshmi flet me shën Thoman'* si u ngrit prej varrit pra:* Prek duart, shpimet e këmbëve të mia, brinjën tok* që u hap, ndaj njihmë* si Zot, Perëndi të pandryshuar, sado kam brumë dheu dhe e shfaq në esenc'* dhe në të pranova Kryq, pësim,* se un' jam Zot njeridashës, Shpëtimtar.

Shastisej Binjaku duke par'* shpime këmbësh, vrima tok* në duar, që i hutuar nga e frikshmja mrekulli* dhe, me dorë, prekte* brinjën pa cen dhe e shihte; dhe kështu, e shfaqti ndër kombe si të padyshimtë krejt* ngritjen pas tri ditësh me lavdi* lart nga varri, dhe e shpallte fort me zë.

Thomai të preku me guxim* siç u denjë-sua fort,* dhe unë marr gazin më të

madh, se shoh që duket krejt* dhe që vërtetohet* ngritja jote, Shpëtimtari im; dogmatizojmë pra: Je i thjeshtë, Perëndi-njeri,* që, sipas kombinimit tënd, o Zot,* i ke dy esencialet energji.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. IV*

O Zot, me lavdinë e Hyjnisë sate të panxënshme, ndërsa dyert ishin të mbyllura, shkove dhe qëndrove në mes të Nxënësve dhe iu zbulove brinjën; dhe, kur iu tregove traumat e duarve dhe plagët e këmbëve, e zhduke zymtësinë e trishtimit dhe the qartë me zë të lartë: “Siç më shihni, o miq, kam marrë natyrën e mishit, nuk jam frymë”. Dhe e nxite Nxënësin që dyshonte, të të prekte frikshëm duke thënë: “Hulumtoji të gjitha dhe mos dysho!”. Dhe ai, sapo ndjeu në dorë esencën tënde të dyfishtë, thirri me tmerr i nxitur prej besimit: “Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty”.

Pasvargje të Oktoikut Ting. I

Kryqësor

Një Kryq u ngul në Kalvar⁵² dhe na lulëzoi pavdekësi nga një burim i përhershëm, nga brinja e Shpëtimtarit.⁴

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

Ejani, o popuj, të përhimnojmë dhe t'i falemi Krishtit, duke lavdëruar ngjalljen e tij prej së vdekurish, se ai është Perëndia ynë,^{52a} që çliroi botën prej kurthit të armikut.*

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Oh, sa e mirë është tregtia juaj, o shenjtore! Sepse dhatë gjakra dhe trashëguat qiej; dhe, pasi u sprovuat për njëfarë kohe,⁵³ ngazëlloheni përjetësisht; me të vërtetë që i mirë malli juaj, sepse, kur braktisët të prishshmet, shijuat të paprishshmet; dhe, duke kërcyer tok me engjëjt, e himnoni pa pushim Trininë e bashkëqenshme.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Krishti thotë: "Prekma brinjën me dorë, o Thoma, shihi shenjat e gozhdëve, heto me besim dhe bëhu besimtar dhe jo mosbesues". Dhe Thomai, sapo e preku me gisht Zotin, thirri fuqishëm: "Ti je Perëndia dhe Zoti im, o i dhembshur, lavdi më ty".



TË MËRKURËN E JAVËS II NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të

Oktoikut

Ting. I

Kryqësore

Kur u kryqëzove, o Krisht, u zhduk tirania, u shkel fuqia e armikut, sepse as engjëll, as njeri, por vetë ti, Zoti, na shpëtove,⁵⁴ lavdi më ty.

Ngjallësore

Isaaku u çua lart në mal,⁵⁵ Jonai u zhyt në fund;⁵⁶ dhe të dy e ikonizonin pësimin

tënd, o Shpëtimtar: i pari prangat dhe therjen, i dyti varrimin dhe jetën e ngritjes sate paradoksale; o Zot, lavdi më ty.

Martirike

Të ardhhtë keq për dhimbjet e shenjtoreve, të cilët pësuan për ty,⁵⁷ o Zot, dhe shëroji gjithë dhimbjet tona, o njeridashës, të lutemi.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*

Oe pacenuar, ne që e kemi mbrojtjen tënde dhe çlirohemi nga mjerimet me përgjërimit e tua, dhe ruhemi në çdo gjë nëpërmjet Kryqit të Birit tënd, të madhështojmë të gjithë besërisht, siç e kemi për detyrë.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e

Thomait

Ting. I Ton tafon su Sotir

Binjaku shën Thoma,* sa ta preku me dorë* ty brinjën që nuk mundi ta shihte, s'u dogj hiç* prej prekjes; mbeti teksa prekte ky plagët me saktësi,* dhe të shpuarit* për ne me heshtë,⁴ i thoshte:* Perëndia im* je, Zoti, sado që hoqe* pësim shpëtimtar për ne. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi i Thomait. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e Thomait.*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. I

Kryqësor

Ty që u mbërtheve mbi dru dhe na dhe jetë, të himojmë pa pushim si Shpëtimtar dhe Zot. (2x)

Ngjallësor

O Krisht, që plaçkite Hadhin dhe e ngjalle njeriun me ngjalljen tënde, denjësona të të himnojmë e të të lavdërojmë me zemër të pastër.*

Martirik

Ju, o martirë të tërëfamshëm, as shtrëngim, as ngushtësi, as uri, as përndjekje, as fshikullime, as tërbim bishash, as shpatë, as zjarr kërcënues nuk mundën t'ju ndanin dot nga Perëndia;⁵⁸ për më tepër, me mallëngjim për të, pasi luftuat si në trupa të huaj, u arratisët nga natyra ngaqë e shpërfillët vdekjen; prandaj dhe denjësisht fituat pagën e mundimeve tuaja dhe u bëtë trashëgimtarë të mbretërisë së qiejve;⁵⁹ përdesisa keni guxim para Perëndisë njeridashës, kërkoheni për botën paqen dhe për shpirtat tanë përdëllimin e madh.¹⁰

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, Shpëtimtari shkoi atje ku ishin së bashku. Dhe, pasi qëndroi mes tyre, i thotë Thomait: Eja, prekmë dhe shihi shenjat e gozhdëve, tendose dorën, preke brinjën time dhe mos u bë mosbesues, por predikoje me besim ngjalljen time prej së vdekurish.

*Pasvargje të Thomait**Ting. II Ikos tu Efrathá*

Oh! Një çudi e re,* mënyr' paradoksale:* Si nuk u dogj hiç kashta* prej zjarrit të Hyjnisë,* pra dora e apostullit?

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Ne le të rendim shpejt,* t'i shenjtërojmë duart* me prerjen e pasionit,* kështu ta prekim brinjën* e Zotit tonë çlirimtar.

Varg: Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall punën e duarve të tij.

Shpirt, përtëriti drejt* gjith' shqisat pra që ke ti* për teori hyjnore,* sepse kështu do Krishti* të bëhet rinovim gjithnjë.

Lavdi dhe Tani

Shpirt, shihe mendërisht* ndryshimin e gjith' botës* dhe zbukuroje zemrën;* stolisu si me gjethe,* me shenjtërim dhe me virtyt.



TË MËRKURËN E JAVËS II NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje**Ting. II Ote ek tu ksilu se*

Sado* s'e le gjirin atëror,*⁶⁰ Krisht, nga dashuria u shfaqe mbi dhé mishprurës,⁶¹ me trup* dhe u ngjalle pas tri ditësh, si durove ti* dhe pësim por dhe vdekje; si i Tërëfuqishëm,* hyre brenda teksa dyert ishin mbyllur fort;* ndaj, sapo Thomai e preku* me gaz brinjën tënde hyjnore,* të lëvdoi si Zot dhe Krijues ty.

Mbi Kryq* të mbërthyen me gozhd' ty* dhe të shpuan, Krisht, me një heshtë në brinjë,⁴ shijove vrer,*¹⁹ vdekjen e durove dhe në varr u vure ti* si i vdekur, por, si Zot Perëndi, fort dërrmove* pranga Hadhi dhe i ngrite tok të vdekurit* që nga jeta; vulat s'i prishe,*¹ ngjalljen tënde e vërtetove* kur iu shfaqe Nxënësve të tu me lavd.

Pashkë* e shenjt' është ky kremtim,* Pashkë mjaft mistike, hyjnorja Pashkë, pra Pashkë-shpëtim,* Pashka që na transferon te jeta pa vdekje,* Pashka, çdo

zymtësi e heq nga gjithë ne, Pashka* që apostujve u dha hir të gëzueshëm;* dhe prandaj thërriste Thomai:* Perëndia im je dhe Zoti* që plaçkite poshtë mbretëri, në Hadh.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. IV

O çudi paradoksale! Mosbesimi lindi një besim të sigurt, sepse, kur Thomai tha: “Nuk besoj nëse nuk shikoj” dhe kur e preku brinjën, e theologoi të mishëruarin si vetë Birin e Perëndisë, e njohu si të pësuar në trup, dhe e shpalli Zotin e ngjallur, dhe thirri me zë të shkëlqyer: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Oktoikut Ting. I Ngjallësor

Me anën e Pësimit tënd, o Krisht, u çliroam prej pësimeve, dhe me anën e Ngjalljes sate u çliroam prej prishjes. O Zot, lavdi më ty.*

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Apostolik

Kitara tërëharmonike e apostujve, duke u lëvizur prej Shpirtit të Shenjtë, asgjësoi celebrimet e demonëve të urreyer dhe, pasi predikoi Një Zot, çliroi kombe nga mashtrimi i idhujve dhe na mësoi t'i falemi Trinisë së njëqenshme.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Martirik Panéfimi mártires

Martirë të famshëm krejtësisht,* toka nuk ju fshehu dot,* por ju mikpriti lart qielli, ju hapën plotësisht* dyert e Parajsës*⁶² dhe, si hytë brenda, po shijoni dru-rin, pemën e jetës,⁶³ Krishtit përgjërojuni*

që në shpirt të na dhurohet hir,* paqe dhe përdëllim i madh¹⁰ gjithnjë.

Lavdi dhe Tani Ting. IV

O çudi paradoksale! Edhe pse e preku zjarrin, kashta shpëtoi se, kur e vuri dorën në brinjën e flaktë të Jisu Krishtit, Thomai nuk u dogj nga prekja, sepse mosbindja e shpirtit e shndërroi nxehtësisht në besim; ndaj thirri nga thellësia e shpirtit: Ti je Zoti dhe Perëndia im që u ngrite nga të vdekurit, lavdi më ty.



TË ENTJEN E JAVËS II NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të Oktoikut Ting. I

Ngjallësore Tu lithu sfracisthentos

Mbi Kryq pra u mbërtheve ti, o jet'⁶ e pasosur,* dhe në varr u shtrive i vdekur,* o Krisht, o Jetëdhënës,* u ngjalle të tretën dit', o Zot,* dhe jetën u dhurove njerëzve.* Prandaj pra ushtrit' engjëllore lart* të thërrisinin, Jetëdhënës.* Lavdi më ty që hoqe keq për ne,* u ngjalle dhe hipe lart në q'ell,* dhe kujdesesh gjithnjë për ne,* o mik i njerëzve.*

Apostolike

O peshkatarë të urtë të botës, përderisa e morët prej Perëndisë dhembshurinë, ndërmjetoni dhe tani për ne që thërrasim: O Zot, shpëtoji mbretërit dhe qytetin tënd dhe, nëpërmjet apostujve, çliroi shpirtat tanë nga të këqijat që i shtrëngojnë.

Martirike Ton tafon su Sotir

T'i lypim gjithë ne tok martirët e Krish-tit,* sepse shpëtimin tonë kërkojnë ata

pra;* të tërë të afrohemi pranë tyre me plot besim,* se burojnë mjaft* hir për shërime,⁶⁴ dhe zbojnë* dhe kolona krejt* demonësh, se janë rojat* e besës së Zotit Krisht.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore E ngjashme*
Të predikuan ty* nëpër botë apostujt* e hyjshëm, të paralajmëruan profetët* me zë të madh, o Vajzë, si nënë të Perëndisë Krisht* dhe besuam ne,* ndaj me kush-tim të nderojmë* tërë ne dhe sakt'* të përhimnojmë, të quajm'* gjithnjë ty Hyjlindëse.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e Thomait E ngjashme

“Thoma, meqë e pe* brinjën time dhe shpimet* nga gozhdët, s’e beson ngjalljen time?”, i thoshte* Jisui kur u ngrit nga varri dhe shfaqej te Nxënësit* parrëfyeshëm,* prandaj Binjaku u bind krejt* dhe i thirri fort* Ndërtuesit, Krijimtarit:* Je Zoti im Perëndi. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi i Thomait. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e Thomait.*

Lavdërime të Oktoikut Ting. I Ngjallësor

Duke lavdëruar denjimin tënd të perëndishëm, të himnojmë, o Krisht; linde prej Virgjëreshës dhe ishe i pandarë nga Ati; pësove si njeri dhe duke dashur¹⁷ durove kryq, u ngrite prej varrit si prej nusëroreje, që të shpëtosh botën, o Zot, lavdi më

ty.* (2x)

Apostolik Ton uranion tagmaton

Me një zë le ta lëvdojmë Petron dhe Pavlin shenjt,* Mateon, Llukën, Markun,* me Joanin, Andrean* dhe Thomanë, kananitin Simon* dhe Jakovin, Filipin tok* Vartholomeun,⁶⁵ ta mburrim ne denjësisht* tërë bashkësin’ e Nxënësve.

Martirik

Ngazëllohuni, o martirë, në Zotin, sepse garuat luftën e mirë,⁵⁰ kundërshtuat mbretër dhe mundët tiranë; nuk u trembët nga zjarri dhe shpata, as nga bishat e egra që i hanin plotësisht trupat tuaj; duke ia drejtuar Krishtit psalmodinë tok me engjëjt, morët kurora nga qiejt; kërkoni që të na dhurohet përdëllimi i madh.¹⁰

Lavdi dhe Tani Ting. IV

O çudi paradoksale! Joani ra në kraharorin e Fjalës,⁶ ndërsa Thomai u denjësuua ta prekte brinjën. I pari nxori nga atje frikshëm thellësinë e theologjisë, Ekonominë. Tjetri u vlerësua të na mësonte misteret, meqë na paraqet fuqishëm argumentet e ngritjes duke thirrur: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Thomait Ting. II Ikos tu Efrathá

Ta internojmë larg* zalisjen e mendimit* dhe zymtësin’ e vesës*, kështu do lulëzojë* pranvera e besimit ton’.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Shfaqesh, o Shpëtimtar,* kur dyert janë mbyllur,* te Nxënësit e tu shenjt’* edhe, për her’ të parë,* Shën Shpirtin na jep ti me ta.

Varg: Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë

dhe kupa qiellore shpall punën e duarve të tij.

Të pamë, Tërëmbret,* me mall prej zemrës sonë* tanimë, jo me sy pra,* si të besuam si Zot,* me himne po të madhështojm’.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Tetë ditë pas ngjalljes sate, mbreti Jisu, Fjala e vetëmlindur e Atit, u shfaqe te Nxënësit e tu kur dyert ishin të mbyllura, edhe u dhe paqen tënde, edhe ia tregove shenjat Nxënësit që nuk besonte, edhe i the: “Eja, prekmi duart, këmbët dhe brinjën e pacen”. Ndaj ai u bind dhe të thërriste: “Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty!”.



TË ENJTEN E JAVËS II NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Ting. I Ton uranion tagmáton

Pasi ta veshim ne rrobën e drejtësisë nur,* rrobën e bardhë më fort* se dëbora, në Pashkë,* sot, pra në këtë dit’, le të dëfrejm’* sepse Krishti, ky dielli* i drejtësisë, si lind⁶⁶ nga të vdekurit,* me paprishje hijeshon çdokënd.

Dita që ka bërë Zoti, është vërtet ajo,* është festa mbretëreshë,* zonja e çdo kremtimi,* si Davidi psal,⁶⁷ në të mistikisht* të dëfrejmë, o popuj mbar’,* se u dhuroi apostujve paqe, hir,* sado dyert ishin mbyllur krejt.

E vërteton mosbesimi i shën Thomait qart’* pra ngritjen shpëtimtare* për planetin nga strofkat* posht’, në Hadh, kur prek guximshëm me dor’,* me të djath-

tën kureshtëse,* vrimat në këmbë dhe duar, ia bën kështu* krejt të sigurt tërë kozmosit.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Kur dyert ishin mbyllur, Jisui u erdhi Nxënësve papritur dhe u dha guxim e paqe. Pastaj i tha Thomait: Pse nuk më beson që u ngjalla prej së vdekurish? Sille këtu dorën tënde të djathtë dhe vendose në brinjën time dhe shih; sepse, me mosbesimin tënd, i mësuan të gjithë pësimet dhe ngjalljen time, që të thërrasin tok me ty: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Pasvargje të Oktoikut Ting. I

Kryqësor

Kryqi i Shpëtimtarit është mur i paçarë për ne, sepse, duke pasur besim tek ai, shpëtojmë të gjithë ne.

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

Lutjet tona të mbrëmjes priti, o Zot i shenjtë, dhe falna ndjesë mëkatesh, se ti je i vetmi që rrëfeve në botë Ngjalljen.*

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Me ndërmjetimin e të gjithë shenjtorëve dhe të Hyjlindëses, o Zot, na jep paqen tënde² dhe mëshirona, si i vetmi i dhembshur.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Krishti thotë: "Prekma brinjën me dorë, o Thoma, shihi shenjat e gozhdëve, heto me besim dhe bëhu besimtar dhe jo mos-besues". Dhe Thomai, sapo e preku me gisht Zotin, thirri fuqishëm: "Ti je Perëndia dhe Zoti im, o i dhembshur, lavdi më ty".



TË PREMTEN E JAVËS II NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të
Oktoikut
Ting. I
Kryqësore*

Ifalemi drurit të Kryqit tënd, o njeridashës Shpëtimtar, sepse në të u ngule ti, jeta e të gjithave;⁹ ia hape Parajsën Kusarit që të erdhi me besim dhe u denjësuua për shijim kur të pohoi: "Kujtomë, o Zot!".⁶⁸ Pranona si atë edhe ne që thërrasim: Të gjithë mëkatuam; falë dhembshurisë sate, mos na shpërfill.

Ngjallësore Ton tafon su Sotir

Ushtarët, Shpëtimtar,* që të ruanin varrin,* nga engjëlli q'u duk,* si të vdekur u bënë,* kur ndriti dhe u lajmëroj* grave Ngjalljen me gaz të madh.*³³ Ty të japim lavd,* o shkatërrues i prishjes,* dhe mëgjunjazi* të biem ty, Perëndisë,* që u ngjalle së vdekurish.*

Martirike

O Zot, athloforët e lavdishëm të kanë veshur si krenari atletizmi dhe gradë kuro-rash, sepse me durim në tortura trium-fuan mbi të paudhë, dhe me fuqi hyjnore e morën fitoren nga qielli; me përgjërimit e tyre dhurona, o Perëndi, përdëllimin tënd të madh.¹⁰

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore
Ton tafon su Sotir*

Kur shihet përmbi dru* qengjin⁶⁹ edhe bariun*⁷⁰ të varur dhe të vdekur keq, shqerra pa njollë* po thoshte duke qarë, duke bërëtitur si nënë kjo:* Biri im dhe Zot* i përmbimirë, si unë* mundem ta duroj* pra bashkëzbritjen mbi mendje,* pësimin tënd vullnetar?¹⁷

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e
Thomait*

Ting. I Ton tafon su Sotir

Ilum, e preke pak* brinjën e tërëfortë* dhe plagët e atij që shëroi Adamin* nga rënia, plaga më e madhe, dhe ne besimtarëve* na shkaktove ti* një lumturi të pavdekshme,* ngritjen e këtij* po e be-sojmë dhe vetëm* me fjalët e Nxënësve.
(2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi i Thomait. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e Thomait.*

*Lavdërime të Oktoikut Ting. I
Kryqësor*

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht, u bë Një grigjë engjëjsh dhe njerëzish⁷¹, si edhe Një Kishë; qielli dhe dheu ngazëllohen,⁷² o Zot, lavdi më ty.
(2x)

Ngjallësor

Himnojmë, o Krisht, pësimin tënd shpëtimtar dhe lavdërojmë ngjalljen tënde.*

Martirik

Ejani, gjithë popujt, t'i nderojmë me himne dhe ode shpirtërore³⁸ athloforët e Krishtit, ndriçuesit e botës,³⁹ predikuesit

e besimit dhe burimin e përhershëm, nga gufojnë shërime për shpresëplotët. Me përgjërimit e tyre, o Krisht Perëndi, dhuroji paqen botës sate dhe shpirttrave tanë përdëllimin e madh.¹⁰

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, Shpëtimtari shkoi atje ku ishin së bashku. Dhe, pasi qëndroi mes tyre, i thotë Thomait: Eja, prekmë dhe shihi shenjat e gozhdëve, tendose dorën, preke brinjën time dhe mos u bë mosbesues, por predikojë me besim ngjalljen time prej së vdekurish.

Pasvargje të Thomait
Ting. IV Os jenon en mártisin

Jeta jonë,⁹ Parajsën lart,* Zot, e hape për njerëzit,*⁶² kur u kryqëzove mbi dru, ndaj ngrite tok* edhe të vdekurit kur e zhduke vdekjen me forcë plot* dhe vërtet i lidhe krejt* tokësoret me qiellin,*⁷¹ me kënaqësi* të pamasë e mbushe grupin, korin e apostujve kur “Paqe” u the, o Fjalë e Perëndis’.

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

U flak prishja, paprishja pra* lulëzoi, të vjetrat krejt* pranga u shpërbënë, ndaj qielloret tok* me dheun dhe tokësoret të dëfrejnë,⁷² se Zoti Krisht* është ngritur, dhe u shfaq* dita plot me gëzim, meqë* Jetëdhënësi* hyri brenda kur dyert ishin mbyllur, pasi vdekja u plaçkit edhe Hadhi nxori sa pati posht’.

Varg: Qiejt tregojnë lavdinë e Perëndisë dhe kupa qiellore shpall punën e duarve të tij.

Ja, sot është dita që ka bër’* Zoti ynë, ndaj me hare* të dëfrejmë,⁶⁷ se Jetëdhënësi

u ngrit* dhe u plaçkit tërë Hadhi, edhe kori apostolik* e dëgjoi gazin pra* dhe Thomai meqë s’kish bes’* por dyshim, ngurrim,* preku brinjën e Zotit dhe pas prekjes si esencë të dyfishtë e shpalli, madje me zë të madh.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Krishti thotë: “Prekma brinjën me dorë, o Thoma, shihi shenjat e gozhdëve, heto me besim dhe bëhu besimtar dhe jo mosbesues”. Dhe Thomai, sapo e preku me gisht Zotin, thirri fuqishëm: “Ti je Perëndia dhe Zoti im, o i dhembshur, lavdi më ty”.



TË PREMTEN E JAVËS II NË MBRËMËSORE

Thirrtore
Ting. I

Kur dyert ishin të mbyllura dhe Nxënësit të mbledhur, u fute befasisht, o i tërëfuqishmi Jisu, Perëndia ynë; dhe, pasi qëndrove midis tyre dhe u dhe paqe, i mbushe me Shpirtin e Shenjtë dhe i urdhërova të prisnin dhe të mos largoheshin fare nga Jerusalemi derisa të visheshin me fuqi nga lart. Prandaj të thërrasim: O ndriçimi, ngjallja³ dhe paqja jonë,² lavdi më ty.

Tetë ditë pas ngritjes sate, o Zot, u shfaqe te Nxënësit e tu në vendin ku ishin mbledhur; dhe, pasi u thirre “Paqe në ju”, i tregove Nxënësit që s’besonte, duart dhe brinjën e pacen; dhe ai u bind dhe të thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty”.

Thomai që quhej binjak, nuk ishte me

ta kur hyre, o Krisht, edhe pse dyert ishin të mbyllura, ndaj nuk i besonte ato që i kishin thënë, pra prej mosbesimit na siguronte në besim; o i mirë, nuk refuzove t'ia tregoje brinjën tënde pa cen dhe plagët e duarve dhe të këmbëve; dhe ai, sapo i preku dhe i pa, të pohoi si Perëndi jo të zhveshur nga veçoritë dhe jo si njeri sipërfaqësor; dhe thërriste: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi Ting. Tërth. II

O Krisht, shkove te Nxënësit kur dyert ishin të mbyllura; Thomai, me plan hyjnor, nuk ishte atëherë me ta, se thoshte: “Nuk besoj fare nëse nuk e shikoj edhe unë Zotin, brinjën nga doli gjaku, uji⁴ dhe pagëzimi, plagën që shëroi traumën e madhe, njeriun; nuk besoj nëse nuk shikoj që nuk ishte frymë, por mish dhe kocka”. O Zot, ti që e shkele vdekjen dhe e informove Thomanë, lavdi më ty.

Tani Hyjlindësore Dogmatike Ting. I

Lavdin' e përbotëshme që u mboll prej njerëzish dhe lindi Zotin, derën qiellore,⁷³ Marinë Virgjëreshë, le ta himnojmë, këngën e engjëjve dhe zbukurimin e besnikëve, se ajo u rrëfye qiell dhe tempull i hyjnisë; ajo, duke rrëzuar mesmurin⁷⁴ e armiqtësisë, kalli paqen në vend të saj dhe e çeli mbretërinë. Duke pasur pra atë spirancën⁷⁵ e besës, kemi përluftar atë që lindi prej saj. Le të ketë pra kurajë, le të ketë kurajë popull' i Perëndisë se ai do t'i luftojë armiqtë si i tërëfuqishëm.*

*Pasvargje Ngjallësore**

Lutjet tona të mbrëmjes priti, o Zot i shenjtë, dhe falna ndjesë mëkatesh, se ti

je i vetmi që rrëfeve në botë Ngjalljen.

Varg: Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi, Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.

Rrethoni Sionin, o popuj, dhe vëreni në mes⁴² dhe jepini lavdi në të, atij që u ngjall së vdekurish, se ai është Perëndia ynë, që na çliroi nga paudhësitë tona.

Varg: Sepse i dha fuqi botës e cila nuk do të lëkundet.

Ejani, o popuj, të përhimnojmë dhe t'i falemi Krishtit, duke lavdëruar ngjalljen e tij prej së vdekurish, se ai është Perëndia ynë,^{52a} që çliroi botën prej kurthit të armikut.

Varg: Shtëpisë sate i ka hije shenjtërimi, o Zot, për ditë të gjata.

Me anën e Pësimit tënd, o Krisht, u çliroam prej pësimeve, dhe me anën e Ngjalljes sate u çliroam prej prishjes. O Zot, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. I

O njeridashës, shumica e dhembshurive të tua është e madhe dhe e paimagjinueshme, meqë u tregove zemërgjerë kur judenjtë të godisnin me shuplakë,⁷ apostulli të prekte dhe mohuesit të hulumtonin me dashakeqësi. Si u mishërove? Si u kryqëzove, ti që je i pamëkatshëm?⁸ Por, urtësona që të të thërrasim si Thomai: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.



TË SHTUNËN E JAVËS II NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ngjallësore**

Ting. I

Ton tafon su Sotir

Ushtarët, Shpëtimtar,* që të ruanin varrin,* nga engjëlli q'u duk,* si të vdekur u bënë,* kur ndriti dhe u lajmëroj* grave Ngjalljen me gaz të madh.*⁴⁴ Ty të japim lavd,* o shkatërrues i prishjes,* dhe mëgjunjazi* të biem ty, Perëndisë,* që u ngjalle së vdekurish.

Lavdi *Tu lithu sfracijstheontos*

Drejt varrit qëmenatë miropurëset shkuan* edhe u tmerruan kur panë një engjëll të shkëlqyer,* se varri lëshonte shkrepëtim',* çudia mendjen ua turbulloj;* edhe rendën dhe dishepujve në qytet* me gaz ua çuan lajmin:*⁴⁴ Skëterrën e plaçkiti Zoti Krisht* dhe i ngjalli të varrosurit,* edhe tutje e largoj me Kryq* frikën e gjyqeve.

Tani *Hyjindësore E gjashme*

Gabrieli kur të tha, Virgjëreshë, "Gëzohu", bashkë me zërin mishërohej Zoti i gjithësisë⁷⁶ te ti,⁷⁷ arka e shenjtë, siç tha Davidi i drejtë.⁷⁸ U tregove më e gjerë se qiejt, duke mbajtur Krijuesin tënd. Lavdi atij që ndenji te ti; lavdi atij që lindi prej teje; lavdi atij që na çliroi me lindjen tënde.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e
Thomait*

Ting. I Tu lithu sfracijstheontos

Kur ishin fshehur Nxënësit mbarë plot me frikë * nga judenjtë dhe në Sion ishin mbledhur, o i Mirë,* u fute dhe ndenje në

mes, Zot,* u dhe gaz kur qen' dyert mbyllur krejt;* u tregove brinjën tënde dhe traumat* e brinjës pa cen, i the pra* Nxënësit mosbesues, Zoti Krisht:* Eja dhe vëre dorën ti* edhe hulumto, un' jam ai që për ty vuajta. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Thomait (tok me Irmoset) në 6, i shenjtë të kishës në 4 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe Ipakoia. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e Thomait, Sinaksari i Mujorit. Zbritësoret (Ditë e Ngjalljes...). Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësoret e Thomait.*

*Lavdërime Ngjallësore Ting. I**

Himnojmë, o Krisht, pësimin tënd shpëtimtar dhe lavdërojmë ngjalljen tënde.

O Zot, që durove kryq dhe shfuqizove vdekjen, dhe u ngjalle së vdekurish, paqësonaje jetën,² si i vetmi i Tërëfuqishëm.

O Krisht, që plaçkite Hadhin dhe e ngjalle njeriun me ngjalljen tënde, denjësona të të himnojmë e të të lavdërojmë me zemër të pastër.

Duke lavdëruar denjimin tënd të perëndishëm, të himnojmë, o Krisht; linde prej Virgjëreshës dhe ishe i pandarë nga Ati;⁶⁰ pësove si njeri dhe duke dashur¹⁷ durove kryq, u ngrite prej varrit si prej nusëroreje, që të shpëtosh botën, o Zot, lavdi më ty.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Tetë ditë pas ngjalljes sate, mbreti Jisu, Fjala e vetëmlindur e Atit, u shfaqe te Nxënësit e tu kur dyert ishin të mbyllura, edhe u dhe paqen tënde, edhe ia tregove shenjat Nxënësit që nuk besonte, edhe i the: "Eja, prekmi duart, këmbët dhe brinjën e pacen". Ndaj ai u bind dhe të thë-

rriste: “Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty!”.

Pasvargje të Thomait
Ting. I Panëfimi märtires

I ngritur nga varri yt plot tmerr,* o Zot, Jetëdhënës Krisht,* s'i zgjidhe vulat e varrit¹ dhe ashtu u fute ti* teksa ishin mbyllur* dyert, mes apostujve të tu të lavdëruar mjaft e u dhe hare, dhe Shpirtin tënd* krejt të drejtë, se ke përdëllim* të pamasë, Shpëtimtar me dhembshuri.(2x)

Varg: Mburre Zotin, o Jerusalem; himnoje Perëndinë tënd, o Sion.

Binjaku Thoma nuk qe atje* kur u vajte Nxënësve* edhe iu shfaqe, s'besoi pra në ngjalljen tënde, Zot;* ndaj u tha atyre* që të kishin par': Po s'vura gishtin tim në brinjën e tij, në shenjat e gozhdimit pra,* nuk besoj dot se u ngjall ai* nga të vdekurit, nga varri dhe u shfaq.

Varg: Se i përforcoi shulat e portave të tua, i bekoi bijtë e tu në ty.

I thirri Thomait Zoti Krisht:* “Në do, vëre dorën, m'prek* dhe shih që kam trup nga dheu, kocka, edhe mos dysho,* mos ji mosbesues,* veçse bëhu ti porsi të tjerët”. Atëherë ky thirri: “Ti je Perëndia im,* Zoti im, o Shpëtimtar im;* lavdi ngjalljes sate jetëprurëse”.

Lavdi dhe Tani Ting. I

Ditën e tetë, ndërsa Nxënësit ishin duke dyshuar, Shpëtimtari erdhi befaz atje ku ishin të mbledhur. Dhe, pasi u dha paqe, i thirri Thomait: “Eja, apostull, prekmi pëllëmbët që m'i karfosën me gozhdë”. O mosbesimi i mirë i Thomait! Zemrat e besnikëve i çoi në njohuri; dhe ai thirri me frikë: Zoti im dhe Perëndia im, lavdi më ty.

CITIME

Joan 20.19-29

1. Matth. 27.66
2. Joan 14.27; Ef. 2.15; II Thes. 3.16
3. Joan 11.25
4. Joan 19.34
5. Lluk. 24.17
6. Joan 13.25
7. Matth. 26.67; Mark 14.65; Joan 18.22; 19.3
8. Joan 8.46
9. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
10. Num. 14.19 etj.
11. Eks. 14.21-15.1 etj.
12. Fil. 4.7
13. Matth. 7.24; Lluk. 6.48
14. Ps. 4.7; 88(89).16
15. I Mbret. (Sam.). 2.2
16. II Kor. 5.17; Ef. 2.15; 4.24
17. Joan 10.15,17-18.
18. Abak. 3.13
19. Matth. 27.34
20. Gjen. 3.6
21. Lluk. 24.42
22. Ps. 62(63).2; Is. 26.9
23. Jona 2.11
24. Matth. 27.51
25. Ps. 136(137).4
26. Dan. 3.1-7
27. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
28. Eks. 12.16; Lev. 23.2-3,7-8,21,24,27,35-36; Num. 28.25
29. Ps. 44(45).3
30. Lluk. 24.49
31. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
32. Matth. 14.31
33. Matth. 28.2-7; Mark. 16.5-7
34. Ps. 50(51).7
35. Lluk. 18.13
36. Is. 6.2
37. Rom. 2.16; I Kor. 4.5
38. Ef. 5.19; Kol. 3.16
39. Fil. 2.15
40. Lluk. 12.4; Joan 15.14-15
41. Fil. 2.7
42. Ps. 47(48).13-15
43. I Petr. 2.5
44. Lluk. 24.9,24; Joan 20.2.
45. Fja. Urt. 11.31; I Petr. 4.18
46. Matth. 20.12
47. Matth. 20.1-9
48. II Tim. 2.3
49. Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23
50. II Tim. 4.7
51. Ps. 94(95).6
52. Matth. 27.33; Mark 15.22; Lluk. 23.33; Joan 19.17
- 52a. Ps. 94.7
53. I Petr. 1.6; 5.10
54. Is. 63.9
55. Gjen. 22.2-3
56. Jona 2.1
57. Fil. 1.29

- | | |
|--|---|
| 58. Rom. 8.35-39 | 69. Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19 |
| 59. Jak. 2.5 | 70. Matth. 26.31; Mark 14.27; Joan 10.11-14; Hebr. |
| 60. Joan 1.18 | 13.20; I Petr. 2.25 |
| 61. I Tim. 3.16 | 71. Kol. 1.20 |
| 62. Gjen. 3.24 | 72. I Kron. 16.31; Ps. 95(96).11; Is. 49.13 |
| 63. Gjen. 2.9; 3.22,24; Fja. Urt. 3.18; Is. 65.22; Apok. | 73. Gjen. 28.17 |
| 2.7; 22.2,14,19 | 74. Ef. 2.14 |
| 64. I Kor. 12.9,28,30 | 75. Hebr. 6.19 |
| 65. Matth. 10.2-4; Mark 3.16-18; Lluk. 6.14-15; Vep.1.13 | 76. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3 |
| 66. Mal. 4.2(3.20) | 77. Lluk. 1.26-31 |
| 67. Ps. 117(118).24 | 78. Ps. 131(132).8 |
| 68. Lluk. 23.42 | |





E DIELA E MIOPRURËSEVE
TË SHTUNËN
NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*4 Thirrtore Ngjallësore
Ting. II*

Ejani t'i falemi atij që lindi...
Krishti, Shpëtimtari ynë...
Bashkë me kryeengjëjt...
Ty që u kryqëzove dhe u varrose...

Lavdi *i Mioprirurëve*
O Nxënëse, pse e përzieni miron me lotët
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 46*)

Tani *Hyllindësore Dogmatike*
Ting. II

O çudi tejet e madhe! Duke parë mre-
kullitë, unë e shpall Hyjinë, nuk e mohoj
se Emanueli¹ u bë njeri, meqë nga njëra
anë si njeridashës hapi portat e natyrës,
veçse nga ana tjetër si Perëndi nuk i
dërmoi çelësat e virgjërisë, por siç hyri
përmes dëgjimit,² kështu doli prej mitrës;
siç u nxu, kështu u mishërua; u fut pa

pasion, doli pashprehshëm sipas profetit
që thoshte: Kjo portë do të jetë e mbyl-
llur; askush nuk do të kalojë përmes saj
përveç Zotit, Perëndisë së Izraelit³ që e ka
përdëllimin e madh.⁴

*Pasvargje Ting. II
Ngjallësor*

Ngjallja jote, o Krisht Shpëtimtar, ndri-
ti tërë botën dhe thirre prapë krijesën
tënde. Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.*

*Të Hyllindësës
Ote ek tu ksilu se*

Varg: Do të kujtoj emrin tënd në gjithë
brezat e brezave.

Gjithë sa helmohen i gëzon, dhe i mbron
sa janë të shtypur, sa kan' uri i ushqen,
ti i pret të huajt, të verb'rit i ndriçon, të
sëmuret më këmb' i ngre, ata që mu-
ndohen, ti i çlodh e i forcon, edhe jetimët
i rrit, Nën' e Perëndisë së lartë, ty po të
përgjunjemi ngrina, dhe shpëtona ne që
po të lutemi.*

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule

veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe
shhtëpinë e atit tënd, edhe do ta dëshirojë
mbreti bukurinë tënde.

Unë mizori që bëra pa kursim çdo pali-
gjësi, pa përmbajtje çdo mëkat, jam i
denjë për çdo dënim; më jep, o Virgjë-
reshë Hyjnuse, nxitje për pendim, që
të shfaqem atje i pafajshëm, sepse të
konsideroj si ndërmjetëse dhe të thërras
si mbrojtje; mos më turpëro.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të
pasurit e popullit.

Ne nuk pasurohemi me ndonjë tjetër
përkije në lidhje me Zotin dhe Bërësin
përveç teje, o Hyjnuse; me mbrojtjen
tënde të nxehtë mos na hidh larg, mos
na turpëro ne që rendim me mall nën
strehën tënde; o nënë e Perëndisë tonë,
nxito, tregojë pasurinë e përdëllimit tënd
dhe na shpëto nga inati i tanishëm.

Lavdi dhe Tani i *Mioprurëseve*

Mioprurëset arritën me nxitim, në agim
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 46.*)

Përlëshoret



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*10 Thirrtore: 7 Ngjallësore dhe 3 të së
kremtes*

Ngjallësoret

Ting. II

Ejani t'i falemi atij që lindi...

Krishti, Shpëtimtari ynë, e fshiu dorë-
shkrimin...

Bashkë me kryeengjëjt le të himnojmë
Ngjalljen...

Ty që u kryqëzove dhe u varrose...

Mbi Kryqin tënd shfuqizove mallkimin...

T'u hapën, o Zot, nga frika dyert...

Duke kënduar himnin shpëtimtar...

Të Mioprurëseve

Ting. II E Anatolit

Herët në mëngjes, gratë mioprurëse
morën aroma dhe shkuan te varri i Zotit;
dhe, kur gjetën ato që nuk shpresonin,
mendonin me ankth për heqjen e gurit
dhe i thoshin njëra-tjetrës: "Ku janë vulat e
varrit? Ku është toga e Pilatit dhe sigurimi
i fortë?".⁵ Dhe një engjëll që shkëlqente,
i lajmëroi gratë që nuk e dinin dhe u tha:
"Pse e kërkonti duke qarë të gjallin që e
gjallëroi gjininë e vdekatarëve? U ngrit
Krishti, Perëndia ynë, si i tërëfuqishëm,
dhe na jep të gjithë neve paprishjen, je-
tën, ndriçimin dhe përdëllimin e madh".⁴

Injëjti E Kumulait

ONxënese, pse e përzieni miron me
lotët? Guri u rrokullis, varri u zbraz; shi-
heni prishjen e shkelur prej jetës; vulat
dëshmojnë gjithkund se rojat⁵ e mos-
bindjes flinin rëndë; vdekshmëria shpëtoi
përmes trupit të Perëndisë; Hadhi qan;
vraponi me hare dhe thojuni apostujve:
Krishti që vrau vdekjen, si i parëlindur
nga të vdekurit,⁶ po shkon para jush në
Galile.

Mioprurëset arritën me nxitim, në agim,
në varrin tënd dhe të kërkonin, o Krisht,
që ta lyenin me miro trupin tënd të pace-
nuar; dhe, meqë i dëgjuan fjalët e engjë-
llit, u shpallnin apostujve simbole gaz-
more se "U ngjall kryetari i shpëtimit tonë"⁷
pasi e plaçkiti vdekjen, ndërsa i dhuron
botës jetën e amshuar⁸ dhe përdëllimin
e madh".⁴

Lavdi *Ting. Tërth. II E Kozma Monakut*
Kur shkuan me nxitim dhe arritën në

varrin tënd, dhe i panë vulat e tij, por nuk e gjetën trupin tënd të pacen, gratë miropurëse vajtonin dhe thoshin: Kush na e vodhi shpresën? Kush e mori të vdekurin e Iyer me miro, të zhveshurin, ngushëllimin e vetëm të nënës? Oh, si vdiq ai që i ngjalli të vdekurit? Si u varros ai që e plaçkiti Hadhin? Pra, ngjallu me pushtetin tënd pas tri ditësh, o Shpëtimtar, ashtu siç the⁹ dhe shpëtoji shpirtrat tanë.

Tani *Hyllindësore Dogmatike*
Ting. II

Shkoi hija e ligjit,¹⁰ kur erdhi Hiri. Se, sikundër ferra nuk digjej, megjithëse nxirrte flakë,¹¹ ashtu edhe ti Virgjëreshë linde dhe Virgjëreshë mbete; në vend të kolonës prej zjarri,¹² lindi diell drejtësie,¹³ në vend të Moisiut, Krishti, shpëtimi i shpirtave tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës
(Zoti mbretëroi...).

Në Liti Idhiomele Ting. I

Engjëlli thërret: O gra miropurëse, pse erdhët në varr? Pse e kërkonit të gjallin ndër të vdekurit? Kini guxim se u ngjall Zoti!

Gratë erdhën në varrin tënd me frikë, ngaqë, zellshëm, donin ta lyenin me aroma trupin tënd; dhe, kur nuk e gjetën, çuditëshin me njëra-tjetrën, meqë nuk e njihnin ngjalljen; mirëpo atyre iu shfaq papritur një engjëll dhe u tha: Krishti u ngjall dhe na dhuron përdëllimin e madh.⁴

Magdalena dhe Maria tjetër shkuan në varr për të kërkuar Zotin; dhe panë një engjëll si rufe, që rrinte ulur mbi gur, i cili u tha: “Pse e kërkonin të gjallin mes të vdekurve? U ngjall siç tha, do ta gjeni në Galile”. Atij le t’i thërrasim: “O Zot që u

ngjalle nga të vdekurit, lavdi më ty”.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Josifi kërkoi trupin e Jisuit dhe e vendosi te varri i tij i ri;¹⁴ se duhej të dilte si prej nusëroreje. Lavdi më Ty, që dërmonte pushtetin e vdekjes dhe u çele njerëzve dyert e Parajsës.^{15*}

Tani *Hyllindësor Injëjti*

Zoti Krisht, Krijuesi dhe Çliruesi im, o e Gjithëqashtë, si lindi prej teje i veshur si unë, çliroi Adamin prej mallkimit të mëparshëm.¹⁶ Prandaj, o e Gjithëqashtë, si Nënë Perëndie dhe Virgjëreshë me të vërtetë, të thërresim pa pushim përsëritjen e engjëllit: Gëzohu,¹⁷ o Zonjë, mbrojtje dhe strehë, dhe shpëtim i shpirtave tanë.*

Pasvarg Ngjallësor Ting. II

Ngjallja jote, o Krisht Shpëtimtar, ndriti tërë botën dhe thirre prapë krijesën tënde. Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.*

Dhe ato të Pashkës (fq. 7)

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Ty që vishesh me dritën si rrobë,¹⁸ Josifi të zbriti prej drurit me Nikodhimin¹⁴ dhe, kur të pa të vdekur, të zhveshur, e të pavarrosur, të nisi një vaj të mallëngjyer dhe, duke vajtuar, po thoshte: Mjer’ o Jisu fort i ëmbël! Që kur të pa dielli pak kohë më parë të varesh në kryq, mbështillej me errësirë,¹⁹ dhe dheu valonte nga frika,²⁰ dhe kurtin’ e Tempullit çajej;²¹ po ja tani shoh që durove vdekje për mua vullnetarisht.²² Si të të varros, o Perëndia im? Apo si të të mbështjell me pëlhura? Dhe me ç’duar ta prek trupin tënd të perëndishëm? Apo ç’këngë t’i këndo

vdekjes sate, o zemërdhembshur? Ma-dhështoj Pësimet e tua dhe përhimnoj Varrimin tënd me Ngjalljen, duke thirrur: Lavdi më Ty.*

Tani *Ting. Tërth. I*

Ditë e Ngjalljes, le të ndriçohemi... (*fq. 7*)

Përlëshore Ting. II

Kur zbritë te vdekja ti, o jeta e pa-vdekshme,²³ atëherë Hadhin e vrave me shkëlqimin e hyjnisë; dhe kur ngrite të vdekurit nga fundet e dheut, gjithë fuqitë qiellore të thërrisnin: Jetëdhënës Krisht, Perëndia ynë, lavdi më ty.*

Lavdi

Bujari Josif, si e zbriti prej drurit trupin tënd të pacenuar, e mbështolli me pëlhurë të pastër dhe me aroma, dhe me vajtime e vuri në një varr të ri;¹⁴ po u ngjalle pas tri ditësh, o Zot, dhe i fale botës përdëllimin e madh.^{4*}

Tani

Grave miropurëse, duke qëndruar pranë varrit, engjëlli u thërriste: Mirot u kanë hije të vdekurve, po Krishti u tregua i huaj për prishjen. Thërrisni pra: U ngjall Zoti dhe i fali botës përdëllimin e madh.^{4*}



NË MËNGJESORE

[*Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kamunin Triadik).*]

Pas Stihologjisë së parë,

Ndenjësores Ngjallësore

Ting. II

Duke mos ndaluar të vuloset guri i varrit, u fale të gjithëve shkëmbin e besës, pasi u ngjalle. O Zot, lavdi më ty.^{5*}

Lavdi

Megjithëse nuk e le sipër gjirin e pacen,²⁴ e denjove për të gjithë varrimin dhe ngjalljen, o Zot, lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore*

Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme misteret e tua, o Hyjlindëse; e vulosur me qashtërsi dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe Nënë e vërtetë, pasi linde Perëndinë e vërtetë. Atij lutju të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores

Ting. II

Pasi arritën në agim dhe e panë bosh varrin, miropurëset u thoshin apostujve: I fuqishmi e vithisi prishjen dhe i rrëmbeu nga prangat ata që ishin në Hadh; shpallni me guxim se u ngjall Zoti dhe na jep përdëllimin e madh.⁴

Lavdi

Për të sjellë miro për varrimin tënd, gratë arritën te varri në agim fshehtazi, meqenëse frikësoheshin nga arroganca e judenjve dhe kishin në mendje ruajtjen e ushtarëve; por natyra e dobët fitoi mbi burrërinë, se predispozicioni i mirë, dhembshuria, i pëlqeu Perëndisë; prandaj thërrisnin përshtatshëm: Ngjallu, o Zot, ndihmona dhe çlirona për hir të emrit tënd.²⁵

Tani *Hyjlindësore*

Përmbilavdëruar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë, të himnojmë, se me anën e kryqit të Birit tënd u mposht Hadhi dhe vdekja vdiq; ne të vdekurit u ngjallëm dhe u denjësua për jetën; morëm Parajsën,¹⁵ kënaqësinë e vjetër.²⁶ Prandaj, duke falënderuar, e lavdërojmë Krishtin, Perëndinë tonë, të fuqishmin si dhe të vetmin mëshirëplotë.*

*I Paqortueshmi (Ps. 118), Bekimtoreset etj.
Kanunet: i Pashkës (tok me Irmoset) në 4, i
Hyjlindësës në 2 dhe i Miroprurëseve në 6.*

*Kanuni i Hyjlindësës që ka Akrostihidhë në
Troparet e para: "I Theofanit".*

Tingulli dhe Irmoset e njëjta

Ke shkaktuar pështjellim në kushte vdekjeje ti,* Zonjë, meqë në bark kishe Krishtin, të përherëshmen jet',*²³ që na lindi sot nga varri dhe shndriti fort,* e Virgjër pa cen aspak,* botën tonë, planetin mbar'.

E pe Perëndinë, Birin tënd të ngjallur, prandaj* gëzohu me apostujt, o e hyjhirshme e dëlir',* ti e para prite pra "Gëzohu"-n sepse,* Hyjlindëse pa qortim,* i shkaktove hare botës.

*Kanuni i Miroprurëseve, poezi e Andreas së Kretës. Ting. II
Tin Moseos odhën*

[Irmosi: »Merreoden, o shpirt, që Moisiu
»shenjt tha dhe thirr ti:* Për shpëtimin
»tim u bë* përkrahës, mbrojtës, ky është
»Zoti,* Perëndia im, dhe do ta lavdëroj.^{27]}*

U mbërtheve me trup* mbi Kryq, sado s'pëson se ke natyr'* porsi Ati, dhe në brinj'* u shpove; botës i nxore gjak, uj',*²⁸ Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

E nderoj Kryqin tënd,* e mburr varrimin tënd, i falem pra* ngjalljes sate, e himnoj,* i Mirë, dhe spontanisht thërras fort:* Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

Ke shijuar vrer keq*²⁹ sado je ëmbëlsi e Kishës ti* dhe prej brinjës sate, Krisht,* na e burove²⁸ paprishjen neve,* Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

Me të vdekurit tok* ty, që të vdekurit i ngrite, Zot,* të menduan, Shpëtimtar,*

shijove prishjen që s'njohe kurrë;* Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

Ngazëllë, qiell ti* edhe dëfre Sion, se Zoti Krisht* u ngjall dhe të vdekurit* i ngriti tekta e përhimnonin.* Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

Shën Josifi, o Krisht,* e mblodhi me çarçafë trupin tënd,* Shpëtimtar, të vuri ty* në varr të ri,¹⁴ por, si Perëndi Zot,* ti u dhe të vdekurve ngjallje dhe jet'.

Gratë me zë të madh* u thoshin Nxënëseve të hyjshëm krejt:* "Ejani himnoni tok* me ne të ngjallurin vërtet, Krishtin",* se e panë para agimit atë.

Lavdi Triadik

E Tër'shenjta Trini,* Njësi pa nisje, një Hyjni, o At',* o Bir dhe ti, Shpirt Hyjnor,* shpëtoje botën, krijesën tënde,* Perëndia ynë je dhe të lëvdojm'.

Tani Hyjlindësor

Si e zhduke, e Thjesht',* në barkun tënd të lashtën nëmë¹⁶ ti,* linde foshnjë dhe kështu* na lulëzove, na dhe bekimin,* është Perëndi ky, sado që vesh mish.

Zbritësore: Anastáseos imera

Ditë e ngjalljes.

Ode III

I Hyjlindësës

Kthehem sot te jeta e pacen,* Zonjë, me mirësi nga ai që linde ti* dhe shndriti gaz me shkëlqim* në skajet e botës, dha shpëtim* dhe hir, e Dëlirë fort.

Ti, o e Dëlirë, të kërcesh,* se e mbajte në bark Zotin me mish dhe e pe* të ngjallur prej varrit ti* sikurse kish thën',⁹ o e pacen,* si Zot madhështojë pra.

*I Miroprurëseve**Stirothenta mu ton nun*

[*Irmosi*]: »Perëndia im, jam shterp' *³⁰ un' »në mendje, ndaj frytdhënës më trego ti, * »o bujk³¹, mbjell'si pra* i të mirave, me »dhembshurinë tënde, Zot./

I karfose, Shpëtimtar, * Zot, pëllëmbët, lart në dru, e more çdo komb* dhe e ftove, Jisu, * prej mashtrimeve për njohjen tënde, për çlirim.

Populli jude i thot' * fort Pilatit: Kriminelin, pra kusarin* na çliro edhe na* kryqëzo ti të pafajshmin, lart ta ngresh atë.³²

Krisht, kur kryqëzoheshe, * toka tundej,²⁰ errësohej drita,¹⁹ kish frik' * nga pushteti yt pra* dhe u ngjallën mjaft të vdekur jashtë varreve.³³

Shqerra jote, o Jisu, * kur qëndronte pranë Kryqit tënd, thërriste* duke qar': Bir, ku shkon? * Ku po ikën qengji³⁴ që u ther për çdo njeri?!

Po i falem Kryqit tënd, * e himnoj varrimin, i nderoj pësimet, * gozhdët e duarve, * shtizën²⁸ si dhe ngjalljen tënde, o Jisui im.

Kur u ngrite, o Jisu, * nga zinxhirët dhe nga prishja, u çlirua* Eva, Adami tok; * e plaçkiti k'shtu armikun ngjallja jote, Zot.

Kur u ngjalle, o Krisht Zot, * u dërrmua çdo shul dhe çdo der'³⁵ e Hadhit* dhe sakaq çdo zinxhir, * hallk' e vdekjes pra nga frika e pushtetit tënd.

O hyjpritës shën Josif, *¹⁴ eja rri mes nesh, thirr se u ngjall Jisui* Çlirimtar edhe Zot; * ngriti dhe Adamin përmes dhembshuris' së tij.

Të dëfrejnë tok me ne* dymbëdhjetë Nxënësit, Josifi¹⁴ edhe* miroprurëset gra* dhe

të tjerë burra, gra, apostuj zotëror'.

Lavdi Triadik

Po i falem, po himnoj* tok me Atin, Birin, Shpirtin Shenjt, të drejtë, * Një natyr'; i bashkoj* në esencë, por i ndaj dhe në persona pra.

Tani Hyjlindësor

Për ne nxore lule, shkop* në mish, Krish-tin, o e lumtur dhe e thjeshtë, * e panjollshme me hir, * dhe vllastar nga rrënja e stëratit shën Jese.³⁶

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni të pimë.

Ndenjësores Ting. II Ta ano zitón

Kur sillnin në varr* mjaft miro, gratë, plot me zell, * gëzonin në shpirt* përmes shkëlqimit engjëllor* dhe të predikonin si Perëndi të kozmosit, Shpëtimtar; * u thërrisnin Nxënësve mbar': * Nga varri vërtet u ngjall pra jeta për gjithë ne.²³

Lavdi dhe Tani Injëjti

Shoqëria e nxënësve të tu bashkë me gratë miroprurëse gëzohen njëzëri, se me ta kremtojmë një të kremte të përbashkët për lavdi dhe nder të Ngjalljes sate. Me anën e tyre, o Zot njeridashës, fali popullit tënd përdëllimin e madh.*

*Ode IV**I Hyjlindësos*

O e Dëllirë, ai që gatoi Adamin,³⁷ stëratit tënd, u gatua prej teje dhe, me vdekjen e vet, e shfarosi sot vdekjen e shkaktuar nga ai¹⁶ dhe i ndriçoi të gjithë fuqishëm me llamburitjet hyjnore të ngjalljes.

O e Dëllirë, e bukur, e hijshme dhe e paqortueshme mes grave³⁸, duke parë Krishtin që linde, të shndrinte tepër bu-

kur nga të vdekurit për shpëtimin e të gjithëve, e lavdëroje me gëzim bashkë me apostujt.

*I Mioprorëseve
Tin ek Parthenu su*

[*Irmosi*]: »Pra lindjen tënde prej Vajze »krejt* e parapa profeti* dhe e shpalli »fort me zë:* Un' kam dëgjuar për famën »tënde dhe jam trembur,* se nga Thema- »ni ti* dhe nga mali i shenjtë hijeplotë* »ke arritur,⁴⁰ o Krisht Zot.]

Nëpërmjet Kryqit e skllavërove barkun e Hadhit, i ngrite bashkë të vdekurit dhe e vithise tiraninë e vdekjes; ndaj ne, pasardhësit e Adamit, të falemi dhe e himnojmë varrimin dhe ngritjen tënde, o Krisht.

O Shpëtimtari ynë, ti që, me mirëdashje, u karfose në Kryq nga dhembshuria e madhe⁴¹ dhe na çlirave prej mallkimit atëror,¹⁶ zgjidhi prangat e mëkateve të mia të rënda, se mund të bësh krejtësisht çdo gjë që do.⁴²

O Shpëtimtar, ti që e karfose në Kryq mallkimin tim të lashtë¹⁶ dhe ma burove nga brinja jote bekimin përmes gjakut,²⁸ zgjidhi prangat e mëkateve të mia të rënda, se mund të bësh krejtësisht çdo gjë që do.⁴²

O Shpëtimtar, kur të takoi në të nëndheshmet, Hadhi u hidhërua⁴³ meqë pa se tani, pa dashje, i dorëzon ata që, me fuqi, i gëlltiti lashtë, dhe ai hulumtohet poshtë, zhvishet dhe plaçkitet, mbetet pa të vdekur.

O armiq të paligjshëm, megjithëse guri u vulos bashkë me togën,⁵ Krishti u ngrit siç kishte parathënë⁹ dhe i zgjidhi prangat e

mëkateve të mia të rënda, se ai mund të bëjë krejtësisht çdo gjë që do.⁴²

Ti që u ngrite prej varrit, e plaçkite Hadhin, i gjallërove të vdekurit dhe më burove paprishjen nëpërmjet ngjalljes sate, zgjidhi prangat e mëkateve të mia të rënda, se mund të bësh krejtësisht çdo gjë që do.⁴²

T'ju vijë turp vërtet, o të paligjshëm, sepse Krishti u ngjall dhe i ngriti bashkë të vdekurit, duke thirrur: "Kini guxim! Unë e munda botën".⁴⁴ Prandaj binduni ose heshtni, o mashtrues që nuk e pranoni ngjalljen e tij.

O i mirë, kur u ngjalle prej varrit, u the mioprorëseve "Gëzohuni" dhe apostujve "Shpallenin ngritjen time"; zgjidhi prangat e mëkateve të mia të rënda, se mund të bësh krejtësisht çdo gjë që do.⁴²

Le ta nderojmë arkond Josifin, të zellshmin në besim, deputetin¹⁴ dhe nxënësin dhe së bashku me të mioprorëset dhe apostujt, duke thirrur me ta dhe duke e përhimnuar besërisht dhe gëzueshëm ngjalljen e Shpëtimtarit.

Lavdi *Triadik*

Kush mund ta shprehë lavdinë e pandarë të Hyjnisë përmbiesenciale? Sepse, sado që është Një në natyrë, himnohet si Trini pa fillim, e bashkëqenshme, si Njësi që himnohet në tri hipostaza të thjeshta.

Tani *Hyilindësor*

O e dëlirë, Virgjëreshë-nënë, si Perëndi-lindëse, përgjëroju pa pushim atij që linde pa burrë, meqë fushoi në barkun tënd, që t'i zgjidhë prangat e mëkateve të mia të rënda, se ti mund të ndihmosh ashtu siç do.

Zbritësore: Epi tis thias filakís

Le të qëndrojnë me ne.

Ode V

I Hyllindësës

Mbledhja e shpresëplotëve ndriçohet me rrezet hyjnore dhe jetëprurëse të ngjalljes së Birit tënd dhe mbushet me ngazëllim, o Hyjnënë e pacenshme.

O mbret i Krijesës, kur u mishërove, nuk i hape portat e Virgjërshës, nuk i prishe vulat e varrit, ndaj u gëzua kur të pa të ngjallur.

I Miropururësive

Tin ahlín tis psihís mu

*[Irmosi: »*Shpërndaje mjegullën e shpirtit »tim, o Shpëtimtari im, dhe me dritën e »porosive të tua⁴⁵ shkëlqemë si i vetmi »mbret i paqes.⁴⁶]

O Shpëtimtari im, më veshe pasi më zhveshe veshjen e lashtë që më thuri - mjerë! - mbjellësi i mëkatit.⁴⁷

O Shpëtimtari im, mëkati më qepi gjethe fiku⁴⁸ - mjerë! - sepse, nga këshilla e gjarprit, nuk e ruajta porosinë tënde të pacen.⁴⁹

Krishti që erdhi nga Maria, derdhi vaj dhe e shëroi shpirtin tim të plagosur prej mendimeve të mia vjedhëse.⁵⁰

Kur ishte pranë Kryqit, Hyllindësja e paqortueshme fliste si nënë: Më le të vetmuar, o Biri im dhe Perëndia im.

O Jisu, e dërrmove thumbin e vdekjes⁵¹ kur, me armën e Kryqit tënd, e vithise gjatë ngritjes sate gjarprin⁵² e keq që nga fillimi.

Adami le të thërrasë me ne: Ku është

thumbi yt, o vdekje? Ku është fitorja jote, o Hadh?⁵³ U thërrmove me gjallërinë e atij që gjallëroi të vdekurit.

Kur arritën në varrin e atij që i gjallëroi ata që ishin poshtë, gratë miropururëse dëgjuan një zë që thoshte: Krishti u ngjall!

O Krisht, të përhimnojmë duke bërë, në ngritjen tënde ngazëlluese, kujtimin e miropururësive besnike dhe të të gjithë Nxënësve të tu.

Le ta nderojnë të gjithë denjësisht bujarin që e zbriti nga druri trupin e Zotit dhe e varrosi besërisht.¹⁴

Lavdi Triadik

Të falem ty, Perëndisë, Atit, Birit dhe Shpirtit, me tri hipostaza dhe i besoj të tria si Një në Një esencë.

Tani Hyllindësor

Ne besimtarët të përhimnojmë ty që e linde përmbinatyrshëm me shtatzëni pa farë Krishtin, të vetmin Zot që e rinovoi Natyrën.

Zbritësore: Orthrisomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

Ode VI

I Hyllindësës

Ai që u kap lashtë prej vdekjes dhe pri-shjes, u lirua me anë të atij që u mishërua prej barkut tënd të pacen dhe u udhëzua për te jeta e paprishshme dhe e amshuar, o Perëndilindëse e virgjër.

Ai që zbriti dhe banoi në mitrën tënde, dhe u mishërua përmbi mend, zbriti në më të poshtmet e tokës,⁵⁴ o e Dëllirë, dhe, kur u ngjall prej varrit, e ngriti Adamin me veten e tij.

*I Miropurëseve
Vithó amartimaton*

[Irmosi: »Nga fundi i mëkatit shtrëngo-
»hem, Shpëtimtar,* dhe dimëroj brenda
»detit⁵⁵ të jetës keq,* por ti, si Jonan'
»prej bishës, nxirrmë⁵⁶ lart* dhe mua nga
»veset, Zot, pra çliromë dhe shpëtomë.]

Kini kurajë, o të dhelindur! Hadhi është
i vdekur, sepse Krishti, kur ishte i varur
mbi dru, e hodhi shpatën kundër tij dhe
dergjat i vdekur, u zhvesh dhe i humbi ata
që kishte.

Kini kurajë, o të vdekur! Hadhi u plaçkit,
varret u hapën²⁰ dhe "Ngrihuni" ju thërret
prej Hadhit Krishti që erdhi për t'i çliruar
të gjithë nga vdekja dhe prishja.

O Hadh, jetëdhënësi dhe Perëndia që
erdhi për t'i çliruar të gjithë nga barku yt
i pangopur, të thërret: Dua të m'i japësh
tani të vdekurit që i gëlltite dikur pasi i
mposhte.

Pasi e plaçkiti armikun dhe i rrëmbeu të
prangosurit, Zoti u ngjall dhe i nxori lart të
gjithë dhe e ngriti si Perëndi i dhembshur
dhe njeridashës Adamin e parëgatuat.

Pasi të mbështolli me çarçaf, o Krisht,
arkond Josifi të vuri në varr dhe, pasi e leu
me aroma¹⁴ tempullin e trupit tënd, i cili
ishte shkatërruar,⁵⁷ rrokullisi një gur të
madh në varr.¹⁴

O gra miropurëse, pse pra nxitoheni?
Pse pra i sillni miro të gjallit? Krishti u
ngjall siç paratha; pushojini lotët, kthejini
në hare.

Lavdi *Triadik*

O besnikë, le ta himnojmë Trininë në
Njësi, duke e lavdëruar Atin bashkë me
Birin dhe Shpirtin e njëqenshëm me Birin,

që është i bashkëpafillim me Atin dhe
Perëndi i përfjetshëm.

Tani *Hyilindësor*

O e Dëlrë, si vresht e nxure në bark pa
kultivim bistakun e paprishjes, nga krojet
e pavdekësisë na gufun si verë jetën e
amshuar.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

Kontaqi Ting. II

Duke u thënë miropurëseve "Gëzohu-
ni", e ndalove qarjen e stërnënës Evë me
ngjalljen tënde, o Krisht Perëndi; dhe
i urdhërove apostujt e tu të shpallnin:
Shpëtimtari u ngrit prej varrit.

Shtëpia

Teksa po shkonin te varri yt, o Shpëtim-
tar, miropurëset ishin të pështjelluara
dhe i thoshin njëra-tjetrës: "Kush do të na
e rrokullisë gurin e varrit?". Dhe panë se
guri ishte rrokullisur; dhe tmerroheshin të
hutuara nga pamja dhe stolia e engjëllit
dhe mendonin të iknin. Por i riu u thirrri:
"Mos kini frikë! U ngjall ai që kërkoni; eja-
ni ta shihni vendin ku dergjej trupi i Jisuit!
Shkoni shpejt dhe lajmërojnë Nxënësit:
Shpëtimtari u ngrit prej varrit".

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të dielën e tretë pas
Pashkës, kremtojmë gratë e shenjta mi-
ropurëse dhe kujtojmë gjithashtu Josifin
nga Arimathea që ishte Nxënës i fshehtë,
si edhe Nikodhimin, Nxënësin e natës.⁵⁸

Vargje: Nxënëset i sjellin miro Krishtit/
dhe unë u sjell atyre himn si miro.

Me ndërmjetimet e miropurëseve të
shenjta, o Perëndi, mëshirona. Amin.

*Ode VII**I Hyjlindësës*

Biri yt, pasi e vrau vdekjen, o e Tërë-paqortueshme, u dhuroi sot të gjithë vdekatarëve jetë të qëndrueshme në jetë të jetëve⁵⁹ ai, i vetmi Perëndia i etërve i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

Ai që mbretëron mbi çdo krijesë, kur u bë njeri, banoi në mitrën tënde, o e Hyhirshme; dhe, kur duroi Kryq dhe vdekje, u ngjall siç duhej hyjnisht dhe na ngriti tok me veten e tij, si i tërëfuqishëm.

*I Miropurësëve**Ta Hruvīm mimūmeni*

[Irmosi: »Në furrë imitonin Djemt',* bë-»nin si Keruvimet:* Kërcenin dhe thë-»rrisin:* Je i bekuar, Perëndi,*⁶⁰ se me »gjykim vërtet ti i hodhe të tëra këto mbi »ne për mëkatet tona,⁶¹ ti pra që je* i »lavdëruar dhe i përmbihimnuar përher' »në gjithë jetët.⁶⁰]

Si njeridashës, doje t'i shpëtoje nga mashtrimi të gjithë⁶² ata që bëre, pranove të nguleshe në Kryq që ta ripërtëritje nëpërmjet trupit tënd ikonën⁶³ e groposur për shkak të pasioneve, o Shpëtimtar; dhe, kur e vithise Hadhin, i ngrite të vdekurit bashkë me veten tënde.

Duke u lartësuar në Kryq, i thirre të gjithë te vetja jote ashtu siç premtove,⁶⁴ o i dhembshur e i mirë; durove t'i pësoje vërtet të gjitha ato për mëkatet tona, prandaj ia çele Kusarit dyert e Parajsës, o Shpëtimtar.⁶⁵

O i Mirë, ashtu siç premtove, e ngrite të triditshëm nga varri tempullin e trupit të shkatërruar,⁵⁷ që ta bësh të njohur vërtet lavdinë tënde që na e gufon përmes besimit, pasi i rrëmbeve të prangosurit që

zotëronte Hadhi qëmoti.

O idiotësi e judenjve! O mani e të paligjëve! Çfarë gjëje të pabesueshme patë që nuk i besuat Krishtit? Mos vallë nuk i ngriti me një fjalë të sëmurët? A nuk e shpëtoi ai mbarë botën? Le t'ju bindin të paktën ushtarët dhe të ngjallurit nga të vdekurit.³³

Rojat që pothuaj vdiqën, le të thonë tani: Si u vodh ai që nuk e panë ata, mosmirënjohësit për të gjitha? Nëse nuk e panë të ngjallur, nuk e morën vesh, si vallë mund ta dinin pra se u vodh? Le t'ju bindë të paktën ky gur dhe shpërgënjtë mortorë të Krishtit.

Pse e ruani si të vdekur? O hebrenj, pse vendosët vula mbi gur duke pasur frikë për vjedhje?⁵ Ja ku u vulos vërtet varri. Prandaj, si u ngrit Krishti nëse nuk ishte Perëndi? Le t'ju bindin të ngjallurit që iu shfaqën shumë vetave.³³

Lavdi Triadik

Bashkë me Atin, e lavdërojmë Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, duke thirrur me zë pa pushim: O Trini, esencë unike, Njësi në tre Persona, mëshiroji dhe shpëtoji të gjithë, dhembshurona ti, Perëndia i lavdëruar në jetë.

Tani Hyjlindësor

O e Pacen, qysh e mbajte në barkun tënd si foshnjë atë që, si Perëndi, e kanë frikë Forcat e engjëjve?⁶⁶ Veçse, u bë siç deshi, fushoi siç dinte, duke dashur t'i shpëtonte gjithë⁶¹ të dhelindurit prej Adamit, kur e zgjidhi Adamin nga mallkimi¹⁶ i shkaktuar prej ngrënies⁴⁹ së hidhur.

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu

Ai që i shpëtoi djemtë.

*Ode VIII**I Hyjlindëses*

Bërësi erdhi në botë nëpërmjet teje, o Perëndilindëse virgjëreshë, dhe, pasi e çau barkun e Hadhit, na dhuroi ngjalljen neve vdekatarëve, ndaj e bekojmë në jetë.

O Virgjëreshë, kur e rrëzoi absolutisht pushtetin e vdekjes me anë të ngjalljes së tij Biri yt, si Perëndi i fortë, na bashkëllartësoi dhe na hyjnizoi, ndaj e përhimnojmë në jetë.

*I Mioprrurëseve**Ton en ti vato Mosi*

[Irmosi:] »Te Moisiu, në mal,* në Sina, »parashfaq^{*} mrekullin' e së Virgjërës në »një ferrë⁶⁷ Zoti Krisht;* himnojeni, be- »koni,* përmbilartësoni atë në gjithë je- »tët.^{60]}

Nga frika e pësimeve të Krishtit, llamburitjet e diellit mblidheshin,¹⁹ të vdekurit ngriheshin,³³ malet lëkundeshin, toka dridhej²⁰ dhe Hadhi zhvishej.

Kur i ngrinin duart në kaminë dikur, Djemtë⁶⁸ e lumtur tri herë, o i Mirë, e paraikonizonin Kryqin tënd të pacenuar, përmes të cilit e vithise forcën e armikut, o Krisht.

O judenj të verbër, mashtrues dhe shkelës, që nuk i bindeni ngritjes së Krishtit, se gjoja është e gënjeshtërt, çfarë shikoni si të rremë? Se u ngjall Krishti që i ngriti të vdekurit?!

O judenj armiq, nëse ju nuk na besoni neve, pyesni ushtarët tuaj; çfarë pësuan ata? Kush e rrokullisi me dorë gurin e varrit?

Kush e thau fikun?⁶⁹ Nga ana tjetër,

kush e shëroi dorën e tharë?⁷⁰ Kush i ngopi dikur turmat në shkretëtirë?⁷¹ Kush përveç Krishtit Perëndi që i ngriti të vdekurit?

Kush i ndriçoi të verbrit? Kush i pastroi të lebrosurit? Kush i rimëkëmbi të çalët?⁷² Kush eci pa u lagur mbi det si mbi sterë?⁷³ Kush përveç Krishtit Perëndi që i ngriti të vdekurit?

Kush e ngriti nga varri një të vdekur të katërditshëm⁷⁴ dhe birin e vejushës?⁷⁵ Kush e përforcoi si Perëndi një të paralizuar në krevat?⁷⁶ Kush përveç Krishtit Perëndi që i ngriti të vdekurit?

Ky gur thërret, vulat që vutë ju mbi varr si roja⁵ bërtasin: Me të vërtetë u ngjall Krishti dhe rron në jetë.

Me të vërtetë, Krishti u ngjall, Hadhi u plaçkit, gjarpri⁵² u vra, Adami u çlirua, të poshtmit shpëtuan. Pra, pse nuk besoni, o armiq dhe shkelës?

Lavdi Triadik

Së bashku me Atin, e lavdërojmë Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, Triadhën e Shenjtë në Një Hyjni, dhe thërrasim: I shenjtë, i shenjtë, i shenjtë⁷⁷ je në jetë.

Tani Hyjlindësor

Linde pa ndryshim Një Krisht, Perëndi-në, në dy esenca, bukën e jetës⁷⁸ së përhershme që u brumos në barkun tënd pa u brumosur prej brumit tonë, o e Dëllirë.

Zbritësore: Afti i kliti ke ajia

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

Kjo është ditë e zgjedhur.

*Ode IX**I Hyjlindëses*

Tok ne, gjith' besnikët, të lumërojmë, Vir-

gjëresh',* ki gaz, porta e Zotit;*³ ki gaz ti, qytet frymor;* ki gaz, përmes teje na feksi sot* drita e Krishtit që ti na linde,* drita e ngjalljes prej varreve.

O derë hyjnore³ e Dritës,⁷⁹ ki gaz dhe dëfre;* perëndoi në varr, por* lindi Krishti; shndriti fort,* më hijesisht dhe se dielli lart,* Zonjë e hyjhirshme, dhe i feksi* besnikët mbarë, Jisui Zot.

*I Miopururëseve
Tin iperfiós sarki*

[*Irmosi*: »Le ta madhështojmë ne,* o »besnik', Hyjlindësen* e vetme që në »mitër* zuri me mish mbi mendje* pra »Fjalën që, prej Atit,* parashndriti fort pa »koh'.]

Kur të njohu, Shpëtimtar,* si Zot mbi Kryq një Kusar,* "Kujtomë" thirri dhe ti* trashëgimtar t'Parajsës* mendore lart e bëre,* i tërëfuqishmi Krisht.⁶⁵

Shërbëtorit Moisi* ia skicove në Sina,* Jisu, në pllaka Ligjin,*⁸⁰ mirëpo u pësh-tyve*⁸¹ për ne nga të paligjshmit* që të dhan' shuplaka ty.⁸²

Me vrer, uthull, Shpëtimtar,* të ujitën⁸³ për ne ty* që na dhe gjak të çmuar* si dhe trup që të hamë,* të pimë tok për jetën* e amshuar që na jep.⁸⁴

Kur në jetëbërësen* brinjë, Krisht, u shpove keq* nga shtiza,²⁸ ia gufove* gjakun tënd pa cen, ujin* e çmuar mbarë botës* si burim të gjall' gjithnjë.

Ti të vdekurve u dhe* jet', por mes të vdekurve* të quajtën, të vunë* në një varr ty që varret* i zbraze dhe plaçkite* Hadhin, ngrite Adamin.

Kur u ngjalle, o Jisu,* u prangos armiku

djall* dhe Hadhi u plaçkit krejt,* varret u boshatisën,* të poshtmet lart u ngritën* dhe t'u falën ty, o Krisht.

O hebre, të vdekurin* kush e vodhi? Qe madje* pa rrob', o të mashtruar;* Krishti u ngjall, u zgjidhën* si prangat edhe shu-lat* që i kishte Hadhi posht'.

Lavd ty, Shpëtimtari Krisht,* që burove jetë plot;* u linde drit' atyre* që në terr⁸⁵ injorance* po rrinin dhe e shndrite,* kur u ngrite, dheun mbar'.

Tok me Nxënësit hyjnor'* dhe me miopururëset,* Josifi i nderuar,* deputet, të himnohet* sepse dhe ky e shpalli* ngjalljen e Jisuit Krisht.

Të çuditshmin shën Josif* edhe miopururëset* plot bes' me Nikodhimin* bashkë, o besëmirë,* t'i mburrim duke thirrur:* Zoti Krisht u ngjall vërtet.

Lavdi Triadik

Je pa nisje ti, o At';* je i pakrijuar, Bir;* Shpirt je i bashkëfronshëm;* në natyr' Një të tre tok,* por jeni tre Persona,* Një Zot, Perëndi vërtet.

Tani Hyjlindësor

O Jese, dëfre; kërce,* o David, se ja ka nxjerr'* e Virgjra, i hyjmbjelli* shkop, një lule,³⁶ pra Krishtin* që është jeta pa fund* dhe jeton përjetësisht.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Virgjëreshë e qashtër dhe prapë të them gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

I shenjtë është Zoti...

(3x)

*Dërgimësore**E Pashkës Ting. II Sarki ipnosas*

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti ynë Zoti Krisht, u ngjalle të tretën ditë, dhe ngrite gjyshin shën Adam, dhe e dërmonte vdekjen krejt. Pashkë⁸⁶ burim i jetës, shpëtim i besnikëve.*

E Miroprurëseve: Jineqes akoutisthite

Dëgjoni, gra, një zë gazmor.* E shkela fort tiranin Hadh,* botën e ngrita prej prishjes,* ndaj rendni, thojuni lajme* miqve të mi,^{86a} ungjillëzim,* pra njoftimin e mirë mjaft;* dua: Krijimi im të shndrit* hare nga vendi ku doli* trishtimi për njerëzinë. (2x)

Lavdërime Ngjallësore Ting. II

Çdo frymë dhe çdo krijesë...

Le të thonë judenjtë...

Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni...

Engjëlli, o Zot, i solli Hirplotes...

Gratë spërkatën me miro...

Kombe dhe popuj le të lavdërojnë...

U kryqëzove, u varrose, o Krisht...

O të paligjshëm me të vërtetë...

Lavdi Mëngjesor Ting. II

Kur me miro afroheshin drejt varrit gratë tok me Marinë, dhe pyesnin veten se si do ta shihnin të përmallshmin sërish, panë gurin e rrokullisur dhe një djalosh të perëndishëm, që ua lehtësoi shqetësimin e shpirtit se: U ngjall Zoti Jisu, - u tha. Prandaj lëçituni dishepujve të tij lëçitës të rendin drejt Galileës dhe atje do ta shohin të ngjallur prej së vdekurish, si Jetëdhënës dhe Zot.*

Tani

E përmbibekuar je...

Në Liturgji, [Tipiket dhe Lumërimet: 4 Ngjallësore dhe 4 nga Ode VI e Miroprurëseve. Hyrtore Ejani t'i falemi... që u ngjall prej së vdekurish. Ose] Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, të 3 Përlëshoret dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Në vend të Të meriton, O shpirt madhështojë... Ndrìçohu, ndrìçohu... Kungatore Lavdërojeni...



NË MBRËMËSORE

*Thirrto**Ting. Tërth. I Heris askitikón*

G'zohu, me gozhdë u ngule ti* edhe me dru e zhduke nëmën nga druri keq,*¹⁶ të vdekurit që nga jeta i ngrite përmes fuqis* krejt hyjnore kur të vunë në një varr;* pushtetin tënd e lëvdojm* o Jisu, me një zë të lart',* o Pashk' e shenjtë,*⁸⁶ jeta jonë,²³ o reflektim,*⁸⁷ Bir i Atit, Zot,* fuqiplotë, ndaj kanë gaz* bashkë me tokën qielloret dhe ode mundëse* ty të këndojnë, o Fjalë që jep fitore, o Krishti im* i tërëpushtetshëm,* që i jep planetit jetë dhe përdëllim të madh.⁴

Jeta²³ është me të vdekurit vall'?"* Është nën dhë Dielli pa perëndim ende pra?,"* vajtonte, thërriste kori i miroprurëseve,* "le të rendim shpejt ne, ejani të shkojm',"* ta shohim të shenjtin varr"* dhe një engjëll të ndritshëm fort* shikuan brenda* dhe u shtangën me mjaft habi,* por ua ndali krejt* qarjen, se thirri fort: "U ngjall* Zoti Krisht jetëdhënës, o të thjeshta, mos kini tmerr,* mos u habitni, ai mbretëroi, kozmosit i dhuron* gëzim, ndjesë fajesh,* hir hyjnor, shpëtim me paqe dhe përdëllim të madh.⁴

Kori i grave, shpejt në agim,* e donte Diellin që është para diellit,* i cili kish përënduar keq atëherë në varr,* por u tha një engjëll dritëprurës nur:* “U lind drita dhe shkëlqen,* shndrit sa flen’ në terr; thojuni⁸⁵ Nxënësve mbarë* dritëprurës dhe kthejeni* zyrtësinë vrer* në hare, dhe pa hezitim* përbrenda zemrës të kërceni, duartrokisni fort* për Pashkën shumë gazmore dhe shpëtimtare për kozmosin”.* U ngjall Zoti, Krishti* që i jep planetit jetë dhe përdëllim të madh.⁴

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Engjëlli thërret: O gra miropurëse, pse erdhët në varr? Pse e kërkoni të gjallin ndër të vdekurit? Kini guxim se u ngjall Zoti!

Pasvargje të Oktoikut Ting. II *Ngjallësore*

Ejani t’i falemi atij që lindi prej Atit para jetëve, Fjalës Perëndi⁸⁸ që u mishërua prej Virgjëreshës Mari. Se, sikundër desh vetë, pasi duroi kryq, u dorëzua për varrim; dhe si u ngjall së vdekurish, më shpëtoi mua, njeriun e mashtruar.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Mëkatova ndaj teje, o Shpëtimtar, si Biri Plangprishës; pranomë, o atë, mua që pendohe⁸⁹ dhe mëshiromë, o Perëndi.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti

ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Athloforët, meqenëse nuk e dëshiruan shijimin tokësor, u denjësuat për të mirat qiellore dhe u bënë bashkëqytetarë me engjëjt. O Zot, me ndërmjetimet e tyre mëshirona dhe shpëtona.

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Gratë erdhën në varrin tënd me frikë, ngaqë, zellshëm, donin ta lyenin me aro-ma trupin tënd; dhe, kur nuk e gjetën, çuditeshin me njëra-tjetrën, meqë nuk e njihnin ngjalljen; mirëpo atyre iu shfaq papritur një engjëll dhe u tha: Krishti u ngjall dhe na dhuron përdëllimin e madh.⁴

Përlëshore

Bujari Josif, si e zbriti...

Lavdi

Kur zbritte te vdekja ti...

Tani

Grave miropurëse...



TË HËNËN E JAVËS III NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të *Oktoikut Ting. II* *Ngjallësore*

Duke mos ndaluar të vulozet guri i varrit,⁵ u fale të gjithëve shkëmbin e besës, pasi u ngjalle. O Zot, lavdi më ty.*

Kataniktike

Paligjësitë e mia u ngritën kundër meje si dallgë deti, dimëroj unë vetëm nga shkelje të shumta si anije në oqean; por më drejto në liman të qetë me anën e pe-

ndimit, o Zot, dhe shpëtomë.

Martirike

Shenjtorët, duke të pasur në botë si rrobë ty që mbështjell qiellin me re,⁹⁰ i duruan torturat e të paligjëve dhe e shfuqizuan mashtrimin e idhujve; me përgjërimit e tyre çlirona dhe ne nga armiku i padukshëm, o Shpëtimtar, dhe shpëtona.

Hyjlindësore

Efsplahnias ipárhusa piji

Je burim dhembshurie dhe kështu,* o Hyjlindëse, bëna krejt të denj' për mëshirë;* popullin që mëkatoi⁹¹ shihe pra,* si gjithnjë tregoje qart' pushtetin tënd;* meqë ne shpresojm' te ti,* "Ki gaz", të thërrasim ty* si një kryegjeneral* të pa-trupësh, Gabrieli shenjt, dikur.¹⁷

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e Miroprurëseve

Ting. II Ta ano zitón

Kur sillnin në varr* shum' mira, gratë, tërë zell,* gëzonin me shpirt* përmes shkëlqimit engjëllor* dhe të predikonin si Perëndi të kozmosit, Shpëtimtar,* u thërrisnin Nxënësve mbar':* Nga varri vërtet u ngjall pra jeta për gjithë ne.²³ (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miroprurëseve (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Miroprurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi i Miroprurëseve. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Miroprurëseve (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. II

Ngjallësor

Çdo frymë dhe çdo krijesë ty të lavdëron, o Zot, se me anën e Kryqit shkatërrove

vdekjen, që t'u tregosh popujve Ngjalljen tënde prej së vdekurish, si i vetmi njeri-dashës.* (2x)

Kataniktik

Duke kuptuar absurditetin e të tmerrshmeve që bëra, përiki drejt dhembshurive të tua, duke imituar Doganierin,⁹² Laviren që lotoi⁹³ dhe Birin Plangprishës;⁸⁹ prandaj dhe gjunjëzohem para teje, o përdëllimtar: Para se të më dënosh, le të të vijë keq për mua, o Perëndi, dhe mëshiromë.⁹⁴

Martirik

O martirë athloforë, përderisa pësuar për hir të Krishtit⁹⁵ deri në vdekje, i keni shpirtrat në qiej, në dorë Perëndie,⁹⁶ dhe në botën mbarë bëhen litani lipsanet tuaja; falen priftërinj dhe mbretër, dhe të gjithë ne popujt, duke u ngazëlluar, thërrasim zakonisht: Gjumë i çmuar është para Zotit vdekja e oshënarëve të tij.⁹⁷

Lavdi dhe Tani Ting. I

Magdalena dhe Maria tjetër shkuan në varr për të kërkuar Zotin; dhe panë një engjëll si rrufe, që rrinte ulur mbi gur, i cili u tha: "Pse e kërkonin të gjallin mes të vdekurve? U ngjall siç tha, do ta gjeni në Galile". Atij le t'i thërrasim: "O Zot që u ngjalle nga të vdekurit, lavdi më ty".

Pasvargje të Miroprurëseve

Ting. Tërth. II Triímeros anestis Hristé

O popuj, nisni ju psalmikisht*⁹⁸ himninin e Krishtit me gaz;* Çlirimtari* i krijesës, Zoti Krisht* dhe jetëdhënës, Pashkë⁸⁶ të madhe na ka lindur* pasi u ngjall prej varrit me lavdi.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

U the ti miroprurëseve* "gëzohuni", e

kthen në gaz* krejt dënimin* që kish Eva;¹⁶ i dërgon* Nxënësit, si u ngjalle; u the ta shpallnin, se ti* u ngjalle pas tri ditësh nga varri.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Na shndriti Krishti, Pashka⁸⁶ plot nder,* e shenjtë; ejani të gjith'* që të shndritim* ne në shpirt, se ja ku tash* këtu u llamburit dita, ndaj le të dëfretim*, të ngazëllohemi të tërë ne.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Gratë spërkatën me miro dhe lot varrin tënd, dhe goja e tyre u mbush plot me gëzim kur thoshin: U ngjall Zoti.*

Në Liturgji çdo ditë të javës, [Tipiket dhe nga Kanuni i Miropurësëve Ode III dhe VI. Ose] Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, të 3 Përlëshoret dhe e shenjtë të kishës. Kontaqi i Pashkës. Trishenjtë. Të meriton. Kungatorja e ditës. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall. Emri i Zotit goftë i bekuar.



TË HËNËN E JAVËS III NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. II Ote ek tu ksilu se

O Krisht,* jeta e të gjithave,*²³ duke të kërkuar që pa gdhirë, erdhën me miro boll* miropurëset edhe plot me aroma pra* dhe lotonin nga malli; por dëgjuan prej varrit* një të ri që tha: Pushoni dhe mos qani më;* thirruni fort njerëzve mbarë* në shpëtimin tuaj me mjaft gaz:* Shpëtimtari Zot u ngrit me shumë lavd.

Josif* i shënuar, si karroc'* keruvimesh⁹⁹ të dim', nga Kryqi e zbrite,¹⁴ e mban në sup* mbretin Krisht; i lumërojmë duart e tua* njësh me sytë e shenjtë, t'i nderojmë pëllëmbët* me të cilat Diellin, Fjalë dhe Perëndi,*⁸⁸ si e transferove, e vure* në një varr,¹⁴ prandaj e lëvdojmë* të hyjnueshmin kujtimin tënd, i lum.

Shfaqet* si Parajsë tjetër drejt* për ne panairi i shenjteve miropurëse gra* edhe i Josifit të nderuar dhe na jep* një burim¹⁰⁰ jete, dhe i hedh si shi botës rrjedhat,* Hirin, i gufon të nxehtat rryma prej ngritjes* së Krishtit, ndaj kore besnikësh,* në kremtim, thërrasin: Lavd Zotit* që e dha në çdo vend ngjalljen e tij pra.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Miropurëset arritën me nxitim, në agim, në varrin tënd dhe të kërkonin, o Krisht, që ta lyenin me miro trupin tënd të pacenuar; dhe, meqë i dëgjuan fjalët e engjëllit, u shpallnin apostujve simbole gazmore se "U ngjall kryetari i shpëtimit tonë⁷ pasi e plaçkiti vdekjen, ndërsa i dhuron botës jetën e amshuar⁸ dhe përdëllimin e madh".⁴

*Pasvargje të Oktoikut Ting. II
Ngjallësor*

Krishti, Shpëtimtari ynë, e fshiu dorë-shkrimin që ishte kundër nesh,¹⁰¹ duke e mbërthyer në Kryq, dhe shfuqizoi pushtetin e vdekjes. I falemi Ngjalljes së tij të triditshme.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj,

kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Të thërras, o Krisht Shpëtimtar, fjalët e Doganierit; le të të vijë keq për mua si për të⁹² dhe mëshirë, o Perëndi.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Meqë martirët e shenjtë ndërmjetojnë për ne dhe e himnojnë Krishtin, çdo mashtrim pushoi, dhe gjinia e njerëzve shpëton përmes besimit.

Lavdi dhe Tani Ting. II

O Nxënëse, pse e përzieni miron me lotët? Guri u rrokullis, varri u zbraz; shiheni prishjen e shkelur prej jetës; vullat dëshmojnë gjithkund se rojat⁵ e mosbindjes flinin rëndë; vdekshmëria shpëtoi përmes trupit të Perëndisë; Hadhi qan; vraponi me hare dhe thojuni apostujve: Krishti që vrau vdekjen, si i parëlindur nga të vdekurit,⁶ po shkon para jush në Galile.

Përlëshore për çdo ditë të javës

Bujari Josif, si e zbriti...

Lavdi

Kur zbritte te vdekja ti...

Tani

Grave miropurëse...



TË MARTËN E JAVËS III NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore të Oktoikut Ting. II

Ngjallësore

Megjithëse nuk e le sipër gjirin e pacen,²⁴ e denjove për të gjithë varrimin dhe ngjalljen, o Zot, lavdi më ty.

Kataniktike

O Zot, unë jam pema e pafrytshme, ngaqë nuk sjell fare fryt kataniksi, dhe tmerrohem nga prerja,¹⁰² dhe frikësohem nga ai zjarr i pashuar,¹⁰³ prandaj të përgjërohem: Para kësaj nevoje, kthemë dhe shpëtomë.

Martirike

O Krisht Perëndi, që i ndriçove shenjtoret e tu më shumë se ari dhe i lavdërove oshënarët e tu si i mirë, me përgjërimit e tyre paqësoje jetën tonë si njeridashës, dhe drejtoje lutjen si temjam¹⁰⁴ ti, i vetmi që prehesh ndër shenjtore.¹⁰⁵

Hyjlindësore

Duke u arratisur nga ligjet e natyrës, e bashkove virgjërinë me lindje hyjnore, sepse vetëm ti e linde atë që lindi, pa kohë, para teje; prandaj të madhërojmë, o Perëndilindëse.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore e Miropurëseve Ting. II

Pasi arritën në agim dhe e panë bosh varrin, miropurëset u thoshin apostujve: I fuqishmi e vithisi prishjen dhe i rrëmbeu nga prangat ata që ishin në Hadh; shpallni me guxim se u ngjall Zoti dhe na jep përdëllimin e madh.⁴ (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miroprurëseve (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe të Miroprurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi i Miroprurëseve. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Miroprurëseve (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

*Ting. II
Ngjallësor*

Le të thonë judenjtë: Si e humbën ushtarët kur e ruanin Mbretin? Përse guri nuk e ruajti gurin e jetës? Ose të japin të varrosurin, ose t'i falen të ngjallurit, duke thënë bashkë me ne: Lavdi shumicës së dhembshurive të tua, o Shpëtimtari ynë, lavdi më ty.* (2x)

Kataniktik

Mos i vër re paudhësitë e mia, o Zot që linde prej Virgjërëshës, dhe pastroma zemrën, duke e bërë tempull të Shpirtit¹⁰⁶ tënd të Shenjtë; mos më hidh të turpëruar tej fytyrës sate, ti që ke përdëllimin e madh të pamatur.*

Martirik

Martirët e shenjtë, kur e morën Kryqin e Krishtit¹⁰⁷ si armë të pamoshtur, shfuqizuan tërë forcën e djallit dhe, meqë morën kurorë qiellore, na u bënë si mur, duke ndërmjetuar përherë për ne.

Lavdi dhe Tani *Ting. II E Anatolit*

Herët në mëngjes, gratë miroprurëse morën aroma dhe shkuan te varri i Zotit; dhe, kur gjetën ato që nuk shpresonin, mendonin me ankth për heqjen e gurit dhe i thoshin njëra-tjetrës: “Ku janë vullat e varrit? Ku është toga e Pilatit dhe sigurimi i fortë?”.⁵ Dhe një engjëll që shkëlqente, i lajmëroi gratë që nuk e dinin dhe u tha: “Pse e kërkonin duke qarë

të gjallin që e gjallëroi gjininë e vdekatarëve? U ngrit Krishti, Perëndia ynë, si i tërëfuqishëm, dhe na jep të gjithë neve paprishjen, jetën, ndriçimin dhe përdëllimin e madh”.⁴

Pasvargje të Miroprurëseve

Ting. II Ote ek tu ksilu se

Shndrit sot* përmbi dhë me hijeshi* dhe feks drita trediellore, çdo terr pasionesh e flak,* shfaqet dhe i ruan besimtarët ngjallja pra,* zotërore; me mall kërcejnë kore apostujsh,* dhe dëfren Josifi dhe kujtimi plot hare,* gaz, i miroprur'seve me nder* i kurorëzon sa e mburrim* me bes' dhe hyjnoren ngritje e lëvdojn'.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

Kur mbi* sup e ngrite, o Josif,*¹⁴ të pazbrazshmen miro¹⁰⁸ që bri Atit, në të djathtë, qëndron,* Birin pra,¹⁰⁹ me miro e varrose; në një varr* e vendose ti ngjalljen¹¹⁰ botërore, e mbylle* me një gur atë që veshi dritën pa shpjegim* si rrobë;¹⁸ prandaj ne, me himne,* po këndojm' për ngritjen, pësimet* shpëtimtare edhe dritëprurëse.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Kori* engjëllor ka shumë tmerr* kur të sheh, Josif, që varros Krishtin,¹⁴ bota të lumëron,* ne besnikët ty të admirojmë dhe hyjnisht* të nderuarën ngjallje mjaft e çmojmë, dhe zellshëm* ty dhe miroprurëset ju mburrim; ndaj gjithnjë,* pa pushim, thërrasim: Me to ti* ndërmjeto për ne të shpëtojmë* nga rreziqet dhe shtrëngimet edhe ne.

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Gratë erdhën në varrin tënd me frikë,

ngaqë, zellshëm, donin ta lyenin me aroma trupin tënd; dhe, kur nuk e gjetën, çuditëshin me njëra-tjetrën, meqë nuk e njihnin ngjalljen; mirëpo atyre iu shfaq papritur një engjëll dhe u tha: Krishti u ngjall dhe na dhuron përdëllimin e madh.⁴



TË MARTËN E JAVËS III NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Ting. II Ote ek tu ksilu se

G'zohen* Nxënëset e Zotit Krisht,* se dëgjuan fjalë gëzimi prej engjëllit dhe me to* krejt u bindën pra për ngjalljen e Shpëtuesit* që për ne u rendit në mes të vdekurve mbarë,* sado shkuan më par' porsi miropurëse* te varri dhe qanin me dhimbje,* por e shihnin të rrokullisur* gurin që s'shpresonin ta lëviznin dot.

Një gaz* të pafund, hyjnor, u dhan'* gratë miropurëse, nxënëset e Jisuit Krisht, Zot* Nxënësve hyjnor', të shenjtë, se e bënë drejt* porosinë e engjëllit hyjnor si u shtangën* prej stolis' së tij të bardhë, dritëpurëse,* thanë: U plaçkit Hadhi për-mes* ngjalljes shpëtimtare për ne krejt* të atij, të mbretit që vdiq keq për ne.

Rrjedhat* prej burimi qarjeje,* plot me lot, shën nxënëset mbarë të Krishtit i ndalën krejt,* tash syamësve të Hirit u përçojn' fjalë* ngazëllimi, u lajmërojnë ngritjen e Fjalës,* se haren' nga varri, pra paradoksalin zë* që ishte i kundërt me vverin,* e dëgjuan që porosiste,* urdhëronte qartazi: Gëzohuni!

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani

Ting. Tërth. II E Kozma Monakut

Kur shkuan me nxitim dhe arritën në varrin tënd, dhe i panë vulat e tij, por nuk e gjetën trupin tënd të pacen, gratë miropurëse vajtonin dhe thoshin: Kush na e vodhi shpresën? Kush e mori të vdekurin e lyer me miro, të zhveshurin, ngushëllimin e vetëm të nënës? Oh, si vdiq ai që i ngjalli të vdekurit? Si u varros ai që e plaçkiti Hadhin? Pra, ngjallu me pushtetin tënd pas tri ditësh, o Shpëtimtar, ashtu siç the⁹ dhe shpëtoji shpirtrat tanë.

Pasvargje të Oktoikut Ting. II

Kryqësor

O Zot Shpëtimtar, ti që shpëtove Petron në det,¹¹¹ shpëtomë me fuqinë e Kryqit dhe mëshiomë, o Perëndi.

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

Bashkë me kryeengjëjt le të himnojmë Ngjalljen e Krishtit; se ai është Çliruesi dhe Shpëtimtari i shpirtrave tanë; dhe me lavdi të frikshme dhe me forcë të fuqishme do të vijë përsëri të gjykojë botën që krijoi.^{112*}

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Kore martirësh i kundërshtuan tiranët dhe u thanë: Ne mobilizohemi për mbretin e fuqive;¹¹³ nëse do të na shfarosni dhe

me zjarr, dhe me tortura, nuk e mohojmë forcën e Trinisë.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Josifi kërkoi trupin e Jisuit dhe e vendosi te varri i tij i ri;¹⁴ se duhej të dilte si prej nusëroreje. Lavdi më Ty, që dërmovë pushtetin e vdekjes dhe u çele njerëzve dyert e Parajsës.^{15*}



TË MËRKURËN JAVËS III NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të
Oktoikut
Ting. II
Kryqësore*

Bëre shpëtim në mes të dheut,¹¹⁴ o Krisht Perëndi; mbi Kryq i tendose duart e tua të pacenuara dhe i përmbloodhe tërë kombet¹¹⁵ që thërrisnin: O Zot, lavdi më ty.

Ngjallësore

Kur u ngrite nga varri dhe i çave prangat e Hadhit, e shfarose dënimin e vdekjes,¹⁶ o Zot, dhe na çlirove të gjithë nga grackat e armikut; dhe kur ua shfaqë veten tënde apostujve, i dërgove për predikim,¹¹⁶ dhe me anën e tyre ia dhe botës paqen tënde, o i vetmi i shumëmëshirshëm.

Martirike

O athloforë të Zotit, është e lumtur toka që u bë pjellore me anën e gjakrave tuaja, dhe të shenjta janë tendat që pritën¹¹⁷ trupat tuaj, sepse në stadium e poshtëruat armikun dhe e shpallët me guxim Krishtin; lutemi, atij përgjërojuni që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtat tanë.

Lavdi dhe Tani *Kryqhyjlindësore*

Duke ndenjur pranë Kryqit tënd dhe duke mos duruar të të shikonte që pësoje padrejtësisht, ajo që të lindi pa farë, vajtonte me klithma dhe qarje, dhe të thërriste: Si pëson, o Bir tepër i ëmbël, ti që nga natyra nuk pranon pësim? Himnoj mirësinë tënde të skajshme.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e
Miropurësore*

Ting. II Efsplahnias ipårhusa

Ndërsa shkuan në varrin tënd, o Zot,* miropurëset mjaft të respektuara donin* të krezmonin shpejt ty, Shpëtimtari Krisht,* si njeri, me miro; veçse engjëlli* u dha lajme, gaz të madh:* U ngjall Zoti, ndaj vërtet* ngritjen e tij plot çudi* jashtë varrit shpalluani apostujve. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miropurësore (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Miropurësore. Pas Odes VI, Kontaqi i Miropurësore. Në Oden IX, Më të Nderuarën. Dërgimësorja e Miropurësore (2x).*

*Lavdërime të Oktoikut
Ting. II
Kryqësor*

Pasi u varfërove vullnetarisht¹¹⁸ me varfërinë e Adamit, erdhe mbi dhë, o Krisht Perëndi, kur u mishërove prej një Virgjëreshe; dhe denjove Kryq që të na çliroje nga skllavëria¹¹⁹ e armikut; o Zot, lavdi më ty. (2x)

Ngjallësor

Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni; engjëlli ndenji mbi gurin e varrit; ai na ungjillëzoi duke thënë: Krishti u ngjall prej së vdekurish, Shpëtimtari i botës,¹²⁰ dhe i mbushi të gjitha me erë lulesh. Gëzohuni,

popuj, dhe ngazëllohuni.*

Martirik

Bashkësitë e martirëve të tu, të përgjër-rohen, o Krisht; mëshirona si njeridashës.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Gratë erdhën në varrin tënd me frikë, ngaqë, zellshëm, donin ta lyenin me aroma trupin tënd; dhe, kur nuk e gjetën, çuditëshin me njëra-tjetrën, meqë nuk e njihnin ngjalljen; mirëpo atyre iu shfaq papritur një engjëll dhe u tha: Krishti u ngjall dhe na dhuron përdëllimin e madh.⁴

Pasvargje të Miropurësive

Ting. II Ote ek tu ksilu se

“Është* vallë ndër të vdekurit* Çlirim-tari, Dielli shumë i madh, akoma nën dhé,* a u ngjall, siç tha?”⁹ thërrisin miropurëset;* dhe, siç qanin kështu, u foli një engjëll nga varri* nxën’sëve të Krishtit, u dha gaz të shenjt’ vërtet* se Krishti u ngjall, ndaj vraponi* edhe ngritjen e tij hyjnore* lart nga varri shpalluani të gjithëve.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

O Krisht,* gratë miropurëse,* si i përgatitën të çmuarat miro erdhën tok bri* varrit tënd kur ende, njeridashës, kishte terr* në të parën e javës, që ta lyenin trupin* e pacenshëm dhe hyjnor, ndaj e mësuan drejt* ngjalljen tënde, shkuan me vrap pra,* mistëve u dhan’ lajme, siç the* “Kini gaz”, kur i takove ti në varr.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Zoti* i fortlartë përmbi dhé* u varros porsi vdekatar, nxënëset e tij shpejt e shpejt* shkojnë që me miro të nderuar ta krezmojnë* edhe shtangen kur shohin një

të ri me fytyrë* që shkëlqen çuditshëm dhe rri mbi të shenjtin varr,* ndaj e njohin ngjalljen e Fjalës* prej së vdekurish pas tri ditësh* edhe ua njoftojnë shën apostujve.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. I*

Ty që vishesh me dritën si rrobë,¹⁸ Josifi të zbriti prej drurit me Nikodhimin¹⁴ dhe, kur të pa të vdekur, të zhveshur, e të pavarrosur, të nisi një vaj të mallëngjyer dhe, duke vajtuar, po thoshte: Mjer’ o Jisu fort i ëmbël! Që kur të pa dielli pak kohë më parë të varesh në kryq, mbështillej me errësirë,¹⁹ dhe dheu valonte nga frika,²⁰ dhe kurtin’ e Tempullit çahej;²¹ po ja tani shoh që durove vdekje për mua vullnetarisht.²² Si të të varros, o Perëndia im? Apo si të të mbështjell me pëlhura? Dhe me ç’duar ta prek trupin tënd të perëndishëm? Apo ç’këngë t’i këndoj vdekjes sate, o zemërdhembshur? Madhështoj Pësimet e tua dhe përhimnoj Varrimin tënd me Ngjalljen, duke thirrur: Lavdi më Ty.*



TË MËRKURËN E JAVËS III NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. II Ote ek tu ksilu se

Fjalët* plot gaz i dëgjuan qart’* nga hyjnoret Mendje që rrinin në varrin e Fjalës Zot* dhe me një vull më të madh vrapuan si e lan’* veçorin’ e mëparshme miropurëse, edhe* tash u shfaqën ungjillore para mistëve,* ngritjen nga bodrumet e Hadhit* të atij që u mishërua* për ne e njoftuan me mjaft emocion.

Gratë* miroprurëse me tmerr* erdhën pranë varrit përpara agimit shumë të thell’* se i sillnin miro Krishtit, jetë-dhënësit;* ndër të vdekurit e mendonin Fjalën që vrau* Hadhin, vdekjen, por hyj-nori engjëll bri u shfaq* dhe u thirri: Pse e kërkonti* ndër të vdekur Zotin e gjallë,* jetëprurës? Ikni, shpallni ngjalljen ju.

Lum ti,* shën Josif, se Fjalën Zot* që, mbi Keruvimet, mbi supet e tyre prehet,⁹⁹ e mban* ti mbi supe si karrocë; mori mish ai* më përpara, por vdiq tani dhe na gjallëroi* ne që vdiqëm; kur e sheh ti ngritjen e tij tash,* tok me miroprurëset plot nder* ke hare edhe pse e qanit* më përpara vdekjen e atij me zi.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Magdalena dhe Maria tjetër shkuan në varr për të kërkuar Zotin; dhe panë një engjëll si rrufe, që rrinte ulur mbi gur, i cili u tha: “Pse e kërkonin të gjallin mes të vdekurve? U ngjall siç tha, do ta gjeni në Galile”. Atij le t’i thërrasim: “O Zot që u ngjalle nga të vdekurit, lavdi më ty”.

Pasvargje të Oktoikut Ting. II
Ngjallësor

Ngjallja jote, o Krisht Shpëtimtar, ndriti tërë botën dhe thirre prapë krijesën tënde. Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.*

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Apostolik

O Shpëtimtar, i madhërove nëpër kozmos emrat e apostujve korifenj; ata i mësuan të parrëfyeshmet e qiejve,¹²¹ u dhanë shërime atyre që ishin mbi dhe, dhe vetëm hijet e tyre i shëronin sëmundjet;¹²² peshkatar i bente çudi dhe judea-

si theologonte dogmat e Hirit; me anën e tyre, o i dhembshur, jepna përdëllimin tënd të madh.⁴

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Martirik

O shenjtore, është e madhe lavdia që morët me anën e besës, sepse jo vetëm kur pësonit e mundët armikun, por edhe pas vdekjes dëboni frymë dhe shëroni të sëmurë, o mjekë shpirtrash dhe trupash; ndërmjetoni pranë Zotit që t’i mëshirojë shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Gratë spërkatën me miro dhe lot varrin tënd, dhe goja e tyre u mbush plot me gëzim kur thoshin: U ngjall Zoti.*



TË ENJTEN E JAVËS III NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të
Oktoikut
Ting. II
Ngjallësore

Për të sjellë miro për varrimin tënd, gratë arritën te varri në agim fshehtazi, meqenëse frikësoheshin nga arroganca e judenjve dhe kishin në mendje ruajtjen e ushtarëve; por natyra e dobët fitoi mbi burrërinë, se predispozicioni i mirë, dhembshuria, i pëlqeu Perëndisë; prandaj thërrisnin përshtatshëm: Ngjallu, o Zot, ndihmona dhe çlirona për hir të emrit tënd.²⁵

Apostolike

O Krisht Perëndi, që i urtësove peshkatarët më shumë se oratorët dhe i

dërgove si predikues në tërë dheun, nëpërmjet njeridashjes sate të parrëfyeshme forcoje Kishën tënde me anën e tyre, dhe dërgoju besimtarëve bekimin tënd, i vetmi përdëllyes dhe njeridashës.

Martirike

O apostuj, martirë, profetë, hierarkë, oshënarë dhe të drejtë, që e mbaruat mirë garën dhe e ruajtët besën,¹²³ meqë keni guxim para Shpëtimtarit, lutemi, ly-peni atë për ne që, si i mirë, t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

Hyllindësore

Nëpërmjet teje, o Gjithmonëvirgjëreshë, u bëmë pjesëmarrës të natyrës hyjnore,¹²⁴ sepse na linde Perëndi të mishëruar; prandaj, detyrimisht, të madhërojmë të gjithë besërisht.

Pas Stihologjisë se dytë, Ndenjësores e Miroprurëseve

Ting. II Ta ano zitón

Shpëtues dhe Zot* dhe njeridashës, shenjtat gra* t'i sillnin me vrap* aromat të të lyenin,* por u thirri engjëlli shenjt nga varri: Zot jetëdhënësi* e ka shkelur Hadhin e zi* me vdekjen dhe prishjen kur u ngrit me lavdi.

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miroprurëseve (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Miroprurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi i Miroprurëseve. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Miroprurëseve (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. II

Ngjallësor

Engjëlli, o Zot, i solli Hirplotes përshë-

ndetjen “gëzohu” para zënies sate;¹⁷ engjëlli rrokullisi dhe gurin e varrit tënd të lavdëruar me ngjalljen tënde. Njëri duke lajmëruar simbole ngazëllimi në vend të helmit; tjetri duke na lëçitur Zotin Jetëdhënësin në vend të vdekjes. Prandaj po të thërresim: O Zot, mirëbërës i të gjithëve, lavdi më ty.* (2x)

Apostolik

Ne që luftohemi nga çdo anë prej ve-prave të padrejta dhe përikim drejt teje, që je vërtet Perëndi, të ofrojmë fjalët e Nxënësve të tu dhe themi: Na shpëto, o Mjeshtër, po humbasim!¹⁰¹ Lutemi, tregojë dhe tani armiqve tanë se e mbulon popullin, e çliron nga rreziqet me ndërmjetimet e apostujve dhe nga mirësia e madhe nuk i llogarit mëkatet; o Zot, lavdi më ty.

Martirik

O martirë athloforë, çdo qytet dhe vend i nderon lipsanet tuaja, sepse ju, pasi garuat ligjërisht,¹²⁵ morët kurorë qiellore; kështu jeni krenaria e priftërinjve, fitorja e mbretërve dhe hijeshia e Kishave.

Lavdi dhe Tani Ting. II I Anatólit

Herët në mëngjes, gratë miroprurëse morën aroma dhe shkuan te varri i Zotit; dhe, kur gjetën ato që nuk shpresonin, mendonin me ankth për heqjen e gurit dhe i thoshin njëra-tjetrës: “Ku janë vullat e varrit? Ku është toga e Pilatit dhe sigurimi i fortë?”.⁵ Dhe një engjëll që shkëlqente, i lajmëroi gratë që nuk e dinin dhe u tha: “Pse e kërkon duke qarë të gjallin që e gjallëroi gjininë e vdektarëve? U ngrit Krishti, Perëndia ynë, si i tërëfuqishëm, dhe na jep të gjithë neve paprishjen, jetën, ndriçimin dhe përdëllimin e madh”.⁴

Pasvargje të Miroprurëseve

Ting II Ote ek tu ksilu se

Kur, si* Perëndi, u ngjalle ti,* grave miroprurëse, Fjalë, u dhe gëzim duke thën':* "Mos më prekni, nuk kam shkuar ende bri Atit,* vetëm shkoni dhe thojuni ju miqve të mi mbar':*⁸⁶ 'Ja po shkon ai përpara jush'." Ndaj, pas kësaj,* Shpirtin Shenjt u dhe kur iu shfaq,* Shpëtimtar, atyre me fryrje* dhe u fuqizuan për shërbimin tënd.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

Fjalët* që than' miroprurëset,* s'i besuan mistët; ato shpallin se u ngjall Zoti Krisht* nga të vdekurit, kështu te varri shkuan shpejt* ta shikonin dhe pan' atje çarçafin dhe rizën,* por atë që po kërkonin, nuk e panë dot,* ndaj, si e kuptuan qart' ngjalljen,* shfaqeshin në kombe e botë* predikues edhe lajmëtar' të saj.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Drita*⁷⁹ që s'afrohet¹²⁶ na u shfaq,* Zoti Krisht prej varrit na shndriti i bukur dhe u bë rob* Hadhi dhe u zhduk satani, bota ka hare* anembanë, kërcen Krijesa, Kisha e Krishtit* po kremton, këndon kujtimin e Josifit shenjt* mjaft të urtë dhe panairin* e tij dhe të grave të hyjshme* miroprurëse tok e nderon, e mburr.

Lavdi dhe Tani *Injëjti I Kumulait*

O Nxënëse, pse e përzieni miron me lotët? Guri u rrokullis, varri u zbraz; shiheni prishjen e shkelur prej jetës; vullat dëshmojnë gjithkund se rojat⁵ e mosbindjes flinin rëndë; vdekshmëria shpëtoi përmes trupit të Perëndisë; Hadhi qan; vraponi me hare dhe thojuni apostujve: Krishti që vrau vdekjen, si i

parëlindur nga të vdekurit,⁶ po shkon para jush në Galile.



TË ENJTEN E JAVËS III NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. Tërth. IV

O tu paradhoksu thávmatos

O të thjeshtat miroprurëse, kur erdhi Krishti mbi dhé,* shkonit pas gjurmëve të tij,*¹²⁷ me gatishmëri në shpirt,* i shërbenit¹²⁸ edhe, kur vdiq,* s'e latë, por shkua dhe i çuat ju* miro me lot sepse kishit dashuri,* prandaj po bëjmë ne,* në kujtimin tuaj, panair me gaz* dhe e mburrim përkushtimin tuaj për atë.

Një grup grash të hyjshme dëshironin fort ta shihnin në varr* Jetën²³ tashmë të vdekur, ndaj,* natën, shkoi dhe atje* e dëgjoi prej engjëjve:* "Siç paratha, Zoti Krisht u ngrit,⁹ prandaj* shkoni shpejt, thojuni Nxënësve të tij:* "Flakeni dhimbjen tej,* zyrtësin' e shpirtit edhe kini gaz* të pashprehshëm pra në vend të qarjes me vajtim".

Ne besnikët, në kujtimin tuaj, miroprurëse, sot* do kërcejmë, do lavdërojm'* Zotin e mbimirë që* ju lëvdoi, pra lypini* pa fund të gjejmë lavd të përjetshëm¹²⁹ ne* dhe të arrijmë shkëlqim shenjtore¹³⁰ lart,* se, o të thjeshta mjaft,* të hyjllumta, keni ju guxim ndaj tij* edhe ndërmjetoni përgjithnjë për tërë ne.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Miroprurëset arritën me nxitim, në agim, në varrin tënd dhe të kërkonin, o Krisht,

që ta lyenin me miro trupin tënd të pacentuar; dhe, meqë i dëgjuan fjalët e engjëllit, u shpallnin apostujve simbole gazmore se “U ngjall kryetari i shpëtimit tonë,⁷ pasi e plaçkiti vdekjen, ndërsa i dhuron botës jetën e amshuar⁸ dhe përdëllimin e madh”.⁴

Pasvargje të Oktoikut Ting. II

Kryqësor

“Le të kryqëzohet” thërrisnin¹³¹ ata që gjithmonë i shijonin karizmat e tua; dhe kërkonin ata, vrasësit e të drejtëve,¹³² të merrnin një kriminel në vend të një mirëbërësi;³² por ti, o Krisht, duke e duruar arrogancën e tyre, heshtje⁸² meqë doje të pësoje²² dhe të na shpëtoje si njeridashës.

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

Ejani t'i falemi atij që lindi prej Atit para jetëve, Fjalës Perëndi⁸⁸ që u mishërua prej Virgjërëshës Mari. Se, sikundër deshi vetë, pasi duroi kryq,²² u dorëzua për varrim; dhe si u ngjall së vdekurish, më shpëtoi mua, njeriun e mashtruar.*

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Athloforët, meqenëse nuk e dëshiruan shijimin tokësor, u denjësuat për të mirat qiellore dhe u bënë bashkëqytetarë me engjëjt. O Zot, me ndërmjetimet e tyre

mëshirona dhe shpëtona.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

Josifi kërkoi trupin e Jisuit dhe e vendosi te varri i tij i ri;¹⁴ se duhej të dilte si prej nusëroreje. Lavdi më Ty, që dërmive pushtetin e vdekjes dhe u çele njerëzve dyert e Parajsës.^{15*}



TË PREMTEN E JAVËS III NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të

Oktoikut

Ting. II

Kryqësore

Ikonës sate të pacenuar i falemi, o i Mirë, duke kërkuar ndjesën e shkeljeve tona, o Krisht Perëndi, sepse vullnetarisht deshe me mirëdashje të ngjiteshe në Kryq,²² që t'i çlirosh ata që gatove³⁷ nga skllavëria e armikut; ndaj me kënaqësi të thërrasim: I mbushe me hare të gjitha, o Shpëtimtari ynë, kur erdhe që ta shpëtosh botën.¹³³

Ngjallësore

Duke mos ndaluar të vuloset guri i varrit, u fale të gjithëve shkëmbin e besës,¹³⁴ pasi u ngjalle. O Zot, lavdi më ty.*

Martirike

Kur martirët e Zotit garuan në mundime, atëherë arroganca e të pabesëve u nxi nëpërmjet besimit; dhe, kur e asgjësuan hyjnisht mashtrimin e idhujve, atëherë i morën nga lart kurorat e fitores dhe ndërmjetojnë për shpirtrat tanë.

Kryqhyjlindësore

Efsplahnias ipårhusa

Kur të pa të tendosur mbi një dru* dhe të vdekur, e Virgjra nëna jote po qante,*

o Krisht, hidhur thoshte: Ç'është ky mister* plot tmerr, Biri im? Si përmbi Kryq po vdes* me vdekje të turpshme¹³⁵ krejt* me dashje²² ti që dhuron* jetë të përjetshme nur* te të gjithë⁵⁹ pranë teje në amshim?

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores e Miropurëseve*

Ting. II Ta ano zitón

Kur sillnin në varr* mjaft miro, gratë, plot me zell,* gëzonin në shpirt* përmes shkëlqimit engjëllor* dhe të predikonin si Perëndi të kozmosit, Shpëtimtar;* u thërrisnin Nxënësve mbar':* Nga varri vërtet u ngjall pra jeta për gjithë ne.²³ (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miropurëseve (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Miropurëseve. Pas Odes VI, Kontaqi i Miropurëseve. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Miropurëseve (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. II

Kryqësor

O Krisht Perëndi, drurin e Kryqit tënd na e tregove si dru jete¹³⁶ neve që besojmë te ti; me anën e tij asgjësove atë që kishte pushtetin e vdekjes¹³⁷ dhe na ngjalle ne të vdekurit nga mëkati; prandaj të thërrasim: O Zot, mirëbërës i të gjithave, lavdi më ty. (2x)

Ngjallësor

Çdo frymë dhe çdo krijesë ty të lavdëron, o Zot, se me anën e Kryqit shkatërrove vdekjen, që t'u tregosh popujve Ngjalljen tënde prej së vdekurish, si i vetmi njeri ridashës.*

Martirik

O martirë athloforë, përderisa pësua për hir të Krishtit⁹⁵ deri në vdekje, i keni shpirtrat në qiej, në dorë Perëndie,⁹⁶ dhe në botën mbarë bëhen litani lipsanet tuaja; falen priftërinj dhe mbretër, dhe të gjithë ne popujt, duke u ngazëlluar, thërrasim zakonisht: Gjurmë i çmuar është para Zotit vdekja e oshënarëve të tij.⁹⁷

Lavdi dhe Tani Ting. I

Engjëlli thërret: O gra miropurëse, pse erdhët në varr? Pse e kërkonit të gjallin ndër të vdekurit? Kini guxim se u ngjall Zoti!

Pasvargje të Miropurëseve

Ting. II Ote ek tu ksilu se

G'zohen* Nxënëset e Zotit Krisht,* se dëgjuan fjalë gëzimi prej engjëllit dhe me to* krejt u bindën pra për ngjalljen e Shpëtuesit* që për ne u rendit në mes të vdekurve mbarë,* sado shkuan më par' porsi miropurëse* te varri dhe qanin me dhimbje,* por e shihnin të rrokullisur* gurin që s' shpresonin ta lëviznin dot.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

Një gaz* të pafund, hyjnor, u dhan'* gratë miropurëse, nxënëset e Jisuit Krisht, Zot* Nxënësve hyjnor', të shenjtë, se e bënë drejt* porosinë e engjëllit hyjnor si u shtangën* prej stolis' së tij të bardhë, dritëpurëse;* thanë: U plaçkit Hadhi përmes* ngjalljes shpëtimtare për ne krejt* të atij, të mbretit që vdiq keq për ne.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Rrjedhat* prej burimi qarjeje,* plot me lot, shën nxënëset mbarë të Krishtit i ndalën krejt;* tash sypamësve të Hirit u

përçojnë' fjalë* ngazëllimi, u lajmërojnë ngritjen e Fjalës,* se haren' nga varri, pra paradoksalin zë* që ishte i kundërt me vverin,* e dëgjuan që porosiste,* urdhëronte qartazi: Gëzohuni!

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Gratë erdhën në varrin tënd me frikë, ngaqë, zellshëm, donin ta lyenin me aroma trupin tënd; dhe, kur nuk e gjetën, çuditëshin me njëra-tjetrën, meqë nuk e njihnin ngjalljen; mirëpo atyre iu shfaq papritur një engjëll dhe u tha: Krishti u ngjall dhe na dhuron përdëllimin e madh.⁴



TË PREMTEN E JAVËS III NË MBRËMËSORE

Thirrtoje të Mbrëmësorese së Madhe (fq. 46)
Ting. II

Herët në mëngjes, gratë miropurëse...
O Nxënëse, pse e përzieni miron...
Miropurëset arritën me nxitim...

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *Ting. Tërth. II E Kozma Monakut*
Kur shkuan me nxitim dhe arritën në varrin tënd, dhe i panë vulat e tij, por nuk e gjetën trupin tënd të pacen, gratë miropurëse vajtonin dhe thoshin: Kush na e vodhi shpresën? Kush e mori të vdekurin e lyer me miro, të zhveshurin, ngushëllimin e vetëm të nënës? Oh, si vdiq ai që i ngjalli të vdekurit? Si u varros ai që e plaçkiti Hadhin? Pra, ngjallu me pushtetin tënd pas tri ditësh, o Shpëtimtar, ashtu siç the⁹ dhe shpëtoji shpirtat tanë.

Tani *Hyllindësore Dogmatike*
Ting. II

Shkoi hija e ligjit,¹⁰ kur erdhi Hiri. Se, si-

kundër ferra nuk digjej, megjithëse nxirrite flakë,¹¹ ashtu edhe ti Virgjëreshë linde dhe Virgjëreshë mbete; në vend të kolonës prej zjarri,¹² lindi diell drejtësie;¹³ në vend të Moisiut, Krishti, shpëtimi i shpirtave tanë.*

*Pasvargje Ngjallësore**

Ejani t'i falemi atij që lindi prej Atit para jetëve, Fjalës Perëndi⁸⁸ që u mishërua prej Virgjëreshës Mari. Se, sikundër deshi vetë, pasi duroi kryq,²² u dorëzua për varrim; dhe si u ngjall së vdekurish, më shpëtoi mua, njeriun e mashtuar.

Varg: Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi. Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.

Krishti, Shpëtimtari ynë, e fshiu dorëshkrimin që ishte kundër nesh,¹⁰¹ duke e mbërthyer në Kryq, dhe shfuqizoi pushtetin e vdekjes. I falemi Ngjalljes së tij të triditshme.

Varg: Sepse i dha fuqi botës e cila nuk do të lëkundet.

Bashkë me kryeengjëjt le të himnojmë Ngjalljen e Krishtit; se ai është Çliruesi dhe Shpëtimtari i shpirtave tanë; dhe me lavdi të frikshme dhe me forcë të fuqishme do të vijë përsëri të gjykojë botën¹¹² që krijoi.

Varg: Shtëpisë sate i ka hije shenjtërimi, o Zot, për ditë të gjata.

Ngjallja jote, o Krisht Shpëtimtar, ndriti tërë botën dhe thirre prapë krijesën tënde. Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. I*

Ty që vishesh me dritën si rrobe,¹⁸ Josifi të zbriti prej drurit me Nikodhimin¹⁴ dhe, kur të pa të vdekur, të zhveshur, e të pavarrosur, të nisi një vaj të mallëngjyer dhe, duke vajtuar, po thoshte: Mjer' o Jisu fort

i ëmbël! Që kur të pa dielli pak kohë më parë të varesh në kryq, mbështillej me errësirë,¹⁹ dhe dheu valonte nga frika,²⁰ dhe kurtin' e Tempullit çahej;²¹ po ja tani shoh që durove vdekje për mua vullnetarisht. ²² Si të të varros, o Perëndia im? Apo si të të mbështjell me pëlhura? Dhe me ç'duar ta prek trupin tënd të perëndishëm? Apo ç'këngë t'i këndoj vdekjes sate, o zemërdhembshur? Madhështoj Pësimet e tua dhe përhimnoj Varrimin tënd me Ngjalljen, duke thirrur: Lavdi më Ty.*



TË SHTUNËN E JAVËS III NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të
Oktoikut
Ting. II
Ngjallësore*

Duke mos ndaluar të vulozet guri i varrit, u fale të gjithëve shkëmbin e besës, pasi u ngjalle. O Zot, lavdi më Ty.^{5*}

Megjithëse nuk e le sipër gjirin e pacen,²⁴ e denjove për të gjithë varrimin dhe ngjalljen, o Zot, lavdi më ty.

Hyjlindësore

Të gjitha përmbi mendim, të gjitha të përmbilavdishme misteret e tua, o Hyjlindëse; e vulosur me qashtërsi dhe e ruajtur me virgjëri, u njohe Nënë e vërtetë, pasi linde Perëndinë e vërtetë. Atij lutju të shpëtohen shpirtrat tanë.*

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores e Miropururëve Ting. II*

Shoqëria e nxënësve të tu bashkë me gratë miropururëse gëzohen njëzëri, se me

ta kremtojmë një të kremte të përbashkët për lavdi dhe nder të Ngjalljes sate. Me anën e tyre, o Zot njeridashës, fali popullit tënd përdëllimin e madh.* (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Miropururëve (tok me Irmoset) në 6, i shenjtit të kishës në 4 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Miropururëve. Pas Odes VI, Kontaqi i Miropururëve. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Miropururëve (2x).*

Lavdërimi Ngjallësore

Çdo frymë dhe çdo krijesë...

Le të thonë judenjtë...

Gëzohuni, popuj, dhe ngazëllohuni...

Engjëlli, o Zot, i solli Hirplotes...

Lavdi dhe Tani Ting. I

Magdalena dhe Maria tjetër shkuan në varr për të kërkuar Zotin; dhe panë një engjëll si rrufe, që rrinte ulur mbi gur, i cili u tha: "Pse e kërkonin të gjallin mes të vdekurve? U ngjall siç tha, do ta gjeni në Galile". Atij le t'i thërrasim: "O Zot që u ngjalle nga të vdekurit, lavdi më ty".

*Pasvargje të Miropururëve**

Ting. II Ote ek tu ksilu se

Vdiqe, dhe nga kryqi i tërëshenjt', arimathiani të zbriti, o Shpëtimtar Jisu Krisht, me aroma dhe me myshk, dhe një savan të ri, të mbështolli¹⁴ dhe të vajtoi, dhe deshte ta puthte, trupin tënd të hyjshëm, me mallëngjim të madh, por ish i tronditur nga tmerri, dhe po të thërriste me frikë: Nder edhe lavdi më Ty, o Zoti Krisht.

Varg: O Zot, e pëlqeve dheun tënd dhe e ktheve robërinë e Jakovit.

Vdije, edhe zbritë në një varr, pasi u zbërtheve prej kryqit, o Shpëtimtar Jisu Krisht,¹⁴ ferri i demonëve, u drodh me vrer dhe me tmerr, se u shqye çdo port' e lloz,³⁵ dhe varret u hapën,²⁰ u ngjallën edhe dolën mbi dhé të vdekurit, edhe i gëzuar Adami, duke përhimnuar thërriste: Nder edhe lavdi më Ty, o Zoti Krisht.

Varg: Mëshira dhe e vërteta u takuan, drejtësia dhe paqja u puthën fort.

Vdije, edhe engjëjt, o Krisht, panë me çudi dhe me frikë, që u dënove pa faj, dridheshin dhe çirreshin, kur të mbulonin me gur dhe kur vulën ta vun' ata që të kryqëzuan, që me shtizën, pa shpirt, ta shpuan brinjën mbi kryq,²⁸ edhe për shpëtimin e botës, të gëzuar thoshin me besë: Nder edhe lavdi më Ty, o Zoti Krisht.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Josifi kërkoi trupin e Jisuit dhe e vendosi te varri i tij i ri,¹⁴ se duhej të dilte si prej nusëroreje. Lavdi më Ty, që dërmovë pushtetin e vdekjes dhe u çele njerëzve dyert e Parajsës.¹⁵

CITIME

**Matth. 28.1-11; Mark 16.1-10;
Lluk. 23.56-24.10; Joan 20.1-18**

1. Is. 7.14
2. Lluk. 1.26-38
3. Jez. 44.1-2
4. Num. 14.19 etj.
5. Matth. 27.62-66
6. Kol. 1.18; Apok. 1.5
7. Num. 14.19 etj.
8. Joan 6.33; 17.2; I Joan 5.11
9. Matth. 20.19; Mark. 9.31; 10.34; Lluk. 18.33
10. Hebr. 10.1
11. Eks. 3.2-5; Vep. 7.30
12. Eks. 13.21-22; Num. 14.14; Neh. 9.12,19
13. Mal. 4.2(3.20)
14. Matth. 27.57-60; Mark 15.42-47; Lluk. 23.50-54; Joan 19.38-42
15. Gjen. 3.24
16. Gjen. 3.16-19

17. Luk. 1.28
18. Ps. 103(104).2
19. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
20. Matth. 27.51-52
21. Matth. 27.51; Mark 15.38; Lluk. 23.45
22. Joan 10.15,17-
23. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
24. Joan 1.18
25. Ps. 43(44).27
26. Gjen. 2.15
27. Eks. 15.1-2
28. Joan 19.34
29. Matth. 27.34
30. I Mbret. [Sam.] 1.5
31. Joan 15.1
32. Matth. 27.16-26; Mark 15.7-14; Lluk. 23.18-23; Joan 18.38-40
33. Matth. 27.52-53
34. Is. 53.7; Joan 1.29,36; Vep. 8.32; I Petr. 1.19; Apok. 5.6,12; 13.8
35. Ps. 106(107).16; Is. 45.2
36. Is. 11.1; Rom. 15.12; Apok. 5.5; 22.16
37. Gjen. 2.7 etj.
38. Kënga 3.7
39. Kënga 1.8; 5.9,17(6.1)
40. Abak. 3.1-3
41. Lluk. 1.78
42. Ps. 134(135). 6
43. Is. 14.9
44. Joan 16.33
45. Is. 26.9
46. Hebr. 7.2
47. Gjen. 3.27
48. Gjen. 3.7
49. Gjen. 3.1-6
50. Lluk. 10.33
51. I Kor. 15.56
52. Gjen. 3.1-5,13-15; II Kor. 11.3; Apok. 12.9,14-15; 20.2
53. Osia 13.14; I Kor. 15.55
54. I Petr. 3.19; 4.6
55. Jona 1.11,15; 2.4,6
56. Jona 2.11
57. Matth. 26.61; 27.40; Mark 14.58; 15.29; Joan 2.19
58. Joan 3.1-2
59. Joan 6.27; 10.28; 17.2
60. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 1,27-28
61. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 4
62. I Tim. 2.4
63. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
64. Joan 12.32
65. Lluk. 23.39-44
66. Ps. 88(89).8
67. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
68. Dan. 3.23
69. Matth. 21.19; Mark. 11.13-14,20
70. Mark 3.1-5

71. Matth. 14.19-21; 16.9-10; Mark. 6.41-44; 8.19-21; Lluk. 9.13-17; Joan 6.11-13
72. Matth. 11.5; Lluk. 7.22
73. Matth. 14.25
74. Joan 11.38-44
75. Lluk. 7.12-15
76. Matth. 8.6-13; 9.2-7; Mark. 2.3-12; Lluk. 5.18-25
77. Is. 6.3
78. Joan 6.35,48
79. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
80. Eks. 31.18; 32.15-16
81. Matth. 26.67; 27.30; Mark 10.34; 14.65; 15.19; Lluk. 18.32
82. Matth. 26.67; Mark 14.65; Joan 18.22; 19.3
83. Matth. 27.34,48; Mark. 15.36; Lluk. 23.36; Joan 19.29-30
84. Joan 6.54,58
85. Is. 9.2; Matth. 4.16
86. I Kor. 5.7
- 86a. Joan 15.14-15
87. Hebr. 1.3
88. Joan 1.1
89. Lluk. 15.11-25
90. Ps. 146(147).8
91. Jis. N. 7.11; I Mbret. [Sam.] 14.33; II Kron. 6.39
92. Lluk. 18.10-14
93. Lluk. 7.37-48
94. Ne. 13.22
95. Fil. 1.29
96. Ps. 118(119).109; Urt. Sol. 3.1
97. Ps. 115.6 (116.15)
98. Ps. 146(147).7
99. Jez. 1.1-26
100. Gjen. 2.6
101. Kol. 2.14
102. Lluk. 13.6-7
103. Matth. 3.10; 7.19; Lluk. 3.9; 13.6-7
104. Ps. 140(141).3
105. Is. 57.15
106. I Kor. 3.16; 6.19
107. Matth. 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 4.23
108. Kënga 1.3
109. Mark 16.19
110. Joan 11.25
111. Matth. 14.31
112. II Tim. 4.1; I Petr. 4.5
113. Ps. 67(68).13
114. Ps. 73(74).12
115. Joan 11.52
116. Matth. 28.16-19
117. Lluk. 16.9
118. II Kor. 8.9
119. Gal. 5.1
120. Joan 4.42; I Joan 4.14
121. II Kor. 12.4
122. Vep. 5.15
123. II Tim. 4.7
124. II Petr. 1.4
125. II Tim. 2.5
126. I Tim. 6.16
127. I Petr. 2.21
128. Matth. 27.55; Mark. 15.41
129. II Kor. 4.17
130. Ps. 110(111).3
131. Matth. 27.22-23; Mark 15.13-14; Lluk. 23.21; Joan 19.6,15
132. Matth. 23.37; Lluk. 11.47-49; Vep. 7.52
133. Matth. 26.63; Mark 14.61
134. Joan 3.17; 12.47
135. Ligji i Dytë 21.23; Gal. 3.13
136. Gjen. 2.9; 3.22,24; Is. 65.22; Apok. 2.7; 22.2,14,19
137. Hebr. 2.14





E DIELA E TË PARALIZUARIT

TË SHTUNËN
NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*4 Thirrtores Ngjallësore
Ting. II*

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht...
U ndriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde...
Lavdëroj fuqinë e Atit e të Birit...
Kryqit tënd të çmuar i falemi...

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Jisui u ngjit në Jerusalem, në Pellgun...
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 76*)

Tani *Hyjlindësore Dogmatike
Ting. III*

Çudi tepër e madhe: Ajo që lindi është e virgjër dhe fëmija është Perëndi para jetëve! Lindja e qartë dhe episodi mbi natyrë. O mister i frikshëm! Dhe kur mendohet mbetet i pashprehshëm dhe kur hetohet nuk kuptohet. Je e lumtur ti, o Vajzë pa cen, bija e Adamit të dhelindur, e cila u shfaqe nënë e Perëndisë së Tërë-

lartë; përgjeroju që t'i shpëtojë shpirtrat tanë.

*Pasvargje Ting. III
Ngjallësor*

O Krisht, që errësove diellin me pësimin tënd dhe ngazëllove gjithësinë me dritën e Ngjalljes sate, prit himnin tonë mbrëmësor, o Njeridashës.*

Të Hyjlindësës Megali tu stavrú su

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Fituam mirëbërje mjaft të madhe, e pacen, me anën tënde, ndaj e lëdojmë tok me engjëjt Birin Zot që lindi nga mitra jote prej mirësisë së skajshme dhembshëm dhe e rigatoi fisin njerëzor.

Varg: Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

E virgjër, e dëlirë, gjithë ne të kemi ty si strehë hyjnore, mbrojtje, ne mëkatarët me shumë faje gjatë jetës, ndaj dhemb-

shurisë sate i lypim fort nga shpirti: Mos na rri larg, por përdëllena¹ edhe shpëtona.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

“Gëzohu”-n me hyjnorin gjeneral shën Gabriel, e Virgjër përgjithnjë, nënë, të ofrojmë² denjësisht ne shërbyesit e tu prej balte, se je shkaktarja e gëzimit, u bëre, o Hyjlindëse, hare për botën.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Në portikun e Solomonit dergjej një...

(Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 77)



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Thirrto

10 Thirrto: 7 Ngjallësore dhe 2 të të Paralizuarit në 3

Ngjallësoret Ting. III

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht...

U ndriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde...

Lavdëroj fuqinë e Atit e të Birit...

Kryqit tënd të çmuar i falemi...

Himnojmë Shpëtimtarin që u mishërua...

Krishti zbriti dhe u ungjillëzoi...

Ne të pavyerit që qëndrojmë...

Idhiomele të të Paralizuarit

Ting. I

O Krisht i dhembshur, ti që e gatove njeriun me dorën tënde³ të pacenshme, erdhe për të shëruar të sëmurët; me fjalën tënde, ngrite paralitikun në Pellgun e Dhenve, shërove dhimbjen e gjakrrjedhësës,⁴ mëshirove vajzën e Kanaeases, që vuante⁵ dhe nuk e shpërfillte kërkesën e Centurionit,⁶ prandaj thërra-

sim: O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty.

(2x)

Duke qenë si një i vdekur i pavarrosur paralitiku, kur të pa, thirri: O Zot, mëshiromë se krevati m'u bë varr. Çfarë po përfitoj nga jeta? Nuk më duhet Pellgu i Dhenve, sepse nuk kam njeri që më futë brenda kur të trazohen ujërat; por po vij pranë teje, burimit të shërimeve, që të thërras edhe unë bashkë me të gjithë: “O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty”.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Jisui u ngjit në Jerusalem, në Pellgun e Dhenve, i cili, sipas judenjve, quhej Bethesda dhe kishte pesë portikë, sepse në to dergjej një shumicë të sëmurësh, meqë shkonte herë pas here një engjëll i Perëndisë dhe e trazonte dhe u dhuronte shëndet atyre që vinin me besë; dhe, pasi pa një njeri që ishte atje prej kohësh, Zoti i tha: “A do që të shërohesh?”. I sëmuri iu përgjigj: “O Zot, s'kam njeri që të më futë në pellg kur të trazohet uji. E harxhova tërë pasjen time në mjekë dhe nuk u denjësova për mëshirën”. Por mjeku i shpirtrave dhe i trupave i tha: “Ngrije shtratin tënd dhe ec duke e shpallur në anët e botës fuqinë time dhe përdëllimin e madh.”⁷

Tani *Hyjlindësore Dogmatike*

Ting. III

Si të mos admirojmë lindjen tënde hyjnjerëzore, o e Gjithënderuar? Se, pa njohur burrë, o e Gjithëkulluar, linde Bir pa Atë trupërisht atë që lindi prej Atit para jetëve pa nënë, i cili s'pësoi fare ndryshim, as përzierje, as ndarje, por ruajti të plotë cilësinë e secilës natyrë. Prandaj, o Zonjë, Nënë Virgjëreshë, atij lutju që të shpëtohen shpirtrat e atyre që me besim të drejtë të njohin si Hyjlindëse.*

Në Liti Idhiomeli i shenjtit të kishës

Lavdi *Ting. Tërth. I*

Poezi e Kumulait

Në Pellgun e Dhenve dergjej një njeri i sëmure dhe, kur të pa, o Zot, thirri: “S’kam ndonjë njeri që të më futë në ujë kur të trazohet; dhe, kur shkoj unë, dikush tjetër arrin para meje dhe shërohet, ndërsa unë dergjem i sëmure”. Dhe, sakaq, Shpëtimtari e dhembshuroi dhe i tha: “Për ty u bëra njeri, për ty mora trup dhe ti thua «S’kam njeri»? Ngrije shtratin tënd dhe ec”. Ti mund t’i bësh të gjitha, të gjitha të binden, të gjitha të nënshtrohen; na kujto të gjithë dhe na mëshiro, o i shenjtë, si njeridashës.

Tani *Hyjlindësor Ngjallësor I njëjti*

Tempull dhe derë⁸ je, pallat dhe fron i Mbretit, o Virgjëreshë e Gjithënderuar, me anën e së cilës Çliruesi im, Zoti Krisht, ndriti mbi ata që flinin në errësirë,⁹ duke qenë diell drejtësie¹⁰ dhe duke dashur të ndriçojë ata që gatoi me dorën e tij³ sipas ikonës së vet.¹¹ Prandaj, o e Gjithëhimnuar, duke pasur përpara tij guxim nënë, ndërmjeto pa pushim që të shpëtohen shpirtrat tanë.*

Pasvarg Ngjallësor

Ting. III

O Krisht, që errësive diellin me pësimin tënd¹² dhe ngazëllove gjithësinë me dritën e Ngjalljes sate, prit himnin tonë mbrëmësor, o Njeridashës.*

Dhe ato të Pashkës (fq. 7)

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Në portikun e Solomonit dergjej një shumicë të sëmuresh; dhe, në mes të së

kremtes, Krishti gjeti një paralitik që dergjej për tridhjetë e tetë vjet dhe i thotë me zë zotëror: “Do që të shërohesh?”. I sëmuri iu përgjigj: “O Zot, s’kam njeri që të më futë në pellg kur të trazohet uji”. Por ai i thotë: “Ngrije shtratin tënd, shiko u bëre mirë, mos mëkato më!”. Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Zot, na dërgo përdëllimin e madh.

Tani *i Pashkës (fq. 7)*

Ditë e ngjalljes...

Përlëshore Ngjallësore Ting. III

Le të dëfrenjë qielloret, le të ngazëllohen të dëshmet,¹³ se rrëfeu fuqi me krahun e tij,¹⁴ Zoti shkeli vdekjen me vdekje; u bë i parëlindur i të vdekurve,¹⁵ prej barkut të Hadhit neve na çliroi, dhe i fali botës përdëllimin e madh.^{7*}

Hyjlindësore Ngjallësore

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjinisë sonë, të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se, duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje, Biri yt dhe Perëndia ynë na çliroi prej prishjes si Njeridashës.*



NË MËNGJESORE

[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kanunin Triadik).]

Pas Stihologjisë së parë,

*Ndenjësose Ngjallësore**

Ting. III

Krishti u ngjall së vdekurish, si i pari i të fjeturve,¹⁶ i parëlinduri i krijesës¹⁷ dhe Krijues i gjithë gjërave,¹⁸ përtëriti në veten e tij natyrën e prishur të gjinisë sonë. Nuk sundon më, o vdekje, se Zoti i të gjithave¹⁹

e dërrmoi pushtetin tënd.

Lavdi

Si shijove vdekjen trupërisht, o Zot, pushove hidhërimin e vdekjes²⁰ me Ngjalljen tënde, dhe e forcove njeriun kundër saj, duke shpallur disfatën e mallkimit të vjetër.²¹ O Zot, mbrojtës i jetës sonë,²² lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore Tin oreótita*

Për bukurinë e virgjërisë sate e për shkëlqimin e qashtësisë sate, Gabrieli u çudit, o Hyjlindëse, dhe të thërriste: Çfarë lëvdate të të sjell të vyershme? Dhe si të të quaj, nuk e di e po shtangem. Prandaj të thërres si u urdhërova: Gëzo-hu, o Hirplote.²

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. III Tin oreótita

Çdo gjë të njerëzve* e prite me vullnet,* i more tonat mbar’*²³ dhe deshe mirësisht* të nguleshe në Kryq dhe preferove lirshëm të vdisje,*²⁴ Bërësi im, si njeri,* që njer’zinë, si Perëndi,* ta çliroje prej vdekjes,* ndaj dhe ne të thërrasim ty* porsì Zot jetëdhënës, i mirë:* Lavd dhembshurisë sate, o Krisht.

Lavdi

Nuk e kuptojmë dot* çudin’ e Kryqit tënd,* nuk e shpjegojmë dot* Ngjalljen e ndritëshme,* dhe i soditim besërisht* misteret e habitëshme.* Vdekja u përmbys përdhe* edhe Hadhi sot u plaçkit,* gjinia njerëzore pra,* me paprishjen tani u vesh.*²⁵ Të gjithë pra thërresim me zë të madh:* Nder dhe lavdi më ty, o Zoti Krisht.*

Tani *Hyjlindësore*

Me mall gëzoheshin* gjith’ engjëlloret lart,* me tmerr çuditëshin* dhe të mbi-

dheshmet tok* kur ty, Hyjlindëse, të erdhi zëri pa cen, se shndriti* për të dy një panair,* se të parëgatuarin* e çliroi, e Dëlir’,* pra nga vdekja helm,²¹ ndaj dhe ne* me engjëllin ty po të thërrasim:* O Virgjëreshë-nënë, ki gaz.²

I Paqortueshmi (Psalmi 118), Bekimto etj.

Kanunet: I Pashkës (tok me Irmoset) në 4, i Hyjlindësës në 2 dhe i të Paralizuarit në 8.

Ode I

Kanuni i Hyjlindësës

Tingulli dhe Irmoset e njëjta

Ke shkaktuar pështjellim në kushte vdekjeje ti,* Zonjë, meqë në bark kishe Krishtin, të përhershmen jet’,*²⁶ që na lindi sot nga varri dhe shndriti fort,* e Virgjër pa cen aspak,* botën tonë, planetin mbar’.

E pe Perëndinë, Birin tënd të ngjallur, prandaj* gëzohu me apostujt, o e hyjhirshme e dëlir’;* ti e para prite pra “Gëzohu”-n sepse,* Hyjlindëse pa qortim,* i shkaktove hare botës.

Kanuni i të Paralizuarit që ka Akrostihidhë në Ode IX: “Josif”.

Poezi e Josifit të Selanikut.

Ting III Thavmastós endhoksos

[*Irmosi*: »Ti je Perëndia që bën mrekulli »me lavd, i çuditshmi që në dhe e ktheve »avushën dhe karrocat* i mbulove; shpë- »tove kombin që të këndonte si çlirim- »tar.²⁷]

O i vetmi mbret, edhe pse bërë mrekulli të çuditshme, Kryqin e durove vullnetarisht,²⁴ e vrave* vdekjen ti, si i dhembshur, përmes vdekjes dhe na ringjalle, o Krisht.

Popuj, sot, në ngritjen e Krishtit, le të kërcejmë me besë, Hadhi u plaçkit dhe i dorëzoi me ankth,* shpejt të drejtët që kish në pranga, që mburnnin madhësh-tit' e Perëndis'.

Me fuqin' hyjnore dikur dhe me fjalën tënde, paralitikun që prej kohësh, Krisht, e shërove, i the* që ta ngrinte krevatin; ma shëro shpirtin se po vuan mjaft keq.

Atëher' në Pellgun e Dhenve, një engjëll, herë pas here, zbriste dhe shëronte krejt vetëm një, kurse tash* Zoti Krisht i pas-tron shumicat pa fund përmes hyjnorit pagëzim.²⁸

Kryegjeneral i shërbyesve lart, të mble-dhurit brenda kishës sate t'shenjtë që përhimojnë Zotin,* mbroji fort nga lloj-lloj rreziqesh, ruaji, kryetar i engjëjve.

Lavdi *Triadik*

Të himnojmë pa pushim, bashkë me engjëjt, Një Perëndi pa mish, trup, Një natyrë në tre Persona, Zotin,* Atin, Fjalën dhe Shpirtin; kanë Një forcë, mbretëri që s'ndahet kurr'.

Tani *Hyjlindësor*

Ky qyteti yt të nderon, e Dëlrir', me besë gjithnjë, ndaj ruaje nga lufta civile, nga rreziqet,* thika si dhe pushtimi nga bar-barët, nga lloj-lloj kërcënimesh pra.

Zbritësore: Anastáseos imera

Ditë e Ngjalljes.

Ode III

I Hyjlindësës

Kthehem sot te jeta e pacen,* Zonjë, me mirësi nga ai që linde ti* dhe shndriti gaz me shkëlqim* në skajet e botës, dha shpëtim* dhe hir, e Dëlrirë fort.

Ti, o e Dëlrirë, të kërcesh,* se e mbajte në bark Zotin me mish dhe e pe* të ngja-llur prej varrit ti* sikurse kish thën',²⁹ o e pacen,* si Zot madhështojë pra.

I të Paralizuarit

Stira psihi qe ágone

*[Irmosi: »***O** *shpirt pa pjellori, shpirt »shterp,*⁸ fryt të lavdishëm fito,* dhe me »dëfrim, gaz, thirri fort:* U sigurova, Pe- »rëndi, me ty,* veç teje s'ka shenjtor,* as »nuk ka të drejtë aspak, o Zoti im.³⁰]*

Dielli, kur të pa ty, Zot,* Fjalë, të varur mbi dru* dikur, e fshehu dritën pra*¹² dhe toka tundej mbarë,³¹ por kur ti,* i tërëfor-ti Krisht,* Zot, po jepje frym', ngjalleshin të vdekurit.³²

Hadhi i dha me mjaft nxitim* shpirtat që kishte kur ti,* i vetmi Zot, arrite pra,* me shpirt në bark, në fund të tij;³³ ata* pushtetit tënd, o Krisht,* i thërrisnin ode falënderuese.

Si të paralizuarin* më par', shëroje, o Zot* i përmbimirë, shpirtin tim* të dobësuar keq për shumë vjet* të ecë në një udh'* që ia shfaqe çdokujt që ka mjaft mall për ty.

O kryeengjëll zotëror,* bashkë me rendet lart, bëj* një përgjërëm për ne që po* të përhimojmë besërisht, na mbro,* na ruaj, se ne ram'* në pasionet, dertet e jetës mizorisht.

Lavdi *Triadik*

«Lavd Atit, Birit, Shpirtit Shenjt* le të thërrasim meqë* Një Perëndi Zot është ai,* sipas natyrës, dhe Fuqitë mbar'* në qiell e lëvdojnë* duke thënë fort dhe me frikë "Shenjt, Shenjt, Shenjt".³⁴

Tani *Hyjlindësor*

Kishe një lindje përmbi mend* pas zënies pa farë, Vajz'* pa cen, e virgjra nënë, Zonj':* Çudi e madhe, vepër tërë tmerr!* E lavdërojmë ne* vdekatarët dhe e nderojnë engjëjt lart.

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni të pimë.

Ndenjësores Ting. III Tin oreótita

Siç tha kozmikja Fjal'* Zot, vetëm me një fjal',* paralitiku yn'* fitoi plot shëndet,* se Krishti përmbi dhë u shfaq nga një dhembshuri mbi çdo mend;* ndaj njeriu ecte drejt* duke mbajtur krevatin fort,* edhe pse s'duronin dot* të shikonin çfarë u bë* pra Shkruesit, të kapur nga smira* paralizuese, e keqe.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore E ngjashme*

Për bukurinë e virgjërisë sate e për shkëlqimin e qashtërsisë sate, Gabrieli u çudit, o Hyjlindëse, dhe të thërriste: Çfarë lëvdate të të sjell të vyershme? Dhe si të të quaj, nuk e di e po shtangem. Prandaj të thërres si u urdhërova: Gëzohu, o Hirplote.^{2*}

Ode IV

I Hyjlindëses

O e Dëllirë, ai që gatoi Adamin,³ stëratit tënd, u gatua prej teje dhe, me vdekjen e vet, e shpërbëri sot vdekjen e shkaktuar nga ai²¹ dhe i ndriçoi të gjithë fuqishëm me llamburitjet hyjnore të ngjalljes.

O e Dëllirë, e bukur, e hijshme dhe e paqortueshme mes grave,³⁵ duke parë Krish-tin që linde, që shndrinte tepër bukur nga të vdekurit për shpëtimin e të gjithëve, e lavdëroje me gëzim bashkë me apostujt.

I të Paralizuarit

To katásqion oros

[Irmosi: »Abakumi e parashikonte malin »e tërëhijesuar, pra mitrën tënde të pa-cen, o e Dëllirë, prandaj dhe thërriste: »Perëndia do të vijë nga Themani dhe i »Shenjtë nga mali i dendur, i tërëhijesu-ar.^{36]}

Meqë tretej nga xhelozia, bashkësia e hebrenjve të kryqëzoi në dru, o Zot,³⁷ por ti, pasi e shpërbëre dënimin e vdekjes,²¹ u ngrite si i fortë dhe e ngrite botën bashkë me veten tënde.

Ai që rrinte ulur i veshur me të bardha, u tha miropurësese: Pse e kërkonin me miro miron që nuk zbrazet?³⁸ U ngrit dhe e mbushi kozmosin me aromë mendore.³⁹

O Fjalë, duke pasur pamje shërbëtori⁴⁰ për shkak të dhembshurisë së skajshme, erdhe dhe e tregove të shëndetshëm atë që dergjej për shumë vjet dhe e urdhëro-rove ta ngrinte shtratin.

Një engjëll i Zotit zbriste herë pas here, trazonte ujin në Pellgun e Deleve dhe shëronte vetëm një, ndërsa Krishti shpë-ton shumica të panumërta me anë të pagëzimit hyjnor.⁴¹

O kryegjeneral i Zotit, kryetar i engjëj-ve dhe udhëzues i të humburve, eja në këtë orë mes nesh dhe dërgoja lutjet e të gjithëve Zotit,⁴² të vetmit Bërës.

Lavdi *Triadik*

Trinia e Shenjtë bashkohet në natyrë, por ndahet në Persona: Ati mbiesencial, Biri i bashkëpërjetshëm dhe Shpirti i Shenjtë, i vetmi i tërëfuqishëm.

Tani *Hyjlindësor*

»O e Dëllirë, si jep gji? Dhe, si linde një foshnjë më të lashtë se Adami? Si e mban

në prehër Birin që është mbi supe ke-
ruvike?”⁴³ - “Ashtu siç di ai që bëri çdo
gjë”.

Zbritësore: Epi tis thias filakis

Le të qëndrojë me ne.

Ode V

I Hyjlindëses

Mbledhja e shpresëplotëve ndriçohet
me rrezet hyjnore dhe jetëprurëse të
ngjalljes së Birit tënd dhe mbushet me
ngazëllim, o Hyjnënë e pacenshme.

O mbret i Krijesës, kur u mishërove, nuk
i hape portat e Virgjëreshës, nuk i prishe
vulat e varrit, ndaj u gëzua kur të pa të
ngjallur.

I të Paralizuarit

Foti to anespero

*[Irmosi: »Me dritën tënde të paperë-
»ndueshme, o Krisht, shkëlqej shpirtin
»tim të përulur dhe më udhëzo në frikën
»tënde, sepse urdhrat e tu janë dritë.^{44]}*

U lartësive mbi drurin e Kryqit dhe
e lartësive bashkë me veten botën e
tërë dhe, pasi erdhe ndër të vdekurit ti,
Perëndia, i ngrite të vdekurit që prej jete.

Krishti u ngjall ashtu siç tha²⁹ pasi i
zbrazti gjithë mbretëritë e Hadhit dhe
iu shfaq apostujve⁴⁵ duke iu dhënë një
ngazëllim të përjetshëm.

Grave iu shfaq një engjëll i shkëlqyer
i veshur me të bardha dhe u tha: Mos
qani! Jeta juaj u ngrit³⁹ pasi i ngjalli të
vdekurit në varre.

Siç e ngrite paralitikun, o Krisht, shëroje
shpirtin tim të paralizuar për shkak të
shkeljeve dhe bëj që, me mirësi, të eci
në udhët e tua të drejta.

O Mikael, kryetar i engjëjve, shpëtoje
popullin që është mbledhur sot në kishën
tënde dhe po shpall madhështitë e Pe-
rëndisë.

Lavdi Triadik

Ati, Biri dhe Shpirti Hyjnor është Njësi e
njënderuar, treshe që ndahet besërisht
përmes hipostazave, por bashkohet në
natyrë.

Tani Hyjlindësor

O e Dëlrë, himnojmë shtatzëninë tënde
të pafarë dhe lindjen e pakuptueshme,
duke të lumëruar si nënë të Zotit dhe
Bërësit të të gjithave.

Zbritësore: Orthrísomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

Ode VI

I Hyjlindëses

Ai që u kap lashtë prej vdekjes dhe pri-
shjes, u lirua me anë të atij që u mishërua
prej barkut tënd të pacen dhe u udhëzua
për te jeta e paprishshme dhe e amshuar,
o Perëndilindëse e virgjër.

Ai që zbriti dhe banoi në mitrën tënde,
dhe u mishërua përmbi mend, zbriti në
më të poshtmet e tokës,⁴⁶ o e Dëlrë, dhe,
kur u ngjall prej varrit, e ngriti Adamin me
veten e tij.

I të Paralizuarit

Vithós mi ton pathón

[Irmosi: »U ngrit fort ndaj meje avusha
»e vesit, më trazon er’ e kundërt,* por ti
»arri, më shpëto,* o Shpëtimtar, nga pri-
»shja; shpëtom’* ashtu si nga egërsira
»profetin.^{47]}*

U lartësive vullnetarisht në dru,²⁴ u
vendose, si i vdekur, në varr dhe, pasi i

gjallërove tok të gjithë të vdekurit në Hadh, i ngrite me pushtet hyjnor, o Krisht.

O i dhembshur, sapo të takoi poshtë, Hadhi u hidhërua⁴⁸ dhe i lëshoi me nxitim të prangosurit që e himnonin me zëra të pareshtur ngjalljen tënde të frikshme, o Shpëtimtar.

Kur e panë Krishtin, jetën²⁶ e të gjithëve, të ngritur nga varri, Nxënësit hyjnorë iu falën⁴⁹ me mallëngjim të madh, mendje të drejtë dhe eufori shpirti.

O Krisht, kur rimëkëmbet me urdhrin tënd ai që dergjej në shtratin e dhimbjes për shumë vjet, të lavdëron duke himnuar dhembshurinë tënde, o jetëdhënës.

Megjithëse rri bri fronit të Zotit, o Mikael, kryetar i engjëjve, eja mes nesh dhe udhëzoni për në rrugën e jetës ne që të kemi si mbrojtës të flaktë.

Lavdi *Triadik*

Bashkë me Fuqitë e frikshme lart, të adhuroj si Trini në Persona, të shpall si Njësi në esencë, o Atë pa nisje, Bir dhe Shpirti i drejtë, Perëndia i të gjithave.

Tani *Hyjlindësor*

Ai që i mban të gjitha me një shenjë, mbahet në prehrin tënd, o Perëndilindëse e virgjër, dhe na rrëmben të gjithë nga dora e skllavërisë së dinakut, si i dhembshur.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

Kontaqi

Ting. III I parthenos símeron

Shpirtin tim paralitik* mjaft rënd' nga veprat e pavend* dhe nga lloj-lloj fajesh, Zot,* ti ngrije me ardhjen tënde* krejt

të shenjt',* si atëherë paralitikun,* që kështu* të të thërras unë i shpëtuar:* Perëndi i dhembshur shumë,* lavdi pushtetit tënd edhe Hirit tënd, Krisht.

Shtëpia

U shfaqe me trup,⁵⁰ o Jisu, Perëndi që je i bashkëpafillim me Atin, dhe që sundon mbi të gjitha tok me Shpirtin e Shenjtë, dhe që i mban në dorë anët e kozmosit;⁵¹ dhe i shërove sëmundjet, i largove pësimet, i ndriçove të verbrit dhe me fjalën hyjnore e ngrite paralitikun sapo e urdhërove të ecte përsosmërisht duke e ngritur mbi supe krevatin që e mbante atë; prandaj, së bashku me të, të përhimnojmë dhe thërrasim: lavdi pushtetit edhe Hirit tënd, Krisht.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Dielën e katërt pas Pashkës, kujtojmë të Paralizuarin dhe, natyrisht, e kremtojmë këtë mrekulli.

Vargje: Fjala e Krishtit e forcoi të lëshuarin,/ kjo pra, një fjalë e vetme, ishte shërim.

Me përdëllimin tënd të pafund, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Ode VII

I Hyjlindëses

Biri yt, pasi e vrau vdekjen, o e Tërë-paqortueshme, u dhuroi sot të gjithë vdekatarëve jetë të qëndrueshme në jetë të jetëve⁵² ai, i vetmi Perëndia i etërve i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

Ai që mbretëron mbi çdo krijesë, kur u bë njeri, banoi në mitrën tënde, o e Hyj-hirshme; dhe, kur duroi Kryq dhe vdekje, u ngjall siç duhej hyjnisht dhe na ngriti tok me veten e tij, si i tërëfuqishëm.

*I të Paralizuarit**O tin floga dhrosisas*

[*Irmosi*: »**T**i që e freskove flakën e ka-
»minës dhe i shpëtove nga djegia Djem-
»të, je i bekuar në jetë, o Zot, Perëndia i
»etërve tanë.^{53]}

Sapo të pa të tendosur në dru, dielli
e mbloodhi dritën¹² sepse nuk mund të
shndriste botën teksa ti, o Tërëmbret, po
perëndojë vullnetarisht²⁴ për shkëlqimin
e mbarë kombeve.

U ngjalle duke i boshatisur varret dhe
e plaçkite Hadhin me pushtet të gjithë-
fuqishëm, prandaj e himnojmë ngritjen
tënde të nderuar hyjnore, o Krisht.

Me pamje të ndritshme, engjëlli hyjnor
u thërriste dikur miropurësive: Pse e
kërkoni të gjallin si të vdekur? U ngrit,
s'është në varr.³⁹

Pasi e shërove me fjalë të paralizuarin,
të dergjurin për shumë vjet, thërrisje:
Ngrije shtratin tënd dhe ec duke himnu-
ar madhësitë e Perëndisë.

O Mikael, kryegjeneral i Zotit, udhëzoji
dhe, me ndërmjetimin tënd, ruaji nga çdo
e keqe ata që mbledhen besërisht në
tempullin tënd të hyjnueshëm për him-
ninin e Perëndisë.

Lavdi *Triadik*

O Trini, shpëtoji nga çdo rrezik dhe bëji
pjesëmarrës në të mirat e tua ata që të
himnojnë besërisht si Perëndi dhe Zot të
të gjithave.

Tani *Hyjlindësor*

Je e virgjër megjithëse e linde mbi mend
të lindurin pa rrjedhje para gjithë jetëve
prej Atit të pafillim, ndaj të lumërojmë, o
e Dëlirë.

*Zbritësore: O Pedhas ek kaminu***Ai** që shpëtoi djemtë.*Ode VIII**I Hyjlindësës*

Bërësi erdhi në botë nëpërmjet teje, o
Perëndilindëse virgjëreshë, dhe, pasi e
çau barkun e Hadhit, na dhuroi ngjalljen
neve vdekatarëve, ndaj e bekojmë në
jetë.

O Virgjëreshë, kur e rrëzoi absolutisht
pushtetin e vdekjes me anë të ngjalljes
së tij Biri yt, si Perëndi i fortë, na bash-
këlartësoi dhe na hyjnizoi, ndaj e për-
himnojmë në jetë.

*I të Paralizuarit**Ton ip' agjelon asijitos*

[*Irmosi*: »**P**erëdinë që lavdërohet pa
»pushim në më të lartat prej engjëjve,³⁴
»o qiej të qiejve,⁵⁴ tokë, male, kodra, fundi
»i detit dhe çdo fis njerëzor, bekojeni me
»himne si Ndërtues dhe Çlirimtar.]

Kur u kryqëzove, o Shpëtimtari ynë, per-
dja u gris⁵⁵ dhe vdekja i dha të vdekurit
që kishte gëlltitur, ndërsa Hadhi u zhvesh
kur të pa që arrite në më të poshtmet e
tokës.

Ku është thumbi yt, o vdekje? Ku është
fitorja jote, o Hadh?⁴⁸ U vrave dhe u shfa-
rose prej Mbretit të ngjallur, dhe nuk
mbretëron më, sepse i Fuqishmi t'i mori
të prangosurit.

Iriu që u shfaq, u thoshte miropurësive:
Shkoni shpejt, lajmërojeni apostujve ngja-
lljen; u ngjall Zoti³⁹ dhe bashkë me të
çuditërisht të vdekurit që nga jeta.

Paralitiku i shtrirë që prej shumë vjetësh,
thërriste: «O Çlirimtar, mëshiromë mua
që s'kam rrugëdalje». Dhe ai e urdhëroi ta

ngrinte shpejt shtratin dhe të ecte drejt.

Meqenëse je hegjemon i Forcave të palëndëta, o kryegjeneral kërko tok me ta për ne çlirimin e shkeljeve, korrigjimin e jetës dhe shijimin e të mirave të atjeshme të përjetshme.

Lavdi *Triadik*

Le të himnojmë njëzëri Një Hyjni të pakrijuar, Një esencë të pandashme, trehipostate, Atin, Perëndi të panisshëm, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, duke thirrur melodinë e frikshme të Serafimeve.³⁴

Tani *Hyjlindësor*

O gjithnjëvirgjëreshë, Isaia të pa qëmoti si një volum⁵⁶ ku u shkrua me gishtin e Atit⁵⁷ Fjala e pamotshme dhe na shpëtoi prej çdo marrëzie ne që të përhimnojmë me fjalë të hyjnueshme.

Zbritësore: Afti i kliti ke ajia

Himnojmë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

Kjo është ditë e zgjedhur.

Ode IX

I Hyjlindësës

Tok ne, gjith' besnikët, të lumërojmë, Virgjëresh',* ki gaz, porta e Zotit;*⁸ ki gaz ti, qytet frymor;* ki gaz, përmes teje na feksi sot* drita e Krishtit që ti na linde,* drita e ngjalljes prej varreve.

O derë hyjnore⁸ e Dritës,⁵⁸ ki gaz dhe dëfre;* perëndoi në varr, por* lindi Krishti; shndriti fort,* më hijesisht dhe se dielli lart,* Zonjë e hyjhirshme, dhe i feksi* besnikët mbarë, Jisui Zot.

I të Paralizuarit

En Sineo to ori

[*Irmosi*]: »**M**oisui në malin Sina të pa* »në një ferrë, se në bark* zure, pa u

»shkrumbuar hiç, zjarrin tmerr*⁵⁹ të Hyj- »nisë, ndërsa mal* pa latim Danieli* »të pa,⁶⁰ Isaia shenjt* shkop pra të thirri »ty* që do mbije prej rrënjës së Davidit »shenjtor.⁶¹]

Kur u ngrite mbi dru, Jisu, edhe ne* tok na ngrite; dhe në varr* kur të vunë vullnetshëm,²⁴ i ngjalle ti* krejt të vdekurit në varr* dhe ata e himnonin* forcën tënde mbi çdo mend* si dhe pushtetin tënd* që nuk mposhtet kurrë, o njeridashës dhe Zot.

Mjaft i bukur nga varri ke lindur ti,* mjaft i bukur, Fjalë, si* dhëndër nga nusërrorja,⁶² e zhduke pra* zymtësin' e Hadhit, Zot,* të burgosurit, o Krisht,* lart i nxore dhe ata* bashkë thërrisnin fort:* Lavd fuqisë sate, lavd ngjalljes sate, Jisu.

Gratë erdhën në varrin e tërëshenjt'* me nxitim dhe sollën lot,* psherëtima dhe miro, por, besërisht,* morën vesh për ngjalljen⁶³ pra* tërë lavd; edhe ne tok* me një përkushtim në shpirt* dhe gaz në zemrën ton'* e kremtojmë duke dëfryer mjaft thellësisht.

Krisht, shërimi trupor i pasonte drejt* urdhërimit tënd, kështu* nisi paralitiku të ecte shpejt* duke sjellë përmbi sup* shtratin ku ishte dergjur* që prej shumë vjetësh, Zot,* dhe ky që qe sëmur',* po e përhimnonte pushtetin tënd aq të madh.

Lyp ndriçim për ne, o Kryegjeneral* mjaft i madh, se rri gjithnjë* pranë Dritës së madhe⁶⁴ dhe jetën ton'* paqësoje, se gjithnjë* keq trazohet nga gjarpri,*⁶⁵ sulmet e tij, ngasje plot* edhe peripeci,* o i admirueshëm, famëmadh dhe i lum.

Lavdi *Triadik*

Të lëvdoj ty si dritë⁶⁴ dhe drita tok,* jet'

dhe jetë plot me bes',* Atë, Fjalë edhe Shpirt Hyjnor, Njësi,* je trehipostate ti,* Një pushtet që nuk ndahet,* Një Hyjni pa ngatërrim,* edhe me Forcat lart* po thërras: I Shenjtë, i Shenjt', i Shenjtë je, Zot.³⁴

Tani *Hyjlindësor*

E pacen, Krishti, dielli mjaft i madh,* doli pra nga barku yt* dritëprurës dhe botën e shndriti nur* me shkëlqime hijesisht;* errësirën e shkëljes*⁶⁶ larg e flaku, ndaj, si shkak,* Hyjnuse, për çdo gjë* të dobishme edhe të mirë ty të himnojm'.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Virgjëreshë e qashtë dhe prapë të them gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

I shenjtë është Zoti... (3x)

Dërgimësore

E Pashkës Ting. II Sarki ipnosas

Si fjete si njeri me trup,* o Mbreti ynë Zoti Krisht,* u ngjalle të tretën ditë,* dhe ngrite gjyshin shën Adam,* dhe e dërmonte vdekjen krejt.* Pashkë¹⁵ burim i jetës, shpëtim i besnikëve.*

E të Paralizuarit: Jineqes akutisthite

Jisui, njeridashësi* i tërëdhembshur, shkoi bri* Pellgut të Dhenve, porsi Zot,* se donte që t'i shëronte* tërë sëmundjet; gjeti pra* një që dergjej për shumë vjet* edhe i thirri: Ngrije shpejt* ti shtratin, çohu edhe ec* në udhë shumë të drejtë.

Lavdërime Ngjallësore Ting. III

Ejani, gjithë kombet...

I rrefyen gjithë çuditë e tua...

Të gjitha u mbushën me gëzim...

Në dritën tënde, o Zot...

Gratë miropurëse blatuan...

Një engjëll që vetëtinte...

Erdhi në varr e të kërkoi...

Hebrenjtë e mbyllën jetën në varr...

Lavdi *Ting. Tërth V*

O Zot, paralitikon nuk e shëroi pellgu, por e ripërtëriti fjala jote; dhe as nuk e pengoi sëmundja kronike, sepse energjia e zërit tënd u shfaq më e fortë; dhe ai hodhi poshtë barrën e padurueshme dhe mbajti ngarkesën e shtratit, si dëshmi të shumicës së dhembshurive të tua;⁶⁷ lavdi më ty!

Tani

E përmbibekuar je...

Në Liturgji, [Tipiket dhe Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e të Paralizuarit. Ose] Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshorja Ngjallësore dhe e shenjtë të kishës. Kontakti i Pashkës. Në vend të Të meriton, O shpirt madhështojë... Ndriçohu, ndriçohu... Kungatore Lavdërojeni...



NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. Tërth. V O tu paradhoksu thávmatos

O çudi paradoksale! Bërësi i gjërave mbar'* me vullnetin e tij u zbraz,* si i dhembshur mori trup* dhe i varfër u bë si ne;*⁶⁸ u shoqërua me njerëz, mrekulli* bollshëm u shfaq i hebrenjve, ndaj kështu,* atë që ish më par'* i paralizuar, e shëroi kur* i tha "Ngrije shtratin tënd", kur qe në Bethesdhá.

Duke dashur që t'i ngrije njerëzit e rënë, o Zot,* ecje mbi dhe si një njeri* dhe sëmundjet e çdokujt* i shëroje,⁶⁹ se dhembshuri* shumë të madhe ke, Krisht, ndaj shkove bri* Rezervuarit të Dhenve, në portik,* o Perëndia im,* dhe me fjalën tënde një paralitik* u shëndosh sado qe shtrir' tridhjet e tetë vjet.

Treteshin judenjt' nga smira, mirëbërjet e tua shkak* për mani, zjarr i bënin, Zot,* kundër teje, i mbimir';* sado shkelnin gjithnjë çdo ligj,* ty, të vërtetën jet', dëshironin mjaft* të vrisnin, o Krisht, të shtunën pa ngurrim,* kur e tregove ti* të shëruar plotësisht atë që ish* më përpara i sëmur', paralitik mjerisht.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*
Poezi e Kumulait

Në Pellgun e Dhenve dergjej një njeri i sëmurë dhe, kur të pa, o Zot, thirri: "S'kam ndonjë njeri që të më futë në ujë kur të trazohet; dhe, kur shkoj unë, dikush tjetër arrin para meje dhe shërohet, ndërsa unë dergjem i sëmurë". Dhe, sakaq, Shpëtimtari e dhembshuroi dhe i tha: "Për ty u bëra njeri, për ty mora trup dhe ti thua «S'kam njeri»? Ngrije shtratin tënd dhe ec". Ti mund t'i bësh të gjitha, të gjitha të binden, të gjitha të nënshtrohen; na kujto të gjithë dhe na mëshiro, o i shenjtë, si njeridashës.

Pasvargje të Oktoikut Ting. III *Ngjallësor*

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht Shpëtimtar, u shpërbë pushteti i vdekjes dhe mashtrimi i djallit u shfuqizua. Dhe gjinia e njerëzve që shpëtohet me besë, himne përditë të blaton.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Himn mbrëmësor të ofrojmë, o Krisht, me temjan dhe ode shpirtërore;⁷⁰ mëshiroji, o Shpëtimtar, shpirtat tanë.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

E madhe është fuqia e martirëve të tu, o Krisht, sepse sado të shtrirë në varre, ata dëbojnë frymë, pasi e asgjësuan pushtetin e armikut me anën e besimit te Trinia, meqë garuan për shpresëtarinë.

Lavdi dhe Tani Ting. I

O Krisht i dhembshur, ti që e gatove njeriun me dorën tënde³ të pacenshme, erdhe për të shëruar të sëmurët; me fjalën tënde, ngrite paralitikun në Pellgun e Dhenve, shërove dhimbjen e gjakrrjedhës,⁴ mëshirove vajzën e Kananeases, që vuate⁵ dhe nuk e shpërfille kërkesën e Centurionit,⁶ prandaj thërrasim: O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Përlëshorja Ngjallësore (Le të dëfrejnë qielloret...) dhe *Hyjlindësorja* (Ty që ndërmjetëve për shpëtimin...).



TË HËNËN E JAVËS IV NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores të Oktoikut*

*Ting. III
Ngjallësore*

Krishti u ngjall së vdekurish, si i pari i të fjeturve;¹⁶ i parëlinduri i krijesës¹⁷ dhe Krijues i gjithë gjërave,¹⁸ përtëriti në veten e tij natyrën e prishur të gjinisë sonë. Nuk sundon më, o vdekje, se Zoti i të gjithave¹⁹ e dërrmoi pushtetin tënd.*

Kataniktike

O shpirt, duke ndenjur për njëfarë kohe në tokë, pendohu; dheu në varr²¹ nuk himnon, nuk çlirohet nga shkeljet; thirri Krishtit Perëndi: O zemërnjohës,⁷¹ mëkatova; para se të më dënosh, mëshiromë.

Martirike

Trimëria e rezistencës suaj fitoi mbi marifetet e armikut të keq që nga fillimi, o athloforë të tërëfamshëm, prandaj u vlerësuar për lumturinë e përfjetshme; ndërmjetoni pranë Krishtit që ta shpëtojë grigjën e popullit krishtdashës, meqë jeni dëshmitarë të së vërtetës.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore Tin oreótita

Për bukurinë e virgjërisë sate e për shkëlqimin e qashtërsisë sate, Gabrieli u çudit, o Hyjlindëse, dhe të thërriste: Çfarë lëvdate të të sjell të vyershme? Dhe si të të quaj, nuk e di e po shtangem. Prandaj të thërres si u urdhërova: Gëzohu, o Hirplote.^{2*}

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores e të Paralizuarit

Ting. III Tin oreótita

Sa qenë trupërisht* paralit' për shkak*

të xhelozisë vrer* që sjell sëmundje plot,* u prishën kur e panë të shërohej paralitiku* një të shtunë dhe të than':* "Nuk lejohet shërim aspak* pra të shtunën, se prishet* atërori pushim në të;* s'të njohën Zot të Ligjit, shërues,* as mjek për shpirtrat tanë, o Krisht (2x).

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kananet: I të Paralizuarit (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e të Paralizuarit. Pas Odes VI, Kontaqi i të Paralizuarit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e të Paralizuarit (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

*Ting. III
Ngjallësor*

Ejani, gjithë kombet, njihni fuqinë e misterit të frikshëm, se Krishti, Shpëtimtari ynë, Fjala e kryes,⁷² u kryqëzua për ne dhe, duke dashur,⁷⁴ u varros, dhe u ngjall së vdekurish, që t'i shpëtojë të gjitha; atij le t'i falemi.* (2x)

Kataniktik

Shumë herë, duke himnuar, gjendesha duke mëkatuar, sepse thosha këngë me gjuhë, teksa mendoja të pavenda në shpirt; por ti, o Krisht Perëndi, korrigjoji të dyja me anë të pendimit dhe mëshiromë.

Martirik

O popuj, ejani të gjithë ta nderojmë kujtimin e athloforëve të shenjtë, se, pasi u bënë teatër për engjëj dhe njerëz,⁷³ morën prej Krishtit kurorën e fitores dhe ndërmjetojnë për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. I

Duke qenë si një i vdekur i pavarrosur, paralitiku, kur të pa, thirri: O Zot, më-

shiromë se krevati m'u bë varr. Çfarë po përfitoj nga jeta? Nuk më duhet Pellgu i Dhenve, sepse nuk kam njeri që më futë brenda kur të trazohen ujërat; por po vij pranë teje, burimit të shërimeve, që të thërras edhe unë bashkë me të gjithë: "O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty".

*Pasvargje
të të Paralizuarit*

Ting. III Megali ton martiron su

Sa ishin të paralizuar tmerr nga smira, Krisht,* të fortët në të keqe e shihnin forcën që kishin* mrekullit' e tua, por s'besonin se je* Bir Perëndie, Zoti* i botës që me fjal' e hoqe paralizën.

Varg: Mëshirat e tua, o Zot, do t'i këndoju në jetë.

Sa ruanin të shtunën, pan' paralitikun keq,* i cili u shërua të shtunën dhe sëmureshin* shpirtërisht; thërrisnin, gjoja si të Ligjshëm,* si Shkruar: Nuk lejohet* që të shërosh të shtunën, ta përdhosësh frikshëm.

Varg: Sepse the: Mëshira do të ndërtohet në jetë.

Stë njihnin si Zot, Bërës të të shtunave,* sa ruanin të shtunat, ndaj murmurisnin se në të* e shërove ti paralitikun, thoshin:* Nuk është mirë fare* ta ngrinte shtratin pra të shtunën i sëmuri.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*

Jisui u ngjiti në Jerusalem, në Pellgun e Dhenve, i cili, sipas judenjve, quhej Bethsedhá dhe kishte pesë portikë, sepse në to dergjej një shumicë të sëmuresh, meqë shkonte herë pas here një engjëll i Perëndisë dhe e trazonte dhe u dhuronte shëndet atyre që vinin me besë; dhe, pasi pa një njeri që ishte atje prej kohësh, Zoti

i tha: "A do që të shërohesh?". I sëmuri iu përgjigj: "O Zot, s'kam njeri që të më futë në pellg kur të trazohet uji. E harxhova tërë pasjen time në mjekë dhe nuk u denjësova për mëshirën". Por mjeku i shpirtrave dhe i trupave i tha: "Ngrije shtratin tënd dhe ec duke e shpallur në anët e botës fuqinë time dhe përdëllimin e madh.⁷

Përlëshorja Ngjallësore (Le të dëfrejnë qielloret...) dhe *Hyjllindësorja* (Ty që ndërmjetëve për shpëtimin...).



TË HËNËN E JAVËS IV NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje Idhiomele të të Paralizuarit
Ting. I*

O Krisht i dhembshur, ti që e gatove njeriun me dorën tënde³ të pacenshme, erdhe për të shëruar të sëmurët; me fjalën tënde, ngrite paralitikun në Pellgun e Dhenve, shërove dhimbjen e gjakrrjedhësës,⁴ mëshirove vajzën e Kananeases, që vuante⁵ dhe nuk e shpërfille kërkesën e Centurionit,⁶ prandaj thërrasim: O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty. (2x)

Duke qenë si një i vdekur i pavarrosur, paralitiku, kur të pa, thirri: O Zot, mëshirromë se krevati m'u bë varr. Çfarë po përfitoj nga jeta? Nuk më duhet Pellgu i Dhenve, sepse nuk kam njeri që më futë brenda kur të trazohen ujërat; por po vij pranë teje, burimit të shërimeve, që të thërras edhe unë bashkë me të gjithë: "O Zot i tërëfuqishëm, lavdi më ty".

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. I*

Jisui u ngjit në Jerusalem, në Pellgun e Dhenve, i cili, sipas judenjve, quhej Bethesdhá dhe kishte pesë portikë, sepse në to dergjej një shumicë të sëmurësh, meqë shkonte herë pas here një engjëll i Perëndisë dhe e trazonte dhe u dhuronte shëndet atyre që vinin me besë; dhe, pasi pa një njeri që ishte atje prej kohësh, Zoti i tha: “A do që të shërohesh?”. I sëmuri iu përgjigj: “O Zot, s’kam njeri që të më futë në pellg kur të trazohet uji. E harxhova tërë pasjen time në mjekë dhe nuk u denjësova për mëshirën”. Por mjeku i shpirtrave dhe i trupave i tha: “Ngrije shtratin tënd dhe ec duke e shpallur në anët e botës fuqinë time dhe përdëllimin e madh.”⁷

*Pasvargje të Oktoikut
Ting. III
Ngjallësor*

Undriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde, o Zot. Parajsa u hap përsëri;⁷⁴ dhe tërë krijesa, duke të lavdëruar, himne përditë të blaton.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Shpëtomë, o Zot, Perëndia im, se ti je shpëtimi i të gjithëve; shtrëngata e pasioneve më trazon dhe pesha e paudhësive të mia më fundos; më jep një dorë ndihmë dhe më lartëso⁷⁵ drejt drite kataniksi, si i vetmi i dhembshur dhe njeri-dashës.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, se-

pse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

E madhe është fuqia e martirëve të tu, o Krisht, sepse sado të shtrirë në varre, ata dëbojnë frymë, pasi e asgjësuan pushtetin e armikut me anën e besimit të Trinia, meqë garuan për shpresëtarinë.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Në portikun e Solomonit dergjej një shumicë të sëmurësh; dhe, në mes të së kremtes, Krishti gjeti një paralitik që dergjej për tridhjetë e tetë vjet dhe i thotë me zë zotëror: “Do që të shërohesh?”. I sëmuri iu përgjigj: “O Zot, s’kam njeri që të më futë në pellg kur të trazohet uji”. Por ai i thotë: “Ngrije shtratin tënd, shiko, u bëre mirë, mos mëkato më!”. Me ndërmjetimet e Perëndilindëses, o Zot, na dërgo përdëllimin e madh.

Përlëshorja Ngjallësore (Le të dëfrenjë qielloret...) *dhe Hyjlindësorja* (Ty që ndërmjetëve për shpëtimin...).



TË MARTËN E JAVËS IV NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të Oktoikut

Ting. III Ngjallësore

Si shijove vdekjen trupërisht, o Zot, pushove hidhërimin e vdekjes me Ngjalljen tënde, dhe e forcove njeriun kundër saj, duke shpallur disfatën e mallkimit të vjetër. O Zot, mbrojtës i jetës sonë, lavdi më ty.*

Kataniktike

Deri kur, o shpirti im, do të insistosh në shkelje? Deri kur do të bësh shtyrje pendimi? Mendoje gjykimin e ardhshëm dhe thirri Zotit: Mëkatova, o Zot i pamëkatshëm, mëshiromë.

Martirike

Shkëlqeni nëpërmjet besës, o shenjtore, ndriçues tepër të ndritshëm, mjekë me devocion hyjnor, athloforë të tërëfamshëm; sepse, përderisa nuk u frikësuar nga torturat e tiranëve, e rrëzuar diskreditimin e idhujve, ngaqë kishit si trofe të pamposhtur kryqin e së vërtetës.

Hyjlindësore

O Perëndilindëse, përikja dhe fuqia jonë, ndihma e fortë e botës, me anën e ndërmjetimeve të tua shpëtoji shërbëtorët e tu nga çdo nevojë, o e vetmja e bekuar.

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore e të Paralizuarit
Ting. III Tin oreótia*

Sa qenë trupërisht* paralit' për shkak* të xhelozisë vrer* që sjell sëmundje plot,* u prishën kur e panë të shërohej paralitiku* një të shtunë dhe të than':* "Nuk lejohet shërim aspak* pra të shtunën, se prishet* atërori pushim në të;* s'të njohën Zot të Ligjit, shërues,* as mjek për shpirtrat tanë, o Krisht. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I të Paralizuarit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e të Paralizuarit. Pas Odes VI, Kontaqi i të Paralizuarit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e të Paralizuarit (2x).*

*Lavdërime të Oktoikut**Ting. III**Ngjallësor*

I rrëfyn gjithë çuditë e tua ruajtësit e tu, o Zot, po këshilli i kotësisë, si mbushi me dhurata të djethtë e tyre, pandehte se fshihte Ngjalljen tënde⁷⁶ që e lavdëron bota; mëshirona.* (2x)

Kataniktik

Mblidhe, o Zot, mendjen time të shpërndarë dhe pastroje zemrën time djerre; më jep pendim si i dhe Petros,⁷⁷ psherëtimë si i dhe Doganierit⁷⁸ dhe lot si i dhe Lavires,⁷⁹ që me zë të lartë të të thërras: O Perëndi, shpëtomë, si i vetmi i dhembshur dhe njeridashës.

Martirik

Ushtarët e Krishtit⁸⁰ e zmbrapsën frikën e mbretërve dhe të tiranëve; dhe me guxim e burrëri e pohuan atë, Zotin e të gjithave,⁸¹ Perëndinë dhe mbretin⁸² tonë dhe ndërmjetojnë për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth V

O Zot, paralitikon nuk e shëroi pellgu, por e ripërtëriti fjala jote; dhe as nuk e pengoi sëmundja kronike, sepse energjia e zërit tënd u shfaq më e fortë; dhe ai hodhi poshtë barrën e padurueshme dhe mbajti ngarkesën e shtratit, si dëshmi të shumicës së dhembshurive të tua;⁶⁷ lavdi më ty!

*Pasvargje të të Paralizuarit
Ting. III Megali ton martiron su*

Pra fjala jote, Fjala ime jetëbërëse,* u shfaq si forcë, jet', në gjymtyr' paralitike tmerr* dhe dëshmi qe ngritja befas e krevatit* ku dergjej prej shum' kohësh* njeriu dhe e mbajti fort me urdhrin tënd, Zot.

Varg: Mëshirat e tua, o Zot, do t'i këndoj në jetë.

Me gaz, paralitiku e zbatonte urdhrin tënd,* të forcës sate krejt të pushtetshme, zotërore, Krisht;* ecte duke mbajtur shtratin dhe thërriste,* dëshmonte, duke thënë:* Kështu më urdhëron të bëj shëruesi im.

Varg: Sepse the: Mëshira do të ndërtohet në jetë.

I dergjuri për mjaft vjet, i paralizuari* në trup mjerisht, nuk ka rrugëdalje, po shtrëngohet keq,* ndaj thërret: "O Çlirimtari Krisht, mëshiro më".* Shpëtuesi i jep forc',* ia përforcon gjymtyrët, i thot' ta ngrej' shtratin.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*
Poezi e Kumulait

Në Pellgun e Dhenve dergjej një njeri i sëmurë dhe, kur të pa, o Zot, thirri: "S'kam ndonjë njeri që të më futë në ujë kur të trazohet; dhe, kur shkoj unë, dikush tjetër arrin para meje dhe shërohet, ndërsa unë dergjem i sëmurë". Dhe, sakaq, Shpëtimtari e dhembshuroi dhe i tha: "Për ty u bëra njeri, për ty mora trup dhe ti thua «S'kam njeri»? Ngrije shtratin tënd dhe ec". Ti mund t'i bësh të gjitha, të gjitha të binden, të gjitha të nënshtrohen; na kujto të gjithë dhe na mëshiro, o i shenjtë, si njeridashës.

Përlëshorja Ngjallësore (Le të dëfrejnë qielloret...) dhe *Hyjlindësorja* (Ty që ndërmjetëve për shpëtimin...).

(Mbyllet e kremtja e të Paralizuarit.)

TË MËRKURËN E MESPENTIKOSTISË TË MARTËN NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV Kírie anelthón en to stavró

Nddodhemi* tash në mes të ditëve* që fillojn' prej shpëtimtares ngjallje dhe kan' si fund* e vulë Pentikostinë* e hyjshme; dita feks me drit' prej dy palëve,* i bashkon drejt dy festat tok,* parashfaq se do vijë* lavdi i Analipsit të Zotit Krisht* dhe krenohet mjaft,* dhe shkëlqen një gaz të madh kudo. (2x)

Mori vesh* dhe dëfren Sioni mjaft;*⁸³ u ungjillëzua ngjallja e Zotit ton' në të;* bijt' e saj besimtarë* gëzonin kur e shikonin Krishtin që në Shpirt* vrasjen e vet të censhme krejt* po e lante,⁸⁴ ndaj ka gaz* dhe në mes të dy festave po kërcen,* bën një panair,* hijesohet bukur, ka lavdi.(2x)

Po afron,* siç u shkrua, derdhja boll* e Hyjnorit Shpirt përmbi të gjithë,⁸⁵ e shpall këtë* dhe mesi tashmë i kohës* pas vdekjes edhe varrimit si dhe ngjalljes tok,* pas premtimit autentik* që u dha Krishti, Zoti,* mbarë Nxënësve edhe kështu shfaqet* ardhja midis nesh* e Ngushëllimtarit Perëndi.⁸⁶ (2x)

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

O Krisht, tani që jemi në mes të së kremtes së ngjalljes sate dhe të ardhjes së Shpirtit tënd të Shenjtë, pasi u mblodhëm, i përhimnojmë misteret e çudivë të tua; na dërgo në të përdëllimin tënd të madh.⁷

Hyrja. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet



Këndimi i profecisë së Mikeas*

(4.2-3,5; 6.1-4,8; 5.3)

Këto thotë Zoti: “Nga Sioni do të dalë një ligj dhe fjalë Zoti nga Jerusalemi dhe do të gjykojë në mes të popujve të shumtë dhe do të kritikojë kombe të forta deri në tokën e largët”, sepse të gjitha kombet do të ecin secili në udhën e tij, ndërsa ne do të ecim në emrin e Zotit, Perëndisë tonë, në jetë. Këto thotë Zoti i tërëfuqishëm: “Dëgjoni, o male dhe lugina të thella, themele të tokës, se do të bëhet gjykimi nga Zoti për popullin e tij”; sepse do të dialogojë me Izraelin duke thënë: “O populli im, ç’të kam bërë a me çfarë të kam mërzhitur? Përgjigjmu! Sepse të nxora nga Egjipti dhe të çlirova prej shtëpie skllavërie dhe e dërgova para fytyrës sate Moisiun dhe Aaronin”. O populli im, çfarë deshën ndaj teje kundërshtarët? Nëse t’u njoftua ty, o njeri, çfarë është e mirë? Dhe çfarë po kërkon Zoti prej teje, përveçse të bësh gjykimin dhe ta duash mëshirën dhe të jesh gati të ecësh bashkë me Zotin, Perëndinë tënd? Sepse Zoti do të madhësohet me fuqi dhe do ta kullojë grigjën e tij me paqe, deri në skajet e dheut.

* Rikujtojmë atë që kemi theksuar tek Udhëzimet, në fillim të Mujorit I dhe që e përsërisim në fillim të çdo volumni: “Në Leximet biblike të Dhiatës së Vjetër i mbajmë qëllimisht, me vetëdije gabimet letrare që ajo ka, sepse respektojmë prototipin, përkthimin e «të Shtatëdhjetëve», të bërë nga hebrenjtë”. Kështu ka vepruar dhe përkthyesi i mëparshëm. P.sh., Psalmi 140 që psalim çdo ditë në Mbrëmësore, ka shumë anomali. Ja një e tillë: “Do të dëgjojnë thëniet e mia, se janë të ëmbla; si një brazdë që çahet në tokë, le të shpërndahen eshtrat e tyre pranë hadhit”.

Këndimi i profecisë së Isaia

(12.3; 55.1-13. Përzgjedhje)

Këto thotë Zoti: “Ju që po eteni, ecni mbi ujë; dhe sa s’keni argjend, si të ecni, blini, dhe hani, dhe pini pa argjend e pa çmim verë dhe të majmë; se këto ju thotë Zoti i Tërëfuqishëm: “O populli im, nxirrni ujë me ngazëllim prej burimeve të shpëtimit. Dhe do të thuash në atë ditë: «Himnojeni Zotin, thirreni emrin e tij, lajmëroni ndër kombet lavdinë e tij, kini në mend se u lartësua emri i tij». O populli im, dëgjomëni mua dhe do të hani gjëra të mira, dhe do të shijojë në gjëra të mira shpirti juaj. Vini veshin dhe ejani pas udhëve të mia. Dëgjomëni dhe do të rrojë në të mira shpirti juaj. Dhe do t’ju vendos dhiatë të përjetshme”. Kërkoni Zotin. Kur t’ju afrohet, ta braktisë i pabesi udhët e tij dhe burri i paligj, mendimet e tij, dhe le të kthehet drejt Zotit, dhe do të mëshirohet, se do t’i lërë me shumicë mëkatet tuaja. “Se nuk janë mendimet e mia si mendimet tuaja, as udhët e mia si udhët tuaja”, thotë Zoti. “Po sa larg është qielli prej dheut, aq larg është udha ime nga udhët tuaja dhe mendimet tuaja nga mendimi im. Se sikundër do të zbrësë shiu a dëbora prej qiellit dhe nuk do të kthehet derisa ta dehë dhenë dhe do të lindë, dhe do të mbijë, dhe do t’i japë farë atij që mbjell, dhe bukë për të ngrënë; ashtu do të jetë fjalla ime që do të dalë prej gojës sime, nuk do të kthehet derisa të kryhen sa desha dhe derisa t’i përmbush me sukses udhët e mia dhe porositë e mia. Se me ngazëllim do të dilni dhe me hare do të mësoni. Se malet dhe bregoret do të kërcejnë duke ju pritur me gaz dhe gjithë drutë e arës do të trokasin me degët. Dhe në vend të dushkut do të ngjitet qiparis dhe

në vend të shkozës do të ngjitet mersini, dhe do të jetë Zoti në emër dhe në shenjë të përjetshme dhe nuk do të shterohet.”

Këndimi i Fjalëve të Urta

(9.1-11)

Urtësia ndërtoi për vete shtëpi dhe mbështeti shtatë shtylla. Theri viktimat e saj dhe përzejë në kanë verën e saj dhe përgatiti tryezën e saj. Dërgoi shërbëtorët e saj duke ftuar me shpallje të lartë mbi kanë, duke thënë ajo: Ai që është i metë, le të kthehet tek unë. Dhe atyre që ishin të varfër nga mendja, u tha: Ejani, hani bukën time dhe pini verën që ju kam përzier. Braktisni idiotësinë dhe do të rroni; dhe kërkoni urtësinë që të jetoni dhe që të arrini mençurinë me dije. Ai që edukon të këqij do të marrë për vete nderim dhe, duke kritikuar të pabesin, do të qortojë veten e tij. Sepse kritikati për të pabesin janë plagë për atë. Mos kritiko të këqij, që të mos të të urrejnë; kritiko të urtin dhe do të të dojë. Jepi të urtit një shkak dhe do të jetë më i urtë; bëj të ditur tek i drejti dhe do të shtojë të pranojë. Fillim urtësie është frika e Zotit dhe mendim shenjtoreësh është mençuria. Ndërsa dija e ligjit i përket mendjes së mirë, sepse në këtë mënyrë do të jetosh shumë kohë dhe do të të shtohen vite jete.

Pasvargje Idhiomele

Ting. I I Joan Monakut

Arriti mesi i ditëve të Pentikostisë. Në të, pasi e zbuloi disi fuqinë hyjnore, Krishti e shëroi një paralitik dhe e ngriti me fjalë nga krevati; dhe, duke bërë çudi, siç i përshkatej Hyjnisë, në një trup balte⁸⁷ u dhuroi njerëzve jetën e amshuar⁵² dhe përdëllimin e madh.⁷

I njëjti

Varg: Kujtoje sinagogën tënde, cilën e fitove që nga fillimi.

Ti, urtësia e Perëndisë,⁸⁸ shkove në Hierore në mes të së kremtes dhe i mësoje dhe i kritikoje judenjtë e pabindur, Fari-senjtë dhe shkruesit, u thërrisnin atyre publikisht: “Ai që ka etje, le të vijë tek unë dhe le të pijë ujë të gjallë, dhe nuk do të ketë etje në jetë. Atij që beson në mirësinë time, do t'i rrjedhin prej barkut lumenj të jetës së përjetshme”.⁸⁹ O sa simpati dhe dhembshuri që ke, Krisht, Perëndia ynë! Lavdi më ty.

Ting. II

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Kur arriti mesi i së kremtes, Jisui u ngjit në Hierore dhe i mësonte judenjtë e pabindur duke thënë: “Atij që beson tek unë, do t'i rrjedhin lumenj prej barkut dhe do të ketë dritën e jetës”.⁹⁰

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Judenjtë thoshin kur i mësoje në mes të së kremtes: “Si i di shkronjat pa mësuar ai?”, se nuk e dinin që ti je urtësia^{90a} që bëri botën;¹⁸ lavdi më ty.

Përlëshore Ting. Tërth. IV

Në mes të së kremtes, vadite me rrjedhat e shpresëtarisë shpirtin tim të etur, sepse u thirrë të gjithëve, o Shpëtimtar: “Ai që ka etje, le të vijë tek unë dhe të pijë”. O burim i jetës, Krisht Perëndi, lavdi më ty. (3x)



NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. IV Tahi prokatálave

O njohës i zemrave⁷¹ dhe i mendimeve mbar',* kur mes Hierores rrije, të vërtetën u thoshe ti gënjeshtarëve:* "Pse doni të më kapni* mua që jap çdo jetë?".* Dhe, publikisht, thërrisje mes së kremtes: "Mos bëni* gjykim sipërfaqësor ju, o të paligjshëm shumë". (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Duke ndenjuri mes Tempullit, sundimtari, Zot* i tërë botës,¹⁹ mes festës, Pentikostisë së shenjt',* me guxim të madh u flet hebrenjve, me fuqi.* Si mbret dhe Zot, e kritikoni* arrogancën tiranike që kanë, por krejt neve* na dhuron përdëllim të madh⁷, se ka dhembshuri të madhe shumë ai. (2x)

Ne që pamë ngjalljen. *Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari (tok me Irmoset) në 8 dhe i dyti në 6.*

Ode I

Kanuni i parë që ka Akrostihidhë:

"Do ta himnoj mesin e të kremteve të mëdha". Poezi e Theofanit.

Ting. IV

Irmosi: Thalasis to erithreon

»Formonte* me duar Moisiu kryq, kësh-
»tu dhe populli,* i vjetri Izrael, me këmbë
»pra* të palagura Detin e Kuq*²⁷ e shke-
»li, prishi dhe fuqin' e Amalikut nëpër
»shkretëtir'.⁹¹

Na shndritin* prej mishërimit tënd hyj-
nor mbi mend dhurata, hir* dhe mirëbër-
je të mëdha, o Zot,* dhe shkëlqejnë hyj-
noret, o Krisht,* të cilat na burojnë dhe

nga mirësia jote vijn' te ne.

Mjaft dukshëm* qëndrove mes së krem-
tes duke rrezatuar, Krisht,* shkëlqimet e
Hyjnisë, se ti je* festa mjaft ngazëlluese,
Zot,* për sa shpëtojnë, edhe shkaku i
shpëtimit tonë, o Jisu.

U bërë* për ne, nga Perëndia, drejtësi,
urti, çlirim;*⁹² prej tokës ne na çon në
lartësi* qiellore edhe na dhuron* Hyjno-
rin Shpirt, o Zoti ynë mirëbërës, përdëll-
es Krisht.

Hyllindësor

S'pësoi* prishje aspak në varr, Zot, trupi
yt, por, siç u bë* pa mbjellje, nuk pësoi
prishje hiç,* ndaj mbi mend, mbi esencë
ai* s'u skllavërua pas natyrës, Zoti ynë,
Shpëtimtari Krisht.

Tjetri. Poezi e Andreas së Kretës

Thálasan épikasas

[Irmosi: »Detin e pikse dhe fundose
»karroca lufte, Faraonin mjaft fodull,*
»Zot, dhe e shpëtove pa u lagur popu-
»llin*²⁷ dhe, në mal të shenjtërimit tënd
»e fute,⁹³ kur thërriste: Ode* triumfale do
»këndojmë ne* për ty, Perëndinë tonë,²⁷
»krejt të fortin në çdo luft'.]

Duartrokisni, kombe; qani, hebrenj, se
Krishti, jetëdhënësi, në Hadh* theu pran-
ga, ngjalli dhe të vdekurit, me fjal'* i
shëroi të sëmurët; ky është' Zoti, Perëndia
ynë,* që u jep jet' të amshuar lart*⁵² atyre
që kanë plot besim në emrin e tij pra.

Bërë çudi: E ktheve ujin në verë, o Zot,⁹⁴
siç i ktheve në Egjipt* mbar' lumenjt' në
gjak,⁹⁵ i ngjalle ti të vdekurit* edhe kjo
qe si një mrekulli e dytë, Shpëtimtari
ynë;* lavd vullnetit tënd që s'shprehet
dot,* lavdi zbrasjes sate⁴⁰ me të cilën na
ripërtërit.

O Shpëtimtari im, je rrjedhja pa fund e jetës së vërtetë, ngjallja jon';*²⁶ me vullnet u lodhe, kishe etje me vullnet,* ndaj u binde ti te ligjet natyrore dhe, pasi arrite* me trup në Sihar, kërkove, Zot,* të pije ti ujë nga Samaritania, Fjalë Krisht.⁹⁶

Shumëfishove peshqit, ngope shumicë popujsh dhe bekove bukët, Zot*⁹⁷ që s'kuptohesh; dhe të eturve u dhe prem-tim* për burim pa fund⁹⁸ urtie; ti je Perëndia ynë, o Krisht,* dhe atyre që në emrin tënd* e kanë besimin, Shpëtimtar, u jep jet'⁹⁹ dhe plot hir.

Lavdi *Triadik*

Tri genie të bashkëpanisshme, të bashkëfronshme po mburr, Atin Perëndi* pa fillim dhe Birin tok pa nisje, Shpirtin Shenjt* të përjetshëm tok me Birin, Një esenc' t'hipostate dhe çmoj* Një hegje-moní mbi çdo epror,* lëvdohet Një Hyjni, Zot, në esencë pa fillim, me himn.

Tani *Hyjlindësor*

Vetëm ti, o Hyjnënë, mbajte në bark krijesin tënd, pa shpjegim, me trup,* mbe-te virgjëresh' sado e kishe ti në bark,* nuk t'u prish hiç virgjëria; ndaj, për grigjën tënde, përgjëroju* pa pushim, si Perëndisë tënd* dhe si Birit tënd, o e dëlirë, lutju përgjithnjë.

Zbritësore: Thálasan épikas

Detin e pikse dhe fundose karroca.

Ode III

Irmosi: Efrénete epí si

»Dëfrehet në ty,¹⁰⁰ o Krisht,* dhe të thë-»rret pra Kisha jote me gaz:* Streha, për-»forcimi im* dhe fuqia ime je ti, o »Zot.¹⁰¹

Zot, hape për kishën ti* burime rrjedhjesh jetëbërëse, Krisht,* o i mirë, dhe thërret:*

Eja çdo i etur të pish me zell.⁸⁹

Do ngriheshe, thoshe qart',* nga toka lart në qiell dhe nga atje* Shenjtin Shpirt premtove se* do t'na e dërgoje, Krisht,⁸⁶ dukshëm mjaft.

Besnikëve krejt u dha* dhurim, papri-shjen Zoti, porsi i mir',* jetëbërës në natyr',* që kish lindur prej virgjëreshës Zonj'.

Tjetri: Estereothi i kardhia mu

[Irmosi: »U sigurua zemra ime në Pe-»rëndinë,* m'u lartësua në Zotin briri.* »Goja ime u zgjerua përmbi armiq* dhe »kisha gaz për shpëtimin tënd.¹⁰²]

Siç është shkruar, kur qe Festa Ligjore, shkoi* në Hierore dhe dha mësimë* Zoti Krisht, u thoshte: Ju, o judenj, të mos* gjykoni kot, si përciptazi.

Ju, o judenj, të mos gjykoni kot, si përcip-tas,* ka ardhur Zoti Krisht që profetët* e thërrisinin qart' të vinte nga Sioni,* që botën ta rithërrasë drejt.

Judenj, ju s'i besoni fjalët e Zotit tonë,* por t'u besoni atyre që bën;* pse mash-troheni? Mohoni Shën Krishtin që* e ka Moisiu shenjt në Ligj.¹⁰³

Judenj, nëse patjetër duhet të vij' Me-sia,*¹⁰⁴ tash erdhi Krishti, Mesia, dhe ju* pse mashtroheni? Mohoni të Drejtin që* e ka Moisiu shenjt në Ligj.¹⁰³

Lavdi *Triadik*

O At', të falemi, je pa nisje si esencë* dhe e himnojm' Birin tënd pa nisje* me të Tërëshenjtin Shpirt besërisht; të tre,* Një qenie, Një Perëndi jeni.

Tani *Hyjlindësor*

U bëre trup edhe u shfaqe¹⁰⁵ pa e ndry-

shuar* esencën; ti je një prej Trinisë,*
Perëndi, i tëri zjarr, por s'e dogje, Krisht,*
të paprishurin bark, lindësen.

Zbritësore: Estereothi i kardhia mu

U siguria zemra ime.

Ndenjëso

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Mes së kremtes, hyjnisht, kur po rri-
je, Zot,* brenda në Hierore, thoshe me
zë:* Të vijë tek un', të pij'* çdo i etur, të
pijë mjaft,* se cilido që pi nga kjo rrje-
dhë hyjnore krejt,* do t'i gufojë dogmat
e mia porsi lumenj* jashtë barkut,⁸⁹ çdo-
kush që ka besë tek unë* që Ati hyjnor
i madh* më dërgoi,¹⁰⁶ me mua tok* do
lëvdohet".* Thërrasim pra* te ti: Lavd ty,
Krisht Perëndi,* për ne shërbyesit e tu*
po i lëshon* rrjedhjet e njeridashjes sate
mjaft pasurisht.

Lavdi *dhe* Tani

Ti për botën gufon ujë jete plot,* uj' ur-
tie edhe gjithë ne na fton* të nxjerrim
shpëtim si çurg,* çdo njeri që e merr, e
mban* hyjnorin ligjin tënd me të shuan
krejt çdo qymyr* mashtrimi, nuk do ketë
kurr' etje në jetë pra,* nuk do ngopet ku-
rrë me të, mbret qiellor, Zot;* prandaj e
lëvdojmë mjaft* forcën edhe pushtetin
tënd,* Krisht, dhe lypim* të na dërgosh*
ndjesë pasurisht për çdo faj,* sepse na
ke shërbëtorë,* o Shpëtimtar,* dhe te ti
ne i kemi shpresat, o Perëndi.

Ode IV

Irmosi: Eparchenta se idhusa

»**K**isha, kur të pa ty, Diellin e drejt'si-
»së,*¹⁰ që ishe ngritur përmbi Kryq,*
»për hirin e saj pra,* mbeti e çuditur në
»vend;»¹⁰⁷ thërriste siç duhej fort:* Lavd

»fuqisë sate, o Zoti Krisht.

Pasi i theve portat e vdekjes me fuqinë
tënde, ua bëre të njohura udhët e jetës¹⁰⁸
së pavdekshme dhe ua hape portat atyre
që thërresin besërisht: Lavdi fuqisë sate,
o Zot.

Meqenëse e ke mesin dhe fundin e të
gjithave¹⁰⁹ dhe, si i pakohshëm, e ke në
dorë pushtetin, qëndrove në mes duke
thirrur: O hyjmendës, ejani të shijoni dhu-
rata hyjnore.

O Krisht, si Perëndi që e ke hegje-
moninë e të gjithave dhe si i fortë që e vithise
pushtetin e vdekjes, premtove se do ta
dërgoje Shpirtin e Shenjtë që del prej
Atit.¹¹⁰

Hyllindësor

Ua shpërndan pasurisht Hirin atyre që
të himnojnë ty dhe Fjalën e parajetshme
që lindi prej teje, o Nënë e pamartuar, e
tërëpacenuar, dhe kërkon për ta faljen e
mëkateve.

Tjetri: O profitis Avakum

[Irmosi: »Shën profeti Abakum e*
»parapa, Shpëtimtar,* me mendorët sy,
»Zot, ardhjen tënde, thirri pra:* "Do vijë
»nga Themani Perëndia",¹¹¹ edhe thërris-
»te fort:* "Lavd lavdit tënd të madh, o
»Krisht,* edhe bashkëzbritjes sate lavd."]

Në qoftë se duhet të vijë Mesia dhe Me-
sia është Krishti,¹⁰⁴ pse nuk e besoni, o të
paligjshëm? Ja ku arriti dhe dëshmojnë
ato që bën: Ujin e ktheu në verë,⁹⁴ një të
paralizuar e shëroi me fjalë.

O hebrenj të paligjshëm, duke mos i kup-
tuar Shkrimet, të gjithë ju bëni gabime,¹¹²
sepse me të vërtetë erdhi Krishti dhe i
ndriçoi të gjithë dhe ju tregoi shumë çudi

kolosale; kot e mohoni jetën autentike.²⁶

Krishti u thërriste judenjve: Një akt ju tregova dhe të gjithë çuditëni tashmë; ju e rrethpritni njeriun të shtunën, siç thuhet, ndaj pse më akuzoni mua që ngrita me fjalë një të paralizuar?

Krishti i kritikonte judenjtë duke u thirrur: Bëra shumë vepra; për kë vepër më qëlloni me gurë?¹¹³ Ngaqë e bëra mirë plotësisht, me fjalë, një njeri? Mos gjykoni nga pamja e jashtme, o njerëz.

O Krisht, me anë të mrekullive të tua, i lartësove kombet drejt njohjes sate, duke i aktivizuar apostujt dhe duke u prehur bashkë me Shpirtin te profetët, o Bir i pacen i natyrës atërore.

Lavdi *Triadik*

O Trini, Njësi e pandarë, Atë pa nisje, Bir dhe Shpirt i Shenjtë, Triadhë në Njësi, e bashkënderuar, e bashkëfronshme, jetëbërëse, Perëndi i pakrijuar, shpëtoji ata që të përhimnojnë dhe çliroji nga rreziqet dhe shtrëngimet.

Tani *Hyllindësor*

O Hyjnuse, nënë-virgjëreshë e dëlirë, që e mbajte parrëfyeshëm Perëndinë në barkun tënd, mos pusho së ndërmjetuari për hirin tonë, që të çlirohemi nga peripecitë nëpërmjet teje, sepse përikim te ti përherë.

Zbritësore: O profitis Avakum

Shën profeti Abakum.

Ode V

Irmosi: Si Kirié mu fos

»Si dritë, Zoti im,* në mbar' botën ke
»ardhur ti,*⁵⁸ si shndritje e shenjtë, që
»nxjerr* nga padija e errët¹¹⁴ sa të him-
»nojnë me besim.

O hyjmendës, përderisa arritëm në mes të të kremteve hyjnore, le të nxitojmë ta praktikojmë me përsosmëri virtytin hyjnor.

Vërtet është i hyjshëm panairi i sotëm! Sepse cakton mesin e të kremteve tepër të mëdha dhe shkëlqen nga të dyja anët.

Hyllindësor

O Shpëtimtari im i shumëmëshirshëm, mendja kryeengjëllore nuk mund ta kuptojë dot lindjen tënde të tërëpacenuar dhe të pashprehshme prej Virgjëreshës.

Tjetri: Kirié o Theós imón

*[Irmosi: »***O** *Zot dhe Perëndia ynë, jepna »paqe ti;* O Zot dhe Perëndia yn', na ki »ne pron';* o Zot, përveç teje tjetër nuk »njohëm dot dhe emrin tënd thërrasim »me besim.¹¹⁵]*

Me mrekulli i stolise apostujt e tu, me çudi i madhërove Nxënësit në mbarë botën dhe i lavdërove, o Shpëtimtari ynë, meqë u dhe mbretërinë tënde.

Nxënësit i ndriçuan absolutisht të gjitha skajet e dheut, duke predikuar fjalën e mbretërisë sate, o Krisht Shpëtimtar, nëpërmjet çudirave, mësimdhënieve dhe mënyrave të shumëllojshme.

Idërgojmë himnim mbretërisë sate dhe të ofrojmë himn ty që u shfaqe për ne mbi dhé, që e ndriçove botën dhe e rithirre Adamin.

Lavdi *Triadik*

Lavdi ty, o Atë i shenjtë, Perëndi i palindur. Lavdi ty, o Fjalë i pakohshëm dhe i vetëmlindur. Lavdi ty, o Shpirt Hyjnor, i bashkëfronshëm dhe i njëqenshëm me Atin dhe me Birin.

Tani *Hyjlindësor*

Barku yt u bë si tryezë e shenjtë, duke pasur bukën qiellore, nga e cila, çdokush që ha, nuk vdes,¹¹⁶ ashtu siç tha ushqyesi i çdo gjëje,^{116a} o Hyjnënë.

Zbritësore: Kírie o Theós imón

O Zot dhe Perëndia ynë.

Ode VI

Irmosi: Thiso si metá fonís

»Do flijoj* me zë himnimi,¹¹⁷ Kisha thë-
»rret tek ti,* o Zot, sepse përmes gja-
»kut,* që nga brinja jote për përdëllim
»rrjedh,*¹¹⁸ u pastrua* nga çdo pisllek
»prej gjakrash demonësh kjo.

Ja erdhi* sot Mespentikostia dhe fort shkëlqen,* nga njëra anë, prej dritës* mjaft të shenjt' të Pashkës hyjnore dhe, nga* ana tjetër,* feks prej Ngushëllimtarit me hir prej tij.

Rrije, Krisht,* në Tempull, bashkësis' hebraike pra* i flisje dhe ia zbuloj* lavdin tënd, kështu shfaqje se një qenie* kishe ti tok* me Atin, Shpëtimtar; të himnojmë ne.

Bëhu ti* për mua mbrojtje, mur që nuk tundet dot* dhe më çliro nga skandal-let* tokësore, Hyjlindëse unike,* dhe shkëlqemë* me dritëdhëniet mjaft të hyjnueshme.

Tjetri: Os ídhata thalasis filánthrope

[Irmosi: »Si ujëra në det më shtrengojnë,
»Njeridashës, krejt tallazet e jetës k'tu,*
»dhe unë pra thërras te ti: Si Jonan' Perën-
»di i tër'dhembshur, nxirrma nga prishja
»jetën dhe më shpëto.¹¹⁹]

Kujdesesh për krejt anët e botës, shkove pra në Hieroren lart, o Jisu,* mes festës

ia mësoje ti turmës fjalën reale, të saktë, siç na thërret shenjtori Joan, o Krisht.

Ihape buzët, Krisht, dhe ia shpalle botës Atin e pakohshëm si dhe me të* të Të-rëshenjtin Shpirt; dhe, pas mishërimit, e ruajte lidhjen farefisnore, Zoti yn', me të dy.

O Shpëtimtar Krisht, aktet e Atit i mbarove,¹²⁰ i provoje fjalët që the* me vepra, me çudi, kur pastroje lebrën dhe ngjallje të vdekur si edhe ngrije, Zot, një paralitik.¹²¹

Merr nisje i panisshmi Bir kur u bë njeri edhe kur mori esencën ton';* në mes të festës jepte mësim, thoshte: Vraponi kundrejt burimit që nuk shteron, që të nxirrni jet'.

Lavdi *Triadik*

Të gjithë Një Hyjni në Trini po lavdërojm', esencë trehipostate pra* të pakrijuar, pa ndarje: Atin, Birin dhe Shpirtin e Shenjtë, e adhurojmë si tre me një qenie.

Tani *Hyjlindësor*

O Vajzë, o e vetmja e pastër dhe Hyjnuse, të himnojmë si virgjëresh'* pas lindjes, të lëvdojm' si të virgjër nënë; nga ti mori trup vërtet Perëndia edhe na ngjalli ne.

Zbritësore: Os ídhata thalasis filánthrope

Si ujëra në det.

Kontaqi

Ting. IV O ipsothís en to stavró

Kur ishte mesi i* së kremtes Ligjore,* u thoshe, Bërës i* çdokujt,¹⁸ Perëndi, Zot,* atyre pra që ndodheshin: Ju ejani bri,* merrni uj',⁸⁹ pavdekësi". Me bes'* para teje ne biem tash* dhe thërrasim bashkërisht:* Na dhuro, Krisht, të mirat,* mëshirat që ke se ti je për ne* si dhe për

botën* burimi i jetës son’.

Shtëpia

Me çurgjet e gjakut tënd, vadite shpirtin tim që është djerr prej shkeljeve të paudha dhe tregojë të frytshëm, me virtyte, sepse ti na the të gjithëve, o Fjalë e Tërëshenjtë e Perëndisë, të vijnë te ti dhe të nxjerrim ujin⁸⁹ e paprishjes, ujin e gjallë dhe pastrues për mëkatet e atyre që e himnojnë ngritjen tënde të lavdishme dhe hyjnore; dhe atyre që të njohin si Perëndi, u jep fuqinë e Shpirtit, e cila iu dërgua me të vërtetë nga lart Nxënësve të tu,¹²² o i miri Zot, përderisa je për ne edhe për botën burimi i jetës son’.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm

Të mërkurën e të Paralizuarit kremtojmë festën e Mespentikostisë.

Varg: Krishti, Mesia, qëndron në mes të së kremtes/ dhe jep mësim në mes të mësuesve.¹²³

Me mëshirën tënde të pafund, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: En ti kamino avramiei

»Në zjarr kamine* persiane, Djemtë »abrahamianë pra* prej një malli shpre- »sëtar digjeshin më fort* se prej flakës, »ndaj thërrisnin: Zot,* je i bekuar ti në »tempullin e lavdit tënd, Perëndi.¹²⁴

Kur e shfarose fuqishëm forcën e vdekjes, o Shpëtimtar, ua bëre të njohur vdekatarëve udhën e jetës¹⁰⁸ dhe ata të thërrasin gëzueshëm: Je i bekuar në tempullin e lavdisë sate, o Zot.¹²⁴

Bashkësitë e hebrenjve nuk të njohën, o Fjalë e Perëndisë, se ishe veshur me trup, por ne të këndojmë: Je i bekuar në

tempullin e lavdisë sate, o Zot.¹²⁴

Hyjlindësor

Ti që je tenda* e shenjtë dhe hyjnore e Zotit lart,*¹²⁵ g’zohu, sepse nëpërmjet teje u dha gaz,* o Hyjlindëse, atyre që* thon’: E bekuar midis grave ti je,¹²⁶ o e panjollshme krejt.

Tjetër: Ton Haldheon i káminos

[Irmosi:] »Edhe pse ndizej furra në Kaldé »me zjarr qëmoti,* me pranin’ e një fry- »me Perëndie po freskohej;* pra psalnin »kështu tre Djemt’: Je i bekuar ti, o Perë- »ndi i etërve tan’.^{127]}

U lodhe trupërisht, o prehja e të gjithëve; kishe etje vullnetarisht, o burim i çudive; kërkove ujë, o Jisu, duke premtuar ujin e gjallë.⁹⁶

Bisedoje me një grua samaritane, o Zot, duke i sqaruar marrëzinë e hebrenjve të paligjshëm; nga njëra anë, ajo besoi se ishe Biri i Perëndisë,¹²⁸ ndërsa, nga ana tjetër, ata të mohuan.

O Shpëtimtar, burim përherë i gjallë, ua premtove ujin e gjallë që hidhet përpjetë, ujin e pavdekësisë,⁹⁶ atyre që e presin besërisht Shpirtin tënd që del prej Atit.¹²⁹

Me pesë bukë ushqeve mijëra të etur dhe i bekove ato që mbetën për mijëra të tjerë, o Shpëtimtar, duke ua treguar lavdinë tënde Nxënësve të hyjnueshëm.⁹⁷

Ai që ha bukën tënde, do të jetojë përjetësisht dhe ai që pi gjakun tënd, mbetet te ti, o Shpëtimtari im, dhe ti mbetesh tek ai dhe do ta ngjallësh në çastin e fundit.¹¹⁶

E bëre të çuditshme Ekonominë tënde, o Zot; duke e vërtetuar me mrekulli pushtetin hyjnor, zmbrapse sëmundjet, ngrite të vdekurit dhe ndriçove të verbrit, si

Perëndi.¹²¹

I pastrove të lebrosurit, i ngrite të çalët, i forcove paralitikët,¹²¹ e shërove gjakrrjedhësen¹³⁰ dhe ece mbi det¹³¹ duke ua shfaqur lavdinë tënde Nxënësve të hyjnueshëm.

Lavdi *Triadik*

O Zot, i falemi Atit tënd të pakohshëm dhe Hirit të Shpirtit që ua ndave apostujve të tu, si Perëndi, kur i dërgoje për predikim.¹³²

Tani *Hyjlindësor*

Në barkun tënd e mbajte Fjalën e paxënshme; i dhe gjë ushqyesit të botës,^{116a} në prehër e mbajte furnitorin tonë, o Perëndilindëse e kulluar.

Zbritësore: Ton Haldheon i káminos
Edhe pse ndizej furra.

Ode VIII

Irmosi: Hiras ekpsetasas Dhaniil

»Duke* ngritur duart, Danieli mbylli gojë* e luanëve në grop*;¹³³ dhe shuan »forcën e zjarrit krejt,*¹²⁷ kur u ngjeshën »me virtyte Djemt*, pra miqtë e shpresë »taris*, tok duke thirrur me gaz: Beko- »ni,* ju gjithë veprat e Zotit, pra Zotin ton*.¹³⁴

Pasi u ngjalle i bukur prej varrit, i stolisur me fuqinë e Hyjnisë iu shfaqe Apostujve të tu, o Zot, duke u premtuar se do t'u dërgoje energjinë e Shpirtit¹¹⁰ atyre që do të thërrisnin: Të gjitha ju, o vepra, himnojeni Zotin.¹³⁴

O kryetar unik i jetës, kur e vrave Hadhin, si Perëndi, u gufove të gjithëve jetën e amshuar, të cilën ua ikonizojnë shumë dukshëm huret e këtyre ditëve dritëprurëse atyre që thërrasin: Të gjitha ju, o ve-

pra, himnojeni Zotin.¹³⁴

Pasi u shfaqe si dielli i drejtësisë,¹⁰ o Krisht, i dërgove apostujt e tu si rreze në botë,¹³² duke të sjellë ty, dritën⁵⁸ e pakonceptueshme, dhe duke e zhdukur mjegullën¹¹⁴ e paditurisë, dhe duke thirrur: Të gjitha ju, o vepra, himnojeni Zotin.¹³⁴

Hyjlindësor

Ja ku shteroi tani kryetari i hegjemonëve nga fisi i Judës, sepse ti, o e Tërëpaqortueshme, linde atë tek i cili ishin rezervuar të mëparshmet, pritjen e kombeve,¹³⁵ Krishtin, të cilit i psalim: Të gjitha ju, o vepra, himnojeni Zotin.¹³⁴

Tietri: Ængjeli qe urani

[Irmosi: »Ængjëj,¹³⁶ qiej¹³⁷ tok, atë që rri »mbi fron lavdie¹³⁸ edhe pa pushim* si »Perëndi lëvdohet,¹³⁹ përhimnojeni* dhe »bekojeni, dhe përmbilartësojeni pra në »gjithë jetët.]

O popuj, ejani të shihni si blasfemohet prej popujve të paligjshëm ai që përhimnohet kur rri mbi fronin e lavdisë¹³⁸ dhe, kur ta shihni, himnojeni Mesian, të parafulurin nga profetët.

Ti je me të vërtetë Krishti që erdhe në këtë botë¹⁴⁰ dhe, nëpërmjet teje, erdhi shpëtimi dhe falja e gabimeve të etërve; ti je jeta²⁶ e vërtetë e atyre që të besojnë.¹⁴¹

Siç është shkruar, në mes të së kremtes, urtësia e Perëndisë⁸⁸ shkoi në Hierore dhe mësonte se ai ishte me të vërtetë Mesia Krisht, me anën e të cilit marrim shpëtimin.

Krishti i shfaqte punët e çudive të shtunave dhe në të gjitha ditët, duke i shëruar të sëmurët me sëmundje të ndryshme,

por populli mashtrues e urrente nga inati.

Judenjtë talleshin hidhur me Krishtin, duke thënë: Këtë paralitikun që dergjej për shumë vjet, ai e shëroi të shtunën dhe e shkeli ligjin.

Krishti u thoshte judenjve: "Moisiu që ju dha Ligjin, nuk urdhëron të rrethpritni?". Dhe të shtunën e rrethpritnin njeriun, që të mos prishej ligji i etërve.

Mosmirënjohësit për çdo gjë, që jetuan qëmoti në shkretëtirë,¹⁴² nga xhelozia hidheshin ashpër kundër mirëbërësit duke blasfemuar, duke lëvizur gjuhët e padrejta dhe duke menduar gjëra të kota.¹⁴³

Lavdi *Triadik*

Pra, Një Perëndi është Trinia, meqenëse Ati nuk u kthye në Bir, as Biri nuk u kthye në dalje, ndaj unë i lavdëroj, veç dhe së bashku, të tre si Dritë, Perëndi.

Tani *Hyjlindësor*

Thuaj, si e linde atë që parashndriti pa kohë prej Atit dhe himnohet bashkë me Shpirtin e Shenjtë? Ashtu siç e di ai i vetmi që deshi mirësisht të lindej nga ti, o Perëndilindëse.

Zbritësore: Ángjeli qe urani

Engjëj, qiej tok.

"Më të nderuarën" nuk thuhet

Ode IX

Irmosi: Lithos ahirótmitos orus

»Si një gur i prerë pa dorë nga mali yt i »palatuar,* Virgjëresh', u pre porsi gur¹⁴⁴ »qosheje,*¹⁴⁵ pra Krishti, i cili i bashkoi* »natyrat krejt të kundërta;*¹⁴⁶ ndaj me »gëzim të madhështojmë ty.

Na mësoi Krishti jetesë të re,¹⁴⁷ pran-daj me zell të gjithë,* me gatishmëri të

përpiqemi ne* ta ruajm' deri në fund,¹⁴⁸ që, ardhjen* e Shpirtit Shenjt Ngushë-llimtar,* o besimtarë, ta shijojmë fort.

Me pavdekshmëri ma ke veshur ti vdek-shmërinë si një rrobë*²⁵ edhe me pa-prishjen, me hirin e saj,* më ngjalle tok, Shpëtimtar, më çove* tek Ati¹⁴⁹ si ma zhduke fort* luftën kronike, jetëdhënëse Krisht.

U rithirrëm në qielloren jetesë nëpër-mjet fuqisë* që ka ndërmjetimi i Krishtit Jisu,* të zbrazur deri në formë skllavi*⁴⁰ edhe na lartësoi krejt,* ndaj, denjësisht, ta madhërojmë ne.

Hyjlindësor

Jemi bindur gjith' ne besnikët, e Virgjër, se burim, shkak, rrënjë* ti je për paprish-jen; të mburrim fort* përmes lavdërime-ve të shumta,* enipostaten pavdek'si* na ke gufuar, o Hyjlindëse.

Tjetri: Alótrion ton miteron

[Irmosi: »E huaj është* virgjëria për në-»nat, Zonjë;* e huaj është lindja* për çdo »virgjëreshë;* në ty Ekonomia hyjnore i »ka bër' të dyja,* pra gjithë fiset nëpër »botë, pa pushim të lumërojnë, Mari. ¹⁵⁰]

O Shpëtimtar,* i mësoje të gjith' kur ishe në Hieroren tënde,* ku ti ishe ngritur,* ndaj çuditëshin, thoshin judenjtë: "Si pra i di shkronjat,* pasi nuk ka studiuar?", se nuk donin hiç të të besonin ty.

Gufonte plot* Çlirimtari im Krisht kariz-ma shërimesh, si dhe bënte* mrekulli,¹⁵¹ shëronte* të sëmurët edhe dobësit' i flak-te, por judenjtë* si zjarr shpërthenin nga shumica e çudive që i bënte shpesh.

Judenjtë, si* të pabindur, i kritikonte fort Çlirimtari im Krisht,* u thërriste: Bëni* pra

gjkime të drejta edhe jo sipërfaqësore,* se, dhe të shtunën, urdhëron Ligji që të rrethprietet çdo njeri.

O Shpëtimtar,* pas premtimit tënd, u dhe Nxënësve të mëdhat' çudi ti,*¹⁵² i dërgove te kombet të shpallnin¹³² lavdin tënd në botë,* ndaj predikonin mishërimin, hirin tënd dhe ngjalljen tënde, Zot.

“Ju çdo njeri* e rrethprietni edhe të shtunën, se s'doni të shfaroset* Ligji; por me mua* pse mërziiteni kaq që, me një fjal', e shërova qyqin?*" Të mos gjykoni ju përciptazi", u thot' judenjve Zoti Krisht.

Shërove, Zot,* ti me fjal' një dor' krejt të tharë,¹⁵³ shëroje, Fjalë, tokën* mjaft të thar' prej kohësh,* zemrën time pra, o Shpëtimtar, tregomë plot me fryte,* që, me pendim të flaktë, dhe unë të sjell mjaft fryte¹⁵⁴ ty, o Krisht.

O Zot, m'i shndrit* syt' e shpirtit, pastroma zemrën se është e lebrosur,* ngrimë se jam shtrirë* në krevatin e dhimbjes siç ngrite dhe paralitikun* që dergjej, Fjalë, Perëndia im, në shtrat me dhimbje dhe vajtim.

Lavdi *Triadik*

E huaj kjo:* Të paligjshmit ta adhurojnë Trininë pa fillim, Zot,* Atin, Birin si dhe* Shenjtin Shpirt, sundimtareni mbi çdo gjë, ajo s'u ndërtua;* e tërë bota u fiksua me pushtetin e saj plot fuqi.

Tani *Hyjlindësor*

E lumtur krejt,* jetëdhënësin, Krishtin, njërin prej Shën Trinis', e nxure* brenda mitrës sate;* e himnon çdo krijesë, e kanë frik' të lartat frone,*¹⁵⁵ e virgjra Nënë, përgjëroju t'i shpëtojë shpirtat tanë pra.

Zbritësore: Alótrion ton miteron

E huaj është virgjëria.

Dërgimësore: O uranón tis astris

Ke një kan' plot dhurata* që nuk shterojn', më bëj të nxjerr* ujë, pra të marr ndjes' fajesh,* se më ka kapur etja fort,* i dhembshur, o Zot, i vetmi* i mirë dhe njeridashës. (2x)

Lavdërime

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Reflektimi,¹⁵⁶ fuqia tok,* urtësia e Atit Zot,*⁸⁸ e përjetshmja Fjal', Biri pra i Perëndis',* shkoi me trup lart në Hierore dhe i mësonte drejt* popujt shumë të këqij,* judenj't, mosmirënjohësit* dhe të frikshmit mjaft,* admironin bollëkun e urtisë duke thirrur: Si i di shkronjat kur askush s'e mësoi kurr'? (2x)

Mbyllte gojën e Shkruesve,* kritikonte judenj'te prer'* Zoti Krisht, Mesia, dhe u thërriste drejt:* Të mos gjykoni kot, cektësisht porsit të padrejtë ju,* të paligjshëm fort, meqë* un' të shtunën e bëra mir'* një paralitik,* ndaj jam Zot i së shtunës¹⁵⁷ dhe i Ligjit; pse kërkoni të më vrisni mua që ngrita të vdekurit?

Bashkësit' e judenjve lasht',* të paligjshmit tmerr, hodhën gur'* kundër Moisiut, mosmirënjohës jan';* dhe e sharruan me sharrë druri fort Isaian shenj't dhe të urtin Jeremi* në llum, baltë, e vunë keq,*¹⁵⁸ por për Zotin Krisht,* kur e ngritën mbi Kryq, thërrisnin: Do besojmë nëse e shpëton veten ti që po e prish tempullin.¹⁵⁹

Lavdi dhe Tani *Ting. IV I Anatolit*

Pasi u ndriçua, o vëllezër, me anë të ngjalljes së Krishtit Shpëtimtar dhe

arritëm në mes të së kremtes zotërore, le t'i ruajmë me sinqeritet porositë e Perëndisë, që të bëhemi të denjë për ta kremtuar dhe festën e Analipsit, dhe të arrijmë në zbritjen e Shpirtit të Shenjtë.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanuni i parë Ode III dhe nga i dyti Ode VI. Hyrtorja Ejani t'i falemi... Shpëtona... që u ngjalle prej së vdekurish.... Ose] Antifonet dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi i Mespentikostisë. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX E huaj është virgjëria... Kungatore "Ai që ha mishin tim dhe pi gjakun tim, mbetet tek unë dhe unë tek ai", tha Zoti. Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall.



TË MËRKURËN E MESPENTIKOSTISË NË MBRËMËSORE

Thirrtoe Ting. IV O eks ipsistu klithis

Si e vithise, me vdekjen tënde, forcën* që kish vdekja, Krisht, u dhe jetë të vdekshmëve;* në ngjalljen tënde me mjaft lavdi,* me veten bashkë* e ngrite fisin ton' kur ti zbritte posht',* ndaj falënderuesin himn ta këndojmë ty* dhe festën e ngjalljes me shkëlqim* pra pas tri ditësh* po e kremtojmë, tash që mbi gjithë ne,* o jetëdhënës,* shndriti mesi i periudhës së ditëve tërë nder;* Zot, Jisu mirëbërës,* je për shpirtat tanë, Shpëtimtar.

Para pësimit dhe Kryqit tënd të çmuar,* Krisht, u bëje popujve të lavdëruarat* çudi; pas Shkrimit, qëndrove drejt* në mes të festës* Ligjore dhe fort të gjithë-

ve u the:* Në ndonjë ka etje, të vijë tek un', të nxjerr'* një ujë, pijen hyjnore, pra* rrjedhat e jetës,*⁸⁹ se ujë force, urtie, jete tok* çdokujt i jap boll,* përderisa vullnetarisht unë ngjava me njerëzit,* si i tërëfuqishëm* edhe njeridashës krejtësisht.

Dergjem në fajet e mia tmerr si në shtrat,* vuaj mjaft, gjymtyrët e mia kan' paraliz;* si det i madh njeridashjeje* je dhe me dashje* njeri u bëre, padukshëm tash më ngri* si paralitikon, i shumëmeshirshmi Krisht,* dhe më ndihmo që të shkoj me vrap* në udh' të shenjtë,* në porositë e tua, o Jisu* që, para Kryqit* dhe pësimit, me mjaft çudi që ke bërë, ia shfaqe ti* bashkësisë hebre se* vuan me vullnet sado je Zot.²⁴

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. II

Kur arrite në Hierore, mes së kremtes, o Krisht Perëndi, i mësoje popujt duke thirrur: "Ai që beson tek unë, edhe nëse do të vdesë, do të jetojë".^{159a} Dhe judenjtë grindeshin rëndë bashkë me Farisenjtë, Saducenjtë dhe Shkruesit duke thënë: "Kush është ky që bën blasfemi?".¹⁶⁰ Nuk mendonin se ti je Perëndia ynë që, para gjithë jetëve, lavdërohesh bashkë me Atin dhe Shpirtin; lavdi ty.

Pasvargje të Oktoikut Ting. III

Ngjallësor

O Krisht, që errësive diellin me pësimin tënd¹² dhe ngazëllove gjithësinë me dritën e Ngjalljes sate, prit himnin tonë mbrëmësor, o Njeridashës.*

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Apostolik

Në tërë dheun doli fjala⁶² juaj, o apostuj shenjtë; e shpërbëtë mashtrimin e idhujve pasi e predikuat hyjnjohej; kjo është lufta juaj e mirë,¹⁶¹ o të lumtur; prandaj i himnojmë dhe i lavdërojmë kujtimet tuaja.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Martirik

Martirët e tu, o Zot, si u mbështetën në besim dhe u siguruan në shpresë, e shkaktërruan tiraninë e armikut; dhe, pasi fituan kurora, ndërmjetojnë bashkë me të patrupët për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani *Ting. III I Germanoit*

Në mes të së kremtes e lavdërojmë atë që bëri shpëtim në mes të dheut.¹⁶² Jeta²⁶ varej në dru¹⁶³ mes dy kusarësh¹⁶⁴ dhe nuk i fliste atij që blasfemonte, ndërsa i thërriste atij që besonte: “Sot do të jesh së bashku me mua në Parajsë”.¹⁶⁵ Zbriti në varr, e plaçkiti Hadhin dhe u ngjall pas tri ditësh duke i shpëtuar shpirtrat tanë.

Përlëshorja e Mespentikostisë [një herë si dhe deri te Mbyllja, ndërsa në fillim të Mëngjesores (pas Perëndia është Zoti) tri herë. Në fund të saj, një herë].



TE ENJTEN E JAVËS IV
NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores të Oktoikut
Ting. III Tin oreotita*

Çdo gjë të njerëzve* e prite me vullnet,* i more tonat mbar’*²³ dhe deshe mirësisht* të nguleshe në Kryq dhe prefero-

ve lirshëm të vdisje,*²⁴ Bërësi im, si njeri,* që njer’zinë, si Perëndi,* ta çliroje prej vdekjes,* ndaj dhe ne të thërrasim ty* porsì Zot jetëdhënës, i mirë:* Lavd dhembshurisë sate, o Krisht.

Apostolike

E hijesove mjaft,* o njeridashës Zot,* si i pushtetshëm fort* kujtimin plot me nder* të shën apostujve, se i forcove t’i imitonin* sa ke hequr, se ata* porsì trima e mundën krejt* forcën e beljarit djall* dhe karizma shërimesh,¹⁶⁶ hir* kan’ marrë; jepi popullit tënd, Krisht,* paqe,¹⁶⁷ siç po të përgjërohen.

Martirike

Vithisët, o atlet’,* çdo rend armiqësor,* se veshët armë, bes’,* dhe u forcuar mjaft* me arsenalin që jep Zoti,¹⁶⁸ meqenëse duruat* me gatishmëri çdo gjë,* kërcënime të tëra ju,* madje kamxhikime tok* nga tiranët, se kishit shpres’* për jetën,¹⁶⁹ o martirë të Krishtit* plot forcë; morët drejt kurora.

Hyjlindësore

Profetët, apostujt e Krishtit dhe martirët na mësuan ta himnojmë Trininë e bashkëqenshme; i ndriçuan kombet e humbura dhe i bënë bijtë e njerëzve shokë me engjëjt.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Mes së kremtes, hyjnisht, kur por rrije, Zot,* brenda në Hierore, thoshe me zë:* Të vijë tek un’, të pij’* çdo i etur, të pijë mjaft,* se cilido që pi nga kjo rrjedhë hyjnore krejt,* do t’i gufojë dogmat e mia porsì lumenj* jashtë barkut,⁸⁹ çdokush që ka besë tek unë* që Ati hyjnor i madh* më dërgoi,¹⁰⁶ me mua tok* do lëvdohet”.* Thërrasim pra* te ti: Lavd ty,

Krisht Perëndi,* për ne shërbyesit e tu* po i lëshon* rrjedhjet e njeridashjes sate mjaft pasurisht. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Mespentikostisë (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe të Mespentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Mespentikostisë. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Mespentikostisë (2x).*

Lavdërimi të Oktoikut

Ting. III

Ngjallësor

Në dritën tënde, o Zot, do të shikojmë dritë, o Njeridashës, që u ngjalle së vdekurish, duke i dhuruar shpëtim gjinisë së njerëzve, që të të lavdërojë tërë krijesa ty, të vetmin të pamëkatshëm; mëshirona.* (2x)

Apostolik

Përderisa i ruajtët paqortueshëm porositë e Krishtit, o apostuj të shenjtë, morët falas dhe jepni falas,¹⁷⁰ duke i shëruar pësimet e shpirtrave dhe të trupave tanë; ndaj, duke pasur guxim, përgjërojuini atij, që t'i mëshirojë shpirtrat tanë.

Martirik

Si ndriçues, në botë¹⁷¹ shkëlqeni dhe pas vdekjes, o martirë të shenjtë, sepse garuat në ndeshjen e mirë;¹⁶¹ prandaj, meqë keni guxim, lypeni Krishtin Perëndi që t'i mëshirojë shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. IV

O Zot, para Kryqit tënd të pacen, kur ishte mesi i së kremtes, u ngjite në Hierore dhe u mësoje judenjve ligjet e Moisiut si dhe ato që ti kishe vendosur në Ligj; dhe duke u çuditur për misterin e parrëfyeshëm të urtësisë sate, o Krisht, e

thurën nga xhelozia intrigën kundër teje, duke thënë: “Si i di ai shkronjat pasi nuk ka studiuar?”, sepse nuk të njihnin ty, Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.

Pasvargje të Mespentikostisë (Këto dhe Pasvargjet në vazhdim deri tek e marta kanë Akrostihidhë: “Të Mespentikostisë”).

Ting. II Ikos tu Efrathá

Ke një pushtet të madh* dhe je një mbret i madh, Zot,* kur mjaft u varfërove,*⁶⁸ me të mëdhat' karizma* e mbushe mbarë kozmosin.

Varg: Kujtoje sinagogën tënde që e fitove nga fillimi.

Rrije mes festës ti* në Tempull edhe çurgjet* e tua po i nxirrje,* të etur krejt vaditje,* i dhembshur, me hyjnorin Hir.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Do që të më shpëtosh,* ndaj dhe merr trup çuditshëm* nga Vajza që s'ka burrë;* mes Tempullit tënd, o Zot,* buron për mua Hirin tënd.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

I Joan Monakut

Në mes të së kremtes, para pësimit dhe ngjalljes sate lavdiplote, o Zot, ishe në Hierore duke mësuar judenjtë e pabindur, Farisenjtë dhe Shkruesit dhe duke u thirrur: “Kush ka etje, le të vijë tek unë dhe le të pijë; atij që beson tek unë, do t'i rrjedhin nga barku lumenjtë e ujit⁸⁹ të jetës së Shpirtit Hyjnor”. O urtësi e parrëfyeshme e mençurisë sate! O Perëndia ynë që i mbush të gjitha,¹⁷² lavdi më ty!



NË MBRËMËSORE

*Thirrtores**Ting. Tërth. I Heris askitikón*

G'zohu, i ndritshmi me hijeshi,* i tërëshenjtë mes i Ngjalljes shpëtuese;* u duke porsi mesditë dhe e shndrit kozmosin nur* me hyjnorin hir, dritë të ngritjes pra* të Krishtit edhe shkëlqen,* si llambadhe, simbol të fort'* paprishjeje dhe* Analipsin në lartësi* na e parashfaq* tok me ardhjen e Shenjtë Shpirt* dhe panairin plot drit' të së shenjtës Pentikosti* që është shumë e çmuar, e shumëdashur, prandaj i jep* mëshirë të madhe*⁷ si dhe paqe¹⁶⁷ shpirtit tonë prej Shpëtimtarit Zot.

Zoti, mes festës, si lum' hyjnor* na jep të gjithëve tash rrjedhat e dhembshurisë;* thërret: Kushdo që ka etje, të vijë të nxjerrë uj',*⁸⁹ se kam përdëllim si det dhe dashuri* plot porsi burim; ai* ndjesë fajesh gufon me Hir* në bot', lan shkelje,* dhe shëron dhe sëmundje tok,* dhe shpëton krejt sa* ngjalljen e tij po e kremtojn',* mbron krejt sa Analipsin e tij plot me lavd e nderojn'* me mall, dhe shpitrave tan' u jep përdëllimin e madh⁷ hyjnisht* me paqen¹⁶⁷ gjithmonë,* sepse është Perëndi që ka shumë mirësi.

Mes Hierores rrinte ai,* i papërshkruari Zot dhe Perëndi, sepse* njeri me trup, mish, për ne ishte bërë dhe na u shfaq,* sado, në natyrë, ishte Perëndi.* U nxirrte të gjithëve* fjalë, rrjedhje jetike fort,* publikisht thoshte:* Lani shpitrat, freskohuni* prej pasioneve* dhe prej vapës së tyre zjarr,* njerëz, nga pija le të mos privohet askush, aspak,* unë dhuroj Hir të hyjshëm, çdo gjë të mir' dhe pavdekësi;* njeriu me Hirin* do ket' lavd në mbre-

tëri tok me mua, Bërësin.

*Dhe 3 të Mujorit**Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV*

O Krisht, tani që jemi në mes të së kremtes së ngjalljes sate dhe të ardhjes së Shpirtit tënd të Shenjtë, pasi u mbloodhëm, i përhimnojmë misteret e çudive të tua; na dërgo në të përdëllimin tënd të madh.⁷

*Pasvargje të Oktoikut Ting. III**Kryqësor*

Një dru pabindjeje⁶⁶ nxori vdekje²¹ për botën, ndërsa druri i Kryqit, jetë dhe paprishje; prandaj të falemi ty, Zotit të kryqëzuar; le të shënohet mbi ne drita e fytyrës sate.¹⁷³

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht Shpëtimtar, u shpërbë pushteti i vdekjes dhe mashtrimi i djallit u shfuqizua. Dhe gjinia e njerëzve që shpëtohet me besë, himne përditë të blaton.*

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

E madhe është fuqia e Kryqit tënd, o Zot, sepse ai u mbërthye në një vend dhe vëpron në botë; dhe nga peshkatarët shfaq apostuj, dhe nga kombet martirë, që të ndërmjetojnë për shpitrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*
I Joan Monakut

Në mes të së kremtes, para pësimit dhe ngjalljes sate lavdiplote, o Zot, ishe në Hierore duke mësuar judenjtë e pabindur, Farisenjtë dhe Shkruesit dhe duke u thirrur: “Kush ka etje, le të vijë tek unë dhe le të pijë; atij që beson tek unë, do t’i rrjedhin nga barku lumenjtë e ujit⁸⁹ të jetës së Shpirtit Hyjnor”. O urtësi e parrefyeshme e mençurisë sate! O Perëndia ynë që i mbush të gjitha,¹⁷² lavdi më ty!



TË PREMTEN E JAVËS IV NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
 Ndenjësores të Oktoikut
 Ting. III*

Kryqësore Tin oreótita

Ti zgjodhe dhe pësim,* dhe vdekje, Kryqin tënd*²⁴ që ngule publikisht,* dhe mes Krijesës, Krisht,* kur deshe mirësisht që trupi yt, Shpëtimtar, të ngulej;* atëherë dielli* rrezet mbarë i fshehu mjaft*¹² dhe Kusari, kur i pa,* të pohoi si Perëndi* dhe thirri: “Më kujto, Zot!”; Parajsën* k’shtu e fitoi se besoi.¹⁶⁵

Ngjallësore E ngjashme

Nuk e kuptojmë dot* çudin’ e Kryqit tënd,* nuk e shpjegojmë dot* Ngjalljen e ndritëshme,* dhe i ditim besërisht* misteret e habitëshme.* Vdekja u përmbys përdhë* edhe Hadhi sot u plaçkit,* gjinia njerëzore pra,* me paprishjen tani u vesh.*¹⁴⁸ Të gjithë pra thërresim me zë të madh:* Nder dhe lavdi më ty, o Zoti Krisht.*

Martirike

Trimëria e rezistencës suaj fitoi mbi marifetet e armikut të keq që nga fillimi, o athloforë të tërëfamshëm, prandaj u vlerësuar për lumturinë e përjetshme; ndërmjetoni pranë Krishtit që ta shpëtojë grigjën e popullit krishtdashës, meqë jeni dëshmitarë të së vërtetës.

Kryqhyjlindësore

O Perëndilindëse, duke pasur si shkop fuqie¹⁷⁴ Kryqin e Birit tënd, i vithisim me të tërbimet e armiqve ne që me mallëngjim të madhështojmë pa pushim.

*Pas Stihologjisë së dytë,
 Ndenjësores e Mespentikostisë*

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Ti për botën gufon ujë jete plot,* uj’ urtie edhe gjithë ne na fton* të nxjerrim shpëtim si çurg;* çdo njeri që e merr, e mban hyjnorin ligjin tënd me të shuan krejt çdo qymyr* mashtrimi, nuk do ketë kurr’ etje në jetë pra,* nuk do ngopet kurrë me të, mbret qiellor, Zot;* prandaj e lëvdojmë mjaft* forcën edhe pushtetin tënd,* Krisht, dhe lypim* të na dërgosh* ndjesë pasurisht për çdo faj,* sepse na ke shërbëtorë,* o Shpëtimtar,* dhe te ti ne i kemi shpresat tona, o Perëndi. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I dyti i Mespentikostisë (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të Mespentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Mespentikostisë. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Mespentikostisë (2x).*

*Lavdërime të Oktoikut
 Ting. III*

Kryqësor

U shporra jashtë për shkak të xhelozisë,¹⁷⁵ ngaqë rashë frikshëm, mirëpo nuk më shpërfillë, o Zot, sepse e more për mua qenien time; kryqëzohesh dhe më shpëton, më fut në lavdi; o Çlirimtari im, lavdi më ty. (2x)

Ngjallësor

Ejani, gjithë kombet, njihni fuqinë e mistrit të frikshëm, se Krishti, Shpëtimtari ynë, Fjala e kryes,⁷² u kryqëzua për ne dhe, duke dashur,²⁴ u varros, dhe u ngjall së vdekurish, që t'i shpëtojë të gjitha; atij le t'i falemi.*

Martirik

O popuj, ejani të gjithë ta nderojmë kujtimin e athloforëve të shenjtë, se, pasi u bënë teatër për engjëj dhe njerëz,⁷³ morën prej Krishtit kurorën e fitores dhe ndërmjetojnë për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Në mes të së kremtes së Pashkës, u ngrite, o Shpëtimtari ynë, në Tempullin e Hierores; dhe, pasi qëndrove në mes të turmës, e mësoje haptas dhe thoshe: Unë jam drita e botës,⁵⁸ ai që vjen pas meje, nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës së pavdekshme.

*Pasvargje të Mespentikostisë**Ting. II Ikos tu Efrathá*

Fjalë, sado që je* me Perëndin' i tëri,*¹⁷⁶ me mua që po humb, ti* bashkohesh, njeridashës,* do që, nga çdo faj, të shpëtoj.

Varg: Kujtoje sinagogën tënde që e fitove nga fillimi.

Hija ka ikur,¹⁷⁷ ja* Mesia mes së Kremtes,* porsi një dritëprurës,* e ka shkëlqyer Hirin,* si Zoti ynë Perëndi.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Binduni, ejani* sa doni shumë të pini* nga pija jetësore* dhe pini⁸⁹ hir me mjaft gaz*,* thërriste Shpëtimtari im.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Le t'i pastrojmë bodrumet e mendimeve, të feksim llamburitje shpirtërore dhe ta shohim jetën, Krishtin,²⁶ kur arrin në Hierore, nga mirësia tejet e madhe, që të triumfojë kundër armikut¹⁷⁸ dhe ta shpëtojë gjininë tonë me anë të Kryqit dhe të ngjalljes. Atij le t'i thërrasim: O Zot i pakuftueshëm, lavdi më ty.



TË PREMTEN E JAVËS IV NË MBRËMËSORE

*Thirrtoje**Ting. I Ton uranion tagmaton*

Fjala Krisht, Zoti i përjetshëm me Atin shenjt, hyjnor* dhe Bërës i çdo gjëje*¹⁸ edhe dhënës i jetës,*¹⁷⁹ mori trup nga Virgjëresha, u bë,* duke dashur, njeri për ne;* urtin', mësimet e tij që nuk shprehen dot,* nxori si i mirë për krejt ne".

Në mes të festës që kishin judenjtë, shkove ti* mes Hierores, o Krisht* që je Zoti i Ligjit;* edhe me pushtet mësoje, Jisu,*¹⁸⁰ dhe, siç thot' Shkrimi, Shkruesit* i kritikoje; habiteshin me urtin',* fjalën tënde, shfaqje mrekullish.

Ai që jep urtësin'¹⁸¹ dhe të mirat edhe derdh* nga një burim i pafund* çurg hyjnor, po thërret fort:* Ejani tek unë, të eturit mbar',* që të merrni uj' jete ju;*⁸⁹ prej barkut tuaj do derdhen lumenj me hir,* plot karizma të hyjnueshme.

*Dhe 3 të Mujorit*Lavdi *Ting. I I Joan Monakut*

Arriti mesi i ditëve të Pentikostisë. Në të, pasi e zbuloi disi fuqinë hyjnore, Krishti e shëroi një paralitik dhe e ngriti me fjalë nga krevati; dhe, duke bërë çudi, siç i përshtatej Hyjnisë, në një trup balte⁸⁷ u dhuroi njerëzve jetën e amshuar⁵² dhe përdëllimin e madh.⁷

Tani *Hyjlindësorja Dogmatike*
Ting. III

Si të mos admirojmë lindjen tënde hyjnërore, o e Gjithënderuar? Se, pa njohur burrë, o e Gjithëkulluar, linde Bir pa Atë trupërisht atë që lindi prej Atit para jetëve pa nënë, i cili s'pësoi fare ndryshim, as përzjerje, as ndarje, por ruajti të plotë cilësinë e secilës natyrë. Prandaj, o Zonjë, Nënë Virgjëreshë, atij lutju që të shpëtohen shpirtat e atyre që me besim të drejtë të njohin si Hyjlindëse.*

*Pasvargje Ngjallësore***Ting. III*

Me anën e Kryqit tënd, o Krisht Shpëtimtar, u shpërbë pushteti i vdekjes dhe mashtrimi i djallit u shfuqizua. Dhe gjinia e njerëzve që shpëtohet me besë, himne përditë të blaton.

Varg: Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi. Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.

Undriçuan të gjitha me Ngjalljen tënde, o Zot. Parajsa u hap përsëri;⁷⁴ dhe tërë krijesa, duke të lavdëruar, himne përditë të blaton.

Varg: Sepse i dha fuqi botës e cila nuk do të lëkundet.

Lavdëroj fuqinë e Atit e të Birit dhe himnojnë pushtetin e Shpirtit të Shenjtë, Hyjninë e pandarë dhe të pakrijuar, Trininë e

bashkëqëndrueshme, që mbretëron në jetë të jetës.

Varg: Shtëpisë sate i ka hije shenjtërimi, o Zot, për ditë të gjata.

O Krisht, që errësive diellin me pësimin tënd¹² dhe ngazëllove gjithësinë me dritën e Ngjalljes sate, prit himnin tonë mbrëmësor, o Njeridashës.

Lavdi *dhe Tani Ting. I*

Ti, urtësia e Perëndisë,⁸⁸ shkove në Hierore në mes të së kremtes dhe i mësoje dhe i kritikojë judenjtë e pabindur, Fari-senjtë dhe Shkruesit, duke u thirrur atyre publikisht: "Ai që ka etje, le të vijë tek unë dhe le të pijë ujë të gjallë, dhe nuk do të ketë etje në jetë. Atij që beson në mirësinë time, do t'i rrjedhin prej barkut lumenj të jetës së përjetshme".⁸⁹ O sa simpati dhe dhembshuri ke, Krisht, Perëndia ynë! Lavdi më ty.

TË SHTUNËN E JAVËS IV
NË MËNGJESORE*Pas Stihologjisë së parë,**Ndenjësores Ngjallësore***Ting. III*

Krishti u ngjall së vdekurish, si i pari i të fjeturve,¹⁶ i parëlinduri i krijesës¹⁷ dhe Krijues i gjithë gjërave,¹⁸ përtëriti në veten e tij natyrën e prishur të gjinisë sonë. Nuk sundon më, o vdekje, se Zoti i të gjithave¹⁹ e dërrmoi pushtetin tënd.

Lavdi

Si shijove vdekjen trupërisht, o Zot, pushove hidhërimin e vdekjes²⁰ me Ngjalljen tënde, dhe e forcove njeriun kundër saj, duke shpallur disfatën e mallkimit

të vjetër.²¹ O Zot, mbrojtës i jetës sonë,²² lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore*

Ty që ndërmjetove për shpëtimin e gjinisë sonë, të përhimnojmë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, se, duke denjuar pësimin e Kryqit me trupin që mori prej teje, Biri yt dhe Perëndia ynë na çliroi prej prishjes si Njeridashës.

Pas Stihologjisë së dytë,

Ndenjësores e Mespentikostisë

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Kur qe mesi i festës Ligjore, Zot,* Çli-
rimtar, e mësoje turmën pa bes',* he-
brenjtë, në Tempull lart,* ua qortoje
mjaft marrëzin'* dhe i thërrisje, si njeri-
dashës, me zë hyjnor:* "Të vij' tek unë
kushdo që ka etje porsì zjarr* dhe të pijë";
ndaj u dhe besnikëve fjalë,* premtim, se
do jepje ti,* nga burimi yt pa cen, çurg*
urtësie;* të themi fort:* Na dërgo, o Krisht
Perëndi,* nga sipër të Tërëshenjtin,* pra
Shpirtin tënd,* dhe shpëtona sepse je
shumëpërdëllimtar. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Ka-
nunet: I pari i Mespentikostisë (tok me
Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas
Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe të
Mespentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i
Mespentikostisë. Në Oden IX, Më të nde
ruarën. Dërgimësorja e Mespentikostisë
(2x).*

*Lavdërime Ngjallësore**

Ting. III

Ejani, gjithë kombet, njihni fuqinë e mis-
terit të frikshëm, se Krishti, Shpëtimtari
ynë, Fjala e kryes,⁷² u kryqëzua për ne
dhe, duke dashur,²⁴ u varros, dhe u ngjall
së vdekurish, që t'i shpëtojë të gjitha; atij

le t'i falemi.

I rrëfyer gjithë çuditë e tua ruajtësit e
tu, o Zot, po këshilli i kotësisë, si mbushi
me dhurata të djathtën e tyre, pandehte
se fshihte Ngjalljen tënde⁷⁶ që e lavdëron
bota; mëshirona.

Të gjitha u mbushën me gëzim kur morën
lajmin e Ngjalljes. Maria Magdalena erdhi
në varr, gjeti një engjëll që rrinte mbi gur,
që i shkëlqenin rrobat dhe i tha: Si kër-
koni të gjallin ndër të vdekurit? S'është
këtu, por u ngrit siç tha, dhe ju pret në
Galile.⁶³

Në dritën tënde, o Zot, do të shikojmë
dritë, o Njeridashës, që u ngjalle së vde-
kurish, duke i dhuruar shpëtim gjinisë së
njerëzve, që të të lavdërojnë tërë krijesa
ty, të vetmin të pamëkatshëm; mëshiro-
na.

Lavdi dhe Tani *Ting. IV I Anatolit*

Pasi u ndriçua, o vëllezër, me anë të
ngjalljes së Krishtit Shpëtimtar dhe arri-
tëm në mes të së kremtes zotërore,
le t'i ruajmë me sinqeritet porosinë e
Perëndisë, që të bëhemi të denjë për ta
kremtuar dhe festën e Analipsit, dhe të
arrijmë në zbritjen e Shpirtit të Shenjtë.

Pasvargje të Mespentikostisë

Ting. II Ikos tu Efrathá

Nxjerr pije shpirtërisht* burimi yt, urti-
në,* ndërsa ne pimë prej tij,* plot mbu-
shemi me dogma* të perëndishme, Shpë-
timtar.

Varg: Kujtoje sinagogën tënde që e fitove
nga fillimi.

Populli hebraik* vërtet i frikshëm, Fjalë,*
plagosej kur dëgjonte* që jepje mësim-
dhënie* shpëtuese ndaj turmave.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Shkove ti në Sion,* Gatues, dhe qëndroje* mes popullit tënd, Fjalë,* dhe popujve u jepje,* o Krisht, hir shpëtimtar të madh.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. IV*

O Zot, para pësimit tënd të pacen, në mes të së kremtes, u ngjite në Hierore dhe u mësoje haptazi judenjve Ligjin e Moisiut, të cilin e urdhërove ti, Ligjvënësi; mirëpo ata, të habitur për misterin e parrëfyeshëm të urtësisë sate, mendojnë me smirë komplotin kundër teje, duke u çuditur se “Si i di shkronjat ai përderisa nuk i ka studiuar?”. Nuk të njihnin ty, Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.

CITIME

Shërimi i të paralizuarit: Joan 5.1-16
Mesentikostia: Joan 7.14-24

1. Dan. kap. 3 Lutja e Azaria 11
2. Lluk. 1.26-28
3. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
4. Mark. 5.25-34; Lluk. 8.43-48
5. Matth. 15.22-28
6. Matth. 8.5-13; Lluk. 7.2-10
7. Num. 14.19 etj.
8. Jez. 44.1-4
9. Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
10. Mal. 4.2 (3.20)
11. Gen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak. 17.3
12. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
13. Ps. 95(96).11
14. Lluk. 1.51
15. Kol. 1.18
16. I Kor. 15.20; Kol. 1.18
17. Kol. 1.15
18. Joan 1.3; Rom. 11.36
19. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
20. I Mbret. [Sam.] 15.32
21. Gjen. 3.16-19
22. Ps. 26(27).1
23. Hebr. 2.17
24. Joan 10.15,17-18
25. I Kor. 15.53
26. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
27. Eks. 14.21-15.1 etj.

28. Ef. 5.26
29. Matth. 20.19; Mark 9.31; 10.34; Lluk. 18.33
30. I Mbret. [Sam.] 2.1-2
31. Matth. 27.51
32. Matth. 27.52
33. I Petr. 3.19; 4.6
34. Is. 6.3
35. Kënga 1.8; 5.9,17(6.1)
36. Abak. 3.3
37. Matth. 27.18; Mark 15.10
38. Kënga 1.3
39. Matth. 28.1-6; Mark 16.5-6
40. Fil. 2.7
41. I Petr. 3.21
42. Tov. 12.12
43. II Mbret. [Sam.] 6.2; 22.11; IV [II] Mbret. 19.15; Ps. 17(18).11; 79(80).2; 98(99).1
44. Is. 26.9
45. Matth. 28.16-17 etj.
46. I Petr. 3.19; 4.6
47. Jona 1.4; 2.7-11
48. Is. 14.9
49. Matth. 28.17; Lluk. 24.52
50. I Tim. 3.16
51. Ps. 94(95).4
52. Mark 10.30; Joan 6.27; 10.28; 17.2
53. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
54. Ps. 148.4
55. Matth. 27.51; Mark 15.38; Lluk. 23.45
56. Is. 8.1
57. Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
58. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
59. Eks. 3.2-5; Ligji i Dytë 33.16
60. Dan. 2.34-35
61. Is. 11.1,10
62. Ps. 18(19).5
63. Matth. 28.1-11; Mark 16.1-10; Lluk. 23.56-24.10; Joan 20.1-18
64. I Joan 1.5
65. Gjen. 3.1-5,13-15; II Kor. 11.3; Apok. 12.9,14-15; 20.2
66. Gjen. 3.2-6
67. Ps. 50(51).3; 68(69).17
68. II Kor. 8.9
69. Vep. 10.38
70. Ef. 5.19; Kol. 3.16
71. Ps. 43(44).22; Fja. Urt. 24.12
72. Joan 1.1
73. I Kor. 4.9
74. Gjen. 3.24
75. Matth. 14.30-31
76. Matth. 28.11-13
77. Matth. 26.75; Lluk. 22.61-62
78. Lluk. 18.13
79. Lluk. 7.37-38
80. II Tim. 2.3
81. Est. 4.17b
82. Tov. 13.15 etj.

83. Ps. 96(97).8
84. Is. 4.4
85. Joel 3.1(2.28)
86. Joan 14.16-17,26; 15.26; 16.7
87. II Kor. 4.7
88. I Kor. 1.24
89. Joan 7.37-38
90. Joan 8.12
- 90a. I Kor. 1.24
91. Eks. 17.8-13
92. I Kor. 1.30
93. Ps. 77(78).54
94. Joan 2.1-10; 4.46
95. Eks. 7.17-20
96. Joan 4.5-14
97. Matth. 14.19-21; Mark 6.41-44; 8.19-20; Lluk. 9.16-17; Joan 6.11-13
98. Joan 6.35; 7.37; Apok. 21.6
99. Joan 10.28; 17.2; I Joan 5.11
100. Est. 4.17 ff
101. Ps. 17(18).2
102. I Mbret. [Sam.] 2.1
103. Ligji i Dytë 18.15
104. Joan 1.42; 4.25
105. I Tim. 3.16
106. Joan 5.36-38; 6.57; 8.42; 10.36; 11.42; 17.3,8,18,21,25; 20.21
107. Abak. 3.11
108. Ps. 15(16).11
109. Apok. 1.8; 21.6; 22.13
110. Lluk. 24.49
111. Abak. 3.3
112. Matth. 22.29
113. Joan 10.32
114. Vep. 26.18
115. Is. 26.12-13
116. Joan 6.53-58
- 116a. Ps. 135(136).25
117. Jona 2.10
118. Joan 19.34
119. Jona 2.1-7
120. Joan 4.34; 5.36; 17.4
121. Matth. 11.5; Lluk. 7.22
122. Lluk. 24.49
123. Lluk. 2.46
124. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 30
125. Ps. 45(46).5
126. Lluk. 1.28
127. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
128. Joan 4.29
129. Joan 15.26
130. Matth. 9.20-22; Mark 5.25-29; Lluk. 8.43-44
131. Matth. 14.25; Mark 6.48
132. Matth. 28.19
133. Dan. 6.22
134. Ps. 102(103).22; Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
135. Gjen. 49.10
136. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 36
137. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 35
138. Urt. Sol. 9.10; Jer. 17.12; Matth. 19.28; 25.31
139. Apok. 4.8
140. Matth. 3.11 etj.
141. I Joan 5.10-11
142. Vep. 7.36 etj.
143. Ps. 2.1
144. Zah. 9.16; Dan. 2.34-35,44-45
145. Is. 28.16; Ef. 2.20; I Petr. 2.6
146. Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19; Ef. 2.17-18
147. II Kor. 5.17
148. Hebr. 3.14
149. I Petr. 3.18
150. Lluk. 1.48
151. Vep. 4.22 etj.
152. Joan 14.12
153. Matth. 12.10-13; Mark 3.1-5; Lluk. 6.6-10
154. Matth. 3.8; Lluk. 3.8
155. Ps. 88(89).8
156. Hebr. 1.3
157. Matth. 12.8; Mark 2.28
158. Jer. 45(38).6
159. Matth. 27.40; Mark 15.29
- 159a. Joan 11.26
160. Mark 2.7; Lluk. 5.21
161. II Tim. 4.7
162. Ps. 73(74).12
163. Ligji i Dytë 28.66
164. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
165. Lluk. 23.39-43
166. I Kor. 12.9,28,30
167. Joan 14.27
168. Ef. 6.11,13
169. Tit. 1.2; 3.7
170. Matth. 10.8
171. Fil. 2.15
172. Ef. 1.23
173. Ps. 4.7
174. Ps. 109(110).2
175. Urt. Sol. 2.24
176. Joan 14.10
177. Hebr. 8.5; 10.1
178. Kol. 2.15
179. Joan 10.28
180. Matth. 7.29; Mark 1.22; Lluk. 4.32
181. Lluk. 21.14-15; Jak. 1.5





E DIELA E SAMARITANES

TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL

Thirrtore Ngjallësore Ting. IV

Duke iu falur Kryqit tënd...

Mallkimin e drurit të mosbindjes...

I dërmove dyert e Hadhit...

Ejani të përhimnojme, o popuj...

Lavdi *i Samaritanes*

Ting. Tërth. III

Pasi e gjeti Samaritanen afër pusit tënd...
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 115*)

Tani *Hyllindësore Dogmatike*
Ting. IV

Pa farë e nxure dhe pashprehshëm e kishe në mitër atë që i përmbysi të fuqishmit prej froneve dhe i lartëson të përulurit¹ dhe e ngre bririn e shpresëtarëve² të tij, që e lavdërojnë Kryqin, varrimin dhe ngjalljen e lavdishme të Krishtit; prandaj ty, Perëndilindësen, shkak të mirash aq të shumta, të lumërojmë pa pushim me

ode, sepse ndërmjeton përherë të shpëtojnë shpirtrat tanë.

Pasvargje Ting. IV *Ngjallësor*

O Zot, duke u ngjitur në Kryq, shove mallkimin tonë stërgjyshëror dhe, duke zbritur në Skëterrë, çlirove robërit ndër shekuj dhe i dhurove gjinisë së njerëzve paprishjen. Prandaj, duke himnuar, lavdërojmë Ngjalljen tënde jetëbërëse dhe shpëtimtare.*

Të Hyllindëses O eks ipsistu klithis
Varg: Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Biri pa kohë i Atit pa kohë, megjithëse është Perëndi, nga bashkëzbritja dhe për shpëtim vdekatarësh u bë njeri që t'ia japë të parëgatuarit tani Parajsën dhe njëkohësisht ta çlirojë natyrën e tërë nga mashtrimi i gjarprit³ dhe ta shpëtojë ikonën⁴ e rënë, si i pajtueshëm; prandaj e bëri nënë të Dëlirën e panjollshme nuse-lindëse, që e kemi të gjithë si spirancë të shpirtrave tanë.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

O e hyjlumtur, mitra jote e kishte të trupëzuar Krijuesin e të gjithave,⁵ i cili e riformonte njeriun e rënë më parë nga shkelja përmes gjarprit;³ se e linde në mish pashprehshëm Perëndinë tonë dhe e çlirove nga prishja me Birin tënd tërë natyrën tonë të vjetërsuar; pra, e himnojmë dhe e lavdërojmë hirin tënd, o Virgjëreshë e panusëruar, duke u përgjerruar të çlirohemi me anën tënde prej çdo ndëshkimi.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Që të na e zbulosh neve mbarë shumicën e mëshirës sate⁶ dhe oqeanin pa fund të mirësisë sate, shlyej të gjithë mëkatet e shërbëtorëve të tu, meqë, o e Tërëpaqortueshme, e Tërëlumëruar, e ke, si nënë e Perëndisë, pushtetin e Krijesës dhe me fuqinë tënde i realizon të gjitha siç do; sepse, duke banuar qartësisht në ty, Hiri i Shpirtit të Shenjtë bashkëpunon me ty në çdo gjë përgjithnjë.

Lavdi *i Samaritanes*

Ting. Tërth. IV

Kur u duke mbi dhë, o Krisht Perëndi...

(fq. 116)

Tani *i Mespentikostisë*

Injëti

Judenjtë thoshin kur i mësoje... (fq. 116)

Përlëshoret

Ngjallësore (Lëçitjen gazmore...) dhe e *Mespentikostisë* (Në mes të së kremtes...)

NË MBRËMËSOREN E MADHE

10 Thirrto: 4 Ngjallësore, 3 të Mespentikostisë dhe 3 të Samaritanes

Ngjallësore Ting. IV

Duke iu falur Kryqit tënd...

Mallkimin e drurit të mosbindjes...

I dërrmove dyert e Hadhit...

Ejani të përhimnojmë, o popuj...

Të Mespentikostisë I njëti

Kirie anelthón en to stavró

Ndodhemi* tash në mes të ditëve* që fillojn' prej shpëtimtares ngjallje dhe kan' si fund* e vulë Pentikostinë* e hyjshme; dita feks me drit' prej dy palëve,* i bashkon drejt dy festat tok,* parashfaq se do vijë* lavdi i Analipsit të Zotit Krisht* dhe krenohet mjaft,* dhe shkëlqen një gaz të madh kudo.

Mori vesh* dhe dëfren Sioni mjaft;*⁷ u ungjillëzua ngjallja e Zotit ton' në të;* bijt' e saj besimtarë* gëzonin kur e shikonin Krishtin që në Shpirt* vrasjen e vet të censhme krejt* po e lante,⁸ ndaj ka gaz* dhe në mes të dy festave po kërcen,* bën një panair,* hijesohet bukur, ka lavdi.

Po afron,* siç u shkrua, derdhja boll* e Hyjnorit Shpirt përmbi të gjithë,⁹ e shpall këtë* dhe mesi tashmë i kohës* pas vdekjes edhe varrimit si dhe ngjalljes tok,* pas premtimit autentik* që u dha Krishti, Zoti,* mbarë Nxënësve edhe kështu shfaqet* ardhja midis nesh* e Ngu-shëllimtarit Perëndi.¹⁰

Të Samaritanes Idhiomele

Ting. I

Burimi i mrekullive arriti te burimi në orën e gjashtë, që të merrte një fryt të Evës për ta shpëtuar, sepse në këtë orë



Eva doli nga Parajsa¹¹ nga mashtrimi i gjarpërit.³ U afrua pra Samaritania që të nxirrte ujë. Kur e pa, Shpëtimtari i tha: “Më jep pak ujë për të pirë dhe unë do të të mbush me ujë që hidhet përpjetë”. Si shkoi me vrap në qytet, e mençura lajmëroi turmat sakaq: Ejani të shihni Zotin Krisht, Shpëtimtarin e shpirtëve tanë.

Ting. II

Samaritania e pyeti Zotin e dhembshur, i tha Zotit kur ai vajti te pusi: “Ma jep ujin e besës, që t’i marr rrjedhat e kolimvithrës, ngazëllim dhe çlirim”. O Krisht jetëdhënës, lavdi më ty.

Injëjti

Biri i bashkëpafillim dhe i bashkëpërrjetshëm dhe Fjala e Atit, burimi i shërimëve, shkoi te burimi. Dhe një grua nga Samaria arriti që të nxirrte ujë. Kur e pa, Shpëtimtari i tha: “Më jep ujë të pi dhe ik, thirrë burrin tënd”. Dhe ajo, duke biseduar si me një njeri dhe jo me Perëndinë, u përpoq të fshihej dhe i tha: “Nuk kam burrë”. Dhe Mësuesi i tha asaj: “Të vërtetën the se nuk ke burrë, sepse kishe pesë dhe ai që ke tani nuk është burri yt”. Dhe, duke u çuditur prej fjalës, ajo vrapoi për në qytet dhe u thërriste turmave: Ejani të shihni Krishtin që i dhuron botës përdëllimin e madh.¹²

Lavdi Ting. Tërth. II

Pasi e gjeti Samaritanen afër pusit të Jakovit, Jisui i kërkoi ujë, ai që e mbulon tokën me re. O çudi! Ai që rri mbi Keruimet,¹³ bisedon me një lavire dhe i kërkon ujë ai që e vari dheun mbi ujërat;¹⁴ i kërkon ujë ai që derdh burime dhe liqene ujërash. E bën sepse do me të vërtetë ta tërheqë atë që kapet si gjah prej armikut kundërshtar dhe ta vaditë me ujin e jetës atë që flakërohet dhimbshëm në gjëra të

pavenda, si i vetmi i dhembshur dhe njeri-dashës.

Tani Hyjlindësore Dogmatike Ting. IV

Profeti David, që u bë hyjprind me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të madhështoi.¹⁵ Qëndroi mbretëresha në të djathtë tënde.¹⁶ Se ty, Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë shkaktare jete që të gatojë përsëri ikonën e tij⁴ të prishur prej pasioneve. Dhe, duke gjetur delen e arratisur nëpër male, ta marrë mbi supe¹⁷ e t’ia shpjerë Atit.¹⁸ Dhe me dëshirën e tij, ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh¹² e të pasur.*

Në Liti Idhiomeli i shenjtit të kishës

Lavdi dhe Tani Ting. III

Qielli dhe dheu le të ngazëllohen sot hijshëm, sepse Krishti u shfaq i trupëzuar si njeri për ta nxjerrë nga mallkimi Adamin¹⁹ me tërë gjininë e tij. Dhe admirohet me anë të çudive kur arrin në Samari dhe qëndron pranë një gruaje, dhe i kërkon ujë ai që rrethohet nga retë. Ndaj, të gjithë ne besëmirët le t’i falemi atij që u varfërua²⁰ me vullnet të dhembshur.

Pasvarg Ngjallësor Ting. IV

O Zot, duke u ngjitur në Kryq, shove mallkimin tonë stërgjyshëror¹⁹ dhe, duke zbritur në Skëterrë,²¹ çlirove robërit ndër shekuj dhe i dhurove gjinisë së njerëzve paprishjen. Prandaj, duke himnuar, lavdërojmë Ngjalljen tënde jetëbërëse dhe shpëtimtare.*

Dhe ato të Pashkës (fq. 7)

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

Kur u duke mbi dhé, o Krisht Perëndi, me anë të Ekonomisë së parrëfyeshme, Samaritania e dëgjoi fjalën tënde njeri-dashëse, ndaj e la kovën te pusi dhe rendi dhe u tha atyre që ishin në qytet: Ejani të shihni një zemërnjohës; mos vallë është Krishti që presim, ai që ka përdëllimin e madh?¹²

Tani *Injëti*

Judenjtë thoshin kur i mësoje në mes të së kremtes: “Si i di shkronjat pa mësuar ai?”, se nuk e dinin që ti je urtësia²² që bëri botën;²³ lavdi më ty.

Përlëshore Ngjallësore

Lëçitjen gazmore të Ngjalljes kur mësuan prej engjëllit, nxënëset e Zotit²⁴ dhe hodhën dënimin prindëror, duke u mburrur²⁵ u thoshin apostujve: U kusarua vdekja, u ngrit Krishti Perëndi dhe i dhuroi botës përdëllimin e madh.*

*E Mespentikostisë*Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Në mes të së kremtes, vadite me rrjedhat e shpresëtarisë shpirtin tim të etur, sepse u thirre të gjithëve, o Shpëtimtar: “Ai që ka etje, le të vijë tek unë dhe të pijë”.²⁶ O burim i jetës, Krisht Perëndi, lavdi më ty.



NË MËNGJESORE

[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kanunin Triadik).]

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësoe Ngjallësore**

Ting. IV

Duke parë hyrjen e varrit dhe duke mos duruar flakën e engjëllit, miropurueset çuditëshin²⁴ me tmerr duke thënë: Mos u vodh vallë²⁷ ai që i çeli kusarit Parajsën?²⁸ Mos u ngjall vallë ai që lëçiti Ngjalljen dhe para pësimit?²⁹ Me të vërtetë u ngjall Krishti Perëndi, dhe u fali atyre që ishin në Hadh jetën dhe ngjalljen.

Lavdi *Tahi prokatálave*

U ngjalle si i Pavdekshëm* prej Skëterrës, o Shpëtimtar,* dhe botën tënde ngjalle* bashk’ me Ngjalljen tënde mbi dhé,* o Krisht, Perëndia yn’;* theve me forcën tënde* gjith’ pushtetin e vdekjes,* shfaqe, o Përdëllyes,* te gjith’ njerëzit Ngjalljen.* Prandaj të lavdërojmë sot* ty, Njeridashësin.

Hyjlindësore Ngjallësore

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëj,³⁰ u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier, dhe denjoi kryq për ne duke dashur,³¹ me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtat tanë.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoe Ngjallësore***Ting. IV**Kateplaji Josif*

Ja së larti zbriti sot* engjëll’ i shenjtë Gabriel,* dhe si ndenji përmbi gur,* atje mbi gurin jetësor,* dhe u thërriste atyre që po qanin:* Pushojeni, o gra,* klithmën tuaj plot vajtim,* edhe pse ndieni tani* mjaft keqardhje për të;* po kini, o gra, kurajë* se ai që kërkon, u ngjall vërtet.* Prandaj thërrisni* të gjith’ apostujt,* se Zoti u ngjall prej së vdekurish.²⁴

Lavdi

Deshe vetë, Shpëtimtar,* edhe durove kryq për ne,*³¹ edhe në një varr të ri,* njerëz të vunë si njeri,*³² ty që me fjalë themelove anët e dheut.*³³ Prandaj u zu si rob* vdekja, e huaj për të gjith',* edhe tmerrësisht* u plaçkit edhe u vodh,* si dhe të gjith' në Hadh i thërrisnin* Ngjalljes sate jetëprurëse.* Se Zoti Krishtu ngjall,* Jetëprurësi* që mbetet përjetë.

Tani *Hyllindësore*

Josifi u çudit,³⁴ që përmbi natyrën kur pa, dhe at'herë merrte vesh k'të shiun përmbi lëmsh³⁵ në zënien tënde të pafarshme, o Hyllindëse, ferrën që në zjarr ish e padjegshme,³⁶ shkopin e Aaronit që zu rrënj' e lulëzoj,³⁷ i fejuari yt ruajtës dëshmoj e u thërriste prift'rinjve: Virgjëresha lind dhe pas lindjes mbetet prapë e virgjër.*

I Paqortueshmi (Psalmi 118), Bekimtoret etj.

Kanunet: I Pashkës (tok me Irmoset) në 4, i Hyllindësës në 2, i dyti i Mespentikostisë në 4 dhe i Samaritanes në 4.

Ode I

Kanuni i Hyllindësës

Tingulli dhe Irmoset e njëjta

Ke shkaktuar pështjellim në kushte vdekjeje ti,* Zonjë, meqë në bark kishe Krishtin, të përherëshmen jet',* që na lindi sot nga varri dhe shndriti fort,* e Virgjër pa cen aspak,* botën tonë, planetin mbar'.

E pe Perëndinë, Birin tënd të ngjallur, prandaj* gëzohu me apostujt, o e hyj-hirshme e dëlir';* ti e para prite pra "Gëzohu"-n sepse,* Hyllindëse pa qortim,* i shkaktove hare botës.

Kanuni i dytë i Mespentikostisë (fq. 94)

Kanuni i Samaritanes që ka Akrostihidhë në

Oden IX: "Josif".

Poezi e Josifit të Selanikut.

Ting. IV

O pataksas Éjpton

[*Irmosi*: »**E** godite fort Egjiptin dhe në »det tiranin Faraon e zhyte thellë,* prej »skllavëris' çlirove një komb,* ndaj ode »triumfi po këndonte sipas Moisiut, se »kishe lavd.^{38]}

Fisin njerëzor e ngriti tok me veten Krishti i varrosur dhe i ngjallur,* ndaj të gëzohet çdo krijesë,* lëshofshin mendoret re sot mjaft qartësisht drejtësi lart nga qielli.³⁹

Si durove Kryq në trup vullnetarisht,³¹ u ngjalle pas tri ditësh nga varrimi,* pra nga të vdekurit; dhe arkat* e Hadhit i zbrazë, jetëdhënës, i nxore dhe shpirtat nga prangat, Zot.

Kur e panë engjëjllin me pamje të ndriçuar, miropurëset me frikë*²⁴ nga varri u larguan dhe, si* e morën vesh ngjalljen e Krisht Zotit, njoftuan shën Nxënësit me nxitim.

Zot që i strehon të lartat me uj',⁴⁰ ujë jete je, prandaj ia dhe ti rrjedhjen* e çmuar krejt Samaritanes* që njohu qart' dhembshurinë tënde, edhe e kërkoi pa hezitim.

Lavdi *Triadik*

Atë, Bir dhe Shpirt, shpëtoji sa të lavdërojnë sinqerisht me bes' dhe qartë* si Bërës botëror të sferës,* Triadhë; dhurona, si i mbimirë, ndjesë mëkatesh dhe përdëllim.

Tani *Hyllindësor*

Ki gaz, fron i zjarrtë;⁴¹ ki gaz, llambë e

tër'artë;⁴² ki gaz, re e ndritshme;⁴³ ki gaz,* pallat i Fjalës dhe tryezë* mendore;⁴⁴ ti Krishtin, si buk' jete⁴⁵ e mbajte në prehrin tënd denjësisht.

Zbritësore: Anastáseos imera

Ditë e Ngjalljes.

Ode III

I Hyllindësës

Kthehem sot te jeta e pacen,* Zonjë, me mirësi nga ai që linde ti* dhe shndriti gaz me shkëlqim* në skajet e botës, dha shpëtim* dhe hir, e Dëlrë fort.

Ti, o e Dëlrë, të kërcesh,* se e mbajte në bark Zotin me mish dhe e pe* të ngjallur prej varrit ti* sikurse kish thën',^{45a} o e pacen,* si Zot madhështojë pra.

I Mespentikostisë (fq. 95)

I Samaritanes

Estereothi i kardhia mu

[*Irmosi*: »Në Zot m'u përforcua zemra, »se e përmbush plot* çdo dëshir' të njeriut »që i lutet,* se u dobësua harku mjaft i »fort'* dhe të dobësuarit janë ngjeshur »me shumë forc'.⁴⁶]

Vullnetarisht u ngrite lart përmbi dru, o Fjalë,*³¹ edhe çaheshin gurët kur të shihnin;* tundej dhe Krijesa mbarë,⁴⁷ o Krisht Zot,* si prej gjumit ngriheshin lart nga varret të vdekurit.⁴⁸

Kur shkove, Fjalë, drejtas Hadhit me shpirt, të panë*²¹ shpirtrat mbar' të të drejtëve dhe psalnin,* e himnonin forcën tënde mbi mendim,* të çliruar nga të përjetshmet pranga, o Zoti Krisht.

«Përse habiteni? Kërkoni në varr me miro,* o gra, Zotin? U ngrit dhe tok e ngriti* botën krejt», u tha një engjëll plot shkëlqim* grave miropurësese, dhe kë-

to u gëzuan fort.²⁴

Meqë je jetë⁴⁹ dhe buron ti pavdekësi, Zot,* te burimi që ulur, o i dhembshur,* me rrjedhimin tënd të urtë krejt, u mbush* një Samaritane, siç lypi, ndaj të himnonte ty.

Lavdi Triadik

Një Perëndi Zot mbi çdo gjë, trinisor, himnohet,* Ati, Biri dhe Shpirti Shenjt, atë pra* batalionet qiellore lart me tmerr* e lëvdojnë dhe fort thërrasin: Shenjt, shenjt, shenjt⁵⁰ je në jet'.

Tani Hyllindësor

Në barkun tënd, e Virgjra nën', pa shpjegim e nxure* Perëndinë dhe Zotin e çdo gjëje* dhe e linde përmbi fjalë dhe mendim,* o Hyjnuse, mbete e virgjër si para lindjes ti.

Zbritësore: Dhefte poma piomen

Eni të pimë.

Kontaqi i Mespentikostisë

Ting. IV O ipsothis en to stavró

Kur ishte mesi i* së kremtes Ligjore,* u thoshe, Bërës i* çdokujt,⁵ Perëndi, Zot,* atyre pra që ndodheshin: Ju ejani bri,* merrni uj',²⁶ pavdekësi". Me bes'* para teje ne biem tash* dhe thërrasim bashkërisht:* Na dhuro, Krisht, të mirat,* mëshirat që ke se ti je për ne* si dhe për botën* burimi i jetës son'.

Ndenjësores e Samaritanes E ngjashme

O qiell, ki gëzim;* kërceni, të dheshme,* se Krishti si njeri* u shfaq nga e Virgjra* dhe e çliroi tërë njerëzinë përmes* vetë vdekjes dhe, kur shndriti fort* me çudi, si i vetmi Zot* i pavdekshëm pra, i dha* gruas Samaritane* burimin e shërimeve, pasi* kishte kërkuar* ai ujë nga ajo.

Lavdi *dhe* Tani *E Mespentikostisë*

E ngjashme

Kur erdhi festa pra* ligjore, o Krisht, Zot* i urtësis', që ti* na jep, ishe ulur* në Hierore dhe, duke u dhënë mësim* mbarë njerëzve, u thoshe k'shtu*: O të etur mjaft, ejani,* pini²⁶ tash nga çurgu im,* me këtë do shijoni* gjith' ju, o njerëz, një shijim unik* si dhe një jetë* hyjnore përjetësisht.

Ode IV

I Hyjlindësës

Oe Dëlrë, ai që gatoi Adamin,^{50a} stëratin tënd, u gatua prej teje dhe, me vdekjen e vet, e shpërbëri sot vdekjen e shkaktuar nga ai⁴⁹ dhe i ndriçoi të gjithë fuqishëm me llamburitjet hyjnore të ngjalljes.

Oe Dëlrë, e bukur, e hijshme dhe e paqortueshme mes grave,^{50b} duke parë Krishtin që linde, që shndrinte tepër bukur nga të vdekurit për shpëtimin e të gjithëve, e lavdëroje me gëzim bashkë me apostujt.

I Mespentikostisë (fq. 96)

I Samaritanes

Isakikoa Kirie

[*Irmosi*: »**E** dëgjova dëgjimin tënd dhe »u tmerrova, edhe u shtanga* kur i njo- »ha dhe kuptova veprat e tua,* se nga »himnimi yt toka mbushet komplet.^{51]}

Qiejt le të dëfrejnë, Krijesa e tërë le të kremtojë: U ngrit Zoti dhe iu shfaq gjithë apostujve të tij⁵² të urtë.

U gropos pushteti yt, o vdekje, kur vdiq Krishti; me ngritjen e tij, të vdekurit dolën nga varret⁴⁸ si nga dhoma nusërore.

Engjëlli u tha miropurëseve: Pse qani, o gra? Pse e kërkoni me miro të Pavdek-

shmin? U ngrit siç tha.²⁴

O Zot, Samaritanes që të kërkoi ujë, i dhe si ujë njohjen e pushtetit tënd, ndaj nuk ka etje në jetë dhe të përhimnon.

Lavdi *Triadik*

O Trini përmbiesenciale, Atë, Fjalë dhe Shpirt Hyjnor, e njëfuqishme, e bashkëpanisshme, shpëtona të gjithë ne që të përhimnojmë besërisht.

Tani *Hyjlindësor*

Ligjvënësi të shikonte qëmoti si ferrë të padjegshme,³⁶ ndërsa Danieli të kuptonte si mal⁵³ të shenjtë, o Zonjë, e vetmja nënë-virgjëreshë.

Zbritësore: Epi tis thias filakis

Le të qëndrojë me ne.

Ode V

I Hyjlindësës

Mbledhja e shpresëplotëve ndriçohet me rrezet hyjnore dhe jetëprurëse të ngjalljes së Birit tënd dhe mbushet me ngazëllim, o Hyjnënë e pacenshme.

O mbret i Krijesës, kur u mishërove, nuk i hape portat e Virgjëreshës, nuk i prishe vulat e varrit, ndaj u gëzua kur të pa të ngjallur.

I Mespentikostisë (fq. 97)

I Samaritanes

Anátílón mi Kirie

[*Irmosi*: »**M**a lind, si diell, dritën pra »të urdhreve të tu, o Zot,* se shpirti im »mëngon për ty⁵⁴ dhe të himnon, se Pe- »rëndi ti* je për ne, prandaj te ti,* mbret »i paqes,⁵⁵ Krishti im,* kam përikur, Çli- rimtar.]

Sapo arritën në varrin tënd të shenjtë në agim, miropurëset panë një të ri që

shkëlqente dhe u habitën kur morën vesh për ngritjen tënde hyjnore, o Krisht.²⁴

Vdekja u vra, Hadhi u skllavërua dhe të prangosurit u çliruan nëpërmjet ngjalljes së Krishtit. Le të ngazëllohemi dhe le të duartrokasim duke kremtuar hijesisht.

Kërceni, o apostuj; hidhuni përpjetë, o engjëj; ngazëllohuni, gjithë ju të dhe-lindurit; Zoti u ngjall, prishja u dëbua, trishtimi pushoi dhe Adami kërcen.

Përderisa je burimi i jetës, o Zot, i dhe gruas Samaritane ujin e ndjesës dhe të dijenisë kur ta kërkoi atëherë, prandaj i përhimnojmë dhembshuritë e tua të parrëfyeshme.

Lavdi *Triadik*

Adhurojmë Një Perëndi të pandashëm në natyrë, Bërësin dhe Zotin e Gjithësisë, Njësi trihipostate, Triadhë të bashkëqenshme, Atin, Fjalën dhe Shpirtin e Shenjtë.

Tani *Hyjlindësor*

O e dëlirë, të quajmë portë të pashkelur,⁵⁶ vend të pakultivuar, arkë⁵⁷ që mban manën, shtambë,⁵⁸ llambë⁴² dhe temjanicë⁵⁹ të qymyrit jolëndor.

Zbritësore: Orthrisomen orthru vatheos

Le të mëngojmë qëmenatë.

Ode VI
I Hyjlindësës

Ai që u kap lashtë prej vdekjes dhe prishjes, u lirua me anë të atij që u mishërua prej barkut tënd të pacen dhe u udhëzua për te jeta e paprishshme dhe e amshuar, o Perëndilindëse e virgjër.

Ai që zbriti dhe banoi në mitrën tënde, dhe u mishërua përmbi mend, zbriti në

më të poshtmet e tokës,²¹ o e Dëlirë, dhe, kur u ngjall prej varrit, e ngriti Adamin me veten e tij.

I Mespentikostisë (fq. 98)

I Samaritanes

Mi katapontisato me

[Irmosi: »Mos më përpift' një fund i »madh,* mos më zhyst' një stuhi* me »shumë ujë,⁶⁰ se u hodha tmerr* dhe »thellë në zemër deti, në fajet e mia; të »thërras pra* porsi shën Jonai: Të ngjitet »lart* dhe drejt teje jeta ime nga prishja, »o Zot, Perëndia im.⁶¹]

Mbi Kryq, Jisu, të ngulën ty* të paligjshmit; me shtiz',* të shpuan, Krisht,⁶² por të varrosi ty* bujari Josif, shenjtori, të vu-ri në varr të ri,³² Shpëtues;* me plot lavd u ngjalle prej tij, o Zot,* dhe e ngrite bashkë çdo krijim që e himnonte pushtetin tënd.

Portat e Hadhit, shulat tok* i dërrmove fort,⁶³ Zot,* edhe, si Perëndi, u ngjalle ti* dhe, kur i takove gratë, u the: "Kini gaz" dhe i dërgove* t'u thoshin shën Nxënësve se u ngrit*⁶⁴ pra i gjalli⁴⁹ dhe u shfaq, edhe anët e botës i shndrit kudo.

Mjaft shndriste një i ri dikur,* pra i shfaquri, dhe* thërriste: Pse po sillni miro, gra,* për Krishtin, si vdekatar, duke qarë? U ngrit, i la të zbrazur* çarçafët dhe varrin; ndaj shkoni ju,* lajmërojini shejt miqt' e tij, shokët, për ngritjen me plot triumf.²⁴

Sado që je det plot mëshir',* çurg i jetës pa fund,* o Krisht, bri pusit të betimit,^{64a} Zot* i mirë, pas rrugëtimit ti ulesh edhe Samaritanes* i thua me zë: M'jep pak ujë ti* për të pirë, k'shtu do marrësh ti rrjedhat e ndjesës për çdo mëkat.

Lavdi *Triadik*

Atin pa nisje, Birin tok* të bashk'fronshëm si dhe* të bashkëqenshmin Shpirt i përhimnoj* me besë, Një mbretëri, Një esencë, Një lavd jan', Një natyrë;* i mbajnë të gjitha si Perëndi* i të gjithave dhe Bërës; i psal me Fuqitë që s'kanë trup.

Tani *Hyjlindësor*

Ty, si të vetmen virgjëresh'* që, pas lindjes, e ke* t'paprishur mitrën, të himnojmë ne,* si llambë⁴² mendore, mal⁵³ Zoti, portë⁵⁶ dhe nusërore plot nur* të Perëndis', tendë lavdie, fron,*¹³ ark' të qartë⁵⁷, shtambë⁵⁸ edhe tryezë,⁴⁴ ti, o e kulluara.

Zbritësore: Katilthes en tis katotatis

Zbrite në më të poshtmet.

Kontaqi i Samaritanes Ting. Tërth. IV

Kur erdhi te pusi me besë, Samaritania të pa ty, ujin e urtësisë, me të cilin, pasi u vadit bollshëm, e trashëgoi mbretërinë e sipërme përjetësisht ajo e kënduara.

Shtëpia

Le ta dëgjojmë Joanin që na mëson misteret e nderuara që u bënë në Samari: Sesi fliste Zoti me një grua kur i kërkoi ujë ai që i mblodhi ujërat në mbledhjet e tyre,⁶⁵ i bashkëfronshmi me Atin dhe Shpirtin; sepse erdhi për të kërkuar ikonën e tij,⁴ përjetësisht, si i kënduar.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të dielën e pestë pas Pashkës, kremtojmë të kremten e Samaritanes.

Vargu: O grua, ndonëse erdhe për të marrë ujë që prishet,/ nxjerr ujin e gjallë, me të cilin i pastron ndotjet e shpirtit.

Me ndërmjetimet e martires sate Fotini, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Ode VII

I Hyjlindëses

Biri yt, pasi e vrau vdekjen, o e Tërë-paqortueshme, u dhuroi sot të gjithë vdekatarëve jetë të qëndrueshme në jetë të jetëve^{65a} ai, i vetmi Perëndia i etërve, i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

Ai që mbretëron mbi çdo krijesë, kur u bë njeri, banoi në mitrën tënde, o e Hyjhirshme; dhe, kur duroi Kryq dhe vdekje, u ngjall siç duhej hyjnisht dhe na ngriti tok me veten e tij, si i tërëfuqishëm.

I Mespentikostisë (fq. 99)

I Samaritanes

Mi paradhois imás

[Irmosi: »**P**ërfundimisht, mos na dorëzo »ne për hir të emrit tënd, mos e shpër- »bë kurrë trashëgiminë tënde Zot;* nga »ne hirin tënd, përdëllimin tënd mos i »largo,*⁶⁶ o i mbilartësuar në mbar' jetët »ti* Perëndi i etërve tan' i lëvdur.^{67]}

O Krisht i pakuptueshëm, vullnetarisht³¹ u llogarite me të paligjshmit⁶⁸ gjatë pësimi hyjnor; dhe, duke i parë këto, toka lëkundej dhe gurët çaheshin⁴⁷ me një shenjë gjithëbërëse, dhe ngriheshin të vdekurit që prej jete.⁴⁸

Kur zbrite me shpirt në vendet më të poshtme të Hadhit, o Krisht Perëndi,²¹ i nxore burrisht të gjithë të prangosurit⁶⁹ që i kishte, që prej jete, vdekja, tirani i hidhur, të cilët të thërrisnin: Lavdi Ekonomisë sate të frikshme.

Iriu që u shfaq, u thoshte grave: Pse e kërkoni me të vdekurit të gjallin në jetë? Ja, siç e shikoni, çarçafët janë bosh dhe

varri bosh; ikni me nxitim dhe thojuni apostujve.²⁴

Samaritania i thërriste Krishtit: Je uji i jetës, ndaj më ujit mua që gjithmonë kam etje për Hirin tënd hyjnor, o Fjalë, o Zoti Jisu, që të mos vuaj më nga thatësira e padijenisë, por t'i shpall madhësitë e tua.

Lavdi *Triadik*

Himnojmë Atin, Birin dhe Shpirtin Hyjnor, Trininë e pandashme, që ekziston nga natyra, që ndahet në Persona, Një esencë të bashkëqenshme, pa fillim, Bërëse të Gjithësisë dhe Perëndi që e himnojnë mbarë rendet e qiejve.

Tani *Hyjlindësor*

Pas një lindjeje të frikshme, mbete virgjëreshë e kulluar, o Perëndilindëse e shenjtë, prandaj të tëra koret e engjëjve dhe të tërë brezat e njerëzve të përhimnojnë me zëra të pareshtur, o vend i pastër i të Panxënshmit.

Zbritësore: O Pedhas ek kaminu

Ai që shpëtoi djemtë.

Ode VIII

I Hyjlindëses

Bërësi erdhi në botë nëpërmjet teje, o Perëndilindëse virgjëreshë, dhe, pasi e çau barkun e Hadhit, na dhuroi ngjalljen neve vdekatarëve, ndaj e bekojmë në jetë.

O Virgjëreshë, kur e rrëzoi absolutisht pushtetin e vdekjes me anë të ngjalljes së tij Biri yt, si Perëndi i fortë, na bashkë-lartësoi dhe na hyjnizoi, ndaj e përhimnojmë në jetë.

I Mespentikostisë (fq. 100)

I Samaritanes

Ta simpanta dhëspota

[Irmosi: »E bëre, o Zot, me urtësinë të-
»nde Gjithësinë* dhe nga ana tjetër e
»fiksove përmbi bazë* ujore krejt fundin e
»tokës¹⁴ ti siç di,* ndaj të gjithë thërrasim
»tok melodikisht*: Pa pushim, ju o vepra
»të Zotit, himnojeni Zotin drejt.⁷⁰]

O i vetmi i pavdekshëm, mbret qiejllor, e durove vullnetarisht vdekjen,³¹ e skllavërove Hadhin, i dërmonte portat prej bronzi⁶³ dhe i more të prangosurit e atjeshëm që prej jete, të cilët e përhimnonin pa pushim pushtetin e mirësisë sate.

O zemërgjerë, kur u lartësove vullnetarisht³¹ mbi dru, gurët u çanë,⁴⁷ dielli u fik,⁷¹ perdja e Tempullit u gris,⁷² toka u tund⁴⁷ dhe Hadhi tërëqesharak u tremb, prandaj i lëshoi të gjithë të prangosurit.

O Krisht, përderisa je drita⁷³ pa perëndim dhe jeta⁴⁹ e të gjithave, u shfaqe tek ata që rrinin në errësirë,⁷⁴ ndaj, sapo të pa bashkësia e të drejtëve, o Fjalë, kërceu dhe thirri: Erdhe që t'i çlirosh të gjithë nga prangat; e himnojmë pushtetin tënd.

Ule pranë burimit në orën e gjashtë, o Shpëtimtar, dhe nga dhembshuria e shumë të dhe ujin e gjallë dhe rrjedhjen e njohurisë Samaritanes, bashkë me të cilën thërrasim melodikisht: Bekojeni pa pushim Zotin, ju, o veprat e Zotit.⁷⁰

Lavdi *Triadik*

Himnojmë Atin e parapafillim, Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e Shenjtë, Një Perëndi të tre, pa ngatërrim, pa ndarje, bërës të të gjithave, pushtet të bashkëfuqishëm, të lirë; dhe thërrasim: Bekojeni pa pushim Zotin, ju, o veprat e Zotit.⁷⁰

Tani *Hyjlindësor*

Isaia pastrohet me anë të qymyrit,⁷⁵ duke parapredikuar qymyrin mendor që do të mishërohej mbi mendim prej teje, o Virgjëreshë e tërëpaqortueshme, dhe do t'i flakëronte mëkatet e lëndshme të vdekatarëve, dhe do ta hyjnizonte natyrën tonë nga dhembshuria.

Zbritësore: Afti i kliti ke aqia

Himnoshë, bekojmë dhe i falemi Zotit.

Kjo është ditë e zgjedhur.

Ode IX

I Hyjlindësës

Tok ne, gjith' besnikët, të lumërojmë, Virgjëresh',* ki gaz, porta e Zotit,*⁵⁶ ki gaz ti, qytet frymor,* ki gaz, përmes teje na feksi nur sot* drita e Krishtit që ti na linde,* drita e ngjalljes prej varreve.

O derë hyjnore⁵⁶ e Dritës,⁷³ ki gaz dhe dëfre;* perëndoi në varr, por* lindi Krishti; shndriti fort,* më hijesisht dhe se dielli lart,* Zonjë e hyjhirshme, dhe i feksi* besnikët mbarë, Jisui Zot.

I Mespentikostisë (fq. 101)

I Samaritanes

Epitiise kratos

[*Irmosi*: »Rrëfeu forc' Krishti* përmes »krahut të tij krejt,* përmbysi të fuqishmit »pra prej fronesh,* i ngriti të mjerët lart*⁷⁶ »– Izraeli e ka Zot –* dhe na vizitoi⁷⁷ me »këto,* ky është lindje nga lart* dhe na »çoi ne në udhën e paqes s'shenjtë.⁷⁸]

Ja! Zoti Krisht, jeta* e të gjithave, u shfaq* i varur përmbi dru⁷⁹ vullnetarisht krejt*³¹ dhe toka, sapo e pa,* u lëkund⁴⁷, u ngritën mjaft* prej trupave të të fjeturve* të shenjtë⁴⁸ qart', u tund fort* tok me dheun edhe burgu i Hadhit poshtë.

I bukur prej varrit,* si nga nusërorja dhom',* Krisht, dole⁸⁰ kur shfarose tiraninë* e vdekjes dhe theve krejt* gjithë shulat posht' në Hadh* me forcë hyjnore,⁶³ Shpëtimtar,* dhe e ndriçove botën* me ndriçim mendor, me lavdet e ngritjes sate.

Të hedhim tash valle* shpirtërore gjithë ne* edhe le të thërrasim: U ngjall Zoti;* të ketë gaz toka plot,* u dëfretë qielli,* dhe retë të na spërkasin ne,* si shi, me drejtësinë*³⁹ duke bërë festë, duke himnuar Krishtin.

Burimi i Hirit,* jeta⁴⁹ për të gjallët mbar',* pra Zoti që na jep mësim, me zë flet,* i thot' gruas: Më jep ti* mua ujë që të pi,* që un' të të jap boll ujë ty,* që i shteron burimet* e mëkateve të tua në gjithë jetët.

Lavdi *Triadik*

Një dritë pa ndarje,* Një Hyjni dhe Bërës, Zot* i Gjithësis', Njësi tridiellore* është' Ati që s'ka fillim,* Biri edhe Shpirti Shenjt.* Atë, besimtarë, ta himnojm'* me të patrupët bashkë* dhe me këngë trishenj-tore, hyjnisht t'i psalim.

Tani *Hyjlindësor*

Meqë je banesë* drite,⁷³ m'i shkëlqe, m'i ndrit* nur bebet shpirtërore, se u nxinë* nga shumë intriga tmerr* të armikut, e Dëllir',* dhe bëmë të denjë fort ta shoh* me zemër mjaft të pastër* llamburitjen që ka feksur nga ti mbi mendje.

Zbritësore: Fotizu, fotizu

Engjëlli i thërriste Hirplotes: Gëzohu Virgjëreshë e qashtër dhe prapë të them gëzohu, se Biri yt u ngjall pas tri ditësh prej varrit.

Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem i ri.

Dërgimësore

E Pashkës Ting. II Sarki ipnosas

Si fjete si njeri me trup,* o Mbreti ynë
Zoti Krisht,* u ngjalle të tretën ditë,* dhe
ngrite gjyshin shën Adam,* dhe e dërr-
move vdekjen krejt.* Pashkë⁸¹ burim i
jetës, shpëtim i besnikëve.*

E Samaritanes: Jineqes akutisthite

Kur shkove, Shpëtimtari im, në Samari
dhe flisje ti* me gruan dhe i kërkove* uj'
për të pir' sado nxore* plot ujë për he-
brenjtë pra* nga i mprehti gur,⁸² dhe ajo*
u kthye në besimin tënd,* i Tërëfortë;
përrjetshëm* shijon tash jetën në qiej.

E Mespentikostisë E ngjashme

Në tempull, njeridashës Zot,* në mes të
festës erdhe ti* dhe thoshe: Sa keni etje,*
të vini tek un', të nxirrni* ujë²⁶ të gjallë
që buron,* që e fik çdo zjarr që keni* dhe
do shijoni mbarë ju* kënaqësi, hir dhe
jetën* e pafund dhe të pavdekshme.

Lavdërimi

Ngjallësore Ting. IV

O Zot i tërëfuqishëm...

Me Kryqin tënd, o Krisht...

Me Kryqin tënd, o Krisht Shpëtimtar...

Pa u ndarë nga gjiri prindëror...

Denjove vdekjen...

Gurët u çanë, o Shpëtimtar...

Të Samaritanes

Ting. III

Varg: Tendos dhe përparo, dhe mbretëro.

Qielli dhe dheu le të ngazëllehen⁸³ sot
hijesisht, sepse, pasi u mishërua, Krishti u
shfaq⁸⁴ si njeri që ta nxirrte nga mallkimi
Adam¹⁹ me tërë gjininë e tij; dhe, pasi

erdhi në Samari, bëhet i çuditshëm me
anë të mrekullive; dhe ishte afër një
gruaje dhe i kërkoi ujë ai që rrethohet
me ujërat e reve. Prandaj, mbarë ne
shpresëplotët, le t'i falemi atij që, nga
mëshira, u varfërua²⁰ vullnetarisht për
hirin tonë.

Ting. Tërth. II

Varg: Deshe drejtësi dhe urreve paligjësi.

Këto i thotë Zoti Samaritanes: Në do ta
dije dhuratën e Perëndisë dhe se kush
është ai që të thotë "Më jep ujë për të
pirë", ti do t'i kërkoje dhe ai do të jepte të
pije, që të mos kishe etje në jetë.

Lavdi Injëjti

Burimi i kryejtës, Jisui, Shpëtimtari
ynë, pasi qëndroi te burimi i patriarkut
Jakov, kërkonte ujë për të pirë nga një
grua Samaritane. Dhe, kur ajo foli për
mungesën e marrëdhënieve nga ana
e judenjve, ai, Bërësi i urtë, me fjalë të
bukura, e çoi në tjetër drejtim, pra që të
kërkonte më mirë ujin e amshuar. Dhe,
sapo e mori, ajo ua shpalli të gjithëve
duke thënë: Ejani të shihni njohësin e të
fshehtave,⁸⁵ Perëndinë që erdhi me trup
për të shpëtuar njeriun.

Tani

E përmbibekuar je...

Dhoksologjia e Madhe

*Në Liturgji, [Tipiket dhe Lumërimet: 4
Ngjallësore, 4 nga Kanuni i Mespentikostisë
Ode III dhe 4 nga Kanuni i Samaritanes Ode
VI. Hyrtore Ejani t'i falemi... Shpëtona... që
u ngjalle prej së vdekurish... Ose] Antifo-
net dhe Hyrtorja e Pashkës. Pas Hyrjes,
Përlëshorja Ngjallësore, e Mespentikostisë
dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Në vend të
Të meriton, Engjëlli i thërriste Hirplotes:*

Gëzohu... Ndriçohu, ndriçohu, o Jerusalem
i ri... *Kungatore* Lavdërojeni...



TË DIELËN E SAMARITANES NË MBRËMËSORE

Thirrtores të Mespentikostisë
Ting. Tërth. I Heris askitikón

G'zohu, i ndritshmi me hijeshi,* i tërëshenjtë mes i Ngjalljes shpëtuese,* u duke porsi mesditë dhe e shndrit nur kozmosin* me hyjnorin hir, dritë të ngritjes pra* të Krishtit edhe shkëlqen,* si llambadhe, simbol të fort'* paprishjeje dhe* Analipsin në lartësi* na e parashfaq* tok me ardhjen e Shenjtë Shpirt* dhe panairin plot drit' të së shenjtës Pentikosti* që është shumë e çmuar, e shumëdashur, prandaj i jep* mëshirë të madhe*¹² si dhe paqe⁸⁶ shpirtit tonë prej Shpëtimtarit Zot.

Zoti, mes festës, si lum' hyjnor* na jep të gjithëve tash rrjedhat e dhembshurisë*;* thërret: Kushdo që ka etje, të vijë të nxjerrë uj',*²⁶ se kam përdëllim si det dhe dashuri* plot porsi burim; ai* ndjesë fajesh gufon me Hir* në bot', lan shkelje,* dhe shëron dhe sëmundje tok,* dhe shpëton krejt sa* ngjalljen e tij po e kremtojnë,* mbron krejt sa Analipsin e tij plot me lavd e nderojn'* me mall, dhe shpirttrave tan' u jep përdëllimin e madh¹² hyjnisht* me paqen⁸⁶ gjithmonë,* sepse është Perëndi që ka shumë mirësi.

Mes Hierores rrinte ai,* i papërshkruari Zot dhe Perëndi, sepse* njeri me trup, mish, për ne ishte bërë dhe na u shfaq,* sado, në natyrë, ishte Perëndi.* U nxirrte të gjithëve* fjalë, rrjedhje jetike fort,*

publikisht thoshte:* Lani shpirtrat, freskohuni* prej pasioneve* dhe prej vapës së tyre zjarr;* njerëz, nga pija le të mos privohet askush, aspak,* unë dhuroj Hir të hyjshëm, çdo gjë të mir' dhe pavdekësi;* njeriu me Hirin* do ket' lavd në mbretëri tok me mua, Bërësin.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV
I Joan Monakut

Në mes të së kremtes, para pësimit dhe ngjalljes sate lavdiplote, o Zot, ishe në Hierore duke mësuar judenjtë e pabindur, Farisenjtë dhe Shkruesit dhe duke u thirrur: “Kush ka etje, le të vijë tek unë dhe le të pijë; atij që beson tek unë, do t'i rrjedhin nga barku lumenjtë e ujit të jetës²⁶ së Shpirtit Hyjnor”. O urtësi e parrëfyeshme e mençurisë sate! O Perëndia ynë që i mbush të gjitha,⁸⁷ lavdi më ty!

Pasvargje të Oktoikut Ting. IV
Ngjallësor

Duke iu falur Kryqit tënd jetëdhënës pa pushim, o Krisht Perëndi, lavdërojmë Ngjalljen tënde të triditshme; se me të përtërite natyrën e prishur të njerëzve, o i Tërëfuqishëm, dhe na tregove ngjitjen në qiej, si i vetmi i mirë dhe njeridashës.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Doja ta shlyeja përmes lotëve dorëshkrimin e fajeve⁸⁸ të mia, o Zot, dhe në jetën time që mbetet të të kënaq-

ja nëpërmjet pendimit; por armiku më mashtron dhe lufton kundër shpirtit tim; o Zot, para se të shfarosem përfundimisht, më shpëto.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

O Krisht Perëndi, që lavdërohesh në kujtimet e shenjtoreve të tu, me anë të përgjërimeve të tyre, na dërgo përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

O Krisht, tani që jemi në mes të së kremtes së ngjalljes sate dhe të ardhjes së Shpirtit tënd të Shenjtë, pasi u mblodhëm, i përhimnojmë misteret e çudive të tua; na dërgo në të përdëllimin tënd të madh.¹²

Përlëshorja e Mespentikostisë (fq. 93) [një herë deri të mërkurën, ndërsa në fillim të Mëngjesores (pas Perëndia është Zoti) tri herë. Në fund të saj, një herë.]



TË HËNËN E JAVËS V NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores të Oktoikut
Ting. IV
Ngjallësore*

Duke parë hyrjen e varrit dhe duke mos duruar flakën e engjëllit, miropurëset çuditëshin me tmerr duke thënë: Mos u vodh vallë ai që i çeli kusarit Parajsën? Mos u ngjall vallë ai që lëçiti Ngjalljen

dhe para pësimit? Me të vërtetë u ngjall Krishti Perëndi, dhe u fali atyre që ishin në Hadh jetën dhe ngjalljen.*

Kataniktike

Ktheje shpirtin tim të varfër që e shpenzoi në mëkate tërë pasurinë,⁸⁹ o Zot; pranomë edhe mua si Laviren,⁹⁰ dhe shpëtomë.

Martirike

Sot, në kujtimin e athloforëve, ushtritë e engjëjve erdhën t'i ndriçojnë mendjet e shpresëplotëve dhe ta hijeshojnë kozmosin me hir. O Perëndi, me përgjërimet e tyre, na dhuro përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani *Hyjllindësore*

O Perëndilindëse Virgjëreshë, je mur i pamposhtur për ne të krishterët, sepse, kur përikim te ti, mbetemi të pagoditur dhe, kur mëkatojmë përsëri, të thërrasim: Gëzohu, o hirplote, Zoti është me ty.⁹¹

Pas Stihologjisë së dytë,

Ndenjësores e Mespentikostisë

Ting. Tërth. II Tin sofian qe Logon

Urtësia²² dhe Fjala e Atit Zot* u dha fjalë apostujve, porosi,* ta shpallnin në botën krejt,* në çdo an',⁹² ardhjen e atij* mbi dhé, por nga hebrenjtë mashtrues me mjaft mani* po tallej frikshëm, shahej porsi një mashtrues⁹³ pra,* nën pushtet demonësh,⁹⁴ por ai u thërriste* pa mbajtur mëri aspak:* "Mos gjykoni padrejtësisht,* të paligjshëm,* ndaj meje ju".* T'i thërrasim:* O Perëndi,* Krisht njeridashës, dërgona* ndjes' fajesh ti;* e himnojmë me besë lavdin tënd që s'ka fund. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kananet: I pari i Mespentikostisë (tok me Irmoset) në 8 dhe të Mujorit në 4. Pas*

Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe të Mespentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Mespentikostisë. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Mespentikostisë (2x).

Lavdërime të Oktoikut

Ting. IV

Ngjallësor

O Zot i tërëfuqishëm, që durove kryq e vdekje dhe u ngjalle së vdekurish, lavdërojmë Ngjalljen tënde.* (2x)

Kataniktik

Jam dele e grigjës sate të arsyeshme dhe përiki drejt teje, bariut të mirë;⁹⁵ kërkomë mua që humba,⁹⁶ o Perëndi, dhe mëshiromë.

Martirik

Kush nuk habitet duke parë, o martirë të shenjtë, luftën e mirë që bëtë?⁹⁷ Se, ndonëse ishit me trup, fituat mbi armikun e patrup, kur e pohuat Krishtin⁹⁸ dhe u armatosët me kryq; prandaj denjësisht u treguat dëbues demonësh dhe luftëtarë barbarësh; ndërmjetoni pa pushim që të shpëtojnë shpirtat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Në mes të së kremtes së Pashkës, u ngrite, o Shpëtimtari ynë, në Tempullin e Hierores; dhe, pasi qëndrove në mes të turmës, e mësoje haptas dhe thoshe: Unë jam drita e botës;⁷³ ai që vjen pas meje, nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës së pavdekshme.

Pasvargje të Mespentikostisë

Ting. Tërth. II Ikos tu Efrathá

Zbrite, o Shpëtimtar,* si ule qiejt,⁹⁹ hyre* në mish nga një e Virgjër,* por pa ndryshuar; ndjesë* më jep dhe jetë pa mbarim.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Ishe në Perëndi* i tëri, Fjal',¹⁰⁰ por deshe* t'më nxirrje ti nga shkeljet,* nga humbja, njeridashës,* me mua u bashkove pra.

Varg: Kujtoje sinagogën tënde, të cilën e fitove që nga fillimi.

O Tërëmbret, ti je* urtia²² krejt e madhe* përmes së cilës Ati* forturtësisht e bëri* me Shpirtin Shenjt mbar' kozmosin.²³

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

Le t'i pastrojmë bodrumet e mendi-meve, të feksim llamburitje shpirtërore dhe ta shohim jetën, Krishtin,⁴⁹ kur arrin në Hierore, nga mirësia tejet e madhe, që të triumfojë kundër armikut dhe ta shpëtojë gjininë tonë me anë të Kryqit dhe të ngjalljes. Atij le t'i thërrasim: O Zot i pakuptueshëm, lavdi më ty.



TË HËNËN E JAVËS V NË MBRËMËSORE

Thirrtoje të Mespentikostisë

Ting. I Ton uranion tagmaton

Fjala Krisht, Zot i përjetshëm me Atin shenjt, hyjnor* dhe Bërës i çdo gjëje*²³ edhe dhënës i jetës,*^{100a} mori trup nga Virgjëresha, u bë,* duke dashur, njeri për ne;* urtin', mësimet e tij që nuk shprehen dot,* nxori si i mirë për krejt ne".

Në mes të festës që kishin judenjtë, shkove ti* mes Hierores, o Krisht* që je Zoti i Ligjit;* edhe me pushtet mësoje, Jisu,*¹⁰¹ dhe, siç thot' Shkrimi, Shkruesit* i kritikoje; habiteshin me urtin',* fjalën tënde, shfaqje mrekullish.

Ai që jep urtësin'^{101a} dhe të mirat edhe

derdh* nga një burim i pafund* çurg hyjnor, po thërret fort:* Ejani tek unë, të eturit mbar',* që të merrni uj' jete ju; *²⁶ prej barkut tuaj do derdhen lumenj me hir,* plot karizma të hyjnueshme.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. II

Kur arrite në Hierore, mes së Kremtes, o Krisht Perëndi, i mësoje popujt duke thirrur: "Ai që beson tek unë, edhe nëse do të vdesë, do të jetojë".¹⁰² Dhe jude-njtë grindeshin bashkë me Farisenjtë, Saducenjtë dhe Shkruesit duke thënë: "Kush është ky, që bën blasfemi?".¹⁰³ Nuk mendonin se ti je Perëndia ynë para gjithë jetëve, që lavdërohesh njësh me Atin dhe Shpirtin; lavdi ty.

Pasvargje të Oktoikut Ting. II *Ngjallësor*

Mallkimin¹⁹ e drurit të mosbindjes³ e zgjidhe, o Shpëtimtar, duke u mbërthyer vullnetarisht³¹ mbi drurin e Kryqit; dhe duke zbritur në Hadh,²¹ o i Fortë, dërrmove zinxhirët e vdekjes si Perëndi. Prandaj i falemi Ngjalljes sate prej së vdekurish, duke thirrur me ngazëllim: O Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

Kush është ai që dimëron dhe vrapon drejt këtij limani, dhe nuk shpëton? Ose kush është ai që ka dhimbje dhe bie para kësaj klinike, dhe nuk shërohet? O Bërës i të gjithave⁵ dhe mjek i të sëmurëve, o

Zot, para se të shfarosem përfundimisht, më shpëto.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

Ti që e pranove durimin e martirëve të shenjtë,¹⁰⁴ pranoje edhe prej nesh himnodinë, o Njeridashës, dhe na dhuro me përgjërimet e tyre përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani Ting. III I Gjermanoit

Në mes të së kremtes e lavdërojmë atë që bëri shpëtim në mes të dheut.¹⁰⁵ Jeta⁴⁹ varej në dru⁷⁹ mes dy kusarësh¹⁰⁶ dhe nuk i fliste atij që blasfemonte, ndërsa i thërriste atij që besonte: "Sot do të jesh së bashku me mua në Parajsë".²⁸ Zbriti në varr, e plaçkiti Hadhin²¹ dhe u ngjall pas tri ditësh duke i shpëtuar shpirtat tanë.



TË MARTËN E JAVËS V NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores të *Oktoikut* *Ting. IV*

Ngjallësore Kateplaji Josif

Deshe vetë, Shpëtimtar,* edhe durove kryq për ne,*³¹ edhe në një varr të ri,* njerëz të vunë si njeri,*³² ty që me fjalë themelove anët e dheut.*³³ Prandaj u zu si rob* vdekja, e huaj për të gjith',* edhe tmerrësisht* u plaçkit edhe u vodh,* si dhe të gjith' në Hadh i thërrisnin* Ngjalljes sate jetëprurëse.* Se Zoti Krisht u

ngjall,* Jetëprurësi* që mbetet përjetë.*

Kataniktike E ngjashme

Si do rrimë, shpirti im,* para Gjykatësit, mendo;* do vendosen frone lart* në orën mjaft të frikshme pra* dhe atëher' do shqyrtohet çdo vepër e kujtdo,* pa mëshir' do jetë Gjykatësi* edhe gati zjarrri për ty plot tmerr* porsi det i trazuar¹⁰⁷ egërsisht fort* që t'i mbulojë të gjitha tok;* këto të tëra,* o shpirt, shikoji,* psherëti para fundit.

Martirike

Me gjakrat e martirëve të tu në tërë botën, Kisha jote, e stolisur si me purpur dhe me li të çmuar, të thërret përmes tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoji popullit tënd dhembshuritë e tua, dhuroji paqe shtetit tënd dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Misteri është i frikshëm dhe mrekullia paradoksale: Si Virgjëresha të mbajti ty, Krijuesin e të gjithave,²³ dhe pas lindjes prapë mbeti e shpëtuar dhe e virgjër! Ti që linde prej saj, mbështete besën, qetësoji kombet dhe paqësoje botën, o Perëndi, si njeridashës.

Pas Stihologjisë së dytë,

Ndenjësores e Mespentikostisë

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Ti për botën gufon ujë jete plot,* uj' urtie edhe gjithë ne na fton* të nxjerrim shpëtim si çurg;* çdo njeri që e merr, e mban* hyjnorin ligjin tënd, me të shuan krejt çdo qymyr* mashtrimi, nuk do ketë kurr' etje në jetë pra,* nuk do ngopet kurrë me të, mbret qiellor, Zot;* prandaj e lëvdojmë mjaft* forcën edhe pushtetin tënd,* Krisht, dhe lypim* të na dërgosh* ndjesë pasurisht për çdo faj,* sepse na

ke shërbëtorë,* o Shpëtimtar,* dhe te ti ne i kemi shpresat tona, o Perëndi. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kananet: I dyti i Mespentikostisë (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit e të Mespentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Mespentikostisë. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Mespentikostisë (2x).*

Lavdërimet të Oktoikut

Ting. IV

Ngjallësore

Me Kryqin tënd, o Krisht, na çlirove prej mallkimit të moçëm,¹⁹ dhe me vdekjen tënde shkatërrove djallin që tiranizoi natyrën tonë, dhe me Ngjalljen tënde i mbushe të gjitha me gaz. Prandaj po të thërresim: O Zot, që u ngjalle së vdekurish, lavdi më ty.* (2x)

Kataniktik

Lamë me lotët e mi, o Shpëtimtar, se u ndota me mëkate të shumta; prandaj dhe bie para teje: Fajtova, mëshiromë, o Perëndi.

Martirik

U bëtë shokë me engjëjt, o martirë të shenjtë, kur predikuat burrërisht Krishtin në stadium, sepse të gjitha të kënaqshmet e botës i braktisët si të paqena, dhe e mbajtët besën si spirancë të sigurt;¹⁰⁸ prandaj, pasi e dëbuan mashtrimin, u derdhni si burim besimtarëve karizma shërimesh;¹⁰⁹ ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. IV

O Zot, para Kryqit tënd të pacen, kur ishte mesi i së kremtes, u ngjite në Hierore dhe u mësoje judenjve legjislacionet e Moisiut si dhe ato që ti kishe vendosur

në Ligj; dhe duke u çuditur për misterin e parrëfyeshëm të urtësisë sate, o Krisht, e thurën nga xhelozia intrigën kundër teje, duke thënë: “Si i di ai shkronjat pasi nuk ka studiuar?”, sepse nuk të njihnin ty, Shpëtimtarin e shpirtave tanë.

Pasvargje të Mespentikostisë

Ting. II Ikos tu Efratha

Si nisje, mes dhe fund*¹¹⁰ në mes të festës rrije* në Hierore, o Zot,* dhe më gufoje falje,* o Krishti im i dhembshur fort.

Varg: Kujtoje sinagogën tënde, të cilën e fitove që nga fillimi.

Fjal’ Krisht, hyjnoren forc’* të ngjalljes sate edhe* Sioni e dëgjoi,* gëzohet tok me bijtë*⁷ dhe të himnon, mëshirëmadh.

Varg: Dhe Perëndia, mbreti ynë para jetëve, punoi shpëtim në mes të dheut.

Prej Atit, porsi drit’* shkëlqeve, por, në vitet* e fundme, si njeri ti* m’u shfaq duke dhënë,* Krisht, faljen e mëkateve.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Në mes të së kremtes së Pashkës, u ngrite, o Shpëtimtari ynë, në Tempullin e Hierores; dhe, pasi qëndrove në mes të turmës, e mësoje haptas dhe thoshe: Unë jam drita e botës;⁷³ ai që vjen pas meje, nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës së pavdekshme.



TË MËRKURËN E JAVËS V

Mbyllet e kremtja e Mespentikostisë dhe psalim të gjitha të sajat, përveç Leximeve. Kanuni i Mujorit psalet në Pasdarkë.



TË MËRKURËN E JAVËS V
NË MBRËMËSORE

Thirrtoje të Samaritanes

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Krishti e gjeti Samaritanen pranë* pusit, i kërkonte pra uj’ për të pirë, se* fort deshte ndreqje, shpëtim për të,* i kish si etje,* siç dhe u bë realisht; ndërsa ajo* nxirrte uj’ të pijshëm, e nxori Jisui lart,* e mbushi boll me të gjallin uj’* edhe ajo fort* u shpalli bashkatdhetarëve të saj:* Ja, ja Mesia* për të cilin tha lasht’ në Ligj Moisiu shenjt,¹¹¹ Zoti Krisht,* që sekretet e fshehta* i zbulon i shfaqur si njeri.

U thot’ banuesve Samaritania:* “Ja Mesia Krisht, për të shkruhej dikur në Ligj* se do të vinte porsi profet* i madh,¹¹¹ njeri pra* dhe Perëndi, përmbi dhë u shfaq me trup;* sa i mbaja thellë në zemër të fshehura* edhe sa un’ kisha bërë keq,* m’i tha edhe më* shpjegoi si të veproje. Edhe kështu* qyteti mbar’ rend,* vërteton fjalët që i tha, i shikon të vërteta krejt* dhe çuditet me ngjarjen,* dhe beson ato që sheh me sy.

Ty që në orën e gjashtë ecje si Zot* në Parajsë,¹¹² të pa, Perëndia im,* sërish në orën e gjashtë, pra* bija e Evës,* stërnënës, kur rrije ti kështu në vend* ku qe një burim uji, pus i gërmuar thell’;* kërkove ujë prej saj ti që* je ujë jete,* që ta vadisje me ujin që kërcen,* dhe kështu ndodhi;* dhe, kur ujin tënd jetëprurës e piu ajo krejt,* ia shpalli qytetit* mbar’ bollëkun e rrjedhimit tënd.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. I

Burimi i mrekullive arriti te burimi në orën e gjashtë, që të merrte një fryt të

Evës për ta shpëtuar, sepse në këtë orë Eva doli nga Parajsa¹¹ nga mashtrimi i gjarprit.³ U afrua pra Samaritania që të nxirrte ujë. Kur e pa, Shpëtimtari i tha: “Më jep pak ujë për të pirë dhe unë do të të mbush me ujë që hidhet përpjetë”. Si shkoi me vrap në qytet, e mençura lajmëroi turmat sakaq: Ejani të shihni Zotin Krisht, Shpëtimtarin e shpirtrave tanë.

Pasvargje të Oktoikut Ting. IV
Ngjallësor

I dërrmove dyert e Hadhit, o Zot, dhe me vdekjen tënde shkatërrove mbretërinë e vdekjes, ndërsa gjininë e njerëzve e çlirove prej prishjes, duke i dhuruar botës jetën dhe paprishjen, dhe përdëllimin e madh.*

Varg: Në gjithë dheun doli zëri i tyre dhe në skajet e botës fjalët e tyre.

Apostolik

Korin e apostujve e ndriçove në Shpirt të Shenjtë, o Krisht; pastroje me anën e tyre dhe ndotjen tonë të mëkatit, o Perëndi, dhe mëshirona.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Martirik

Meqë keni guxim para Shpëtimtarit, o shenjtore, ndërmjetoni pa pushim për ne mëkatarët, dhe kërkoni ndjesë mëkatesh, dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani Ting. II

Samaritania e pyeti Zotin e dhembshur, i tha Zotit kur ai vajti te pusi: “Ma jep ujin e besës, që t’i marr rrjedhat e kolimvithrës, ngazëllim dhe çlirim”. O Krisht jetëdhënë, lavdi më ty.

Përlëshore Ngjallësore (Lëçitjen gazmore... dhe Misteri i fshehur...).



TË ENJTEN E JAVËS V
NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores të Oktoikut
Ting. IV*

Ngjallësore O ipsothis en to stavro

U kryqëzove, Zot,* për ne me dëshirë,*³¹ u llogarite ndër* të vdekurit, o Krisht,* u ngjalle pas tri ditësh, jetëdhënësi Jisu,* e dërrmove me pushtetin tënd* vdekjen, tërë fuqin’ e saj* dhe i gjallërove ti* mbarë shpirtrat në Hadh, Ferr;* ndaj, duke të himnuar, gjithë ne,* o i pavdekshëm,* ta çmojmë fort ngjalljen ty.

Apostolike Tahi prokatálave

Ndriçues në skajet e sferës,¹¹³ që feksin, o Krisht,* i shfaqe tër’ Nxënësit e tu që shpirtrat na shndrisin me predikimin tënd;* me ta i errësive* idhujt, tërë mashtrimin,* me dogma shpresëtare llamburite nur botën;* shpëto shpirtrat tan’ me ndërmjetimet e tyre, Zot.

Martirike E ngjashme

Pasi, Perëndia yn’ Krisht, athloforët e tu* i zhdukën me Kryq porsi me arm’ dredhit’ e armikut djall, e të keqit krejt* që nga fillimi,¹¹⁴ shndritën* si ndriçues,¹¹³ drejtuan* njerëzit, dhe shërim ndajnë te sa e kërkojnë* me bes’; shpirtrat na shpëto me lutjet e tyre, Zot.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore E ngjashme
E virgjër që kishe në bark Perëndin’ e mbimir’,* ta lypësh, e vetmja e himnuar fort, pa asnjë qortim, me apostujt tok*

që të na japë ndjesë* shkëlqesh përpara fundit,* ndreqjen e jetës neve që, me plot mall, me besë* dhe detyrimisht, të përhimnojmë, e pastër nur.

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores e Samaritanes*

Ting. Tërth. II

O Zot i përmbimrë, na dërgo tani të gjithë neve ndjesë fajesh siç ia hape Samaritanes besnike burimin e Hyjnisë sate dhe gufove mbi të hyjnjojhe duke e vaditur me pije të hyjzënë. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Samaritanes (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e Samaritanes. Pas Odes VI, Kontaqi i Samaritanes. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Samaritanes (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. IV

Ngjallësor

Pa u ndarë nga gjiri prindëror,¹¹⁵ o Fjalë e Vetëmlindur e Perëndisë,¹¹⁶ erdhe mbi dhë nga njeridashja, duke u bërë njeri pa ndryshuar, dhe durove Kryq e vdekje trupërisht, ti i papësuar sipas Hyjnisë dhe, si u ngjalle së vdekurish, i fale gjinisë së njerëzve pavdekshmërinë, si i vetmi i Tërëfuqishëm.* (2x)

Apostolik

Shpirti i Shenjtë, o Krisht Perëndi, i tregoi si mësues Nxënësit e pashkolluar,¹¹⁷ dhe, si i tërëfuqishëm, e shfuqizoi mashtrimin përmes harmonisë shumëfolëse të gjuhëve.¹¹⁸

Martirik

Si të mos i admirojmë garat tuaja, o

martirë të shenjtë? Sepse, ndonëse të veshur me trup të vdekshëm, triumfuat kundër armiqtsh të patrup; nuk ju trembën kërcënimet e tiranëve, nuk ju tmerruan sulmet e torturave; me të vërtetë u lavdëruat denjësisht prej Krishtit, që u jep shpirttrave tanë përdëllimin e madh.¹²

Lavdi dhe Tani Ting. II

Biri i bashkëpafillim dhe i bashkëpërtjetshëm, Fjala e Atit, burimi i shërimeve, shkoi te burimi. Dhe një grua nga Samaria arriti që të nxirrte ujë. Kur e pa, Shpëtimtari i tha: “Më jep ujë të pi dhe ik, thirre burrin tënd”. Dhe ajo, duke biseduar si me një njeri dhe jo me Perëndinë, u përpoq të fshihej dhe i tha: “Nuk kam burrë”. Dhe Mësuesi i tha asaj: “Të vërtetën the se nuk ke burrë, sepse kishe pesë dhe ai që ke tani nuk është burri yt”. Dhe, duke u çuditur prej fjalës, ajo vrapoi për në qytet dhe u thërriste turmave: Ejani të shihni Krishtin që i dhuron botës përdëllimin e madh.¹²

Pasvargje të Samaritanes

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Det, burim mirësie je,* o i vetmi i dhembshur Krisht,* edhe arkëtar jete, si i flisje pra* Samaritanes, një gruaje? I thirre ti: “Jepmë uj’,* për të pirë, dhe kështu* do të kesh ndjesë shkëlqesh ti”.* E himnojmë ne* dhembshurin’ tënde mjaft të madhe, me të e shpëtove krejt gjinin’ njerëzore, me mirësi pa fund.

Varg: Dhe tendos, dhe përparo, dhe mbretëro.

“**N**jerëz, ejani, shihni ju* një njeri që më tha drejt sot,* kur po rrinte te pusi, sa kam bërë keq;* është profet i vërtetë, mjaft i madh¹¹¹ dhe e di çdo gjë* dhe të dukshme ose jo”.*⁸⁵ Më dhuro, Krisht, të

gjallin uj,* njeridashës Zot,* që u jep uj' të eturve,²⁶ të mos kem etje përsëri në jetë, o njeridashësi Shpëtimtar.

Varg: Deshe drejtësi dhe urreve përligjësi.

I përhershmi burim, jeta* e pavdekshme, hyjnori çurg* i pasosur, pa prishje, pas së gjatës udh',* rrinte te pusi pasi i kish dërguar larg Nxënësit* për të bler' ndonjë ushqim* dhe ai bisedonte tok* me një vendase* kur ajo nxirrte uj', se Krishti donte që ta kthente në besim, t'ia ndriçonte sytë e shpirtit nur.

Lavdi dhe Tani *Ting. III*

Qielli dhe dheu le të ngazëllohen sot hijshëm, sepse Krishti u shfaq i trupëzuar si njeri për ta nxjerrë nga mallkimi Adam-in¹⁹ me tërë gjininë e tij. Dhe admirohet me anë të çudive kur arrin në Samari dhe qëndron pranë një gruaje, dhe i kërkon ujë ai që rrethohet nga retë. Ndaj, të gjithë ne besëmirët le t'i falemi atij që u varfërua²⁰ me vullnet të mirë.



TË ENJTEN E JAVËS V NË MBRËMËSORE

Thirrtores të Samaritanes

Ting. IV Kirie anelthón en to stavró

Shihni ju:* Moisiu shkroi lasht'* pra në Ligj se do të vinte mbi dhé Jisui Zot,* Mesia;¹¹¹ nga dhembshuria* u shfaq te pusi dhe bisedoi si njeri* tok me mua; vërtet ky është* Krishti ynë shpëtues* që vjen tashmë në botë", kështu u tha* njerëzve atje* në Sihar, Samaritania pra.

Pinë uj'* qytetarët boll si mjal't,* krejt të pijshëm që e nxirrte goja e ëmbël fort* e gruas edhe nxitonin,* vraponin drejt pusit

që i rridhte me bollëk* çurgjet. Donin ta shihnin qart'* dhe burimin e jetës,* të përhershmin, që shpirtrat e tretur keq* nga çdo faj i zi,* i vadiste, i freskonte mjaft.

Kur e pan'* qytetarët se njësoj* qe Burimi me esencën tonë, si një prej nesh,* i thirrën Samaritanes:* Besuam jo se na the ti, por personalisht* tash besuam vërtet sepse* ne e njohëm atë drejt* si shpëtim dhe çlirim të përgjeshëm krejt* mbarëbotëror,* që na fal çdo faj që kryejmë.

Dhe 3 të Mujorit.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Pasi e gjeti Samaritanen afër pusit të Jakovit, Jisui i kërkoi ujë, ai që e mbulon tokën me re. O çudi! Ai që rri mbi Keruvinet,¹³ bisedon me një lavire dhe i kërkon ujë ai që e vari dheun mbi ujërat;¹⁴ i kërkon ujë ai që derdh burime dhe liqene ujërash. E bën sepse do me të vërtetë ta tërheqë atë që kapet si gjah prej armikut kundërshtar dhe ta vaditë me ujin e jetës atë që flakërohet dhimbshëm në gjëra të pavenda, si i vetmi i dhembshur dhe njeridashës.

Pasvargje të Oktoikut Ting. IV

Kryqësor

Duke pasur gjithmonë Kryqin tënd për ndihmë, o Krisht, i shkelim lehtësisht kurthet e armikut.

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtoreve në duart e zonjës së saj, kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Ngjallësor

O Zot, duke u ngjitur në Kryq, shove mallkimin tonë stërgjyshëror¹⁹ dhe, duke zbritur në Skëterrë,²¹ çlirove robërit ndër shekuj dhe i dhurove gjinisë së njerëzve paprishjen. Prandaj, duke himnuar, lavdërojmë Ngjalljen tënde jetëbërëse dhe shpëtimtare.*

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

O flijime të gjalla, holokauste me lo-gjikë,¹¹⁹ martirë Zoti, therorë të përsosur Perëndie, dele që e njihni Perëndinë dhe jeni të njohura prej Perëndisë,¹²⁰ mandra e të cilave nuk shkelet nga ujqërit, ndërmjetoni që të kullosim edhe ne bashkë me ju në ujë prehjeje.¹²¹

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Këto i thotë Zoti Samaritanes: Në do ta dije dhuratën e Perëndisë dhe se kush është ai që të thotë “Më jep ujë për të pirë”, ti do t’i kërkoje dhe ai do të jepte të pije, që të mos kishe etje në jetë.

Përlëshore Ngjallësore (Lëçitjen gazmore... dhe Misteri i fshehur...)



TË PREMTEN E JAVËS V
NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores të Oktoikut
Ting. IV*

Kryqësore Tahí prokatálave

Në Kryq të mbërthyen judenjtë, o Zot

Shpëtimtar,* me të na rithirre ne nga kombet më parë, njeridashës, kur shtrive ti* vullnetarisht³¹ pëllëmbët* përmbi të dhe pranove* që me shtiz’ fort të shpo-heshe në brinjë;⁶² i qoft’ lavd* shumicës së dashurisë sate,¹²² o zemërmadh.

Ngjallësore

U ngjalle si i Pavdekshëm* prej Skë-terrës, o Shpëtimtar,* dhe botën tënde ngjalle* bashk’ me Ngjalljen tënde mbi dhë,* o Krisht, Perëndia yn’;* theve me forcën tënde* gjith’ pushtetin e vdekjes,* shfaqe, o Përdëllyes,* te gjith’ njerëzit Ngjalljen.* Prandaj të lavdërojmë sot* ty, Njeridashësin.*

Martirike E ngjashme

Dëshmorët e tu, o Zot, në ndeshjen e tyre, fituan kurorat e mosprishjes prej teje, Perëndisë tonë, se, duke pasur fuqinë tënde, i mposhtën tiranët dhe thyen ambi-ciet e pafuqishme të demonëve. Me lutjet e tyre, o Krisht Perëndi, shpëto shpirtrat tanë.*

Lavdi *dhe* Tani *Kryqhyjlindësor E ngjashme*

Kur ty nëna jote e pacen të pa përmbi Kryq* të ngjitesh, thërriste me vajtim nënor keq, o Fjalë e Perëndisë, Zot:* O sa çudi e huaj,* e re është, im Bir, kjo?* Si, jeta e të gjithave,⁴⁹ ke lidhje me vdekjen?* Se do, si i dhembshur, që t’i ngjallësh të vdekurit.

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores e Samaritanes
Ting. IV Tahí prokatálave*

Kur Samaritania arriti të nxirrte uj’ lart* nga pusi i prishshëm dhe i dheshëm, si zakonisht, e nxori të gjallin uj’,* se pa atje, e gjeti,* pra burimin që rrinte* ku qe gërmuar pusi i Jakovit, Krisht Zotin* që

vapën e zjarrtë botërore krejt e freskon.
(2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I Samaritanes (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Samaritanes. Pas Odes VI, Kontaqi i Samaritanes. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Samaritanes (2x).*

Lavdërime të Oktoikut

Ting. IV

Kryqësor Édhokas simíosisin

Zot, atyre që të kanë frikë, një shenjë ti u dhe,*¹²³ Kryqin tënd mjaft të çmuar pra;* me të triumfove fort*¹²⁴ përmbi hegjemonët* e terrinës¹²⁵ dhe na riçove drejtas lumëris'* së lashtë,¹²⁶ ndaj e lëvdojmë, o Jisu,* Ekonomin' e njeridashjes sate; o fuqiploti Zot,* Shpëtimtar je për shpirtrat tan',* mirëbërës i kozmosit.
(2x)

Ngjallësor

Me Kryqin tënd, o Krisht Shpëtimtar, udhëhiqna në të vërtetën tënde dhe shpëtona nga grackat e armikut. Ti që u ngjalle së vdekurish, ngjallna ne që ramë nga mëkati, duke nderë dorën tënde, o Zot njeridashës, me ndërmjetimet e shenjtorëve të tu.*

Martirik

Është e çmuar vdekja e shenjtorëve të tu, o Zot,¹²⁷ sepse të dërmuarit nga shpata, zjarri dhe të ftohtët, e derdhën gjakun e tyre, ngaqë kishin shpresë te ti, që të merrnin pagën e mundimit; duruan dhe morën prej teje, o Shpëtimtar, përdëllimin e madh.⁷

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Burimi i kryejetës, Jisui, Shpëtimtari ynë, pasi qëndroi te burimi i patriarkut Jakov, kërkonte ujë për të pirë nga një grua Samaritane. Dhe, kur ajo foli për mungesën e marrëdhënieve nga ana e judenjve, ai, Bërësi i urtë, me fjalë të bukura, e çoi në tjetër drejtim, pra që të kërkonte më mirë ujin e amshuar. Dhe, sapo e mori, ajo ua shpalli të gjithëve duke thënë: Ejani të shihni njohësin e të fshehtave,⁸⁵ Perëndinë që erdhi me trup për të shpëtuar njeriun.

Pasvargje të Samaritanes

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Kishte ardhur të merrte uj'* me një shtambë, por iku shpejt* duke lënë shtambën pa ujë, rendi tej* Samaritania dhe thirri në qytet se kish gjetur pus,* kishte gjetur një burim* të pasosur me jetë çurg,* ky çurg shpëtimtar* e ujiti dhe e freskoi edhe zemrën e saj që ish tretur nga veset shumë paligjësisht.

Varg: Dhe tendos, dhe përparo, dhe mbretëro.

Të vërtetën më the", i tha* Krishti Samaritanes pra,* "që sot nuk ke burrë të ligjshëm, se më par'* kishe ti pesë edhe ai që ke tash, nuk është hiç* burri yt, por ligjërisht* është i huaj". Kështu ajo* shkoi në qytet* me nxitim duke thirrur: "Pash' një burrë që më tha çdo gjë që bëra fshehtas, ky është Shpëtuesi".

Varg: Deshe drejtësi dhe urreve përligjësi.

Një Çurg tjetër që nxirrte jet'* nga një pus qiellor me Hir* gjeti edhe mori Samaritania, se* nuk ishte çurg i zakonshëm, tokësor ky që merrte pra,* ujë tjetër që ai* dhe në zemrën e saj me vull* po kërcente mjaft* dhe u shfaq si burim i

ri dhe tjetër që freskonte vapë vesesh. E gjeti papritur bri pusit.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Kur u duke mbi dhé, o Krisht Perëndi, me anë të Ekonomisë së parrëfyeshme, Samaritania e dëgjoi fjalën tënde njeri-dashëse, ndaj e la kovën te pusi dhe rendi dhe u tha atyre që ishin në qytet: Ejani të shihni një zemërnjohës; mos vallë është Krishti që presim, ai që ka përdëllimin e madh?¹²



TË PREMTEN E JAVËS V NË MBRËMËSORE

Thirrtores Idhiomele të Samaritanes (fq. 114)

Burimi i mrekullive arriti te burimi...

Samaritania e pyeti Zotin e dhembshur...

Biri i bashkëpafillim...

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Pasi e gjeti Samaritanen afër pusit të Jakovit, Jisui i kërkoi ujë, ai që e mbulon tokën me re. O çudi! Ai që rri mbi Keruimet,¹³ bisedon me një lavire dhe i kërkon ujë ai që e vari dheun mbi ujërat;¹⁴ i kërkon ujë ai që derdh burime dhe liqene ujërash. E bën sepse do me të vërtetë ta tërheqë atë që kapet si gjah prej armikut kundërshtar dhe ta vaditë me ujin e jetës atë që flakërohet dhimbshëm në gjëra të pavenda, si i vetmi i dhembshur dhe njeri-dashës.

Tani *Hyjlindësore Dogmatike*

Ting. IV

Profeti David, që u bë hyjprind me anën tënde, i parathirri melodikërisht atij që të

madhështoi.¹⁵ Qëndroi mbretëresha në të djathtë tënde.¹⁶ Se ty, Perëndia që denjoi të bëhet njeri prej teje pa atë, të rrëfeu nënë shkaktare jete që të gatojë përsëri ikonën e tij⁴ të prishur prej pasioneve. Dhe, duke gjetur delen e arratisur nëpër male, ta marrë mbi supe¹⁷ e t'ia shpjerë Atit.¹⁸ Dhe me dëshirën e tij, ta bashkojë me fuqitë qiellore dhe ta shpëtojë botën, o Hyjlindëse, Krishti që ka përdëllimin e madh¹² e të pasur.*

*Pasvargje Ngjallësore**

Ting. IV

Duke iu falur Kryqit tënd jetëdhënës pa pushim, o Krisht Perëndi, lavdërojmë Ngjalljen tënde të triditshme; se me të përtërite natyrën e prishur të njerëzve, o i Tërëfuqishëm, dhe na tregove ngjitjen në qiej, si i vetmi i mirë dhe njeri-dashës.

Varg: Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi. Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.

Mallkimin¹¹⁹ e drurit të mosbindjes³ e zgjidhe, o Shpëtimtar, duke u mbërthyer vullnetarisht³¹ mbi drurin e Kryqit; dhe duke zbritur në Hadh,²¹ o i Fortë, dërmmove zinxhirët e vdekjes si Perëndi. Prandaj i falemi Ngjalljes sate prej së vdekurish, duke thirrur me ngazëllim: O Zot i Tërëfuqishëm, lavdi më ty.

Varg: Sepse i dha fuqi botës e cila nuk do të lëkundet.

I dërmmove dyert e Hadhit, o Zot, dhe me vdekjen tënde shkatërrove mbretërinë e vdekjes, ndërsa gjininë e njerëzve e çlirove prej prishjes, duke i dhuruar botës jetën dhe paprishjen, dhe përdëllimin e madh.¹²

Varg: Shtëpisë sate i ka hije shenjtërimi, o Zot, për ditë të gjata.

O Zot, duke u ngjitur në Kryq, shove mallkimin tonë stërgjyshëror¹⁹ dhe, duke zbritur në Skëterrë,²¹ çlirove robërit ndër shekuj dhe i dhurove gjinisë së njerëzve paprishjen. Prandaj, duke himnuar, lavdërojmë Ngjalljen tënde jetëbërëse dhe shpëtimtare.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

Kur u duke mbi dhé, o Krisht Perëndi, me anë të Ekonomisë së parrëfyeshme, Samaritania e dëgjoi fjalën tënde njeri-dashëse, ndaj e la kovën te pusi dhe rendi dhe u tha atyre që ishin në qytet: Ejani të shihni një zemërnjohës; mos vallë është Krishti që presim, ai që ka përdëllimin e madh?¹²

Përlëshore Ngjallësore (Lëçitjen gazmore...
dhe Misteri i fshehur...)



TË SHTUNËN E JAVËS V NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores Ngjallësore*
Ting. IV*

Duke parë hyrjen e varrit dhe duke mos duruar flakën e engjëllit, miropurëset çuditëshin²⁴ me tmerr duke thënë: Mos u vodh vallë²⁷ ai që i çeli kusarit Parajsën?²⁸ Mos u ngjall vallë ai që lëçiti Ngjalljen dhe para pësimit?²⁹ Me të vërtetë u ngjall Krishti Perëndi, dhe u fali atyre që ishin në Hadh jetën dhe ngjalljen.

Lavdi

U ngjalle si i Pavdekshëm prej Skëterrës, o Shpëtimtar, dhe botën tënde ngjalle bashk' me Ngjalljen tënde mbi dhé, o Krisht, Perëndia ynë; theve me forcën

tënde gjith' pushtetin e vdekjes, shfaq, o Përdëllyes, te gjith' njerëzit Ngjalljen. Prandaj të lavdërojmë sot ty, Njeri-dashësin.

Hyjlindësore

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëj,³⁰ u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier, dhe denjoi kryq për ne duke dashur,³¹ me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes shpirtrat tanë.

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores e Samaritanes*

Ting. IV O ipsothis en to stavro

O qiell, ki gëzim;* kërceni, të dheshme, se Krishti si njeri* u shfaq nga e Virgjra* dhe e çliroi tërë njerëzinë përmes* vetë vdekjes dhe, kur shndriti fort* me çudi, si i vetmi Zot* i pavdekshëm pra, i dha* gruas Samaritane* burimin e shërimeve, pasi* kishte kërkuar* ai ujë nga ajo. (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kananet: I Samaritanes (tok me Irmoset) në 6, i shenjtit të kishës në 4 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e Samaritanes. Pas Odes VI, Kontaqi i Samaritanes. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Samaritanes (2x).*

*Lavdërime Ngjallësore**

Ting. IV

O Zot i tërëfuqishëm, që durove kryq e vdekje dhe u ngjalle së vdekurish, lavdërojmë Ngjalljen tënde.

Me Kryqin tënd, o Krisht, na çlirove prej mallkimit të moçëm,¹⁹ dhe me vdekjen tënde shkatërrove djallin që tiranizoi natyrën tonë, dhe me Ngjalljen tënde i

mbushe të gjitha me gaz. Prandaj po të thërresim: O Zot, që u ngjalle së vdekurish, lavdi më ty.

Me Kryqin tënd, o Krisht Shpëtimtar, udhëhiqna në të vërtetën tënde dhe shpëtona nga grackat e armikut. Ti që u ngjalle së vdekurish, ngjallna ne që ramë nga mëkati, duke nderë dorën tënde, o Zot njeridashës, me ndërmjetimet e shenjtoreve të tu.

Pa u ndarë nga gjiri prindëror,¹¹⁵ o Fjalë e Vetëmlindur e Perëndisë,¹¹⁶ erdhe mbi dhë nga njeridashja, duke u bërë njeri pa ndryshuar, dhe durove Kryq e vdekje trupërisht, ti i papësuar sipas Hyjnisë dhe, si u ngjalle së vdekurish, i fale gjinisë së njerëzve pavdekshmërinë, si i vetmi i Tërëfuqishëm.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Burimi i kryejetës, Jisui, Shpëtimtari ynë, pasi qëndroi te burimi i patriarkut Jakov, kërkonte ujë për të pirë nga një grua Samaritane. Dhe, kur ajo foli për mungesën e marrëdhënieve nga ana e judenjve, ai, Bërësi i urtë, me fjalë të bukura, e çoi në tjetër drejtim, pra që të kërkonte më mirë ujin e amshuar. Dhe, sapo e mori, ajo ua shpalli të gjithëve duke thënë: Ejani të shihni njohësin e të fshehtave,⁸⁵ Perëndinë që erdhi me trup për të shpëtuar njeriun.

Pasvargje të Samaritanes
Ting. IV Os jeneon en mártisin

E pa gruaja Zotin Krisht,* të përjetshmin burim, që qe* ulur pranë pusit dhe, meqë vuante* nga vapa, nga lloj-lloj vesesh zjarr, kërkoi të merrte boll* uj' të gjall' që derdhej çurg* prej tij pa kursim dhe çdo ves* e shëronte krejt;* dhe e mori prej Fjalës falas, ndaj nuk shkonte më

te tokësori dhe tek i prishshmi pus si më par'.

Varg: Dhe tendos, dhe përparo, dhe mbretëro.

Qe zakon, i tha gruaja, që të mos shoqëroheshin* tok me ta judenjët, porse i urti Zot,* Bërësi, si mori ujë, drejt e ktheu me fjalë pra* mjaft të ëmbla, që ajo* ta kërkonte hyjnorin uj',* pijen që rrjedh vet'* jetën; ndaj, kur e piu, drejt qytetit i përçonte rrjedhat, shpallte se Krishti ishte Shpëtuesi.

Varg: Deshe drejtësi dhe urreve përligjësi.

“Pusi është i thellë shumë*,* ti s'ke kov'; si do m'japësh ti* ujë që nuk priset?”, të tha ty gruaja* Samaritane; mendoi se mos ishte si çdo njeri* dhe jo Perëndi sado* qe çuditur prej fjalëve* që i the, o Krisht;* kur me thënie të ëmbla e vadite krejt, e bëre të të shpallte si Shpëtimtar të të gjithave.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Këto i thotë Zoti Samaritanes: Në do ta dije dhuratën e Perëndisë dhe se kush është ai që të thotë “Më jep ujë për të pirë”, ti do t'i kërkoje dhe ai do të jepte të pije, që të mos kishe etje në jetë.

Mbyllet e kremtja e Samaritanes.

CITIME


Samaritania: Joan 4.4-30
Mespentikostia: Joan 7.14-24

1. Lluk. 1.52
2. I Mbret. [Sam.] 2.1,10; Ps.148.14; Sirak 47.5
3. Gjen. 3.1-6
4. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
5. II Makk. 1.24; Sirak 24.8
6. Neh. 13.22 etj.
7. Ps. 96(97).8
8. Is. 4.4
9. Joel 3.1(2.28)
10. Joan 14.16-17,26; 15.26; 16.7

11. Gjen. 3.24
12. Num. 14.19 etj.
13. II Mbret. [Sam.].6.2; 22.11; IV [II] Mbret.19.15; Ps. 17 (18).11; 79(80).2; 98(99).1
14. Ps. 135(136).6
15. Lluk. 1.49
16. Ps. 44(45).10
17. Matth. 18.12-13; Lluk. 15.4-5
18. Ef. 2.18; 3.12
19. Gjen. 3.16-19
20. II Kor. 8.9
21. I Petr. 3.19; 4.6
22. I Kor. 1.24
23. Joan 1.2; Rom. 11.36
24. Matth. 28.1-8; Mark 16.1-8
25. Gjen. 3.16
26. Joan 7.37-38
27. Joan 20.15
28. Lluk. 23.39-44
29. Matth. 16.21; 17.9,23; 27.63; 28.6; Mark. 14.28; Lluk. 9.22
30. I Petr. 1.12
31. Joan 10.15,17-18
32. Matth. 27.59-60; Joan 19.40-41
33. Ps. 148.5 etj.
34. Lluk. 1.26-38
35. Gjyk. 6.37-38; Ps. 71(72).6
36. Eks. 3.2-5
37. Num. 17.23; Hebr. 9.4
38. Eks. 14.21-15.1 etj.
39. Is. 45.8
40. Ps 103(104).3
41. Jez. 1.13-26
42. Eks. 25.30; 38.13
43. Eks. 13.21-22 etj.
44. Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
45. Joan 6.35; 6.41,48,51
- 45a. Matth. 20.19; Mark 9.31; 10.34; Lluk. 18.33
46. I Mbret. [Sam.].2.1-9
47. Matth. 27.51
48. Matth. 27.52-53
49. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
50. Is. 6.3
- 50a. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
- 50b. Kënga 1.8; 5.9,17(6.1)
51. Abak. 3.1-3
52. I Kor.15. 6
53. Dan. 2.34
54. Ps. 62(63).2; Is. 26.9
55. Hebr. 7.2
56. Jez. 44.1-4
57. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
58. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
59. Eks. 30.1 etj.
60. Ps. 68(69).16
61. Jona 2.4-7
62. Joan 19.34
63. Ps. 106(107).16; Is. 45.2
64. Matth. 28.9-10
- 64a. Gjen. 21.30-31
65. Gjen. 1.9
- 65a. Mark 10.30; Joan 6.27; 10.28; 17.2
66. Dan. kap.3 Lutja e Azarias 10-11
67. Dan. kap.3 Lutja e Azarias 2,28
68. Is. 53.12; Mark 15.28; Lluk. 22.37
69. Ps. 67(68).7
70. Dan. kap.3 Lutja e Azarias 34
71. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
72. Matth. 27.51; Mark 15.38; Lluk. 23.45
73. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
74. Is. 9.2; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
75. Is. 9.6-7
76. Lluk. 1.51-52
77. Lluk. 1.68
78. Lluk. 1.78-79
79. Ligji i Dytë 28.66
80. Ps. 18(19).6
81. I Kor. 5.7
82. Eks. 17.6; Num. 20.11; Ligji i Dytë 8.15
83. I Kron. 16.31; Ps. 95(96).11
84. I Tim. 3.16
85. Sosana 42
86. Joan 14.27
87. Ef. 1.23
88. Kol. 2.14
89. Lluk. 15.13-20
90. Lluk. 7.37-50
91. Lluk. 1.28
92. Matth. 28.19
93. Matth. 27.63; Joan 7.12
94. Joan 7.20; 8.48-52; 10.20
95. Joan 10.11-14
96. Matth. 18.12; Lluk.15.4
97. II Tim. 4.7
98. Matth. 10.32; Lluk. 12.8
99. II Mbret. [Sam.].22.10; Ps. 17(18).10; 143(144).5
100. Joan 14.10-11
- 100a. Joan 10.28
101. Matth. 7.29; Mark 1.22; Lluk. 4.32
- 101a. Lluk. 21.14-15
102. Joan 11.26
103. Mark 2.7; Lluk. 5.21
104. Apok. 14.12
105. Ps. 73(74).12
106. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.32; Joan 19.18
107. Dan. 7.9-10
108. Hebr. 6.19
109. I Kor. 12.9; 28.30
110. Apok. 1.8; 21.6; 22.13
111. Ligji i Dytë 18.15
112. Eks. 3.8
113. Fil. 2.15
114. Joan 8.44

- | | |
|--|------------------------------|
| 115. Joan 1.18 | 122. Ps. 50(51).2; 68(69).17 |
| 116. Joan 1.14,18; 3.16-18; I Joan 4.9 | 123. Ps. 59(60).6 |
| 117. Vep. 4.13 | 124. Kol. 2.15 |
| 118. Vep. 2.6-11 | 125. Ef. 6.12 |
| 119. Lev. 1.3; 17.4; Is. 56.7; Rom. 12.1 | 126. Gjen. 2.15 |
| 120. Joan 10.11-14 | 127. Ps. 115.6 |
| 121. Ps. 22(23).2 | |





E DIELA E TË VERBRIT

TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*4 Thirrtoret e para Ngjallësore
Ting. Tërth. I*

Me Kryqin tënd të nderuar...
Ai që i fal Ngjalljen gjinisë...
Çudi e madhe! Krijuesi...
Adhurimin e mbrëmjes ta ofrojmë...

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O Zot, duke ecur rrugës...
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq.143*)

Tani *Hyjlindësore Dogmatike I njëjti*
Le ta nderojmë Vajzën e hyduhur dhe të respektuar, më të lartën se Keruvimet, sepse, kur deshi të trupëzohej, Krijuesi i të gjithave¹ banoi në të parrëfyeshëm. Sa çështje të huaja dhe mistere paradoksale! Kush nuk do habitet duke e dëgjuar këtë, që Perëndia bëhet njeri? Nuk u bë ndryshim në të, kaloi portat e virgjërisë

dhe nuk u pakësua në asgjë, siç thotë profeti: Asnjë nuk do ta kalojë kurrë, përveç Zotit, Perëndisë së Izraelit,² i cili ka përdëllimin e madh.³

*Pasvargje Ting. Tërth. I
Ngjallësor*

Ty, Krishtin Shpëtimtar, që u mishërove dhe nuk u ndave prej qiejve, me zëra dhe këngë po të madhërojmë, se durove Kryq e vdekje për gjininë tonë si Zot njeridashës dhe, pasi theve dyert e Hadhit, u ngjalle pas tri ditësh, duke shpëtuar shpirtat tanë.*

*Të Hyjlindësës
Ting. Tërth. I Heris askitikón*

Varg: Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Gëzohu, o vula e profetëve, predikimi i apostujve hyjfolës, sepse na linde të mishëruar, përmbi mendje dhe fjalë, Perëndinë, të qenshmin me të vërtetë; pasi na u kthye me anën e tij fisnikëria e lashtë dhe shijojmë Parajsën,⁴ të mbu-

rrim shumë me himne ty, shkaktaren e shkëlqimit aq të fortë; të kemi si pasuri, o e Tërëshenjtë, si ndërmjetëse që prano-heshe mirë, ndërsa Biri yt e shpërndan pasurisht përdëllimin e madh,³ arritjen e amshuar, jetën.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harro popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Gëzohu, o qiell logjik, ku fushoi Perëndia kur u mishërua, shtambë e manës hyjnore,⁵ llambadhe e Diellit, mal i tërë-hijesuar⁶ i Perëndisë, dhomë nusëroreje që nxure Hyjninë, tryezë⁷ jetëdhënëse, llambë e artë,⁸ Parajsë dritëprurëse, ferrë e padjegshme,⁹ arkë e shenjtërimin,¹⁰ shkallë mbiqiellore,¹¹ re¹² e gjallë, shkop që mbive nga rrënja e Jeseut,¹³ o Virgjëreshë; përgjëroju Krishtin që t'u japë shpirtave tanë përdëllimin e madh.³

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Gëzohu, o e Tërëpaqortueshme, që e nxure pa shpjegim Birin e Perëndisë dhe e linde pasi e mori vërtet prej gjakrave të tua mishin sipas nesh, me shpirt mendor dhe të lirë; sepse, kur e mori tërësisht Adamin, e rigatoi dhe e shpëtoi njeriun. Prandaj na shpallet Krishti me dy natyra, duke e treguar veças energjinë në veten e tij; përgjëroju atij që t'u japë himnuesve të tu përdëllimin e madh.³

Lavdi dhe Tani i së kremtes

O Krisht Perëndi, diell mendor...

(Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq.143)

Përlëshoret

NË MBRËMËSOREN E MADHE

10 Thirrtoje: 7 Ngjallësore dhe 2

Idhiomele të të Verbrit në 3

Ngjallësoret

Ting. Tërth. I

Me Kryqin tënd të nderuar...

Ai që i fal Ngjalljen gjinisë...

Çudi e madhe! Krijuesi...

Adhurimin e mbrëmjes ta ofrojmë...

Krishtin, kryetarin e shpëtimit...

Rojat udhëzoheshin...

O Zot, që plaçkite Hadhin...

Idhiomele të të Verbrit

Ting. II

Ai që lindi i verbër, thoshte me vete: Mos vallë kam lindur i verbër për shkak të mëkateve të prindërve? Mos vallë kam lindur si shfaqje për mosbesimin e kombeve? S'kam fuqi të pyes kur është natë e kur është ditë. Këmbët e mia janë rraskapitur dhe pengohen nëpër gurë, ngaqë nuk e kam parë diellin kur shkëlqen as në ikonë atë që më gatoi. Prandaj të lyp, o Krisht Perëndi: Hidhi sytë mbi mua dhe mëshiomë. (2x)

I njëjti

Duke kaluar nga Hierorja, Jisui gjeti një njeri të verbër që nga lindja dhe, pasi e dhembshuroi, vuri baltë mbi sytë e tij dhe i tha: "Shko, lahu në rezervuarin e Siloamit". Dhe, kur u la, ai shikoi duke lavdëruar Perëndinë. Dhe familjarët e tij i thoshin: "Kush t'i hapi bebet të cilat nuk mund t'i shëronte askush nga ata që shohin?". Dhe ai thirri: "Një njeri i quajtur Jisu më tha: «Lahu në Siloam» dhe pashë. Ky është me të vërtetë ai për të cilin ka folur Moisiu në Ligj si Krisht Mesia; ai është shpëtimtari i shpirtave tanë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O Zot, duke ecur rrugës, gjete një njeri të verbër që nga lindja dhe Nxënësit, të çuditur, të pyetën duke thënë: “O Mësues, kush ka mëkatuar që ka lindur i verbër, ai apo prindërit e tij?”. Dhe ti, o Shpëtimtari im, u thirrë: “Nuk ka mëkatuar as ai, as prindërit e tij, por për t’u shfaqur veprat e Perëndisë tek ai; unë duhet t’i kryej punët e atij që më dërgoi, të cilat nuk mund t’i kryejë askush”. Dhe, kur i the këto, pasi pështyve përtokë dhe bëre baltë, ia lyeve sytë duke i thënë: “Shko, lahu në rezervuarin e Siloamit”. Dhe ai, kur u la, u shërua dhe të thërriste: “Besoj, o Zot!”, dhe t’u fal. Ndaj thërrasim dhe ne: “Mëshirona!”.

Tani *Hyjlindësore Dogmatike I njëjti*

Në Detin e Kuq u përshkrua dikur ikona e Nuses së pamartuar. Atje Moisiu, që ndau ujin;¹⁴ këtu Gabrieli, shërbëtori i çudisë.¹⁵ Atëherë Izraeli kaloi në këmbë përmes thellësisë së detit, pa u lagur;¹⁴ ndërsa tani Virgjëresha lindi Krishtin pa farë. Deti, pas kalimit të Izraelit, mbeti i pashkelur;¹⁴ e Pacenuara, pas lindjes së Emanuelit, mbeti e paprekur. O Perëndi, që je¹⁶ dhe ishe më parë, dhe u shfaqe si njeri, mëshirona.*

Në Liti Idhiomeli i shenjtit të kishës

Lavdi *Ting. IV*

Duke e konsideruar tërë jetën si natë, i verbri të thirrri, o Zot: Hapmi bebet, o Bir i Davidit, Shpëtimtari ynë, që edhe unë, së bashku me të gjithë, ta himnoj fuqinë tënde.

Tani *Hyjlindësor I njëjti*

Priti lutjet e shërbëtorëve të tu, o e Panjollshme, duke pushuar kryengritjet e mjerimeve tona, duke na shpëtuar

nga çdo hidhërim; se vetëm ty të kemi spirancë të fortë e të sigurt,¹⁷ dhe kemi mbrojtjen tënde. Mos u turpëroshim, o Zonjë, duke t’u lutur. Shpejto të dëgjosh lutjet e atyre që të thërresin besërisht: Gëzohu, o Zonjë, ndihma e të gjithëve, gëzimi, mbrojtja dhe shpëtimi i shpirtrave tanë.*

Pasvarg Ngjallësor Ting. Tërth. I

Ty, Krishtin Shpëtimtar, që u mishërove dhe nuk u ndave prej qiejve, me zëra dhe këngë po të madhërojmë, se durove Kryq e vdekje për gjininë tonë si Zot njeridashës dhe, pasi theve dyert e Hadhit, u ngjalle pas tri ditësh, duke shpëtuar shpirtrat tanë.*

Dhe ato të Pashkës (fq. 7)

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot...

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

O Krisht Perëndi, diell mendor i drejtësisë,¹⁸ ti që me preken tënde të pacen e ndriçove dyfish atë që nuk e kishte dritën që nga mitra, shndriti edhe sytë e shpirtrave tanë dhe tregona bij dite,¹⁹ që të të thërrasim besërisht: Dhembshuria jote është e madhe për ne dhe e parrëfyeshme; o njeridashës, lavdi më ty.

Tani *Ting. Tërth. I*

Ditë e Ngjalljes... (fq. 7)

Përlëshore Ngjallësore Ting. Tërth. I

Fjalën e panisëshme bashkë me Atin e me Shpirtin e Shenjtë, që lindi prej Virgjëreshës për shpëtimin tonë, le ta përhimnojmë, o besnikë, e le t’i falemi; se denjoi të ngjitet trupërisht mbi kryq dhe të durojë vdekje dhe të ngjallë të vdekurit me Ngjalljen e tij të lavdëruar.*

Hyjlindësore Ngjallësore

Gëzohu, derë e Zotit e pakaluar;²⁰ gëzohu, mur dhe mbrojtje e atyre që rendin te ti; gëzohu, o liman i padimëruar dhe i pamartuar. Ti që linde trupërisht Bërësin tënd dhe Perëndinë, mos resht së ndërmjetuari për ata që të himnojnë dhe adhurojnë Birin tënd.*



NË MËNGJESORE

[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kanunin Triadik).]

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësoret Ngjallësore**

Ting. Tërth. I Ton sinánnarhon Logon

Përlëvdoheni Kryqin e Shpëtimtarit Krisht, dhe me këngë Varrimin e tij nderojeni,* edhe Ngjalljen pas tri ditësh lavdërojeni,* se të burgosurit në Hadh* dhe të vdekurit në varr* i ngriti Zot' i fuqishëm,* dhe e theu fuqin' e djallit,* dhe i ndriti t'errësuarit.

Lavdi

O Zot, u shpalle i vdekur, ti që vrave vdekjen; në varr u vendose, ti që zbraze varret; ushtarët përsipër ruanin varrin,²¹ dhe ti përposhtë ngjalle të vdekurit ndër shekuj. O Zot i Tër'fuqishëm dhe i pakuptueshëm, lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore Ton sinánnarhon Logon*
Lum e lum ti, o mal, ku²² bariti Zot' i madh;*²³ lum e lum ti, o ferrë, që nuk u dogje dot;*⁹ lum e lum, o urë, që na shpie në shpëtim,* në Parajs' e në dëfrim* dhe në jetën pa mbarim,* o Nën' e shenjtë, gëzohu,* që virgjërisht na ke lindur* Shpëtimtarin tonë Jisu Krisht.*

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret
Ting. Tërth. I
Ngjallësore*

O Zot, në mes të të dënuarve të mbërthyen të paudhët,²⁴ dhe brinjën tënde e shpuan me shtizë,²⁵ o Përdëllyes; dhe varrim denjove, ti që theve dyert e Hadhit dhe u ngjalle pas tri ditësh; gratë rendën të të shihnin dhe u lajmëruan Ngjalljen apostujve.²⁶ O Shpëtimtar i përmbilartësuar, që të himnojnë engjëjt, o Zot i bekuar, lavdi më ty.*

Lavdi

Misteri yt i huaj u bë shpëtim për botën, o Shpëtimtar, sepse, kur u ngjalle prej varrit siç i përkiste Hyjnisë, i ngrite tok me veten si Perëndi të prishurit; o jeta e të gjithëve, o Zot, lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore Ton sinánnarhon Logon*
Virgjëreshë dhe Nënë Mari Hyjlindëse,* që hidhërimin e Evës e ktheve në gëzim,* të himnojmë ne besnikët dhe të falemi,* se na çlirove plotësisht* nga mallkimi prindëror,*²⁷ o Zonj' e Përmbibekuar,* pra lutu për ne paprerë* dhe shpëtona prej rreziqeve.*

I Paqortueshmi (Psalmi 118), Bekimtoret etj.

Kanunet: I Pashkës (tok me Irmoset) në 6, i Hyjlindëses në 2 dhe i të Verbrit në 6.

Ode I

*Kanuni i Hyjlindëses
Tingulli dhe Irmoset e njëjta*

Ke shkaktuar pështjellim në kushte vdekjeje ti,* Zonjë, meqë në bark kishe Krishtin, të përherëshmen jet',* që na lindi sot nga varri dhe shndriti fort,* e Virgjër pa cen aspak,* botën tonë, planetin mbar'.

E pe Perëndinë, Birin tënd të ngjallur, prandaj* gëzohu me apostujt, o e hyj-hirshme e dëlir';* ti e para prite pra "Gëzohu"-n sepse,* Hyjlindëse pa qortim,* i shkaktove hare botës.

Kanuni i të Verbrit që ka Akrostihidhë në Oden IX: "Josif". Poezi e Josifit të Selanikut.

Ting. Tërth. I

Jin ef in uq élampsen

[Irmosi: »Izraeli shkoi mbi dhen' që »s'e ndriti as e pa dielli kurr'* dhe të »zhveshur s'e shikoi qielli i madh;* e kaloi »pa u lagur fare¹⁴ dhe në mal* shenjtëri- »mi ti e fute;²⁸ kur kalonte mbi avushë,* »psalte, këndonte fort* ode triumfale »krejt.¹⁴]*

E pranove kryqëzimin vullnetar²⁹ në trup, o Zot,* nxore,³⁰ bekim,* jetë pra për botën, Krijimtar i Gjithësis'*¹ dhe i vetmi i bekuar krejt, ndaj të himnojm',* të lëvdojmë edhe të bekojmë me hare të madhe,* psalim, këndojmë fort* ode triumfale mjaft.

Kur bujari shën Josif të vuri thellë në një grop'* si ty të vran',* zemërmadh Krisht, në një varr, në hyrjen e tij pra* rrokullisi një gur,³¹ por u ngjalle tërë lavd* dhe e ngrite botën tok me veten dhe ajo me plot gaz* psalte, këndonte fort* ode triumfale krejt.

Engjëlli që panë gratë shenjte mjaft, u thoshte fort:* Pse sillni tash* miro edhe lot? U ngjall Krisht Zoti, shkoni ju* shumë shpejt te Nxënësit,³² shikuesit e tij,* që vajtojnë e qajnë, lajmërojnë për ngjalljen e tij,*³³ që të kërcejn' me gaz* dhe të hidhen përpjet' tok.

Çlirimtari, duke bërë të çuditshmet

mrekulli,* burrin pa sy* që nga lindja, e shëroi dhe i tha atij* kur i vuri baltë: "Shko në Siloam, atje* lahu dhe kështu t'më njohësh si Zot që po eci mbi dhé* e që kam veshur trup* prej së madhes dhembshuri.

Lavdi Triadik

Një esenc' trihipostate ne krejt adhurrojmë,* ndaj çdo besnik* ta lëvdojë Atin, Birin dhe të drejtin Shpirt,* Bërës, Zot dhe Çlirimtar për mbarë kozmosin,* pra Një Perëndi të pakrijuar, dhe bashkë me engjëjt* të themi ne me zë:* O mbret, ti je shenjt, shenjt, shenjt.³⁴

Tani Hyjlindësor

Zoti, nga e madhja dhembshuri, banoi, e Dëlir',* në barkun tënd* o e pamartuar; donte t'i shpëtonte krejt* njerëzit e prishur prej armikut dredharak;* lutju Krishtit, ta shpëtoj' këtë qytet nga çdo pushtim, sulm,* nga çdo armik, barbar,* Zonja jonë e pacen.

Zbritësore: To sotíri Theó

»Shpëtimtari yn' Zot* u lavdërua sepse* »e udhëhoqi* në det popullin* pa uj' »ndër këmbë dhe e zhyti Faraonin keq* »me tërë ushtrinë; t'i këndojmë të vetmit »Zot.¹⁴

Ode III

I Hyjlindësës

Kthehem sot te jeta e pacen,* Zonjë, me mirësi nga ai që linde ti* dhe shndriti gaz me shkëlqim* në skajet e botës, dha shpëtim* dhe hir, e Dëllirë fort.

Ti, o e Dëllirë, të kërcesh,* se e mbajte në bark Zotin me mish dhe e pe* të ngjallur prej varrit ti* sikurse kish thën',^{34a} o e pacen,* si Zot madhështojë pra.

*I të Verbrit**Saleyomenin tin kardhian mu*

[Irmosi: »Forcoje zemrën time, Zot, se
»prej dallgëve të jetës tundet edhe, si
»Perëndi,* në liman të qetë pa furtun'
»drejtoje, o Krisht.]

O zemërmadh, me kryqëzimin tënd aq të
çmuar që pranove në trup, e tunde fort*
tokën mbar',³⁵ mbështete zemrat që lë-
kundeshin mjaft.

Arkondi shën Josif të vuri, i dhembshur,
në një varr të ri,³¹ por ti, pas tri ditësh,
Krisht,* nga të vdekurit u ngjalle dhe na
bëre të rinj.

Një engjëll me fytyr' të ndritshme hyjnore
u tha grave: Ju, pse po e kërkon pra* si
të vdekur Zotin? Është ngjallur siç kishte
thënë'.³²

I tërëdhembshur, e shërove dikur të ver-
brin që të erdhi, ndaj i lëvdonte fort* të
çuditshmet që ke bër', Ekonomin' tënde,
Zot.

Lavdi Triadik

Tok, Atit Perëndi dhe Birit të parapafillim,
Hyjnorit Shpirt ne u falem; * është natyr'
trihipostate dhe Një Zot botëror.

Tani Hyjlindësor

Prej barkut virgjëror e linde të mishëruar
Perëndin',³⁶ kërkoji atij, o Zonj',* të na
mëshirojë krejt, e Tërëshenjtë gjithnjë.

Zbritësore: Dhinami tu stavru su

»**M**a siguro* mendimin, o Krisht,*³⁷ me
»forc' nga Kryqi* që ta përhimnoj* dhe ta
»lëvdoj kryqëzimin tënd* shpëtimtar tani,
»të lutem ty.

*Ndenjëso**Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Kur po ecje ti udhës, Bërës dhe Zot* i të
gjithave,¹ gjete një qyq pa sy* që qante
dhe thoshte që* "S'e kam parë as die-
llin* të shndrijë, as shkëlqimin e hënës,
ndaj të thërras:* Ke lindur nga e Virgjra,
ta shndritësh nur çdo krijim,* ndaj më
shndrit dhe mua, si i dhembshur, që unë*
të bie në gjunjë ty,* të të falem, dhe të
thërras:* Perëndi Krisht,* më jep, më
fal* ndjesë fajesh, se disponon,* o njeri-
dashës i vetëm,* plot dhembshuri,*³⁸ s'i
kam parë aspak në jetë ndriçuesit". (2x)

*Ode IV**I Hyjlindës*

Oe Dëllirë, ai që gatoi Adamin,^{38a} stërat
tënd, u gatua prej teje dhe, me vdekjen e
vet, e shpërbëri sot vdekjen e shkaktuar
nga ai²⁷ dhe i ndriçoi të gjithë fuqishëm
me llamburitjet hyjnore të ngjalljes.

Oe Dëllirë, e bukur, e hijshme dhe e
paqortueshme mes grave^{38b}, duke parë
Krishtin që linde, që shndrinte tepër
bukur nga të vdekurit për shpëtimin e të
gjithëve, e lavdëroje me gëzim bashkë
me apostujt.

*I të Verbrit**Akikoa Kirie tin akoín su*

[Irmosi: »Dëgjimin tënd unë, o Zot, e
»dëgjova dhe pata frikë,* e kuptova³⁹ Eko-
»nominë tënde, i vetmi njeridashës, dhe
»të lëvdova ty.]

Kur u vendose në dru ti që je jetë,⁴⁰ më
rigjallërove për shkak të mëshirës së
madhe³ mua që vdiqa²⁷ nëpërmjet një
druri,⁴¹ për këtë të lavdëroj, o Fjalë.

O Zot, kur shoqëroheshe në mënyrë
paradoksale me mistët e tu,⁴² u thoshe:

Shkoni, predikojeni gjithkund⁴³ ngjalljen time.

O Zoti Krisht, e vërtetove ngritjen tënde prej varrit kur u shoqërove shumë ditë me ata⁴² që të donin duke i ngazëlluar.

I dhe shikimin një të verbri që nga mitra kur i the: Ik, lahu dhe shiko përsëri duke e lavdëruar Hyjninë time.

Lavdi *Triadik*

O Trini e bashkëndëruar, pa fillim, pa ndarje në esencë, e ndarë në hipostaza, shpëtoji të gjithë ata që të lavdërojnë besërisht dhe me frikë.

Tani *Hyjlindësor*

O e Tërëpaqortueshme, e pacen, e lavdërojmë lindjen tënde të përmbinatyrshme duke të lumturuar si lindëse të Perëndisë së të gjithave.

Zbritësore: Isakíkoa tin akoín

»**E** dëgjova un' dëgjimin³⁹ e fuqis' së »Kryqit tënd, përmes tij* një Parajsë »qiellore na u hap*⁴⁴ dhe të thirra fort:* »Lavd pushtetit tënd, Perëndia im.

Ode V

I Hyjlindëses

Mbledhja e shpresëplotëve ndriçohet me rrezet hyjnore dhe jetëprurëse të ngjalljes së Birit tënd dhe mbushet me ngazëllim, o Hyjnënë e pacenshme.

O mbret i Krijesës, kur u mishërove, nuk i hape portat e Virgjërshës, nuk i prishe vulat e varrit, ndaj u gëzua kur të pa të ngjallur.

I të Verbrit

Tin tálanan psihin mu

[*Irmosi*]: »**Z**ot, shpirtin tim luftues gjat' »natës ndaj çdo pasioni të zi, dhemb-

»shuroje, eja shpejt,* o diell mendor, tek »unë dhe* feksi porsi ditën rrezet plot »ndriçim,* ma kthe në dritë nur natën,⁴⁵ »o Krisht.^{4]}

U lartësive mbi dru dhe i lartësive me veten gjithë të vdekshmit, dhe e vrave gjarprin⁴⁶ armik, dhe e gjallërove gatimin e duarve të tua,⁴⁷ o i dhembshur, si i vetmi Perëndi i të gjithave.

Ti që u bëre vullnetarisht i vdekur,²⁹ u vendose në varr dhe, kur i ngrite të vdekurit në ngjalljen tënde, i zbraze gjithë mbretëritë e Hadhit, o mbret i pavdekshëm.

Edhe pse bëje gjëra të mëdha e të çuditshme mbi dhe, o Fjalë, të vrau një popull i paudhë; por ti, o Zoti Krisht, duke qenë i vetmi i fuqishëm, u ngjalle prej së vdekurish siç kishe thënë më parë.⁴⁸

Kur ia hape sytë atij që s'e kishte parë dritën e dukshme, i ndriçove bebet dhe e binde të të lavdëronte se të njohu si Bërës që u shfaqe si njeri nga dhembshuria.

Lavdi *Triadik*

Të gjithë ne, shpresëplotët, le ta lavdërojmë Trininë në Njësi dhe Njësinë në Trini, Atin dhe Birin dhe Shpirtin e drejtë, Një Perëndi, realisht Krijues të çdo gjëje.

Tani *Hyjlindësor*

O Nënë-vgjërshë e dëlirë, e hyjhirshme, si linde kur nuk kishe njohur burrë? Si e ushqen atë që ushqen Krijesën? – Siç e di vetëm ai, Perëndia dhe Bërësi i të gjithave.¹

Zbritësore: Orthrizontes voomen si

»**O** Zot, mëngojmë⁴⁵ dhe të thërrasim ty: »Na shpëto ne,* se je Perëndia yn',*veç »teje s'njohim ndonjë tjetër.⁴⁹

Ode VI
I Hyjlindësës

Ai që u kap lashtë prej vdekjes dhe prishjes, u lirua me anë të atij që u mishërua prej barkut tënd të pacen dhe u udhëzua për te jeta e paprishshme dhe e amshuar, o Perëndilindëse e virgjër.

Ai që zbriti dhe banoi në mitrën tënde, dhe u mishërua përmbi mend, zbriti në më të poshtmet e tokës, o e Dëlrë, dhe, kur u ngjall prej varrit, e ngriti Adamin me veten e tij.

I të Verbrit
Os ton profitin tu thirós

[Irmosi: »Siç e çlirove shën profetin nga »një bishë tmerr, dhe mua më nxirr nga »thellësia e pasioneve që s'frenohen dot,* »lutem ta shoh edhe un' një herë, Zot,* o »Krisht, Tempullin tënd të shenjtë.^{50]}*

Ti që u kryqëzove me kusarët,²⁴ nga çdo ves* shpirtprishës dhe çdo kusar dinak i ke çliruar, o njeridashës Zot,* gjithë sa, ngjalljen dhe kryqëzimin tënd,* e himnojnë bashkë me një zë.

Si një të vdekur pa frym', Zot, në varr të vunë ty*³¹ që gjithë të vdekurve u fryn jet',⁵¹ por u ngjalle edhe i zbraze ti,* Krisht Fjalë, varret e tëra nëpërmjet* forcës sate krejt hyjnore.

Pas ngjalljes, ti u thoshe miqve,⁵² o Krisht: "Rrini ju* këtu në Jerusalem pra derisa të vishni forcën që s'mposhtet dot,* që do të vijë nga lart,⁵³ do keni ju* aleancë të sigurt krejt".

Si bërë balt', syt' e të verbrit që nga lindja, Zot,* i leve; kështu shikimin, Fjalë, ia dhurove, ndaj e himnonte fort* forcën pa cen që ke, me të cilën, Krisht,* e shpëtove mbarë botën.

Lavdi Triadik

Njësi trihipostate, Atë i palindur, Bir* i lindur dhe Shenjti Shpirt që del, Zot i trishenjtë, Një forc', Një mbretëri* dhe Një esencë, shpëtoje popullin* tënd të tërë shpresëplotë.

Tani Hyjlindësor

Kush do t'i shprehë madhështit' e tua, Virgjërsh'?* E linde në trup përmbi natyrë Perëndinë³⁶ që, përmes teje pra,* o e dëlir', e fortpaqortueshme,* nga çdo faj çlironte botën.

Zbritësore: Eqiklosé me ávisos

»Avusha më rrethoi, varr për mua u bë »pra i madhi peshk,* por unë drejt teje »thirra,⁵⁰ je Njeridashës, Zot* dhe më »shpëtoi e djathta jote, Çlirimtar.

Kontaqi Ting. IV Epefanis símeron

Kam dëmtim në syt' mendor',* ndaj unë po vij* te ti si i verbri qyq* nga lindja edhe të thërras* me shumë pendim: Dritë plot shkëlqim* je për sa janë në terr,⁵⁴ në mëkat, o Krisht.

Shtëpia

O Krisht, drita e të errësuarve dhe udhëzuesi i të humburve,⁵⁴ më dhuro rrjedhjen e urtësisë mistike dhe të dijes së sipërme, që t'i rrëfej ato që na mësoi libri hyjnor i Ungjillit të paqes,⁵⁵ d.m.th. mrekullinë e të verbrit, se, megjithëse ishte i verbër nga lindja, i merr sytë shqisorë dhe shpirtërorë, duke thirrur besërisht: Dritë plot shkëlqim je për sa janë në terr,⁵⁴ në mëkat, o Krisht.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Gjashtë pas Pashkës, kremtojmë çudinë që u bë tek i verbri prej Zotit dhe Perëndisë dhe

Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Varg: Meqë je dhënë i dritës, o Dritë më e madhe se drita,/ o Fjalë, i jep shikimin të verbrit që nga lindja.

O dritëdhënësi Krisht, Perëndia ynë, me anë të përdëllimit tënd të pamasë, mëshirona dhe shpëtona. Amin

*Ode VII
I Hyjlindësës*

Biri yt, pasi e vrau vdekjen, o e Tërëpaqortueshme, u dhuroi sot të gjithë vdekatarëve jetë të qëndrueshme në jetë të jetëve^{55a} ai, i vetmi Perëndia i etërve, i bekuar dhe i përmbilavdëruar.

Ai që mbretëron mbi çdo krijesë, kur u bë njeri, banoi në mitrën tënde, o e Hyjhirshme; dhe, kur duroi Kryq dhe vdekje, u ngjall siç duhej hyjnisht dhe na ngriti tok me veten e tij, si i tërëfuqishëm.

*I të Verbrit
Pirós svestírion*

[Irmosi: »E fiku lutja e Tre Djemve zja-rrin e madh; kamina freskuese e shpall-te fort çudin',* se s'i digjte fare shën»himnuesit* e Perëndisë dhe Zotit të»etërve tan'⁵⁶.]*

Kur u vare mbi dru, o Shpëtimtar, dielli u fik,⁵⁷ dheu lëkundej, mbarë Krijesa tundej³⁵ dhe të vdekurit ngriheshin nga varret.⁵⁸

Kur u ngrite nga të vdekurit, o Mbret, u ngritën bashkë me ty shpirtrat që flinin atje dhe që e lëvdonin pushtetin tënd nëpërmjet të cilit u dërrmuan prangat.

Erdhi në agim një kor grash që të të lyente me miro dhe, kur mësoi se ishte ngritur, o Zot, ngazëllohej⁵⁹ së bashku me Nxënësit e hyjnueshëm; me anën e tyre na jep ndjesën e të këqijave.

I leve me baltë sytë e të verbrit dhe e urdhërove të shkonte në Siloam; dhe ai, kur u la, shkoi duke të himnuar, o Krisht, mbret i gjithçkaje.

Lavdi Triadik

Le ta përhimnojmë Atin e pafillim, Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e Tërëshenjtë: I Shenjtë, i shenjtë, i shenjtë je,³⁴ o Perëndi, mbret i gjithçkaje.

Tani Hyjlindësor

Oe pacen, pas shtatzënisë, u shfaqe si Virgjëreshë e kulluar, sepse linde Perëndinë që i ripërtëriti natyrat me fuqinë e tij; përgjëroju atij që të na shpëtojë.

Zbritësore: O en kamino pirós

»Ti që në furr' zjarri përhimnuesit i ke »shpëtuar,⁵⁶ je i bekuar, o Perëndi i »etërve tan'.⁶⁰

*Ode VIII
I Hyjlindësës*

Bërësi erdhi në botë nëpërmjet teje, o Perëndilindëse virgjëreshë, dhe, pasi e çau barkun e Hadhit, na dhuroi ngjalljen neve vdekatarëve, ndaj e bekojmë në jetë.

O Virgjëreshë, kur e rrëzoi absolutisht pushtetin e vdekjes me anë të ngjalljes së tij, Biri yt, si Perëndi i fortë, na bashkëllartësoi dhe na hyjnizoi, ndaj e përhimnojmë në jetë.

*I të Verbrit
Agjelon sístima*

[Irmosi: »O rende engjëlllore, o grup »njerëzor, të gjithë, mbretin, krijuesin »e botës, himnojeni tok;* lartësoje, o »popull,* priftërinj, levitë bekojeni në »jetë.⁶¹]*

U habitën brigadat e engjëjve sapo të panë, të frikësuar, varur mbi Kryq, o Krisht tërëmbret, që e ndryshojë mbarë Krijesën⁵⁷ dhe e himnonin njeridashjen tënde.

O Krisht, kur të pa poshtë, Hadhi psherëtiu dhe i ktheu me nxitim të vdekurit që ishin burgosur⁶² atje që nga jeta, të cilët e himnonin njeridashjen tënde.

Megjithëse bëje mrekulli kolosale, o Krisht, u lartësove vullnetarisht në Kryq²⁹ dhe u bashkove me të vdekurit ti që e vrave Hadhin dhe i çlirove me burrëri gjithë të prangosurit.

O Krisht, e shërove një të verbër që të erdhi, kur e urdhërove të lahej në burimin e Siloamit, të shikonte dhe të të shpallte si Perëndi që u shfaqe në trup³⁶ për shpëtimin e botës.

Lavdi *Triadik*

O Trini e pandarë, Njësi pa ngatërrim, Perëndi i të gjithave dhe Bërës i çdo gjëje, shpëtoji nga ngasjet e shumëllojshme ata që të himnojnë dhe i falen besërisht pushtetit tënd.

Tani *Hyjlindësor*

O Virgjërëshë e pacenuar, e hyjhirshme, përgjeroju Birin tënd përherë, që të mos më turpërojë rëndë në ditën e gjykimit, por të më renditë bashkë me delet e zgjedhura.⁶³

Zbritësore: Ton ek Patrós pro eonon

»**M**bilartësoje, o popull, priftërinj për-
»himnojeni tok* në gjithë jetët⁶¹ pra Birin
»Perëndi që lindi prej Atit Zot* para jetës
»edhe në koh' të fundme mori mish nga
»e virgjra nënë.

Ode IX

I Hyjlindësës

Tok ne, gjith' besnikët, të lumërojmë, Virgjërësh',* ki gaz, porta e Zotit;*⁴ ki gaz ti, qytet frymor;* ki gaz, përmes teje na feksi nur sot* drita e Krishtit që ti na linde,* drita e ngjalljes prej varreve.

O derë hyjnore⁴ e Dritës, ki gaz dhe dëfre;* perëndoi në varr, por* lindi Krishti; shndriti fort,* më hijesisht dhe se dielli lart,* Zonjë e hyjhirshme, dhe i feksi* besnikët mbarë, Jisui Zot.

I të Verbrit

Oti eplisë si megalia

[Irmosi: »Zoti i fort' të madhështoi⁶⁴
»meqë të shfaqti ty* të virgjër, të kullu-
»ar dhe pas shtatzënisë, se, pa far',* e
»ke lindur, Zonj', Bërësin tënd, prandaj
»edhe ne,* Hyjlindëse, të madhështojmë
»përherë.]

Krisht Perëndi, u ngule përmbi drurin e Kryqit tënd* dhe triumfove mbi çdo autoritet armiqësor,*⁶⁵ dhe e zhduke mallkimin e atëhershëm,²⁷ prandaj* të madhështojmë, Shpëtimtar, detyrimisht.

Fjalë, thell' Hadhi, kur të pa me shpirt, psherëtiu fort,* të vdekurit të gjithë i lëshoi ngaqë kishte frik',* ndaj e njohën ata forcën e pushtetit tënd, Zot;* me ta detyrimisht të madhështojmë ne.

Bënte çudi të tmerrshme mrekullueshëm Zoti Krisht.*⁶⁶ E shihte bashkësia hebraike, kishte xhelozitë*⁶⁷ dhe e vrau, por Hadhin e zbrazti krejt kur u ngjall* teksa të gjithë tok i ngrinte si i fort'.

Siç the, u ngrite, jetëdhënës Zot, nga të vdekurit,*⁴⁸ u shfaqe te shën Nxënësit pas ngjalljes⁶⁸ ti që bëre, Krisht,* mrekulli

dhe shërove të verbër,⁶⁹ ndaj tok me ta,* në gjithë jetët, ne të madhërojmë ty.

Lavdi *Triadik*

Atin e adhuroj si drit',⁷⁰ si drit' Birin⁷¹ e lëvdoj,* të Drejtin Shpirt si dritë e himnoj, Një drit' pa ndarje hiç* që kuptohet në tri karaktere, shën Perëndi* dhe mbret të çdo Krijese, fuqiplotin Zot.

Tani *Hyjlindësor*

O Virgjëreshë e dëlirë, pa cen, u duke ti* dhe më e gjer' nga qiejt, se në mish e nxure Perëndin'* që s'përshkruhet; e kishe në barkun tënd si çlirim* për gjith' sa të himnojne pa ngurrim me bes'.

Zbritësore: Se tin ipër nun

»**M**e një mendje ne besnikët ty të madhërojm',* shenjten nënë mbi fjalë dhe »mendim, që në kohë, mot,* të pakoh- »shmin e kishe në bark pa shpjegim.

I shenjtë është Zoti Perëndia ynë. (3x)

Dërgimësore

E Pashkës Ting. II Sarki ipnosas

Si fjete si njeri me trup,* o Mbreti ynë Zoti Krisht,* u ngjalle të tretën ditë,* dhe ngrite gjyshin shën Adam,* dhe e dërrmove vdekjen krejt.* Pashkë⁷² burim i jetës, shpëtim i besnikëve.*

E të Verbrit E ngjashme

Syt' shpirtërorë, Zot, i kam* të verbër prej mëkatit skrop,* prandaj më ndriço, i dhembshur,* pasi të më vendosësh, Krisht,* përulësi dhe kataniks* edhe me lot pendimi të më bësh të pastër shumë'.

Tjetër: Jineqes akutisthite

Kur ecte Shpëtimtari yn',* takoi një të verbër qyq.* Dhe, si pështyu posht', bëri* pak baltë, me të e leu* "Shko ti në

Siloam", i tha,* "dhe atje lahu", ndaj ai* shkoi dhe erdhi si u la,* dhe dritën tënde e shihte,* o Krishti im dritëdhënës.

Lavdërime: 7 Ngjallësore dhe 1 i të Verbrit Ngjallësoret Ting. Tërth. I

O Zot, kur ishte varri i vulosur...

O Zot, duke dërrmuar...

O Zot, gratë rendën në varr...

O Zot, sikundër dole nga varri...

O Zot, o Mbret i jetëve...

O Zot, kush do t'i tregojë çuditë...

Gratë miroprrurëse shkuan...

Dhe i të Verbrit

Idhiomel Ting. Tërth. IV

Varg: Më mbikëqyr dhe më mëshiro.

O Krisht Perëndi që u mishërove nga mëshira e madhe,⁷³ i preke me gishtërinjtë e tu bërës dhe me dhé bebet e atij që nuk e kishte dritën që nga mitra; kështu e denjësove për llamburitjen hyjnore nga dhembshuritë e mëdha e të parrëfyeshme;⁷⁴ vetë ti dhe tani, o dritëdhënës, na i ndriço shumë shqisat e shpirtave, si i vetmi që jep pa kursim.

Lavdi *Injëjti*

Kush do të flasë për fuqitë e tua, o Krisht? A kush do t'i numërojë mrekullitë e tua të shumta? Meqë, siç u shfaqe mbi dhé i dyfishtë nga mirësia, ashtu ua jepje të dyfishta shërimet të sëmurëve; se atij që ishte invalid që nga mitra, nuk i hape vetëm sytë e trupit, por edhe të shpirtit; prandaj të pohonte si Perëndi që fshihej dhe që ua jepte të gjithëve përdëllimin e madh.³

Tani

E përmbibekuar je...

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji [Tipiket dhe Lumërimet: 4 të Tingullit dhe 4 nga Ode VI e të Verbrit. Hyrtoja Ejani t'i falemi... Shpëtona... që u ngjalle... ose] Antifonet dhe Hyrtoja e Pashkës. Pas Hyrjes, Përlëshorja ngjallësore dhe e kishës. Kontaqi i Pashkës. Në vend të Të meriton, O shpirt madhështojë... Ndrìçohu, ndrìçohu.. Kungatore Lavdërojeni... Në vend të Pamë dritën, Krishti u ngjall.



TË DIELËN E TË VERBRIT NË MBRËMËSORE

Ting. Tërth. I Heris askitikón

Fjalë, je sy, të njohim si sy,* Bërës të njerëzve të plot' në gjymtyrë dhe* të syve të trupit ton' tokësor, gatues të ri* që bën sy; ndaj, tashmë me përzierjen ti* me dhé dhe pështymë tok,* e shëron parrëfyeshëm* të verbrin qyq me* gish-tërinjtë e tu, o Zot,* që formojnë sakt'* dhe shikimin, dhe baltën, Krisht,* ndaj po shikon i verbri që nga lindja siç sheh çdokush,* edhe pse s'e shihte diellin dot, të sheh ty, pra diellin*¹⁸ e ëmbël, e sheh fort* dhe ikonën e gatuesit ton' të mirë krejt.

I kish në rregull gjymtyrët mbar',* - siç i ka trupi pra i njerëzve normalisht -* i verbri krejt që nga mitra e nënës, megjithatë* s'kish ide për botën, se qe plotësisht* pa sy, ndaj përdridhej ky* si në këmbë edhe në trup,* sepse pengohej* shpesh nga gurët dhe binte keq,* por me ty e merr* pasurin', sytë, dhe të sheh,* o drit' e botës,⁷¹ dhe të shpall si dhënës të dritave,* si hegjemon, Perëndi dhe

Ndërtues, Zot mbarëbotëror* të tërë Krisjesës,*¹ dhe kërcen nga ngazëllimi i madh, o Shpëtimtar.

Shkruesit po verbohën në shpirt*⁷⁵ vullnetarisht nga germa, hija e Ligjit pra,* kur Krishti, i ëmbli diell, ndrit si e bëri të ri* për gjith' ne pushimin e të shtunave;* kështu, të paudhët mjaft* për të verbrin dyshojnë fort:* Si u shërua* ky i verbër? Qe keq më par'.* Thonë se s'sheh dot,* bën sikur sheh, gënjen ai* për hir të Shpëtimtarit që heq perden e Ligjit krejt,*⁷⁶ dhe e feks hijen,⁷⁷ dhe dritën e tij ua jep ish-të verbërve* dhe tash e shikojnë* dhe i shpallin botës dhënësin Zot të dritave.

*Dhe 3 të Mujorit.**Lavdi dhe Tani Ting. II*

Ai që lindi i verbër, thoshte me vete: Mos vallë kam lindur i verbër për shkak të mëkateve të prindërve? Mos vallë kam lindur si shfaqje për mosbesimin e kombeve? S'kam fuqi të pyes kur është natë e kur është ditë. Këmbët e mia janë rraskapitur dhe pengohen nëpër gurë, ngaqë nuk e kam parë diellin kur shkëlqen as në ikonë atë që më gatoi. Prandaj të lyp, o Krisht Perëndi: Hidhi sytë mbi mua dhe mëshiromë.

*Pasvargjet Ting. Tërth. I**Ngjallësor*

Me Kryqin tënd të nderuar, o Krisht, turpërove djallin, dhe me Ngjalljen tënde e nxore thumbin e mëkatit⁷⁸ dhe na shpëtove nga dyert e vdekjes.⁷⁹ Të lavdërojmë, o i Vetëmlindur.*

Varg: Ngrita sytë e mi drejt teje që banon në qiell; ja, si sytë e shërbëtorëve janë në duart e zotërinjve të tyre, si sytë e shërbëtores në duart e zonjës së saj,

kështu sytë tanë janë drejt Zotit tonë, derisa të na mëshirojë.

Kataniktik

O Zot, nuk pushoj së mëkatuari, dhe, sado më bën të denjë për njeridashje, nuk e kuptoj; munde zemërngurtësinë time, o i vetmi i mirë, dhe mëshiomë.

Varg: Mëshirona, o Zot, mëshirona, sepse për shumë kohë u mbushëm me poshtërim, për më shumë u mbush shpirti ynë; përqeshja qoftë te të mirëqenët dhe poshtërimi te krenarët.

Martirik

O martirë të tërëfamshëm, meqenëse i shpërfillët të gjitha tokësoret dhe u futët me guxim dhe burrërisht në tortura, nuk dështuat në shpresat e lumtura,⁸⁰ por u bëtë trashëgimtarë të mbretërisë⁸¹ së qiejve; duke pasur guxim para Perëndisë njeridashës, kërkon paqen për botën dhe për shpirtrat tanë përdëllimin e madh.³

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Duke kaluar nga Hierorja, Jisui gjeti një njeri të verbër që nga lindja dhe, pasi e dhembshuroi, vuri baltë mbi sytë e tij dhe i tha: “Shko, lahu në rezervuarin e Silo-amit”. Dhe, kur u la, ai shikoi duke lavdëruar Perëndinë. Dhe familjarët e tij i thoshin: “Kush t’i hapi bebet të cilat nuk mund t’i shëronte askush nga ata që shohin?”. Dhe ai thirri: “Një njeri i quajtur Jisu më tha: «Lahu në Siloam» dhe pushë. Ky është me të vërtetë ai për të cilin ka folur Moisiu në Ligj si Krisht Mesia; ai është shpëtimtari i shpirtrave tanë.”

Përlëshore Ngjallësore (Fjalën e panisëshme... dhe Gëzohu, derë e Zotit e pakaluar...).

TË HËNËN E JAVËS VI NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. Tërth. I

Ngjallësore Ton sinanarhon Logon

Përlëvdoheni Kryqin e Shpëtimtarit Krisht,* dhe me këngë Varrimin e tij nderojeni,* edhe Ngjalljen pas tri ditësh lavdërojeni,* se të burgosurit në Hadh* dhe të vdekurit në varr* i ngriti Zot’ i fuqishëm,* dhe e theu fuqin’ e djallit, edhe i ndriti t’errësuarit.*

Kataniktike

Le të rrimë zgjuar dhe le t’i dalim para Krishtit të gjithë ne me shumicë mëshire dhe llamba të ndritshme, që të denjësohemi për të hyrë brenda në nusërore, se ai që flet nga jashtë derës, pa efekt i thërret Perëndisë: Mëshiomë.⁸²

Martirike

O Zot, athloforët e tu, meqë e patën zili gotën e pësimit tënd,⁸³ e lanë kënaqësinë e jetës dhe u bënë shokë me engjëjt; me lutjet e tyre jepu shpirtrave tanë ndjesë dhe përdëllimin e madh.³

Hyjlindësore

Qielloret bashkë me engjëjt, dhe tokësoret bashkë me njerëzit të thërrasim ty, o Hyjlindëse, me zë ngazëllimi: Gëzohu, o portë më e gjerë se qiejt;⁸⁴ gëzohu, i vetmi shpëtim i vdekatarëve; gëzohu, o e thjeshtë; gëzohu, o hirplote¹⁵ që linde Perëndi të mishëruar.

Pas Stihologjisë së dytë,

Ndenjëso e të Verbrit

Ting. Tërth. I Ton sinanarhon Logon

Kur po ecje përpara ngjalljes dhe Kryqit, Zot,* i dhembshur, një invalid që nga



lindja, mjaft nxehtësisht,* të thërriste: “Mëshirom’, Bir i Davidit mbret,* dritën e syve ti ma jep* të të shoh dhe unë”; kur, o Fjalë, ia leve bebet* me pak baltë, që bëre ti me pështymë, fort shkëlqyeshëm i dhe drit’.

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I të Verbrit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e të Verbrit. Pas Odes VI, Kontaqi i të Verbrit. Në Oden IX, Më të nderuarën, Dërgimësoret e të Verbrit.*

*Lavdërimi Ting. Tërth. I
Ngjallësor*

O Zot, kur ishte varri i vulosur prej të paligjve,²¹ dole prej tij, sikundër linde prej Hyjlindëses; nuk e kuptuan si u mishërove, engjëjt e tu pa trup; nuk të ndjenë kur u ngjalle, ushtarët që të ruanin; se që të dyja këto janë të vulosura për ata që kërkojnë, dhe u janë shfaqur çuditë atyre që i falen misterit me besë. Neve që e përhimnojmë, jepna si shpërblim ngazëllimin⁸⁵ dhe përdëllimin e madh.^{3*}
(2x)

Kataniktik

Mjerrë! Pse u bëra i ngjashëm unë me fikun e pafrytshëm dhe trembem për mallkimin⁸⁶ dhe prerjen?⁸⁷ Por, o bujk përmbiqiellor, Krisht Perëndi, shpirtin tim djerrë tregoje të frytshëm dhe, si Birin e Sththurur, pranomë⁸⁸ dhe mëshiromë.

Martirik

E bekuar është ushtria e mbretit të qiejve, sepse, ndonëse athloforët ishin të dhelindur, nxitoheshin të arrinin gradën engjëlllore, pasi i shpërfillën trupat dhe u denjësuat me anën e pësimeve për çmimin e të patrupëve. Me uratat e tyre, o Zot, shpëtoji shpirtat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. IV

Duke e konsideruar tërë jetën si natë, i verbri të thirri, o Zot: Hapmi bebet, o Bir i Davidit, Shpëtimtari ynë, që edhe unë së bashku me të gjithë ta himnoj fuqinë tënde.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. Tërth. I Ósie pater*

Shfaqet i verbri tek ata që gjoja shihnin qart’*⁷⁵ si verbëri dhe shpirtin, dhe mendjen ua errëson,* ndërsa e shohin shërimin e tij befas,* ndaj e thërrasin dhe me blof pyesin:* Tash, si po të shohim* si një nga sa krejt shohin,* sado qe pa sy nga lindja ti* dhe rrije udhës i ulur porsi lypsar?*. Ai e shfaq pra* dhuruesin e dritës* që i ka bër’ dritat në bot’,*⁸⁹ që e shpallin* si Bir të parapafillim të Perëndisë* që, në fund, nga e Virgjra u shfaq* njeri prej Shpirtit Shenjt,⁹⁰ Hyjnor, se kish dashuri.

Varg: Shtjer sytë mbi mua dhe mëshiromë.

Dukej për tokën si një barrë që e lodhte mjaft,* kështu e shihnin njerëzit ndërsa ecte ai,* i verbri, dhe i vriteshin këmbët udhës* sado kish, si shikim dhe pasje, një shkop;* ndaj te dritëdhën’si* përikën, e merr prej tij* shikimin, dritën edhe e sheh* me sy Gatuesin Zot që natyrën ton’* pra njerëzore krejt* prej dheut,⁴⁷ më përpara,* e bëri pas ikonës së tij,* ngjashmërisë*⁹¹ dhe tash me baltë dhe pështymë i ndriçoi fort* bebet edhe nga dhembshuria* i dha porsi dhuratë të shihte diellin.

Varg: Hapat e mi drejtoji sipas fjalës sate.

Sapo i verbri e pa dritën, Fjalën e Atit* e pa në trup të njëjtë me pamjen e njerëzve,* përmes tij e pa, si njerëzit e tjerë,* Diellin Zot mbi ditën⁹² dhe drit’pru-

rës;* g'zohej për shikimin* komplet të ri, prandaj dhe* po ecte drejt, s'e pengonte gur* në monopate dhe njerëzit e shihnin.* Ndriçuesin e tij* si Bir të Perëndisë* e njihte, dinte se u bë trup* nga keqardhja,* por mbeti çfarë që teksa u bë njeri krejt* dhe që mori atë që s'ishte,* edhe bashkimin pa ngatërrim e ruajti.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*

O Zot, duke ecur rrugës, gjete një njeri të verbër që nga lindja dhe Nxënësit, të çuditur, të pyetën duke thënë: “O Mësues, kush ka mëkatuar që ka lindur i verbër, ai apo prindërit e tij?”. Dhe ti, o Shpëtimtari im, i thirre: “Nuk ka mëkatuar as ai, as prindërit e tij, por për t'u shfaqur veprat e Perëndisë tek ai; unë duhet t'i kryej punët e atij që më dërgoi, të cilat nuk mund t'i kryejë askush”. Dhe, kur i the këto, pasi pështyve përtokë dhe bëre baltë, ia lyeve sytë duke i thënë: “Shko, lahu në rezervuarin e Siloamit”. Dhe ai, kur u la, u shërua dhe të thërriste: “Besoj, o Zot!”, dhe t'u fal. Ndaj thërrasim dhe ne: “Mëshirona!”.



TË HËNËN E JAVËS VI NË MBRËMËSORE

Thirrtores Idhiomele të të Verbrit

Ting. II

Ai që lindi i verbër, thoshte me vete: Mos vallë kam lindur i verbër për shkak të mëkateve të prindërve? Mos vallë kam lindur si shfaqje për mosbesimin e kombeve? S'kam fuqi të pyes kur është natë e kur është ditë. Këmbët e mia janë rraskapitur dhe pengohen nëpër gurë, ngaqë nuk e kam parë diellin kur

shkëlqen as në ikonë atë që më gatoi. Prandaj të lyp, o Krisht Perëndi: Hidhi sytë mbi mua dhe mëshiromë.

I njëjti

Duke kaluar nga Hierorja, Jisui gjeti një njeri të verbër që nga lindja dhe, pasi e dhembshuroi, vuri baltë mbi sytë e tij dhe i tha: “Shko, lahu në rezervuarin e Siloamit”. Dhe, kur u la, ai shikoi duke lavdëruar Perëndinë. Dhe familjarët e tij i thoshin: “Kush t'i hapi bebet të cilat nuk mund t'i shëronte askush nga ata që shohin?”. Dhe ai thirri: “Një njeri i quajtur Jisu më tha: «Lahu në Siloam» dhe pashë. Ky është me të vërtetë ai për të cilin ka folur Moisiu në Ligj si Krisht Mesia; ai është shpëtimtari i shpirtrave tanë.”

Ting. IV

Duke e konsideruar tërë jetën si natë, i verbri të thirri, o Zot: Hapmi bebet, o Bir i Davidit, Shpëtimtari ynë, që edhe unë, së bashku me të gjithë, ta himnoj fuqinë tënde.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O Zot, duke ecur rrugës, gjete një njeri të verbër që nga lindja dhe Nxënësit, të çuditur, të pyetën duke thënë: “O Mësues, kush ka mëkatuar që ka lindur i verbër, ai apo prindërit e tij?”. Dhe ti, o Shpëtimtari im, i thirre: “Nuk ka mëkatuar as ai, as prindërit e tij, por për t'u shfaqur veprat e Perëndisë tek ai; unë duhet t'i kryej punët e atij që më dërgoi, të cilat nuk mund t'i kryejë askush”. Dhe, kur i the këto, pasi pështyve përtokë dhe bëre baltë, ia lyeve sytë duke i thënë: “Shko, lahu në rezervuarin e Siloamit”. Dhe ai, kur u la, u shërua dhe të thërriste: “Besoj, o Zot!”, dhe t'u fal. Ndaj thërrasim dhe ne:

“Mëshirona!”.

Tani *I njëjti Hyjlindësore Dogmatike*

Në Detin e Kuq u përshkrua dikur ikona e Nuses së pamartuar. Atje Moisiu, që ndau ujin;¹⁴ këtu Gabrieli, shërbëtori i çudisë.⁹⁰ Atëherë Izraeli kaloi në këmbë përmes thellësisë së detit, pa u lagur;¹⁴ ndërsa tani Virgjëresha lindi Krishtin pa farë. Deti, pas kalimit të Izraelit, mbeti i pashkelur;¹⁴ e Pacenuara, pas lindjes së Emanuelit, mbeti e paprekur. O Perëndi, që je¹⁶ dhe ishe më parë, dhe u shfaqe si njeri, mëshirona.*

*Pasvargë Ngjallësore**

Ting. Tërth. I

Me Kryqin tënd të nderuar, o Krisht, turpërove djallin, dhe me Ngjalljen tënde e nxore thumbin e mëkatit⁷⁸ dhe na shpëtove nga dyert e vdekjes.⁷⁹ Të lavdërojmë, o i Vetëmlindur.

Varg: Zoti mbretëroi, u vesh me hijeshi. Zoti u vesh dhe u ngjesh me fuqi.

Ai që i fal Ngjalljen gjinisë së njerëzve, u çua për therje si dele.⁹³ U tmerruan prej tij krerët e Hadhit dhe u hapën dyert e vuajtjes. Se hyri Krishti, Mbreti i lavdisë,⁹⁴ duke u thënë të burgosurve “Dilni”, dhe atyre që ishin në errësirë “Shfaquni”.

Varg: Sepse i dha fuqi botës e cila nuk do të lëkundet.

Çudi e madhe! Krijuesi i të padukurave, si pësoi trupërisht nga njeridashja, u ngjall i pavdekuri. Ejani, o breza kombesh, t’i falemi këtij; se, pasi shpëtuam prej kurthit me dhembshurinë e tij, mësuam të himnojmë një Perëndi në tri Hipostaza.

Varg: Shtëpisë sate i ka hije shenjtërimi, o Zot, për ditë të gjata.

Ty, Krishtin Shpëtimtar, që u mishërove dhe nuk u ndave prej qiejve, me zëra dhe këngë po të madhërojmë, se durove Kryq e vdekje për gjininë tonë si Zot njeridashës dhe, pasi theve dyert e Hadhit, u ngjalle pas tri ditësh, duke shpëtuar shpirtrat tanë.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. IV*

O Krisht Perëndi, diell mendor i drejtësisë,¹⁸ ti që me prekjen tënde të pacen e ndriçove dyfish atë që nuk e kishte dritën që nga mitra, shndriti edhe sytë e shpirtrave tanë dhe tregona bij dite,¹⁹ që të të thërrasim besërisht: Dhembshuria jote është e madhe për ne dhe e parrëfyeshme; o njeridashës, lavdi më ty.

Përlëshore Ngjallësore (Fjalën e panisëshme... *dhe* Gëzohu, derë e Zotit e pakaluar...).



TË MARTËN E JAVËS VI NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores Ngjallësore**

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Përlëvdoheni Kryqin e Shpëtimtarit Krisht,* dhe me këngë Varrimin e tij nderojeni,* edhe Ngjalljen pas tri ditësh lavdërojeni,* se të burgosurit në Hadh* dhe të vdekurit në varr* i ngriti Zot’ i fuqishëm,* dhe e theu fuqin’ e djallit, edhe i ndriti t’errësuarit.

Lavdi

O Zot, u shpalle i vdekur, ti që vrave vdekjen; në varr u vendose, ti që zbraze varret; ushtarët përsipër ruanin varrin,²¹

dhe ti përposhtë ngjalle të vdekurit ndër shekuj. O Zot i Tër'fuqishëm dhe i pakuptueshëm, lavdi më ty.

Tani *Hyllindësore Ton sinánarhon Logon*
Lum e lum ti, o mal, ku²² bariti Zot' i madh;*²³ lum e lum ti, o ferrë, që nuk u dogje dot;* lum e lum, o urë, që na shpie në shpëtim,* në Parajs' e në dëfrim* dhe në jetën pa mbarim,* o Nën' e shenjtë, gëzohu, që virgjërisht na ke lindur* Shpëtimtarin tonë Jisu Krisht.

*Pas Stihologjisë së dytë,
 Ndenjësores e të Verbrit*

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Me pështymën e Zotit Krisht, që me duar sakt'* i bëri më parë njerëzit,⁴⁷ ky i verbër shikon,* sado diellin e madh nga lindja s'e kish par',* ndaj e falënderon me shpirt* Perëndinë si e pa ikonën e tij që ishte* e gatuar siç qe ikona e Zotit Bërës të ikonës krejt lasht'.⁹¹ (2x)

Ne që pamë Ngjalljen, *Psalmi 50 dhe Kanunet: I të Verbrit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e të Verbrit. Pas Odes VI, Kontaqi dhe Shtëpia e të Verbrit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e të Verbrit.*

Lavdërime Ngjallësore Ting. I

O Zot, kur ishte varri i vulosur...

O Zot, duke dërrmuar kyçet...

O Zot, gratë rendën në varr...

O Zot, sikundër dole nga varri...

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Kush do të flasë për fuqitë e tua, o Krisht? A kush do t'i numërojë mrekullitë e tua të shumta? Meqë, siç u shfaqe mbi dhe i dyfishtë nga mirësia, ashtu ua jepje

të dyfishta shërimit të sëmureve; se atij që ishte invalid që nga mitra, nuk i hape vetëm sytë e trupit, por edhe të shpirtit; prandaj të pohonte si Perëndi që fshihej dhe që ua jepte të gjithëve përdëllimin e madh.³

*Pasvargje të të Verbrit
 Ting. Tërth. I Ósie pater*

Një llamburitje dritëprurëse që feksi fort* dhe haptas tek i verbri i shndritur një të shtunë,* të rriturit në ligjet e Moisiut* vullnetarisht e panë si në hije,*⁷⁷ mbetën si të verbër*⁷⁵ s'e din' hijen-mbushësen* e Ligjit,⁷⁶ ndaj s'e shikuan dot* atë që bëri me fjalë të shtunën pra,*⁹⁵ që e shëroi krejt* të verbrin me një larje* dhe me të renë bërje, baltën* me pështymë.* Si të bashkohemi me të, do shohim Perëndin';* verbërinë farisiane*⁷⁵ ta kritikojmë ne me shikimin prej Hyjnis'.

Varg: Shtjer sytë mbi mua dhe mëshiromë.

Drita e syve si agim lind për të verbrin qyq* të vuajtur mjaft, që po jetonte në terr nate* ku s'ka shikim, si bën dush me urdhër hyjnor* në Siloam, në gurrën e tij, prandaj* shfaqet dritëprurës* i ri dhe kritikon repret'* dhe natën, mjegullën tërë terr* që kanë Shkruesit Ligjorë⁷⁵ dhe ua shndrit* me dritë plot shkëlqim* manin' e errësuar;* kjo dritë zhduk çdo verbëri, nat',* që ka hija*⁷⁷ e germës⁹⁶ së mëparshme. Bëhet kjo punë saktë* me shkëlqimet e hijshme plot nur* që Fjala Zot na jep me bekim të madh gjithnjë.

Varg: Hapat e mi drejtoji sipas fjalës sate.

Shkoi në lartësi, në gjendje dritëprurëse* i verbri kur u shndrit me një dritë hydjijeje* edhe pse qe më par' nga të dyja anët* absolutisht i verbër pa sy, dhe njeh* Krishtin dritëbërës* dhe dritëdhënës si

Zot.* Ai shkëlqeu pas tri ditësh* nga varri edhe, me ngjalljen e tij, i dha* gaz dheut; përmes saj,* mbi njerëzit në pranga,* në errësirë,⁹⁷ fekso dritë* rigatimi* për shkak të dhembshurisë dhe të përdëllimit* mjaft të madh; Krishti, Shpëtimtari* ka dhembshuri të madhe ndaj dhe na mëshiron.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

O Krisht Perëndi, diell mendor i drejtësisë,¹⁸ ti që me prekjen tënde të pacen e ndriçove dyfish atë që nuk e kishte dritën që nga mitra, shndriti edhe sytë e shpirtrave tanë dhe tregona bij dite,¹⁹ që të të thërrasim besërisht: Dhembshuria jote është e madhe për ne dhe e parrëfyeshme; o njeridashës, lavdi më ty.

Mbyllet e kremtja e të Verbrit.

TË MARTËN E JAVËS VI
MBYLLJA E SË KREMTES SË PASHKËS
NË MBRËMËSORE

Pas bekimit nga prifti, Krishti u ngjall (10x) si në Javën e Ndrishme. Paqësoret.

6 Thirrtores Ngjallësore Ting. I

Lutjet tona të mbrëmjes...
Rrethoni Sionin, o popuj...
Ejani, o popuj, të përhimnojmë...
Dëfreni, o qiej, buçisni...
Atë që u kryqëzua për ne...
Duke qëndruar pranë varrit tënd...

Lavdi

Fjalën e bashkëpanisshme...

Tani *Hyjllindësorja Dogmatike*
Lavdinë e përbotshme...

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës.

Le të themi të gjithë... Bëna të denjë, o Zot... Le ta plotësojmë lutjen tonë...

Pasvarg Ngjallësor Ting. I

Me anën e Pësimiit tënd, o Krisht, u çliuam prej pësimeve, dhe me anën e Ngjalljes sate u çliuam prej prishjes. O Zot, lavdi më ty.*

Dhe ato të Pashkës me Lavdi dhe Tani i tyre (fq. 7):

Varg: Le të ngjallet Perëndia...

Pashka hierore na u shfaq neve sot... *etj.*

TË MËRKURËN E JAVËS VI
NË MËNGJESORE

Të gjitha si në ditën e Pashkës, përveç Sinaksarit. Apostulli dhe Ungjilli i ditës.

**ANALIPSI (NGRITJA NË QIELL) I ZOTIT
DHE PERËNDISË DHE SHPËTIMTARIT
TONË JISU KRISHT.**

TË MËRKURËN E JAVËS VI
NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrtores të së kremtes
Ting. Tërth .II*

Zoti u ngjit në qiej...

O Zot, në ngjitjen tënde...

Duke i parë lartësimet e tua...

O Krisht, sapo të panë...

Lavdi *dhe* Tani

O Zot, kur e përmbushe, si i mirë...
(*Kërkoji në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 161*)

Pasvargje (të parat e Litisë së të kremtes)

O Zot, pasi u ngjite në qiejt...

Varg: Perëndia u ngjit me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

O Krisht, u ngjite tek Ati yt...

Varg: Mbarë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë me zë ngazëllimi.

O Zot, engjëjt e tu u thoshin...
(*Kërkoji në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 161*)

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Linde siç deshe vetë...
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 161*)

Përlëshorja



NË MBRËMËSOREN E MADHE

10 Thirrtoje Idhiomele

Ting. Tërth. II

Zoti u ngjit në qiej që të dërgonte Ngushëllimtarin⁹⁸ në botë. Qiejt e bënë gati fronin e tij,⁹⁹ retë bazën e tij.¹⁰⁰ Engjëjt çuditën duke parë një njeri më lart se ata, Ati e pret në gjirin e tij¹⁰¹ atë që e ka të bashkëpërvetshëm. Shpirti i Shenjtë i urdhëron gjithë engjëjt e tij: "Ju, arkondë, ngrijini portat".⁹⁴ Të gjitha ju, o kombe, duartrokisni, se u ngjit Krishti atje ku qe më parë. (2x)

O Zot, në ngjitjen tënde, Keruvimet u çuditën se të panë të ngriheshe mbi re ty Perëndinë që rri mbi to,¹⁰² dhe ne të

lavdërojmë sepse mëshira jote është e mirë;¹⁰³ lavdi më ty. (2x)

Duke i parë lartësimet e tua në malet e shenjtë, o Krisht, reflektimi i lavdisë së Atit,¹⁰⁴ e përhimnojmë pamjen tënde, fytyrën e shndritur; u falemi pësimeve të tua, e nderojmë ngjalljen, e mburrim Analipsin e lavdishëm; mëshirona. (2x)

O Krisht, sapo të panë të ngriheshe mbi re, apostujt, të zyrtë shumë, thoshin duke qarë: O Zot, mos na lër jetimë ne,¹⁰⁵ shërbëtorët e tu që na deshe nga keqardhja, si i dhembshur, mirëpo, siç na premtove, dërgoje Shpirtin tënd të Tërëshenjtë⁹⁸ që t'i ndriçojë shpirtrat tanë. (2x)

O Zot, kur e plotësove misterin e Ekonomisë, pasi i more Nxënësit e tu, u ngrite në malin e Ullinjve dhe e kalove kupën e qiellit; ti që u varfërove¹⁰⁶ si unë për mua dhe u ngjite atje nga nuk u ndave, dërgoje Shpirtin tënd të Tërëshenjtë⁹⁸ që t'i ndriçojë shpirtrat tanë. (2x)

Lavdi *dhe* Tani *Injëjti*

Duke mos u ndarë nga gjiri atëror¹⁰¹ dhe pasi u shoqërove si njeri mbi dhë,¹⁰⁷ o Jisu tejet i ëmbël, sot u ngjite me lavdi nga mali i Ullinjve; dhe, pasi e lartësove me dhembshuri natyrën tonë të rënë, u ule bashkë me Atin; prandaj, duke u habitur me çudinë, rendet qiellore të të patrupëve shtangeshin dhe, të tronditura dhe të shtrënguara nga tmerri, e madhështonin njeridashjen tënde; bashkë me to dhe ne të mbidheshmit, duke lavdëruar bashkëzbritjen tënde te ne dhe analipsin tënd nga ne, përgjërohemi duke thënë: Ti që, gjatë analipsit tënd, i mbushe me gëzim të pafund Nxënësit dhe Perëndilindësen që të lindi, denjësona dhe ne me lutjen e

tyre për harenë e të zgjedhurve të tu nga përdëllimi yt i madh.³

Hyrje. O Dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i profecisë së Isaia
(2.2-3)

Zoti thotë këto: Në ditët e fundme do të jetë i dukshëm mali i Zotit dhe shtëpia e Perëndisë mbi majat e maleve dhe do të lartësohet më lart se malet; dhe do të vijnë mbi të mbarë kombet dhe do të ecin shumë kombe dhe do të thonë: Ejani të ngjitemi në malin e Zotit dhe në shtëpinë e Perëndisë së Jakovit dhe do të na e njoftojë udhën e tij dhe do të ecim në të.

Këndimi i profecisë së Isaia
(62.10-63.3,7-9)

Zoti thotë këto: Ecni përmes portave të mia dhe bëni udhë për popullin tim dhe hidhini tej gurët e udhës; ngrini parullë në kombe, sepse ja ku Zoti bëri *një gjë* që u dëgjua deri në fund të tokës; thojni bijës Sion: Ja ku shpëtimtari yt arriti duke pasur rrogën dhe veprën e tij para fytyrës së tij; dhe do ta quajë popull të shenjtë, të çliruar prej Zotit, ndërsa ti do të quhesh qytet i kërkuar dhe jo i braktisur. Kush është ai që arriti nga Edhomi, rrobat e të cilit janë me ngjyrë të kuqe prej Vosorit, kështu i bukur me stolinë e tij? Thërret me forcë të madhe: “Unë dialogoj për drejtësi dhe gjykim për shpëtim. –Pse janë të kuqe rrobat e tua dhe veshjet e tua si nga torku, shtypja? –Jam i mbushur me shumë shtypje dhe nuk është me mua *ndonjë* burrë prej kombeve. E kujtova mëshirën e Zotit, vir-

tytet e tij në të gjitha që na shpërblen. Zoti është gjykatës i mirë për shtëpinë e Izraelit, sjell mbi ne sipas përdëllimit të tij dhe sipas shumicës së drejtësisë së tij. Dhe tha: “A nuk është ky populli im, bijtë e mi? Dhe nuk do të shpërfillen”. Dhe iu bë atyre për shpëtim nga çdo shtrëngim i tyre. Jo ndërmjetës, jo engjëll, por vetë Zoti i shpëtoi se i deshi dhe i erdhi keq për ta. Dhe i çliroi dhe i mori lart ata dhe i ngriti gjithë ditët e jetës.

Këndimi i profecisë së Zaharias
(4.1,4,8-11)

Zoti thotë këto: Ja ku po vijnë ditë Zoti; dhe këmbët e tij do të bazohen në atë ditë mbi malin e Ullinjve që është përballë Jerusalemit, nga lindja. Dhe në atë ditë do të dalë ujë i gjallë nga Jerusalemi, gjysma e tij në detin e parë dhe gjysma e tij në detin e fundmë; dhe në verë, dhe në pranverë kështu do të jetë; dhe do të jetë Zoti mbret mbi tërë dheun; në atë ditë do të jetë Një Zot dhe emri i tij Një. *Uji do të ketë rrethuar tërë dheun dhe shkretëtirën nga Gavaja deri në Remon, në jug të Jerusalemit; ndërsa Ramaja do të mbetet mbi vend nga porta e Beniaminit deri në vendin e portës së parë, deri në portën e Gomorit dhe deri në përgun Anameil dhe deri në torkat e mbretit. Do të banojnë në të dhe mallkim nuk do të ekzistojë më dhe Jerusalemi do të banojë me siguri.*

Në Liti Idhiomele

Ting. I

O Zot, pasi u ngjite në qiejt nga ku kishe zbritur, mos na lër si jetimë,¹⁰⁵ ardhhtë Shpirti yt duke i sjellë botës paqen;¹⁰⁸ tregoju bijve të njerëzve veprat e fuqisë sate, o Krisht njeridashës.

Injëti

O Krisht, u ngjite tek Ati yt i pafillim, ti që nuk u ndave nga gjiri i tij¹⁰¹ i papërshkruar, dhe Forcat nuk bënë shtesë në lavdërimin e Trishenjit³⁴, sepse si Një Bir të njohën dhe pas trupëzimit, o Zot, si të vetëmlindurin e Atit;¹⁰⁹ na mëshiro me shumicën e dhembshurive të tua.¹¹⁰

Injëti

O Zot, engjëjt e tu u thoshin apostujve: O burra galileas, pse qëndroni duke vështruar në qiell? Ai është Krishti Perëndi që u ngjit nga ju në qiell; ai do të vijë përsëri siç e patë kur shkante në qiell; adhurojeni me oshënarí dhe drejtësi.¹¹¹

Ting. IV

O Krisht, kur arrite në malin e Ullinjve për të zbatuar mirëdashjen e Atit, u shtangën engjëjt qiellorë dhe u frikësuan të nëndheshmet; dhe Nxënësit ishin të pranishëm me hare dhe tmerroheshin kur u flisje; dhe një re si fron ishte gati përballë dhe të priste; dhe, pasi i ngriti portat, qielli shfaqej bukur; dhe toka i zbuloi bodrumet, që Adami ta njihte zbritjen dhe, nga ana tjetër, ngritjen. Dhe këmbët lartësoheshin, si nga një dorë, ndërsa një gjuhë bekonte shumë, siç dëgjohej; të mori një re dhe të pranoi qielli përbrenda; o Zot, e bëre këtë vepër të madhe dhe paradoksale për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Injëti

O Perëndi, natyrën e Adamit që zbriti në vendet më të poshtme të tokës, e ripërtërite në veten tënde dhe e lartësove sot mbi çdo autoritet dhe pushtet;¹¹² meqë e deshe, e vure të ulej tok me veten tënde; dhe, meqë e dhembshurove, e bashkove me veten; meqë e bashkove, pësove bashkë me të; dhe, meqë pësove,

edhe pse je i papësueshëm, e lavdërove me veten. Por të patrupët thoshin: “Kush është ky burrë i bukur?”¹¹³ Por s’është vetëm njeri, por Perëndi dhe njeri, fenomeni i përmban të dyja bashkë”. Prandaj engjëjt, të hutuar, duke fluturuar të stolisur, u thërrisnin Nxënësve: “O burra galileas, ai që iku nga ju, është Jisui njeri-Perëndi; do të vijë përsëri si Perëndi-njeri, gjykatës i të gjallëve dhe i të vdekurve,¹¹⁴ dhe do t’u dhurojë besnikëve ndjesën e mëkateve dhe përdëllimin e madh.”³

Injëti

Kur ngjiteshe me lavdi, o Krisht Perëndi, teksa po shikonin Nxënësit, të merrnin retë me trup, hapeshin portat e qiellit, ngazëllohej shumë kori i engjëjve, Fuqitë më të sipërme thërrisnin: “Ngrijini portat, ju arkondët tanë, se do të hyjë mbreti i lavdisë”,⁹⁴ ndërsa apostujt thoshin të çuditur: Mos u nda nga ne, o bari i mirë,¹¹⁵ por na dërgo Shpirtin tënd të Tërëshenjtë⁹⁸ që i udhëzon dhe i mbështet shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani Injëti

O Zot, kur e përmbushe, si i mirë, misterin e fshehur që nga jetët dhe nga gjeneratat,¹¹⁶ erdhe në malin e Ullinjve bashkë me Nxënësit e tu dhe me atë që të lindi ty, Bërësin e të gjithave;¹ sepse ajo që, gjatë pësimit tënd, kishte, si nënë, dhembje më të madhe se të gjithë, duhej të shijonte një hare të madhe shumë gjatë lavdisë së trupit tënd; në këtë gëzim morëm pjesë edhe ne gjatë ngjitjes sate në qiej, o Krisht, dhe e lavdërojmë përdëllimin tënd të madh³ që ndodhi ndër ne.

Pasvargje Idhiomele Ting. II

Linde siç deshe vetë, u shfaqe siç të pëlqeu, pësove në trup, o Perëndia ynë,

u ngjalle nga të vdekurit pasi e shkele vdekjen, u ngjite me lavdi ti që mbush Gjithësinë,¹¹⁷ dhe na dërgove Shpirtin Hyjnor,⁹⁸ që ta përhimnojmë dhe ta lavdërojmë hyjninë tënde.

Varg: Mbarë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë me zë ngazëllimi.

Kur ngjiteshe nga mali i Ullinjve, o Krisht, Fuqitë, kur të panë, i thërrisnin njëratjetrës: “Kush është ky?”. Dhe u dëgjua: “Ky është i fuqishmi dhe i pushtetshmi, ky është i forti në luftë, ky është me të vërtetë mbreti i lavdisë”.¹¹⁸ “Dhe pse janë të kuqe rrobat e tij?”. “Erdhi nga Vosori,¹¹³ domethënë nga trupi”. Dhe ti vetë, si Perëndi, pasi u ule në të djathtën e madhërisë, na e dërgove Shpirtin e Shenjtë,⁹⁸ që t’i udhëzojë dhe t’i shpëtojë shpirtrat tanë.

Varg: Perëndia u ngjit me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

O Krisht Perëndi, u ngjite me lavdi nga mali i Ullinjve para Nxënësve të tu dhe u ule në të djathtën e Atit ti që i mbush të gjitha¹¹⁷ me anë të hyjnisë; dhe u dërgove Shpirtin e Shenjtë⁹⁸ që i ndriçon, i mbështet dhe i shenjtëron shpirtrat tanë.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

Perëndia u ngjit me brohori, Zoti me zë trumbete¹¹⁹ që ta lartësonte ikonën e rënë të Adamit dhe të dërgonte Shpirtin Ngushëllimtar⁹⁸, që t’i shenjtërojë shpirtrat tanë.

Përlëshore Ting. IV

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë, pasi i ngazëllove Nxënësit me premtimin e Shpirtit të Shenjtë,⁹⁸ kur ata u siguruan përmes bekimit, se ti je Biri i Perëndisë, Çlirimtari i botës. (3x)

NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. I Tu lithu sfracisthentos

Kur ngjitja e çuditshme i shtangte engjëjt shenjtë,* Nxënësit hyjnor’ i habiste i frikshmi lartësim pra;* u ngjite me lavd, si Perëndi,* për ty u hapën portat,⁹⁴ Shpëtimtar,* ndaj Fuqitë qiellore çuditeshin* dhe thoshin: Lavd zbritjes sate;*¹¹² lavd mbretërisë sate, Zoti Krisht;* lavd Analipsit tënd, plot nder,* o i vetmi njeridashës; lavdi përdëllimit tënd. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. III Tin oreótita

E parajetshmja Fjal’* edhe e pafillim* e hyjnizoi krejt* fisin ton’ njerëzor,* natyrën tonë mistikisht, të cilën e kishte marrë* dhe u ngjit sot lart; engjëjt* rendnin para dhe Nxënësve* u tregonin kur ai* shkonte plot lavd drejt qiejve;* apostujt, si u falën, “Lavd Zotit,* lavd Perëndis’ së ngjitur”, thoshin. (2x)

TË ENJTEN E JAVËS VI

NË MËNGJESORE

Pas Polieleit, Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinanarhon Logon

Zbrite nga qielloret në tokë dhe atë* që dergjej poshtë në burgun e Hadhit,¹²⁰ pra fisin ton’,* pamjen e Adamit, tok e ngjalle dhe, o Krisht,* me Analipsin tënd, o Zot,* si e ngrite lart në qiej bri fronit atëror ti,* e vendose të rrijë si njeridashës dhe i mirë, përdëllimtar. (2x)

Proqimeni Ting. IV

Perëndia u ngjit me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Varg: Mbarë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë me zë ngazëllimi.

Ungjilli III Mëngjesor

Ne që pamë ngjalljen... *Psalmi 50.*

Lavdi

Me ndërmjetimet e apostujve...

Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...

Varg: Përdëllemë, o Perëndi...

Dhe Idhiomeli.

Ting. Tërth. II

Sot, duke e parë në qiej natyrën tonë, Fuqitë e sipërme çuditëshin për mënyrën e huaj të ngjitjes dhe habitëshin duke i thënë njëra-tjetrës: "Cili është ky që erdhi?".¹¹³ Por, duke parë Zotin e tyre, urdhëroheshin t'i ngrinin portat qiellore.⁹⁴ Bashkë me to të himnojmë pa pushim ty që do të vish sërish me trup nga atje si gjykatës i të gjithëve dhe Perëndi i tërëfuqishëm.

Kanunet: I pari (tok me Irmoset) në 8 dhe i dyti në 4; pa Vargje.

Ode I

Kanuni i parë, poezi e Joan Monakut

Ting. Tërth. I.

Irmosi: To sotiri Theó

»Shpëtimtari yn' Zot* u lavdërua, sepse* »e udhëhoqi* në det popullin* pa uj' ndër »këmbë dhe e zhyti Faraonin keq* me »tërë ushtrin'; t'i këndojmë atij vetëm.¹⁴

Kombe mbar', t'i këndojm'* ne Zotit

Krisht që u ngjit* me lavd mbi supe* Keruvimesh lart* dhe në të djathtën e të Atit na ka ulur ne;* t'i psalim një himn triumfal, se ka lavd të madh.

Kore engjëjsh e pan'* në më të lartat me trup* Krishtin ndërmjetës* mes të vdekshmëve* dhe Perëndisë¹²¹ dhe me mjaft habi të gjithë tok* me një zë këndonin një ode triumfi pra.

T'i këndojmë të gjith'* ne Perëndis' që iu shfaq* shën Moisiut,* hyjshikuesit,* mbi malin e Sinaï kur i dha të shenjtin Ligj;*²³ nga Mali i Ullinjve po ngjitet me trup plot lavd.

Hyjlindësor

Ndërmjeto pa pushim* që t'i shpëtojë nga çdo* peripeci sa* bëri Zoti Krisht,* që mori trup prej teje dhe nga gjiri atëror*¹⁰¹ s'u nda aspak, Nënë e pacen e Perëndis'.

Kanuni i dytë që ka Akrostihidhë sipas Alfabetit, dhe në Odet VIII dhe IX: "Ode e Josifit". Poezi e Josifit të Selanikut.

Ting. IV

Anikso to stoma mu

[*Irmosi:* »Ja gojën e çel tani, i frymëzuar »prej Shpirtit¹²² Shenjt'* dhe këngë do t'i »këndoj nënës së madhe mbi fron;*¹²³ »dhe do ta kremtoj* me valle buzëqe- »shur,* me zë do t'i shpall kudo gjithë »çudit' e saj.*]

U ngjalle, Krisht, pas tri ditësh ti që s'vdes pas natyrës kurr';* iu shfaqë të njëmbëdhjetëve, gjith' Nxënësve tok* dhe vrapove lart* drejt Atit përmbi re ti,* o bërës i çdo gjëje,¹ o Shpëtimtar dhe Zot.

I hyfrymëzuari David thërret fort, mjaft dukshëm, psal:* Me një zë trumbetash, brohoritjesh Zoti u ngjit* drejtas qiejve,*¹¹⁹ arriti pranë Atit,* eprorit të dri-

tave,⁷⁰ Bërësit botëror.

Të plakurën botë nga shumë faje¹²⁴ ti e ke bërë, Krisht,* të re¹²⁵ me pësimin dhe me ngjalljen tënde; o Zot,* hipur lart mbi re,* u ngjite për në qiej;* lavdi lavdit tënd edhe nder nderit tënd gjithnjë.

Hyjlindësor

E kishe në bark, e tërëpaqortueshmja, Zonja jon,* sunduesin botëror që vullnetarin pësim* e denjoi pra,*²⁹ më pas u ngjit tek Ati* të cilin s'e la edhe pse kishte marrë trup.

Zbritësore I njëjti: Thio kalifthis

»Si mbulohet prej territ hyjnor¹²⁶
»memeci,*¹²⁷ me oratori* thot' një Ligj¹²⁸
»të hyshkruar,*¹²⁹ pasi e hodhi baltën
»larg shpirtërorit sy, po sheh Krishtin,*²³
»ekzistentin¹⁶ dhe mistikisht njeh* Shën
»Shpirtin, me këng' pra hyjnisht e mburr.

Ode III

Irmosi: Dhinami tu stavru su

»Ma siguro* mendimin, o Krisht,*³⁷ me
»forc' nga Kryqi,* që ta përhimnoj* dhe
»ta lëvdoj kryqëzimin tënd* shpëtimtar
»tani, të lutem ty.

Drejt Atit tënd* u ngrite, o Krisht,* o jetëdhënës* njeridashës, dhe* me dhembshurin' tënde që s'shprihet,* fisin tonë lart e ngrite, Zot.

O Krisht, rendet* e engjëjve lart* kur tok me fisin* njerëzor të pan'* të ngritur, shtangeshin, Shpëtimtar,* dhe të përhimnonin pa pushim.

Kur ngriheshe* me trup, koret lart,* pra engjëjt, o Krisht,* po çuditeshin* dhe e himnonin me përkushtim* Analipsin tënd të shenjtë, Zot.

Natyren ton',* të njerëzve, Krisht,* që, përmes prishjes,* kishte rënë keq,* me ngritjen tënde e ngrite ti* dhe me veten na lëvdove, Zot.

O e Dëllir,* sa ty të himnojm'* si nënë Zoti,* lype pa pushim* atë që doli nga barku yt,* të shpëtojm' nga blofi djallëzor.

Tjetri: Tus sus innologus

[Irmosi: »O Zonjë dhe nën' e Perëndisë,
»burim i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith'
»ata që të këndojnë plot me zell;* dhe
»lart në q'ell ku mbretëron kurorëzoi me
»çdo lavdi.*]

U thoshin Fuqitë më të poshtme Fuqive që ndodheshin më lart:* Krishti mbret, Zot ja erdhi, qielloret porta hapini,*⁹⁴ arriti si e veshi trupin tokësor dhe u bë njeri.

Adamini që humbi prej mashtrimit të gjarprit,⁴¹ ti e kërkove,¹³⁰ Krisht,* e veshe dhe u ngrite, dhe u ulë në të djathtën lart* të Atit si i bashkëfronshëm, kur të psalnin himn engjëjt ty.

Kërcen toka, ka hare, gëzohet dhe qielli sot për ngritjen lart* të Bërësit të kozmosit,¹ që i bashkoi dukshëm fort* vullnetarisht të kundërtat,¹³¹ pra tokën poshtë me qiellin.

Hyjlindësor

E linde rrëzuesin e Hadhit, të vetmin Zot që s'vdes asnjëher',* ndaj, nënë-virgjëreshë e tërëdëllirë, lype ti* gjithnjë t'i vrasë veset që më vrasin, të më shpëtojë krejt.

Zbritësore: Érikse gastrós

»Prangat që kish mitra e sterile edhe*
»talljen plot vrer nga një grua me fëmijë,*
»i shfarosi lutja thjesht e profeteshës*
»Ana qëmoti me një shpirt të dërrmuar*

»drejt fuqplotit* Perëndi¹³² të dijeve.¹³³

Ndenjësores

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Hipe mbi ret' e qiellit si u le* paqen njerëzve poshtë,¹³⁴ u ngjite lart,* u ule bri Atit tënd,* në të djathtën e tij se ti* je i njëqenshëm tok me të dhe me të Shenjtin Shpirt,* me trup u shfaqe,³⁶ por pa ndryshim mbete, ndaj e pret* fundin botëror, Zot, që të vish të gjykosh drejt* mbi tokën mbar' kozmosin,*¹¹⁴ o gjykatës i drejtë krejt,*¹³⁵ t'na i mbrosh ti,* Jisu, shpirtrat* si përdëllimtar Perëndi,* dhurona, o mirëbërës* dhe Shpëtimtar,* ndjesë shkëlqesh, sepse na ke shërbëtorë ne. (2x)

Ode IV

Irmosi: Isakioa tin akoïn

»E dëgjova un' dëgjimin³⁹ e fuqis' së »Kryqit tënd, përmes tij* një Parajsë qie- »llore na u hap*⁴⁴ dhe të thirra fort:* Lavd »pushtetit tënd, Perëndia im.

Ti, mbreti i engjëjve, u ngjite me lavdi që të na dërgoje Ngushëllimtarin nga Ati,⁹⁸ prandaj thërrasim: Lavdi Analipsit tënd, o Krisht.

Sapo Shpëtimtari u ngjit me trup drejt Atit, u çuditën për të ushtritë e engjëjve dhe thirrën: Lavdi Analipsit tënd, o Krisht.

Fuqitë e engjëjve u thërrisnin më të sipërmeve. »Ngrijini portat për Krishtin, mbretin tonë.⁹⁴ Atë e përhimnojmë së bashku me Atin dhe me Shpirtin.

Hyjlindësor

Virgjëresha lindi dhe nuk njohu gjëra nënë, mirëpo, nga njëra anë, është nënë dhe, nga ana tjetër, mbeti e virgjër;

duke e përhimnuar thërrasim: Gëzohu, o Perëndilindëse.

Tjetri: O kathímenos en dhoksi

[Irmosi: »Ti që rri midis lavdisë* përmbi »fronin¹³⁶ e hyjeshëm,* nga një re e leh- »të*¹³⁷ erdhe, o Jisu i përjetëshëm,* dhe »na shpëtove me dorën jetëdhënëse,* të »thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithnjë »mbi ty.*]

Pasi i mori ata që deshë, Jisu jetëdhënësi u ngjit në mal dhe i bekoi dhe, pasi hipi mbi një re, arriti në gjirin atëror,¹⁰¹ të cilin nuk e kishte lënë kurrë.

Tërë bota, e dukshme dhe e padukshme, kremton me ngazëllim; kërcejnë engjëjt dhe njerëzit duke lavdëruar pa pushim Analipsin e atij që, nga mirësia, u bashkua me ne përmes trupit.

O njeridashës, Jisu i tërëpushtetshëm, përderisa e shpërbëre pushtetin e vdekjes,¹³⁸ si Zot i pavdekshëm, na dhurove të gjithëve pavdekësinë dhe u ngjite me lavdi kur po të vështronin Nxënësit e nderuar.

Hyjlindësor

O e Tërëpaqortueshme, barku yt u bë i lum sepse u denjësove të mbash pa shpjegim atë që e zmbropsi në mënyrë paradoksale barkun e Hadhit; atij, Krishtit, përgjëroju që të na shpëtojë ne që të himnojmë.

Zbritësore: Anaks anakton

»Vetëm ti dole, Fjal', nga i vetmi Atë* »që s'ka shkak, o mbret i mbretërve;¹³⁹ »dhe Shpirtin* autentik që ka forc' të »barabartë* me ty, pra si mirëbërës e »dërgove,* Zot, tek apostujt; i psalnin »fuqis' që ke.

*Ode V**Irmosi: Orthrizontes voomen si*

»O Zot, mëngojmë⁴⁵ dhe të thërrasim ty:
 »Na shpëto ne,* se je Perëndia yn',* veç
 »teje s'njohim ndonjë tjetër.⁴⁹

Pasi e mbushe Gjithësinë me hare, o
 Përdëllimtar, shkove me trup te Fuqitë e
 sipërme.

Sapo të panë të ngritur, Fuqitë e engjëj-
 ve thërrisnin: Ngrijini portat për mbretin
 tonë.⁹⁴

Kur e panë Shpëtimtarin që ngrihej, apos-
 tujt thërrisnin me tmerr: Lavdi mbretit
 tonë.

Hyjlindësor

Të himnojmë si virgjëreshë pas lindjes, o
 Hyjlindëse, meqenëse e kishe në mitrën
 tënde Perëndinë Fjalë për hir të botës.

Tjetri: Eksesti ta simpanta

[*Irmosi:* »Të gjith' i habite ti me një çudi
 »dhe një lavdi,* ti, o Virgjëresh' e pamar-
 »tuar,* Zotin e jetës që¹⁴⁰ mbretëron lart
 »në q'ell si një bir e mbajte në pëqi,*
 »dhe shpëtim që lartazi* u dhurove bes-
 »nikëve.*]

Kur e vrave vdekjen me vdekjen tënde,
 o Zoti Krisht, pasi i more ata që deshe, u
 ngjite në Malin e shenjtë të Ullinjve; dhe
 nga atje rende drejt Lindësit tënd, hipur
 mbi një re.

Lindja jote është e huaj, ngjallja e huaj,
 Analipsi yt hyjnor nga mali, o Jetëdhënës,
 është i huaj dhe i frikshëm; atë e iko-
 nizonte Ilia kur ngjitej mbi një karrocë
 me katër kuaj¹⁴¹ duke të himnuar, o nje-
 ridashës.

Engjëjt u thoshin apostujve që po vësh-
 tronin: O burra galileas, pse hutoheni me

Analipsin e Zotit jetëdhënës? Ai do të vijë
 përsëri mbi tokë për të gjykuar mbarë
 botën¹¹⁴ si gjykatës tejet i drejtë.¹³⁵

Hyjlindësor

O Hyjlindëse, pasi të ruajti virgjëreshë
 të paprishur pas lindjes, Krishti ngjitet
 drejt Atit të cilin nuk e la edhe pse kishte
 marrë trup me mendje dhe jetë prej teje
 nga mëshira e parëfyeshme.

Zbritësore: Litirion kátharsin

»O bij dritëpamës nur të Kishës, prisni*
 »një vesë që fryn zjarr nga Shpirti, që
 »është* shfarosja pastruese e fajit,
 »meqë* sot prej Sionit* doli ligji,¹⁴² pra
 »Hiri* shpirtëror që duket si gjuhë e
 »zjarrtë.

*Ode VI**Irmosi: Eqiklosé me ávisos*

»Avusha më rrethoi, varr për mua u
 »bë pra i madhi peshk,* por unë drejt
 »teje thirra,⁵⁰ se Njeridashës je* dhe më
 »shpëtoi e djathta jote, Zoti im.

Duke parë sot Ndërtuesin të ngritur në
 ajër, apostujt kërcyen me shpresën e
 Shpirtit dhe thërrisnin nga frika: Lavdi
 ngritjes sate.

O Krisht, engjëjt erdhën duke u thirrur
 Nxënësve të tu: Siç e patë Krishtin të
 ngjitej, po ashtu do të vijë me trup si
 gjykatës i drejtë i të gjithëve.¹³⁵

O Shpëtimtari ynë, sapo të panë të
 ngritur me trup në lartësi, Fuqitë qiellore
 thoshin me zë të lartë: O Zot, njeridashja
 jote është e madhe.

Hyjlindësor

Të vlerësojmë denjësisht si ferrë të
 padjegshme,⁹ mal,⁶ shkallë¹¹ të gjallë dhe

portë qiellore,⁸⁴ o Mari lavdiplotë, mburrje e orthodhoksëve.

Tjetri: Tin thian taftin

[*Irmosi: »Këtë të kremte e lusim sot, për »Zonjën edhe nënën Hyjlindëse, gjithë »hyjmentësit,* eni trokisni pra duar- »të*¹⁴³ dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.*]*

Retë le të na hedhin nga lart ngazëllim¹⁴⁴ të përjetshëm, sepse Krishti ngjitet sot drejt Atit të tij, hipur mbi një re si mbi Keruvime.

Kur u duke në formë trupore,¹⁴⁵ i mblo- dhe në një bashkim të kundërtat e mëparshme,¹³¹ dhe, kur po të vështronin Nxënësit, u ngjite drejt qielloreve, o i Dhembshuri njeridashës.

“Pse janë të kuqe rrobat e atij¹¹³ që u bashkua me trashësi mishi?”. Kështu flisnin engjëjt e shenjtë ndërsa shikonin Krishtin që mbante simbolet hyjnore të pësimit të çmuar.

Hyjlindësor

O Vajzë e kulluar, e himnojmë zënien tënde, e himnojmë lindjen e parrëfyeshme nëpërmjet së cilës u çliuam nga prishja, keqtrajtimi dhe burgimi i errët i Hadhit.¹²⁰

Zbritësore: Ilasmós imín

»Zot, për ne, si falje¹⁴⁶ dhe shpëtim,¹⁴⁷ »shkëlqeve* nga e Virgjra, dhe, siç e zhva- »te nga prishja* në det, profetin Jona nga »një bark bishe,*⁵⁰ shndrite ta shpëtoje »dhe tërë Adamin* thell’ nga prishja, se »me krejt fisin kish rënë.⁴⁴

Kontaqi Ting. Tërth. II Tin ipér imón

Ti Ekonom’ për ne e përmbushe* dhe të dheshmet i bashkove me qielloret,* Perëndia yn’ Krisht,¹³¹ me lavdi ti u more

lart,* por nga ne s’u ndave asnjëher’,* s’u largove, dhe atyre, Zot,* që të duan, u thërret kështu:* Meqë jam unë me ju,* s’ka asnjë kundër jush.

Shtëpia

Pasi t’i lëmë në tokë tokësoret dhe hi- rin në dhé, ejani të shohim sipër dhe t’i ngremë lart sytë dhe mendimet; ne vdekatarët t’i ngjitim fytyrat bashkë me ndjenjat në portat qiellore; të imagjinoj- më sikur jemi në Malin e Ullinjve dhe vështrojmë Çlirimtarin, hipur mbi një re, sepse nga atje Zoti rendi në qiej, atje dhe bujari u ndau dhuratat apostujve duke i thirrur si atë dhe i mbështeti e u tha: Nuk ndahem nga ju; meqë jam unë me ju, s’ka asnjë kundër jush.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Enjten e Javës së Gjashtë pas Pashkës, kremtojmë Analipsin e Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht.

Varg: Kur u ule në të djathtën atërore, o Fjalë,/ u dhe mistëve një besim më të sigurt.

O Krisht, Perëndia ynë, që u ngjite me lavdi, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: O en kamino pirós

»Ti që në furr’ zjarri përhimnuesit i ke »shpëtuar,*⁵⁶ je i bekuar, o Perëndi i »etërve tan’.⁶⁰

Ti që u more lart me re drite dhe e shpëtove botën, je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Pasi e ngrite mbi supe natyrën e humbur, o Krisht,¹³⁰ ia çove Perëndisë dhe Atit.¹⁴⁸

Ti që u ngrite me trup tek Ati i patrur, je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Pasi e ngrite natyrën tonë të vdekur për shkak të mëkatit,²⁷ ia çove vetë Atit tënd, o Shpëtimtar.¹⁴⁸

Hyjlindësor

Ti që linde nga një Virgjëreshë, të cilën e bërë Hyjlindëse, je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Tjetri: Uk elátrefsan

[*Irmosi:* »Nuk u faleshin krijesave hyj-
»mendësit, por Kryetarit lart,*¹⁴⁹ dhe
»kërcënimin me zjarr* e shkelnin me
»trimëri,⁵⁶ psalnin me brohori:* Zot, lavdi
»më ty, o Perëndi i etërve,* ti je vetëm i
»bekuar.^{60*}]

Kur ngjiteshe, mbi mendjen, nga dheu, të mori një re e ndritshme, o Zot që je dritë, dhe bashkësitë qiellore himnonin tok me apostuj duke thënë: O Perëndi, je i bekuar.

Le të duartrokasim të ngazëlluar të gjithë në Analipsin e Krishtit dhe le të brohorasim: Zoti u ngrit me zë trumbe-¹¹⁹ dhe, si i bashkëfronshëm, u ul në të djathtën e Atit në jetë.

Duke psalur qëmoti, Moisiu i madh thërriste: "Engjëjt qiellorë le t'i falen¹⁵⁰ Krishtit që po ngrihet, si mbreti i të gjithave". Atij i thërrasim: "O Perëndi dhe Zot i etërve, je i bekuar".⁶⁰

Hyjlindësor

O çudi paradoksale! O e hyjhirshme, si zure Perëndinë e panxënshëm që u varfërua¹⁰⁶ trupërisht dhe u ngjit sot në qiej me shumë lavdi dhe i gjallëroi nje-rëzit?

Zbritësore: Símfonon ethróisen

»Bënin simfoni tok veglat muzikore* që
»të adhuronin ikonën e artë,* pa shpirt,¹⁵¹
»por i shndritshmi Hir, Ngushëllimtari,*
»na nxit, me nder, but',* të thërrasim: E
»vetmja Trini pa koh',* me Një forc', je e
»bekuar.

Ode VIII

Irmosi: Ton ek Patrós pro eoon

»Mbilartësoje, o popull, priftërinj për-
»himnojeni tok* në gjithë jetët⁶¹ pra Birin
»Perëndi që lindi prej Atit Zot* para jetës
»edhe në koh' të fundme mori mish nga
»e virgjra nënë.

Krishtin jetëdhënës, që u ngrit me dy esenca në qiej me lavd dhe rri tok me Atin, o priftërinj, himnojeni,⁶¹ o popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

O Shpëtimtar që e çlirove Krijesën nga skllavëria e idhujve dhe e paraqite të lirë tek Ati yt,¹⁴⁸ të himnojme dhe të përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Atë që e vithisi kundërshtarin me zbri-tjen e tij dhe e lartësoi njeriun me ngri-tjen e tij,¹¹² o priftërinj, himnojeni;⁶¹ o popull, përmbilartësojeni në gjithë jetët.

Hyjlindësor

Përderisa e mbajte në barkun tënd atë që rri mbi Keruvimet,¹⁰² u tregove më e lartë se ata, o Perëndilindëse e kulluar; atë e lavdërojmë bashkë me të patrurët në gjithë jetët.

Tjetri: Pedhas evajís

[*Irmosi:* »Djemat* e dënuar për t'u dje-
»gur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit
»Krisht, si simbol në lashtësi,*⁵⁶ dhe si një
»veprim tani,* dhe tërë botën po e mbledh
»për këng' e lavdërim:* Himnojeni, ju ve-

»prat e Zotit,* dhe e lartësoni përmbi të gjitha jetët.^{152*}]

Mendjet qiellore iu shfaqën apostujve gjatë Analipsit dhe iu thanë: Pse habiteni duke parë? Ky që po ngrihet te qielloret, do të vijë prapë për të gjykuar njerëzit mbi tokë, meqë është i vetmi gjykatës.¹¹⁴

Le t'i japim madhështi Perëndisë,¹⁵³ të brohorasim me simfoni himnimi, të këndojmë, të kërcëjmë, të duartrokasim: Perëndia ynë u ngjit nga dheu te qielloret, ndërsa e himnonin engjëjt dhe kryeengjëjt, si Zot dhe Bërës të të gjithave.¹

Natyrë jonë që ishte e rënë, u ngrit më lart se engjëjt dhe rri përherë në fron hyjnor, përmbi mendim; ejani të bëjmë panair dhe të thërresim: O vepra, himnojeni Zotin dhe përmblartësojeni në gjithë jetët.¹⁵²

Hyjlindësor

O Perëndilindëse, pasi e plaçkiti vdekjen me Kryqin e tij, Biri yt u ngjall pas tri ditësh dhe, pasi iu shfaq Nxënësve të tij, rendi drejt qielloreve; bashkë me ta i falemi duke e himnuar dhe duke e lavdëruar në gjithë jetët.

Zbritësore: Lii ta dhesmá

»Një simbolizim trindriçues i Zotit* që hyjkryeson, freskon flak', zgjidh zinxhirë.* I psalin Djemtë*⁵⁶ dhe Krijesa e tërë të vetmit Shpëtues, mirëbërës; si »Zot* gjithëgatues, e himnon¹⁵² fort në »jetë.

Ode IX

Irmosi: Se tin ipér nun

»Me një mendje ne besnikët ty të »madhërojm',* shenjten nënë mbi fjalë »dhe mendim, që në kohë, mot,* të

»pakohshmin e kishe në bark pa shpjegim.

Çlirimtarin botëror, ty, Zot dhe Perëndi,* kur të shihnin apostujt ty të ngriheshe lart hyjnisht* po kërcenin, me tmerr të madhështonin mjaft.

Kur e pan' të hyjnizuarin trupin tënd, Krisht,* sipër, engjëjt i bënë njeri-tjetrit një shenjë pra,* thanë: Ky është Perëndia yn' vërtet.

Kur të panë rendet pa trup të ngritur mbi re,* Perëndi Krisht, fort thirrën: Ngrini portat ju, hapini* pra për mbretin e lavdit,⁹⁴ të përjetshmin Zot.

E shpëtove, Zot, njeriun, e ngrite ti lart* nëpërmjet ngritjes sate¹¹² kur ti zbritte në tokën posht'* gjer në fund të saj, ndaj të madhërojmë ne.

Hyjlindësor

Kur e pe të fluturonte nga toka atë* që e kishe në bark, e madhëroje me engjëjt tok;* g'zohu, nënë e Zotit Krisht, Hyjlindëse.

Tjetri: Apas jijenís

[Irmosi: »Gjithë njerëzit, kërceni me »ngazëllim te drit' e Shpirtit Shenjt',* eni »lavdërojeni;* engjëjt e q'ellit eni kremto-jeni* këtë të shenjtë panair të kryezonjës »Mari,* dhe thërrisni:* Ti je më e lumu- »ra,* Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.*]

Madhështim: Engjëjt shenjt'* çuditëshin duke parë* lart ngjitjen e Jisuit Krisht:* Si u ngrit sipër nga dheu* ky, plot me lavd, nder dhe forcë!

Sa dhurata mbi kuptim! Sa mister i frikshëm! Se sunduesi* i çdo gjëje nga toka* te qielloret po shkon dhe Shpirtin Shenjt'* ua dërgon shën Nxënësve⁹⁸ që t'ua shndritë fort* mendjen, zemrën*

dhe në Hir t'i bëj' si zjarr,* të përflaktë me forcë dhe zell hyjnor.

Madhështim: Engjëjt shenjt'* çuditeshin...

Zoti Krisht u tha shën Nxënësve: "Rrini bashkë në Jerusalem* dhe do t'ju dërgoj Shpirtin,*⁵³ Ngushëllimtarin tjetër,¹⁵⁴ që është' në fron* me Atin dhe i njënderuar tok me mua pra* që më shihni* hipur mbi të ndritshmen re* teksa ngjitem lart drejt qielloreve.

Madhështim: Engjëjt shenjt'* çuditeshin...

Më lart se çdo qiell, dukshëm u ngrit fort madhështia¹⁵⁵ e atij* që, me dashje, u bë trup,* i varfër,¹⁰⁶ ndaj natyra jon' që kish rën',* me ulje pranë Atit u nderua; gjithë ne* le të bëjmë* panair me brohori,* tok të duartrokasim¹⁴³ me gaz të madh.

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësor*

Drita⁷¹ që prej Dritës⁷⁰ shndriti, e Tërë-paqortueshme, nga ti* lindi dhe e flaku tej* çdo errësirë të ateizmit skrop* dhe sa po flinin natën, i ndriçoi; ndaj krejt ne,* pas detyrës,* ty të lumërojmë mjaft* përgjithnjë dhe në jetë të jetëve.

Zbritësore: Heris ánasa

»**K**i gaz, lavd nënor-virgjëror, mbretëre-shë,* gjuhë oratorësh, të aftë në fjalë,* »nuk mund të të psalin siç duhet; çdo »mendje* trulloset kur s'e kap* lindjen »tënde, s'e koncepton,* ndaj me një zë »ne të lëvdojmë ty.

Dërgimësore: Ton mathitón oronton se

Kur po të shihnin Nxënësit, lart ti shkoje,* sado që rrije ulur, Krisht, tok me Atin,* engjëjt rendnin para duke thirrur fort:* Ngrijini portat, hapini,* sepse u ngjit Mbreti⁹⁴ drejtas* lavdis' së ndritshme nga nisja. (2x)

Lavdërime

Ting. I Ton uranion tagmaton

Me engjëjt, ne tokësorët të bëjmë panair* për Perëndin' që hipi* përmbi fronin e lavdit,*¹⁵⁶ me himn të thërrasim: At' qiellor,* je shenjt; Fjal' e përjetshme tok,* je shenjt; dhe ti, Shpirt i tërëshenjt', je hyjnor,*³⁴ o Trini, të madhërojmë ne.

(2x)

O Shpëtimtar, hegjemonet e engjëjve e pan'* mënyrën aq të huaj* të largimit tënd lart, ndaj,* njëri-tjetrin, pyesnin me çudi:* Ç'është kjo pamje? Si njeri* është në formë i dukuri, por me trup* si Zot ngjitet më lart se qiejt.

Kur galileasit, Fjalë, të pan' të ngritur lart* nga mali i Ullinjve* trupërisht, i dëgjuan* engjëjt që me zë u thanë: Përse* rrini duke vështruar pra?* Me trup do vijë ai prapë si tani* që e patë, po kështu, njësoj.

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Linde siç deshe vetë, u shfaqe siç të pëlqeu, pësove në trup, o Perëndia ynë, u ngjalle prej së vdekurish pasi e shkele vdekjen, u more me lavdi ti që mbush Gjithësinë,¹¹⁷ dhe na dërgove Shpirtin Hyjnor,⁹⁸ që ta përhimnojmë dhe ta lavdërojmë hyjninë tënde.

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji, Antifonet:

Antifoni i parë

Varg a): Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Me ndërmjetimet e Hyjlindësës...

Varg b): Se Zoti është tejet i lartë, mbret i madh mbi tërë dheun.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...

Varg c): Nënshtrove popuj dhe kombe nën këmbët tona.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...

Antifoni i dytë

Varg a): I madh është Zoti dhe tepër i himnueshëm.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë, që u ngjite me lavdi nga ne në qiej, ne që të psalim aliluia.

Varg b): Perëndia njihet në pirgjet e tij.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë...

Varg c): Se ja ku u mbloodhën mbretërit e dheut.

Shpëtona, o i Bir i Perëndisë...

Antifoni i tretë

Varg a): Dëgjojini ato, mbarë kombet.

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë...

Varg b): Goja ime do të flasë urtësi dhe studimi i zemrës sime mençuri.

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë...

Varg c): Do ta ul veshin tim në paravoli, do ta hap problemin tim në psaltir.

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë...

Hyrtores

U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete. **Shpëtona**, o i Bir i Perëndisë...

Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi i Analipsit. Trishenjtë. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX Me një mendje, ne besnikët. Kungatore U ngjit Perëndia. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja.



TË ENJTEN E ANALIPSIT NË MBRËMËSORE

Thirrtores Idhiomele të Analipsit

Ting. I

O Zot, pasi u ngjite në qiejt nga ku kishe zbritur, mos na lër si jetimë,¹⁰⁵ ardh të Shpirti yt duke i sjellë botës paqen;¹⁰⁸ tregoju bijve të njerëzve veprat e fuqisë sate, o Krisht njeridashës.

O Krisht, u ngjite tek Ati yt i pafillim, ti që nuk u ndave nga gjiri i tij¹⁰¹ i papërshtuar, dhe Forcat nuk bënë shtesë në lavdërimin e Trishenjtë³⁴, sepse si Një Bir të njohën dhe pas trupëzimit, o Zot, si të vetëmlindurin e Atit;¹⁰⁹ na mëshiro me shumicën e dhembshurive të tua.¹¹⁰

I njëjti

O Zot, engjëjt e tu u thoshin apostujve: O burra galileas, pse qëndroni duke vështuar në qiell? Ai është Krishti Perëndi që u ngjit nga ju në qiell; ai do të vijë përsëri siç e patë kur shkante në qiell; adhurojeni me oshënarë dhe drejtësi.¹¹¹

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *dhe* Tani *Ting. II*

Linde siç deshe vetë, u shfaqe siç të pëlqeu, pësove në trup, o Perëndia ynë, u ngjalle nga të vdekurit pasi e shkele vdekjen, u ngjite me lavdi ti që mbush Gjithësinë,¹¹⁷ dhe na dërgove Shpirtin Hyjnor,⁹⁸ që ta përhimnojmë dhe ta lavdërojmë hyjninë tënde.

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i Madh:

Ting. i Rëndë

Perëndia ynë i bëri të gjitha sa deshi në

qiell e në dhë.

Varg a): Në daljen e Izraelit nga Egjipti, e shtëpisë së Jakovit nga një popull barbar.

Perëndia ynë i bëri...

Varg b): Deti pa dhe iku, Jordani u kthye mbrapa.

Perëndia ynë i bëri...

Varg c): Ç'është me ty, o det, që ike, dhe ti, o Jordan, që u ktheve mbrapa?

Perëndia ynë i bëri...

*Pasvargje të Analipsit
Ting. II Ote ek tu ksilu se*

U thot' * Krishti që përmbush çdo gjë *¹¹⁷ Nxënësve si shkoi në mal, Malin e Ullinjve: O miq, *⁵² po afrohet koha ime që të ngrihem lart; * shkoni dhe t'u mësoni kombeve fjalën time, *⁴³ e dëgjua ju nga zëri im". Dhe atëher', * si mbi një karrocë me plot lavd, * lart u ngjit, ndaj shtangeshin shumë * shën apostujt edhe mbetën tërë tmerr.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Krisht, kur * Nëna edhe Nxënësit * shkuan bashkë në Betani, duart e tua, Zot, * lart i ngrite dhe, si i bekove, menjëher' * një re drite të mori larg * prej syve të tyre; * kur me madhështi u ngjite atëherë ti, * realisht u shfaqe i ulur * plot lavd në të djathtë të Atit; * ne me bes' të falemi ty dhe atij.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Tok ju, * besëmirë, ejani, * mali i Ullinjve lart është, veçse të ngjitemi njësh * pas apostujve; atje zemrën dhe mendjen

ton' * le t'i ngremë ne sipër, që ta shohim tash Krishtin * mbi një re të ndritshme fort; ndaj me kënaqësi * dhe plot me hare të thërrasim: * Lavd, lavd, Analipsit tënd, o Zot, * o Krisht, shumëmëshirues Perëndi.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Duke i parë lartësimet e tua në malet e shenjta, o Krisht, reflektimi i lavdisë së Atit,¹⁰⁴ e përhimnojmë pamjen tënde, fytyrën e shndritur; u falemi pësimeve të tua, e nderojmë ngjalljen, e mburrim Analipsin e lavdishëm; mëshirona.

Përlëshorja



TË PREMTEN E JAVËS VI NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. Tërth. IV To prostahthén mistikós*

Pasi u ngjite në Malin e Ullinjve, * nga ku u ngrite, * se e ndritshmja re nga toka, * o Jisu përdëllyes, * ty të mori teksa * shën Nxënësit po shikonin, - çudi plot tmerr! * Dhe engjëjt në qiell thoshin * me zë të lart': * "Ngrihuni, porta, me frik' nga ushtrit' e sipërme". Të himnon me ta, mbret,⁹⁴ çdo krijim, * Perëndi i të gjithave. (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Hipe mbi ret' e qiellit si u le * paqen njerëzve poshtë,¹³⁴ u ngjite lart, * u ule bri Atit tënd, * në të djathtën e tij se ti * je i njëqenshëm tok me të dhe me të Shenjtin Shpirt, * me trup u shfaqe,³⁶ por pa ndryshim mbete, ndaj e pret * fundin botëror, Zot, që të vish të gjykosh drejt *

mbi tokën mbar' kozmosin,*¹¹⁴ o gjykatës i drejtë krejt,*¹³⁵ t'na i mbrosh ti,* Jisu, shpirtrat* si përdëllimtar Perëndi,* dhu-rona, o mirëbërës* dhe Shpëtimtar,* ndjesë shkëlqesh, sepse na ke shërbëtorë ne.

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Analipsit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Analipsit (2x).

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. II Ikos tu Efrathá*

O mrekulli e re!* Natyra njerëzore* u lidh me Perëndinë* e fortpushtetshëm, Fjalën,* edhe u ngjit në qiejt lart.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Dita e ndritshme nur,* e hijshme dhe e shenjtë* e ngritjes zotërore,* hyjnore, për në qiej,* shkëlqeu dhe shndrit kozmosin.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Siç u dërgove, Krisht,* Zot, Nxënësve nga sipër* të bashkëqenshmin Shpirt ti,* o Shpëtimtar, dërgoja* dhe popullit tënd Hirin tënd.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. I

O Krisht, kur po ngjiteshe sipër, nga nuk u ndave, Fuqitë e engjëjve dhe të gjithë të patrupët po u thërrisnin me ngazëllim Fuqive më të larta: "T'i ngrenë portat hegjemonët tuaj, se do të hyjë mbreti i lavdisë",⁹⁴ sepse të mori me trup froni keruvik;¹⁰² o Zot, lavdi më ty.

Përlëshorja e Analipsit [një herë, si edhe deri në Mbyllje, ndërsa në fillim të Mëngjesores (pas Perëndia është Zoti) tri herë. Në fund të saj, një herë.].



TË PREMTEN E JAVËS VI NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV Édhokas simíosin

Nuk pëson sipas Hyjnisë, por pësove porsi njeri,* veç u ngjalle pas tri ditësh,* plaçkite dhe vdekjen, Zot,* tok me veten ngrite,* o Krisht, krejt të prishurit dhe drejt Atit shkove lart,* pasi premtove se do dërgoje ti* te Nxënësit e tu, apostujt e tu, Shpirtin Ngushëllimtar,* Shpëtimtari i shpirtit ton',*⁹⁸ o Jisu i pushtetshëm fort.

"Pse qëndroni duke parë lart drejt qiejllit?", engjëjt shenjt' që, si njerëz, dalloheshin,* i pyesnin mistet mbar'* të Jisuit, Fjalës.* "Ky që po vështroni të merret nga një re plot drit',* në një mënyrë të ngjashme, siç u duk,* do vijë ta gjykojë botën"¹¹⁴ siç ka thënë, ndaj shkoni ju* dhe zbatojini sa ju tha* Shpëtimtari i shpirtave.

Fjalë e tërëfuqishme, ti, pas ngritjes mbi konceptin,* jashtë varrit tënd, more tok* ata që i deshe fort* dhe i nxore jashtë,* pra në Betani; dhe në Malin e Ullinjve lart* arrite dhe i bekove dhe kështu* u ngrite edhe engjëjt u nënshtroan krejt para teje, Zot,* o Jisu, mbret i Forcave;* i shpëton shpirtrat tanë, Krisht.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

Sot, duke e parë në qiej natyrën tonë,

Fuqitë e sipërme çuditeshin për mënyrën e huaj të ngjitjes dhe habiteshin duke i thënë njëra-tjetrës: “Cili është ky që erdhi?”.¹¹³ Por, duke parë Zotin e tyre, urdhëroheshin t’i ngrinin portat qiellore.⁹⁴ Bashkë me to të himnojmë pa pushim ty që do të vish sërish me trup nga atje si gjykatës i të gjithëve dhe Perëndi i tërëfuqishëm.

Pasvargje të Analipsit

Ting. II Ikos tu Efrathá

Pëlqimin atëror* e mbushe, o i mirë;* të lartat me të poshtmet* ti i bashkove,¹³¹ shkove* me lavd atje ku që më par’.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Drejt Lindësit tënd, Krisht,* u ngjite sado s’ishe* i ndarë, dhe natyrën* që dergiej poshtë, o Zot* i dhembshur, ti e ngrite lart.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Të mori lart një re* e ndritshme edhe engjëjt* me tmerr edhe me frikë* ty të shërbenin, o Krisht,* sipas të hyjshmit, urdhrit tënd.

Lavdi dhe Tani *Ting. i Rëndë*

Shkove në Malin e Ullinjve, ti që e përdëllen fisin e njerëzve, dhe një re të mori nga sytë e Nxënësve të tu, të cilët trembeshin nga shkaku i fanitjes, ndërsa gëzoheshin duke pritur Shpirtin e Shenjtë; na mbështet tek ai, o Shpëtimtar, dhe mëshirona.

TË SHTUNËN E JAVËS VI NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores

Ting. I Tu lithu sfracisthestos

Kur ngjitja e çuditshme i shtangte engjëjt shenjtë,* Nxënësit hyjnor’ i habiste i frikshmi lartësim pra,* u ngjite me lavd, si Perëndi,* për ty u hapën portat,⁹⁴ Shpëtimtar,* ndaj Fuqitë qiellore çuditeshin* dhe thoshin: Lavd zbritjes sate,*¹¹² lavd mbretërisë sate, Zoti Krisht,* lavd Analipsit tënd, plot nder,* o i vetmi njeridashës, lavdi përdëllimit tënd. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores

Ting. I Tu lithu sfracisthestos

Dhe Hadhin e plaçkite, dhe botën e ndriçove* gjatë ngjalljes sate; u ngjite me lavd, o Shpëtimtar Zot* që çdo gjë e mban në dorë fort,* o jetëdhënës; ndaj me engjëjt tok* të lëvdojmë, o i tërëfuqishëm, ne:* Lavdi Analipsit tënd, Krisht,* lavd mbretërisë sate, o Jisu;* lavd dhembshurisë sate pra,* o i vetmi njeridashës, i vetmi përdëllimtar. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Analipsit (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Analipsit (2x).

Pasvargjet e Lavdërimeve

Ting. II Ikos tu Efrathá

“Ju që ju mblodha, un’* nuk do t’ju lë jetimë,*¹⁰⁵ do t’ju dërgoj Shën Shpirtin”,* kështu iu foli Zoti* Krisht miqve⁵² dhe u dha premtim.⁹⁸

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, bro-



horisni për Perëndinë tonë me zë nga zëllimi.

Engjëjt u than' me zë* apostujve të urtë:* O burra galileas,* siç po e shihni, prapë* do vijë me lavdi ai.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Zbritën me gaz, o Fjal',* nga Mali i Ullinjve* shën Nxënësit e tu, Zot,* dhe thurnin lavde, himne* për Analipsin tënd hyjnor.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. IV*

U ngjite me lavd nga toka në qiej, ti që i mbush të gjitha¹¹⁷ me anë të Hyjnisë dhe u ule në të djethtë të Atit ti, Fjala Perëndi që nga fillimi;¹⁵⁷ prandaj, kur i panë të frikësuar, Fuqitë qiellore u thoshin apostujve: “Pse e shihni duke soditur në qiell? Ai që ju po e shikoni, ai do të vijë sërish me lavdi për të gjykuar tërë dheun¹¹⁴ dhe për ta shpërblyer çdokënd sipas veprave të tij.”¹⁵⁸ Atij t'i thërrasim: O Zot i pakuptueshëm, lavdi më ty.

CITIME

Shërimi i të Verbrit: Joan kap. 9.

Analipsi: Mark 16.19-20; Lluk. 24.50-52; Vep. 1.2-11

1. Joan 1.3
2. Jez. 44.1-4
3. Num. 14.19 etj.
4. Gjen. 2.15
5. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
6. Abak. 3.3
7. Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.2
8. Eks. 25.30-37; 38.13
9. Eks. 3.2-5; Vep. 7.30
10. Ps. 131(132).8
11. Gjen. 28.12
12. Eks. 13.21 etj.
13. Is. 11.1,10; Rom. 15.12; Apok. 5.12; 22.16
14. Eks. 14.21-15.1 etj.
15. Lluk. 1.26-28
16. Eks. 3.14
17. Hebr. 6.19
18. Mal. 4.2(3.20)

19. I Thes. 5.5
20. Matth. 19.29; Mark 3.27; Lluk. 11.22
21. Matth. 27.66
22. Ps. 2.6 etj.
23. Eks. 31.18; 33.18-19,23
24. Matth. 27.38; Mark 15.27; Lluk. 23.33; Joan 19.18
25. Joan 19.34
26. Matth. 28.7-8
27. Gjen. 3.16-19
28. Ps. 77(78).54
29. Joan 10.15,17-18
30. Joan 10.28
31. Matth. 27.59-60; Mark 15.46; Lluk. 23.52-53; Joan 19.38-42
32. Matth. 28.2-7; Mark 16.5-7
33. Mark 16.10
34. Is. 6.3
- 34a. Matth. 20.19; Mark 9.31; 10.34; Lluk. 18.33
35. Matth. 27.51
36. I Tim. 3.16
37. I Mbret. [Sam.] 2.1
38. Ps. 5.8; 68(69).14; 105(106).7,45
- 38a. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9; II Makk. 7.23
- 38b. Kënga 1.8; 5.9,17(6.1)
39. Abak. 3.1-2
40. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
41. Gjen. 3.2-6
42. Vep. 1.4
43. Matth. 28.19
44. Gjen. 3.23-24
45. Ps. 62.1; Is. 26.9
46. Gjen. 3.1-5,13-15; II Kor. 11.3; Apok. 12.9,14-15; 20.2
47. Ps. 118(119).73; Jov 10.8
48. Matth. 16.21; 17.23; 26.32; 27.63; 28.6; Mark 14.28
49. Is. 26.13
50. Jona kap. 2
51. Gjen. 2.7
52. Lluk. 12.4; Joan 15.15
53. Lluk. 24.49
54. Rom. 2.19
55. Ef. 6.15
- 55a. Mark 10.30; Joan 6.27; 10.28; 17.2
56. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-28
57. Matth. 27.45; Mark 15.33; Lluk. 23.44
58. Matth. 27.52-53
59. Matth. 28.8; Mark 16.1-2; Lluk. 24.1
60. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
61. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
62. I Petr. 3.19
63. Matth. 25.33
64. Lluk. 1.49
65. Kol. 2.15
66. Joan 12.37
67. Matth. 27.18; Mark 15.10
68. Matth. 28.16-17 etj.
69. Matth. 9.30 etj.

70. Jak. 1.17
 71. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
 72. I Kor. 5.7
 73. Lluk. 1.78
 74. Kol. 3.12
 75. Matth. 23.24-25
 76. II Kor. 3.16
 77. Hebr. 10.1
 78. I Kor. 15.56
 79. Ps. 106(107).18-19
 80. Tit. 2.13
 81. Jak. 2.5
 82. Matth. 25.1-12
 83. Matth. 20.22; Mark 10.38-39
 84. Gjen. 28.17
 85. Ps. 50(51).14
 86. Matth. 21.19; Mark 11.13-14,20
 87. Lluk. 13.6-7
 88. Lluk. 15.11-20
 89. Ps. 135(136).7
 90. Lluk. 1.30-35
 91. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak 17.3
 92. Ps. 135(136).8
 93. Is. 53.7; Vep. 8.32
 94. Ps. 23(24).7,9
 95. Matth. 12.8; Mark 2.28; Lluk. 6.5
 96. Rom. 7.6
 97. Ps. 106(107).10
 98. Joan 15.26
 99. Ps. 102(13).19
 100. Ps. 103(104).3
 101. Joan 1.18
 102. II Mbret. [Sam].6,2; 22.11; IV [II] Mbret. 19.15; Ps. 17(18).11; 79(80).2; 98(99).1
 103. Ps. 68(69).17; 108(109).21
 104. Hebr. 1.3
 105. Joan 14.18
 106. II Kor. 8.9
 107. Baruh 3.38
 108. Gal. 5.22
 109. Joan 1.14,18; 3.16-18; I Joan 4.9
 110. Ps. 50(51).3; 68(69).17
 111. Lluk. 1.75
 112. Ef. 1.21; 4.9-10
 113. Is. 63.1-2
 114. II Tim. 4.1; I Petr. 4.5
 115. Joan 10.11-14
 116. Kol. 1.26
 117. Ef. 1.23
 118. Ps. 23(24).8
 119. Ps. 46(47).6
 120. I Petr. 3.19
 121. I Tim. 2.5
 122. Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27
 123. Ps. 44(45).10
 124. Sosana 52
 125. II Kor. 5.17; Gal. 6.15
 126. Eks. 20.21; Sirak 45.5
 127. Eks. 4.10
 128. Eks. 20.22 etj.
 129. Eks. 31.18; Ligji i dytë 9.10
 130. Matth. 18.12-13
 131. Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18
 132. I Mbret. [Sam.].1.4-19
 133. I Mbret. [Sam.].2.3
 134. Joan 14.27
 135. II Makk. 12.6; Ps. 7.12; II Tim. 4.8
 136. II Kron. 18.18; Is. 6.1; Dan. 7.9
 137. Is. 19.1
 138. Hebr. 2.14-15
 139. I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16
 140. Rom. 9.5
 141. IV [II] Mbret. 2.11; Sirak 48.9
 142. Mih. 4.2; Is. 2.3
 143. Ps. 46(47).2
 144. Is. 45.8
 145. Fil. 2.8
 146. I Joan 2.2; 4.10
 147. Hebr. 5.9
 148. Ef. 2.18; 3.12; I Petr. 3.18
 149. Rom. 1.25
 150. Ligji i dytë 32.43
 151. Dan. 3.7
 152. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
 153. Ligji i dytë 32.3; Sirak 39.15
 154. Joan 14.16
 155. Ps. 8.2
 156. Matth. 19.28; 25.31
 157. Joan 1.1
 158. Apok. 22.12





**E DIELA E 318 ETËRVE HYJPRURËS
NË NIKE**

**TË SHTUNËN
NË MBRËMËSOREN E VOGËL**

*Thirrtores Ngjallësore
Ting. Tërth. II*

Duke pasur fitoren kundër Hadhit... (2x)
Sot Krishti, pasi shkeli vdekjen...
Nga ti, o Zot, që je në tërë krijesën...

Lavdi *Ting. Tërth. II*
Trumbetat mistike të Shpirtit...
(*Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 179*)

Tani *Injëjti Hyjlindësore Dogmatike*
Të meriton me të vërtetë të të lumërojmë ty, Hyjlindësen, sepse, kur u fut në barkun tënd të pacenuar, Krijuesi i të gjithave¹ u bë trup pa u ndërruar në natyrë as duke bërë me fantazi Ekonominë, mirëpo me mishin e gjallë dhe me logjikën që mori prej teje dhe, pasi brenda tij e mori qenien, për hirin tonë si njeri u bashkua në hipostazë, ai Një, Perëndi i përsosur

dhe njeri prej teje; prandaj e dallojmë besërisht diferencën në dy natyra të dukshme; atij përgjëroju, o e Tërëshenja e thjeshtë, të na dërgojë nga lart paqen dhe përdëllimin e madh.²

*Pasvargje
Ting. Tërth. II
Ngjallësore*

Ngjalljen tënde, o Krisht Shpëtimtar, engjëjt e himnojnë në qiej. Denjësona dhe ne përmbi dhé, që të të lavdërojmë me zemër të pastër.*

*Të Hyjlindëses
Olin apothëmeni*

Varg: Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë brezat e brezave.

Perëndia i mbikohshëm, siç i premtoi me betim qëmoti paraatit tënd, e bëri kohët e fundit kur doli prej barkut tënd të hyjshëm,³ o e pacenuar; sepse, me të vërtetë, lindi prej teje Zoti që i mban në pëllëmbë anët e botës; atë ma bëj të butë në orën e gjykimit, o Mari virgjëreshë, që

të fitoj mbretërinë e tij nëpërmjet lartësimit përmes virtyteve dhe vrasjes së pasioneve.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule veshin tënd, dhe harroje popullin tënd dhe shtëpinë e atit tënd, edhe do të dëshirojë mbreti bukurinë tënde.

Me mendje të pastër, Isaia, që nga larg, paratha se do të lindje⁴ Bërësin e Krijesës,¹ o Virgjëreshë e thjeshtë, e kulluar, sepse vetëm ti u shfaqe si e tërë-paqortueshme që nga jeta; prandaj të lutem: Pastroje zemrën time të ndotur dhe tregomë pjesëtar të shkëlqimit hyjnor të Birit tënd dhe në anën e tij të djathtë kur të ulet për të gjykuar mbarë botën, siç është shkruar,⁵ o Vajzë.

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të pasurit e popullit.

Nëpërmjet Birit tënd u shfaq katastrofa e vdekjes, sepse ti, o Vajzë, u bërë banesë e jetës⁶ së paprishshme; prandaj të lutem: Mua që dergjem në arkat e Hadhit, në arkat e pasioneve të mia, më ngri dhe më udhëzo në ngazëllim, gjallëri, shpërblim të lumtur, o Virgjëreshë, dhe më denjëso për harenë e paprishshme hyjnore, ku ka shijim të përjetshëm, ku ka dritë pa perëndim.

Lavdi *Ting. IV*

Le ta kremtojmë sot besërisht ne...

(Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 180)

Tani

Një i Analipsit, një çfarëdo

Përlëshore: Ngjallësore dhe e Analipsit

NË MBRËMËSOREN E MADHE

*10 Thirrtores: 3 Ngjallësore, 3 të Analipsit dhe 4 të Etërve
Ting. Tërth. II
Ngjallësoret*

Duke pasur fitoren kundër Hadhit...

Sot Krishti, pasi shkeli vdekjen...

Nga ti, o Zot, që je në tërë krijesën...

Të Analipsit I njëjti (fq. 159)

Zoti u ngjit në qiej...

O Zot, në ngjitjen tënde...

Duke i parë lartësimet e tua...

*Të Etërve I njëjti
I apëgnosmeni*

Para dritëprurësit, ti ke lindur⁷ para jetës nga një bark, një At', pa nën',* edhe pse Ariosi pa mend, me arrogancë* nuk të beson si Perëndi, por* si krijim, të bashkon kot* ty me krijimet; ndaj dhe mbledh lënd',* Zot, për zjarrin përjetë,* si thesar për veten, por Sinodi* i mbledhur në Nike të shpalli si Bir, Zot mbi Një fron me Atin dhe Shenjtin Shpirt.

“Shpëtimtar, kush ta ka grisur këmi-shën?”*⁸ “Ariosi”, - the, Zot, “që ndan Trininë,* të bashkëndëruarin sundim në pjesë”. “Ky pra* s’të pranon si një nga Trinia,* e mëson dhe Nestorin:* “Perëndi-lindëse asnjëher’* t’mos e quash Marinë”* - herezi e madhe; por Sinodi* i mbledhur në Nike të shpalli si Bir, Zot mbi Një fron me Atin dhe Shenjtin Shpirt.

Bie keq Ariosi në grem’ faji,* se i mbyll syt’ t’mos e shohë dritën* dhe në të përbrendshmet me hyjnorin grep u shqye,* jashtë e hedh esencën mbarë* si edhe shpirtin dhunshëm* se në mënyrë dhe në mendje* u bë një tjetër Judë,* pra



tradhtar i frikshëm;⁹ por Sinodi* i mbledhur në Nike të shpalli si Bir, Zot mbi Një fron me Atin dhe Shenjtin Shpirt.

I pamendi, Ariosi, e ndau* monarkin' e Trinis' së Tërëshenjtë* në tri pra esenca krejt të ndryshme, të pangjashme.* Etër hyjprurës, që u mblodhët* me shpirt, plot zell të zjarrtë* pra si thesviti shën Ilia,*¹⁰ saktë si i mësoi* Shpirti Shenjt, atë që blasfemoi* me dogma turpi fort e presin me shpatën e këtij Hyjnorit Shpirt¹¹ shumë drejt.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

Trubetat mistike të Shpirtit, Etërit hyjmbajtës, le t'i himnojmë sot, ata që kënduan në mes të Kishës melodi harmonike theologjike, një Triadhë pa asnjë ndryshim në substancë dhe hyjni, rrëzuesit e mashtrimit dhe mbrojtësit e orthodhoksëve, që ndërmjetojnë gjithmonë te Zoti, që të shpëtohen shpirtat tanë.

Tani *Hyjlindësorja Dogmatike*
Injëjti

Cili nuk do të të lumërojë, o Virgjëreshë e Tërëshenjtë? Cili nuk do ta përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se Biri yt i Vetëmlindur, që shkëlqeu prej Atit pa kohë, lindi prej teje së Qashtës dhe u mishërua pa shpjegim, duke qenë nga natyra Perëndi, dhe duke u bërë për ne njeri nga natyra, jo i ndarë në dy persona, por i njohur në dy natyra të papërziera. Atij lutju, o Zonjë e Tërëlumur, të mëshirohen shpirtat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Gjenezës

(14.14-20)

Sapo dëgjoi Abrahami se u robërua Loti, vëllai i tij, numëroi ata që kishin lindur në shtëpinë e tij, pra treqind e tetëmbëdhjetë veta, dhe shkoi prapa tyre deri në Dan. Dhe u hodh mbi ta natën, ai dhe shërbëtorët e tij bashkë me të, dhe i goditi e i ndoqi deri në Hoval, që është në të majtë të Damaskut. Dhe e ktheu gjithë kalorësinë e sodomëve dhe Lotin, vëllanë e tij, dhe gjithë plaçkat e tij, dhe gratë, dhe popullin. Dhe doli mbreti i sodomëve në takim me të, pasi ky u kthye nga therja e Holodhogomorit dhe e mbretërve që ishin me të në luginën e Saviut (kjo ishte fushë mbretërishe); dhe Melkisedeku, mbreti i Salimit, nxori bukë dhe verë; dhe ishte prift i të Shumëlartit. Dhe e bekoi Abrahamin dhe tha: I bekuar qoftë Abrahami prej Perëndisë së Shumëlartë, i cili ndërtoi qiellin e dheun, dhe i bekuar qoftë Perëndia i Shumëlartë, i cili të dorëzoi armiq të tu që të jenë të nënshtruar te ti.

Këndimi i Ligjit të Dytë

(1.8-11; 15-17)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: "Shikoni, e dorëzova para jush dheun; pasi të futeni, trashëgoni dheun, për të cilin Zoti iu betua etërve tanë, Abrahamit, dhe Isaakut, dhe Jakovit, se do t'ua jepte atyre dhe farës së tyre pas këtyre. Dhe iu foli juve në atë kohë, duke thënë: 'Nuk do të mundem t'ju sjell unë vetëm. Zoti, Perëndia ynë, ju shumoi, dhe ja jeni sot si yjet e qiellit për sa i përket numrit. Zoti, Perëndia i etërve tanë, ju shtoftë juve, si jeni, një mijë herë, dhe ju bekoftë, sikundër ju foli juve'. Dhe mora prej jush burra të urtë, dijetarë dhe

të mençur, dhe i vura që të udhëheqin mbi ju, kryemijësja dhe kryeqindësja, dhe kryepesëdhjetësja, dhe kryedhjetësja, dhe prokurorë të gjykatësit tuaj. Dhe i porosita gjykatësit tuaj në atë kohë, duke u thënë: 'Dëgjoni midis vëllezërve tuaj dhe gjykoni drejt midis burrit dhe midis vëllait të tij dhe midis prozelitit të tij. Nuk do të njohësh fytyrë në gjykim. Sipas të voglit dhe sipas të madhit do të gjykosh. Nuk do të ulësh fytyrë njeriu, sepse gjykimi është i Perëndisë'.

Këndimi i Ligjit të Dytë

(10.14-18; 20-21)

U tha Moisiu bijve të Izraelit: Ja, i Zotit, Perëndisë tënd është qielli dhe qielli i qiellit, dheu dhe të gjitha sa janë në të. Por Zoti parapëlqeu që t'i dojë etërit tanë, dhe zgjodhi nga të gjitha kombet farën e tyre pas këtyre, ju, në këtë ditë. Dhe do rrethpritni zemërngurtësinë tuaj, dhe qafën tuaj nuk do ta ashpëroni më; sepse Zoti, Perëndia juaj, ky Perëndi perëndish dhe Zot zotash, Perëndia i madh, i fuqishëm dhe i frikshëm, i cili nuk admiron fytyrën, që nuk do të marrë dhuratë, që bën gjykim për prozelit, dhe jetim, dhe të ve, dhe e do prozelitin, ka për t'i dhënë atij bukë dhe veshje. Zotin, Perëndinë tënd do ta kesh frikë dhe atë vetëm do të adhurosh, dhe tek ai do të ngjitesh dhe në emrin e tij do të betohesh. Ai do të jetë krenaria jote dhe ai do të jetë Perëndia yt, që të bëri gjëra të mëdha dhe të lavdishme, këto që i panë sytë e tu.

Në Liti Idhiomeli i shenjtit të kishës

Lavdi I Etërve Ting. III

Jeni bërë, o Etër të Shenjtë, ruajtës të saktë traditash apostolike,¹² sepse,

meqenëse dogmatizuat orthodhoksisht njëqenshmërinë e Trinisë së Shenjtë, rrëzuar sinodikisht blasfeminë e Ariosit; bashkë me të, pasi kritikuat si kundërshtarë të Shpirtit Makedhonin, dënuat Nestorin, Eftikun dhe Dhioskorin, edhe Savelin, edhe Sevir Aqefalin; lutemi që ta ruani jetën tonë pa njollë brenda besimit, që të shpëtojmë nga mashtrimi i tyre.

Tani I Analipsisit Ting. Tërth. II

O Zot, kur e plotësove misterin e Ekonomisë, pasi i more Nxënësit e tu, u ngrite në malin e Ullinjve dhe e kalove kupën e qiellit; ti që u varfërove¹³ si unë për mua dhe u ngjite atje nga nuk u ndave, dërgoje Shpirtin tënd të Tërëshenjtë¹⁴ që t'i ndriçojë shpirtrat tanë.

Pasvargjet Ngjallësore Ting. Tërth. II

Ngjalljen tënde, o Krisht Shpëtimtar...

Duke thyer dyert prej bronzi...

Krishti, duke dashur të na ngrejë...

Pasi u kryqëzove siç deshe, o Krisht...

Lavdi I Etërve Ting. IV

Le ta kremtojmë sot besërisht ne, tërësitë e orthodhoksëve, duke mbajtur besimin e mirë, kujtimin e përvitshëm të Etërve hyjmbartës, që u mbloodhën nga e gjithë bota në qytetin e shkëlqyer të Nikeasve; sepse ata shembën me mendje besëmirë dogmën ateiste të Ariosit të tmerrshëm dhe sinodikisht e dëbuan jashtë Kishës katolike, dhe Birin e Perëndisë e mësuan fuqishëm tek të gjithë që ta pohojnë atë në Simbolin e Besës si të bashkëqenshëm dhe të bashkëpërvitshëm, i cili është para jetëve, duke e parashtruar këtë saktësisht dhe besërisht te Simboli; prandaj dhe ne, duke ndjekur dogmat e tyre të hyjshme, duke besuar me siguri,

adhurojmë bashkë me Atin dhe Birin edhe Shpirtin e Tërëshenjtë, Triadhën e bashkëqenshme në një Hyjni.

Tani *I Analipsit I njëjti*

O Zot, kur e përmbushe, si i mirë, misterin e fshehur që nga jetët dhe nga gjeneratat,¹⁵ erdhe në malin e Ullinjve bashkë me Nxënësit e tu dhe me atë që të lindi ty, Bërësin e të gjithave;¹ sepse ajo që, gjatë pësimit tënd, kishte, si nënë, dhembje më të madhe se të gjithë, duhej të shijonte një hare të madhe shumë gjatë lavdisë së trupit tënd; në këtë gëzim morëm pjesë edhe ne gjatë ngjitjes sate në qiej, o Krisht, dhe e lavdërojmë përdëllimin tënd të madh² që ndodhi ndër ne.

Përlëshore

Ngjallësore Ting. Tërth. II

Fuqitë Engjëllore erdhën mbi varrin tënd, dhe ata që ruanin u bënë si të vdekur;¹⁶ dhe qëndronte Maria në varr, duke kërkuar trupin tënd të pacenuar.¹⁷ E plaçkite Hadhin, pa u ngarë prej tij; takove Virgjëreshën, duke dhuruar jetë. O Zot, që u ngjalle së vdekurish, lavdi më ty.*

Lavdi *I Etërve Ting. Tërth. IV*

I përmbilavdëruar je, o Krisht, Perëndia yn', që i themelove mbi dhë si yje Etërit tanë dhe me anën e tyre u hoqe udhën të gjith've te besa e vërtetë, i shumë-mëshirshëm, lavdi më ty.*

Tani *I Analipsit Ting. IV*

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë, pasi i ngazëllove Nxënësit me premtimin e Shpirtit të Shenjtë,¹⁴ kur ata u siguruan përmes bekimit, se ti je Biri i Perëndisë, Çlirimtari i botës.



NË MËNGJESORE

[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës të së dielës (me Kanunin Triadik)]

Pas Stihologjisë së parë,

*Ndenjësores Ngjallësore**

Ting. Tërth. II

Kur ishte varri i hapur dhe Hadhi vajton-te, Maria u thërriste apostujve¹⁸ që ishin fshehur.¹⁹ Dilni, o punëtorë²⁰ të vreshtit,²¹ lëçitni lajmin e Ngjalljes. U ngjall Zoti, duke i dhuruar botës përdëllimin e madh.²

Lavdi

O Zot, Maria Magdalena qëndronte pranë varrit dhe qante duke thirrur dhe, duke të pandehur si kopshtar, të thoshte: Ku e vure¹⁷ Jetën e amshuar?²² Ku e fshehe atë që rri mbi fron kerubik?²³ Se ata që e ruanin, u bënë si të vdekur nga frika.¹⁶ Ose më jepni Zotin tim, ose thërrisni bashkë me mua: Ti që ishe ndër të vdekurit dhe i ngjalle të vdekurit, lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore*

Ti që e quajte Nënë tënde të bekuar, erdhe te Pësimi me vullnetin tënd,²⁴ dhe shkëlqeve në Kryq, duke dashur të kërkosh Adamin, duke u thënë engjëjve: Përgëzomëni, se u gjet drahamia e humbur.²⁵ Ti që i rregullove të gjitha urtësisht, lavdi më ty.

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësoret

Ting. Tërth. II

Jeta²² dergjej në varr dhe një vulë ishte mbi gur. Ushtarët e ruanin Krishtin²⁶ si një Mbret që flinte dhe, si goditi pa u dukur armiq të tij, u ngjall Zoti.*

Lavdi

Me anën e vdekjes sate vullnetare,²⁴ gjetëm jetën e pavdekshme, o i tërëfuqishëm, i vetmi Shpëtimtar i të gjithëve, që e asgjësove fitoren e Hadhit dhe thumbin e vdekjes;²⁷ me ngritjen tënde të nderuar na rithirre të gjithë.

Tani *Hyllindësore*

O Hyllindëse e virgjër, përgjeroju Birit tënd, Krishtit, Perëndisë tonë, që u mbërthye vullnetarisht²⁴ në Kryq dhe u ngjall prej së vdekurish, që të shpëtohen shpirtat tanë.

I Paqortueshmi (Ps. 118), Bekimtoret etj.

Kanunet: Ngjallësori (tok me Irmoset) në 4, i pari i Analipsisit në 4 dhe i Etërve në 6.

Kanuni i Etërve të shenjtë që ka

Akrostihidhë:

“E himnoj mbledhjen e parë të barinjve”.

Ting. Tërth. II

Ode I

Os en ipiro pezeftsas

Duke himnuar Sinodin e tërëshenjt’* të shën Etërve, me mall,* po gëzohem, të thërras:* O Krisht, më ndihmo ta mbaj,* ta ruaj vendimin e tij krejt të shenjtë dhe hyjnor.

Pasi u mblodhën hyjprurësit etër sot,* si rrufe të shpallën, Krisht,* si të vetëmlindur ty*²⁸ dhe të bashkëpafillim* me Atin, si edhe të njëqenshëm të pohuan fort.

Famëmëdhenjt’, nusen tënde, të shenjtën Kish,’*²⁹ e stolisën si me ar,* Krisht, e bën’ të hirshme nur* kur e ekspozuan drejt* dhe qartas caktimin e besimit, dhëndër Shpëtimtar.

Hyllindësor

Shën mbretëresha e çmuar me shumë lavd* krejt hyjnor, të bukur fort,* e stolisur është bri* Birit, Perëndis’ së saj*³⁰ edhe përgjërohet, lyp për ne shpëtimin shpirtëror .

Zbritësore: Thio kalifthis

»**S**i mbulohet prej territ hyjnor³¹ me-
»meci,*³² me oratorí* thot’ një Ligj³³ të
»hyjshkruar,*³⁴ pasi e hodhi baltën larg
»shpirtërorit sy, po sheh Krishtin,*³⁵ ek-
»zistentin³⁶ dhe mistikisht njëh* Shën
»Shpirtin, me këng’ pra hyjnisht e mburr.

Ode III

I Etërve: Uq estin ájios

E pret Ariosin pa mend* shpata e mprehtë atërore, se blasfemoi, tha se gjatë lindjes pra* hyjnore ndodhi pësım,* ndarje, rrjedhje; ishte besëkeq, pa turp.

Si Abrahami shenjt dikur,*³⁷ qenë mobilizuar me urti gjith’ hyjfolësit, i asgjësuan pra* armiqt’ e tu maniak’, Krisht,* me fuqinë tënde, o i miri Zot.

E para mbledhje që u bë* nga priftërinjt’ e tu, Krisht,* me të drejtin besim të shpalli të njëqenshëm ty* me Atin që s’ka fillim,* Gjithëbërës, ty që linde, Shpëtimtar.

Hyllindësor

S’ka forcë njerëzorja fjal’,* as gjuha, Virgjëreshë, denjësisht të të mburrë, sepse deshi mirësisht* të trupëzohej nga ti* pa far’ jetëdhënësi Krisht, e dëlir’.

Zbritësore: Érikse gastrós

»**P**rangat që kish mitra e steriles edhe*
»talljen plot vrer nga një grua me fëmijë,*
»i shfarosi lutja thjesht e profeteshës*
»Ana qëmoti me një shpirt të dërmuar*
»drejt fuqiploetit* Perëndi³⁸ të dijeve.³⁹

*Kontaqi i Analipsit**Ting. Tërth. II Tin ipër imón*

Ti Ekonomin' për ne e përmbushe* dhe të dheshmet i bashkove me qielloret,* Perëndia yn' Krisht;⁴⁰ me lavdi ti u more lart,* por nga ne s'u ndave asnjëher',* s'u largove, dhe atyre, Zot,* që të duan, u thërret kështu:* Meqë jam unë me ju,* s'ka asnjë kundër jush.

*Ndenjësores të Etërve**Ting. IV Tahí prokatálave*

O Etër të lumur hyjfolës, u shfaqët mbi dhé* ndriçues,⁴¹ shkëlqyes krejt të fortë të së vërtetës, se shkritë herezit',* fjalët e shumta boshe,* blasfemitë; shpërnda-të* rrëmujë dhe trazira pra nga famë-këqijtë,* dhe, si hierarkë, ndërmjetoni që të shpëtojm'.

*Lavdi**I njëjti O ipsothis en to stavró*

Nikea, një qytet* zëmadv, i shkëlqyer,* tetëmbëdhjet' dhespot'* i mbloodhi te ve-tja* nga çdo vend kundër Ariosit sot, meqë ky* kish thën' blasfemi ndaj Zotit Krisht,* Fjalës, Birit të Perëndisë,* njërit prej Trinisë Zot* edhe e zvogëloi;* por e vithisën Etërit përdhé* edhe besimin* ata e forcuan mjaft.

Tani I Analipsit E ngjashme

Jisu, u ngrite ti* me lavd lart në qiej* dhe tok u ule në* të djathtën e Atit* nga nuk u ndave fare, njeridashësi Krisht,* Nxënësve të tu të urtë mjaft* u prem-tove se Shpirtin Shenjt* ti do t'ua dërgoje, Zot,*¹⁴ ndaj shkëlqena mendimet,* na jep ndriçim që, pa pushim, me zell,* të të himnojmë* shumë ty mirëbërësin.

*Ode IV**I Etërve: Hristós mu dhínamis*

Përderisa e bastardoj besimin ortho-dhoks me mendjen mosmirënjohëse, ai që kishte emër të keq, Ariosi, me vo-time atërore u nxor jashtë Kishës si një gjymtyrë e kalbur.

Kori i Etërve, duke luftuar për hirin tënd, o Zot, i mundi me triumf armiqtë e tu, dhe të besoi si të bashkëqenshëm me Atin dhe Shpirtin.

O Krisht, Perëndi dhe njeri, u bërë ndërmjetues midis Perëndisë dhe nje-rëzve; prandaj, duke të njohur si Një Bir, hyjmendësit të shpallën me dy natyra.

Hyllindësor

Shijimi i një pemë më shfaqti të vdekur, mirëpo druri i jetës që u shfaq prej teje, o e Tërëdëlirë, më ngjalli dhe më bëri trashëgimtar të shijimit të Parajsës.

Zbritësore: Anaks anakton

»Vetëm ti dole, Fjal', nga i vetmi Atë*
»që s'ka shkak, o mbret i mbretërve;⁴²
»dhe Shpirtin* autentik që ka forc' të
»barabartë* me ty, pra si mirëbërës e
»dërgove,* Zot, tek apostujt; i psalnin
»fuqis' që ke.

*Ode V**I Etërve: To thio fegji su*

Me të vërtetë janë të bukura këmbët e atyre që të predikojnë ty, paqen⁴³ që e kapërcen çdo mendje⁴⁴ të mbarë engjëj-ve dhe njerëzve dhe e bashkon botën me shumicën e paqes,⁴⁵ o Krisht.

Pasi u mbloodhën, mësuesit hyjnorë që u vulosën me nderim sipas ligjit të priftërisë së tërëshenjtë, të predikuan, o

Krisht, si urtësi dhe fuqi të Atit⁴⁶ dhe Fjalë enipostate.

Pasi e vaditët Kishën me rrjedhat e pas-tra të ujërave të mësimdhënieve të Krish-tit, shijoni të ngazëlluar përjetësisht në ujërat e prehjes.⁴⁷

Hyjlindësor

Oe vetmja Perëndilindëse, e tërëkullu-ar, e kërkojmë tani mbrojtjen tënde, se të njohim si llambë⁴⁸ të ndritshme që rre-zaton Krishtin, diellin e drejtësisë.⁴⁹

Zbritësore: Litirion kátharsin

»**O** bij dritëpamës nur të Kishës, prisni* »një vesë që fryn zjarr nga Shpirti, që »është* shfarosja pastruese e fajit, me- »që* sot prej Sionit* doli ligji,⁵⁰ pra Hiri* »shpirtëror që duket si gjuhë e zjarrtë.

Ode VI

I Etërve: Tu viu tin thólasan

Nga Etërit s'mundi dot* të shpëtonte⁵¹ mbjellësi* i barëve të egra shumë*,⁵² pra maniaku pas emrit – deshi kështu* e pashprehshmjia providenc'*. Kish zili Judën tër'dinaku, ndaj plasi.⁹

Hijnori, i çmuari* kor i Etërve të shpall* të vetëmlindur,²⁸ reflektim* të esencës së Atit,⁵³ të shndritur fort* edhe Bir të lindur, Zot,* më përpara çdo gjëje, Jisu Shpëtimtar.

Një bark që si gurr' kish nxjerr'* çurg të turbullt, të pavend,* pra të pabesën herezi,* shumë tmerrshëm u ça⁹ por dhe drejtësisht* me lutje si me parmend',* me kujdesjen e priftërinjve mjaft hyjnor'.

Hyjlindësor

Të kish parashkruar ty* Moisiu mjaft i madh*⁵⁴ midis profetëve si ark',⁵⁵ lla-

mbë,⁴⁸ shtambë,⁵⁶ tryezë⁵⁷ simbolikisht,* o nënë e Virgjër nur,* mishërimin e Zotit nga ti k'shtu e tha.

Zbritësore: Ilasmós imín

»**Z**ot, për ne, si falje⁵⁸ dhe shpëtim,⁵⁹ »shkëlqeve* nga e Virgjra, dhe, siç e zhva- »te nga prishja* në det, profetin Jona nga »një bark bishe,*⁶⁰ shndrite ta shpëtoje »dhe tërë Adamin* thell' nga prishja, se »me krejt fisin kish rënë.⁶¹

Kontaqi Ting. Tërth. IV

Predikimi i apostujve dhe dogmat e Etërve forcuan një besim në Kishë, e cila, duke u veshur me këmishën e së vërtetës që u end prej thelogjisë së sipërme,⁸ e cakton drejt⁶² dhe e lavdëron misterin e madh të shpresëtarisë.⁶³

Shtëpia

Le ta dëgjojmë Kishën e Perëndisë, e cila thërret me predikim të lartë:⁶⁴ «I eturi le të vijë tek unë dhe le të pijë;⁶⁵ kana që mbaj, është kana e urtësisë;⁶⁶ këtë pije e përzjeva⁶⁷ me fjalë të vërteta; nuk derdh ujë kundërshtimi,⁶⁸ por pohimi, nga i cili, duke pirë Izraeli i tanishëm,⁶⁹ sheh Perëndinë të flasë: 'Shikoni, shikoni se vetë unë jam dhe nuk ndryshova;⁷⁰ unë jam Perëndia i parë, unë, edhe pas këtyre, dhe veç meje s'ka tjetër absolutisht'.⁷¹ Prandaj ata që marrin pjesë, do të ngopen dhe do të himnojnë misterin e madh të shpresëtarisë".⁶³

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Dielën e Shtatë pas Pashkës, kremtojmë Sinodin e Treqind e Tetëmbëdhjetë Etërve Hyjprurës të Si-nodit të Parë Ekumenik në Nike.

Vargje: O yje dritëprurës të qiellit mendor,/

me rrezet tuaja ma shkëlqeni mendjen.

Vargje kundër Ariosit: Përderisa Ariosi e quan Birin si të huaj nga esenca e Atit,/ qoftë i huaj nga lavdia e Perëndisë.

Ode VII

I Etërve: Dhrosovolon men tin káminon

Fituat mbi Ariosin, sinonimin me maninë, i cili u egërsua me mani dhe tha gjëra të padrejta me krenari kundër Perëndisë,⁷² sepse mohoi t'i thërrasim Birit: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

Duke imituar birin e bubullimës,⁷⁴ o të mrekullueshëm, me gojët tuaja të zjarrta ua mësoni të gjithëve Fjalën si të bashkëpafillim dhe të bashkëfronshëm me Atin, që të thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

O të hyjllumtur, erdhët si me krahë për të ndihmuar Fjalën, sepse Shpirti i Shenjtë ju mblodhi nga cepat e botës për të thirrur: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

Hyjlindësor

Kamina nuk i dogji tre Djemtë,⁷⁵ ngaqë e paraikonizante lindjen tënde, sepse zjarri hyjnor banoi brenda teje duke mos të flakëruar dhe i ndriçoi të gjithë të të thërrasin: E bekuar je ti që kishe Perëndinë në mitër.

Zbritësore: Símfonon ethróisen

»**B**ënin simfoni tok veglat muzikore* që »të adhuronin ikonën e artë,* pa shpirt,⁷⁶ »por i shndritshmi Hir, Ngushëllimtari,* »na nxit, me nder, but',* të thërrasim: E »vetmja Trini pa koh',* me Një forc', je e »bekuar.

Ode VIII

I Etërve: Ek flogós tis osiis

Kur u përflakën prej rrezeve të Hyjnisë

sate, barinjtë e tu të mirë të pohuan si Krijuesin e të gjithave dhe Zotin, të cilin e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Kur u mblodh me hyjmentësi, kori i tërëkënduar i barinjve, duke theologuar tani Trininë e pakrijuar, na mëson të gjithë të thërrasim: Të përmbilavdërojmë në gjithë jetët.

Hierarkët, barinjtë e admirueshëm, e ndriçojnë shumë Kishën e Krishtit, duke e hijeshuar njëri këtu, tjetri gjetiu dhe duke e përmbilartësuar në gjithë jetët.

Hyjlindësor

Mbarë profetët të parapanë ty mistikisht në imazhe, se do të kishe Fjalën në shtatzëninë tënde, sepse, kur ai mori trup prej teje, doli i dyfishtë; atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Zbritësore: Lii ta dhesmá

»**N**jë simbolizim trindriçues i Zotit* që »hyjkryeson, freskon flak', zgjidh zinxhi- »rë.* I psalin Djemtë*⁷⁷ dhe Krijesa e tërë »të vetmit Shpëtues, mirëbërës; si Zot* »gjithëgatues, e himnon⁷⁸ fort në jetë.

Ode IX

I Etërve: Theón anthropis

E bashkëfronshmja, e bashkëpafillim* me Atin, Fjala që është para jetësh, ju mblodhi ju* se, fortshenjt', ju gjeti aleatë me zell* dhe, me fuqi nga Shpirti,⁷⁹ ju armatosi mjaft;* tash, me Forcat engjëlllore, e lëvdoni përgjithnjë.

Si mjekë shpirti dhe trupi, herezin* e frikshme të Ariosit, përhapjen e saj, ju tok* e ndaluar; dhe Simbolin e Besës drejt* te gjithë ne e ekspozuar hyjnisht; meqë* tash e kemi, ne jua mburrim ditën përgjithnjë me gaz.

Je dritë⁸⁰ pa cen ti, ndaj na e çliro* shpirtin nga veset, mjegulla, nga çdo terr siç ndërmjetojn',* o Krisht, celebruesit e tu që tani,* si të pabërë, pa fillim fort të shpallin ty* Zotin që ke bër' çdo gjë, të bashk'panisshëm me Atin.

Hyjlindësor

Me shtatzënin' tënde që s'rrëfeket dot,* që s'shprehet, u dhurua te të vdekurit ngjallje tash,* se për gjithë ne shkëlqeu jeta nga ti,* jeta e mishëruar dhe e shpërbëri fort* zyrtësin' e vdekjes qartë, Zonjë dhe Hyjlindëse.

Zbritësore: Heris ánasa

»Ki gaz, lavd nënor-virgjëror, mbretë-reshë;* gjuhë oratorësh, të aftë në fjalë,* nuk mund të të psalin siç duhet; çdo mendje* trulloset kur s'e kap* lindjen tënde, s'e koncepton,* ndaj me një zë ne të lëvdojmë ty.

I shenjtë është Zoti, Perëndia ynë. (3x)

Dërgimësore

Ngjallësore: Tis mathitës sinélthomen

Për peshk në gjol seç dolën sot,* pranë Tiberiadës,* shën Pjetri tok me nxënësit,* të bijt' e Zebedeut,* me shën Thoman' e me shokët;* Krishti i porositi* t'i hidhnin rrjetat djathtazi,* zunë shumë peshq pa masë, dhe ra me not* Pjetri dhe i vajti Jisuit, i cili* u duk së treti dhe tregoj,* buk' e peshq lart thëngjijve.^{81*}

E Etërve: Jineqes akutísthite

Sot kemi festë, panair* për Etërit e hyjshëm fort* gjatë kujtimit të tyre,* me lutjet që bëjnë, lypim,* popullin tënd, i dhembshuri* Zot, çliroje nga çdo dëmtim* prej herezive; denjëso* të gjith' ne të të lëvdojmë,* pra Atin, Birin dhe Shpirtin.

E Analipsit: Ton mathitón oronton se

Kur po të shihnin Nxënësit, lart ti shkoje,* sado që rrije ulur, Krisht, tok me Atin,* engjëjt rendnin para duke thirrur fort:* Ngrijini portat, hapini,* sepse u ngjit Mbreti⁸² drejtas* lavdis' së ndritshme nga nisja.

Lavdërime

Ngjallësore Ting. Tërth. II

Kryqi yt, o Zot, është jetë...

Varrimi yt, o Zot, i çeli Parajsën...

Bashkë me Atin dhe me Shpirtin...

U ngjalle pas tri ditësh prej varrit...

Dhe të Etërve

I njëjti Olin apothémeni

Etërit e hyjshëm fort,* pasi formuan çdo shkencë* shpirtërore dhe pastaj,* kur menduan bashkë me Shpirtin Tërëshenjt,*⁸³ shkruan hyjnisht³⁴ të gjith'* me një shpirt Simbolin* qiellor dhe të nderuar; në të na mësojnë ne* qartas krejt se Fjala është gjithashtu* tok pa fillim si Ati prind* dhe njësoj substancën e ka ai.* Etërit me lavde, të tërëpasur dhe në të vërtet'* hyjmendës, shkojnë pas mësimëve* dukshëm të apostujve. (2x)

Varg: I bekuar je, o Zot, Perëndia i etërve tanë.

Pasi pritën plot shkëlqim* mendor, me hyj frymëzim pra,* shpallën çdo hyjthënie tok* që diktoi Shpirti. Folën me fjalë shkurt* dhe me mjaft mençuri* dogma ungjillore* dhe tradita bese kryetarët, predikuesit* e Jisuit, Zotit, të lumurit,* se kishin marrë që nga lart* qartësisht zbulimet e dogmave.* Ndaj edhe këta u ndriçuan dhe u denjësuat fort,* dhe paraqitën besimin ton',* që Hyjnia na mëson.

Varg: Mblidhjani atij oshënarët e tij.

Mblodhën çdo eksperienc' nga Pimantika dhe vunë* po tani në akt inat* krejt të drejtë, siç duhej;⁸⁴ ndaj dëbuan fort* ujquit prishës, të rënd'*⁸⁵ dhe kështu i flakën* me hobe prej Shpirtit Shenjt larg⁸⁶ tërësis' së Kishës pra,* sepse kishin rënë për vdekje keq,* sëmundje kishin pa shërim.* Po kështu barinjtë e shenjtë bën'* porsi shërbëtorë vërtet të Krishtit tonë Perëndi,*⁸⁷ dhe njohës mjaft të hyjnueshëm,* predikues të fshehtash.

Lavdi *Ting. Tërth. IV*

I Gjergjit të Nikomedhisë

Kori i Etërve të shenjtë, mbledhur prej anëve të dheut, dogmatizoi një substancë dhe natyrë të Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; edhe misterin e thelogjisë ia dorëzoi me fuqi Kishës. Ata, duke i lavdëruar me besë, le t'i lumërojmë duke thënë: O ushtri e hyjshme, luftëtarë hyjfolës të rreshtimit të Zotit, yje shumëndriçuese të kupës së qiellit mendor, kështjella të parrëzueshme të Sionit mistik, lule erëkëndshme të Parajsës, gojë të tërarta të Fjalës, mburra e Kishës, lavdia e botës, ndërmjetoni pa pushim për shpirtat tanë.

Tani

E përmbibekuar...

Në Liturgji, [Tipiket dhe 12 Lumërimet: 4 të Ting. Tërth. II, 4 nga Ode III e Analipsit dhe 4 nga Ode VI e Etërve. Hyrje Ejani t'i falemi... që u ngjalle prej së vdekurish... Ose]Antifonet e Analipsit, por në të dytin me Shpëtona... që u ngjalle prej së vdekurish. Hyrja e Analipsit, por me Shpëtona... që me lavd u ngjite prej nesh në qiej... Pas Hyrjes, Përlëshorja ngjallësore, e Analipsit, e Etërve dhe e shenjtit të kishës. Kontaqi i

Analipsit. Të meriton. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja e Analipsit. Kungatore Lavdërojeni...



TË DIELËN E ETËRVE TË SHENJTË NË MBRËMËSORE

Thirrtores

3 të Etërve

(Kërkoji në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 178)

Para dritëprurësit, ti ke lindur...

Shpëtimtar, kush ta ka grisur këmishën...

Bie keq Ariosi në grem' faji...

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi *I Etërve*

(Kërkoji në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 179)

Trumbetat mistike të Shpirtit...

Tani *I njëjti*

Duke i parë lartësimet e tua në malet e shenjta, o Krisht, reflektimi i lavdisë së Atit,⁵³ e përhimnojmë pamjen tënde, fytyrën e shndritur; u falemi pësimeve të tua, e nderojmë ngjalljen, e mburrim Analipsin e lavdishëm; mëshirona.

Pasvargje të Etërve

(Kërkoji në Lavdërimet, fq. 186)

Ting. Tërth. II Olin apothémeni

Etërit e hyjshëm fort...

Varg: I bekuar je, o Zot, Perëndia i etërve tanë.

Pasi pritën plot shkëlqim...

Varg: Mblidhini oshënarët e tij për të.

Mblodhën çdo eksperienc'...

Lavdi *Ting. III*

Jeni bërë, o Etër të Shenjtë, ruajtës

të saktë traditash apostolike,¹² sepse, meqenëse dogmatizuat orthodhoksisht njëqenshmërinë e Trinisë së Shenjtë, rrëzuar sinodikisht blasfeminë e Ariosit; bashkë me të, pasi kritikuat si kundërshtarë të Shpirtit Makedhonin, dënuat Nestorin, Eftikun dhe Dhioskorin, edhe Savelin, edhe Sevir Aqefalin; lutemi që ta ruani jetën tonë pa njollë brenda besimit, që ta shpëtojme nga mashtrimi i tyre.

Tani *Ting. Tërth. II*

Perëndia u ngjit me brohori, Zoti me zë trumbete⁸⁸ që ta lartësonte ikonën e rënë të Adamit dhe të dërgonte Shpirtin Ngushëllimtar,¹⁴ që t'i shenjtërojë shpirtat tanë.

Përlëshore

E Etërve Ting. Tërth. IV

I përmbilavdëruar je, o Krisht, Perëndia yn', që i themelove mbi dhë si yje Etërit tanë dhe me anën e tyre u hoqe udhën të gjith've te besa e vërtetë, i shumë mëshirshëm, lavdi më ty.*

Lavdi dhe Tani *I Analipsit Ting. IV*

U ngjite me lavdi, o Krisht, Perëndia ynë, pasi i ngazëllove Nxënësit me premtimin e Shpirtit të Shenjtë,¹⁴ kur ata u siguruan përmes bekimit, se ti je Biri i Perëndisë, Çlirimtari i botës.

Mbyllet e kremtja e Etërve të Shenjtë dhe vazhdon e kremtja e Analipsit.

TË HËNËN E JAVËS VII NË MËNGJESORE

Përlëshorja tani (pas Perëndia është Zoti) tri herë dhe në fund të Mëngjesores një herë, si dhe një herë në fund të Mbrëmësores. Kështu psalet deri te Mbyllja e Analipsit.

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores

Ting. Ting. I Tu lithu sfragisthentos

Kur ngjitja e çuditshme i shtangte engjëjt shenjtë,* Nxënësit hyjnor' i habiste i frikshmi lartësim pra; u ngjite me lavd, si Perëndi,* për ty u hapën portat,⁸² Shpëtimtar,* ndaj Fuqitë qiellore çuditëshin* dhe thoshin: Lavd zbritjes sate,*⁸⁹ lavd mbretërisë sate, Zoti Krisht,* lavd Analipsit tënd, plot nder,* o i vetmi njeridashës, lavdi përdëllimit tënd. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores

Ting. I Tu lithu sfragisthentos

Dhe Hadhin e plaçkite, dhe botën e ndriçove* gjatë ngjalljes sate; u ngjite me lavd, o Shpëtimtar Zot* që çdo gjë e mban në dorë fort,* o jetëdhënës; ndaj me engjëjt tok* të lëvdojmë, o i tërëfuqishmi ne:* Lavdi Analipsit tënd, Krisht,* lavd mbretërisë sate, o Jisu;* lavd dhembshurisë sate pra,* o i vetmi njeridashës, i vetmi përdëllimtar. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I dyti i Analipsit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Analipsit.

Pasvargje të Lavdërimeve

Ting. II Ikos tu Efrathá

Bashkë me Nxënësit* e Fjalës, o bes-



nikë,* në malet e virtytit* të ngjitemi, ta shohim* lavdin' e Krishtit si të denj'.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Blofin manihean* e turpëruan Mendjet* kur ua sqaronin ngritjen* me trup të Krishtit haptas* atyre që habiteshin.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Lirës bjeri, David,* o mbret, me gaz, se Krishti* i ngjitur lart në qiej,* i vërteton me vepra* sa fjalë the në profeci.

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

O Krisht Perëndi, u ngjite me lavdi nga mali i Ullinjve para Nxënësve të tu dhe u ule në të djathtën e Atit ti që i mbush të gjitha⁹⁰ me anë të hyjnisë; dhe u dërgove Shpirtin e Shenjtë¹⁴ që i ndriçon, i mbështet dhe i shenjtëron shpirtat tanë.



TË HËNËN E JAVËS VII NË MBRËMËSORE

Thirrto

3 të Analipsit (fq. 173)

Ting. IV Édhokas simíosin

Nuk pëson sipas Hyjnisë...

“Pse qëndroni duke parë lart...

Fjalë e tërëfuqishme, ti, pas ngritjes...

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. IV*

O Krisht, kur arrite në malin e Ullinjve për të zbatuar mirëdashjen e Atit, u shtangën engjëjt qiellorë dhe u frikësuan të nëndheshmet; dhe Nxënësit ishin të pranishëm me hare dhe tmerroheshin

kur u flisje; dhe një re si fron ishte gati përballë dhe të priste; dhe, pasi i ngriti portat, qielli shfaqej bukur; dhe toka i zbuloi bodrumet, që Adami ta njihte zbritjen dhe, nga ana tjetër, ngritjen. Dhe këmbët lartësoheshin, si nga një dorë, ndërsa një gjuhë bekonte shumë, siç dëgjohej; të mori një re dhe të pranoi qielli përbrenda; o Zot, e bëre këtë vepër të madhe dhe paradoksale për shpëtimin e shpirtave tanë.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Pëlqimin atëror* e mbushe, o i mirë;* të lartat me të poshtmet* ti i bashkove,⁴⁰ shkove* me lavd atje ku qe më par'.

Varg: Gjithë kombet duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Drejt Lindësit tënd, Krisht,* u ngjite sado s'ishe* i ndarë, dhe natyrën* që dergjej poshtë, o Zot* i dhembshur, ti e ngrite lart.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Të mori lart një re* e ndritshme edhe engjëj* me tmerr edhe me frikë* ty të shërbenin, o Krisht,* sipas të hyjshmit, urdhrit tënd.

Lavdi dhe Tani *Ting. IV*

O Perëndi, natyrën e Adamit që zbriti në vendet më të poshtme të tokës, e ripërtërite në veten tënde dhe e lartësove sot mbi çdo autoritet dhe pushtet;⁹¹ meqë e deshe, e vure të ulej tok me veten tënde; dhe, meqë e dhembshurove, e bashkove me veten; meqë e bashkove, pësive bashkë me të; dhe, meqë pësive, edhe pse je i papësueshëm, e lavdërove

me veten. Por të patrupët thoshin: “Kush është ky burrë i bukur?⁹² Por s’është vetëm njeri, por Perëndi dhe njeri, fenomen i përmban të dyja bashkë”. Prandaj engjëjt, të hutuar, duke fluturuar të stolisur, u thërrisnin Nxënësve: “O burra galileas, ai që iku nga ju, është Jisui njeri-perëndi; do të vijë përsëri si Perëndi-njeri, gjykatës i të gjallëve dhe i të vdekurve,⁹³ dhe do t’u dhurojë besnikëve ndjesën e mëkateve dhe përdëllimin e madh.²



TË MARTËN E JAVËS VII NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. II Ta ano zitón*

Në tokë nga lart,* Krisht, zbritë por nga toka lart* ti rende sërish*⁸⁹ te Lindësi yt, Zot, ndërsa* Nxënësit e tu ngritjen tënde po e shihnin, ndaj tok me ta,* Shpëtimtar, kremtojmë dhe ne* si dhe Analipsin tënd e himnojmë me mall. (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores
Ting. III Tin oreótita*

E parajetshmja Fjal’* edhe e pafillim* e hyjnizoi krejt* fisin ton’ njerëzor,* natyrën tonë mistikisht, të cilën e kishte marrë* dhe u ngjit sot lart; engjëjt* rendnin para dhe Nxënësve* u tregonin kur ai* shkonte plot lavd drejt qiejve;* apostujt, si u falën, “Lavd Zotit,* lavd Perëndis’ së ngjitur”, thoshin. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Analipsit (tok me Imoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën.

Dërgimësorja e Analipsit.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. II Ikos tu Efrathá*

“Ju që ju mblodha un’* nuk do t’ju lë jetimë,*⁹⁴ do t’ju dërgoj Shën Shpirtin”,* kështu iu foli Zoti* Krisht miqve,⁹⁵ dhe u dha premtim.¹⁴

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Engjëj u than’ me zë* apostujve të urtë:* O burra galileas,* siç po e shihni, prapë* do vijë me lavdi ai.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Zbritën me gaz, o Fjal’,* nga Mali i Ullinjve* shën Nxënësit e tu, Zot,* dhe thurnin lavde, himne* për Analipsin tënd hyjnor.

Lavdi dhe Tani Ting. IV

Kur ngjiteshe me lavdi, o Krisht Perëndi, teksa po shikonin Nxënësit, të merrnin retë me trup, hapeshin portat e qiellit, ngazëllohej shumë kori i engjëjve, Fuqitë më të sipërme thërrisnin: “Ngrijini portat, ju arkondët tanë, se do të hyjë mbreti i lavdisë”,⁸² ndërsa apostujt thoshin të çuditur: Mos u nda nga ne, o bari i mirë,⁹⁶ por na dërgo Shpirtin tënd të Tërëshenjtë¹⁴ që i udhëzon dhe i mbështet shpirttrat tanë.



TË MARTËN E JAVËS VII NË MBRËMËSORE

Thirrtores

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Kur të shihnin, Zot, Nxënësit,* shën apos-

tujt e tu hyjnor',* shkove lart në qiej edhe bri Lindësit* dhe në të djathtën e tij u ule, se s'ndahesh prej atij,* Bir përmbi esencë, Krisht,* edhe Shpirtin Ngushëllimtar,* siç u kishe thën',* ua dërgove,¹⁴ ai i bëri qiej tokësorë krejt apostujt e shenjt', hyjfolës, të urtë mjaft.

Trup u bëre, prej mirësis'* që s'rrëfeket, dhe vdekje, Kryq,* sado s'vdes, durove vullnetarisht,²⁴ por prap'* ti, pas tri ditësh, u ngjalle nga të vdekurit, o Jisu,* pas dyzet ditësh pra* shkove lart, nga ku zbrite posht',* Zot, më parë ti*⁸⁹ dhe te Lindësi gjithë ne na çove⁹⁷ si i kishe paqësuar krejt tokësorët; lavdi më ty.

Kur të panë të ngriheshe* përmbi re ty, apostujt shenjt'* mjaft të urt' vajtonin me lot, plot zyrtësi* edhe thërrisnin: Krisht, mos na lër jetimë,⁹⁴ meqenëse* na ke dashur, o Jisu,* nga keqardhja, prandaj dërgo, siç premtove ti,* Shpirtin tënd të Fortshenjtë përmbi ne,¹⁴ që t'i ndriçojë shpirtrat tanë, i gjithëdhembshur, Zot, Shpëtimtar.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*

O bashkësitë e besëmirëve, duke mësuar mistikisht nga mendimet e Nxënësve të Krishtit, ejani të themi himn pa mbarim si apostujt, të thërrasim bashkë me Davidin: Perëndia u ngjit me brohoritje, Zoti me zë trumbete,⁸⁸ që t'i çlirojë fiset e vdekatarëve nga skandalet e keqbërësve dhe t'i ndriçojë shpirtrat tanë.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

O mrekulli e re!* Natyra njerëzore* u lidh me Perëndinë* e fortpushtetshëm, Fjalën,* edhe u ngjit në qiej lart.

Varg: Gjithë kombet duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Dita e ndritshme nur,* e hijshme dhe e shenjtë* e ngritjes zotërore,* hyjnore, për në qiej,* shkëlqeu dhe shndrit kozmosin.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Siç u dërgove, Krisht,* Zot, Nxënësve nga sipër* të bashkëqenshmin Shpirt ti,* o Shpëtimtar, dërgoja* dhe popullit tënd Hirin tënd.⁹⁸

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. I*

O Krisht, kur po ngjiteshe sipër, nga nuk u ndave, Fuqitë e engjëjve dhe të gjithë të patrupët po u thërrisnin me ngazëllim Fuqive më të larta: "T'i ngrenë portat hegjemonët tuaj se do të hyjë mbreti i lavdisë",⁸² sepse të mori me trup froni keruvik;²³ o Zot, lavdi më ty.



TË MËRKURËN E JAVËS VII NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. IV Epefanis símeron

"Mos na lër jetimë ne*⁹⁴ pasi u ktheve* drejtas Atit tënd, o Zot* gjith'bërës, na ke shërbëtor",* o njeridashës, thërrisnin fort,* kur po të shihnin apostujt të ngritur lart. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

E ngjashme

E pan' rreshta engjëjsh shenjt',* famë-mëdhenj mjaft,* Zotin e lavdisë,⁹⁹ kur* po ngrihej dukshëm dhe me trup,* i thoshin fort njëra-tjetrës pra:* Ngrijini portat se mbreti po kthehet lart.⁸² (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I dyti i Analipsit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Analipsit.

Pasvargje të Lavdërimeve

Ting. Tërth. II Triimeros anestis

Prej dhembshuris' së skajshme, me trup* nga Virgjëresha linde, Krisht,* dhe durove* Kryq vullnetarisht,²⁴ veçse* nga varri pas tri ditësh u ngjalle dhe na dhe jet',* na ngjalle dhe ne, o i dhembshur fort.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Kur Nxënësit hyjnorë, o Krisht,* o Perëndi, të shihnin ty,* ndërsa dukshëm* ngriheshe drejt qiejve* nga toka, u premtove se Shenjtin Shpirt nga Ati* do t'ju dërgoje,¹⁴ jetëdhënës Zot.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Shumica engjëlllore ka tmerr,* habitet se ngjitjen e ke* aq të huaj,* plot frik', tërëmbret Jisu;* Fuqive më të larta me zë u thotë: Portat* e qiellit tani t'i ngrini ju.⁸²

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

Duke mos u ndarë nga gjiri atëror¹⁰⁰ dhe pasi u shoqërove si njeri mbi dhe,¹⁰¹ o Jisu tejet i ëmbël, sot u ngjite me lavdi nga mali i Ullinjve; dhe, pasi e lartësove me dhembshuri natyrën tonë të rënë, u ule bashkë me Atin; prandaj, duke u habitur me çudinë, rendet qiellore të të patrupëve shtangeshin dhe, të tronditura dhe të shtrënguara nga tmerri, e madhështonin njeridashjen tënde; bashkë me to dhe ne

të mbidheshmit, duke lavdëruar bashkëzbritjen tënde te ne dhe analipsin tënd nga ne, përgjërohemi duke thënë: Ti që, gjatë analipsit tënd, i mbushe me gëzim të pafund Nxënësit dhe Perëndilindësen që të lindi, denjësona dhe ne me lutjen e tyre për harenë e të zgjedhurve të tu nga përdëllimi yt i madh.²



TË MËRKURËN E JAVËS VII NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV O eks ipsistu klithís

Sapo arrite në Malin e Ullinjve,* si e kishe bërë shpëtimin për gjithë ne,* lart fluturove nga mali ti* dhe shkove plot lavd* në qiell, Krisht, para Nxënësve të tu,* ndaj i shtangte rendet e poshtme misterit yt;* u thoshin fort më të lartëve:* Ngrijini portat,* do hyjë nga doli Perëndia, mbret*⁸² mbi tërë botën,* krejt siç desh me mirësi, si e bëri shpëtimin pra* në mënyr' paradoksi* për krijesat, mbarë kozmosin.

Kori i Nxënësve, kur po të vështronte* që po shkoje lart, tha: Tani pse largohesh, Zot,* nga shërbëtorët e tu? Ku shkon* ti që, në dorë,* i mban të gjitha anët e kozmosit? Ne braktisëm çdo gjë dhe erdhëm pas teje, Krisht,*¹⁰² o Perëndi, me gëzim të madh,* se po shpresonim* të ishim bashkë me ty përjetësisht;* ndaj, mos na lër ne* si jetimë, siç na premtove,⁹⁴ o atë i dhembshur Zot,* shpëtimtar je për shpirtrat,* shën Ngu-shëllimtarin na dërgo.¹⁴

Miqve të tu, Zot, u dhe bekim të plot' krejt,* kur ti i mësoje: Shikoni, o miqt'

e mi,* po shkoj tek Ati, do t'ju dërgoj* një Ngushëllues* tjetër,¹⁴ s'i lë delet që kam mbledhur un',*¹⁰³ nuk do t'i harroj sa i desha, por vishni ju* fuqi hyjnore nga lart¹⁰⁴ dhe pas,* në tërë kombet,* pasi të shkoni, t'u predikoni fort* lajmin e mirë*¹⁰⁵ shpëtimtar ju, me urtësi edhe mirësi, me hir,* dhe çlirojeni shpirtat* nga mashtrimi i demonëve.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Perëndia u ngjit me brohori, Zoti me zë trumbete⁸⁸ që ta lartësonte ikonën e rënë të Adamit dhe të dërgonte Shpirtin Ngushëllimtar¹⁴, që t'i shenjtërojë shpirtat tanë.

Pasvargje

Ting. Tërth. II E agjeliqë

Kisha rën' përtokë dhe erdhe të më ngrije* dhe më ngrite ti dhe më more, ndaj këtej, Zot,* me veten më lëvdon fort* përmes uljes bri Atit tënd;* ndodhi kjo pasi i theve krejt mendjemadhësit' e djallit që më vithisi dikur;* i psal, Krisht, njeridashjes sate pa fund, pa konceptim.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë nga zëllimi.

O Adam, kërce; tok dëfre, o Ev'; këmi-shët* që i veshët prej prishjes në Parajsë lashtë,*¹⁰⁶ i ktheu në paprishje* kur pra mori trup pa shpjegim* Bërësi Zot edhe tok e ngriti, e uli të nderuar shumë me Atin e tij;* paprishjen që shpresonit më përpara,¹⁰⁷ e morët tash.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Pa ndryshim, pa ndarje, pa ngatërrim e veshi* tër' natyrën time, e shkeli fort armikun,* tiranin shkelës Zoti* me hyj-

noren forcë, kështu* rendi prapë lart me të tek Ati; u zhduktë herezia, fjalët e kota që tha,* ndërsa ta madhërojmë ne besnikët devotshmërisht.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

Sot, duke e parë në qiej natyrën tonë, Fuqitë e sipërme çuditeshin për mënyrën e huaj të ngjitjes dhe habiteshin duke i thënë njëra-tjetrës: "Cili është ky që erdhi?".⁹² Por, duke parë Zotin e tyre, urdhëroheshin t'i ngrinin portat qiellore.⁸² Bashkë me to të himnojmë pa pushim ty që do të vish sërish me trup nga atje si gjykatës i të gjithëve dhe Perëndi i tërëfuqishëm.



TË ENJTEN E JAVËS VII NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinanarhon Logon

Zbrite nga qielloret në tokë dhe atë* që dergjej poshtë në burgun e Hadhit,¹⁰⁸ pra fisin ton',* pamjen e Adamit, tok e ngjalle dhe, o Krisht,* me Analipsin tënd, o Zot,* si e ngrite lart në qiej bri fronit atëror ti,* e vendose të rrijë si njeridashës dhe i mirë, përdëllimtar. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. Tërth. IV To prostahthën mistikós

Pasi u ngjite në Malin e Ullinjve,* nga ku u ngrite,* se e ndritshmja re nga toka,* o Jisu përdëllyes,* ty të mori teksa* shën Nxënësit po shikonin, çudi plot tmerri!* Dhe engjëjt në qiell thoshin* me zë të lart':* "Ngrihuni, porta, me frik' nga ushtrit' e sipërme". Të himnon me ta, mbret,⁸² çdo krijim,* Perëndi i të gjithëve. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Analipsit (tok me Irmoset) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Analipsit. Pas Odes VI, Kontaqi i Analipsit. Në Oden IX, Më të nderuarën. Dërgimësorja e Analipsit.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. Tërth. II E agjeliqë*

Kur më more mua të tërin, Krisht, pash-prehshëm,* ti natyrën tënde të tërë krejt hyjnore* me mua e përzjeve,* por s'pësove ndarje, ndryshim;* lavd së frikshmes zbritje dhe pësimit, dhe ngjalljes, edhe ngritjes sate,⁸⁹ u ngrit lart me to* natyra jonë që kish rënë poshtë; lavdi më ty.

Varg: Gjithë kombet, duartrokisni, brohorisni për Perëndinë tonë me zë ngazëllimi.

Mistëve të tu u thërrisnin, Shpëtimtar Zot,* engjëjt e tu: Ju pse i ngrini lart qepallat,* e shihni plot habi ju* të padukshmin? Ai që tash* ngjitet me lavdi, kështu me trup do të vijë, të gjykojë çdo frymë,⁹³ çdo vdekatar* me një kandar të drejtë, se ky është Perëndi-njeri.

Varg: U ngjit Perëndia me brohoritje, Zoti me zë trumbete.

Shpëtimtari im, gjatë Analipsit tënd pra,* mjaft të çmuar, kori i Nxënësve të tu, Zot,* në mal kish gaz dhe qarje,* o njeridashësi yn' Jisu,* dhe thërriste: Mos na lër jetimë⁹⁴ ne shërbëtorët e tu, Shpirtin Hyjnor na dërgo,*¹⁴ që t'i ndriçojë shpirtrat e shërbyesve të tu, Krisht.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. IV*

U ngjite me lavd nga toka në qiej, ti që i mbush të gjitha⁹⁰ me anë të Hyjnisë dhe u ule në të djathtë të Atit ti, Fjala Perëndi

që nga fillimi;¹⁰⁹ prandaj, kur i panë të frikësuar, Fuqitë qiellore u thoshin apostujve: "Pse e shihni duke soditur në qiell? Ai që ju po e shikoni, ai do të vijë sërish me lavdi për të gjykuar tërë dheun⁹³ dhe për ta shpërblyer çdokënd sipas veprave të tij."¹¹⁰ Atij t'i thërrasim: O Zot i pakuptueshëm, lavdi më ty.



TË PREMTEN E JAVËS VII

Mbyllet e kremtja e Analipsit dhe psalen të gjitha të sajat, përveç Leximeve, Litisë, Polieleit (dhe Ndenjësores së tij), Ungjillit të Mëngjesores, (pra dhe pa Ne që pamë ngjalljen), si dhe Antifoneve. Shërbesa e Mujorit bëhet në Pasdarkë.



TË SHTUNËN E JAVËS VII

d.m.th. para Pentikostisë

Kujtojmë të gjithë ata që fjetën që nga jeta me besë dhe me shpresën e ngjalljes për jetën e amshuar.

TË PREMTEN NË MBRËMËSORE

*Thirrtores Martirike të Oktoikut
Ting. Tërth. II*

Martirët e tu, o Zot, nuk të mohuan, nuk u larguan nga porositë e tua; me ndërmjetimet e tyre, mëshirona.

Ata që u bënë martirë për hirin tënd, o Zoti Krisht, duruan shumë tortura; me ndërmjetimet dhe lutjet e tyre, ruana të gjithë ne.

Martirët athloforë dhe qytetarët e qiellit,

kur garuan mbi dhé, duruan shumë tortura dhe e fituan kurorën e përsosur në qiej, që të ndërmjetojnë për shpirtat tanë.

Dhe të të fjeturve

Ting. Tërth. IV O en Edhém Parádhisos

Duke kujtuar, o besnikë, sot të gjithë të vdekurit* sipas emrit, që jetuan me kushtim,* bes' që nga jeta, ta himnojm'* Shpëtimtarin Zot pa pushim,* t'i kërkojmë që në orën e gjyqit* të kenë mbrojtje të mirë mjaft* përpara Perëndisë ton'* që tërë dheun e gjykon,* vendin e djathtë⁵ me gëzim,* pjesë të drejtësh lart* të arrijnë, në ndriçim dhe trashëgim* që shenjtorët krejt kanë,*¹¹¹ të bëhen dhe të vyer denjësisht* pra në mbretërin' e tij mbiqiellore me dëfrim dhe lavd.

Ti që me vetë gjakun tënd shpërbleve njerëzit, Shpëtimtar,* dhe me vdekjen tënde vrave vdekjen ton'* të hidhur, na çlirove krejt,* në amshim jetën na e dhe*¹¹² përmes ngjalljes sate; prehi gjithë, Zot,* ata që fjetën me plot besim* qoftë në det ose në dhé,* në shkretëtirë, në qytet* ose në çdo vend, priftërinj,* mbretër, asketë tok* murgj dhe kryepriftërinj pra, në çdo mosh'* dhe në çdo gjeneratë;* këta të vyer bëji denjësisht* lart për mbretërinë tënde qiellore me dëfrim dhe lavd.

U ngjalle nga të vdekurit, Krisht, dhe vdekja nuk është më* sundimtare mbi sa fjetën me besim;* ndaj, Zot, kërkojmë vazhdimisht:* Prehi shërbyesit e tu* në avllit' e tua¹¹³ në përjetësi* edhe në gjirin abramian*¹¹⁴ sa nga Adami deri sot* të adhuruan pastër ty,* etërit, fisin tonë krejt,* miqtë, vëllezërit* si dhe çdo njeri që është sjellë mir',* perëndishëm

në jetë* dhe u shpërngul te ti me çdo mënyr'* denjësoji pra për mbretërinë tënde qiellore lart.

Lavdi *Nekrosim*

Ting. Tërth. IV I Joan Damaskinoit

Qaj e vajtoj kur shkoj ndër mend vdekjen, dhe shoh bukurinë tonë të formuar sipas ikonës së Perëndisë,¹¹⁵ të shtrirë në varr, të shëmtuar, pa rëndësi, pa formë. O çudi! Ç'është ky mister që ndodh me ne? Si iu dorëzuam prishjes dhe si u bashkuam me vdekjen? Me të vërtetë, siç është shkruar, sipas urdhrit të Perëndisë,⁶¹ i cili u fal prehjen atyre që u ndanë prej nesh.*

Tani *Hyjlindësore Dogmatike*

Ting. Tërth. II

Cili s'do të të lumërojë, o Hyjlindëse Virgjëreshë, cili s'do të përhimnojë lindjen tënde të kulluar? Se biri yt i vetëmlindur që shkëlqeu prej Atit pa mot, gjith' ai lindi prej teje së pastrës i mishëruar pa tregim, duke qenë prej natyre Perëndi dhe duke u bërë për ne njeri prej natyre, i pandarë në dy fytyra, por i njohur me dy natyra pa përzier; atij lutju, o Zonj' e lumur, të mëshirohen shpirtat tanë.*

O dritë gazmore. *Në vend të Proqimenit, psalim në Ting. Tërth. IV*

Aliluia (3x)

Të dytën me Varg: Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Aliluia (3x)

Të tretën me Varg: Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

Aliluia (3x)

Pasvargje

Martirik

Kryqi yt, o Zot, u bë armë e pamposh-

tur për martirët, sepse e shikonin para tyre vdekjen dhe, duke synuar jetën e ardhshme, përforcoheshin me shpresën tënde; me lutjet e tyre, mëshirona.

Nekrosime

Varg: Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mirat.

O Shpëtimtar, e nderove me ikonën tënde¹¹⁵ gatimin e duarve të tua¹¹⁶ kur e pikturove në pamje lëndore ngjashmërinë e esencës mendore; dhe më bëre pjesëtar të saj, dhe më vure të mbizotëroj me vullnet të lirë mbi sa janë në dhé,¹¹⁷ o Fjalë; prandaj, o Krisht, vendosi shërbëtorët e tu në vendin e të gjallëve¹¹⁸ dhe në tendat e të drejtëve.¹¹⁹

Varg: Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Që të dallohej grada ime nga jeta e të tjerëve, mbolle në Edem një kopsht të stolisur me pemë të shumëllojshme, të çliruar nga pikëllimi, trishtimi dhe meraku dhe më vure mbi dhé si të përzier, pjesëmarrës në jetën hyjnore, të barabartë me engjëjt; prandaj, o Krisht, vendosi shërbëtorët e tu në vendin e të gjallëve¹¹⁸ dhe në tendat e të drejtëve.¹¹⁹

Lavdi

Ting. Tërth. II I Joan Damaskinoit

Urdhri yt krijues ka qenë fillimi im dhe qenia ime; dhe duke dashur të më bësh krijesë të gjallë prej natyre të dukur dhe të padukur, ma formove trupin prej dheut dhe më dhe shpirt me fryrjen tënde të perëndishme dhe jetëbërëse.¹¹⁶ Prandaj, o Krisht, vendosi shërbëtorët e tu në vendin e të gjallëve¹¹⁸ dhe në tendat e të drejtëve.^{119*}

Tani *Hyjlindësor*

Injëjti Triimeros anestis Hristé

Krisht, prehi shërbëtorët e tu* që fjetën, ndërmjetojn' te ti* nëna jote,* oshënarët, çdo shenjtor,* profetët me apostujt, martirët, hierarkët* edhe të drejtët, që bri teje jan'.

Përlëshore Ting. Tërth. IV

O i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha me thellësi urtësie¹²⁰ dhe njeridashje, dhe ua shpërndan të gjithëve atë që është në dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që linde, o Hyjlindëse e panusëruar, shpëtimi i besimtarëve.



NË SHËRBESEËN E AGRIPNISË

[Nëse nuk bëhet Agripni, pas Tani përlëshoje... të Mbrëmësore, Kanuni i mëposhtëm i të Fjeturve. Trishenjtë dhe Përlëshoret. Mëshirona, o Perëndi... etj. Dhe Troparet Bashkë me shpirtrat e të drejtëve... Lutja për të Fjeturit (Mëshirona, o Perëndi... O Perëndi i shpirtave dhe i çdo trupi... Uratore e Vogël, Botimi i dytë, i plotësuar: 2019, fq. 334). Urtësi. Ai që është i bekuar. Përlëshim].

Prifti: I bekuar është Perëndia....

Lexuesi: Psalmi 90

Dhe psalim në Ting. Tërth. IV

Aliluia (3x)

Të dytën me Varg: Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Aliluia (3x)

Të tretën me Varg: Dhe kujtimi i tyre në jetë të jetëve.

Aliluia (3x)

Përlëshore Ting. Tërth. IV

O i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha me thellësi urtësie¹²⁰ dhe njeridashje, dhe ua shpërndan të gjithëve atë që është në dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Lavdi

Sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Tani *Hyllindësore*

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që linde, o Hyllindëse e panusëruar, shpëtimi i besimtarëve.

Bekimtores Nekrosime (në Uratoren e Vogël, Botimi i dytë, i plotësuar, 2019, fq. 270). Mëshirona, o Perëndi etj. dhe Urata O Perëndi i shpirtrave dhe i çdo trupi... (në Uratoren e Vogël, fq. 334). Psalmi 50 dhe Kanuni i të Fjeturve që ka Akrostihidhë: “U këndoj të ikurve një melodi të gjashtë”, me Vargje në troparin e parë të çdo Ode “Me ndërmjetimet e martirëve të tu, prehi, o Krisht, shpirtrat e shërbëtorëve të tu”; në të dytin “Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mirat”; në të tretin Lavdi; në të katërtin Tani.

Ting. Tërth. II

Ode I

Os en ipiro pezefsas

Trimat martirë te dhomat në qiell, Krisht,* vazhdimisht të lypin ty:* Denjësoji të arrijn'* besimtarët që ke marr'*

nga dheu të mirat e përjetshme, o Zot Shpëtimtar.

Si e stolise çdo gjë, më gatove ti,* Shpëtimtar, porsi të gjall',* të përzier, dhe jam mes* madhështisë-vogëlsis';* ndaj prehi lart shpirtrat e shërbësve të tu, o Zot.

Në nisje ti më caktove bujk, qytetar* të Parajsës,¹²² Shpëtimtar,* por e shke-la urdhrin tënd*⁶¹ dhe më internove larg;*¹²³ ndaj shpirtrat e shërbëtorëve të tu, o Zot, prehi.

Hyllindësor

Ai që më parë Evën, stërnënë ton',* nga një brinjë e kish bër',*¹²⁴ vesh mish, trup nga barku yt* i pacen dhe me k'të trup* fuqinë e vdekjes e shfaros, o e Dëlirë krejt.

Ode III

Uq estin ajios os si

Me rreth fitoreje nga ti,* Zot jetëdhënës, janë nur stolisur martirët e tu si garuan fort* pas ligjit¹²⁵ dhe të kërkojn'* për të ikurit besnik' çlirim në jet'.¹²⁶

Me shumë shenja dhe çudi* më par', më edukove mua që kisha humbur; si në fund e zbraze, Zot,* ti veten¹²⁷ me dashuri,* më kërkove, m'gjete, më shpëtove, Krisht.¹²⁸

Sa tejkaluan rrjedhje, vull* gjërash, sa befaz ikën dhe të erdhën, pranoji të banojnë lart me gaz* në të përjetshmet tenda,* si, i Mirë, t'i drejtosh me bes' dhe hir.¹²⁹

Hyllindësor

Askush nuk është pa qortim* si ti, e fortdëlirë,* se, nga jeta, ti vetëm Perëndinë e vërtet'* në bark e zure, Hyjnën';* e shfarosi ky fuqin' e vdekjes skrop.

Irmosi: Uq estin ájios os si

»Nuk ka të shenjtë pra si ti,* o Perëndia
»im, Zot,* që e ngrite lart bririn e besni-
»këve të tu* dhe na forcove¹³⁰ të gjith',*
»o i mir', mbi gurin e pohimit¹³¹ tënd.

Prifti: Mëshirona, o Perëndi etj.

Ndenjësore

Nekrosime Ting. Tërth. II

Me të vërtetë janë kotësi të gjitha,¹³²
ndërsa jeta është hij¹³³ dhe ëndërr, dhe kot
trazohet çdo i dhelindur siç tha Shkrimi.¹³⁴
Kur tërë botën ta fitojmë, atëherë në varr
do të banojmë, atje ku së bashku janë
mbretër dhe të varfër. Prandaj, o Krisht
Perëndi, prehi si njeridashës shërbyesit e
tu që u zhvendosën.

Lavdi dhe Tani *Hyllindësore*

O Hyllindëse e Tërëshenjtë, mos më
braktis në kohën e jetës sime, mos më lër
në mbrojtjen njerëzore, por ti përkrahmë
dhe mëshiomë.

Ode IV

Hristós mu dhínamis

O Zot, duke shfaqur veçorinë e urtësisë
tepër të madhe dhe mirësinë e bollshme,
të pasur, për sa u përket dhuratave, ko-
ret e martirëve i radhite së bashku me
engjëjt.

Denjësoji për lavdinë tënde të pashpreh-
shme, o Krisht, të zhvendosurit drejt teje,
atje ku është banesa e atyre që dëfrejnë¹³⁵
dhe zëri i ngazëllimit¹³⁶ të pastër.

Pranoji ata që i more prej tokës, të cilët
e himnojnë pushtetin tënd hyjnor dhe bëji
bij drite¹³⁷ pasi të pastrosh mjegullën e
mëkatit, o i Shumëmëshirshëm.

Hyllindësor

Ty, bukurinë e Jakovit,¹³⁸ Zoti të zgjodhi
si enë të pacen, tempull të tërëpaqortue-
shëm, arkë të gjithëshenjtë,⁵⁵ vend shenj-
tërimi¹³⁹ virgjëror.

Ode V

To thio fegji su

Martirët na japin përherë shpëtim me-
që iu ofruan Perëndisë së lavdëruar si
holokaust hyjnor dhe si aparkë të natyrës
njerëzore.

O Zot, shërbëtorët e tu besnikë që fjetën
më parë, denjësoji për banimin qiellor
dhe ndarjen e karizmave pasi t'u japësh
çlirimin nga shkeljet.

Denjësoji për mbretërinë tënde ata që
kanë mbaruar jetën, o i Dhembshur, i vet-
mi i pavdekshëm, i vetmi jetëbërës nga
natyra, oqeani vërtet i pagjurmësuar i
mirësisë.

Hyllindësor

O Zonjë e botës, ai që lindi prej teje u bë
fuqi dhe himnim¹⁴⁰ si dhe shpëtim nga
portat e Hadhit i atyre që shkatërrohen,
dhe i çliron ata që të lumërojnë besërisht.

Ode VI

Tu viu tin thálason

Kur karfoseshe në Kryq, i mblidhje
rreth vetes koret e martirëve që imitonin
pësimin tënd, o i Mirë, prandaj të lutemi
prehi ata që u shpërngulën drejt teje.

Kur të vish i frikshëm me lavdinë tënde të
pashprehshme në re që të gjykoshe mbarë
botën, bëj që me mirësi, o Çlirimtar, të të
presin me ngazëllim shërbëtorët¹⁴¹ e tu
besnikë që more prej tokës.

O Zot, je burim jete¹⁴² dhe nxjerr të prangosur me trimëri¹⁴³ hyjnore; shërbëtorët e tu që u larguan me besim drejt teje, fushoji në shijimin e Parajsës.¹⁴⁴

Hyjlindësor

U kthjem në dhé kur e shkelëm porosi-në hyjnore të Perëndisë;⁶¹ por me anën tënde u lartësuam nga toka në qiell pasi e hodhëm poshtë prishjen e vdekjes.

Irmosi: Tu viu tin thálasan

»Ja detin e jetës tash* e shikoj të ngri-
»het prej* furtune ngasjesh ashpërsisht,*
»te limani yt shumë i qetë rend* edhe
»të thërras: Ma ngri* shpirtin ti, o mëshi-
»rëplot, nga prishja pra.⁶⁰

Kontaqi Ting. Tërth. IV

Bashkë me shenjtoretë prehi, o Krisht, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, atje ku nuk ka dhembje, as helme, as psherëtima,¹⁴⁵ por jetë të pambaruar.*

Shtëpia

Vetëm ti je i pavdekshëm,¹⁴⁶ ti që bërë dhe gatove njeriun; ndaj ne vdekatarët nga dheu u formuam¹⁴⁶ dhe në të njëjtin dhé do të shkojmë, siç urdhërove ti që më gatove dhe më the: "Përderisa je dhé, do të ikësh në dhé".⁶¹ Atje do të shkojmë të gjithë ne të vdekshmit duke bërë si vaj mortor oden "aliluia".

Ode VII

Dhrosovolon men tin káminon

Pasi u çliruan me gjakun tënd nga shkelja e parë dhe u spërkatën vetë me gjakun e tyre, martirët e ikonizojnë qartë therjen tënde; i bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

O Fjalë, Krisht tepër kryejtësor, e vrave vdekjen që mburrej me arrogancë; pranoji tani ata që fjetën me besë, që himnojnë dhe psalin: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

O Zot, tepër kryehyjnor, që më gjallërove mua njeriun me fryrje të perëndishme,¹¹⁶ denjësoji të shpërngulurit për mbretëri-në tënde, që të të psalin, o Krisht: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.⁷³

Hyjlindësor

U bërë më e lartë se çdo krijesë, o e tërëpaqortueshme, kur nxure Perëndinë, që i dërrmoi portat e vdekjes dhe i theu totalisht shulet;¹⁴⁷ ndaj, o e Dëlitë, të himnojmë ne besnikët si Hyjnë.

Ode VIII

Ek flogós tis osiis

Meqë u treguat të qëndrueshëm në gara, u stolisët me kurorën e fitores, o martirë, athloforë të Krishtit, dhe thërrisnit: Të përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Besëmirët që mbaruan jetën hyjshëm dhe erdhën drejt teje, Zotit, priti me butësi dhe, si i dhembshur, prehi ata që të përmbilartësojnë në gjithë jetët.

Doje me mirësi, o Shpëtimtar, që të rri-në tani në dheun e të butëve¹⁴⁸ tërë të parafjeturit, duke i drejtësuar për shkak të besimit ndaj teje dhe Hirit,¹²⁹ të cilët të përmbilartësojnë në gjithë jetët.

Hyjlindësor

Të gjithë të lumërojnë, o e Tërëlumë-rueshme,¹⁴⁹ ty që linde Fjalën vërtet të lum, që u bë trup për ne;¹⁵⁰ atë e përmbilartësojmë në gjithë jetët.

Irmosi: Ek flogós tis osiis

»Vesë nxore prej flakës tek oshënarët
»ti,*⁷³ dhe me ujë e dogje flin' e të drejtit
»shenjt*¹⁵¹ vetëm me vullnetin tënd, o
»Krisht, bën çdo gjë¹⁵² ti,* ne në gjithë
»jetët të përmbilartësojmë.

Ode IX

Theón anthropis idhín

I mirë, shpresa kish fuqizuar mjaft* kore
martirësh dhe u dha krah' për dashurin'
tënde;* e paraskicoi prehjen e ardhme
lart* që s'ka lëkundje sigurisht, për të
cilën, Zot,* denjësoji të shpërngulurit,
besnikët e tu, Krisht.

Me mirësi doje që ta marrin lart* sa u
shpërngulën besërisht shkëlqimin tënd
krejt hyjnor,* vezullues; si i vetmi përdëllimtar,*
prehjen në gji abrahamian¹¹⁴ ti dhuroju,
Zot,* dhe për lumturinë e përfjetshme denjësoji,
Krisht.

I mirë je dhe i dhembshur në natyr',*
do përdëllim,¹⁵³ avushë plot mëshirë je,
Shpëtimtar;* ndaj atje ku shndrit shkëlqimi
yt, Zot, t'i kesh* dhe t'i rreshtosh sa
nga ky vend i torturave* i zhvendose lart
prej hijeve të vdekjes¹⁵⁴ prishëse.

Hyjlindësor

Të dimë tendë Hyjnore,¹⁵⁵ e Dëllir',*
pllakë me Ligjin³⁴ shenjt të Hirit, arkë,⁵⁵
sepse iu dha,* iu dhurua falje nëpërmjet
teje pra* të drejtësuarve përmes gjakut
të atij*¹⁵⁶ që nga barku yt u mishërua,
Vajz' pa hiç qortim.

Irmosi: Theón anthropis idhín

»Nuk munden Zotin ta shohin njerëz
»zit,*¹⁵⁷ se rreshta engjëjsh s'kan' guxim
»ta shohin,¹⁵⁸ veçse nga ti,* e Dëllirë,
»njerëzve iu duk si njeri,* Fjala e mi-

»shëruar,¹⁵⁰ e madhështojmë ne,* dhe të
»lumërojmë me ushtritë engjëjlore tok.

Trishenjt. *Përlëshoret* O i vetmi Krijues...
Ty të kemi dhe mur, dhe liman... *Prifti*
Mëshirona... O Perëndi i shpirtave... *Dhe*
Përlëshim.



TË SHTUNËN NË MËNGJESORE

*Pas Gjashtë Psalmeve dhe Paqësoreve,
psalim në Ting. Tërth. IV*

Aliluia (3x)

Të dytën me Varg: Të lumtur ata që i
zgjodhe dhe i more, o Zot.

Aliluia (3x)

Të tretën me Varg: Dhe kujtimi i tyre në
jetë të jetëve.

Aliluia (3x)

Përlëshore Ting. Tërth. IV

O i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha
me thellësi urtësie¹⁰ dhe njeridashje, dhe
ua shpërndan të gjithëve atë që është në
dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtat e shër-
bëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan
te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Lavdi

Sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi,
Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Tani Hyjlindësore

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe
ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që
linde, o Hyjlindëse e panusëruar, shpëti-
mi i besimtarëve.

*Stihologjia e zakonshme (Psalmet 109-
117). Në të gjitha "Përsëri dhe përsëri... O*

Perëndi i shpirtave...” *të Stihologjive dhe të Kanunit, kujtohen vëllezërit tanë që u larguan më përpara.*

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësores Ting. Tërth. II
Martirike*

Kishte rezistenca atletike në arenë, tortura tiranike ndaj martirëve; dhe qëndronin koret e të patrupëve duke mbajtur çmimet e fitores. Të urtët shastisën tiranë dhe mbretër, dhe e mposhtën beljarin me pohimin e Krishtit. O Zot, që i përforcove, lavdi më ty.

Varg: I çuditshëm është Perëndia në shenjtoret e tij.

Kur duruan në garë atletike dhe morën prej teje çmimet e fitores, shenjtoret asgjësuan dinakëritë e të paligjshmëve dhe fituan kurorat e pavdekësisë; duke u zbutur me anën e tyre, o Perëndi, dhurona përdëllimin e madh.²

Varg: Te shenjtoret që janë në tokën e tij, bëri mrekulli Zoti.

O Zot, kujtimi i athloforëve të tu u tregua si Parajsa e Edenit,¹⁵⁹ sepse gjatë tij ngazëllohet tërë Krijesa; prandaj me lutjen e tyre na jep paqen dhe përdëllimin e madh.²

Lavdi Nekrosime

O Jisu, si Perëndi i pajtueshëm,¹⁶⁰ ata që i more kur fjetën besërisht, caktoj në tendat e të zgjedhurve dhe në vendin e të gjallëve,¹¹⁸ mbushi me dritën tënde të pa-perëndueshme dhe denjësoji për harenë tënde mbiqiellore.

Tani Hyllindësore Ngjallësore

Ti që e quajte Nënë tënde të bekuar, erdhe te Pësimi me vullnetin tënd,²⁴

dhe shkëlqeve në Kryq, duke dashur të kërkosh Adamin, duke u thënë engjëjve: Përgëzomëni, se u gjet drahmia e humbur.²⁵ Ti që i rregullove të gjitha urtësisht, lavdi më ty.*

I Paqortueshmi (Ps. 118) në dy Stanca (Qëndrime); pas Stancës së parë, Prifti “Përsëri dhe përsëri... O Perëndi i shpirtave...” etj. ndërsa në plotësimin e së dytës, Bekimtores Nekrosime (në Uratoren e Vogël, Botimi i dytë, i plotësuar, 2019, fq. 270). Pastaj, “Përsëri dhe përsëri” dhe Prifti kujton prapë. Pastaj Psalti:

Ndenjësores Ting. Tërth. I

Prehi, o Shpëtimtari ynë, bashkë me të drejtët shërbëtorët e tu dhe fushoji në avllitë e tua siç është shkruar,¹⁶¹ duke mos i vënë re, si i mirë, paudhësitë e tyre të bëra me dashje dhe pa dashje dhe të gjitha ato me dije dhe pa dije, o njeridashës.

Lavdi dhe Tani Hyllindësore

O Krisht Perëndi, që nga një Virgjëreshë linde si diell për botën, pasi të na shfaqësh me anën e saj bij drite,¹³⁷ mëshirona.

Psalmi 50 dhe Kanunet: I shenjtiti të kishës (tok me Irmoset) në 6 dhe i mëposhtmi në 8. Ky i fundit ka Akrostihidhë (pa Hyllindësoret e Odeve III, V, VI dhe VII): “Lavdërim nga Arseni për të tërë shpirtat”.

Ting. Tërth. II

Ode I

Os en ipiro pezeftas

O Zot, krijues, gjyqtar edhe hegjemon* i çdo shpirti, që i ke* gjithë anët përmbi dhé,* në dor’, o Krisht¹⁶² Shpëtimtar,* bri teje besnikët që shpërngule prehi në

amshim.

Të përgjrohemi nxehtë të gjithë ne,* Zot, për çdo fis njerëzor* që ka fjetur dhe çdo grad',* për çdo moshë, çdo nivel;* shpëtoji, o Krisht dhe Perëndi, sa i zhvendose ti.

Me dorën tënde pa cen, Fjal', i dhembshur Zot,* më gatove vetëm ti,* Krisht, prej dheut dhe më dhe* mendje, shpirt me frymëzim* plot jetë;¹¹⁶ prandaj shpëtoji sa i more nga këtej.

Hyjlindësor

O e dëlirë, e Virgjër, je si strehim* botëror edhe e fort',* luftëtare, mbrojtëse* përmes përgjërimit tënd* të nxehtë; ndërmjeto për sa po vuajn', je si mur për ta.

Zbritësore: Os en ipiro pezeftsas

»Si në sterë Izraeli kaloi lehtë* dhe »më këmbë, duke par'* Faraonin, ndje- »kësin,* mbrapa gjurmëve të tij,* të »zhytej; thërriste: Zotit t'i këndojm' këng' »mundëse.¹⁶³

Ode III

Uq estin ajios os si

Me forcë lavdi mjaft hyjnor,* si re i ngre ti shpirtrat e besnikëve drejtas teje nga çdo skaj tok'sor;*¹⁶⁴ ndaj shërbëtorët e tu* që i more bri nga çdo an', prehi lart.

Veç ti e vë çdo hegjemon,* çdo mbret dhe çdo gjykatës e sovran;¹⁶⁵ ndaj, si Perëndi i tërë kozmosit,* çliroi Krisht Shpëtimtar,* Zot, nga Ferri kur të bësh gjykimin tënd.

Krisht, denjësoji për haren'* dhe për shijimin tënd përjetësisht sa ke marrë, tok me të moshuarit,* adoleshentët, të rinjt',* virgjëreshat, Bërësi i dheut mbar'.

Hyjlindësor

Mos zmbrops sa te ti, përgjithnjë,* vijne plot mall, përikin shpejt, o shpresë e fort' e botës, o Hyjlindëse,* por, Zonj', për sa të nderojn',* ndërmjeto edhe çliroi nga çdo dert.

Zbritësore: Uq estin ajios os si

»Nuk ka të shenjtë pra si ti,* o Perëndia »im, Zot,* që e ngrite lart bririn e besnikëve »të tu* dhe na forcove¹³⁰ të gjith',* o i »mir', mbi gurin e pohimit¹³¹ tënd.

Ndenjësore Ting. Tërth. IV

Tin sofian qe Logon

I ke kryer me shenjë të gjitha, Zot,* meqë je i pajtueshëm; Perëndi,* të lypim ta prehësh lart,* ku shumicat e shenjtëve* banojnë, me të drejtët së bashku në qiell pra* çdo të krishter' që vdiq me besim, atë, gjysh, vëlla,* mik, stëratë, murg, mbret, hegjemon, pasanik tok* të varfër, ndaj jepu, Mbret,* gjith' atyre që fjetën mir',* faljen, ndjesën* e shkelleve* që bën' kundër teje, Jisu,* o Fjalë, o Shpëtimtar, Krisht* i dhembshur mjaft;* se të gjithë ata të kanë shërbyer ty.

Lavdi dhe Tani Hyjlindësore

Të ofroj si vejusha detyrimisht,* Zonjë, si dy të hollat¹⁶⁶ falënderim,* himnimin e hireve,* që na bëre me mbushulli,* meqë u shfaqe strehë dhe ndihmë, sepse gjithnjë* nga ngasjet dhe shtrëngimet më nxjerr, kur shpëtova pra* unë si nga mesi i kaminës me flakë,*⁷⁵ nga ankth e trishtim, me shpirt* të thërres, o Hyjlindëse:* Më përkrah ti* dhe ndërmjeto* pranë Birit tënd Perëndi,* t'u japë falje mëkatesh* sa besërisht* po i falen fëmijës sate, o e pacen.

*Ode IV**Hristós mu dhínamis*

O Zot Shpëtimtar, ti që i kullot në vend blerimi dhe i çon në ujë të gjithë¹⁶⁷ shpresëplotët, mos i dëbo shërbëtorët e tu larg dëfrimit të atjeshëm.

Vetë ti renditi me brigadat engjëjllore koret e murgjve, hierarkëve, celebruesve të tu mbarë, sepse ty t'i besuan shpirtrat dhe trupat, o Njeridashës.

Vetëm ti, si Zot i të gjithave, i di sulmet e vdekjes, gjatësinë e jetës dhe fundin e tërë njerëzve, prandaj dhembshuroji dhe tani shërbëtorët e tu, o i Mbimirë.

Hyllindësor

Përderisa e kishe në mitër Perëndinë e shenjtë të shenjtëve, o e Tërëshenja virgjëreshë, me përgjërime të hyjnueshme bëje të butë tani, që t'i radhitë në shijim, në tendat e shenjtoreve ata që i shpërngule.

Zbritësore: Hristós mu dhínamis

»“**F**uqia ime Krishti, Perëndia, është”, *¹⁶⁸
»psal me mendje të pastër edhe thërret, *
»siç e meriton pra Zoti, Kisha jon' e vyer
»fort* dhe feston në Krishtin me hare.

*Ode V**To thio fegji su agathé*

Ja ku, duke të himnuar, o Shpëtimtar, koret e hyjshme të martirëve, rendet e apostujve dhe të profetëve, si edhe organizatat e të drejtëve, të përgjërohen shumë që t'i shpëtosh të gjithë ata që i more pranë nga bota.

Kur me zërin e trumbetës sate të fortë do të hapen varret e të vdekurve¹⁶⁹ dhe toka do të trembet e frikësuar, atëherë radhiti, o Krisht, me delet në të djathtë tënde⁵

shërbëtorët e tu që zhvendose.

Si i pajtueshëm, prehi dhe shpëtoji shumicat e burrave bashkë me gratë, grupet e fëmijëve me pleqtë, të varfrit, skilevërit dhe të pasurit që u transferuan me besim nga të këtushmet drejt teje.

Hyllindësor

O e Pacenshme, të kemi si mbrojtëse ne të gjallët dhe të vdekurit me besë, racat dhe gjuhët; kështu, kërkojmë që, me ndërmjetimet e tua drejt Zotit, të fitojmë prehjen e atjeshme.

Zbritësore: To thio fegji su agathé

»**M**e drit' hyjnore, i miri ti,* shpirtrat
»e atyre që po mëngojnë¹⁷⁰ me mall për
»ty, shndriti – lyp – * të të njohin, Fjalë e
»Perëndis', Zot¹⁰⁹ vërtet,* që rithërret nga
»mjegulla e mëkateve.

*Ode VI**Tu viu tin thálasan*

O Zot, të të vijë keq,* butësohu, Shpëtimtar,* tregoje përdëllimin tënd,*¹⁷¹ si i mirë shpëtoji gjithë ata* që, o njeridashës Krisht,* nga i tëri dhë i zhvendose drejt vetes.

Veç ti, Zot, pajtohesh leht',*¹⁶⁰ ndaj përfilli pra ata* që jetën e mbaruan keq* në lumenj, çurg, në rrjedhë, në mbytje tmerr,* që vdiqën mjaft befasisht,* në livadhe, në vrima dhe në male,¹⁷² Zot.

Si Zot, i ke parë sa* vdiqën keq padukurisht,* në det, në luftë, në betej'* dhe sa kanë mbaruar me plagë plot,* të gjith' dhembshuroji ti,* Shpëtimtar Krisht, si njeridashës përgjithnjë.

Hyllindësor

Qeto turbullimin tim* të vështirë nga trazir'* që më shkaktojnë veset tmerr*;

jepi pra butësi zemrës sime ti, e tërëdëlira Zonj',* që për njerëzit linde kapëdanin Krisht.

Zbritësore: Tu viu tin thálasan

»Ja detin e jetës tash* e shikoj të ngrihet
»prej* furtune ngasjesh ashpërsisht,* te
»limani yt shumë i qetë rend* edhe të
»thërras: Ma ngri* shpirtin tim, o mëshi-
»rëplot', nga prishja pra.⁶⁰

Kontaqi Ting. Tërth. IV

O Shpëtimtar i pavdekshëm, të shpërngulurit nga ne, nga provizoret, fushoji në tendat e të zgjedhurve dhe prehi bashkë me të drejtët; sepse, megjithëse kanë mëkatuar si njerëz mbi dhé, megjithatë, ti, si Zot i pamëkatshëm,¹⁷³ falua atyre shkeljet me dashje dhe pa dashje, duke pasur si ndërmjetëse Perëndilindësen, që të thërrasim me një zë për hirin e tyre: Aliluia.

Shtëpia

Vetëm ti je i pavdekshëm,¹⁷⁴ ti që bërë dhe gatove njeriun; ndaj ne vdekatarët nga dheu u formuam¹¹⁶ dhe në të njëjtin dhé do të shkojmë, siç urdhërove ti që më gatove dhe më the: "Përderisa je dhé, do të ikësh në dhé".⁶¹ Atje do të shkojmë të gjithë ne të vdekshmit duke bërë si vaj mortor oden "aliluia".

Sinaksari i Mujorit

Ode VII

Dhrosovolon men tin káminon

Kurtëvish me engjëjt përtë gjykuar dheun mbi fronin e lavdisë sate,⁹³ o Shpëtimtar, mbushi shpirtrat e shërbëtorëve të tu me ngazëllimin tënd hyjnor, që të psalin dhe të thërrasin pa pushim: Je i bekuar, o

Perëndi i etërve tanë.⁷³

O Krisht Shpëtimtar, mëshiroji dhe çliroji, si i dhembshur, nga kërcënimi i atjeshëm të gjithë ata që vdiqën nga shqyerja e egërsirave, ata që i copëtoi peshku dhe ata që i pllakosi tërmeti, dhe ranë në gropa dhe gremina.

Që të të himnojmë besërisht ty, Perëndinë e etërve,⁷³ shpëtoji me shoqërinë tënde dhe me gëzim ata që u asgjësuan nga shpata, thika, zjarri, vështirësitë e mëdha dhe të zgjatura, vrasjet me gurë, nga kusarët, uria dhe epidemia.

Hyllindësor

O e dëlirë, vetëm ti je ura e botës që i transferon njerëzit te Perëndia; prandaj, o Nënë e Zotit, shpëtoji me ndërmjetimet e tua nga çdo nevojë dhe prishje ata që e mbaruan jetën me shpresë dhe dashuri ndaj teje.

Zbritësore: Dhrosovolon men tin káminon

»Nj'engjëll furrën vesëprurëse e bëri për
»Djemt' oshënarë, ndërsa kaldenjt',* me
»një urdhër që* Perëndia dha, u dogjën
»krejt.*⁷⁵ Tirani u bind, prandaj thërret:*
»Je i bekuar ti, o Perëndi!¹⁷⁵ i etërve tan'.

Ode VIII

Ékstithi friton urané

O i vetmi i dhembshur, përdëlleji dhe prehi mbarë njerëzit e çdo lloj grade, të cilët i zhvendose, mbretërit e tu besnikë, arkondët, prijësit e tokës dhe gjykatësit, që ishin eprorë popujsh dhe fisesh, o Zot Shpëtimtar, që të të himnojmë në gjithë jetët.

O Njeridashës, çliroji nga zjarri i frikshëm shërbyesit e Kishës sate të nderuar dhe shpëtoji organizatat e kallogjerëve, shum-

cën e klerikëve, koret e celebruesve të tu të perëndishëm dhe denjësoji të tërë për lavdinë e atjeshme, që të të himnojmë në gjithë jetët.

O Zoti Krisht, shpëtoji, mëshiroji dhe prehi shpirtrat e popullit tënd, ata që e përfunduan besërisht dhe me çdo lloj frike jetën në çdo vend dhe krahinë; dhe çliroji nga Gjehena dhe hidhërimi i torturave, që të të himnojmë në gjithë jetët.

Hyllindësor

Vetëm ti, o Virgjëreshë e pacen, e zhduke me të vërtetë mallkimin e Evës,⁶¹ ndërsa u nxore jetë të dhelindurve; prandaj denjësoji me ndërmjetimet e tua për jetën e amshuar¹⁷⁶ gjithë ata që u zgjidhën nga jeta e përkohshme, që të të himnojmë në gjithë jetën.

Zbritësore: 'Ekstithi friton uranë

»Dridhu, tmerrohu ti, o q'ell*¹⁷⁷ edhe »tronditu prej* themelive ti, o dhë,*¹⁷⁸ »se ja ku hidhet me të vdekurit, Zoti që »lart mbretëron,* dhe mbyllet në varrin »e përlurur.* O Djema e bekoni,* priftërinj »e himnoni,* të gjith' e lartësoni përherë »dhe përjetë.*

Ode IX

Aporí pasa glosa

Përdëllyes, të lypin* kore engjëjsh tani pra* me Keruvimet edhe me të shenjtat Serafime gjithashtu tok* Fronet, Kryesit', Pushtetet, Autoritetet* e Kryeengjëjt me Zotërinjtë¹⁷⁹ dhe kërkojn':* Mbar' shpirtrat që zhvendose, i Forti Zot, mëshiroji ti.

Bashkësi profetike* ty të lypin me kore* apostujsh, patriarkësh, tok me grupe martirike dhe shumicë* oshënarësh përgjeronen shumë dhe thërrasin:* Shpëtoji,

Njeridashës, shërbyesit e tu,* shpirtrat e tërë që besërisht mbi dhë kanë vdekur, Zot.

Ti e di, e sheh çdo gjë,*¹⁸⁰ dhe i njej tërë njer'zit,* dhe jetën, dhe mbarimin e çdokujt; ndaj për të gjithë jep çlirimin* nga të rëndat faje dhe të tërë sa ke zgjedhur,* shërbyesit e tu besëmir', i dhembshur fort,* si Perëndi unik denjësoji për hije në Parajs'.

Hyllindësor

E fortshenjtë, e virgjër,* Zonjë e botës, strehë* je për të gjith' sa rrojnë ose vdiqën, je shijim dhe lehtësim, lavd,* qetësi për sa të kanë pasuri ty, ndihmë,* çlirim dhe mbrojtje; ndaj, o e mirë, e pacen,* mbarë ata shpëtoji me përgjërimit e tua ti.

Zbritësore: Aporí pasa glosa

»Asnjë gjuhë në botë* s'të këndon dot »pas vlerës,* dhe turbullohet mendja e »gjith' engjëjve për ty, o Virgjëreshë.* Po »na prit me mirësi pas besës që të kemi,* »se ti e di fort mirë që kemi mall për ty* »edhe të madhështojmë përherë mbrojtj' »e besnikëve.*

Dërgimësore: O uranón tis astris

Kur e kujtojmë çdokënd* që vdiq në Krisht, le ta kujtojm'* ditën ton' përfundimtare,* t'i përgjërohemi gjithnjë* për hirin ton' dhe të tyre* të mirit Zot mirëbërës.

Hyllindësore E ngjashme

O ëmbëlsi engjëllore dhe ngazëllim për të mjerët, ti që i mbron të krishterët, o Shën Mari Virgjëreshë; përkrahmë ti dhe shpëtomë, nga zjarr' i ferrit përjetë.*

*Lavdërime**Ting. Tërth. II Iapegnosmeni*

Vdekja fundin e ka të frikshëm; gjyqi* që do bëjë Zoti, është i tmerrshëm,* se zjarri që s'shuhet, është gati;¹⁸¹ krimbi s'fle kurr'*¹⁸² por torturon, si dhe kërcitja* e atjeshme e dhëmb've,* terri do jet' tejet i jashtëm,*¹⁸³ i përjetshëm dënimi.* Shpëtimtarit pra le t'i thërrasim:* Krisht, prehi sa ke zgjedhur nga provizoret, prej mëshirës sate të madhe mjaft.

Gjithë sa po treteni k'tu për jetën,* shkoni dhe, të shtangur, uleni kokën* në varre, shikojeni mashtrimin që ka bota.* Ku e ka trupi bukurin' tash?* Ku lavdia e pasjes?* Ku krenaria e jetesës?* Çdo gjë është e kotë.*¹⁸⁴ Shpëtimtarit pra le t'i thërrasim:* Krisht, prehi sa ke zgjedhur nga provizoret, prej mëshirës sate të madhe mjaft.

Tash, në varr, ai që ish lart përmbi fron,* veshi prishjen, mbreti me rrob' të purpurt,* tash nuk është më në fron, por dergjet brenda varrit.* Shih: Çdo pushtet i perandorit* iku; shih se si ëndërr* jeta e njerëzve kalon shpejt,* s'mbetën dot tokësoret;* Shpëtimtarit pra le t'i thërrasim:* Krisht, prehi sa ke zgjedhur nga provizoret, prej mëshirës sate të madhe mjaft.

Në vend lehtësimi, në gji abramian,¹¹⁴* njeridashës dhe Shpëtimtar, caktoji* për hir të mëshirës sate aq të madhe,² vëri* gjithë sa janë të shpërngulur* nga këtu me një shpresë* për të përjetshmen jet'¹⁸⁵ dhe ikën* pra me çdo lloj mënyre;* ndaj preh çdo gjini, çdo gjindje, moshë* dhe burra tok me gra, dhe foshnja të sapolindura, i dhembshur plot përdëllim.

*Lavdi Nekrosim**Ting. II I Joan Damaskinoit*

Si lule fishket¹⁸⁶ dhe si ëndërr shkon edhe tretet çdo njeri; por, kur të oshëtitë trumbeta, gjithë të vdekurit si me një bashkëtronditje do të ngrihen përsëri¹⁶⁹ që të të dalin përpara, o Krisht Perëndi;¹⁴¹ atëherë, o Zoti Krisht, vendosi shpirtrat e shërbëtorëve të tu që i more prej nesh, ndër tentat e shenjtorëve të tu.*

Tani Ting. Tërth. II Hyjlindësor

Ti je Perëndia ynë që krijove çdo gjë me urtësi;¹⁸⁷ dërgove profetët që ta profetizonin ardhjen tënde dhe apostujt që t'i shpallnin madhështitë e tua; dhe të parët profetizuan ardhjen tënde, ndërsa të tjerët me anën e pagëzimit i ndriçuan kombet; dhe martirët, si vuajtën, arritën ato që aspirojnë; dhe ndërmjeton pranë teje kori i dyfishtë tok me lindësen tënde; prehi, o Perëndi, shpirtrat që more dhe ne na denjëso për mbretërinë tënde, ti që durove Kryq për mua të dënuarin, o çlirimtari im dhe Zoti im.

*Pasvargjet Nekrosime të Lavdërimeve.**Poezi e Theofanit.**Ting. Tërth. II Olin apothémeni*

Duke pasur mirësi* të pakuptuar për krejt ne,* dhe burim që nuk shteron* plot mëshir' hyjnore, te ti sa erdhën bri,* vëri, Zot, të fushojn'* përmbi dhë të gjallësh*¹¹⁸ dhe në tenda fort të dashura,¹⁸⁸ plot mallëngjim, hare;* jepu pasurinë që s'zhduket hiç,* por mbetet e qëndrueshme* përgjithnjë, sepse derdhe gjakun tënd,* Krisht, për gjithë¹⁸⁹ ne edhe bleve botën me një çmim¹⁹⁰ të madh* dhe jetëprurës, o Shpëtimtar,* shumëpërdëllyes Zot.

Varg: Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot.

Vdekjen jetëbërëse* vullnetarisht e durove,*²⁴ jetën na e fale ti* dhe shijim përherë për ne besnikët mbar’;* Krisht, rreshtoji në të* sa me shpres’ për ngjalljen* kanë fjetur, ndjeji mirësisht çdo faj që bënë keq,* ndjeji si i vetmi që s’ke mëkat,* i vetmi njeridashës, Zot,* që të lavdërohet me çdo mënyr’,* të himnohet emri yt, o i mirë, dhe ta mburrim mjaft* të gjithë ne të shpëtuarit,* njeridashjen tënde pra.

Varg: Shpirtrat e tyre do të rrinë në të mirat.

Shumëpërdëllyes Krisht,* të dimë si sundimtarin* me fuqi hyjnore ty* mbi të gjallët dhe Zotin e të vdekurve;*¹⁹¹ shërbëtorët e tu* besimtarë prehi,* njeridashës, në vend lehtësimi me të zgjedhurit* edhe në shkëlqimet e shenjtëve,*¹⁹² sepse shpërngulen lart te ti* që je mirëbërësi krejt unik,* dashamirësi, përdëllyesi¹⁹³ i vetëm dhe shpëton* ata që “sipas ikonës” pra* i gatove¹¹⁵ porsi Zot.

Lavdi *Nekrosim*

Ting. Tërth. II I Joan Damaskinoit

Ishte dhimbje për Adamin shijimi i drurit qëmoti në Eden, kur gjarpri nxori helm⁶¹ nga goja, sepse nëpërmjet tij hyri vdekja¹⁹⁴ dhe hëngri tërë gjininë njerëzore; por, Zoti, kur erdhi, e vithisi dragoin dhe na dhuroi prehje; prandaj le t’i thërrasim: Të të vijë keq, o Shpëtimtar, dhe prehi së bashku me të zgjedhurit e tu ata që i more.

Tani *Hyjlindësor Olin apothémeni*

Shfaqesh, o e Tërëshenjt’,* shtëpi hyjnore, se zure* Perëndi dhe linde ti,* por pa

burrë, Zotin në dy natyra veç;* kish vullnet të dyfishtë*,* në një hipostazë;* lyp atë, të vetëmlindurin,²⁸ të parëmlindurin,*¹⁹⁵ që edhe pas lindjes të ruajti* të virgjër pa qortim aspak,* që të prehë shpirtra të vdekurish,* sa me besë fjetën, në gjendje hijeshie pa cenim,* në lumturi qiellore lart,* Zonjë e dëlirë krejt.

Përlëshore Ting. Tërth. IV

O i vetmi Krijues, që i rregullon të gjitha me thellësi urtësie¹²⁰ dhe njeridashje, dhe ua shpërndan të gjithëve atë që është në dobi të tyre, prehi, o Zot, shpirtrat e shërbëtorëve të tu, sepse shpresën e besuan te ti, Bërësi, Gatuesi dhe Perëndia ynë.¹²¹

Lavdi dhe Tani *Hyjlindësore*

Ty të kemi dhe mur, dhe liman, dhe ndërmjetuese që të pret mirë Perëndia që linde, o Hyjlindëse e panusëruar, shpëtimi i besimtarëve.

Në Liturgji, [Tipiket dhe nga Kanuni, Odet III dhe IV. Ose] Antifonet e zakonshme. Pas Hyrjes, Përlëshore O i vetmi Krijues dhe e shenjtit të kishës. Kontaqi Bashkë me shenjtorët. Apostulli dhe Ungjilli i ditës dhe Nekrosimi. Të meriton. Kungatore Të lumtur ata që i zgjodhe dhe i more, o Zot, dhe kujtimi i tyre do të jetë brez pas brezi, Aliluia. Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja O i vetmi Krijues. Para Emri i Zotit goftë i bekuar, bëhet Trisajë.

CITIME

Analipsi:

Mark 16.19-20; Lluk. 24.50-52; Vep. 1.2-11

1. Joan 1.3; Kol. 1.16

2. Num. 14.19 etj.

3. Ps. 88(89).3-5

4. Is. 7.14

5. Matth. 25.33

6. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
7. Ps. 109(110).3
8. Joan 19.23-24
9. Vep. 1.18
10. III [I] Mbret. 19.10,14
11. Ef. 6.17
12. I Kor. 11.2; II Thes. 2.15
13. II Kor. 8.9
14. Joan 15.26
15. Kol. 1.26
16. Matth. 28.4
17. Joan 20.11-16
18. Lluk 24.10; Joan 20.18
19. Joan 20.19
20. Matth. 9.38; Lluk. 10.2
21. Matth. 20.1
22. I Joan 5.20
23. II Mbret. [Sam.] 6.2 etj.
24. Joan 10.15,17-18
25. Lluk. 15.8-10
26. Matth. 27.65-66
27. Osia 13.14; I Kor. 15.55
28. Joan 1.14,18; 3.16,18; I Joan 4.9
29. Apok. 21.9; 22.17
30. Ps. 44(45). 10-14
31. Eks. 20.21; Sirak 45.5
32. Eks. 4.10
33. Eks. 20.22 etj.
34. Eks. 31.18; Ligji i Dytë 9.10
35. Eks. 33.23
36. Eks. 3.14
37. Gjen. 14.14-16
38. I Mbret. [Sam.]1.4-19
39. I Mbret. [Sam.]2.3
40. Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18
41. Fil. 2.15
42. I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16
43. Is. 52.7; Rom. 10.15
44. Fil.4.7
45. Ps. 71(72).7
46. I Kor. 1.24
47. Ps. 22(23).2
48. Eks. 25.30-37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 4.9; 8.2; Hebr. 9.2
49. Mal. 4.2(3.20)
50. Mih. 4.2; Is. 2.3
51. Rom. 12.9; I Kor. 5.13
52. Matth. 13.25
53. Hebr. 1.3
54. Hebr. 11.24
55. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
56. Eks. 16.33; Hebr. 9.4
57. Eks. 25.22-29; 39.18; 40.20; Lev. 24.6; Hebr. 9.9
58. I Joan 2.2; 4.10
59. Hebr. 2.10; 5.10
60. Jona 2.1-8
61. Gjen. 3.2-6,16-19
62. II Tim. 2.15
63. I Tim. 3.16
64. Fja. Urt. 9.3
65. Joan 7.37
66. Fja. Urt. 9.1-2
67. Fja. Urt. 9.5
68. Num. 20.13; 27.14; Ligji i Dytë 32.51; 33.8; Ps. 80(81).8; 105(106).32
69. Rom. 9.6-7
70. Mal. 3.6
71. Is. 44.6
72. Ps. 72(73).8
73. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
74. Mark 3.17
75. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 24-26
76. Dan. 3.7
77. Dan. 3.23-Lutja e Azarias 28
78. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
79. Rom. 15.13
80. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
81. Joan 21.1-14
82. Ps. 23(24).7,9
83. Vep. 15.28
84. Ps. 4.5
85. Vep. 20.29
86. I Mbret. [Sam.] 17.49-51
87. Rom. 1.1 etj.
88. Ps. 46(47).6
89. Ef. 1.21; 4.9-10
90. Ef. 1.23
91. Ef. 1.21; 4.9-10
92. Is. 63.1-2
93. II Tim. 4.1; I Petr. 4.5
94. Joan 14.18
95. Lluk. 12.4; Joan 15.14-15
96. Joan 10.11-14
97. Ef. 2.18; 3.12; I Petr. 3.18
98. I Kor. 16.23
99. I Kor. 2.8; Jak. 2.1
100. Joan 1.18
101. Baruk 3.38
102. Matth. 19.27
103. Joan 10.16
104. Lluk. 24.49
105. Matth. 28.19
106. Gjen. 3.21
107. Gjen. 3.4-5
108. I Petr.3.19
109. Joan 1.1
110. Apok. 22.12
111. Kol. 1.12
112. Matth. 19.16 etj.
113. I Kron. 16.29
114. Lluk. 16.22
115. Gjen. 1.26-27; 5.1; 9.6; Urt. Sol. 2.23; Sirak. 17.3
116. Gjen. 2.7-8,15; II Makk. 7.23; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8-9

117. Gjen. 1.28
118. Ps. 114(115).9
119. Ps. 117(118).15
120. Rom. 11.33
121. Ps. 61(62).8; 72(73).28; 77(78).7
122. Gjen. 2.15
123. Gjen. 3.24
124. Gjen. 2.21-22
125. II Tim. 2.5
126. Hebr. 9.12
127. Fil. 2.7
128. Matth 18.12-13; Lluk.15.4-6
129. Rom. 3.24-30; 5.1; Gal. 2.16; 3.8,24
130. I Mbret [Sam.] 2.1-2
131. Matth. 16.16-18
132. Kisht. 1.2 etj.
133. Jov 8.9
134. Ps. 38(39).7,12
135. Ps. 86(87).7
136. Ps. 41(42).4; 46(47).1; 117(118).15
137. Ef. 5.8; I Thes. 5.5
138. Ps. 46(47).5
139. I Esd. 8.75; II Esd. 9.8
140. Ps. 117(118).14
141. I Thes. 4.17
142. Jer. 2.13
143. Ps. 67(68).7
144. Gjen. 2.15
145. Is. 35.10
146. I Tim. 6.16
147. Ps.106 (107).16
148. Matth. 5.5
149. Lluk. 1.48
150. Joan 1.14
151. III [I] Mbret. 18.38
152. Ju. 9.5-6; Ps. 134(135).6; Urt. Sol. 12.18; Mark. 1.40; Hebr. 1.3
153. Mik. 7.18
154. Ps. 106(107).14
155. Eks. 25.8; 26.30; Hebr. 9.2 etj.
156. Rom. 5.9
157. Eks. 33.20; Joan 1.18
158. Is. 6.2
159. Gjen. 2.8
160. Rom. 5.10-11; II Kor. 5.18-19
161. Ps. 64(65).5
162. Ps. 94(95).4
163. Eks. 14.21-15.1 etj.
164. Ps. 134(135).7
165. Rom. 13.1
166. Mark. 12.42; Lluk. 21.2
167. Ps. 22(23).2
168. Abak. 3.19; Joan 20.28
169. Matth. 24.31; I Kor. 15.52; I Thes. 4.16
170. Is. 26.9
171. Ps. 84(85).8
172. Hebr. 11.38
173. Joan 8.46
174. I Tim. 6.16
175. Dan. 3.28
176. Matth. 19.16 etj.
177. Jer. 2.12
178. Ps. 81(82).5
179. Kol. 1.16
180. Joan 21.17
181. Matth. 3.12; Mark 9.43-45; Lluk. 3.17
182. Mark 9.46-48
183. Matth. 8.12 etj.
184. Kish. 1.1 etj.
185. Tit. 1.2
186. Is. 40.6-7; Jak. 1.11
187. Ps. 103(104).24
188. Ps. 83(84).2
189. Matth.26.28; Mark. 14.24; Lluk. 22.20
190. I Kor. 6.20
191. Rom. 14.9
192. Ps. 109(110).3
193. Mih. 7.18
194. Rom. 5.12
195. Rom. 8.29; Kol. 1.15; Hebr. 1.6





TË DIELËN E PENTIKOSTISË

TË SHTUNËN
NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*Thirrtores: 3 Idhiomelet e para të
Mbrëmësore së Madhe në 4, duke
përsëritur të parën:*

Ting. I

Kremtojmë Pentikostinë... (2x)
O Krisht, i përtërite Nxënësit e tu...
Të gjitha i jep Shpirti Shenjt...

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

O Zot, kur ua dërgove Shpirtin tënd...
(Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 212)

*Pasvargje Idhiomele (Thirrtoret e tjera të
Mbrëmësore së Madhe):*

Ting. II

Pamë dritën e vërtetë...

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o
Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në
thellësitë e zemrës sime.

Me profetët, na lajmërove udhën...

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe
mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të
Shenjtë.

Në avllitë e tua do të të himnoj ty...
(Kërkoji në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 211)

Lavdi dhe Tani I njëjti

Ta përhimnojmë Triadhën e bashkë-
qenshme, Atin dhe Birin bashkë me
Shpirtin e Shenjtë, sepse kështu pre-
dikuan të gjithë profetët dhe apostujt
tok me martirët.

Përlëshore

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë...

Dhe Përlëshim.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

Pa Psaltir. Thirrtores Idhiomele në 10.

Ting. I

Kremtojmë Pentikostinë, ardhjen e
Shpirtit, afatin e premtimit¹ dhe për-
mbushjen e shpresës. Sa i madh dhe i

nderuar është misteri! Ndaj të thërrasim: O Zot, Krijues i gjithçkaje, lavdi më ty. (2x)

O Krisht, i përtërite Nxënësit e tu me gjuhët e huaja, që, me anë të tyre, të të predikonin ty, Fjalën e pavdekshme dhe Perëndinë² që u jep shpirttrave tanë përdëllimin e madh.³

Të gjitha i jep Shpirti Shenjt, buron profeci, përsos priftërinj, u mësoi të paditurve urtësi, peshkatarët i tregoi si theologë, mban tërë institucionin e Kishës. O Ngushëllimtar i bashkëqenshëm dhe i bashkëfronshëm me Atin e me Birin, lavdi më ty.

Ting. II

Pamë dritën e vërtetë,⁴ morëm Frymën qiellore, gjetëm besën e vërtetë, duke iu falur Trinisë së pandarë, se ajo na shpëtoi.* (2x)

Me profetët, na lajmërove udhën e shpëtimit dhe ndër apostujt shkëlqeu Hiri i Shpirtit tënd, o Shpëtimtari ynë; ti je Perëndia i parë, ti je dhe në vazhdim;⁵ dhe, në jetë të jetëve, ti je Perëndia ynë.

Në avllitë e tua do të të himnoj ty, Shpëtimtarin e botës,⁶ dhe, pasi t'i ul gjunjët, do t'i falem⁷ fuqisë sate të pamposhtur; në mbrëmje dhe në mëngjes dhe në mesditë,⁸ dhe në çdo kohë do të të bekoj, o Zot.⁹

Në avllitë e tua, o Zot, pasi i ulëm gjunjët⁷ e shpirtit dhe të trupit, ne besimtarët të përhimnojmë ty, Atin e pafillim dhe Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e bashkëpërjetshëm dhe të Tërëshenjtë që i shndrit dhe i shenjtëron shpirtat tanë.

Le ta përhimnojmë Trininë e bashkëqenshme, Atin dhe Birin bashkë me Shpirtin e Shenjtë, sepse kështu pre-

dikuan të gjithë profetët dhe apostujt tok me martirët.

Lavdi *dhe* Tani

Ting. Tërth. IV Poezi e mbretit Leon

Ejani, o popuj, t'i falemi Hyjnisë trihi postate, Birit në Atë¹⁰ bashkë me Shpirtin e Shenjtë; sepse Ati e lindi pa kohë Birin e bashkamshuar dhe të bashkëfronshëm dhe Shpirti i Shenjtë ishte me Atin duke u lavdëruar tok me Birin; Një fuqi, Një esencë, Një Hyjni, së cilës i falemi të gjithë duke thënë: Shenjt Perëndi që i bëri të gjitha përmes Birit¹¹ në bashkëpunim me Shpirtin e Shenjtë. Shenjt i fuqishëm, përmes të cilit njohëm Atin¹² dhe erdhi në botë Shpirti i Shenjtë. Shenjt¹³ i pavdekshëm, Shpirti Ngushëllimtar që del prej Atit¹ dhe prehet te Biri. O Trini e Shenjtë, lavdi më ty.

Hyrje. O dritë gazmore. Proqimeni i ditës dhe Leximet.

Këndimi i Numrave

(11.16-30)

Zoti i tha Moisiut: “Më mblidh shtatëdhjetë burra nga pleqtë e popullit, të cilët ti i njeh vetë se ata janë pleqtë e popullit dhe shkruesit e tyre; dhe do t'i sjellësh në Tendën e Dëshmisë dhe do të qëndrojnë atje bashkë me ty; dhe do të zbres dhe do të flas atje me ty dhe do të heq nga Shpirti që është mbi ty dhe do të vendos mbi ta dhe ata do ta marrin përsipër bashkë me ty vrullin e popullit dhe nuk do t'i mbash vetëm ti”. Dhe Moisiu mblodhi shtatëdhjetë burra nga pleqtë e popullit dhe i vuri të qëndronin rreth Tendës. Dhe Zoti zbriti në re dhe i foli Moisiut dhe hoqi nga Shpirti që ishte mbi të dhe e vendosi mbi shtatëdhjetë burrat pleq. Dhe, sapo u preh Shpirti mbi ta, dhe profetizuan

në repart, dhe nuk vazhduan më. Dhe mbetën dy burra në repart, emri i njërit ishte Eldhadh dhe emri i tjetrit Modhadh. Dhe Shpirti u preh mbi ta; dhe ata ishin në katalog dhe nuk erdhën në Tendë, dhe profetizuan në repart. Dhe djaloshi vrapoi te Moisiu, dhe e lajmëroi, dhe i tha atij duke folur: “Eldhadhi dhe Modhadhi profetizojnë në repart”. Dhe, si iu përgjigj, Jisui i Naviut, që qëndronte bri Moisiut, i zgjedhuri i tij, i tha: “Zoti Moisi, pengoji”. Dhe Moisiu i tha: “Mos ki zili ti për hirin tim? Dhe kush do ta japë gjithë popullin e Zotit si profetë, kur Zoti do ta japë Shpirtin e tij mbi ta?”.

Këndimi i profecisë së Joelit
(2.23-3.5)

Këto thotë Zoti: O bij të Sionit, nga-zëlluhuni dhe dëfreni më Zotin, Perëndinë tuaj, sepse ju dha ushqime për drejtësi; dhe do t'ju hedh shi të hershëm dhe të vonshëm si më parë; dhe lumenjtë do të mbushen me grurë dhe tokat do të mbushen dhe do të derdhen shumë verë dhe vaj; dhe do t'ju shpërblej në vend të viteve ku hëngri karkaleci dhe krimbi dhe bulkthi dhe vemja dhe fuqia ime e madhe që ju dërgova; dhe do të hani; duke ngrënë, dhe do të ngopeni, dhe do ta himnoni emrin e Zotit, Perëndisë tuaj që bëri me ju gjëra të çuditshme, dhe nuk do të turpërohet rëndë populli im në jetë. Dhe do ta dini mirë se unë jam në mes të Izraelit dhe unë jam Zoti, Perëndia juaj, dhe nuk ekziston ndonjë tjetër përveç meje: dhe nuk do të turpërohet më rëndë populli im në jetë. Dhe do të ndodhë që, pas këtyre, do të derdh nga Shpirti im mbi çdo mish, dhe bijtë tuaj dhe bijat tuaja do të profetizojnë, dhe pleqtë tuaj do të shohin ëndrra dhe djelmoshat tuaj

do të shikojnë vegime. Madje, dhe mbi shërbëtorët e mi, dhe shërbëtorët e mia, në këto ditë, do të derdh nga Shpirti im dhe do të profetizojnë; dhe do të jap çudi lart në qiell dhe shenja poshtë mbi tokë, gjak dhe zjarr dhe avull tymi. Dielli do të kthehet në terr dhe hëna në gjak para se të vijë dita e madhe dhe e shquar e Zotit; dhe do të ndodhë që, cilido që do ta thërrasë emrin e Zotit, do të shpëtojë.

Këndimi i profecisë së Jezekielit
(36.24-28)

Këto thotë Zoti: Do t'ju marr nga kombet dhe do t'ju mbledh nga gjithë tokat dhe do t'ju fut në tokën tuaj; dhe do t'ju spërkat me ujë të pastër, dhe do të pastroheni nga të gjitha ndotjet tuaja dhe nga të gjithë idhujt tuaj dhe do t'ju pastroj; dhe do t'ju jap një zemër të re dhe do t'ju jap një shpirt të ri; dhe do ta heq zemrën e ngurtë nga mishi juaj dhe do t'ju jap një zemër mishore; dhe do ta jap edhe Shpirtin tim brenda jush dhe do të bëj që të ecni në të drejtat e mia dhe që t'i ruani gjykimet e mia dhe do t'i kryeni; dhe do të banoni mbi dheun që u dhashë etërve tuaj dhe ju do të jeni populli im dhe unë do të jem Perëndia juaj.

Në Liti Idhiomele Ting. II

Me profetët, na lajmërova...
Në avllitë e tua do të të himnoj ty...
Në avllitë e tua, o Zot, pasi i ulëm...
(Kërkoji në Thirrtores, fq. 211)

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

O Zot, kur ua dërgove Shpirtin tënd apostujve¹ kur po rrinin ulur, bijtë e hebrenjve, habiteshin tepër duke i parë meqë i dëgjonin të flisnin me gjuhë të tjera të huaja sikundër ua jepte Shpirti;

se, duke qenë të pashkolluar,¹⁴ u urtësuan dhe, pasi i kapën si gjah kombet, u thoshin me oratori hyjnore; prandaj dhe ne të thërrasim: O Zot që u shfaqe mbi tokë dhe na shpëtove nga mashtrimi, lavdi më ty.

Pasvargje Idhiomele Ting. Tërth. II

O Zot, kombet, duke mos e njohur fuqinë e Shpirtit të Tërshenjtë, e cila u erdhi apostujve të tu, mendonin se ishte nga dehja ndryshimi i gjuhëve; mirëpo ne, pasi u mbështetëm prej tyre, themi pa pushim kështu: O njeridashës, mos e hiq prej nesh Shpirtin tënd të Shenjtë.¹⁵

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

O Zot, mbiardhja e Shpirtit të Shenjtë i mbushi apostujt e tu dhe i bëri të flisnin në gjuhë të tjera; prandaj paradoksi mendohej prej të pabesëve si dehje, por prej shpresëplotëve si shkaktar shpëtimi; lutemi: O njeridashës, na denjëso edhe ne për ndriçimin e tij.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, shpirt i së vërtetës,¹⁶ që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë, dhe shpëto, o i Mirë, shpirtat tanë.*

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Dikur, gjuhët u ngatërruan nga arroganca e bërjes së kullës,¹⁷ por tani gjuhët u urtësuan për lavdinë e hyjnohjes. Atje, Perëndia i dënoi ata që u bënë të pa-

besë nga shkelja, këtu Krishti i ndriçoi peshkatarët me Shpirtin. Atëherë u iku të folurit si ndëshkim, ndërsa tani përtëritet të folurit e përbashkët për shpëtimin e shpirtave tanë.

Përlëshore Ting. Tërth. IV

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë, që i tregove peshkatarët të gjith'urtë, duke iu dërguar Shpirtin e Shenjtë; dhe me anën e tyre rrjetove tërë botën, njeridashës, lavdi më ty * (3x)



NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Ta festojmë hijesisht* të fundmen, pas-kremtoren dit',* o besnikë, kjo është pra* Pentikostia; u përmbush* afati krejt i premtimit,¹ se menjëher'* zbriti në të, mbi dhe i shenjtë zjarr* i Ngushëllimtarit si mjaft gjuhë* edhe i shndriti Nxënësit, i shfaqti* si mistë mbiqielorë;* e ndriti botën* kur erdhi drita* e Shën Ngushëllimtarit. (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjëso E ngjashme*

Erdhi përmbi njerëzit* nga Shpirti kroi i tij pra,* mendërisht u nda veças* si lum' me zjarr, i shndriti nur* apostujt dhe i freskoi, për ta u shfaq si* zjarr, pors i një re që flladiste fort,* flakë me plot dritë që ish si shi;* me ta e morëm ne Hirin e Hyjshëm* nëpërmjet zjarrit dhe ujit;*¹⁸ e ndriti botën,* kur erdhi, drita* e Shën Ngushëllimtarit. (2x)

Pas Polieleit, Ndenjësores

Ting. Tërth. IV To prostahthén mistikós

Pas ngjalljes sate prej varrit dhe pas ngritjes* hyjnore lart në* qiej,¹⁹ o Krisht, u dërgove,* lavdin tënd, o i dhembshur,* Nxënësve hyjpamës;* u fute të drejtin Shpirt,²⁰ ndaj, porsi kitar',* me një melodi mistike* prej t'shenjtit tast* fort ia shpallën çdokujt, Zot, tingëllimet si dhe Ekonominë tënde, Shpëtimtar,* mirëbërës; lavdi më ty. (2x)

Shkallesat. Antifoni i parë i Ting. IV

Proqimeni Ting. IV

Shpirti yt i mirë do të më udhëheqë në dhe të drejtë.

Varg: O Zot, dëgjo faljen time.

Çdo frymë le të lavdërojë Zotin. (3x)

Ungjilli IX Mëngjesor

Nuk thuhet Ne që pamë ngjalljen, por menjëherë Psalmi 50.

Ting. II

Lavdi

Me ndërmjetimet e apostujve.

Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Përdëllemë, o Perëndi.

Dhe Idhiomeli.

Ting. Tërth. II

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, shpirt i së vërtetës,¹⁶ që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë, dhe shpëto, o i Mirë, shpirtrat tanë.*

Kanunet: I pari (tok me Irmoset) në 8 dhe i dyti (tok me Irmoset) në 6.

Ode I

Kanuni i parë që ka Akrostihidhë:

"E kremtojmë Pentikostinë".

Poezi e Kozma Monakut.

Ting. i Rëndë

Irmosi: Ponto ekálipse

»Zoti që thyen fort* me një krah të lartë²¹
»mjaft* kundërshtarë, mbuloi karroca,
»Faraonin tok;* ne le t'i këndojm' se u
»lëvdua fort.²²

Siç ua dhe fjalën lashtë*,¹ ti ua kreve Nxënësve,* ua dërgove Shën Shpirtin Ngushëllimtar, i shndrite pra* botës dritë, njeridashës Shpëtimtar.

Sot, te besnikët mbar'* hodhi Hir Hyjnor i Shpirt* dhe kështu u përmbushën të parapredikuarat* lashtë nga profetët,²³ nga i shenjti Ligj.²⁴

Kanuni i dytë, "jambik", që ka Akrostihidhë të brendshme me Vargje "heroelegjike": «O Fjalë e hyjlindur, u dërgove të mbidheshmëve Shpirt, një tjetër Ngushëllimtar sërish, nga gjiri i Lindësit; u jepte himnuesve hir si përmes gjuhësh zjarri, porsi shenjë për Hyjninë e tij të palëndët dhe të natyrës sate».

Poezi e zotit Joan Arklasi (Damaskinoi)

Ting. IV

Irmosi: Thio kalifthis

»Si mbulohet prej territ hyjnor²⁵ me-
»meci,*²⁶ me oratori* thot' një Ligj²⁷ të
»hyjshkruar,*²⁸ pasi e hodhi baltën larg
»shpirtërorit sy, po sheh Krishtin,*²⁹
»ekzistentin³⁰ dhe mistikisht njeh* Shën
»Shpirtin, me këng' pra hyjnisht e mburr.

Goja e nderuar dhe e respektuar* tha: Miq,³¹ s'ndahem un'* nga ju;³² dhe kur të ulem* bri fronit atëror të fortlartë,¹⁹ hirin e Shpirtit, pa fund* do t'ua hedh¹ atyre që duan,* me shumë dëshirë, të shndritin nur.

E Vërteta krejt, Fjala, pra përcaktimi* atëror, e bën* zemrën shumë të qetë* si e mbaroi veprën vet' Krishti,³³ miqt'³¹ i dëfren kur Shpirtin* ua dërgoi veç siç premtoi,* me gjuh' zjarri, erë të vrullshme.

Zbritësore: Ponto ekálipse dhe Thio kalifthis

Zoti që thyen fort.

dhe

Si mbulohet.

Ode III

Irmosi: Tin eks ipsus dhínamin

»**U** the Nxënësve, Krisht: Rrini në Jeru-
»salem* derisa të vishni ju forcën* nga
»lart;³⁴ Ngushëllimtarin tjetër pra,* si un',
»do t'ju dërgoj, ai është Shpirti* im dhe i
»tim Ati, do mëkëmbeni me të dhe do të
»siguroheni.

Forca e Hyjnorit Shpirt që erdhi, e bashkon* me një harmoni të shenjt' zërin* e copëtuar të atyre pra* që kishin lashtë keq një mendje;¹⁷ besnikët* po i urtëson me diturinë e Trinisë që na siguroi fort.

Irmosi tjetër: Ërikse gastrós

»**P**rangat që kish mitra e steriles edhe*
»talljen plot vrer nga një grua me fëmijë,*
»i shfarosi lutja thjesht e profeteshës*
»Ana qëmoti me një shpirt të dërrmuar*
»drejt fuqplotit* Perëndi³⁵ të dijeve.³⁶

S'kapet dot shkëlqimi, drita e Shën Shpirtit,* që hyjkryeson, i shfaqti oratorë* peshkatarët e pashkolluar¹⁴ që mbyllnin* me fjalë goj' sofistësh dhe nxirrnin kombe* pa fund nga nata* mjaft e thellë, plot me terr.

Drita gjithëbërëse, shkëlqimi pa fund* doli pra nga Drita³⁷ që nuk lindi kurrë,* në

Sion, një zhurmë me flakë iu shfaq tash* kombeve, se kjo është e njëqenshmja dritë* dhe, përmes Birit,* vjen si forc' e Atit lart.¹

Zbritësore: Tin eks ipsus dhínamin dhe Ërikse gastrós

U the Nxënësve, Krisht.

dhe

Prangat që kish mitra.

Ndenjësores

Ting. Tërth. IV To prostathén mistikós

Me gaz u mbushën, u bënë guximtarë,* ndërsa, më parë,* miqt' e Shpëtimtarit³¹ kishin* frik';³⁸ kjo ndodhi kur zbriti* sot nga lart Shën Shpirti* mbi Nxënësit, mbi shtëpinë ku rrinin tok;* i flisnin çdo kombi veças* në shumë gjuh';* u përhapën gjuhët që, si zjarr, dukeshin, por s'i dogjën fare por përkundrazi:* Krejt këta i freskuan mjaft. (2x)

Ode IV

Irmosi: Katanoón o profitis

»**K**ur mori vesh ardhjen tënde tani në
»fund profeti shenjt* thirri: E kam dë-
»gjuar,* o Zot, forcën tënde,³⁹ se erdhe
»që t'i shpëtosh ti,* Krisht, të mirët e tu⁴⁰
»të tërë; lavd ty, o Perëndi.

Ngushëllimtari, Perëndia i vërtetë, që foli me profetët⁴¹ më parë dhe u predikua nëpërmjet Ligjit²⁴ te njerëzit e dobët, sot bëhet i njohur ndër shërbyesit dhe dëshmitarët e Fjalës.⁴²

Duke sjellë shenjë të Hyjnisë, zjarrin,⁴³ Shpirti u shpërnda tek apostujt dhe, nëpërmjet gjuhëve të huaja, shfaqti se vjen nga Ati, por është fuqia hyjnore, vetadministruuese.

Irmosi tjetër: Anaks anakton

»Vetëm ti dole, Fjal', nga i vetmi Atë*
»që s'ka shkak, o mbret i mbretërve;⁴⁴
»dhe Shpirtin* krejt të vërtet' që ka forc'
»të barabartë* me ty, Zot, si mirëbërës
»e dërgove* mbi shën apostujt; i psalnin
»fuqis' sate.

O Fjalë e Perëndisë, me fjalë e përzjeve
banjën hyjnore të rilindjes⁴⁵ me natyrën
tonë të kombinuar dhe më hedh, si shi,
rrjedhë nga brinja jote e shpuar,⁴⁶ duke e
vulosur me nxehtësinë e Shpirtit.

Të gjitha gjunjëzohen para Ngushë-
llimtarit dhe Birit të Atit,⁴⁷ absolutisht
të njëqenshëm me Atin, sepse dinë një
esencë, të vërtetë, të paafuar, të pa-
kohshme në tre Persona, meqenëse
rrezatoi dritë Hiri i Shpirtit.

Sa jeni adhurues të esencës trindriçuese,
kremtojeni me përkushtim Hyjkryesinë
absolute, sepse Krishti, si mirëbërës, vep-
ron përmbi mendje dhe shkëlqen, si pish-
tar, për shpëtim duke dhënë tërë Hirin e
Shpirtit.¹

*Zbritësore: Katanoón o profitis dhe Anaks
anakton*

Kur mori vesh ardhjen tënde.

Dhe

Vetëm ti dole, Fjal'.

Ode V

Irmosi: To dhiá ton fovon su

»Shpirti i shpëtimit që brenda barqeve*
»profetike pra u zu nga frika jote dhe i
»bëri mbi dhé shtatzëna,*⁴⁸ te besnikët
»po banon në një mënyr' të re* si u kish
»pastruar zemrat apostujve,* përderisa
»urdhrat e tu janë dritë⁴⁹ dhe paqe.

Fuqia që erdhi sot nga lart, është Shpirti

i mirë,⁵⁰ Shpirti i urtësisë së Perëndisë,⁵¹
Shpirti që del nga Ati dhe na u shfaq
nëpërmjet Birit neve besimtarëve;¹ tek
ata që banon, ai ua jep shenjtërimin që e
ka natyrisht dhe qartësisht.

Irmosi tjetër: Litirion kátharsin

»**O** bij dritëpamës nur të Kishës, prisni*
»një vesë që fryn zjarr nga Shpirti, që
»është* shfarosja pastruese e fajit, me-
»që* sot prej Sionit* doli ligji,⁵² pra Hiri*
»shpirtëror që duket si gjuhë e zjarrtë.

Siç deshi, me vullnet të lirë, Shpirti, me
pushtetin e vet, zbret nga Ati dhe i urtëson
apostujt me gjuhët dhe e vërteton fjalën
jetëprurëse që tha Shpëtimtari. Shpirti
është me pamje të njëjtë në Hyjni dhe i
barabartë në fuqi me Atin.

Fjala gjithësunduese e Perëndisë i shë-
ronte nga mëkati mendjet e apostujve
dhe i bënte banesa të pastra për veten e
tij,⁵³ dhe tani banon në to drita e Shpirtit⁵⁴
të barasfuqishëm dhe të njëqenshëm me
të.

*Zbritësore: To dhiá ton fovon su dhe
Litirion kátharsin*

Shpirti i shpëtimit.

dhe

O bij dritëpamës nur.

Ode VI

Irmosi: Naftión to salo

»**I** përzier shumë* jam nga jetësoret
»furtuna,* kujdesjet, dhe zhytem me
»bashk'lundrues,* me fajin, hidhem në
»bisha shpirtprishëse;* si Jonai të thë-
»rras: Më nxirr lart,* Krisht, nga vdekje-
»prurësi fund edhe më shpëto.⁵⁵

Pasurisht mbi çdo trup,* siç the, hodhe
nga Shpirti yt Hir* edhe Gjithësia me

njohjen tënde,* o Zot, u mbush,⁵⁶ se je Bir që pa rrjedhje hiç* linde ti prej Atit tënd, Krisht, ndërsa* Shpirti del prej tij pa ndarje,¹ jeni Një Trini.

Irmosi tjetër: Ilasmós imín

»Zot, për ne, si falje⁵⁷ dhe shpëtim,⁵⁸
»shkëlqeve* nga e Virgjra, dhe, siç e
»zhvate nga prishja* në det, profetin
»Jona nga një bark bishe,*⁵⁵ shndrite ta
»shpëtoje dhe tërë Adamin* thell' nga
»prishja, se me krejt fisin kish rënë.⁵⁹

Shpirt të dëshiruar dhe të drejtë futna* neve ti²⁰ përjetë, Zot, si përtëritës;* është tok me Atin dhe del gjithnjë prej Atit* dhe djeg lëndë ndotjesh me plot neveri pra* si edhe lan mendje, i Gjithëpushtetshëm.

Në Sion, apostujve të tu që prisnin* ardhjen tënde, Zot,³⁴ me er', zjarr u vë Shpirtin* që dëshironin si grad'; ai është shenja* e atij që lindi nga Ati, pra Fjalës;* ti zbulon shpejt fjal' boshe, lajka kot kombesh.

Zbritësore: Naftión to salo dhe Ilasmós imín

I përzier shumë.

dhe

Zot, për ne si falje.

Kontaqi Ting. Tërth. IV

Kur zbriti dhe përzjeu gjuhët, i Tërëlarti i ndante kombet.¹⁷ Kur i shpërndaui gjuhët e zjarrit, i thirri të gjithë në bashkim; dhe me një zë e lavdërojmë Shpirtin e Tërëshenjtë.

Shtëpia

O Jisu, na jep shpejt ngushëllim të qëndrueshëm neve shërbëtorëve të tu, sepse frymët tona i ka pushtuar apatia; mos u nda³² nga shpirtat tanë në shtrëngime, mos u largo nga mendjet tona në pe-

ripeci, por eja shpejt përherë; afrohu te ne, afrohu⁶⁰ ti që je kudo; siç ishe përgjithmonë bashkë me apostujt e tu, po ashtu bashkohu me ata që të dëshirojnë, o i dhembshur, që, duke u bashkuar me ne, ta himnojmë dhe ta lavdërojmë Shpirtin tënd të Tërëshenjtë.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Dieën e tetë pas Pashkës, kremtojmë Pentikostinë e Shenjtë.

Varg: Me një frymë të vullshme dhe me gjuhë si pishtarë zjarri,/ Krishti ua shpërndan apostujve Shpirtin Hyjnor.¹

Në këtë ditë të madhe, Shpirti u derdh mbi peshkatarët.

Me ndërmjetimet e apostujve të shenjtë, o Krisht, Perëndia ynë, mëshirona. Amin.

Ode VII

Irmosi: I en kamino tu pirós

»Djemt' oshënarë që u hodhën në furrë
»zjarri qëmoti,* e kthyen zjarrin në fresk
»të madh* me anë himnodie, kur k'shtu
»thërrisnin:* Je i bekuar ti gjithnjë,* Pe-
»rëndi Zot, i etërve tan' .⁶¹

Kur apostujt i rrëfenin me oratori madhështitë hyjnore, ata që nuk besonin, e mendonin si dehje energjinë e Shpirtit, përmes së cilës bëhet e njohur Trinia, Një Perëndi i etërve tanë.

E theologojmë orthodhoksisht natyrën e pandashme, Atin Perëndi pa fillim, me Fjalën dhe Shpirtin që kanë të njëjtin pushtet, ndërsa thërrasim: I bekuar je, o Perëndi i etërve tanë.

Irmosi tjetër: Símfonon ethróisen

»Bënin simfoni tok veglat muzikore* që
»të adhuronin ikonën e artë,* pa shpirt,⁶²
»por i shndritshmi Hir, Ngushëllimtari,*

»na nxit, me nder, but',* të thërrasim: "E »vetmja Trini pa koh',* me Një forc', je e »bekuar."

Përderisa nuk i dinin fjalët që thanë profetët,²³ sapo dëgjuan fjalët e huaja të apostujve, të pamendët flisnin për një dehje vere; mirëpo ne besimtarët të thërrasim hyjnisht: O ripërtëritës i Gjithësisë, je i bekuar.

Joeli i hyjnueshëm, shikuesi, e quajti si bubullimë zërin e Fjalës së adhurueshme, tepër hyjkryesuese që tha: Ata mbi të cilët unë do të derdh nga Shpirti im,²³ do të thërrasin me një zë: O natyrë e trindritshme, je e bekuar.

Ora e tretë pati fatin e mirë ta merrte Hirin, që të shfaqte disi se duhet të adhurojmë tri hipostaza me thjeshtësinë e pushtetit; dhe tani, ditën e parë dhe kryesore, o Bir, Atë dhe Shpirt, je i bekuar.

*Zbritësore: I en kamino tu pirós dhe
Simfonon ethróisen*

Djemt' oshënarë.

dhe

Bënin simfoni.

Ode VIII

Irmosi: Áflekto pirí en Siná

»Ferra në Sina që nuk digjej edhe pse »bashkohej me zjarrin,⁶³ Perëndin'* me- »mecit që s'kish zë të ëmbël aspak,* pra »Moisiut,²⁶ ia kish bërë të njohur; Djemt' »një zell hyjnor i shfaqti fort* pa dëm »në zjarr,⁶¹ ndaj himnonin: Krejt veprat »zotërore,* Zotin lartësoni, himnoni në »gjith' jetët.⁶⁴

Pasi erdhi me formë gjuhësh të zjarrta mbi peshkatarët, fryma e Shpirtit të Tërshenjtë nga lart me një zë të

vrullshëm e gjallërues, ata i shprehnin me oratori madhështitë e Perëndisë. Krejt veprat zotërore, lartësojeni dhe himnojeni Zotin në gjith' jetët.⁶⁴

Ne që shkojmë në malin e paprekshëm, duke mos pasur frikë nga zjarri i frikshëm,⁶⁵ ejani të qëndrojmë në malin Sion, në qytetin e Perëndisë së gjallë,⁶⁶ duke kërcyer tani me Nxënësit. Krejt veprat zotërore, lartësojeni dhe himnojeni Zotin në gjith' jetët.⁶⁴

Irmosi tjetër: Lii ta dhesmá

»Një simbolizim trindriqës i Zotit* që »hyjkryeson, freskon flak', zgjidh zin- »xhirë.* I psalin Djemtë*⁶¹ dhe Krijesa »e tërë të vetmit Shpëtues, mirëbërës; »si Zot* gjithëgatues, e himnon⁶⁴ fort në »jetë.

Shpirti që zbriti me pamje gjuhësh si pishtarë të zjarrtë, sjell ndërmend fjalët shpëtimtare për njerëzit, të cilat ua tha Krishti apostujve¹ pasi i dëgjoi prej Atit;⁶⁷ ndërsa Krijesa e huaj të këndon ty të bekuarin duke u familjarizuar me ty.⁶⁴

Imbushe apostujt me Dritën që lëshove, e cila është e vetëndritshme, shpëtimtare, dritëdhënëse, që vjen me vullnet të lirë si frymë e nderuar; jepna edhe neve, shërbëtorëve të tu, Shpirtin të cilit i lutemi.

O Mbret, goja e profetëve, mbushur me shpirt, këndoi për ardhjen tënde trupërisht; dhe, si e dërgove Shpirtin që del¹ nga gjiri atëror⁶⁸ dhe që është i pakrijuar, bashkëbërës dhe i bashkëfronshëm me ty, u mësove besëmirëve adhurimin e trupëzimit tënd.

Zbritësore: Áflekto pirí en Siná dhe Lii ta dhesmá

Ferra në Sina që nuk digjej.

dhe

Një simbolizim trindriqës.

Ode IX

Irmosi: Mi tis fthoras dhiapira

»Ti, pa përvojën e prishjes, shtatzënë
»ishe pra* dhe tërëmjeshtrit Zot,⁶⁹ Fjalë,
»si borxh i dhe trup, nën* pa burrë, o
»Perëndilindëse e virgjër;* je en' e të
»panxënshmit dhe vend i të pafundit Bë-
»rës tëndit; të madhështojmë ne. (2x)

Mbi një karrocë që vlonte prej zjarrit
ngjitej lart* i frymëzjarri Ilia⁷⁰ plot zell⁷¹
me gaz dikur* dhe shfaqte frymën që
nga sipër mbi apostujt* tash shndriti
dhe ata, si u feksën nga ajo, Triadhën e
mësuan te gjithë ne.

Një gjë e huaj, tej ligjeve të natyrës son',*
dëgjohej se me një gjuhë flasin apostujt
pra;* veçse, me Hir nga Shpirti, ndryshe e
dëgjonin* mjaft kombe, fise, gjuhë⁷² dhe
mistikisht i njihnin madhështit' hyjnore të
Shën Trinis'.

Irmosi tjetër: Heris ánasa

»Ki gaz, lavd nënor-virgjëror, mbretëre-
»shë;* gjuhë oratorësh, të aftë në fjalë,*
»nuk mund denjësisht të të psalin siç
»duhet; çdo mendje* trulloset kur s'e
»kap* lindjen tënde, s'e koncepton,* ndaj
»me një zë ne të lëvdojmë ty. (2x)

Vajzës jetëprurëse duhet t'i psalim* se
përbrenda mitrës vetëm kjo e fshehu* Zot
Fjalën, shërues të natyrës sonë* mjaft të
sëmurë pra;* në të djathtën e Atit tash*
rri³² edhe dërgoi Hir shpirtëror.¹

Sa na fryu Hiri hyjrrjedhës,²³ ne jemi*
transformuar bukur në mënyr' të huaj,*
shkëlqejm' e lëvdojmë esencën e urtë*

trevezulluese,* që e njohim pa ndarje
hiç* dhe të barabartë në forc' e lavd.

*Zbritësore: Mi tis fthoras dhiapira dhe
Heris ánasa*

Ti, pa përvojën e prishjes.

dhe

Ki gaz, lavd nënor-virgjëror.

Dërgimësore: O uranón tis astris

O Shpirt i Tërëshenjtë* që del nga Ati
dhe, përmes* Birit, erdhe tek apostujt*¹
e pashkolluar, Nxënësit,*¹⁴ krejt sa të
njohin si Zot ty,* shpëtoji dhe shenjtëroji.
(2x)

Është dritë Ati,³⁷ dritë* dhe Fjala,⁷³ dritë
Shpirti Shenjtë* i dërguar mbi apostujt*
në gjuhë zjarri dhe me të* planeti mbarë
ndriçohet* të adhuroj' Shën Trininë.

6 Lavdërime Idhiomele

Ting. IV

Tërë kombet panë gjëra paradoksale
sot në qytetin e Davidit, kur zbreti Shpirti
i Shenjtë në formë gjuhësh të zjarra;
sepse tha hyjfolësi Lluka: Kur Nxënësit e
Krishtit ishin mbledhur, u bë një zë si një
erë e vullshme dhe e mbushi shtëpinë ku
po rrinin; dhe të gjithë filluan të flisnin
me fjalë të huaja, me dogma të huaja,
me mësimë të huaja të Trinisë së Shenjtë.
(2x)

Shpirti i Shenjtë ka qenë përherë, është
dhe do të jetë, meqenëse as filloi dhe
as do të pushojë, por është gjithmonë i
bashkërenditur dhe numërohet bashkë
me Atin dhe Birin. Është jetë dhe jetëbë-
rës; dritë dhe dritëdhënës; i vetëmirë dhe
burimi i mirësisë; me anën e tij njihet Ati
dhe lavdërohet Biri dhe bëhet i njohur nga
të gjithë si Një fuqi, Një bashkëradhitje,

Një adhurim i Trinisë së Shenjtë. (2x)

Shpirti i shenjtë është dritë, jetë dhe burim i gjallë mendor, Shpirt urtësie,⁵¹ Shpirt mençurie,⁷⁴ i mirë,⁵⁰ i drejtë,²⁰ mendor, hegjemon,⁷⁵ pastrues shkeljesh, Perëndi dhe perëndibërës, zjarr që del prej zjarrit, folës, energjik, ndarësi i karizmave.⁷⁶ Nëpërmjet tij u kurorëzuan mbarë profetët dhe apostujt e Perëndisë bashkë me martirët. Dëgjim i huaj! Pamje e huaj! Zjarr që ndahet në ndarje karizmash. (2x)

Lavdi *dhe* Tani *Ting. Tërth. II*

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirti i së vërtetës,¹⁶ që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete, eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i mirë, shpirtrat tanë.*

Dhoksologjia e Madhe

*Në Liturgji, Antifonet:
Antifoni i parë*

Varg a): Qiejt tregojnë lavdi Perëndie dhe bërjen e duarve të tij e njofton kupa qiellore.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg b): Një ditë i thotë ditës tjetër fjalë dhe një natë i njofton natës tjetër njohuri.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg c): S'ka thënie, as fjalë që zërat e të cilëve nuk dëgjohen.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Varg d): Në gjithë dheun doli zëri i tij dhe në skajet e botës fjalët e tij.

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Lavdi *dhe* Tani

Me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Antifoni i dyti

Varg a): Të dëgjoftë Zoti në ditë shtrëngimi, të mbroftë emri i Perëndisë së Jakovit.

Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të psalim Aliluia.

Varg b): Të dërgoftë ndihmë nga shenjtëtorja dhe të përkrahtë nga Sion.

Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të psalim Aliluia.

Varg c): E kujtoftë çdo therore tënden dhe holokaustin tënd e bëftë të majmë.

Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë, ne që të psalim Aliluia.

Lavdi *dhe* Tani

O i vetëmlindur Bir.

Antifoni i tretë

Varg a): O Zot, me fuqinë tënde do të dëfrehet mbreti dhe me shpëtimin tënd do të ngazëllohet shumë.

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë.

Varg b): Dëshirën e zemrës së tij ia dhe, edhe vullnetin e buzëve të tij nuk ia shterove.

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë.

Varg c): Sepse e arrite atë në bekime mirësie, vure mbi kryet e tij kurorë prej guri të çmuar.

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë.

Varg d): Të kërkoi jetë edhe i dhe ditë të gjata në jetë të jetës.

I bekuar je, o Krisht, Perëndia ynë.

Hyrtore: Lartësohu, o Zot, me fuqinë tën-

de, do t'i këndojmë e do t'i psalim fuqitë e tua. Shpëtona, o Ngushëllimtar i mirë...

Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi. Në vend të Trishenjtë, Sa u pagëzuat. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX Ti, pa përvojën e prishjes. *Kungatore* Shpirti yt i mirë do të më udhëheqë në dhe të drejtë. Aliluia. *Në vend të Pamë dritën, Përlëshorja. Përlëshim:* Ai që e dërgoi prej qiellit në formë gjuhësh të zjarra Shpirtin e Tërshenjtë mbi Nxënësit dhe apostujt e tij të shenjtë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...



TË HËNËN PAS PENTIKOSTISË
(E SHPIRTIT TË SHENJTË)
TË DIELËN NË MBRËMËSORE

Pas Psalmit Nistor, Paqësoret:

Me paqe le t' i lutemi Zotit.

Për paqen që lartazi⁷⁷ dhe për shpëtimin e shpirttrave tanë, le t' i lutemi Zotit.

Për paqen e tërë botës, qëndrimin e mirë të Kishave⁷⁸ të shenjtë të Perëndisë, dhe për bashkimin e të gjithëve, le t' i lutemi Zotit.

Për kryepiskopin tonë (*aksh*), të nderuarën presviteri dhe dhiakonatën më Krishtin, për tërë klerin dhe popullin, le t' i lutemi Zotit.

Për popullin që rri rrotull dhe pret Hirin e Shpirtit të Shenjtë, le t' i lutemi Zotit.

Për ata që i ulin zemrat⁷⁹ dhe gjunjët e tyre para Zotit, le t' i lutemi Zotit.

Që të forcohemi për ta plotësuar pëlqimin, le t' i lutemi Zotit.

Që të na dërgohen pasurisht mëshirat e tij, le t' i lutemi Zotit.

Që të pranohet gjunjëzimi ynë si temjan para tij, le t' i lutemi Zotit.

Për ata që kanë nevojë për ndihmën e tij, le t' i lutemi Zotit.

Që të shpëtojmë prej çdo hidhërimi, zemërimi, rreziku dhe nevoje, le t' i lutemi Zotit.

Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruana, o Perëndi, me hirin tënd.

Të Tërshenjtën, të pacenuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën, Zonjën tonë Hyj lindëse dhe Gjithmonëvirgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit, Perëndisë, le t' ia parashtrojmë.

Se ty të përket tërë lavdia, nderimi dhe adhurimi, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pa Psaltir: 6 Thirrtores Idhiomele Ting. IV
Tërë kombet panë gjëra paradoksale sot në qytetin e Davidit, kur zbriti Shpirti i Shenjtë si në formë gjuhësh të zjarra; sepse tha hyjfolësi Lluka: Kur Nxënësit e Krishtit ishin mbledhur, u bë një zë si një erë e vullshme dhe e mbushi shtëpinë ku po rrinin; dhe të gjithë filluan të flisnin me fjalë të huaja, me dogma të huaja, me mësim të huaja të Trinisë së Shenjtë. (2x)

Shpirti i Shenjtë ka qenë përherë, është dhe do të jetë, meqenëse as filloi dhe as do të pushojë, por është gjithmonë i bashkërenditur dhe numërohet bashkë me Atin dhe Birin. Është jetë dhe jetëbërës; dritë dhe dritëdhënës; i vetëmirë dhe burimi i mirësisë; me anën e tij njihet Ati dhe lavdërohet Biri dhe

bëhet i njohur nga të gjithë si Një fuqi, Një bashkëradhitje, Një adhurim i Trinisë së shenjtë. (2x)

Shpirti i Shenjtë është dritë, jetë dhe burim i gjallë mendor, Shpirt urtësie,⁵¹ Shpirt mençurie,⁷⁴ i mirë,⁵⁰ i drejtë,²⁰ mendor, hegjemon,⁷⁵ pastrues shkeljesh, Perëndi dhe perëndibërës, zjarr që del prej zjarrit, folës, energjik, ndarësi i karizmave.⁷⁶ Nëpërmjet tij u kurorëzuan mbarë profetët dhe apostujt e Perëndisë bashkë me martirët. Dëgjim i huaj! Pamje e huaj! Zjarr që ndahet në ndarje karizmash. (2x)

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. II*

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, Shpirti i së vërtetës,¹⁶ që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe dhurues jete, eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë dhe shpëto, o i mirë, shpirtrat tanë.*

Hyrje. Proqimeni i Madh:

Ting. i Rëndë

Cili Perëndi, është kaq i madh sa Perëndia ynë. Ti je Perëndi i vetëm që bën çudira.

Varg a): Ua bëre të njohur popujve fuqinë tënde.

Cili Perëndi.

Varg b): Dhe thashë: Tani fillova, ky ndryshim është i së dhathtës së të Shumëlartit.

Cili Perëndi.

Varg c): I kujtova veprat e Zotit se do t'i kujtoj nga fillimi të çuditshmet e tua.

Cili Perëndi.

Menjëherë dhjaku (ose prifti, nëse s'ka dhjak):

Përsëri dhe përsëri, pasi t'i ulim gjunjët, le t'i lutemi Zotit.

Prifti (i gjunjëzuar në Derën e Bukur drejt perëndimit si dhe gjatë leximeve të Uratave të tjera):

O Zot i pacen, i papikëluar, i pafillim, i padukshëm, i pakonceptueshëm, i pagjurmësuar, i pandryshuar, i pakapërcyeshëm, i pafund, që nuk mban mëri, i vetmi që ke pavdekësi, që banon në dritë të paafrueshme,⁸⁰ që bëre qiellin dhe tokën, dhe detin dhe të gjitha krijesat në to,⁸¹ ti që ua plotëson të gjithëve kërkesat para se t'i kërkojnë,⁸² të lutemi dhe të përgjërohemi, o Zot njeridashës, Ati i Zotit dhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht që, për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiejve dhe u mishërua nga Shpirti i Shenjtë dhe Maria⁸³ gjithmonë e virgjër, Hyjlindëse e lavdëruar; ai, pasi më përpara na mësonte me fjalë dhe, më pas, e shfaqte dhe me vepra, kur pësonte pësimin shpëtimtar, na dha shembull neve, shërbëtorëve të tu të përlulur dhe të padenjë, që të ofrojmë lutje duke përkulur qafën dhe gjunjët⁸⁴ për mëkatet tona dhe për mëkatet e popullit që i bëri nga padija. Ti pra, o i shumëmëshirshëm dhe njeridashës, dëgjona në ditën që do të të thërrasim⁸⁵ dhe, kryesisht, në këtë ditë të Pentikostisë, kur, pasi Zoti ynë Jisu Krisht u ngjit në qiej dhe u ul në të dhathtën tënde, të Perëndisë dhe Atit,⁴⁹ dërgoi Shpirtin e Shenjtë mbi Nxënësit dhe apostujt e tij të shenjtë,¹ i cili u ul mbi çdo njërin prej tyre dhe u mbushën të gjithë me Hirin e tij të pasosur, dhe i thanë në gjuhë të tjera madhështitë e tua, dhe profetizuan. Prandaj, dëgjona tani ne që po të lutemi dhe kujtona ne të përlulurit dhe të dënuarit dhe çliroji

shpirtrat tanë nga robëria,⁸⁶ meqë e ke si ndërmjetëse për ne dhembshurinë tënde. Pranona ne që kemi rënë në gjunjë para teje dhe thërrasim: “Mëkatuam!”. Para teje kemi rënë që nga mitra, ti je Perëndia ynë që nga barku i nënës sonë,⁸⁷ veçse, përderisa ditët tona mbaruan në kotësi,⁸⁸ u privuam nga ndihma jote, shteruam nga çdo apologji. Por, duke pasur guxim në dhembshuritë e tua, thërrasim: “Mos i kujto mëkatet e rinisë dhe të paditurisë sonë⁸⁹ dhe pastrona nga të fshehtat tona.⁹⁰ Mos na shpërfill në kohën e pleqërisë, kur fuqia jonë do të shterohet, mos na braktis,⁹¹ para se të kthehemi te dheu,⁹² denjësona të kthehemi te ti⁹² dhe kujdesu për ne me mirëkuptim dhe hir. Shikoji paligjësitë tona me dhembshuritë e tua; vendose avushën e dhembshurisë sate përballë shumicës së paudhësive tona. Shtjere syrin tënd nga lartësia jote e shenjtë⁹³ mbi popullin tënd që është përreth dhe po pret mëshirën tënde të pasur. Vizitona me mirësinë tënde, çlirona nga shtypja e djallit, siguron jetën me ligjet e tua të shenjta dhe hyjnore, besoja popullin tënd engjëllit ruajtës besnik, mblidhna të gjithë në mbretërinë tënde, jepu ndjesë atyre që besojnë te ti, falua mëkatet atyre dhe neve, pastrona me energjinë e Shpirtit tënd të Shenjtë, shfatosi dredhitë e armikut kundër nesh”.

Dhe bashkëngjit këtë uratë:

I bekuar je, o Zot, kryemjeshtër i tërë-fuqishëm, që e ndriçove ditën me dritën diellore dhe e hijesove natën me llamburitjet e zjarrit; ti që na denjësove ta kalojmë kohën e ditës dhe t'i afrohemi fillimit të natës, dëgjoje lutjen tonë dhe të mbarë popullit tënd dhe, si të na i ndjesh gjithë neve mëkatet me dashje

dhe pa dashje, pranoji përgjërimet tona të mbrëmjes dhe dërgoje shumicën e mëshirës sate dhe të dhembshurive të tua⁹⁴ mbi trashëgimin tënd. Rrethona me engjëjt e tu të shenjtë, armatosna me armët e drejtësisë sate,⁹⁵ fortifikona me të vërtetën tënde, ruana me fuqinë tënde, çlirona nga çdo peripeci dhe çdo komplot i kundërshtarit. Dhe na e jep edhe këtë mbrëmje bashkë me natën që po vjen, të përsosur, të shenjtë, të paqme, pa mëkat, pa skandal, pa fantazi, po ashtu dhe të gjitha ditët e jetës sonë, me ndërmjetimet e Perëndilindëses së shenjtë dhe të mbarë shenjtoreve që të kanë pëlqyer që nga jeta.

Dhjaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruana, o Perëndi me hirin tënd.

Të Tërëshenjtën, të pacenuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjlindëse dhe Gjithmonëvirgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtorët, duke e kujtuar veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit, Perëndisë, le t'ia parashetrojmë.

Prifti: Se ti e ke në dorë të na mëshirosh dhe të na shpëtosh, o Krisht, Perëndia ynë, dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Lutjen e gjatë (Ektenis):

Le të themi të gjithë...

Prifti: Se ti je Perëndi mëshirues dhe njeridashës dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Dhjaku: Përsëri dhe përsëri, pasi t'i ulim gjunjët, le t'i lutemi Zotit.

Prifti: O Jisu Krisht, Perëndia ynë, ua

dhe njerëzve paqen tënde⁹⁶ dhe kur ishe akoma në jetë dhe me ne, na e dhe neve besimtarëve përgjithmonë dhuratën e Shpirtit të Tërshenjtë,¹ si trashëgimi që nuk humbet, madje ua dërgove sot më qartë këtë Hir Nxënësve të tu, apostujve, dhe i aftësove buzët e tyre me gjuhë të zjarra, me anë të tyre ne, çdo gjini e njerëzve, e pranua duke e dëgjuar me veshët tanë⁹⁷ hyjnohurinë veças, në dialekte në ndryshme, dhe u ndriçua me dritën e Shpirtit, dhe u çlirua nga mashtrimi, si nga terri, dhe, me shpërndarjen dhe energjinë mbinatyrore të gjuhëve të zjarra dhe të ndjeshme, e mësua besimin te ti dhe u ndriçua që të theologojmë ty tok me Atin dhe Shpirtin e Shenjtë në Një Hyjni, fuqi dhe pushtet. Pra ti, reflektimi i Atit, karakteri i palëvizshëm dhe i pandryshuar i esencës dhe natyrës së tij,⁹⁸ burimi i shpëtimit dhe i Hirit, m'i hap buzët dhe mua mëkatarit dhe mësomë si duhet dhe për çfarë duhet të lutem,⁹⁹ sepse ti e di shumicën e madhe të shkeljeve të mia; mirëpo, dhembshuria jote le ta mundë pafundësinë e tyre, sepse ja ku po qëndroj pranë teje me frikë pasi e hodha dëshpërimin e shpirtit tim në detin e mëshirës sate. Ma qeveris jetën, ti që qeveris fuqishëm tërë Krijesën me fjalën e urtësisë sate të parrëfyeshme, limani i qetë i të dimëruarve. Më trego udhën ku duhet të eci.¹⁰⁰ Jepu mendimeve të mia Shpirtin e urtësisë sate, dhuroji Shpirtin e mençurisë marrëzisë sime. Hijesoji veprat e mia me Shpirtin e frikës sate.⁷⁴ Përtërte Shpirtin e drejtë thellë brenda meje.²⁰ Dhe me Shpirtin sundues mbështete⁷⁵ lëkundjen e mendjes sime, që të denjësohem t'i bëj porositë e tua çdo ditë, i udhëhequr drejt së mirës prej Shpirtit tënd të mirë⁵⁰ dhe të kujtoj

përherë ardhjen tënde të lavdëruar, e cila do t'i hulumtojë veprat tona.¹⁰¹ Dhe mos më lër të mashtrohem nga gjërat e pëlqyeshme dhe të prishshme të botës, por ma forco dëshirën për të shijuar thesaret e ardhshme, sepse ti, o Zot, ke thënë se çfarëdo që të kërkojë dikush në emrin tënd, do ta marrë pa pengesë prej Atit tënd¹⁰² dhe Perëndisë së bashkamshuar. Ndaj dhe unë mëkatar i tani, në zbritjen e Shpirtit tënd të Shenjtë, i përgjerohem mirësisë sate: M'i jep për shpëtim ato për të cilat t'u luta.¹⁰³ Po, o Zot, dhënësi i mirë i çdo mirëbërjeje në mënyrë të pasur, sepse ti jep shumë më tepër nga sa kërkojmë.¹⁰⁴ Ti je i dhembshur, përdëllyes, ti more pjesë, pa mëkat, në trupin tonë¹⁰⁵ dhe u përkulesh me dhembshuri atyre që ulin gjunjët para teje dhe je i butë ndaj mëkateve tona.⁵⁷ Ndajjepi, o Zot, popullit tënd dhembshuritë e tua, dëgjona nga qielli yt i shenjtë.¹⁰⁶ Shenjtëroji me fuqinë e së djathtës sate shpëtimtare, mbuloji nën strehën e kraheve të tu,¹⁰⁷ mos i shpërfill punët e duarve të tua.¹⁰⁸ Kemi mëkatuar vetëm ndaj teje, mirëpo të adhurojmë vetëm ty, nuk dimë t'i falemi ndonjë perëndie të huaj, as t'i ngremë duart tona drejt një perëndie tjetër, o Zot.¹⁰⁹ Fali fajet tona dhe, pasi t'i pranosh lutjet tona me gjunjëzim, na zgjat të gjithëve një dorë ndihmë. Pranoje lutjen e të gjithëve si temjam¹¹⁰ të mirëpritur që pranohet lart, para mbretërisë sate të përmbimëre.

Dhe bashkëngjit këtë uratë:

O Zot, o Zot, që na çlirove nga çdo shigjetë që hidhet ditën, çlirona dhe nga çdo gjë që ecën në errësirë.¹¹¹ Pranoji si therore mbrëmësore ngritjet e duarve tona.¹¹⁰ Denjësona ta kalojmë

pa qortim stadiumin e natës pa u ngarë prej të këqijave dhe çlirona nga çdo trazirë dhe frikë që na bëhet nga djalli. Dhuroju kataniks shpitrave tanë dhe kujdes mendimeve tona për hulumtimin gjatë gjykimit tënd të tmerrshëm dhe të drejtë.¹⁰¹ Nguli mishrat tanë në frikën tënde¹¹² dhe vriti gjymtyrët tona të mbidheshme,¹¹³ që të ngazëllohem dhe në qetësinë e gjumit, me kujtimin e gjykimeve të tua. Dhe largo nga ne çdo fantazi të papërshtatshme dhe dëshirë të dëmshme. Dhe na ngri në kohën e lutjes, të mbështetur në besë dhe të përparuar në porositë e tua.

Dhjaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruana, o Perëndi, me hirin tënd.

Të Tërëshenjtën, të pacenuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyjllindëse dhe Gjithmonëvirgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit, Perëndisë, le t'ia parashtojme.

Prifti: Me mirëdashjen dhe Hirin e Birit tënd të vetëmlindur, me të cilin je i bekuar bashkë me Shpirtin tënd të Tërëshenjtë, të mirë dhe jetëbërës, tani e përherë e në jetët e jetëve.

Pastaj Bëna të denjë, o Zot...

Dhjaku: Përsëri dhe përsëri, pasi t'i ulim gjunjët, le t'i lutemi Zotit.

Prifti: O Krisht, Perëndia ynë, je burimi ndriçues dhe jetësor, që gufon përherë, je fuqia e bashkamshuar dhe krijuese e Atit; ti e përmbushe tejet bukur gjithë Ekonominë³³ për shpëtimin e njerëzve; i theve kyçet e mbyllura të vdekjes dhe shulat e Hadhit dhe i shkele shumicat e frymëve të liga; e ofrove për ne veten tënde si fli të patëmetë duke dhënë për

theror trupin e pacen, të pashkelur dhe të paprekur nga çdo mëkat¹¹⁴ dhe na dhurove jetën e amshuar me anë të këtij celebrimi të frikshëm dhe të parrefyeshëm. Zbrite në Hadh,¹¹⁵ i dërmive shulat e përjetshëm¹¹⁶ dhe u tregove ngjitjen atyre që rrinin poshtë, ndërsa dragoin¹¹⁷ e thellë, nismëtarin e së keqes, e kape me grepin, me karremin e hyjurtë dhe e lidhe me zinxhirët e territ në skëterrë,¹¹⁸ në zjarrin e pashuar¹¹⁹ dhe errësirën e jashtme shumë¹²⁰ dhe e sigurove krejtësisht me forcën tënde të pafund. O urtësi e famshme e Atit,¹²¹ që u tregove ndihmëtar i madh për ata që përndiqen dhe i ndriçoje ata që rrinin në errësirën dhe hijen e vdekjes.¹²² O Zot i lavdisë¹²³ së vazhdueshme, Bir i dashur i Atit¹²⁴ të tërëllartë, Dritë⁷³ e amshuar nga Drita³⁷ e amshuar, Diell i drejtësisë,¹²⁵ dëgjona ne që po të lutemi dhe prehi shpirtat e shërbëtorëve të tu, të etërve, vëllezërve tanë, të afërmeve të tjerë biologjikë dhe të gjithë familjarëve në besë,¹²⁶ kujtimin e të cilëve po e bëjmë tani, se ti e ke pushtetin e të gjithave dhe në dorën tënde i mban fort mbarë anët e dheut.¹²⁷ O Zot i tërëpushtetshëm, Perëndi i etërve dhe Zot i mëshirës,¹²⁸ krijues i gjinisë së vdekshme dhe të pavdekshme dhe i gjithë natyrës njerëzore që bëhet dhe pastaj shpërbëhet, Zot i jetës dhe i vdekjes, i jetesës këtu dhe i zhvendosjes atje, që numëron vitet e të gjallëve dhe vendos kohën e vdekjes, që na zbret në Hadh dhe na ngjit,¹²⁹ që na lidh me sëmundje dhe na çliron me fuqi, që i rregullon dobishëm të pranishmet dhe qeveris mirë të ardhshmet, dhe që i gjallëron me shpresën e ngjalljes¹³⁰ të goditurit nga thumbi i vdekjes,¹³¹ ti pra, o Zot i të gjithave, o Perëndi, o Shpëtimtari

ynë, je shpresë e gjithë anëve të dheut dhe e atyre që ndodhën larg në det¹³² dhe në këtë ditë të fundme, të madhe dhe shpëtimtare, të Pentikostisë, na e tregove disi misterin e Trinisë së Shenjtë, të njëqenshme, të bashkamshuar, të pandashme dhe të pangatërrueshme, si edhe përmbiardhjen dhe praninë e Shpirtit tënd të shenjtë dhe jetëbërës në formë gjuhësh të zjarra dhe e hodhe mbi apostujt e tu të shenjtë dhe i vendose si ungjillorë të besës sonë të mirë dhe i shfaqe omologjetë dhe predikues të thelogjisë së vërtetë dhe në këtë të kremte të tërëpërsosur dhe shpëtimtare denjove të pranosh përgjërime për falje për hir të atyre që mbahen në Hadh dhe na jep shpresa të mëdha që do t'u dërgosh lehtësim të burgosurve nga mërzitjet që i pushtojnë. Ti, pra, dëgjona ne të përlulit dhe të mjerët që të lutemi, dhe shpirtrat e shërbëtorëve të tu të parafjetur prehi në vend të ndritshëm, në vend të blertë, në vend freskie, nga ka ikur çdo dhimbje, hidhërim dhe psherëtimë;¹³³ dhe renditi shpirtrat e tyre në tendat e të drejtëve¹³⁴ dhe denjësoji për paqe dhe lehtësim; sepse nuk do të të himnojnë të vdekurit, o Zot, as ata që janë në Hadh nuk do të kenë guxim të të ofrojnë lavdërim, por ne të gjallët të bekojmë¹³⁵ dhe të lypim dhe të ofrojmë lutje për falje dhe fli për hir të shpirtrave të tyre.

Dhe bashkëngjit këtë uratë:

O Perëndi i madh¹³⁶ dhe i amshuar, i shenjtë dhe njeridashës, që na denjësove të qëndrojmë edhe në këtë orë para lavdisë sate të paafrueshme për himnim dhe lavdërim të të çuditshmeve të tua,¹³⁷ le të të vijë keq për ne, shërbyesit e tu të padenjë, dhe na jep hir që të të

ofrojmë pa u shpërqendruar, me zemër të dërrmuar dhoksologjinë trishenjtoje¹³⁸ dhe falënderimin e dhuratave të tua të mëdha që na bëre dhe na bën gjithmonë. Kujtoje, o Zot, dobësinë tonë dhe mos na lër të humbasim për shkak të paudhësive tona, por bëje të madh përdëllimin¹³⁸ për përluljen tonë, që, pasi të arratisemi nga errësira e mëkatit, të ecim në ditë drejtësie dhe, pasi të veshim armët e dritës,¹³⁹ të jemi pa intriga, larg komplotit të të ligut dhe të të lëvdojmë me guxim për të gjitha ty, të vetmin të vërtetë dhe njeridashës Perëndi; sepse, me të vërtetë, është i madh misteri yt, o Zot dhe Bërës i të gjithave,¹⁴⁰ edhe shpërbërja provizore e krijesave të tua si edhe bashkimi i më-passhëm dhe prehja në jetë. E shpallim hirin tënd për të gjitha, për hyrjet në këtë botë dhe për daljet tona,¹⁴¹ që u japin garanci shpresave tona për ngjalljen dhe jetën pa të këqija, për shkak të premtimit tënd të vërtetë. Le t'i shijojmë në ardhjen tënde të dytë, të ardhshme, sepse ti je kryetari i ngjalljes sonë dhe gjykatës njeridashës që s'merr ryshfet, o Zot që shpërblen ato që bëjmë në jetë, që more pjesë në mish dhe gjak, pothuajse si ne,¹⁴⁵ nga bashkëzbritja e skajshme dhe kishe eksperiencë vullnetarisht nga pasionet tona të paakuzuara, meqë kishe dhembshuri të thellë,¹⁴² dhe, përderisa u sprovove vetë ti nga ngasjet, u bëre ndihmëtar i vetëquajtur i atyre që ngacmohen.¹⁴³ Prandaj na mblodhe të gjithë në papasionshmërinë tënde. Ndaj, o Zot, pranoi lutjet dhe përgjërimet tona dhe prehi mbarë etërit, nënat, vëllezërit, motrat dhe fëmijët e çdokujt dhe cilindo tjetër njëfarësh dhe njëfisnor me ne dhe të gjithë shpirtrat e parafjetur me shpresën e ngjalljes për jetën e amshuar.¹³⁰ Dhe

radhiti shpirtrat dhe emrat e tyre në librin e jetës,¹⁴⁴ në gjirin e Abrahamit,¹⁴⁵ Isaakut dhe Jakovit, në vendin e të gjallëve,¹⁴⁶ në mbretërinë e qiejve,¹⁴⁷ në Parajsën e shijimit,¹⁴⁸ duke i futur të gjithë në banesat e tua¹⁴⁹ të shenjta nëpërmjet engjëjve të tu të ndritshëm; ngriji edhe trupat tanë në ditën që caktove sipas premtimeve të tua të shenjta dhe të vërteta. Pra, o Zot, s'ka vdekje për shërbëtorët e tu, kur mërgojmë nga trupi dhe emigrojmë drejt teje, Perëndisë, por zhvendosje nga më të trishtuarat drejt më të mirave dhe më të pëlqyerave, është prehje dhe hare. Dhe, nëse kemi mëkatuar disi ndaj teje, bëhu i butë për ne dhe për ata, sepse askush s'është i panjollë para teje, qoftë jeta e tij sikur edhe një ditë,¹⁵⁰ veçse ti je i vetmi që u shfaqe mbi tokë si i pamëkatshëm, o Zoti ynë Jisu Krisht;¹¹⁴ nëpërmjet teje të gjithë shpresojmë të gjejmë mëshirë dhe falje mëkatesh. Ndaj, si Perëndi i mirë dhe njeridashës dhe për ne, dhe për ata, lëri, fali shkeljet tona me dashje dhe pa dashje, me dije dhe pa dije, të dukshme dhe të fshehta, me punë a me mendje a me fjalë në të gjitha komunikimet dhe lëvizjet; dhe të mëparshmëve dhuroju çlirim dhe lehtësim, ndërsa ne që jemi përqark, na beko dhe na jep neve dhe mbarë popullit tënd mbarim të mirë dhe me paqe, duke na dhuruar neve dhe gjithë popullin tënd dhembshuri të thellë¹⁵¹ dhe njeridashje gjatë ardhjes sate të frikshme dhe të tmerrshme; dhe bëna të denjë për mbretërinë tënde.

Dhe bashkëngjit këtë uratë:

O Perëndi i madh¹³⁶ dhe i tërëllartë, i vetmi që ke pavdekësi, që banon në dritë të paafrueshme,⁸⁰ që e bëre tërë Krijesën me urtësi,¹⁵² që bëre ndarje midis dritës

dhe errësirës dhe e vure diellin mbi pushtetin e ditës, ndërsa hënën dhe yjet në pushtetin e natës,¹⁵³ që na denjësove në mëkatarët dhe në këtë ditë, që të arrijmë para fytyrës sate me lavdërim¹⁵⁴ dhe të të ofrojmë adhurimin mbrëmësor, pra ti, o Zot njeridashës, drejtoje lutjen tonë si temjan para teje¹¹⁰ dhe pranoje si erë të këndshme.¹⁵⁵ Dhe na e jep të qetë këtë mbrëmje dhe natën që po vjen; vishna armët e dritës;¹³⁹ çlirona prej frikës së natës dhe prej çdo gjëje që lëviz në terr;¹¹¹ dhe gjumin që na e dhurove për prehjen e dobësisë sonë, na e fal të çliruar nga çdo fantazi e djallit. Po, o Zot i të gjithave,¹⁴⁰ dhënës i të mirave, lypim që, edhe në krevatet tona, ta kujtojmë me kataniks edhe natën emrin tënd të tërëshenjtë dhe, duke shndritur me mendimin e thellë të porosive të tua, të ngrihemi me ngazëllim shpirti për lavdërimin e mirësisë sate duke i sjellë lutje dhe përgjërime dhembshurisë sate për mëkatet tona dhe të mbarë popullit tënd, të cilin vizitoje me përdëllim përmes ndërmjetimeve të Perëndilindëses së shenjtë.

Dhjaku: Përkrahna, shpëtona, mëshirona dhe ruana, o Perëndi, me hirin tënd.

Të Tërëshenjtën, të pacenuarën, të përmbibekuarën, të lavdëruarën Zonjën tonë Hyllindëse dhe Gjithmonëvirgjërën Mari, bashkë me gjithë shenjtoret, duke e kujtuar, veten tonë dhe njëri-tjetrin dhe gjithë jetën tonë, Krishtit, Perëndisë, le t'ia parashtojme.

Prifti: Se ti je prehja e shpirtrave dhe e trupave tanë dhe ty ta drejtojmë lavdinë, Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Dhiaku: Le ta plotësojmë lutjen tonë të mbrëmjes ndaj Zotit.

Dhe të gjitha të tjerat si zakonisht.

Pasvargje Idhiomele Ting. III

Tani gjuhët u bënë dukshëm si shenjë për të gjithë, sepse judenjtë, nga doli Krishti sipas trupit,¹⁵⁶ pasi u sëmurën prej mosbesimit, ranë nga Hiri Hyjnor dhe u denjësuam për dritën hyjnore ne që jemi nga kombet, meqë u mbështetëm në fjalët e Nxënësve që shprehnin lavdinë e Perëndisë, mirëbërësit të të gjithave; së bashku me ta, pasi t'i ulim zemrat bashkë me gjunjët, le t'i falemi besërisht Shpëtimtarit të shpirtave tanë, duke u mbështetur prej Shpirtit të Shenjtë.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Tani Shpirti Ngushëllimtar u derdh në çdo trup,²³ sepse, pasi filloi nga kori i apostujve, prej tyre, me pjesëmarrje, e shtriu Hirin mbi besnikët dhe e vërteton zbritjen e tij të fuqishme duke shpërndarë te Nxënësit gjuhët në pamje të zjarrtë për himnodinë dhe lavdinë e Perëndisë. Prandaj, të ndriçuar në mendje e në zemër dhe të mbështetur në besë me anë të Shpirtit të Shenjtë, përgjërohemi të shpëtohen shpirtat tanë.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Apostujt e Krishtit tani vishen me pushet nga sipër,³⁴ sepse Ngushëllimtari i ripërtërit duke iu futur atyre një mënyrë të re me një njohje të re mistike. Duke e predikuar me zëra të huaj dhe lartfolës, na mësojnë ta adhurojmë natyrën e amshuar, të thjeshtë dhe trihipostate të Perëndisë, mirëbërësit të të gjithave; prandaj, të ndriçuar nëpërmjet mësim-

dhënieve të tyre, le t'i falemi Atit bashkë me Birin dhe Shpirtin, duke iu lypur t'i shpëtojnë shpirtat tanë.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. IV

Ejani, o popuj, t'i falemi Hyjnisë trihipostate, Birit në Atë¹⁰ bashkë me Shpirtin e Shenjtë; sepse Ati e lindi pa kohë Birin e bashkamshuar dhe të bashkëfronshëm dhe Shpirti i Shenjtë ishte me Atin duke u lavdëruar tok me Birin; Një fuqi, Një esencë, një Hyjni, së cilës i falemi të gjithë duke thënë: Shenjt Perëndi që i bëri të gjitha përmes Birit¹¹ në bashkëpunim me Shpirtin e Shenjtë. Shenjt i fuqishëm, përmes të cilit njohëm Atin¹² dhe erdhi në botë Shpirti i Shenjtë. Shenjt¹³ i pavdekshëm, Shpirti Ngushëllimtar që del prej Atit¹ dhe prehet te Biri. O Trini e Shenjtë, lavdi më ty.

Tani përlëshoje...

Trishenjtë dhe Përlëshorja I bekuar je (3x)

Përlëshim

Ai që e zbraz veten nga gjiri atëror dhe mori plotësisht natyrën tonë, dhe e hyjnizoi atë, dhe pastaj, si u ngjit përsëri në qiej dhe ndenji në të djathtë të Perëndisë dhe Atit, dërgoi Shpirtin hyjnor, të Shenjtë, të bashkëqenshëm, të bashkëfuqishëm, të bashkëlavdishëm, të bashkëpërvjetshëm mbi Nxënësit dhe apostujt e tij të shenjtë, dhe me anën e këtij i ndriçoi ata, dhe me anën e tyre gjithë botën, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të shenjtë, të tërëpacenshme, të tërëpanjollshme, të apostujve të shenjtë, të lavdishëm, të tërëfamshëm dhe hyjpredikues dhe të gjithë shenjtoreve na mëshiroftë dhe na shpëtoftë për hir të mirësisë së tij. Amin.

TË HËNËN E SHPIRTIT TË SHENJTË NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores
Ting. IV Kateplaji Iosif*

Ta festojmë hijesisht* të fundmen, pas-kremtoren dit',* o besnikë, kjo është pra* Pentikostia; u përmbush* afati krejt i premtimit,¹ se menjëher'* zbriti në të, mbi dhe i shenjt i zjarr* i Ngushëllimtarit si mjaft gjuhë* edhe i shndriti Nxënësit, i shfaq* si mistë mbiqiellorë;* e ndriti botën* kur erdhi drita* e Shën Ngushëllimtarit. (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësores E ngjashme*

Erdhi përmbi njerëzit* nga Shpirti kroi i tij pra,* mendërisht u nda veças* si lum' me zjarr, i shndriti nur* apostujt dhe i freskoi, për ta u shfaq si* zjarr, porsi një re që flladiste fort,* flakë me plot dritë që ish si shi;* me ta e morëm ne Hirin e Hyjshëm* nëpërmjet zjarrit dhe ujit,*¹⁸ e ndriti botën,* kur erdhi, drita* e Shën Ngushëllimtarit. (2x)

*Psalmi 50 dhe Kanunet si dje,
por, pas Odes III, Ndenjësores*

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

Me çudi mbushi kombe të ndryshme mjaft* Tërëshenjt i Shpirt kur si zjarr zbriti sot* mbi shenjtët apostuj pra,* njeridashës, se flisnin drejt* me gjuhë zjarri, dhe dialektin e vet çdokush* po e dëgjonte, ndaj mrekullinë e shihnin si* dehje sa s'besonin, si shpëtim besëmirët,* vërtet; dhe prandaj ne po* e lëvdojmë pushtetin tënd* dhe kërkojmë*

të na dërgosh* pasurisht, o Krisht, Perëndi* dhe Çlirimtar, ndjesë fajesh,* se jemi ne* shërbëtorët e tu me shumë devotshmëri. (2x)

*Pas Odes VI
Kontaqi dhe Shtëpia e djeshme*

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Në të njëjtën ditë, të Hënën e Pentikostisë, kremtojmë vetë Shpirtin e Tërëshenjtë, jetëbërës dhe të tërëfuqishëm, Njërin Perëndi të Trinisë, të bashkënderuarin, të bashkëqenshmin dhe të bashkëlavdishmin me Atin dhe Birin.

Vargje: Çdo frymë le të lavdërojë Frymën e Zotit,/ me anën e së cilës u zhdukën arrogancat e frymëve të liga.

Në zbritjen e Shpirtit të Shenjtë, me ndërmjetimet e apostujve të tu, o Krisht Perëndi, mëshirona. Amin.

Dërgimësore: O uranón tis astris

O Shpirt i Tërëshenjtë* që del nga Ati dhe, përmes* Birit, erdhe tek apostujt*¹ e pashkolluar, Nxënësit,*¹⁴ krejt sa të njohin si Zot ty,* shpëtoji dhe shenjtëroji. (2x)

Tjetër

Ësht' dritë Ati,³⁷ dritë* dhe Fjala,⁷³ dritë Shpirti Shenjt* i dërguar mbi apostujt* në gjuhë zjarri dhe me të* planeti mbarë ndriçohet* të adhuroj' Shën Trininë.

6 Lavdërime Idhiomele

Me profetët, na lajmërove udhën e shpëtimit dhe ndër apostujt shkëlqeu Hiri i Shpirtit tënd, o Shpëtimtari ynë; ti je Perëndia i parë, ti je dhe në vazhdim;⁵ dhe, në jetë të jetëve, ti je Perëndia ynë. (2x)

Në avllitë e tua do të të himnoj ty, Shpëtimtarin e botës,⁶ dhe, pasi t'i ul gjunjët, do t'i falem⁷ fuqisë sate të pamposhtur; në mbrëmje dhe në mëngjes dhe në mesditë,⁸ dhe në çdo kohë do të të bekoj, o Zot.⁹ (2x)

Në avllitë e tua, o Zot, pasi t'i ulim gjunjët⁷ e shpirtit dhe të trupit, ne besimtarët të përhimnojmë ty, Atin e pafillim dhe Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e bashkëpërrjetshëm dhe të Tërëshenjtë që i shndrit dhe i shenjtëron shpirtrat tanë. (2x)

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

Dikur, gjuhët u ngatërruan nga arroganca e bërjes së kullës,¹⁷ por tani gjuhët u urtësuan për lavdinë e hyjnohjes. Atje, Perëndia i dënoi ata që u bënë të pabesë nga shkelja, këtu Krishti i ndriçoi peshkatarët me Shpirtin. Atëherë u iku të folurit si ndëshkim, ndërsa tani përtëritet të folurit e përbashkët për shpëtimin e shpirtrave tanë.

Në Liturgji, Antifonet dhe Hyrtorja e së Kremtes. Pas Hyrjes, Përlëshorja dhe Kontaqi. Në vend të Trishenjtit, Sa u pagëzuat. Në vend të Të meriton, Irmosi i Odes IX Ki gaz, lavd nënor-virgjëror. *Kungatore* Shpirti yt i mirë do të më udhëheqë në dhe të drejtë. Aliluia. Pamë dritën. *Përlëshim:* Ai që dërgoi prej qiellit në formë gjuhësh të zjarra Shpirtin e Tërëshenjtë mbi nxënësit dhe apostujt e tij të shenjtë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë,...

Njoftim: Gjatë tërë javës së Pentikostisë së Shenjtë hahen të gjitha.

TË HËNËN E SHPIRTIT TË SHENJTË NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. I Ton uranion tagmaton

Gjuhët po bëhen të reja që t'i rrëfejn' mjaft fort,* si përmes gjuhësh zjarri* dhe me fjalë të tjera,* madhështit' e Zotit që të besojn'* gjithë njerëzit përmbi dhe,* shenjë për kombet vërtet është kjo tani,* se shpëtimi na ka ardhur pra.

Realizove premtimin që u dhe Nxënësve,* se mbi ta do dërgoje* forcë nga lart,³⁴ e bën pra:* Shpirtin tënd të Shenjtë po e dërgon*¹ dhe kështu na u shfaq, o Krisht,* se e vërteta ti je;¹⁵⁷ sa shpresojn' në ty,* s'turpërohen¹⁵⁸ realisht, i mir',

Krisht, kur arriti afati, Ngushëllimtarin tënd,* porsi me gjuhë zjarri,* e dërgon përmbi botë,*¹ që ai t'i djegë me zjarr hyjnor* fajet që kemi gjithë ne* që po e theologojmë me besë plot,* të na jap' kontakt real me të.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. I*

Kremtojmë Pentikostinë, ardhjen e Shpirtit, afatin e premtimit¹ dhe përmbushjen e shpresës. Sa i madh dhe i nderuar është misterit! Ndaj të thërrasim: O Zot, Krijues i gjithçkaje, lavdi më ty.

Pasvargje

Ting. II Ikos tu Efrathá

Siç u premtove, Krisht,* shën Nxënësve, e bëre:* Shën Shpirtin tënd hyjnor, ti,* o Fjalë, ua dërgove*¹ edhe i shndrite tërësisht.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.



Befas nga qielli,* fuqia mbar' e Shenjt' * Ngushëllimtar i shfaq' * të urtë mjaft apostujt* dhe theologë qartazi.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Fiset e huaja,* me plot habi, hyjnorët* apostuj i dëgjonin* ta mburrnin Shën Trininë* në shumë gjuhë, veç e veç.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

O Krisht, i përtërite Nxënësit e tu me gjuhët e huaja, që, me anë të tyre, të të predikonin ty, Fjalën e pavdekshme dhe Perëndinë² që u jep shpirttrave tanë përdëllimin e madh.³

Përlëshorja e së kremtes [një herë si edhe deri te Mbyllja, ndërsa në fillim të Mëngjesores (pas Perëndia është Zoti) tri herë; në fund të saj, një herë].



TË MARTËN PAS PENTIKOSTISË NË MËNGJESORE

*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësore
Ting. I Ton tafon su Sotir*

Me Atin, Birin un'* e himnoj, e nderoj tok,* e adhuroj tok, tok e vë Shpirtin e fortshenjt';* i ndaj në veçori, veçse i bashkoj prapë në Hyjni,* se tash Shpirti Zot,* pasi i mbushi apostujt* shenjt' të Krishtit Zot,* i urtësoi ta shpallnin* kështu nëpër botën krejt. (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë,
Ndenjësore E ngjashme*

Si zjarr nga qielli* frikshëm ka zbritur Hiri* i Shpirtit Shenjt edhe i ndriçoi apostujt,* pra Nxënësit e Krishtit, dhe i tregoi

ndriçues shenjt'* që po shpallnin fort* Një zotëri, Një fuqi njësh* të Trinis' së Shenjt',* të cilën e adhurojmë* edhe e lëvdohet* mjaft. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Pentikostisë (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Pentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Pentikostisë. Më të nderuarën. Dërgimësoret e Pentikostisë.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. II Ikos tu Efrathá*

Nxënësit e tu, Fjal',* në mendje fort u ndritën* me drit' nga Hyjpushteti,* e morën Shenjtin Shpirt, Krisht,* vërtet madje esencialisht.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Gjuhët, si zjarr nga lart,* u shfaqën kur po zbrisnin* të ndara mbi apostujt* edhe i shndritnin shumë,* por nuk i flakëronin pra.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Eja, Ngushëllimtar,* nga lart mbi ne siç shkove* më parë mbi apostujt,* shpëtona, shenjtërona* ne që të shpallim Perëndi.

Lavdi *dhe* Tani *Ting. I*

Të gjitha i jep Shpirti Shenjt, buron profeci, përsos priftërinj, u mësoi të paditurve urtësi, peshkatarët i tregoi si theologë, mban tërë institucionin e Kishës. O Ngushëllimtar i bashkëqenshëm dhe i bashkëfronshëm me Atin e me Birin, lavdi më ty.

Në Liturgji [gjatë gjithë javës], Antifonet dhe Hyrtoja e Pentikostisë. Përlëshorja e Pentikostisë dhe e kishës. Kontaqi i Pentikostisë. Trishenjtë. Të meriton. Pamë dritën. Kungatorja e ditës.



TË MARTËN PAS PENTIKOSTISË NË MBRËMËSORE

Thirrtoje

Ting. I Ton uranion tagmaton

Të vlefshme dhe të logjikshme për qiejt me logjik* ishin k'to gjuhë zjarri* që ta shpallnin në kombe* lavdin mbar' të Perëndis', që me zjarr* qiejt nur i stolisi lart* dhe Gjithësinë e dukshme e shndriti krejt* tok me Birin dhe me Shpirtin Shenjt.

Ndërsa qen' tok në Sion, Nxënësit e Zotit Krisht,* sipas premtimit, erdhi*¹ dhe u ul si zjarr mbi ta* Shenjti Shpirt edhe i shfaqti kështu* me një frymë që nxirrte zjarr,* ndaj i treguan me shumë oratori* dogmat krejt mistike të Trinis'.

Si bakër të farkëtuar, si shpata, Shpirti Shenjt* i bëri fort hyjnorët* Nxënës kur erdhi, saqë* dhen', për Bërësin, ta bënin të shenjt* si t'i thernin fort të këqijt',* ta asgjësonin të ligun, shpatat e tij,*¹⁵⁹ shpirtat tanë t'i shpëtonin pra.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani Ting. II

Pamë dritën e vërtetë,⁴ morëm Frymën qiellore, gjetëm besën e vërtetë, duke iu falur Trinisë së pandarë, se ajo na shpëtoi.*

Pasvargje

Ting. IV Édhokas simiosin

Erdhi tek apostujt e tu energjia e Shpirtit tënd* fort të shenjtë sot, Shpëtimtar,* i tërëfuqishmi Zot,* dhe të urt' i shfaqti* nga hydjia dhe ja i mbushi me mësimin tënd* të lum, prandaj e lëvdojmë gjithë ne* Ekonominë tënde shpëtimtare, o Jisu Perëndi;* i shpëton shpirtat tanë ti,* Çlirimtar mirëbërës Krisht.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Shpirti yt i tërëfortë, i njëqenshëm me ty, o Zot,* sot dërgohet nga Ati lart*¹ me gjuhë të zjarra, Krisht,* dhe bën, si shpërndahet,* ta rrëfejn' apostujt e tu pushtetin, lavdin tënd* dhe madhështitë e tua, o Jisu* i fortfuqishëm, ndaj Ekonominë tënde shpëtuese* e lëvdojmë, o Shpëtimtar,* i shpëton shpirtat tanë ti.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Sot, karizmat e Ngushëllimtarit, Shpirtit tënd, Çlirimtar,* njerëzores natyrë ti* ia fale⁷⁶ edhe, siç the,* Shpëtimtar, e bërë* të profetizonte dhe i mësove gjithashtu* Trinis' pa ndarje t'i falej, Fjalë Krisht;* prandaj, me besë, ne Ekonominë tënde shpëtuese* e lëvdojmë, o Shpëtimtar,* i shpëton shpirtat tanë ti.

Lavdi dhe Tani Ting. II

Me profetët, na lajmërova udhën e shpëtimtimit dhe ndër apostujt shkëlqeu Hiri i Shpirtit tënd, o Shpëtimtari ynë; ti je Perëndia i parë, ti je dhe në vazhdim,⁵ dhe, në jetë të jetëve, ti je Perëndia ynë.



TË MËRKURËN PAS PENTIKOSTISË
NË MËNGJESORE*Pas Stihologjisë së parë, Ndenjësores**Ting. IV Tahí prokatálave*

Uerdhi apostujve, siç u premtua, o Krisht,* i fortshenjti Shpirt vullnetarisht edhe i bashkoi gjuhët e ndryshme krejt* që kishin lloj-lloj kombesh* dhe i bëri si një zë* për besën e Triadhës së pabërë, ndaj lypim:* Bano dhe te ne, o njeridashës, i miri Zot.⁵³ (2x)

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësores**Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon*

Me çudi mbushi kombe të ndryshme mjaft* Tërëshenjtë Shpirt kur si zjarr zbriti sot* mbi shenjtët apostuj pra,* njeridashës, se flisnin drejt* me gjuhë zjarri, dhe dialektin e vet çdokush* po e dëgjonte, ndaj mrekullinë e shihnin si* dehje sa s'besonin, si shpëtim besëmirët',* vërtet; dhe prandaj ne po* e lëvdojmë pushtetin tënd* dhe kërkojmë* të na dërgosh* pasurisht, o Krisht, Perëndi* dhe Çlirimtar, ndjesë fajesh,* se jemi ne* shërbëtorët e tu me shumë devotshmëri. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I dyti i Pentikostisë (tok me Irmoset) në 8 dhe të Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësores e Mujorit dhe e Pentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Pentikostisë. Më të nderuarën. Dërgimësores e Pentikostisë.

*Pasvargje të Lavdërimeve**Ting. Tërth. II Triúmeros anestis*

ITërëshenjtë Shpirt, Drita pra* që del nga Drita³⁷ erdhi tash* me gjuh' zjarri përmbi dhe t'i bëjë shkumb* mëkatet e atyre që besërisht i falen* Trinis' trihipostate me kushtim.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Zot, na e përtërit Shpirtin tënd* të Tërëshenjtë që, dikur,* ua dërgove* Nxënësve të tu, o Krisht,* që i forcoi mjaft ta zbatonin, o i dhembshur,* vullnetin tënd shpëtues në botë.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Le ta theologojm' me besim* të Tërëshenjtin Shpirt, me zë* le t'i themi:* Mos na lër, Ngushëllimtar,* ti që na jep të gjithëve ne shpëtim dhe jetë* edhe i shenjtëron sa të himnojn'.

Lavdi dhe Tani Ting. II

Në avllitë e tua do të të himnoj ty, Shpëtimtarin e botës,⁶ dhe, pasi t'i ul gjunjët, do t'i falem⁷ fuqisë sate të pamposhtur; në mbrëmje dhe në mëngjes dhe në mesditë,⁸ dhe në çdo kohë do të të bekoj, o Zot.⁹

TË MËRKURËN PAS PENTIKOSTISË
NË MBRËMËSORE*Thirrtores**Ting. I Ton uranion tagmaton*

Epa në zjarr Moisiu të Qenshmin³⁰ përmbi mal*²⁹ që tash zbret mbi apostujt,* hyjshikues të urtë,* Shpirti me një formë zjarri që mjaft* qart' ta shfaqte se është Një,* në Një natyr' Perëndia që, dhe tani,* foli po ashtu si atëher'.

Sa ftuan për pagëzimin e ujit mjaft hyjnor* me gjuhë porsi flakë,* hyjrrëfyesit, dogjën,* bënë shkumb, me zjarrin e

Shenjtit Shpirt,* fjalët e oratorëve* pa besë. Ngushëllimtar, na ndriço dhe ne* që, me besë, të theologojm’.

Zot, parrëfyeshëm more material, lëndë,* ndaj, Perëndia im, sa* të shërbejnë në lëndë,* si lashtë* të Palëndshmit, i përtërit* përmes zjarrit, i bën si flak’* nga Shenjti Shpirt,¹⁶⁰ njeridashës; himnosh mjaft,* i çuditshëm në çdo akt që bën.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Në avllitë e tua, o Zot, pasi i ulëm gjunjët⁷ e shpirtit dhe të trupit, ne besimtarët të përhimnojmë ty, Atin e pafillim dhe Birin e bashkëpafillim dhe Shpirtin e bashkëpërrjetshëm dhe të Tërëshenjtë që i shndrit dhe i shenjtëron shpirtat tanë.

Pasvargje

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Fortsunduesi, Shpirti Shenjt* i fortmir’, i njëqenshëm është* dhe i bashkëfortë, i bashkëpafillim,* i bashkëfronshëm, dhe bashkëgjithëbërës, gjithnjë i gjall’* tok me Atin, Fjalën Zot,* dhe apostujt e Fjalës Krisht* i përmbushi mjaft* me urti, që në kombe të çuditshmet e Hyjnisë, trinisoret dogma, t’i shpallnin në shumë gjuh’.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Turma kombesh të ndryshme krejt* kishin terr prej panjohuris*, si të pirë, ndaj thoshin, Perëndi-njeri,* se ishin pirë keq mistët e tu kur të hyjnueshmet,* çdo të lartë, shpallnin fort* në mjaft gjuh’, flaknin tej në Shpirt* dehje, çdo mashtrim,* veçse ne që po të theologojmë, po shpëtojmë, si të njohëm prej tyre mirë dhe saktësisht.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

O burim i përjetshëm, nxjerr,* si lum’, pashprehshëm mirësi* përgjithmonë, ujë të gjall’¹⁶¹ ti derdh pa fund,* o i njëqenshëm me Atin dhe me Birin; ndaj shpirtin tim,* përmes rrjedhjes sate çurg,* ma vadit, ma çliro gjithnjë* prej kaminës ti,* prej të frikshmeve ngasje dhe prej flakës së pasioneve, prej zjarrit të Ferit që nuk pushon aspak.

Lavdi dhe Tani *Ting. II*

Le ta përhimnojmë Trininë e bashkëqenshme, Atin dhe Birin bashkë me Shpirtin e Shenjtë, sepse kështu predikuan të gjithë profetët dhe apostujt tok me martirët.



TË ENJTEN PAS PENTIKOSTISË NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. I Ton tafon su Sotir

Ja ku përmbushen plot* parathënie profetësh,*²³ sepse Ngushëllimtari që si Zot i shfaq* dhe ua zbuloi pak të ardhmet me dritat e zbehura,* tashmë pasurisht* u derdh përmbi shën apostujt* dhe, përmes tyre,* mbi sa me besë i falen* Trinisë së pabërë. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjëso

Ting. Tërth. I Ton sinánarhon Logon

Shpëtimtar, kur apostujt e tu i mbushi krejt* lavdia e Shpirtit Shenjt, i tregoi ndriçues nur,* ndaj e hiqnin heretiken mjegull nga çdo vend,* shpirtat e besëmirëve* i ndriçonin që ta adhuronin

fort Atin tënd, Krisht,* tok me Shpirtin e Tërëshenjtë që, sa të falen ty, i shenjtëron. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I pari i Pentikostisë (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Pentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Pentikostisë. Më të nderuarën. Dërgimësoret e Pentikostisë.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. IV Os jeneon en mártisin*

Indriçoi apostujt mjaft* zbritja e Shenjtit Shpirt mbi ta* tashmë, kur e panë si gjuhë tërë zjarr,* si oratorë i shfaqti te të gjithë dhe shpallnin fort* se Trinia ka vërtet* Një bashkim të njëqenshëm tok,* ndaj habiteshin* mbarë kombet kur shihnin që të pashkolluar krejt më parë,¹⁴ thoshin gjëra të pashprehshme me fuqi.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Kur po rrinin në katin lart,* morën Nxënësit energjin* e Shën Shpirtit që erdhi me të vrullshmen frym* edhe me gjuhët e zjarrta, ndaj po jepnin mësimë mjaft* dhe të ndryshme qartësisht,* thoshin fjalën e Hirit drejt,*¹⁶² vërtetonin fort* se ai që, me dashje, kish pësuar, Krishti,¹⁶³ është Perëndi i vërtetë dhe Shpëtimtar, dhe Zot.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Ti prej Shpirtit tënd të fortshenjt*, Hir hyjnor shën apostujve* u dërgove; na jep dhe neve, lutemi,* tash një ndriçues në zemër që, t'i feksë gjithnjë me drit* pra me ardhjen e tij, Zot,* që, pa reshtur,

me zë të madh,* qartas gjithë ne* ta drejtojmë lart të trefishtin lavdërim,¹³ Trininë e pandar* në natyrë, drejt ta himnojmë ne.

Lavdi dhe Tani Ting. II

Me profetët, na lajmërove udhën e shpëtimtimit dhe ndër apostujt shkëlqeu Hiri i Shpirtit tënd, o Shpëtimtari ynë; ti je Perëndia i parë, ti je dhe në vazhdim;⁵ dhe, në jetë të jetëve, ti je Perëndia ynë.



TË ENJTEN PAS PENTIKOSTISË NË MBRËMËSORE

Thirrto

Ting. IV Édhokas simíosis

Shpirti Shenjt, që na i ndan karizmat,⁷⁶ erdhi mbi dhe tani* jo siç shndriti, porsi në hi,* në Ligj, te profetët lasht*,¹⁶⁴ më përpara, edhe* krejt esencialisht neve na u dha ai me hir* me ndërmjetimin e Krishtit;¹ zemrat pra* t'i lajmë me virtyt dhe ta pranojmë ardhjen e tij nga lart* mistikisht të ndriçuar ne,* o besnikë, me përkushtim.

Njeridashës, mos e hiq prej nesh, Krisht, Shpirtin tënd fort të shenjt*,¹⁵ por dhurona ti Hirin tënd,* kur ne të jetojmë drejt,* denjësisht përherë* dhe me zemër, shpirt; ndaj dhe pjesëmarrjen e tij, Zot,* ta trashëgojmë, të jemi tempuj ne,* banesa të Ngushëllimtarit,⁵⁴ o Jisu, Perëndia ynë;* shpirtrat tanë të kanë ty* Shpëtimtar që na mëshiron.

Shpirtin Shenjt që shenjtëron gjithçka, plot me përkushtim e bes* ta himnojmë me zë të madh:* I ardhuri Zot mbi dhe,* siç kish dashur Ati* mirësisht, mos ik larg nesh që e adhurojmë drejt* Hyjninë

tënde, por shfaqna tempuj ne*⁵⁴ të dhembshurisë sate që s'rrëfëhet dot dhe na shenjtëro* tërë ne që, me besë plot,* ty të psalim, Ngushëllimtar.

Dhe 3 të Mujorit

Lavdi dhe Tani *Ting. I Rëndë*

Edhe pse kemi Ngushëllimtar pranë Atit, Krishtin Perëndi, le t'i falemi me besë një Ngushëllimtari tjetër, Shpirtit të së vërtetës, që erdhi sot mbi dhe.

Pasvargje

Ting. I Panëfimi märtires

Me bes', ta theologojmë ne* Shpirtin që nga Ati del* dhe që në Bir po i falemi,¹ i cili mban çdo gjë,* e administron sakt',* ruan jetën, mbron si dhe vazhdon, shpëton edhe mbetet; le t'i themi: Shën Ngushëllimtar* që s'kuptohesh, botës sate, Zot,* ti dhuroji paqen tënde, Hirin tënd.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Shën Shpirti, burim për çdo të mir',* erdhi në esenc' mbi dhe* që mbarë sferën, çdo an', ta mbushë me hyjnoren forc'* dhe me dhembshurinë* qiellore nëpërmjet apostujve; atij t'i thërrasim: O thesar, Ngushëllimtar* që s'kuptohesh, botës sate, Zot,* ti dhuroji paqen tënde, Hirin tënd.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Shën Shpirtin e dim' si Perëndi,* i njëqenshëm është ai,* i bashkëfronshëm me Atin dhe me Fjalën, dritë nur* e tërëpërsosur* që shkëlqeu fort nga Drita, Ati³⁷ i përsosur pa nisje, vjen përmes Shën

Birit Zot;*¹ t'i thërrasim: O Ngushëllimtar* jetëdhënës, jepi paqe gjith' botës.

Lavdi dhe Tani *Ting. Tërth. IV*

O Zot, kur ua dërgove Shpirtin tënd apostujve¹ kur po rrinin ulur, bijtë e hebrenjve habiteshin tepër duke i parë meqë i dëgjonin të flisnin me gjuhë të tjera të huaja sikundër ua jepte Shpirti; se, duke qenë të pashkolluar,¹⁴ u urtësuan dhe, pasi i kapën si gjah kombet, u thoshin me oratori hyjnoret; prandaj dhe ne të thërrasim: O Zot që u shfaqe mbi tokë dhe na shpëtove nga mashtrimi, lavdi më ty.



TË PREMTEN PAS PENTIKOSTISË NË MËNGJESORE

Pas Stihologjisë së parë, Ndenjëso

Ting. Tërth. IV To prostathén mistikós

Pas ngjalljes sate prej varrit dhe pas ngritjes* hyjnore lart në* qiej,¹⁹ o Krisht, u dërgove,* lavdin tënd, o i dhembshur,* Nxënësve hyjpamës;* u fute të drejtin Shpirt,²⁰ ndaj, porsi kitar',* me një melodi mistike* prej t'shenjtit tast* fort ia shpallën çdokujt, Zot, tingëllimet si dhe Ekonominë tënde, Shpëtimtar,* mirëbërës; lavdi më ty. (2x)

Pas Stihologjisë së dytë,

Ndenjëso E ngjashme

Me gaz u mbushën, u bënë guximtarë,* ndërsa, më parë,* miqt' e Shpëtimtarit³¹ kishin* frik';³⁸ kjo ndodhi kur zbriti* sot nga lart Shën Shpirti* mbi Nxënësit, mbi shtëpinë ku rrinin tok;* i flisnin çdo kombi veças* në shumë gjuh',* u përhapën gjuhët që, si zjarr, dukeshin, por s'i do-

gjën fare por përkundrazi:* Krejt këta i freskuan mjaft. (2x)

Psalmi 50 dhe Kanunet: I dyti i Pentikostisë (tok me Irmose) në 8 dhe i Mujorit në 4. Pas Odes III, Ndenjësoret e Mujorit dhe e Pentikostisë. Pas Odes VI, Kontaqi i Pentikostisë. Më të nderuarën. Dërgimësoret e Pentikostisë.

*Pasvargje të Lavdërimeve
Ting. I Ton uranion tagmaton*

Ilia plot zell, frym'zjarrti, hipi mbi një karroc'* të zjarrtë që valonte,*⁷⁰ shfaqte fryrjen hyjnore* që tash, qartazi, shkëlqen në Sion* mbi apostujt që lartazi.* Në-përmjet saj, e çliruan, e shndritën fort* botën dhe i dhanë njohuri.

Varg: Krijë zemër të pastër tek unë, o Perëndi, dhe përtërit frymë të drejtë në thellësitë e zemrës sime.

Me gjuhët si zjarr lëçisnin apostujt mbarë tok* pra për Ekonominë* krejt hyjnore të Krishtit.* Kombet i ndriçuan të kishin drejt,* saktë, besë për Perëndin',* Atin dhe Birin dhe Shpirtin e Tërëshenjt',* në tri hipostaza, Një Zot Shenjt.

Varg: Mos më hidh larg fytyrës sate dhe mos e hiq prej meje Shpirtin tënd të Shenjtë.

Sion e shenjtë dhe nënë e gjithë Kisha-ve,*¹⁶⁵ në ty Ngushëllimtari,* Shpirti, zbriti porsì zjarr* frikshëm mbi apostujt, gëzohu tash* dhe kremtoje Pentikostin'* që, realisht, mbarë bota e do me shpirt;* panairin bëje tok me ne.

Lavdi dhe Tani Ting. Tërth. II

O Mbret qiellor, Ngushëllimtar, shpirt i së vërtetës,¹⁶ që ndodhesh kudo dhe i mbush të gjitha, thesar i të mirave dhe

dhurues jete; eja dhe qëndro ndër ne dhe pastrona nga çdo njollë, dhe shpëto, o i Mirë, shpirtat tanë.*



TË SHTUNËN PAS PENTIKOSTISË

Mbyllet e kremtja e Pentikostisë dhe psalen të gjitha të sajat, përveç Leximeve, Litisë, Polieleit (dhe Ndenjësores së tij), Ungjillit të Mëngjesores dhe Antifoneve. Shërbesa e Mujorit psalet në Pasdarkë.

CITIME

Pentikostia: Vep. 2.1-41

1. Joan 14.16-17,26; 15.26; 16.7; Tit. 3.6
2. Joan 1.1
3. Num. 14.19 etj.
4. Joan 1.9
5. Is. 41.4
6. Joan 4.42; I Joan 4.14
7. Ps. 28(29).2; 95(96).9
8. Ps. 54(55).18
9. Ps. 33(34).2
10. Joan 14.10,20
11. Hebr. 1.2
12. Joan 17.26
13. Is. 6.3
14. Vep. 4.13
15. Ps. 50(51).13
16. Joan 14.17; 16.13
17. Gjen. 11.1-9
18. Matth. 3.11; Lluk. 3.16
19. Mark 16.19; Lluk. 24.51; Vep. 1.2
20. Ps. 50(51).12
21. Eks. 6.1 etj.
22. Eks. 14.21-15.3 etj.
23. Joel 3.1-2(2.28); Zah. 12.10
24. Num. 11.29
25. Eks. 20.21; Sirak 45.5
26. Eks. 4.10
27. Eks. 20.22 etj.
28. Eks. 31.18; Ligji i dytë 9.10
29. Eks. 33.23
30. Eks. 3.14
31. Lluk. 12.4; Joan 15.14
32. Matth. 28.20
33. Joan 17.4; 19.30
34. Lluk 24.49

35. I Mbret. [Sam.]1.4-19
36. I Mbret. [Sam.]2.3
37. Jak. 1.17
38. Joan 20.19
39. Abak. 3.1-2
40. Abak. 3.13-14
41. Hebr. 1.1
42. Vep. 1.8; 2.32; 3.15; 13.31
43. Ligji i dytë 4.24
44. I Tim. 6.15; Apok. 17.14; 19.16
45. Tit. 3.5
46. Joan 19.34
47. Is. 45.23; Rom. 14.11; Fil. 2.10
48. Is. 26.18
49. Is. 26.9
50. Ps. 142(143).10
51. Urt. Sol. 7.7
52. Mih. 4.2; Is. 2.3
53. Joan 14.23
54. I Kor. 6.19
55. Jona 2.1-8
56. Is. 11.9
57. I Joan 2.2; 4.10
58. Joan 4.42 etj.
59. Gjen. 3.2-6,16-19
60. Ligji i Dytë 4.7
61. Dan. 3.23-Lutja e Azarias 28
62. Dan. 3.7
63. Eks. 3.2-5 etj.
64. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
65. Eks. 19.12-13; Ligji i Dytë 4.11; 5.5
66. Hebr. 12.22
67. Joan 8.26; 15.15
68. Joan 1.18
69. Joan 1.3
70. IV [II] Mbret. 2.11
71. III [I] Mbret. 19.10,14
72. Dan. 3.4 etj.
73. Joan 1.4,9; 3.19; 8.12; 9.5; 12.46
74. Is. 11.2-3
75. Ps. 50(51).14
76. I Kor. 12.4-11
77. Jak. 3.17
78. Vep. 16.5
79. Ps. 118(119). 36,112
80. I Tim. 6.16
81. Ps. 145(146).6
82. Matth. 6.8
83. Lluk. 1.35
84. Mark 14.35; Lluk. 22.41
85. Ps. 19(20).10
86. Ps. 13(14).7; 52(53).6; 125(126).4
87. Ps. 21(22).11
88. Ps. 77(78). 33
89. Ps. 24(25).7
90. Ps. 18(19).13
91. Ps. 70(71).9
92. Joel 2.12 etj.
93. Ps. 101(102).20
94. Is. 63.15
95. Rom. 6.13; II Kor. 6.7
96. Joan 14.27
97. Ps. 17(18).45
98. Hebr. 1.3
99. Rom. 8.26
100. Ps. 142(143).8
101. Dan. 7.10
102. Joan 15.16; 16.23
103. Jona 2.10
104. Ef. 3.20
105. Hebr. 2.14
106. Ps. 19(20).7
107. Ps. 16(17).8; 60(61).5
108. Ps. 137(138).8
109. Ps. 43(44).21
110. Ps. 140(141).2
111. Ps. 90(91).5-6
112. Ps. 118(119).120
113. Kol. 3.5
114. Joan 8.46
115. I Petr. 3.19; 4.6
116. Ps. 106(107).16; Is. 45.2
117. Apok. 12.3 etj.
118. II Petr. 2.4
119. Matth. 25.41
120. Matth. 8.12; 22.13; 25.30; II Petr. 2.17; Juda 13
121. I Kor. 1.24,30
122. Is. 9.1; Matth. 4.16; Lluk. 1.79
123. I Kor. 2.8; Jak. 2.1
124. Matth. 3.17; 12.18; 17.5; Mark 1.11; 9.7; Lluk. 3.22; 9.35
125. Mal. 4.2(3.20)
126. Gal. 6.10
127. Ps. 94(95).4
128. Urt. Sol. 9.1
129. I Mbret. [Sam.] 2.6
130. Tit. 1.2
131. I Kor. 15.56
132. Ps. 64(65).6
133. Is. 35.10
134. Ps. 117(118).15
135. Ps. 113(114).25-26 [115(116).17]
136. Ligji i Dytë 10.17 etj.
137. Sir. 38.6
138. I Kron. 1.8
139. Rom. 13.12-13
140. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
141. I Mbret. [Sam.] 29.6; II Mbret. [Sam.] 3.25; IV [II] Mbret. 19.27; Ps. 120(121).8
142. Kol. 3.12
143. Hebr. 2.18
144. Fil. 4.3; Apok. 13.8; 20.12-15; 21.27; 22.19
145. Lluk. 16.23
146. Ps. 114(115).9
147. Matth. 3.2 etj.

- | | |
|------------------------------------|-----------------------------------|
| 148. Gjen. 2.15 | 157. Joan 14.6 |
| 149. Joan 14.2 | 158. Ps. 21(22).5 |
| 150. Jov 14.4-5 | 159. Ps. 9.7 |
| 151. Lluk. 1.78 | 160. Ps. 103(104).4 |
| 152. Ps. 103(104).24 | 161. Joan 4.5-10 |
| 153. Gjen. 1.16-18; Ps. 135(136).8 | 162. Lluk. 4.22; Vep. 14.3; 20.32 |
| 154. Ps. 94(95).2 | 163. Joan 10.15,17-18 |
| 155. Jez. 20.41; Fil. 4.18 | 164. Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1 |
| 156. Rom. 9.5 | 165. Ps. 86(87).5; Gal. 4.26 |





TË DIELËN E GJITHË SHENJTORËVE

TË SHTUNËN NË MBRËMËSOREN E VOGËL

*4 Thirrtoret e para Ngjallësore
Ting. Tërth. IV*

Himn mbrëmësor dhe adhurim...

O Zot, o Zot, mos na hidh tej...

Gëzohu, Sion e shenjtë...

Fjala, që lindi para jetëve...

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O kori i hyjnueshëm i martirëve...

(Kërkoje në Mbrëmësoren e Madhe, fq. 242)

Tani *Hyjlindësore Dogmatike
Ting. Tërth. IV*

Si të të lumërojmë, o Perëndilindëse?
Dhe si do ta përhimnojmë misterin e pa-
konceptueshëm të shtatzënisë sate, o
e përmbibekuar? Sepse Bërësi i jetëve
dhe Krijuesi i natyrës sonë, përderisa
e dhembshuroi ikonën e vet,¹ zbriti me
zmbropsjen² e pagjurmësuar; ai që është

në gjirin e Atit³ fushoi në mitrën tënde,
o e dëlirë, dhe pa u ndryshuar u bë trup
prej teje, o e panusëruar, megjithëse
mbeti ai që ishte, Perëndi; prandaj i
falemi, Perëndisë së përsosur dhe njeriut
të përsosur, të njëjtit nga të dyja pamjet,
sepse që të dyja janë natyra vërtet në
të; dhe veçoritë e tij natyrore, sipas
esencave të tij të dyfishta, i shpallim të
gjitha si të dyfishta, duke respektuar dy
energji dhe vullnete; se, duke qenë i një-
qenshëm me Atin Perëndi, do lirshëm
dhe vepron si njeri; atij përgjëroju, o e
tërëlumëruar e thjeshtë, që t'i shpëtojë
shpirtrat tanë.

*Pasvargje Ting. Tërth. IV
Ngjallësor*

U ngjite mbi Kryq, o Jisu, që zbritte prej
qiellit; shkove te vdekja ti, o jeta e pa-
vdekshme; Dritë e vërtetë, për ata që
ishin në errësirë; Ngjallja e të gjithë të
rënëve. Ndrichi dhe Shpëtimtari ynë,
lavdi më ty.*

*Të Hyjlindësës
Ting. Tërth. IV O tu paradhoksu
thávmatos*

Varg: Do ta kujtoj emrin tënd në gjithë
brezat e brezave.

Gëzohu, o Përrëndilindëse tërëmodeste;
gëzohu, o burim që u nxjerr jetë besnikëve;
gëzohu, o Zonjë e të gjithëve, e Krijesës;
gëzohu, o e bekuar e tërëpaqortueshme;
gëzohu, o e lavdishme, e tërëpacenuar;
gëzohu, o pallat mbretëror; gëzohu, o
tendë hyjnore; gëzohu, o e kulluar; gëzo-
hu, o nënë-virgjëreshë; gëzohu, o hyjnuse.

Varg: Dëgjo, o bijë, dhe shiko, dhe ule
veshin tënd, dhe harroje popullin tënd dhe
shtëpinë e atit tënd, edhe do ta dëshirojë
mbreti bukurinë tënde.

Gëzohu, hyjnëne pa cen; gëzohu, o
shpresë e besëmirëve; gëzohu, o pastrim
i botës; gëzohu, ti që çliron shërbëtorët e
tu nga çdo shtrëngim; gëzohu, ngushëllim
i njerëzve; gëzohu, o ndihmë jetëprurëse;
gëzohu, o pirg i atyre që të ftojnë; gëzohu,
o banesë hyjnore e Perëndisë dhe mal i
shenjtë.⁴

Varg: Fytyrën tënde do ta bëjnë litani të
pasurit e popullit.

Gëzohu, o Zonjë Hyjlindëse; gëzohu, për-
krahja dhe shpresa e vetme e njerëzve;
gëzohu, strehë dhe llambë gjithmonë e
ndezur;⁵ gëzohu, fitil⁶ i lavdëruar; gëzohu,
pallat i shenjtëruar mbretëror; gëzohu,
parajsë; gëzohu, tendë hyjnore; gëzohu,
burim që nxjerr rrjedhë për ata që vra-
pojnë drejt teje.

Lavdi

Një nga Idhiomelet e Shenjtorëve, çfarëdo.

Tani

Hyjlindësor në të njëjtin Tingull, çfarëdo.



NË MBRËMËSOREN E MADHE

*10 thirrtores: 6 Ngjallësore
dhe 4 të Shenjtorëve
Ngjallësoret Ting. Tërth. IV*

Himn mbrëmësor dhe adhurim...

O Zot, o Zot, mos na hidh tej...

Gëzohu, Sion e shenjtë...

Fjala, që lindi para jetëve...

Lavdërojmë Ngjalljen tënde...

Lavdi ty, o Krisht Shpëtimtar...

*Të Shenjtorëve
Ting. Tërth. II Olin apothémeni*

Folësit e Zotit Shpirt,* apostujt e Shpë-
timtarit,* si u bënë besërisht* si një
mjet i Shpirtit Shenjt, shkuan nëpër
bot',* në çdo vend dhe çdo cep,* prediki-
min plot nder* mjaft orthodhoksisht e
mbollën; ndaj, me kultivim hyjnor* dhe
me Hir, ushtrit' e martirëve* që mbinë,
e treguan pak,* me zjarr dhe lloj-lloj
shtrembërimesh tok* dhe me fshiku-
llime, pësimin e nderuar zotëror* dhe
me guxim ndërmjetojnë fort* dhe për
shpirtrat tanë pra.

Digjeshin prej dashuris',* si zjarr, për
Zotin, shpërfillën* zjarrin, si qymyr i
shenjt'* ndizeshin martirët e respektuar
fort,* dogjën në Krisht, si kasht',* çdo
tërbim të blofit,* mbyllën goja bishash⁷
urtësisht me lutje, përgjërëm.* Kur ua
prisnin kokat, i prisnin drejt* kolonat e
armiqve tmerr* dhe, kur derdhnin çurgjet
e gjakrave* duke pasur shumë durim,
po e vaditnin Kishën boll* edhe kështu
gjelbëronte mjaft* në besim dhe në virtyt.

Bishat i mundonin mjaft,* u binin frikshëm me shpata,*⁸ ua gërvishnin thonjtë tmerr* dhe ua prisnin duart, i shtrembëronin keq;* kur me zjarr digjeshin,* s'mposhteshin aspak pra;* kur ua prisnin kyçet dhe i shponin thell', duronin shum'* shën martirët me qëndrueshmëri,* se parashihnin rrethe, lavd* dhe kurora pa cen prej Zotit lart* edhe e shikonin të ardhmin fund; prandaj me mjaft guxim* për shpirtrat tanë po ndërmjetojn'* para Krishtit Perëndi.

Siç e kemi për detyr',* me këng' hyjnore t'i mburrim* sa garuan me besim* në çdo skaj të botës, martirët shenjtë tok,* priftërinjtë me zell* dhe hyjmenës shumë,* dhe të thjeshtat gra tok me apostujt, mbledhje shenjtësh, se* me pësim u bën' pa pësim me hir* nga Krishti; të mbidheshmit pra* u bashkuan fort me të qiellshmit* dhe tani, si yje të ndritshme, na ndriçojnë tërë lavd,* për shpirtrat tanë po ndërmjetojn'* para Krishtit Perëndi.

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O kori i hyjnueshëm i martirëve, baza e Kishës, përsosmëria e Ungjillit, ju i përmbushët me vepra thëniet e Shpëtimtarit, sepse me ju u mbyllën portat e Hadhit që u hapën kundër Kishës;⁹ derdhja e gjakut tuaj i thau flitë e lëngëta idhujtare; therja juaj lindi tërësinë e besimtarëve; i çuditët të patrupët dhe qëndroni të kurorëzuar para Perëndisë;¹⁰ tek ai ndërmjetoni pa pushim për shpirtrat tanë.

Tani *Hyjlindësore Dogmatike*
Ting. Tërth. IV

Mbreti i qiejve u shfaq mbi dhé nga njeridashja dhe u shoqërua me njerëzit,¹¹ se, duke marrë trup nga Virgjëresha e

Kulluar, dhe duke lindur prej saj me këtë trup, ky është një Bir me dy natyra, por me një hipostazë. Prandaj, duke e shpallur atë vërtet si Perëndi të përsosur dhe Njeri të përsosur, ne pohojmë Krishtin, Perëndinë tonë, të cilit lutju, o Nënë e Panusëruar, të mëshirohen shpirtrat tanë.*

Hyrje. O dritë gazmore.

Proqimeni i ditës dhe Leximet

Këndimi i profecisë së Isaisë
(43.9-14)

Këto thotë Zoti: "Gjithë kombet u mblodhën së bashku dhe do të mblidhen arkondë nga ato. Kush do t'i njoftojë këto? Ose gjërat që nga fillimi kush do t'ju njoftojë? Le t'i sjellin dëshmitarët e tyre, dhe le të drejtohen, dhe le të dëgjojnë, dhe le të thonë të vërteta. Bëhuni dëshmitarët e mi dhe unë dëshmitar, thotë Zoti Perëndia, dhe fëmija im që zgjodha; që të njihni dhe të besoni, dhe të kuptoni se unë jam. Përpara meje nuk u bë Perëndi tjetër dhe pas meje nuk do të jetë. Unë Perëndia dhe veç meje nuk është ndonjë që shpëton. Unë lajmërova dhe shpëtova, talla dhe nuk ishte në mes jush i huaj. Ju, dëshmitarë për mua dhe unë, Zoti Perëndia, ende nga fillimi dhe nuk ka njeri që të shpëtojë nga duart e mia. Do ta bëj, dhe kush do ta kthejë mbrapsht këtë?". Kështu thotë Zoti, Perëndia, që ju çliron, i Shenjti i Izraelit.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(3.1-9)

Shpirtrat e të drejtëve janë në dorë Perëndie dhe nuk do t'i prekë torturë. U dukën në sytë e të pamendëve se vdiqën dhe u konsiderua keqtrajtim dalja e tyre dhe ecja nga ne dërmim, por ata janë

në paqe; sepse, edhe nëse para faqes së njerëzve do të ndëshkohen, shpresa e tyre është plot pavdekësi; dhe pasi do të edukohen me pak *mundime*, do të fitojnë mirëbërje të mëdha, sepse Perëndia i provoi dhe i gjeti të denjë për veten. Si ar në shkritore i provoi ata dhe si holokaust flijimi i pranoi ata; dhe në kohën e shqyrtimit të tyre do të ndriçojnë dhe si shkëndija në kallam do të vrapojnë. Do të gjykojnë kombe dhe do të sundojnë popuj, dhe do të mbretërojnë tek ata Zoti ndër shekuj. Ata që kanë besim në të, do ta kuptojnë të vërtetën dhe besimtarët me dashuri do të qëndrojnë me durim pranë tij, sepse ka hir dhe mëshirë ndër oshënarët e tij dhe mbikëqyrje mbi të zgjedhurit e tij.

Këndimi i Urtësisë së Solomonit
(5.15-23; 6.1-3)

Të drejtët jetojnë përjetë dhe në Zotin është paga e tyre, dhe përkujdesja e tyre pranë të Shumëlartit. Për këtë do ta marrin mbretërinë e hijeshisë dhe kurorën e bukurisë nga dorë Zoti, sepse me të djathtën do t'i mbulojë dhe me krahun do t'i mbrojë. Do ta marrë *si* armatim zellin e tij dhe do ta mobilizojë me armë Krijesën për mbrojtje armiqsh. Do të veshë *si* korracë drejtësi, dhe do të veshë *si* helmetë gjykim pa hipokrizi. Do të marrë *si* mburojë të pamposhtur oshënarë dhe do të mprehë zemërim të prerë për shpatë; dhe do të bashkëluftojë me atë bota kundër të marrëve. Do të ecin suksesshëm te qëllimi predha rrufesh, dhe si nga një hark i plotë rrethi nga retë do të hidhen në shenjë dhe nga zemërimi që hedh gurë do të hidhen breshëri të plota. Do të indinjohe kundër tyre ujë deti, ndërsa lumenj do të

përmytin papritur. Do t'u kundërvihet atyre erë fuqie dhe si stuhi do t'i ajrojnë ata si grurë, dhe do të shkretojë gjithë dheun paligësi dhe keqbërje do të përmbysë frone dinastish. Dëgjoni, pra, o mbretër, dhe bëhuni të mençur, mësoni, o gjykatës të anëve të dheut. Vëreni veshin, ju që sundoni shumicë dhe që jeni mburrur mbi turma kombesh, se ju dha nga Zoti sundimi dhe dinasti nga i Shumëlarti.

*Në Liti Idhiomeli i shenjtit të kishës
dhe të mëposhtmet*

Ting. I

Le ta festojmë shpirtërisht me simfoninë e besës panairin botëror të atyre që i pëlqyen Perëndisë¹² që nga jeta, patriarkët e çmuar, kolektivin e profetëve, bukurinë e apostujve, mbledhjen e martirëve, mburrjen e asketëve, kujtimin e gjithë shenjtorëve, sepse ndërmjetojnë pa pushim te Zoti që t'i japë botës paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹³

Të gjithë ju, o shpresëplotë, ejani ta lëvdojmë me psalme, himne dhe ode shpirtërore¹⁴ kujtimin e tërëfamshëm të të gjithë shenjtorëve; duke lumëruar me nderim Pagëzorin e Shpëtimtarit, apostujt, profetët, martirët, hierarkët, mësuesit, oshënarët, asketët, të drejtët dhe organizatën perëndidashëse të grave të shenjta, le të thërrasim me një zë: O Krisht i përmbimirë, Perëndia ynë, me ndërmjetimet e tyre, jepu paqe Kishave të tua,¹⁵ mbretit krishtdashës fitore kundër armiqve dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹³

Ejani të gjithë të dëfremë shpirtërisht në kujtimin e shenjtorëve, sepse ja ku arriti duke na sjellë karizma që na pashurojnë; prandaj, me zë ngazëllimi¹⁶ dhe

ndërgjegje të pastër,¹⁷ le të thërrasim duke thënë: Gëzohu, o kolektivi i profetëve që predikuar ardhjen e Krishtit në botë dhe i parashikonit të largëtat si të afërta; gëzohu, o kori i apostujve, peshkatarë të njerëzve,¹⁸ që rrjetuat kombe; gëzohu, o bashkësia e martirëve që nga cepat e tokës u mblodhët në një besim, për hir të të cilit duruat plagosje nga torturat dhe e morët sigurisht kurorën e atletizmit; gëzohu, o koshere e Etërve që i tretët trupat me asketizëm dhe, pasi i vratë pasionet e mishit,¹⁹ i dhatë krahë mendjes nëpërmjet dashurisë hyjnore dhe fluturuan në qiej, ku, duke dëfryer bashkë me engjëjt, shijoni të mirat e amshuara; pra, o profetë, apostuj, martirë tok me asketë, përgjërojeni vazhdimisht atij që ju kurorëzoi, që të na çlirojë nga armiqtë e dukshëm dhe të padukshëm ne që, me besë dhe mallëngjim, po bëjmë kujtimin tuaj të nderuar gjithmonë.

Lavdi *Ting. Tërth. I*

O besëmirë, le të rendim së bashku në këtë panair, sepse është shtruar para nesh tryeza mistike me kanë mistike,²⁰ e mbushur me gjellë të mira dhe të shijshme, d.m.th., me virtytet e martirëve; sepse ata, me durim në shpirt, nga cepat e sferës ia ofruan Perëndisë dhimbjet e shumëllojshme të gjymtyrëve të trupit dhe çdo kulm të moshës si fli të arsyeshëm; dhe disave prej tyre iu prenë kokat, të tjerëve u prenë duart dhe çdo nyje; kështu, gjithë shenjtorët u bënë pjesëmarrës në pësimet e Krishtit.²¹ O Zot, ti që u dhe kurora si shpërblim për torturat, na denjëso, si njeridashës, të ecim në gjurmët e tyre.

Tani *Hyjlindësore Ngjallësore I njëjti*
Tempull dhe derë je, pallat dhe fron i Mbretit, o Virgjëreshë e Gjithënderuar, me anën e së cilës Çliruesi im, Zoti Krisht, ndriti mbi ata që flinin në errësirë, duke qenë diell drejtësie dhe duke dashur të ndriçojë ata që gatoi me dorën e tij sipas ikonës së vet. Prandaj, o e Gjithëhimnuar, duke pasur përpara tij guxim nënor, ndërmjeto pa pushim që të shpëtohen shpirtat tanë.*

Pasvargje Ngjallësore Ting. Tërth. IV

U ngjite mbi Kryq, o Jisu...

Le të lavdërojmë Krishtin...

Me psalme dhe me himne lavdërojmë...

O Kryezot i të gjithëve, Bërës...

Lavdi *Ting. Tërth. II*

O shpresëplotë, ejani të formojmë sot një kor duke bërë panair besërisht dhe le ta nderojmë lavdishëm kujtimin famëplotë dhe të nderuar të të gjithë shenjtorëve duke thënë: Gëzohuni, o apostuj famëmëdhenj, profetë, martirë dhe hierarkë; gëzohu, o bashkësi e oshënarëve dhe e të drejtëve; gëzohu, o kor i grave të çmuara; ndërmjetoni të gjithë pranë Krishtit për botën, që t'i dhurojë mbretit fitore mbi barbarët dhe shpirttrave tanë përdëllimin e madh.¹³

Tani *Hyjlindësore Ngjallësore I njëjti*
Zoti Krisht, Krijuesi dhe Çliruesi im, o e Gjithëqashtë, si lindi prej teje i veshur si unë, çliroi Adamin prej mallkimit të mëparshëm.²² Prandaj, o e Gjithëqashtë, si Nënë Perëndie dhe Virgjëreshë me të vërtetë, të thërresim pa pushim përshëndetjen e engjëllit: Gëzohu, o Zo-

një,²³ mbrojtje dhe strehë, dhe shpëtim i shpirtrave tanë.*

Përlëshore Ngjallësore Ting. Tërth. IV

Që lartazi zbritë, o i Zemërdhembshur, varrim denjove të triditshëm, që të na çlirosh neve prej pësimeve. O Zot, Jeta dhe Ngjallja jonë,²⁴ lavdi më ty.*

Përlëshore e Shenjtorëve Ting. IV

Kisha jote e stolisur si me purpur dhe li të çmuar, përmes gjakrave të martirëve të tu në gjithë botën, të thërret me anë të tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoji popullit tënd dhembshuritë e tua, dhuroji shtetit tënd paqe dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹³

*Përlëshore tjetër, poezi e përkthyesit
I njëjti*

Kisha jote, e stolisur si me purpur dhe li të çmuar përmes gjakrave, lotëve dhe djersëve të profetëve, apostujve, etërve, martirëve, asketëve dhe të të drejtëve në tërë botën, të thërret me anë të tyre, o Krisht Perëndi: Dërgoji popullit tënd dhembshuritë e tua, dhuroji shtetit tënd paqen dhe shpirtrave tanë përdëllimin e madh.¹³

Hyjlindësore Ngjallësore I njëjti

Misteri i fshehur prej jete dhe i panjohur ndër engjëj,²⁵ u shfaq ndër të dheshmit me anën tënde, o Hyjlindëse, Perëndia që u mishërua me bashkim të papërzier, dhe denjoi kryq për ne duke dashur,²⁶ me të cilin ngjalli të parëgatuarin dhe shpëtoi prej vdekjes²² shpirtrat tanë.*

*Pendarto [Bekimi i pesë bukëve],
Lexim dhe Përlëshim.*

NË MËNGJESORE

*[Shërbesa e zakonshme e Mesnatës
të së dielës (me Kanunin Triadik)].*

*Pas Stihologjisë së parë,
Ndenjësore Ngjallësore*
Ting. Tërth. IV*

U ngjalle së vdekurish, o jeta²⁴ e të gjithëve, dhe engjëlli i ndritshëm u thërriste grave: Pushoni lotët, ungjillëzojini apostujt, thërrisni duke përhimnuar, se u ngjall Zoti Krisht,²⁷ që denjoi të shpëtojë, si Perëndi, gjininë e njerëzve.

Lavdi

Njerëzit vulosën varrin tënd, o Shpëtimtar,²⁸ engjëlli rrokullisi gurin prej derës.²⁹ Gratë të panë të ngjallur prej së vdekurish, dhe ato u ungjillëzuan dishepujve të tu në Sion, se u ngjalle,³⁰ o jeta²⁴ e të gjithëve, dhe i zgjidhe zinxhirët e vdekjes. O Zot, lavdi më ty.

Tani *Hyjlindësore*

Ti që linde për ne prej Virgjëreshës dhe durove kryqëzim, o i Mirë, që plaçkite vdekjen me vdekje dhe rrëfeve Ngjalljen si Perëndi, mos i shpërfill ata që gatove me dorën tënde;¹ trego njeridashjen tënde, o Mëshirëplotë; prit Hyjlindësen që të lindi të ndërmjetojë për ne; dhe shpëto, o Shpëtimtari ynë, një popull të dëshpëruar.

*Pas Stihologjisë së dytë, Ndenjësore
I njëjti To prostahthén mistikós*

Me gaz, arriti i veshur me të bardha* shën Gabrieli,* si rrufe e rrokullisi* gurin që kishte varri* i Jisuit, Zotit.*²⁹ U bën' si të vdekur rojat e tij të tër'* atë çast, si edhe vula* që ish në varr.*²⁸ Turp të keni, o të paligjshëm, dhe ta dini se Krishti ynë është triumfues pra,* na shpëtoi prej



vdekjes ne.

Lavdi *Ngjallësore Tin sofian qe Logon*

Kur u ngrite prej varrit, o Zoti Krisht,* porosite me gaz miropurureset,* t'u thoshin dishepujve,* që u ngjalle së vdekurish;*³⁰ edhe rendi shën Pjetri dhe hodhi një sy mbi varr,* dhe kur pa brenda dritën, çudinë s'e merrte vesh,* po kur pa prokofin* dhe pëlhurat e bardha,* mënjanë të hedhura,* edhe Trupi atje s'qe më,*³¹ të thërriste me zë të madh:* Zoti Krisht, lavdi më ty,* se ti na shpëtove të gjithë si Perëndi;* se ti ke qenë përjetë* drita dhe³² diell' i qiellit.*

Tani *Hyjlindësore Ngjallësore*

Më ty gëzohet, o Hirplote, gjithë krijesa, tërësia e engjëjve, gjinia njerëzore, o tempull i shenjtëruar dhe Parajsë e arsyeshme, mburrje e virgjërisë, prej së cilës u mishërua dhe u bë djalë Perëndia ynë, që është para jetëve; se mitrën tënde e bëri fron, dhe barkun tënd e bëri më të gjerë se qiejt. Më ty gëzohet, o Hirplote, gjithë krijesa; lavdi më ty.*

I Paqortueshmi (Psalmi 118), Bekimtore etj.

Ungjilli Mëngjesor I, etj.

Kanunet: Ngjallësori (tok me Irmoset) në 4, Kryqngjallësori në 2, i Hyjlindësës në 2 dhe i Shenjtorëve në 6.

Kanuni i Gjithë Shenjtorëve që ka Akrostihidhë: "U këndoj brigadave të shumëllojshme të të gjithë shenjtorëve". Ting. Tërth. IV

Ode I

Armatilatin Faraó

Brigadat e shenjtorëve të tu i përhimnoj, o Zot, dhe të lyp:* Le t'më shndrisë shpir-

ti* përmes dritës sate që s'afrohet,³³ siç të luten, Krisht,* drita që rrezaton; flake çdo terr të injorancës ti,* dritëdhënës, Fjalë e Perëndis'.

Pasi u ngjite mbi dru, i tërhoqe tërë kombet, Zot Perëndi,* drejtas njohjes sate* dhe me dritën e Trinisë Shenjte ti i shndrite fort,* kjo u bë me apostujt e tu të shenjtë dhe po ashtu* shporre çdo mashtrim përmes tyre, Krisht.

Meqë i bindeshin legjislacionit tënd, i zmbraapsnin tej me besim* tërë tokësoret* shën apostujt e tu dhe e hijeshonin dheun krejt,* mbarë sferën, me dritën e Hirit, të predikonin, Krisht,* pas Ungjillit, famëmëdhenijt' plot lavd.

E ngritën Kryqin tënd³⁴ martirët dhe pësimin e nderuar me gaz,* drejt e imituan* pa u epur; trimat s'i tmerruan as tiranët e vrazhd'* me kanosje, as zjarri, as shpatat, as kamxhikimet dhe* as uria, as vdekja, Zot, për ty.

Hyjlindësor

E fortdëlir', kur virgjëreshat morën qartë burrëri dhe guxim,* garat martirike* i duruan pa u epur dhe pas teje, psalmikisht,* Birit tënd, tërëmbretit, u çuan, o Virgjëreshë nën',* duke u gëzuar³⁵ tok dhe hyjnisht.

Zbritësore: Anikso to stoma mu

»Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej »Shpirtit³⁶ Shenjt'* dhe këngë do t'i këndoje nënës së madhe mbi fron;*³⁷ dhe do »ta kremtoj* me valle buzëqeshur,* me »zë do t'i shpall kudo gjithë çudit' e saj.*

Ode III

O stereosas kat' arhás

Si veshën priftëri të shenjt',* barinjte dhe

priftërinjtë* e administruan me mençuri, Krisht,* dhe vërtet e pasuruan përmes fjalëve nga lart* për mësimdhëniet, bukur,* dhe e stolisën nur denjesisht.

Të zbukuruar me stolit'* e para që kish Parajsa,* si ndriçues të vërtet' u treguat* dhe, si qiell, Kishën e Jisuit Krisht e bëtë ju,* shenjtë, e zbukuroat,* ndryshe çdokush, me lloj-lloj stolish.

Me bindje para ligjit tënd,* të lumtët bashkë në kore,* me lloj-lloj virtytesh u hijeshuan,* ndaj në qiell trashëguan mjaft banesa³⁸ me hare* dhe denjesisht të gjithë* rrinë në vendin që u takon.

Hyjlindësor

E linde Fjalën Perëndi*³⁹ nga Perëndia, Hyjnënë,* përmes barkut virgjëror për ne, Zonjë,* ndaj e dëshiruan vajza të dëlira porsi Zot* edhe e ndoqën qartë,* zellshëm pas teje³⁵ të tëra k'to.

Zbritësore: Tus sus innologus

»**O** Zonjë dhe nën' e Perëndisë, burim »i pasosur jetësor,* ti siguroji gjith' ata »që të këndojnë plot me zell;* dhe lart »në q'ell ku mbretëron kurorëzoi me çdo »lavdi.*

Kontaqi Ngjallësor

Ting. Tërth. IV Os aparáhás tis fiseos

Kur dole prej varrit, ngrite të vdekurit dhe ngjalle Adamin. Eva vallëzon për Ngjalljen tënde, dhe anët e botës kremtojnë Ngjalljen tënde prej së vdekurish, o Mëshirëplotë.*

Shtëpia

Pasi plaçkite mbretërinë e Hadhit dhe pasi ngjalle të vdekurit, o Zemërgjerë, takove gratë miropurëse, duke u dhuruar atyre gëzim në vend të hidhërimit,³⁰ dhe

apostujve të tu u tregove simbolet e fitores,³¹ o Shpëtimtari im Jetëdhënës, dhe krijesën e ndriçove, o Njeridashës. Prandaj dhe bota gëzohet për Ngjalljen tënde prej së vdekurish, o Mëshirëplotë.*

Ndenjësore

Ting. Tërth. IV Tin sofian qe Logon

I kujtojmë hyjnisht hierarkët, Krisht,* i lëvdojmë asketët, stëretërit,* profetët dhe etërit,* patriarkët, apostujt njësh,* martirët, oshënarët e tu, çdo të drejtë, shenjt* që e ka emrin shkruar në librin e jetës lart;*⁴⁰ i aktivizojm' për ndërmjetime të gjithë* dhe lusim, o Perëndi* njeridashës, ta paqësosh* botën tënde* përmes tyre* që të të thërrasim: Vërtet* ti je Zot që, në këshillën* e shenjtëve,* lavdërohesh;⁴¹ ndërsa kujtimin ua çmon siç vlen.

Tani Hyjlindësore

Malin e tërëshenjtë⁴² le ta himnojm'* dhe Parajсэн mendore, kthimin e mir'* të Evës dhe arkën,⁴³ pra* edhe portën⁴⁴ e qiellshme,* të ndritshmen re⁴⁵ dhe ferrën që digjej, por s'prishej dot,*⁴⁶ thesarin, pasurinë e madhe të rruzullit,* falje e mëkateve të lashta për ne është,* shpëtimi nga krimi yn'* u punua përmes asaj.* I thërrasim* me përmallim:* Ndërmjeto te Zoti, yt Bir,* që ndjesë shkeljesh të jepet* me dorën plot,* tek ata që i falen lindjes sate me bes'.

Ode IV Si mu iskís Kírie

Duke u bashkuar me anë të dashurisë dhe duke dëfryer në ty singerisht dhe pastër, shoqëria e shenjtorëve kërcen me ngazëllim valle të paprishshme bashkë me engjëjt rreth teje, Perëndisë dhe Zotit të të gjithave.⁴⁷

O hieromartirë të famshëm, me fuqi rinore morët kurorën e martirëve, duke qenë më parë të lavdëruar me krezmimin hyjbërës të priftërisë; prandaj, pasi morët denjësisht kurorë të dyfishtë, ngazëlloheni me Krishtin përjetësisht.

O hyjprurës, gjithë mentalitetin e mishit⁴⁸ ia nënshtruat vërtet Shpirtit, pasi i zhdukët vrullet e tij të pamposhtura me kreshmë dhe asketizëm; dhe tani morët shpërblimet e mundimeve, meqë ndriçoni me dritën e papasionshmërisë.

O të lavdishëm, porsi martirë të Krishtit, të martirit të parë, i duruat shumë me qëndrueshmëri dhe trimëri torturat, duke garuar si në trupa të huaj; dhe tani, përderisa u treguat trashëgimtarë të Mbretërisë,⁴⁹ buroni shërime për besnikët.

Hyjlindësor

O Hyjlindëse, u bërë nuse e Perëndisë, sepse na linde trupërisht Fjalën e tij të parajetshme; me hirin e tij, gratë e rimëkëmbën rënien e stërnënës⁵⁰ pasi jetuan shenjtërisht dhe u stolisën nëpërmjet teje me triumfe të ndryshme.

Zbritësore: Tin aneksihniaston

»Të pagjurmësuarin plan perëndor që po mishërohet i larti Zot prej Virgjëreshës, »Abakumi si profet e pa dhe tha me zë të »madh: Zot i fuqishëm lavdi më ty.*

Ode V Ina ti me aposo

Si profetë hyjnorë, u denjësuat t'i parashikonit të ardhshmet dhe, meqenëse i dëshironit me fisnikërinë e shpirtit, e pastruat veten me sjellje të thjeshtë, o hyjprurës, duke u ndriçuar me fuqinë e Shpirtit.

Tani lavdërohet me karizma të hyjshme kori i shenjtorëve, të gjithë para Ligjit, patriarkët, profetët si edhe apostujt, bashkësitë e martirëve, të asketëve, mësuesve, të të drejtëve bashkë me hieromartirët.

O Shpëtimtar njeridashës, e përhimnojmë pa pushim pasurinë tënde hyjnore dhe bollëkun e të mirave, meqë po shohim sot të ndriçohet mbledhja e shenjtorëve të tu me dritën tënde dhe me llambat e pashuara të Hirit.

Hyjlindësor

Meqë e deshën Birin tënd tejet të admiruar, gratë e tërëthjeshta, i konsideruan si asgjë të pëlqyeshmet e jetës sepse kishin dashuri të flaktë vetëm për lavdinë dhe shkëlqimin e tij hyjnor, o e Tërëkulluar.

Zbritësore: Eksesti ta sîmpanta

»Të gjithë i habite ti me një çudi dhe një »lavdi,* ti, o Virgjëreshë e pamartuar,* »Zotin e jetës që⁵¹ mbretëron lart në q'ell »si një bir e mbajte në pëqi,* dhe shpëtim »që lartazi* u dhurove besnikëve.*

Ode VI Ilâsthitî mi Sotîr

Të gjetën, Zot Shpëtimtar,* shenjtorët si gur të çmuar plot nder që u vu në Sion,* në qoshe,⁵² si bazë të patundur edhe mbi të* e ndërtuan veten* porsi gurë të përzgjedhur, Krisht.⁵³

Pikoi ujë dhe gjak* i shenjtë, hyjbërës, Zot, nga brinja që ta shpuan me shtiz',*⁵⁴ e ftuan hyjnoren mbledhje, mbarë shenjtorët tok,* o Krisht mirëbërës,* dhe e rigatuan kozmosin.

Me mjaft nderim e himnojm'* hyjnoren, ren' e martirëve,⁵⁵ që shndriti prej Hirit nur.* Me gjak si me purpur, me mantelin

e garave* që i bën' me forcë,* shndriti me më shumë hijeshi.

Hyjlindësor

Si nënë krejt të vërtet'* të Zotit të njohim, o e Tërëpaqortueshme, ne,* me ty u çlirua femërorja natyrë pra,* si u mbush me bes' dhe* çdo virtyt, garoi për Krishtin.

Zbritësore: Tin thian taftin

»**K**ëtë të kremte e lusim sot, për Zonjën »edhe nënën Hyjlindëse, gjithë hyjmendë- »sit,* eni trokisni pra duartë*⁵⁶ dhe lavdë- »roni Zotin që lindi prej asaj.*

Kontaqi i Shenjtorëve

Ting. Tërth. IV Os aparhás tis fiseos

Je mbjellës i Krijesës, Zot, ndaj bota të ofron si fli,* aparkë ty prej natyrës, martirë shenjt'* hyjmbajtës; përmes lutjeve,* përgjërimit të tyre, ruaje, i mëshirshëm, në paqe mjaft të thellë Kishën tënde me ndërmjetimet pra të Hyjlindëses.

Shtëpia

Ata që u martirizuan në tërë dheun dhe u shpërngulën në qiej, ata që imituan pësimet e Krishtit dhe na i heqin pasionet, mblidhen sot këtu dhe e tregojnë Kishën e të parëlindurve,⁵⁷ e cila ikonizon të sipërmen dhe i thërret Krishtit: Ti je Perëndia im; o i Shumëmëshirshëm, ruamë pra me ndërmjetimet e Hyjlindëses.

Sinaksari i Mujorit dhe i sotëm:

Sot, të Dielën pas Pentikostisë, festojmë të kremten e Gjithë Shenjtorëve anembanë planetit, në Azi, Libi, Evropë, në Veri dhe në Jug.

Varg: I himnoj mbarë miqtë e Zotit tim;⁵⁸ kur të ketë ndonjë shenjtor në të ardhmen, le të futet në të Gjithë.

Me ndërmjetimet e nënës sate të pacen dhe të Gjithë Shenjtorëve që nga jeta, o Krisht Perëndi, mëshirona dhe shpëtona, si i vetmi i mirë dhe njeridashës. Amin.

Ode VII Theú sigatávasin

Brigadat e shenjtorëve e himnojnë pareshtur atë që prehet ndër shenjtorë,⁵⁹ shijojnë tani dëfrim hyjnor dhe kërcejnë me gëzim duke psalur: Je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Përderisa bashkësitë e shenjtorëve u ndriçuan tërësisht dhe me shpresëtari përmes shkëlqimeve hyjnore nga derdhjet e dritës tridimensionale, e theologojmë me devotshmëri Njësinë e trefishtë, Atin e bashkëpafillim dhe Birin dhe Shpirtin e Shenjtë.

Kur të paraqitesh me lavdinë tënde të pashprehshme, si Perëndi mes perëndish,⁶¹ dhe do t'i japësh secilit⁶² çmimet dhe kurorat, atëherë denjësoji të gjithë të të psalin: Je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Me ngazëllim, le t'i këndojmë korit të gjithë shenjtorëve që përbëhet nga çdo fis, gradë dhe sjellje, dhe le të psalim bashkë me ta: Je i bekuar, o Perëndi i etërve tanë.⁶⁰

Hyjlindësor

Të gjitha ju, të reja, bëni së bashku një kor të hyjshëm për Marinë e pacen dhe të Tërëshenjtën Hyjlindëse dhe thërrisni me zë të lartë: Ngazëllohu, ti që na nxjerr burimin e haresë.

Zbritësore: Uq elátrefsan

»**N**uk u faleshin krijesave hyjmendësit, »por Krijetarit lart*⁶³ dhe kërcënimin me »zjarr* e shkelën me trimëri,⁶⁴ psalnin

»me brohori:* Zot, lavdi më ty, o Perëndi i
»etërve,* ti je vetëm i bekuar.^{60*}

Oda VIII

Eptaplasios káminon

Gëzohuni, o martirë, profetë, apostuj, katalogu i nderuar i hieromartirëve, i të drejtëve, i oshënarëve dhe kori i hyjnueshëm i mësuesve; dhe këndon bashkë me gratë miropurëse: O Djem, bekoni; o priftërinj, përhimnoni;⁶⁵ o popull, përmbilartësoni në gjithë jetët.

O shenjtorë, të mbushur me shkëlqimin përmbi mendje dhe të plotë me ngazëllim, jeni perëndi me anë të afrimitetit me Perëndinë; dhe, duke pasur lidhje me llamburitjet hyjbërëse, dhe duke u ndriçuar prej rrezeve të lavdisë së pashprehshme, përmbilartësojeni Krishtin në gjithë jetët.

O shenjtorë, u dukët si ndriçues të shumëndritshëm dhe e hijeshoni qiellin e Kishës me karizma të larmishme dhe bukuri të ndryshme, me drejtësi, mëçuri, burrëri dhe urtësi, dhe thërrisni:⁶⁶ O priftërinj, përhimnojeni;⁶⁵ o popull, përmbilartësojeni Krishtin në jetë.

Hyllindësor

Të gjitha ju, o gra hyjmenëse, që u përsosët në Krisht përmes Shpirtit dhe rrethoni tani Virgjërëshën e pacen, nënën e vërtetë të Perëndisë, e cila na çliroi nga mallkimi i stërnënës Evë,²² përhimnojeni frytin e saj në jetë.

Zbritësore: Pedhas evajís

»Djemtë* e dënuar për t'u djegur, prej
»zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si
»simbol në lashtësi;*⁶⁷ dhe si një veprim
»tani,* dhe tërë botën po e mbledh për
»këng' e lavdërim:* Himnojeni, ju veprat

»e Zotit,* dhe e lartësoni përmbi të gjitha
»jetët.^{68*}

Ode IX Eksesti epi tuto

Kolona e të zgjedhurve me mjaft bes',* si u fortifikua me shpresë dhe me dashuri,* tërë kërcënimet, çdo fshikullim,* torturat e tiranëve* i duruan plot lavd dhe me gaz, pra* martirët e vërtetë,* të pasur mjaft me Krishtin* që jep fitore gjatë garave.

Ta mburrim denjësisht Pagëzorin tash,* si liman shpëtimtar, me mësues të hyjshëm dhe gra* të perëndidashura, priftërinj,* apostuj me profetë njësh,* hierodëshmorë famëmëdhenj,* martirë, oshënarë,* të drejtë dhe asketë* me shoqërin' e patriarkëve.

E shenjta bashkësi, u sprovove mjaft* me zjarr ngasjesh edhe nuk të joshën shijime aspak,* ndaj, lavdimëdhenj, ke ni gaz vërtet* dhe pranë fronit zotëror,* dritëpamës rrini në qiejt lart,*¹⁰ sepse pasqyrat⁶⁹ ikën* me hijen e pavlefshme,*⁷⁰ kur e vërteta qartas na u shfaq.

Hyllindësor

U shfaqe si pajtuese, Virgjërësh',* për të ndarat, se njerëzit janë përmes teje lart* dhe në qielloret tenda vërtet* me engjëjt; e dëshmojnë qart'* koret e krejt shenjtëve që tani* me ta e përhimnojnë,* Hyllindëse, tët Bir pra* përjetësisht me këngë, melodi.

Zbritësore: Apas jijenís

»Gjithë njerëzit, kërceni me ngazëllim te
»drit' e Shpirtit Shenjt',* eni lavdërojeni;*
»engjëjt e q'ellit eni kremtojeni* këtë të
»shenjtë panair të kryezonjës Mari* dhe
»thërrisni:* Ti je më e lumura,* Virgjërësh'
»e kulluar Hyllindëse.*

*Dërgimësore: Tis Mathitës sinélthomen
Ngjallësore*

Mblidhuni me dishepujt tok* në mal të Galilesë,* ku po na thotë Zoti Krisht,* se e ka marrë forcën* kudo mbi dhé e mbi q'ellin,* se atje Pagëzimin* për gjithë kombet urdhëron,* n'emër t'Atit e Birit e Shpirtit t'Shenjt',* dhe kështu të mbe-temi të bashkuar,* përjetë pas premtimit t'tij,* gjer në mbarim të jetës.^{71*}

E Shenjtorëve

Me himne ta kurorëzojm'* Prodhromin, Pagëzorin* me hierodëshmorët tok,* çdo oshënar, profetët,* apostujt me hierarkët,* gjithë të drejtët bashkë,* martirët dhe asketët shenjt',* të hydashurat gra, rendin engjëllor,* ta lëvdojmë detyrimisht, ta lypim* Zot Shpëtimtarin, të fitojm'* lavdin e tyre ne krejt.

Hyjlindësore

Ai që lavdërohet shumë* prej engjëjve hyjnisht lart,*⁷² me ne u shoqërua posht',*¹¹ pashprehshëm sado s'iku* nga atërori gji³ dhe ti* shkak për shpëtim u bëre* për ne, i dhe nga gjaku yt* i dëlir', e kulluar, si hua trup* përmbi fjal'; për ne shërbëtorët e tu* kërkoji ndjesë për çdo faj,* t'na japë hir e paqe.

Lavdërime

Ngjallësore Ting. Tërth. IV

O Zot, megjithëse vajte në gjykatore...

O Zot, megjithëse të vunë...

O Zot, armë kundër djallit...

Engjëlli yt, o Zot, që lëçiti Ngjalljen...

Pësove në Kryq, ti i papësuar...

Të Shenjtorëve

Ting. IV Os jeneon en mártisin

Zoti, shenjtët që jan' në dhe,* të çu-

ditshëm i bëri krejt,*⁷³ se mbi trup pranuan pësimet, plagët tmerr* që kish pësuar ai⁷⁴ dhe u stolisën kështu me hir* qartë, bukur dhe hyjnisht;* porsi yje që s'humbin kurr'* sipër Kishës son'* dhe si lule që s'vshken, t'i nderojmë, si flijime, si therore vullnetarisht, se e donin fort.

Le t'i mburrim mësuesit,* oshënarët, apostujt tok,* hierodëshmorët, profetët, çdo martir,* gratë që bën' asketizëm me mall edhe garuan fort* dhe të drejtët njësh në grup,* pra shumicën e shenjtëve* ta lëvdojmë ne* me psalmime hyjnore, si banues në Parajsën lart edhe si trashëgimtarë të Mbretëris'.⁴⁹

Ti lëvdojmë martirët ne,* se e bënë si qiell dhen',* me virtyte, hyjshëm e imituan drejt* vdekjen e Krishtit dhe ecën mbi një udhë që është shkak* për pavdekësinë ton'* dhe që veset e njerëzve,* me një kirurgji* plot me hir, i pastruan dhe garuan burrërisht në botën mbar', me një shpirt, guximshëm dhe trimërisht.

Lavdi Mëngjesor Ting. I

Kur dishepujt nxitonin drejt malit për lartësimin e Zotit prej dheut, ai u doli përpara. Dhe si iu falën atij dhe si mësuan pushtetin që iu ishte dhënë kudo, prej së larti u dërguan të predikonin Ngjalljen prej së vdekurish dhe rivendosjen në qiej, të cilëve u premtoi se do të jetë me ta përjetë: Krishti,⁷⁵ Perëndia i vërtetë dhe Shpëtimtari i shpirttrave tanë.*

Tani

E përmbibekuar je...

Dhoksologjia e Madhe

Në Liturgji [Tipiket dhe Lumërimet: 4 të Tingullit, 4 nga Ode III dhe 4 nga Ode VI e Shenjtorëve. Ose] Antifonet e të dielave. Të

tjera si zakonisht, por Kontaqi Je mbjellës i Krijesës, Zot... Kungatore: Ngazëllohuni, o të drejtë, në Zotin; të drejtëve u ka hije lavdërimi. Alilulia.

CITIME

1. Gjen. 2.7-8,15; Ps. 102(103).14; 118(119).73; 138(139).5; Jov 10.8.9; II Makk. 7.23
2. Fil. 2.7
3. Joan 1.18
4. Ps. 2.6 etj.
5. Eks. 25.30,37; 35.16; 38.13; 40.22; Num. 8.2; Hebr. 9.2
6. Eks. 38.16(37.19)
7. Hebr. 11.33
8. Hebr. 11.35-37
9. Matth. 16.18
10. III [I] Mbret. 17.1; 18.15; IV [II] Mbret. 3.14; 5.16
11. Baruh 3.38
12. Gjen. 5.24; Hebr. 11.5
13. Num. 14.19 etj.
14. Ef. 5.19; Kol. 3.16
15. Vep. 9.31
16. Ps. 41(42).5; 46(47).2; 117(118).15
17. I Tim. 3.9; II Tim. 1.3
18. Matth. 4.19; Mark 1.17
19. Kol. 3.5
20. Fja. Urt. 9.1-2
21. II Tim. 2.11-12
22. Gjen. 3.16-19
23. Lluk. 1.28
24. Joan 1.4; 11.25; 14.6; Kol. 3.4; I Joan 1.2; 5.12,20
25. I Petr. 1.12
26. Joan 10.15,17-18
27. Matth. 28.1-8; Mark 16.1-8
28. Matth. 27.66
29. Matth. 28.2
- 29a. Matth. 28.4
30. Matth. 28.9-10
31. Lluk. 24.12; Joan 20.3-8
32. Hebr. 1.3
33. I Tim. 6.16
34. Matth. 10.38; 16.24; Mark 8.34; 10.21; Lluk. 9.23; 14.27
35. Ps. 44(45).15-16
36. Ps. 44(45).2; 118(119).131; Jez. 3.27
37. Ps. 44(45).10
38. Joan 14.2
39. Joan 1.1
40. Fil. 4.3; Apok. 13.8; 20.12-15; 21.27; 22.19
41. Ps. 88(89).8
42. II Petr. 1.18
43. Eks. 25.9-20; 38.1; Ligji i Dytë 10.2; II Kron. 6.41; Ps. 131(132).8; Hebr. 9.4
44. Gjen. 28.17
45. Eks. 13.21-22; 16.10; 19.9; 34.5; Num. 9.15; 11.25; Ligji i Dytë 31.15; Urt. Sol. 18.3; Is. 19.1
46. Eks. 3.2-3
47. Jov 5.8; Urt. Sol. 6.7; 8.3
48. Rom. 8.6-7
49. Jak. 2.5
50. Gjen. 3.2-6
51. Rom. 9.5
52. Is. 28.16
53. I Kor. 3.1-12
54. Joan 19.34
55. Hebr. 12.1
56. Ps. 46(47).2
57. Hebr. 12.23
58. Lluk. 12.4; Joan 15.14
59. Is. 57.15
60. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 2,28
61. Ps. 81(82).1
62. Rom. 2.6
63. Rom. 1.25
64. Dan. 3.17-18
65. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 61
66. Urt. Sol. 8.7
67. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 25-26
68. Dan. kap. 3 Lutja e Azarias 34
69. I Kor. 13.12
70. Kol. 2.17; Hebr. 8.5; 10.1
71. Matth. 28.20
72. Ps. 148.2; Is. 6.3
73. Ps. 15(16).3
74. Gal. 6.17
75. Math. 28.16-20



Dhiata e Vjetër në adhurimin e Kishës

Kisha e ka përdorur që nga fillimi përkthimin e Dhiatës së Vjetër që quhet përkthimi "ItëShtatëdhjetëve" (Εβδομήκοντα, Septuaginta - në vazhdim: S.), i cili u bë midis shekujve III dhe I para Krishtit. Është përkthimi më i rëndësishëm i Dhiatës së Vjetër - më poshtë do të flasim dhe për përkthime të tjera.

Përkthimi i S. ka shumë gabime gramatikore dhe sintaksore. Atëherë, si e pranoi dhe e ka në përdorim Kisha për dy mijë vjet, edhe pse u bënë në kohëra të ndryshme dhe ekzistojnë përkthime më të sakta?

Shkaku kryesor është se bëhet fjalë për punë parakristiane që u realizua nga vetë hebrenjtë në Aleksandrinë e Egjiptit. Gjuha hebraike ishte harruar jashtë Palestinës, madje në Palestinë, në kohën e Krishtit, flitej gjuha aramaike, një degë simitike mjaft afër hebraishtes.

D.m.th. nëpërmjet Aleksandrit të Madh, gjuha dhe kultura greke ishte përhapur në botën e atëhershme. Është karakteristike se Dhiata e Re u shkrua greqisht, përveç Ungjillit të Mattheut që u shkrua hebraisht, por u përkthye shpejt ose nga vetë apostulli, ose me mbikëqyrjen e tij. Madje letra e Pavlit drejtuar Romakëve është në greqisht.

Pra, Kisha, me shumë urtësi, e mbajti përkthimin e S. dhe jo ndonjë tjetër paskristiane, që të mos akuzohej se e kishte bërë sipas interesave të saj. Një shembull:

Në profecinë e njohur të Isaisë që thotë se Krishti do të lindej prej një virgjëreshë (7:14) teksti hebraik nuk e ka fjalën "almah" (= virgjëreshë), por "betulah" (=

grua e re, para kohës së martesës) - në këtë pikë u bë debat i madh. Pra, ishte e paimagjinueshme që një vajzë para martesës të mos ishte vajzë, etika e Moisiut ishte strikte.

Pra, përkthimi në këtë pikë dha kuptimin e pasazhit. Madje, nëse do të nënkuptohej një grua e zakonshme dhe jo e virgjër, pse profeti e thotë pikërisht më përpara, në të njëjtin varg, "Zoti do t'u japë një çudi: Ja që virgjëresha do të bëhet shtatzënë..."? Si do të ishte çudi kur të gjitha gratë janë virgjëresha para martesës dhe lindjes?

Pra, nëse do ta kishim përkthyer "gruan e re para martesës" në "virgjëreshë", do të na akuzonin për shtrembërimin, falsifikimin e tekstit. Në këtë pikë ata S. devijuan pak nga ana letrare në përkthim, por patjetër kjo u bë me hyjfrymëzim, se dogma për zënien e së Tërëshenjtës është diçka bazë për Krishtërimin.

Për raste të tilla, Kisha preferoi ta mbannte përkthimin e S. sado që ekzistojnë tri përkthime të tjera qysh nga shekujt I dhe II pas Krishtit. Dhe kuptohet se ka dhe përkthime të tjera të mëvonshme.

Nuk ka vend mendimi se Etërit dhe shkrimtarët e Kishës nuk dinin hebraisht, prandaj dhe Kisha mbajti detyrimisht përkthimin e S. Janë të famshme "Eksapla" ("Gjashtëpiket") e Origenit. Ati i Kishës shën Epifani, kryepiskop i Qipros, ishte izraelit, shën Lukiani korrigjoi dhe plotësoi përkthimet e mëparshme etj. Por, edhe ka përkthime në vazhdim e deritani (p.sh. Dhiata e Vjetër, mbikëqyrje e përgjithshme nga prof. dr. Athanasi Haptupi, përkthimi nga teksti hebraik i korrigjuar, Athinë 1960). Por dhe ata, për-

kthyesit, nuk pretendojnë që punët e tyre të përdoren në adhurim.

As Etërit e Mëdhenj dhe as Mësuesit Eku-menikë nuk guxuan ta preknin tekstin liturgjik të S. Shën Grigor Theologu, p.sh., ishte një filolog tejet i famshëm, një kolos! Në poezinë e tij ndjek Homerin. Por dhe në shekujt e fundit kanë ekzistuar figura të mëdha nga ana e gjuhës dhe e thelogjisë, si Nikodhim Agjioriti (1749-1809). Para Grigor Theologut ne jemi xhuxha në fushën letrare; ndërsa, në fushën e hyjfrymëzimit, jemi pluhur!

Nga ana tjetër, edhe teksti hebraik që kemi, ka defekte dhe nuk dimë se cili është versioni më origjinal në pika ku ndryshojnë disi, pra i studiojmë paralelisht.

Heretikët thonë se, për të tërhequr lexuesit, duhet të përkthehet Shkrimi i Shenjtë në një gjuhë “të rrjedhshme”. Por fjala e Perëndisë nuk është roman për shijim estetik! Kënaqësinë letrare mund ta gjejmë gjetiu. Bibla ka “hare-dhimbe”, ka lajmin e mirë, por u shkrua me dhimbje dhe lot, thanë, dhe zbatohet kryesisht me dhimbje, lot, madje edhe me gjak! Nëse përtojmë ta lexojmë një herë, do të përtojmë ta zbatojmë një qind herë! Etërit thanë “jep gjak, që të marrësh shpirt”!

Mirë, por si do ta bëjmë Ungjillin më të afrueshëm te populli i Perëndisë? Fatkeqësisht, nuk kemi ende shqip një shpjegim të Biblës. Në vende të tjera ekzistojnë punë të tilla të mrekullueshme nga thelogë orthodhoksë. D.m.th. përkthimi i saktë nga ana letrare dhe poshtë komentet e Etërve të shenjtë dhe të të tjerëve ose, të paktën, përkthim i lirshëm, i zgjeruar dhe joliteral. Mirëpo, siç thamë, këto punë nuk janë për përdorim liturgjik

dhe asnjë nga përkthyesit nuk pretendon diçka të tillë.

Nëse në pika të vështira të S., që nuk janë të qarta, që mund të kuptohen ndryshe, do të mbajmë një version dhe të tjerat do të lihen, nuk do të kuptojmë referencat e Etërve, të cilët do të kishin preferuar një tjetër shpjegim. Që ta sqarojmë atë që themi, një student i atëhershëm na kishte pyetur se si apostull Pavli thoshte diçka - nuk na kujtohet pasazhi konkret.

U çuditëm dhe iu përgjigjëm: “Ku është shkruar kështu, ore Kozma?”. Na tregoi vargun. Përkthyesi e kishte përkthyer në versionin më të dobët! Gjithashtu, çdo gjuhë ka veçoritë e saj. Pra, ka dhe “stile” të ndryshme. Hebraishtja, për të dhënë shkallën sipërore, radhit dy herë fjalën. P.sh. “Duke duruar, e durova Zotin” (Ps. 39:2). Ose “Kënga e Këngëve” (=kënga më e bukur). Janë “idiomatizma” hebraike, stili biblik.

Heretikët, për të cilët po flasim, thonë të vëmë në adhurim përkthime të reja, sepse “germa vret”. Por Pavli e tha (II Kor. 3:6) jo nga ana letrare, por shpirtërore. Qortonte hebrenjtë për formalitet. Mbanin tipat dhe humbnin esencën, siç i kishte qortuar Krishti [“Jepni të dhjetën e mendrës e të marajt e të barit të gjumit, dhe keni lënë më të rëndësishmet e Ligjit”] (Matth. 23:23).

Me liberalitetin që i karakterizon këta heretikë jo vetëm në përkthim, por edhe në shpjegimin e Biblës, meqë çdokush nga ata është goja e hyjfrymëzuar, janë copëtuar në qindra dhe qindra sekte, nuk e dimë numrin e tyre; madje ndoshta as Zoti nuk do ta dijë! Dhe vazhdojnë të copëtohen... Ku është Shpirti i Shenjtë? Shpirti bashkon, armiku ndan!

U shfaqën para pak shekujsh dhe duan

të mësojnë Kishën dymijëvjeçare. Pa busullën e Traditës së shenjtë u shfaqën të cekët. Sipas shën Joan Gojartit, nëse në ndonjë çështje ekziston Tradita, “mos kërko diçka më tepër” (Komentar, II Thes. 2:15). Tradita, trashëgimia e paçmuar! Por ata thonë “Vetëm Bibla”. Në realitet, pa Traditën, nuk kanë as Biblën! E çuditshme, por e vërtetë! Tradita na ka thënë se cilat janë Shkrimet e Shenjta, meqë, siç dihet, ka edhe libra pseudonime me emra profetësh dhe apostujsh. Tradita e Shenjtë e Kishës i ka mënjanuar librat falso dhe na ka dhënë libra autentikë të Biblës! Pra, thamë se, pa Traditën, nuk ekziston Bibla. Kjo do të mjaftonte që të mbaronte këtu diskutimi, por ne po vazhdojmë.

Ideja e tyre se çdokush përkthen me hyfrymëzim, pra saktë, Fjalën e Perëndisë, jo vetëm Dhiatën e Vjetër, por dhe atë të Re, i ka keqpërdorur të dyja; dhe, disa herë, grupimet e tyre kanë shpjegime të kundërta, ndaj kanë konflikte midis tyre! Kanë përfunduar në besim dhe etikë të kundërt të Shkrimit të Shenjtë. P.sh. nuk dënon me vdekje vetë Dhiata e Vjetër(!) homoseksualizmin (p.sh. Lev. 20:13), por shprehet rreptësisht edhe e Reja (p.sh. Pavli në I Kor. 6:9-10).

Ata jo vetëm e pranojnë homoseksualizmin, por mburren për të! Madje edhe krerët e tyre mund të jenë homoseksualë. Kështu siç po shkojnë gjërat, nuk përjashtohet fakti se, pas pak, homoseksualizmi dhe pedofilia të jenë avantazh për grada të larta në sektet e tyre... Disa thonë se ai që dënon mëkate të tilla është Pavli, jo Krishti. Mendimi i atyre që mënjanojnë shenjtoret, na kujton dikë tjetër për të cilin flet oshënar Dorotheu dhe tregon se ku të çon egoizmi kur nuk

ndjekim udhëzues të shenjtë:

“Me të vërtetë, o vëllezërit e mi, unë njoh dikë që arriti në situatë mjerane. Në fillim, kur fliste një vëlla me të, e përbuzte dhe thoshte: ‘Kush është ai? Nuk ka përveç Zosimait dhe atyre që e ndjekin’. Pastaj filloi dhe nuk i vlerësonte dhe ata, dhe thoshte: ‘S’ka ndonjë tjetër përveç Makarit’. Pas pak filloi të thoshte: ‘Kush është Makari? S’ka si Vasili dhe Grigori’. Pas pak filloi t’i përbuzte dhe ata duke thënë: ‘Kush është Vasili dhe kush Grigori? S’ka si Pavli dhe Petroja’. I them: ‘Vërtet, o vëlla, dhe ata do t’i përbuzësh’. Më besoni, që pas pak kohe filloi të thoshte: ‘Kush është Petroja dhe kush Pavli? Askush përveç Trinisë së Shenjtë’. Kështu më vonë ngriti krye dhe ndaj Perëndisë dhe u çmend” (Mësimdhënia II Për përlulësinë, 4).

Një profesor theolog i nderuar në fushën ndërorthodhokse, z. Gjergj Galitis, dëshmoi se në një konferencë ndërkristiane u ngrit një grua “klerike” dhe tha: “Uluni ju, burra, uluni dhe shkruani Ungjij të rinj, sepse të vjetrit janë vjetëruar dhe u ka kaluar koha!”. Ai nuk tha nëse reagues koleget e saj e thanë: “Je antifeministe? Ne do të shkruajmë, jo burrat!” (Ark. Timothe Xjavara, Ορθόδοξη Θεολογία και Ισλάμ, 2014, fq. 32).

Këtu përfundon “mendja e hapur”, pa radarin, GPS-in e Etërve të shenjtë. Nga dimensionin “horizontal” ata punojnë, në rregull, por ekziston dhe dimensionin vertikal, jeta e brendshme, “njeriu i fshehur i zemrës” (I Petr. 3:4) që ka rëndësi kryesore. Në ungjillin e ri do të përfshihet dhe thënia e Pavlit (Gal. 1:8) “nëse ne ose një engjëll nga qielli do t’ju ungjillëzonte jashtë atij që ju ungjillëzuam ne, qoftë anatematizuar”?! “Është qesharake ta

konsiderojë dikush veten e tij më të mirë nga ai që shkroi Biblën”, thotë një apologjet i lashtë (Justin, Dialog, 85.5). Kështu, përsëri Pavli e këshillonte nxënësin e tij Timothe ta ruante të vërtetën që i ishte besuar dhe t’u shmangej fjalëve boshe nga njohuria pseudonime (I Tim. 6:20).

Pra, përkthimi i S. është maja e ajsbergut, thjesht shfaq mentalitetin e tyre. Dhiata e Re përdor përkthimin e S. Korrigjojnë apostullin Pavël, qoftë nga ana shpirtërore, qoftë nga ana letrare - apostulli shprehej spontanisht, pra fjala e tij ka shumë gabime - do të korrigjojnë dhe ato të Krishtit? Dhe pasazhet e Tij nga Dhiata e Re janë marrë nga S, p.sh. kur satani E ngacmoi në shkretëtirë pas pagëzimit të Tij, Zoti iu përgjigj me vargje nga Dhiata

ta e Vjetër. Një përgjigje ishte pasazhi (Ligji i Dytë 8:3) se nuk do të jetojë njeriu vetëm me bukë, “por mbi çdo fjalë që del nëpërmjet goje Perëndie” (Matth. 4:4). Nuk do të ishte më e rrjedhshme në vend të “mbi çdo fjalë që del nëpërmjet goje Perëndie” të shkruante “me çdo fjalë të Perëndisë”? Ka bërë gabim? Nuk është pyetje retorike! Perëndia na ndjeftë për blasfeminë!

Për ne, pra për Kishën, miliona shenjtore u shenjtëruan me këtë Bibël gjatë historisë, ndërsa ata për të cilët po flasim, nuk kanë shenjtore, nuk i njohin shenjtorët, lundrojnë në detin e jetës pa ngushëllim, pa shembull nga vëllezër të shenjtë!

